



DY FJALË PËR LEXUESIN

Duke pasë kërkesa të mëdha nga lexues të internetit, për të marrë informacion mbi botimet që bëhen në Postribë, dhe kryesisht për Postribën, mendova t'u vë në dispozicion, në mënyrë të shkurtuar, disa të dhëna nga libri "Postriba" (përmbledhje studimore), të autorit Riza Spahija, i cili ka të përfshir 63 autorë të huaj dhe 130 autorë shqipëtarë, të marrura nga 549 referenca të këtyre autorëve.

Në këtë material, nuk kam përfshir ilustrimin fotografik, i cili gjendet i bollshëm dhe me ngjyra në librin studimor "Postriba"

Materiali që paraqitet në këtë faqe është i zgjedhur, por jo i plotë, siç është i paraqitur në tre vëllimet.

Personat që kërkojnë të marrin informacion të plotë, mund ta gjejnë tek autori i këtij libri, ose mund të bëhet kërkesë në "facebook", në adresën : riza_spahija@hotmail.com.

POSTRIBA

Postriba është rrethinë etnografike që përfshin fshatrat rrëzë maleve Maranaj e Cukal, në të dy anët e lumit Kir, duke shkuar në veri deri afër Sheut të Rrjollit. Si qendër është fshati Drisht me kalanë e tij historike. Territorin e Postribës e përbëjnë fshatrat: Drishti, Vilza, Ura e Shtrejtë, Domni, Boksi, Dragoçi, Kullajt e Boksit, Mesi, Myselimi, Rrash-Vorfa, Shakota dhe Suma me lagjet e saj (Gurra-Dajcë, Bukmirë, Pergjon, Dedgjon, Vatnikaj, Delaj, Bojaj, Likaj). Në të kaluarën baza ekonomike e postribasve ka qenë blegtoria, sidomos në zonën malore të saj, ndërsa në zonën fushore përparësi kishte bujqësia, kryesisht drithërat e bukës, perimet. Kultura e duhanit hyri pas shekullit XVII. (Fjalori Enciklopedik, "Postriba", f. 863).

Sot Postriba përmbledh bajrakët e Drishtit, të Boksit dhe atë të Sumës, krahina që përfshijnë shumë fshatra. Dikur para Luftës Ballkanike përfshinte edhe Shllakun e Temal-Dushmanin, që sot shkojnë me zonën e Dukagjinit...

Në çdo vend të botës, popujt kanë qenë gjithmonë në lëvizje, në kërkim të një jete më të mirë. Lëvizjet mund të kenë ndodhur për arsye të ndryshme si për probleme gjaku, për raste luftërash të ndryshme, vendosje të detyrueshme për arsye të ruajtjes nga konvertimi drastik i religjionit më të fuqishëm, për

gjenocid etnik etj. Gjithsesi popujt janë vendosur në vende të ndryshme ose duke emigruar në vende të tjera ose gjatë migrimit nga vendet e tjera në vendin ku banojnë sot. (studimi im, R. S).

Zona e Postribës ka qenë një bazë e rëndësishme e Luftës ANÇ dhe malësorët kanë marrë pjesë në të gjallërisht. Pas çlirimit (1944), Postriba ka marrë një zhvillim të madh ekonomik e shoqëror. Ka përparime të ndjeshme në mënyrën e jetesës. Burimet ekonomike janë shtuar. Është zgjeruar shumë sipërfaqja e mbjellë me kulturën e duhanit dhe të perimeve, (Fjalori enciklopedik)...

Në zonën e Postribës, që në lashtësi kanë ardhur studiues të fushave të ndryshme, pasi kjo zonë ka paraqitur interes të veçantë, sidomos për qytetërimin e lashtë të qendrës kryesore të Postribës, qytetit të Drishtit, ose siç quhej në dokumente të vitit 1120: "Drivastensem", në shekullin e XIV: " statuta et ordinatones ecclesie cathedralis "Drivastensis", dhe në mbishkrime të hollash, po në këtë shekull "Civitas Drivastum"...

Qendra e Postribës me Drivastin e lashtë përfshinte një hapësirë mjaft të gjerë, që fillonte me kalanë e Drishtit, ku qëndronte Paria e qytetit dhe vazhdonte të shtrihej në dy anët e rrjedhjes së lumit Kir duke kaluar lagjet Sulejman, Milan, Zhup, Firip, Hebibaj, pastaj kalonte nëpër fshatrat Boks, Dragoç, Kullaj, Rrash deri tek Kisha e Shëngjinit, ku edhe sot gjenden rrënojat e saj afër fshatit Rrash. Gjithë kjo hapësirë, nga Kalaja e Drishtit dhe deri tek Kisha e Shëngjinit në Rrash ka qenë e mbushur me shtëpi banimi e ndërtesa ekonomike, ku siç ka mbetur gojëdhëna nga populli: "Kalonte macja çati më çati". Këto të dhëna nuk janë vetëm gojëdhëna, por janë të pasqyruara edhe në dokumenta të kohës, të cilat vertetojnë qytetërimin e lashtë të kësaj zone.

Dokumente të shkruara, të njohura deri më sot, dëshmojnë se, që në vitin 1402 në Drisht, ekzistonin dogana të posaçme për eksportimin e fshikëzave dhe fijeve të mëndafshita. Kjo tregon se masa e prodhimit të fshikëzave dhe fijeve ishte në ato përmasa, sa që përveç plotësimit të nevojave të brendshme, mbetej edhe për të eksportuar.

Një tjetër tregues i rëndësishëm i lashtësisë dhe kulturës së Postribës është "Varreza Tumulare e Shtojit", një nga më të mëdhatë në Shqipëri për nga numri i tumave, që në gjendjen e sotme të ruajtjes përfshihen rreth 160 të tilla. Për këto tuma flet edhe studiuesi i zellshëm i kulturës shqiptare, patrioti Shtjefën Gjeçovi, i cili një pjesë të materialeve arkeologjike, të mbledhura prej tij, me sa duket u përkasin tumave të Shtojit. Tumat e Fushës së Shtojit i përkasin zonës së Postribës dhe përbëjnë një qytetërim ilir. Kjo është aq e vërtetë sa që në Kratulën mbi Sekaj të fshatit Boks është zbuluar kështjellë ilire, ku gjenden gjurmët e portës së lindjes dhe asaj të perëndimit. Kjo kështjellë gjendet afër minierës së mermerit po mbi Kratul. Kështjella ilire ka një pozicion gjeografik të përshtatur për të kundëruar Kalanë e Drishtit si dhe atë të "Rozafatit" në Shkodër. Studimet arkeologjike në Varrezat Tumulare të Shtojit i realizoi doktori i shkencave historike Aristotel Koka, të titulluara me temën: "Varreza Tumulare e Shtojit". Gjurmimet e rregullta të doktorit të shkencave historike, Aristotel Koka filluan në vitin 1980 dhe deri në vitin 1990 ai realizoi studimin dhe gërmimin e 11 tumave. Këto tuma janë ngritur në fazën e bronxit të hershëm ose siç quhet "Në periudhën prehistorike", si dhe në fazën e dytë që i përket periudhës së hekurit ose asaj qytetare.

Sipas studiuesit Jorgo Panajoti, mësojmë se këngët shkodrane hyjnizojnë heroizmin e trimave shkodranë në mbrojtje të tërësisë tokësore dhe sovranitetit të vendit nga pushtuesit. Kënga shkodrane hymnizon në rradhë të parë trimat si Dasho Shkreli, Oso Kuka, Mehmet Shpendi, Adem Haxhija (Postribë). Ajo përqendrohet më shumë në ngjarje që lidhen me qytetin e Shkodrës (madje me kalanë e saj, dugajtë, Bahçallekun), me Postribën, Kastratin, Krajën, Dukagjinin, Koplikun, Qafën e Malit, Prronin e Thatë, Fushën e Shtojit, etj.

Studiuesi Prof. Dr. Ramazan H. Bogdani na informon për krijimet koreografike tradicionale të Postribës. Ai tregon se Postriba gëzon një pasuri të madhe kulturore e shpirtërore që lidhet me jetën e pasur artistike të zonës..

Një studim me vlera të mëdha shkencore për Postribën ka kryer gjeologu i madh, paleontologu dhe albanologu i njohur hungarez, doktor Franc Nopça (1877-1933). Veprat e tij janë gjeologjike, gjeografike, etnografike e deri poetike. Ky autor, me dije e kulturë të gjithanshme, përshkruan në tërësi pasurinë kulturore të Shqipërisë së Veriut dhe është i pari që ka bërë rajonizimin e Alpeve dhe të Cukalit, ku në këtë të fundit përfshihet edhe Postriba. Gjithashtu ka studiuar edhe Malësinë e Pukës dhe një pjesë të Malësisë së Mirditës. Si rezultat i këtyre studimeve, Nopça, bëri një sërë botimesh, ndër të cilat më me rëndësi është vepra "Gjeografia dhe gjeologjia e Shqipërisë së Veriut", bashkë me hartën gjeologjike

përkatëse në shkallën 1: 200 000. Kjo hartë është mjaft e mirë dhe me gjithë të metat që ka, mund të përdoret.

Në gazetën “Agimi” të vitit 1920, në artikullin “Edhe Shkodra” thuhet mes tjerash: “Mbas Korçës e Vlorës, në mbrojtje të trojeve ngrihet edhe Shkodra. Shkodra plakë e Bardhylëvet, e Gencëvet dhe e Teutës. **Në kushtrim të Shkodrës dynden edhe Malcija, Hoti e Gruda, Shkreli e Kelmendi, të pesë bajrakët e Postribës si edhe ato pesë të Dukagjinit...**”

Në gazetën “Agimi” të vitit 1920, në artikullin “Lajme vendi” ndër të tjera thuhet: “.. Me një të gushtit të dielën, në njëmbëdhjetë para dite u nis në ballë të luftës ushtria vullnetare, e përbërë prej 500 vetvet, vetëm shkodranë. Me këtë u bashkuan kosovarët, muhaxhirët e Podgoricës e rrethet e krahinës së Shkodrës. **Remit të djathtë u printe Deli Meta me hotjanë e Adem Haxhija me postribas, dy fise këta më të fortat e Gëgnisë sonë e që, si ndër kohë të lashta ashtu të vona janë kenë mburoja e palëkundëshme e Shkodrës kundra sulmevet malazeze.**”

Në Gazetën “Populli” të vitit 1919, në titullin “Akt bese” bëhet fjalë për besën e lidhur në fshatin Prekal mes bajrakëve të Postribës dhe të Dukagjinit. Kjo besë u lidh me 25 nëntor 1919. Në mes tjerash thuhet: “Na të nënshkruemit parijs e përfaqësuesit e bajrakut të Drishtit, Sumës, Boksit, Shoshit e të Kirit, të cilët jemi mbledhë sot me 25 nëntor 1919, të ejten, në Prekal e kena lidhë si mbas zakoneve të vendit e kombit tonë, një besë për dhjetë javë, që prej datës 27 të këtij muaji e deri të katërten ditë të Shënkollit...” Gjithashtu u lidh besë edhe më 4 tetor 1919 deri ditën e parë të majit 1920 mes bajrakut të Boksit dhe atij të Prekalit. Në shtypin periodik të viteve 1919-1920 Postriba përmendet disa herë për lidhje bese me bajrakët e Dukagjinit, për luftën në mbrojtje të trojeve, etj. Në gazetën “Koha e Re” nr. 6, të vitit 1920 në studimin shkencor “Geographie moderne de la grande Albania” ose “Gjeografia moderne e Shqipërisë së Madhe”, ku përfshihen katër vilajete: i Shkodrës, i Kosovës, i Manastirit dhe i Janinës, në mes tjerash bëhet fjalë edhe për Postribën si zonë e fisme, e trimërisë dhe e besës, për mbrojtjen e trojeve.

Një zë të fuqishëm për heroizmin dhe nacionalizmin e trimave të Postribës, na paraqet autori Kasem Taipi me botimin e tij “Zana popullore”. Në këngën e Mustaf Pashë Qorrit, ndër të tjera thotë:

“Kishte kenë kjo Postriba
Përmbi të gjithë malet e Malcis
Kryet xurr Selmani
Mori shpaten e llis...”

Në materialin gojor që kam marrë nga pleq të Urës së Shtrejtë, kënga që paraqita më lart këndohet kështu:

“...Sylejmani i Tafë Alisë
Preu kryet e llisë
Nën shpatë të Malcisë...”

Në këngën e Haxhi Alisë, i cili është nga Postriba, Kasem Taipi thotë ndër të tjera:

“ Haxhi Alija me të birin
Porsi mbret me Vezirin
Nën haraç ç’e shtjen qafirin
Sa të ja mbërrinë trimnis
Rahmet xhana Haxhi Alisë...”

Tek kënga e Hamz Kazazit, autori thotë ndër të tjera:

“Një sahat pa dalun drita
Ja mërrijni Postriba
Postriba porsi motit
Me yryç shkuen te topi
...

Haxhi Idrizi kishte thanë
Do t'i vijë galib halldupit
Nën klluç i prenë të tanë
Si në vakt të Kara Mahmudit

...

Hot e Krajë, Shalë e Shosh
Postriba me shkodranë
Yryç bajnë në Tarabosh
Marrin krena e nishanë

...

Hafiz Pasha si iblizi:
Trim qenka Haxhi Idrizi
Trim qenka he gjettë belanë
Lufton Dashja me gjithë të vllanë

...

Në Postribë trima pashë
Bashkë me male kahremana
Nizamin e banë helaqë
Moren rob edhe nishana..."

Në temën "Patronime nga leksiku i besimeve fetare" shkruar nga Dr.Jusuf Shpuza (Shkodër), paraqitur në seminarin e katërt "Shkodra në Shekuj", vëllimi i tretë na paraqiten disa patronime, por unë po paraqes ato që kanë lidhje me zonën e Postribës: "Domi, dokumentohet në shekullin XV (Moreto Domi, Luban, Shkodër), 1417 dhe Brayco Domi, Reç, Shkodër, 1417. Nuk përfshihen këtu familjet që mbajnë aktualisht patronimin Domi, të cilët e kanë origjinën nga fshati Domën i Postribës. Ndërsa mbiemri Tyrbetari, është patronim që mbahet nga disa familje të lagjes "Tyrbetarë" të fshatit Drisht të Postribës. Ndërsa emrat familjare Kërshëndella dhe Shënepremte duhet të kenë ardhur drejtpërdrejt nga emra festash. I pari dokumentohet në shekullin XV (Premti dhe Gjergji) Kërshëndellë, Shëngjin, Drisht, Shkodër, 1485...

Postriba gëzon një kulturë të lashtë në kultivimin e bimëve e sidomos në kultivimin e qepës, lakrës, duhanit, drithërave etj. Kështu që në lashtësi janë të përmendura qepët e Drishtit, dy format e saj, ajo globoze dhe ajo konike. Gjithashtu është e përmendur edhe lakra e Drishtit, e cila ka vlera të larta organoleptike si dhe është e ëmbël dhe e shijshme. Mund të përmendim edhe duhanin "Postriba" që është kultivuar qysh herët dhe gjithmonë është kërkuar nga tregu brenda dhe jashtë shtetit, pasi ka tregues të mire në pirjen e tij, në shije, në raportin e Shmukut, apo raportet e sheqerit me proteinat etj. Të përmendur janë dhe Kungulli Sakez i Vogël i Postribës si dhe Kungulli i Kuq Kapadollëm me tul, i Postribës. etj."

Postriba është e pasur me zbulime arkeologjike, ku një pjesë e territorit është akoma e pa studiuar, si kalaja Ilire, lagjia Muzhilë e fshatit Drisht, Kalaja e Drishtit, si dhe zona arkeologjike e studiuar si Fusha e Shtojit, etj. Postriba është edhe një zonë e pasur etnografike, pra ka një histori shumë të pasur me mënyrën e jetesës, kulturën, jetën shoqërore e shpirtërore, zakonet, veshjet, etj. Janë kryer mjaft studime etnografike mbi mjetet e punës, veglat e punës, veshjet, zakonet, doket, jetën shpirtërore në gëzime e hidhërimet, instrumentet popullore që janë përdorur etj., por ka përsëri material për të cilat duhen studime e hulumtime të ndryshme.. Kështu për këto vlera, mund të organizohet turizmi historik, arkeologjik, etnografik etj. Në Postribë, si në fshatrat Drisht, Kala të Drishtit, Mes, Boks (Kalaja Ilire), Kodrat e Bardhajve (Bardhanjel), Fushat e Myselimit etj., ka mjaft material të fushës historike, arkeologjike, etnografike që duhet studiuar e hulumtuar për t'i vënë në shërbim të turistëve vendas ose të huaj.

Që në kohë të lashta studiues të huaj apo vendas kanë shkruar për Postribën në përgjithësi dhe për Drishtin në veçanti, si një nga qytetet e lashta të Shqipërisë Bregdetare.Një nga studiuesit e hershëm ishte edhe Marin Barleti. Në temën "Drishti në historinë kombëtare të Shqiptarëve", të shkruar nga Riza Drishti dhe të paraqitur në librin "Shkodra në Shekuj", seminari i tretë, vëllimi i parë, ndër të tjera thuhet: "Sipas

Marin Barletit (1460-1512-13), në veprën "Historia e Skënderbeut", shkruhet se: "E shoh me vend të them këtu para lexuesit, se nuk dihet fare nga kush është themeluar qyteti i Drishtit, dhe as që njihet lashtësia e tij, megjithë qytetarët, të cilëve u pëlqen t'i besojnë gabimit të vet, e çojnë me mburrje fillimin e themelimit të qytetit tek romakët...një gjë e tillë nuk provohet në asnjë dokument qoftë të shkruar, qoftë ndryshe..."

Sipas studiuesit dr. Romeo Gurakuqi të paraqitur në: "çështja e Shkodrës në Konferencën e ambasadorëve (1912-1913) deri në momentin e dorëzimit të Malit të Zi", shkrim i cili është përfshirë në librin "Shkodra në Shekuj", seminari i tretë, vëllimi i parë, ndër të tjera thuhet: "... Konferenca e Ambasadorëve të Fuqive të Mëdha u mbledh në Londër në dhjetor 1912 për të zgjidhur problemet e lindura nga lufta në mes të Aleatëve Ballkanikë dhe Turqisë. Në këtë konferencë u ra dakord që Serbia nuk duhej të shtrihet drejt bregut të Adriatikut dhe se duhej të krijohet një Shqipëri Autonome. Konferenca që kryesohej nga Sekretari i Jashtëm Britanik Eduard Grey debatoi rreth problemeve kryesore:... Në fundin e muajit janar 1913, Austro- Hungaria arriti të binte praktikisht në një marrëveshje me Italinë për një qëndrim të përcaktuar për problemin e Shkodrës. S. Berchtold mendonte se tokat përtej malit të Taraboshit dhe Bunës mund t'i jepeshin Malit të Zi së bashku me kompensime të përshtatshme në drejtim të Pejës. Në këtë moment të parë ajo do të ishte e gatshme siç duket t'i jepte rrugë Prizrenit për Serbinë. Me këtë Austro-Hungaria kërkonte të shmangte me çdo kusht ndarjen e Shkodrës nga Malësia, që me të drejtë e konsideronte pjesë integrale të një hinterlandi etno-kulturor homogjen dhe të pandashëm shqiptar. Fundi i muajit janar shënon një pikë kthese në qëndrimin e Rusisë në lidhje me Shkodrën. Ajo la të kuptohet se mund të hiqte dorë nga qyteti me kusht që të merrte kompensime të përshtatshme si në rajonin përfaqëues Shkodrës (pjesën më të madhe të liqenit të Shkodrës, rrjedhën e plotë të Bunës në jug të qytetit si dhe territorin lindor të liqenit përfshirë një pjesë të madhe të lumit Kir)."

Studiuesi turk, profesor Nexhip Alpan, në temën "Mbrojtja e Shkodrës", paraqitur në librin "Shkodra në Shekuj", seminari i tretë, vëllimi i parë, ndër të tjera thotë: "Shkodra tremijë vjeçare është kryeqyteti i parë i shtetit ilirian të sunduar prej Mbretit Bardhyl dhe Mbretëreshës Teuta..."

Shkodra, kur filloi rrethimi malazet (Rrethimi i Shkodrës më 1912, shënimi im- R.S.) mbrohej me një ushtri mikse (shqiptaro-Osmanë) me ushtarë të rregullt dhe vullnetarë (Në vullnetarët një rol të rëndësishëm ka luajtur Postriba, e cila nga çdo shtëpi nxirrte një luftëtar vullnetar dhe të gjithë së bashku ishin të organizuar në një battalion vullnetar, të quajtur, sipas popullit, "Nishanxhi tabor" ose batalioni i vdekjes, komanduar nga trimi patriot, Adem Haxhija. **Mjafton të përmendim natën e 29 dhjetorit 1912, ku u vranë 60 postribas dhe u plagosën 70 luftëtarë të tjerë, po postribas, në betejën më të përgjakshme në Bardhanjel, ku lufta u zhvillua trup më trup e bajonetë më bajonetë.**


Në librin "Shkodra në Shekuj", seminari i tretë, vëllimi i parë, Dr. Bajram Xhafa, në temën "Roli i Shkodrës në Revolucionin e Qershorit 1924 dhe qendresa qeveritare ndaj sulmit të forcave kryengritëse kundër prefekturës", ndër të tjera thotë: "...Në Shkodër, Postriba ka qenë me Zogun. Me forcat antiqeveritare u bashkua Bajram Hyseni nga Rrjollli me 30 veta, për hatër të Sylço Beg Bushatit, me të cilin kishte lidhje. Gjithashtu morën pjesë toger Ndok Gjeloshi me 180 shaljanë dhe Dom Loro Caka me 100 malësorë prej Shllakut."

Me 30 maj 1924 (sipas disa të tjerëve me 31), Rexhep Shala dha urdhrin për sulm kundër ndërtesës së prefekturës. Fuqia qeveritare e përbërë prej 125 xhandarësh, mbeti me 32 xhandarë, kryesisht nga jugu dhe forcat e Ndrec Prengës prej 15-20 vetësh, xhandarë të paorganizuar. Nga Paria e Shkodrës dhe e maleve kanë qenë Sulejman e Hasan Hoti, Selo Drishti, Abdyl e Taip Lluja, Rexhep Suma, Alush Mehmeti (Ulqinak) dhe Engjëll Serreqi. Prej oficerëve kanë marrë pjesë Zef Prendushi, Nexhip Begteshi, Luigj Shantoja dhe kapter Ismail Radovicka. Prej civilëve shkodranë kanë qenë edhe Hamz Juka, Maliq Sokoli, Kasem Lluja, Caf Lezha dhe Hamit Gega. **Nga Paria e maleve: Adem Haxhija nga Postriba vet i shtatë, Vat Mirashi, bajraktar i Shkrelit më të birin, Konto Marashi, Sadri Zeka, (Shkreli), Gjon Gjoni prej Grude dhe Ismail Delia, gjithsej 42 veta.**

VENDNDODHJA GJEOGRAFIKE, KUFIJTË E POSTRIBËS

Postriba shtrihet në verilindje të qytetit të Shkodrës, në të ashtuquajturën Zona e Mbishkodrës. Largësia rrugore nga qendra e qytetit në qendrën e komunës së Postribës, në Mes Qendër është 7

kilometra. Ajo përfshihet në gjerësinë gjeografike veriore në paralelin 42 gradë e zero pesë minuta në jug dhe 42 gradë e pesëmbëdhjetë minuta në veri. Gjithashtu në gjatësinë gjeografike lindore, në meridianin 19 gradë e tridhjetë minuta në perëndim dhe 19 gradë e dyzetë e pesë minuta në lindje.



Hartë topografike e Postribës

Postriba zë një sipërfaqe prej 180 kilometra katror. Rreth 80 % të kësaj sipërfaqeje e zënë kodrat dhe malet, ndërsa vetëm rreth 20% shtrihet në zonën fushore. Lartësitë ekstreme të Postribës janë maja e Cukalit me 1722, 9 metra mbi nivelin e detit dhe Lugina e Shtodrit 37 metra mbi nivelin e detit. Lartësia mesatare e zonës është 575 metra mbi nivelin e detit.

Në periudhën para pavarësisë Postriba ishte e organizuar në pesë bajrakë si ndarje fisnore e territoriale. Bajrakët, sipas shkallës hierarkike rradhiteshin si më poshtë: Bajraku i parë, ai i Drishtit, pasi Drivasti (Drishti i sotëm) ishte qytet i zhvilluar i Mesjetës dhe qendër e Postribës. Pas Drishtit, bajraku i dytë ishte Boksi. Bajraku i tretë ishte Suma, bajraktari i së cilës ishte nga Shakota. Bajraku i katërt ishte Shllaku dhe ai i pesti ishte Temal-Dushmani.

TRUALLI

Malet kryesore që përfshihen brenda territorit të Postribës janë Cukali, Maranaj, Cilikoku, Bëshkasi, Mgulla, Blini, Bjeshkët e Domnit, Mali i Rragamit, etj. Cukali i përket Postribës, Shllakut dhe Temalit. Ndarja mes tyre realizohet mes për mes Fushës së Liqenit që ndodhet në Cukal. Pjesa perëndimore e Cukalit bashkë me gjysmën e Fushës së Liqenit i përkasin Postribës, ndërsa pjesa lindore dhe verilindore u përkasin Shllakut dhe Temalit. Majat e maleve të Cukalit, të Maranajt, etj., përbëjnë pjesën më të ngritur që quhet antiklinali dhe maja përbën kulmin e antiklinalit, ndërsa lugina e lumit Kir që është pjesa më e ulët quhet sinklinal dhe fundi i luginës quhet fundi i sinklinalit. Shpatet e këtyre maleve quhen krahët e sinklinales ose këmbët e antiklinales. Malet e larta që shtrihen në dy anët e lumit Kir me luginën e thellë të këtij lumi formojnë atë që quhet kanion, pra “Kanioni i Urës së Shtrejtë”. Lugina shumë e thellë dhe e ngushtë, si formë gryke, me shpate të thikëta gati pingule, me fundin që zihet i tëri nga shtrati i lumit Kir, ka formuar Kanionin e Urës së Shtrejtë. Këtu thellësitë e kanionit shkojnë disa qindra metra. Ky kanion, si shumë të tjerë është krijuar nga gërryerja në thellësi të lumit Kir, të shkëmbinjve të ngjeshur e të qëndrueshëm, kryesisht shkëmbinj sedimentarë karbonatikë (gëlqerorë, dolomitë, etj.). Në formimin e

këtij kanioni një rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe zhvendosjet tektonike (çarjet dhe shkëputjet), të cilat kanë lehtësuar veprimin e gërryerjes së ujërave të lumit Kir, lëvizjet neotektonike, topografia e relievit, etj.

PASURITË NËNTOKËSORE TË POSTRIBËS

Postriba është shumë e pasur në nëntokën e saj. Pothuajse i gjithë territori malor i saj është i pasur me minerale të ndryshme. Në bazë të studimeve që janë bërë në malin e Drishtit dhe atë të Mesit, në vendin e quajtur "Semna" janë shkëmbinj masivë të pasur me gurin gëlqeror, karbonat I kalciumit (Ca C O3), i cili nxjerr çimento të markës 900, ose më qartë çimento të markës së parë. Siç thuhet, studimi është i inxhinierëve rusë së bashku me inxhinierët tanë. Për shfrytëzimin e kësaj pasurie nëntokësore është rënë dakord nga shteti ynë që të vijë një firmë gjermane, por deri tani çdo gjë ka mbetur pezull, arsye e së cilës nuk e dimë. Në vendin e quajtur "Kratuli i Boksit", një kodër mali mbi lagjen Sekaj, ka filluar para disa viteve shfrytëzimi i mineralit të mermerit, mermer i bardhë, por nuk zgjati shumë ky shfrytëzim dhe u ndaluan punimet. Thuhet nga vendasit se punimet u ndaluan ngaqë në këtë vend u zbulua kështjella ilire, dhe si një vend i lashtë historik, që ishte, sa duket për këtë arsye u ndaluan punimet dhe shfrytëzimi i mineralit të mermerit. Mermeri në këtë minierë është mbi sipërfaqe të tokës.

Për studimin e kështjellës ilire po i referohemi materialit si më poshtë: "Në revistën arkeologjike "Iliria" të vitit 1983 ka një studim me të njëjtin titull të paraqitur nga studiuesi Frederik Fistani, i cili në mes të tjerash thotë: "Vendbanimi i fortifikuar ilir i Kratulit (Postribë), gjendet rreth 6 km në verilindje të Shkodrës, në afërsi të Urës së Mesit, në lagjen Sekaj të fshatit Boks, prej së cilës (Urës së Mesit) e ndajnë vetëm 600 metra. E quajtmë kështu nga kodra me të njëjtin emër, që ngrihet mbi fshatin Boks (mbi lagjen Sekaj të këtij fshati, shënimi im, R. S). Kjo është një kodër e vogël e formacionit karstik, me lartësi 143 metra mbi nivelin e detit. Zgjatja e saj në drejtim të lindjes të çon, mbas një qafe të lehtë, në një majë të dytë (135 metra të lartë) që njihet me emrin Kodra e Herës.

Në zonën nga Mulliri i Domnit deri tek Shkalla e Madhe, gjendet mermer i kuq, për të cilin është bërë studimi, por shfrytëzimi nuk ka filluar. Në zonën e quajtur "Cilikok", mbi Domën, ose më sakt në kufi me bjeshkët e Domnit gjendet mermer shumë ngjyrësh. As ky mineral nuk i është nënshtruar ende shfrytëzimit. Në zonën e Domnit, në vendin ish Kroni i Domnit gjendet në sipërfaqe kaolinë e cilësisë shumë të mirë. Është përdorur që në çlirim. Përdoret për tulla shahmat, për porcelan, etj. Sot kjo kaolinë nuk shfrytëzohet nga asnjë kompani apo firmë private. Në zonën Qerpik të Vilzës, ose Mazrrek është një brez i tërë që vazhdon nga kjo zonë, kalon nëpër Domën dhe arrin deri në Leporosh. Gjithë ky brez është i pasur me mineral hekuri, i cili nuk është shfrytëzuar akoma, por që vetëm është studiuar nga specialistë të gjeologjisë. Përveç këtyre pasurive nëntokësore Postriba ka dhe mund të ketë edhe pasuri të tjera nëntokësore, por këto pasuri ose nuk janë studiuar, ose mund të jenë studiuar por ne nuk kemi informacion më të detajuar deri sot.

RELIEVI

Postriba ka një reliev mjaft të ndryshueshëm, duke filluar nga zona fushore e saj, si Fusha e Shtojit, e cila në pjesët më të ulëta të saj zbret në 36 metra mbi nivelin e detit. Duke kaluar në fshatrat e Myselimit dhe të Mesit kjo lartësi rritet gradualisht në 40, 50 dhe 60 metra mbi nivelin e detit. Në fushat e fshatrave Kullaj të Boksit, të Dragoçit dhe të Boksit këto lartësi rriten në rreth 60 metra mbi nivelin e detit në fushat e Kullajve, në 65- 70 metra mbi nivelin e detit në fushat e Dragoçit dhe në rreth 70-75 metra mbi nivelin e detit në fshatin Boks, në lagjet Sekaj dhe Rrasek, ndërsa në Kodër Boks arrin në 100, 110, 120 dhe 125 metra mbi nivelin e detit tek xhamia e Boksit. Në tokat e quajtura Grace etj., që i përkasin Kodër Boksit këto lartësi përsëri zbresin më poshtë. Në fshatin Drisht tokat shtrihen në lartësitë që variojnë nga 65 metra mbi nivelin e detit dhe gradualisht ngriten në 70, 80, 90 metra mbi nivelin e detit në Drisht poshtë, ndërsa në lagjen Kala të Drishtit kalojnë në 100, 200 metra e më shumë mbi nivelin e detit. Në fshatin Vilzë, në lagjet Thelloja e Ndër Fusha lartësitë variojnë nga 100 deri në 200 metra mbi nivelin e detit e më shumë. Për të gjitha këto lartësi që po jap më poshtë bëhet fjalë për tokat bujqësore, ndërsa malet e këtyre zonave qëndrojnë më lart. Në fshatin Shakotë, Derraj, Domën vendosja e tokave varion në lartësitë 300, 400, 500, 600 metra mbi nivelin e detit, e më lart. Në fshatin Sumë, sipas lagjeve të këtij fshati lartësitë e tokave variojnë në lagjen Likaj 300-400 metra mbi nivelin e detit, në Bojaj 600-700 metra mbi nivelin e detit, në Delaj 700-800 metra mbi nivelin e detit, në Pergjon 700-800 metra mbi nivelin e detit,

në Martindrejaj 800-900 metra mbi nivelin e detit, në Bukmirë 700-900 metra mbi nivelin e detit dhe në Gurra-Dajcë 600-900 metra mbi nivelin e detit. Në Bjeshkët e Bregut 700-800 metra mbi nivelin e detit. Në Ndërmolla rreth 900 metra mbi nivelin e detit e më shumë. Në lagjen Amaraj të Drishtit lartësitë e vendosjes së tokave lëvizin nga 100 deri në 150 metra mbi nivelin e detit mesatarisht. Në fshatin Ura e Shtrejtë vendosja e tokave varion nga 100 metra mbi nivelin e detit dhe duke u ngjitur bregut të lumit deri në kufi me Prekal arrin në lartësinë 300 metra mbi nivelin e detit. Xhamija e fshatit Ura e Shtrejtë është e vendosur në lartësinë 125 metra mbi nivelin e detit dhe është në një lartësi me Xhaminë e Kodër Boksit. Lagjja Rrekal është e vendosur në lartësinë 600-700 metra mbi nivelin e detit. Lartësitë ekstreme janë lugina e Kirit në pjesët më të ulëta të zonës malore dhe Maranaj e Cukali në pjesët më të larta të kësaj zone. Trajtat themelore të zonës malore të Postribës janë malet dhe luginat. Malet formojnë kurrize të larta si Mali i Maranajt, Cukalit, Kashtylli i Domnit, Blini, Bëshkasi, etj. Kreshtat e maleve në dy anët e luginës së lumit Kir kanë formuar Kanionin e Urës së Shtrejtë që paraqet një pamje natyrore të mrekullueshme, një pamje mahnitëse që lë mbresa në shpirtin e njeriut. Relievi, duke qenë shumë i ndryshueshëm në zonën e Postribës ka ndikuar dukshëm në procesin tokëformues, duke na dhënë toka të ndryshme, sipas zonalitetit vertikal si dhe në ndërtimin pedologjik të tyre. Kështu tokat e vendosura në pjerrësi të mëdha kanë dhënë toka të cekëta, me përbërje mekanike të lehta dhe që vazhdimisht i nënshtrohen një erozioni të pamëshirshëm, si rezultat i pjerrësive të mëdha. Ndërsa në zonat më të ulëta dhe në fushë, ku pjerrësia është e vogël, relievi ka ndikuar në procesin tokëformues duke dhënë toka me horizont humosor ku dallohen mirë shtresat pedologjike "A", "B" dhe "C, duke dhënë toka me përbërje mekanike të mesme dhe të rënda.

MUNDËSITË E ZHVILLIMIT TË TURIZMIT NË POSTRIBË

Postriba i ka të gjitha mundësitë e zhvillimit të turizmit në territorin e saj dhe kryesisht gjatë gjithë gjatësisë së lumit Kir, ku gjen Kanionin e Urës së Shtrejtë dhe Shpellën Karstike të këtij fshati, pyjet e bukura në dy anët e lumit Kir. Gjithashtu Postriba ka Urën e Mesit, një monument kulture në shkallë kombëtare, Fushën e Liqenit në Cukal, Fose-Gurishta ose siç quhet ndryshe "Pylli i Gështenjave" në mes fshatrave Dragoç dhe Kullaj, Domnin, Kalanë e Drishtit, Shtodrin (Rezervuari me të njëjtin emër në Myselim), Bjeshkët e Bregut dhe Bjeshka Ndërmolla, etj. Në të gjitha këto vende, me një përmirësim të infrastrukturës rrugore krijohen mundësi mjaft të mira për t'i vënë këto pasuri natyrore në dispozicion të turistëve vendas dhe të huaj, si dhe në dispozicion të studiuesve të fushave të ndryshme të dijes. Në temën studimore "Aspekte historike dhe aktuale të turizmit në Shkodër" të shkruar nga Dr.Sokol Axhemi dhe të paraqitur në librin "Shkodra në Shekuj", në mes të tjerave thuhet: "...Për të realizuar një turizëm historik, Postriba i ka të gjitha mundësitë dhe mund të shërbejë për historianë, albanologë, studiues të ndryshëm, pasi Postriba ofron këto mundësi turizmi historik:

1. Studimi i Drivastit dhe i kalasë së tij, i cili mund të shërbejë si vend turistik.
2. Vizita turistike në Urën e Mesit, në parkun "Fos-Gurishta", në liqenin artificial të "Shtodrit", etj.
3. Studimi i shpellave karstike në Ura Shtrejtë dhe në Fushën e Liqenit në Cukal ku gjendet një shpellë e tillë.

URA E MESIT

Ura e Mesit është e ndërtuar mbi lumin Kir, pothuajse në qendër të Postribës, rreth 6-7 kilometra nga qendra e qytetit të Shkodrës. Ura e Mesit është ndërtuar në gjysmën e dytë të shekullit XVIII në afërsi të qytetit të Shkodrës, në rrugën Shkodër-Drisht-Cukal. Kjo urë guri, sipas të dhënave të hershme është e gjatë 130-150 hapa dhe e gjerë 11-12 këmbë, ka 13 syza qemerë, shtatë nga perëndimi dhe pesë nga lindja, në mes të të cilave është syzi i madh, rreth 25-30 hapash e gjërë, këmbët e të cilit syz janë të mbështetura shkëmb mbi shkëmb. Me përmasat e reja ajo ka një gjatësi prej 108 metrash, gjerësi 3-4 metra dhe përbëhet prej 13 harqesh guri. Harku më i madh ka hapësirë 21, 5 metra dhe lartësi 12 metra. Është ndërtuar në fillim harku më i madh dhe harku tjetër, ndërsa më vonë janë shtuar 11 harqe të tjera. Në vitin 1912 syzin e madh e prishën ushtarët turqë, për të mos lënë që të kalonin malazetët nga Boksi në Mes. Edhe austriakët në të ikur deshën ta minonin, por nuk i lanë postribasit. Gojëdhënat na japin, se gurët e latuar, veç që janë lidhur me hekur përbrenda, rrëfanët e të cilëve duken përjashta, janë lidhur me

material special për çimentimin e tyre në një formë të lidhjes organike, për të pasur jetëgjatësi. Për vlerat e mëdha teknike e arkitektonike është shpallë monument kulture.(Fjalori Enciklopedik, “Ura e Mesit”, f. 1136).

Ura e Mesit nuk gjendet e shënuar në hartën e Coronellit, megjithëse është aq e saktë dhe e plotë në tregimin e të gjitha urave të krahinës. Kjo më shtyn të besoj se ura e mbajtur, sipas disa autorëve, si ndërtim romak ose venedikas, të paktën në themelet e saj, nuk ekzistonte para fundit të viteve ‘700,

ORGANIZIMI I VJETËR ME BAJRAKË BAJRAKËT

Studiuesja angleze Meri Edith Durham, në librin e saj të titulluar: “Për fiset, ligjet e zakonet e Ballkanit”, Grupin e Postribës e ndan në 5 bajrakë si më poshtë:

1. Bajraku i Mazrekut
2. Bajraku i Drishtit
3. Bajraku i Shllakut
4. Bajraku i Dushmanit
5. Bajraku i Sumës.

Deri në vitin 1920, në “Luftën e Koplikut”, Postriba është përfaqësuar nga pesë bajrakët, si më sipër.(shënimi im, R. S)... ***në kushtrim të Shkodrës dynden edhe Malcija, Hoti e Gruda, Shkreli e Kelmendi, të pesë bajrakët e Postribës si dhe ata të pesë të Dukagjinit zhdrypën në teposhtë për një herë... ”*** “Agimi”, 1920-1921, gusht - “Edhe Shkodra në rrezik”

Si institucion bajraku ishte krijuar para shekullit XVIII dhe mbështetej në fillim mbi bazën e lidhjeve të gjakut, duke përfshirë njerëz të një fisi. Udhëheqja e tij i përkiste krerëve të fisit, ndërsa udhëheqja e forcave ushtarake njerit prej djemve (zakonisht të tretit) të krerëve të fisit, i cili, si mbajtës i flamurit në ekspeditat luftarake quhej bajraktar (nga mbajtës i flamurit. Flamur = bajrak: flamurtar = bajraktar).

Me ligjin e Xhibalit (1856) që rregullonte marrëdhëniet midis Portës së Lartë dhe malësorëve, bajraku mori edhe kompetenca në lëmin civil, ndërsa bajraktari merrte rrogë nga autoritetet osmane dhe në mjaft raste funksioni i tij u bë i trashëgueshëm dhe ai pasurohej duke marrë gjoba për shkelje të normave të Xhibalit. **Ndërsa në shekullin XIX e vitet e para të shekullit XX bajrakët, nën presionin e masës së malësorëve, dolën nga kontrolli i administratës osmane, dhe u bënë mbështetje e lëvizjes kombëtare në luftë kundër pushtetit osman.**

VENDBANIMI I FORTIFIKUAR ILIR I KRATULIT

Në revistën arkeologjike “Iliria” të vitit 1983 ka një studim me të njëjtin titull të paraqitur nga studiuesi Frederik Fistani, i cili në mes të tjerave thotë: “...Vendbanimi i fortifikuar ilir i Kratulit (Postribë), gjendet rreth 6 km. në verilindje të Shkodrës, në afërsi të Urës së Mesit, në lagjen Sekaj të fshatit Boks, prej së cilës (Urës së Mesit) e ndajnë vetëm 600 metra. E quajtmë kështu nga kodra me të njëjtin emër, që ngrihet mbi fshatin Boks (mbi lagjen Sekaj të këtij fshati). Kjo është një kodër e vogël e formacionit karstik, me lartësi 143 metra mbi nivelin e detit. Zgjatja e saj në drejtim të lindjes të çon, pas një qafe të lehtë në një majë të dytë (135 metra të lartë) që njihet me emrin Kodra e Herës. Maja e Kratulit, mbi të cilën është ngritur vendbanimi, zotëron fushën pjellore të Shtojit dhe luginën e Kirit, që shtrihet para saj nga ana perëndimore dhe ajo juglindore. Në anët e tjera, atë e rrethon një zonë kodrinore me kullota të mira. Para saj kalon rruga, që nëpër Urën e Mesit, lidh Shkodrën me Postribën

Vendbanimi zë sheshin e vogël majë kodrës së Kratulit. Ai është i kufizuar nga një mur mbrojtës, që mbyll një hapësirë në formë elipsi me diametrin e madh 90 metra dhe atë të vogël rreth 45 metra, d.m.th. një sipërfaqe prej më pak se 1, 2 hektar. Paraqitja skematike e vendbanimit në majën e kodrës së Kratulit gjendet më poshtë, në format dhe përmasat që paraqitëm më lart. Muri rrethues është ruajtur relativisht mirë me përjashtim të një pjese nga ana perëndimore, që është dëmtuar rëndë. Ai është ndërtuar me blloqe të mëdha në dy faqet anësore, kurse mesi është mbushur me gurë të vegjël e mesatarë. Blloqet janë me forma të parregullta dhe të papunuara, ashtu sikurse kanë dalë nga gurorja. Ato janë murosur në të thatë pa lidhje llaçi. Gjerësia e murit lëviz nga 3, 10 - 3, 35 metra; lartësia e ruajtur

në traktet më të mira është 1, 6 - 2, 55 metra. Bloqet e mëdha arrijnë përmasat 0, 40 x 0, 60 x 0, 80 metra; 0, 50 x 0, 70 x 0, 90 metra; 0, 60 x 0, 70 x 1, 20 metra. Në anën lindore muri rrethues është përforcuar me një kullë katërkëndëshe. Kulla ka përmasa 4, 40 metra në krahun e daljes dhe 6, 70 metra në anën ballore.

Muri i saj është ruajtur në lartësinë 1, 40 metra. Ai është rreth 1 metër i gjerë dhe i formuar prej dy rradhë blloqesh pa mbushje në mes. Është ndërtuar me të njëjtën teknikë si edhe muri rrethues. Bloqet e përdorura kanë në përgjithësi po ato madhësi e pamje, me përjashtim të gurëve të qosheve që janë të zgjedhura me forma pak më të rregullta. Në krahun e majtë kulla është e lidhur me murin, ndërsa në të djathtin ajo i mbështetet murit, të paktën në ato radhë që janë ruajtur. Hyrjes dhe daljes në vendbanim i shërbenin tri porta. Dy prej tyre gjenden përballë njëra-tjetrës në anët veriore e jugore, të vendosura gati në një bosht me diametrin e vogël të elipsit. E treta është në anën lindore, 3, 8 metra në të majtë të kullës. Të trija janë porta të thjeshta, të tipit korridor që çajnë trashësinë e murit rrethues. Dy të parat janë 2 - 2, 15 metra të gjera, ndërsa e treta 1, 8 metra. (shih paraqitja skematike në majën e kodrës së Kratulit, si më lart).

Nga pikëpamja tipologjike dhe teknike e ndërtimit, fortifikimi i Kratulit është në përgjithësi i ngjashëm me Gajtanin dhe lidhet me kategorinë e vendbanimeve ilire të këtij tipi. Megjithatë ai paraqet dy veçanti që e dallojnë prej tyre. Veçanti e parë është forma e rregullt eliptike e planimetrisë, e cila, megjithëse nuk mund të thuhet se përbën një zgjidhje të paramenduar e të pavarur nga konfiguracioni i terrenit, meriton të vihet në dukje. Veçantia e dytë ka të bëjë me praninë e kullës si një element fortifikimi, që siç është vënë në dukje, mungon në vendbanimet e tipit Gajtani. (S. Islami, Probleme të kronologjisë së qytetit ilir, "Iliria" VI, f.102).

Ky element i ri që sjell Kratuli kërkon padyshim një shpjegim si në këndvështrimin tipologjik ashtu dhe në atë kronologjik. Terreni brenda fortifikimit është shkëmbor, në mënyrë të veçantë pjesa qendrore e tij. Vetëm një brez i ngushtë buzë murit rrethues është tokë më e butë. Gjurmë banesash apo ndërtime të tjera nuk vërehen. Në sipërfaqe ndeshen me shumicë fragmente qeramike. Gjatë vizitave që janë bërë herë pas here në këtë vendbanim është mundur të mblidhen disa sende arkeologjike, të cilat po i paraqesim më poshtë:

I. SENDE TË PERIUdhËS SË HEKURIT

1. Fragmente enësh balte (rreth 25 copë) me faqe të trasha, të punuara me dorë, prej një balte të ashpër, e cila përmban edhe grimca të bardha gëlqerore; ato kanë ngjyrë të murrme në kafe ose të zezë. Në pjesën më të madhe janë barqe; vetëm pak prej tyre ruajnë elemente që ndihmojnë për njohjen e formës së enës. Midis tyre dallojnë një buzë tasi, buza e një ene me qafë konike dhe një fund qypi. Prej vegjëve (2 copë), njëra në formë gjuhe, i përket një ene mesatare (shih tab. I, 1-4.), ndërsa e dyta është një vegjë petullicë, që i përket një ene të vogël, qoftë kjo oinohe apo dyvegjake. Nga tiparet e saj, kjo qeramikë e Kratulit është e ngjashme me atë të shtresës së dytë të Gajtanit (B. Jubani. Qeramika ilire e qytetës së Gajtanit. "Iliria" II. F. 382 vv), (ed. française "Iliria" II. P.414 ss), që daton në periudhën e hekurit.

2. Një rrasë e vogël (5 x 5, 5 cm.) prej guri të butë, në sipërfaqen e së cilës është gdhendur një figurë trapezoidale me relief të ulët. Është vështirë të përcaktohet se ç'përfaqëson. Ndoshta kemi të bëjmë me një amuletë guri, gdhendja e së cilës ka mbetur e papërfunduar ose me ndonjë stampë për përgatitjen e një kallëpi për derdhje (shih Tab. I, 5. Vendbanimi i fortifikuar ilir i Kratulit).

3. Gur spilitik me ngjyrë gri të errët në të zezë e formë vezake që përdorej me sa duket si shtypës. Të tillë janë gjetur me shumicë në shtresën e dytë të Gajtanit. Gjenden në forma të gatshme në zallin e Kirit (Tab. I, 6 Vendbanimi i fortifikuar ilir i Kratulit).

4. Sumbull bronzi, në formë kalote të ulët. Pjesë stolie, që kapej në veshje me anë të një thumbi, i cili mungon. Njihet në repertorin e stolive ilire të periudhës së hekurit, që vijnë nga varrezat e kulturës Glasinac-Mat. (Tab. I, 7 Vendbanimi i fortifikuar ilir i Kratulit).

II. SENDE TË KULTURËS QYTETARE ILIRE

1. Fragmente amforash midis të cilave dallojmë një vegjë që është pajisur në fund me një vulë palmete (Tab. I, 8 Vendbanimi i fortifikuar ilir i Kratulit). Të tilla janë gjetur në Gajtan, Zgërdhesh, Xibër, Apoloni, Qeparo e Butrint. Këto janë amfora transporti të ngjashme me ato korintike (C. Koehler, Cirithian. A and B

transport Amforas.Princeton University, Ph D. 1979, Pl. 23 nr.163) të tipit B, të cilat mendohet se janë prodhuar edhe në Korkyrë (Ph. Desy, A propos d'une premier synthese sur les amphores corinthiennes, "L'Antiquite classique", Bruxelles 1982, p.286) dhe ndoshta edhe në ndonjë qendër tjetër në Iliri. (S.Islami, Qyteti ilir në Zgërdhesh, "Iliria" II, f.206, Tab. IV, 8, 9 (ed. Française, "Iliria" II, p.229, Pl. IV 8, 9). Datohen si të fundit të shek.IV p. e. sonë.

2.Kupë balte të tipit Megarë e stolisur me motivin e bletës, i takon fundit të shek. III-shek. II të e. sonë (shih Tab. I, 9 Vendbanimi i fortifikuar ilir i Kratullit)

3.Fragmente të shumta enësh të tjera të tavolinës, midis të cilave dallojmë buzë kupash, buzë funde e vegjë skifosash, kantarësh e amforiskash. Shumica e tyre duket se janë prodhime të Dyrrahut; vetëm fragmentet e një kantari dëshmojnë për një import apul. Nga pikëpamja kohore këto materiale i takojnë shek. III-II p. e. sonë.

4.Fragmente të dy fibulave prej bronzit. Njëri prej fragmenteve i takon një fibule me trup të harkuar, koka e së cilës ka formën e një petëze trapezoidale me një thumb në skajin e sipërm. Fragmenti tjetër përfaqëson dy gjilpërat dhe spiralen e një fibule me trupin në formë shigjete. Të dyja fibulat datojnë në shek. II-I p. e. sonë. (shih Tab. I, 10, 11 Vendbanimi i fortifikuar ilir i Kratullit).

5.Gjilpërë bronzit me kokën piramidale, 10 cm. e gjatë (shih Tab. I, 12 Vendbanimi i fortifikuar ilir i Kratullit).

6.Monedhë bronzit e Gentit, që mban në faqe portretin e mbretit, ndërsa në shpinë anijet ilire me legjendën BACIAE GENTHIO; diametri 20 mm. pesha 3, 59 gram

7.Monedha bronzit, që kanë në faqe mburojën ilire (në faqen e fërkuar) ndërsa në shpinë përkrenaren ilire. Sipër përkrenares, emri i nëpunësit EY / II (o) - PO (Y); poshtë:..., diametri 13 mm., pesha 3, 60 gram Tip pak i njohur. Është ekzemplar i parë i këtij tipi, që ruan gati të plotë emrin e nëpunësit monetar. Vihet në qarkullim pas vitit 168 p. e. sonë.

SENDE TË SHEKULLIT TË PARË TË E. SONË.

1.Fragmente amforash transporti, që gjenden me shumicë në sipërfaqe, sidomos në vende të gërryera nga shirat. Ndër fragmentet më të ruajtura vërejmë tipa që i përkasin shek. I të e. sonë. Midis tyre një buzë amfore ruan vulën SINP... (shih. Tab. I, 13, 14 Vendbanimi i fortifikuar ilir i Kratullit).

2.Bish luhareje, që përfundon me një kokë pate; mban vulën CRV (Shih Tab. I. 15 Vendbanimi i fortifikuar ilir i Kratullit).

3, Veç këtyre në sipërfaqe kemi gjetur edhe pesha vegjësh për endje, pjesë të një çengeli prej hekuri, që përdorej për varjen e enëve në vatrat e zjarrit, fragmente mokrash prej guri vullkanik, që shërbenin për bluarjen e drithit, gozhdë të mëdha hekuri e bronzit, zgjyra hekuri dhe një copë plumbi, sende këto që me sa duket lidhen me këtë periudhë të fundit të jetës së vendbanimit (shih Tab.I, 16 - 24, Vendbanimi i fortifikuar ilir i Kratullit).

Siç mund të vihet re nga materiali që paraqitëm, vendbanimi ka patur një jetë të gjatë që fillon me periudhën e hershme të hekurit dhe zbret deri në shek.e parë të e. sonë. Gjurmë më të vona nuk ndeshen. Gërmimet sistematike do të sjellin padyshim të dhëna më të sakta, nëpërmjet të cilave do të mund të përcaktohet më mirë karakteri i këtij vendbanimi dhe etapat e ndryshme të jetës në të. Interes të veçantë, tani për tani, paraqet këtu prania e kullës për tipologjinë e kësaj kategorie vendbanimesh. Ky problem meriton të ndiqet më me vëmendje për të saktësuar në se ajo është ndërtuar bashkë me murin rrethues apo është shtesë e mëvonshme në sistemin e fortifikimit të tij, gjë kjo e fundit që duket më e besueshme.

KULTURA E TUMAVE TË SHTOJIT

Tumat janë kodërvarre të ndërtuara me dhe', me dhe' e gurë, rrallë vetëm me gurë, karakteristikë për varrimin ilir. Shfaqja e tyre në Ballkan lidhet me shtegtimet e blegtorëve indoeuropianë të stepave, në fillim të epokës së metaleve. Në Iliri duken për herë të parë në bronzin e hershëm...Përdoren pa ndërprerje gjatë tërë epokës së bronzit dhe bëhen karakteristike veçanërisht për epokën e hekurit të hershëm...

Tumat janë gjetur në të gjitha rrethet e Shqipërisë, më shumë në krahinat veriore (Tumat e Fushës së Shtojit në Postribë, shënimi im, R. S.)...

Sipas studimit të Dr. Aristotel Kokës, të paraqitur në "Shkodra në Shekuj", vëllimi i parë, me të njëjtin titull, po paraqes në këtë libër disa të dhëna të rëndësishme, të cilat tregojnë se Fusha e Shtojit, që përfshihet në zonën e Postribës, i përket vendbanimit ilir. Në mes tjerash Dr. Aristotel Koka thotë: "...Vitet e fundit po i kushtohet vëmendje gjithnjë e më e madhe gjurmimit e studimit të kulturës ilire në zonën e Shkodrës, e cila në të kaluarën ka qenë pak e njohur dhe kryesisht nga gjetjet e rastit, shpesh pa të dhëna të sigurta për prejardhjen e tyre..."(F. Prendi- Materiale të kulturës ilire të zbuluara në Shqipërinë e Veriut "Bushit" 2 1958. I. 10 v.)

Një rëndësi të veçantë në këtë drejtim patën gërmimet e kryera gjatë viteve 1980- 1990 në varrezën tumulare të Fushës së Shtojit, njërës prej varrezave më të mëdha të vendit tonë, me rreth 160 tuma, e cila shtrihet në zonën e Postribës, midis fshatrave Boks e Dragoç dhe Urës së Mesit. Kjo varrezë prej kohësh ka tërhequr vëmendjen e studiuesve, të cilët kanë lënë edhe shënime për shtrirjen e numrit të madh të tumave (rreth 250), por shumë prej tyre kanë qenë shkatërruar gjatë kohëve. Gërmimet në këtë nekropol hodhën dritë mbi disa aspekte të zhvillimit historikokulturor të zonës së Shkodrës për periudha të rëndësishme të protohistorisë së saj, siç është ajo e kohës së bronzit dhe e hekurit, periudha në të cilat kaloi formimi i etnosit ilir.

Në Shtojt janë gërmuar 11 tuma. Ato ndodhen në përgjithësi në grupe të vogla, nga tre deri në gjashtë dhe rrallë janë të veçuara. Përmasat e tyre janë të vogla e mesatare, në lartësi 1-3 m e diametër 10-30 m. Tumat përmbajnë të gjithë elementet karakteristike që kanë tumat ilire në të gjithë territorin e shtrirjes së tyre, siç janë ndërtimi i tyre me gurë e dhe', unaza kufizuese si dhe tipe të ndryshme varresh. Përveç këtyre në tumat e Shtojit gjenden edhe elemente të veçantë, që nuk janë ndeshur në tumat e gërmuara deri tani si brenda ashtu dhe jashtë vendit tonë.

Ngjashmëri me tumat e Shtojit kanë edhe tumat e Lumës, në të cilat lidhjet kulturore të Lumës me arealin e Shkodrës i ndeshim që në epokën e bronzit të hershëm, dëshmuar kjo nga vendbanimet e varrezave tumulare. Siç e paraqet në studimin e tij Dr. Muhamet Bala, nën titullin "Kultura materiale e shpirtërore e Lumës në epokën e hekurit dhe lidhjet e saj me arealin e Shkodrës", ku në mes të tjerave thotë: "...Në fundin e bronzit e në fillimin e epokës së hekurit rriten në mënyrë të ndjeshme gjurmët e përqëndrimit të popullatës ilire në Lumë. Kjo vërehet edhe gjatë gjithë fazave suksesive të epokës së hekurit, veçanërisht nga gërmimet sistematike të kryera në varrezat tumulare të fshatrave Çinamak, Kënetë...etj." Interes të veçantë paraqet nekropoli i madh tumular i Çinamakut, prej më se 80 tumash, vendosur në një fushë të vetme, sot e përmbytur nga Liqeni i Fjerzës...Gurët zakonisht janë përdorur për ndërtimin e varrezave dhe mbulesën e tumave. Kjo duket në një tumë të Kenetës, Shtojit etj., të përbëra nga një ose disa rrjeshta gurësh njëri mbi tjetrin. Në fqinjësi me tumat e Lumës, paraqesin ngjashmëri tumat e rrethit përbri (Hasit) të ndërtuara me gurë e me dhe' dhe ato të Shtojit të Shkodrës (Zona e Postribës, shënimi im, R.S.). Me këto tipare, tumat e Lumës, Hasit e Shtojit qëndrojnë afër edhe me tumat e Matit e Glasinacit, që në shumën e rasteve janë prej gurësh e dheu... Tumat mbulojnë një ose shumë varre. Thuajse të gjitha përmbajnë varr qëndror. Varret qëndrorë në disa raste janë të thelluar në taban, por ka edhe raste që janë të vendosura dhe mbi taban. Ato kanë zakonisht formë katërkëndëshe, vezake, me ose pa mbulesë gurësh. Ka edhe tuma pa varre qëndrore... Qoftë në epokën e bronzit, qoftë në atë të hekurit në fazën e parë, dytë dhe të tretë, armët dhe pajisjet shtëpiake si dhe ato të zbulurimeve, stolitë etj. kanë ngjashmëri me tumat e Shtojit, gjë që dëshmon për origjinën e njëjtë ilire. (shënimi im, R. S.). Riti i varrimit ka qenë kryesisht me vendosje trupi dhe rrallë me djegie të trupit jashtë tumave. Lidhur me ritin e varrimit ajo që tërheq më tepër vëmendje, për bronzin e hershëm në këtë varrezë, është platforma mbi varrin qëndror të tumës nr. 6 (që përmendëm), me mbeturina kockash të flijuara shpendi së bashku me grupin e figurinave që lidhet me një ceremoni të veçantë, e cila ka të bëjë me një koncept të caktuar mortor mistiko-fetar të banorëve të asaj kohe. Prania e këtyre figurinave me përkatësi moshe e seksi të ndryshme simbolizon një familje të përbërë nga burri, gruaja dhe katër fëmijë, ndër të cilët, tri të seksit femër në moshë të rritur e një fëmijë të mitur. Kjo dëshmon për organizimin patriarkal të shoqërisë fisnore të periudhës së hershme të bronzit në këtë zonë.

Materialet e zbuluara në këtë varrezë i përkasin periudhave të ndryshme historike që nga bronzi i Hershëm e pa ndërprerje deri në periudhën qytetare ilire (shek. IV-I p. e. sonë.). Ato hedhin dritë mbi çështje të veçanta që kanë të bëjnë me karakterin e kësaj kulture, lidhjet e saj me grupe kulturore të

krahinave fqinje apo më të largëta, veçoritë kulturore lokale, zhvillimin ekonomik e shoqëror dhe në lidhje të pandarë me to, mbi problemin e përkatësisë etnike të saj. Në periudhën e bronzit të hershëm dallojmë dy faza zhvillimi: Shtoj I a dhe Shtoj I b. Rëndësi të veçantë paraqesin në këtë varrezë dy varret e bronzit të hershëm të tumës nr. 6, të vendosur njëri mbi tjetrin me kronologji, rite varrimi dhe kulturë të dallueshme nga njëri-tjetri, varri qendror me gropë dhe varri çist (arkë druri) me elemente të kulturës Cetina. Varri qendror me gropë nën taban, ku u gjetën dy enë balte, përbën një nga format më tipike të varrezave tumulare të periudhës së bronzit të hershëm të Shqipërisë e të Ballkanit. (A.Koka, Tuma nr.6 e varrezës...f. 58).

Materiali i fazës së parë të bronzit të hershëm (Shtoj I a), ku përfshihen edhe gjetjet e varrit qendror të tumës nr. 6, krahas disa elementeve të trashëguara nga neoliti, siç janë objektet e varrit qendror të tumës nr. 6, figurinat, enët në formë govate etj., karakterizohet nga tipare krejt të reja siç janë disa forma enësh, teknika zbukurimi, si ato plastike në trajtë shiritash, me shtypje, ngulitje e incizim pseudobarbotin, etj. Këto dëshmojnë se në formimin e kulturës së bronzit të hershëm këtu kanë marrë pjesë dy përbërës: ai autokton neolitik dhe përbërësi i ri me origjinë stepore. Kultura e kësaj faze në Shtoj zhvillohet në marrëdhënie e lidhje me vende fqinje dhe në një areal më të gjerë. Në rradhë të parë ajo përputhet me kulturat bashkëkohëse të pellgut të vet gjeografik ku ajo u zhvillua, si me atë të Kalasë së Shkodrës, Gajtanit (B.Jubani. Qeramika ilire e qytezës së Gajtanit "Iliria" II, 1972, f.249 v. Tab. I. 1, 2, 3, 4, 5 etj.) e Belajve, me të cilat formon një njësi në vetme kulturore. Disa forma e zbukurime të qeramikës e lidhin kulturën e Shtojit I a, me atë të vendbanimit të Dajçit në Kukës (M. Bela.Vendbanimi shpellor i Dajçit. "Iliria" 1987. 2, f.27-29. Tab. II. 1-27.)... Kultura e fazës Shtoj I a, veçanërisht përmban shumë elemente që e lidhin ngushtë, në pikëpamje kulturore, me krahinat e Adriatikut qendror e të prapatokës së tij, duke e përfshirë kështu kulturën e Shtojit, e përgjithësisht të pellgut të Shkodrës, në sferën e përhapjes së kulturës së njohur si tip adriatik, i kulturës Ljubjana. Një etape më të vonë të bronzit të hershëm i përket varri çist, ku u gjet një enë e tipit Cetina, që datohet në vitet 1800-1700 p. e. sonë, i cili shërben edhe për varrin qendror të kësaj tume. Ky tip varri njihet në arealin e kulturës Cetina si një tip i zakonshëm për të.Qeramika e fazës së dytë (Shtoj I b) ka mjaft tipare që e lidhin atë ngushtë me fazën e parë, gjë që tregon vazhdimësinë nga njëra etapë në tjetrën, por njëkohësisht në këtë fazë dalin nga përdorimi stili e zbukurimet tipike për kulturën Kofoten e Vuçedol, si zbukurimi pseudobarbotin, dhe duken disa tipe e zbukurime të reja, ku një vend të rëndësishëm zënë elementet tipike të bronzit të hershëm të rrethit kulturor Cetina. Kjo dukuri nuk është e veçuar vetëm në Shtoj. Qeramikë e ngjashme me atë të kulturës Cetina është zbuluar edhe në vende të tjera të zonës së Shkodrës, si në Kalanë e Shkodrës, në Gajtan e veçanërisht në tumat e Shkrelit. (G.Hoxha. vep. e cit. f, 75-76, Tab. I. 23, 24, 25; B.Jubani.Qeramikë ilire...380-381. Fig. 2; Gërmimet arkeologjike të vitit 1983. f. 249). Në Shtoj gjenden gjithashtu edhe disa elemente të fazës fundore të kulturës Cetina e fillimit të kulturës dinarike.

Si përfundim mund të konkludojmë se kultura e bronzit të hershëm në Shtoj, e përgjithësisht e zonës së Shkodrës zhvillohet në disa forma në përgjithësi ndryshe nga ajo e kulturës Maliqi III a dhe Maliqi III b. lidhjet më të ngushta, kultura e bronzit të hershëm e Shtojit i ka me kulturat bashkëkohëse të krahinave të Dalmacisë qendrore e të prapatokës së saj, duke e përfshirë kështu kulturën e Shtojit në sferën e përhapjes së këtyre kulturave. Kështu kultura e bronzit të hershëm të zonës së Shkodrës, mendojmë se duhet konsideruar si një kulturë me tipare të qarta krahinore, që zhvillohet në kontakte e lidhje me zonën e kulturës së Maliqit, por duke anuar më tepër nga krahinat e Dalmacisë qendrore. Me këto krahina zona e Shkodrës do të vazhdojë të jetë e lidhur pandërprerje gjatë gjithë epokës së bronzit dhe asaj të hekurit, kur midis këtyre trevave do të formohet edhe një unitet i gjerë etno-kulturor ilir i përfaqësuar nga grupi ilir qendror Glasinac-Maliq.

Materiali i shumtë e i larmishëm i zbuluar në varret e epokës së hekurit jep një tablo të qartë kulturore e kronologjike me vazhdimësi që nga fillimi i fazës së parë deri në fund të fazës së tretë (Shek. V p. e. sonë). Në fazën e parë të periudhës së hekurit, e cila i përgjigjet periudhës kalimtare nga bronzi i vonë në periudhën e hekurit, kultura e Shtojit ka lidhje si me krahinat veriore ashtu dhe me ato jugore të Ilirisë...Stolitë e pakta të kësaj periudhe, siç janë fibula gjyslykore, varësja, pinceta si dhe kama e shpata, të ardhura nga tumat e Shtojit, e cila ndodhet në British Museum të Londrës, (L.Ugolini. Albanica Antica, I Roma.1923. f. 15 fig.15 II V. catling. I. atc Minoan vases bronzes in Oxford." B. S. A." 63 1968. f: 102- 103) janë të përhapura në të gjithë territorin e Ballkanit. Në fazën e dytë (Shek. VIII-VII p. e. sonë) vihen re ndryshime të dukshme në zhvillimin e kulturës së kësaj periudhe. Hyn hekuri gjerësisht në prodhim dhe

prej tij përgatiten jo vetëm armë e vegla pune, por edhe stoli. Kjo fazë karakterizohet nga një zhvillim i ndjeshëm i metalurgjisë së hekurit, sidomos për prodhimin e veglave të punës e armëve. Objektet e kësaj faze përbëhen nga thika, hanxharë, sëpata shpatullake, maja hekurash e shtiza tipash të ndryshme, diadema, pafta e varëse, fibula, sumbulla etj. Shpesh herë enët dhe stolitë janë të zbkuruara me motive të pasura të incizuara, në të cilat pasqyrohet, pothuaj, tërë repertori i artit gjeometrik ilir, i cili lulëzimin e tij e pati në fazën e dytë të periudhës së hekurit (shek.VIII-VII p. e. sonë). Ka varre me inventar të pasur dhe varre të varfër, gjë që vërehet edhe në fazën e tretë. Këto dukuri tregojnë për një nivel ekonomik përgjithësisht të zhvilluar, si dhe për diferencim më të madh ekonomik-shoqëror tek ilirët e kësaj treve. Faza e tretë karakterizohet nga zhvillimi i mëtejshëm i dukurive të fazës paraardhëse. Në këtë kohë shfaqet importi arkaik, i cili dëshmon për marrëdhënie ekonomike të kësaj zone me botën greke.

Në tërësi materialet e fazës së dytë e të tretë të hekurit, nga pikëpamja tipologjike e stilistike, inkuadrohen në grupin kulturor ilir Glasinac-Mat. Qeramika riprodhon forma tipike për kulturën ilire të epokës së hekurit të Matit. Grupi i stolive lidhet ngushtë me Matin po aq edhe me Glasinacin: Megjithatë, në stolitë e Shtojit ka disa elemente lokale që dallohen nga tipat e tyre të gjetura në qendrat e lartpërmendura. Rrallë gjenden edhe zbkurime që janë karakteristike si për kulturën ilire të zonave veriore, ashtu edhe për ato jugore. Mat e Glasinac, dëshmojnë për karakterin e veçantë krahinor të zhvillimit të brendshëm, lidhur kjo me pozitën gjeografike qendrore që zinte zona e Shkodrës në zhvillimin kulturor të këtij grupi (A. Koka Kultura e varrezës tumulare... f. 246 - 247). Të gjitha këto e përcaktojnë zonën e Shkodrës së bashku me atë të Malit të Zi ku gjenden tiparet e kulturës së Shtojit, nga pikëpamja gjeografike e kulturore, si hallkë ndërmjetëse e grupit Glasinac-Mat dhe si një nga zonat më të rëndësishme të përhapjes së kulturës ilire të këtij grupi. (Dr. Aristotel Koka "Kultura e tumave të Shtojit" "Shkodra në Shekuj", vëll. I, f. 211-215).

MESJETA

Drishti

Kryeqendra e Postribës, Drishti apo Drivasti siç quhej në Mesjetë, është themeluar si qytet shumë herët.

Duke grumbulluar material për librin studimor që do të paraqes për Postribën, kam gjetur edhe një libër që bën fjalë për "Fillimet e Heraldikës Shqiptare" në të cilin gjeta emblemën e Drishtit, e cila duket qartë në figurën që paraqitet në libër. Nga Drishti studiuesi Ippen na ka lënë të fotografuar emblemën e derës së Engjëllorëve, të zbuluar jo shumë larg portës së mureve rrethuese të këtij qyteti.

Këtu poshtë po paraqes dy Stemat e familjes së Engjëllorëve të viteve 1555 dhe atë të ripërpunuar të shekullit XVII, të paraqitur nga autorja Lucia Nadin në librin e saj: "Shqiptarët në Venedik". (1479-1552). Këtu poshtë po paraqes pjesën e përparme të hyrjes së Kalasë së Drishtit, ku duken qartë bedenat dhe kulla afër portës. Kjo portë e hyrjes është nga perëndimi i kështjellës, nga ka qenë hyrja kryesore për në kështjellë. Studiuesi Riza Drishti në librin "Shkodra në Shekuj", seminari i tretë, vëllimi i parë, në temën studimore të titulluar "Drishti në historinë kombëtare të Shqiptarëve", e ndan këtë temë në 8 pjesë kryesore, të cilat janë si më poshtë: "

1.TË DHËNA HISTORIKE PËR THEMELIMIN E DRISHTIT...

Studiuesi në: "Të dhëna historike për themelimin dhe disa aspekte të jetës qytetare në Drisht" në mes të tjerave thotë: "...Sipas Marin Barletit (1460-1512-13), në veprën "Historia e Skënderbeut, " shkruante se: "...E shoh me vend të them këtu para lexuesit, se nuk dihet fare nga kush është themeluar qyteti i Drishtit dhe as që njihet lashtësia e tij, megjithqë qytetarët, të cilëve u pëlqen t'i besojnë gabimit të vet, e çojnë me mburrje fillimin e themelimit të qytetit tek romakët...një gjë e tillë nuk provohet në asnjë dokument qoftë të shkruar, qoftë ndryshe..." (Marin Barleti: "Historia e Skënderbeut", Tiranë, 1964, f.155, 158, 466).

Në burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë lexojmë: "...Në shekullin e XII jeta kishtarë e banorëve të Drishtit ishte e lidhur me shumë qytete të tjera të vendit tonë. Më 1199 në selinë e kryepeshkopit të Tivarit u mblodh koncili kishtar i peshkopatave të Shqipërisë: Krujës, Skurjes, Pultit,

Drishtit, Shasit, Ulqinit dhe Sardës...(A. Buda, I. Zamputi, K. Frashëri, P. Pepo: "Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, shek. VIII-XV, Tiranë, 1962, vëll. II. f. 409. Botim i USHT, (IHGJ.f.13).

Duke shkruar për historinë e disa qyteteve shqiptare autorët e librit "Historia e Shqipërisë" theksojnë se: "...Disa nga këta qytete qenë vazhdim i qyteteve antike si Durrësi, Shkodra, Lezha, Vlora, Drishti, të cilët për shumë shekuj kishin humbur rëndësinë e mëparshme". ("Historia e Shqipërisë", Tiranë, 1959, vëll. I. f.184- 185). Më tej në shekullin XIV, duke përmendur qytetet shqiptare thuhet se: "...Në zejtarinë e metalurgjisë dalloheshin pothuaj të gjitha qytetet e Shqipërisë. Sidomos në Shkodër, Drisht e Vlorë kovaçët përpunonin hekurin dhe prodhonin me të vegla bujqësore, si plorë, plugje, shata, gozhda..." "...Për prodhimin e mëndafshit qenë të përmendur... Drishti e Pulti..." (Po aty. F.217)... Dokumentet përmendin edhe poçarët e Drishtit. Qyteti i Drishtit kishte vreshtari të zhvilluar dhe ullishta të shumta. Prodhoheshin verë, vaj, të cilat tregtoheshin në Shkodër. Qyteti i Drishtit kishte stemën dhe statutin e vet qysh në vitin 1397. Prodhonte dhe hidhte në qarkullim monedhën e vet prej bronxi me emrin e qytetit, në latinisht: "Civitas Drivastum". Të gjitha këto të dhëna që përmenda më sipër vërtetojnë se Drishti ishte një qytet i rëndësishëm, krahas qyteteve të tjera që u përmendën me lart, si Shkodra, Lezha, Durrësi, Vlora etj.(shënimi im R. S).

Prof. Zija Shkodra në librin e vet shkruan se: "...Nga fundi i shekullit XIII gjurmët e korporatave i gjejmë në Durrës, ndërsa më vonë (shek.XIV-XV) ato janë të përhapura në Prizren, Shkodër, Drisht, Krujë etj.(Zija Shkodra: "Esnafët shqiptarë (Shek. XV-XX), (Tiranë, 1973. f. 9. 82, 83 dhe "Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare", Tiranë, 1984, f. 441) Studiuesi dhe folkloristi i mirënjohur shkodran, Kolë Kamsi, në kumtesën për Drishtin, shkruan se: "... albanologu austriak Teodor Ipen ndër kërkime të veta ka gjetur, në Drisht në shtëpinë e bajraktarit (Halil Isufit shënimi im, R. S.) një heshtë të kohës së fundit të bronxit, një copë guri që kishte të gdhendur një shqytë me tre hyj e një shkronjë që s'njihet mirë, ka pasur një rrasë varri me një shkrim latin...(Kolë Kamsi: "Drishti" (Kumtesë), Shkodër, 1964, botuar në Buletini Shkencor i ILP të Shkodrës nr.I, f. 163-166).

Në vazhdim, Apolon Baçe, në një artikull studimor shkruan për Drishtin se: "...Një gur varri i gjetur në vend me mbishkrimin kushtuar Aurelianit, një kalorës romak, na lejon që duke u bazuar në stilin dhe formulën e dedikimit, lindjen e qytetit ta shtyjë të paktën deri nga shekulli I-II i erës sonë. (Apolon Baçe: "...Qyteti mesjetar i Drishtit", Tiranë, 1975, botuar në revisten Monumente të kulturës në Shqipëri", nr. 2. f. 51-53), kurse Gjerak Karaiskaj dëshmon se: "... Në kështjellën e Drishtit janë ruajtur gjurmë prehistorike. Kështjella i përket fortifikimit Ilir...Mbi këtë kështjellë janë bërë herë pas here riparime dhe rindërtime në Mesjetë, si nga drishtianët ashtu edhe nga pushtuesit e huaj..."(Gjerak Karaiskaj: " 5000 vjet fortifikime në Shqipëri", Tiranë, 1981, f.18, 147. Bep Jubani: "Plotësime për monumentet arkeologjike në Shqipërinë e Veriut", botuar në revisten "Monumentet ", Tiranë, 1986, f. 125-127)

Në një studim tjetër të thelluar na jepet një panoramë më e plotë e jetës qytetare dhe fshatare të krahinës së Drishtit, gjatë sundimit gati 83 vjeçar venedikas (1396-1478), me ndonjë ndërprerje në vitet 1421-1442. Aty shpërthyen disa kryengritje kundër pushtuesit venedikas në vitet: 1399, 1405, 1409, 1410 si dhe kundër pushtuesit serb në vitet 1421-1442. (Luan Malltezi: "Qytetet e bregdetit shqiptar gjatë sundimit venedikas -aspekte të jetës së tyre", Tiranë, 1988, f. 3, 87, 88). Në vazhdim të këtij problemi, historiania Pranvera Bogdani, duke shkruar për Balshajt, thotë: "...Aty përfshijnë në zotërimet e veta Zetën, qytetet Shkodër, Drisht, Tivar e Budva, të cilët mbetën bërthama territoriale e principatës gjatë gjithë kohës së sundimit të tyre..." (Pranvera Bogdani: Zëri "Balshaj", botuar në librin: "Fjalori enciklopedik shqiptar", Tiranë, 1985, f. 64). Së fundi, studiuesi ushtarak jugosllav Dragoljub Joksimović, shkruan se: "... Drivast" (Drishti), është njera nga kështjellat më të rëndësishme (castrum) mesjetare në Shqipëri, në sistemin e mbrojtjes së Shkodrës...Në kohë të lashta mënohej nga ilirët dhe pastaj nga romakët..." (Dragoljub Joksimović: Zëri "Drivast" (shqip Drishti) në Vojna Enciklopedija (Enciklopedi ushtarake), Beograd, 1971, vëll. II, f. 542).

2. BURIMI I EMRIT SHQIPNI, SHQIPËRI, SHQIPTAR, SHQIP

Burimi i emrit:Shqipni, Shqipëri, Shqiptar, Shqip-prejardhjen e ka nga një familje prej Drishtit (1368-402): Me interes për burimin e emrit të sotëm "Shqipni", "Shqipëri", "Shqiptar", "Shqip", si dhe vetë emrit ilir të qytetit të Drishtit, parashtrohet në veprën "Studime gjuhësore" të gjuhëtarit tonë të shquar Prof. Dr. Eqrem Çabej. Sipas tij del se emri që përdorim sot: Shqipni, Shqipëri, Shqiptar, Shqip-krahas varianteve të tjera të diskutueshme, më i besueshmi, dhe që ndodhet brenda trojeve etnike shqiptare, por që ende

mbetet hipotezë, është se këta emërtime e kanë burimin nga një familje në Drisht, qysh në vitet 1368-1402. Kjo familje drishtiane mbante mbiemrin: Schipudar, schipuder, schapudar dhe schepuder. Ky emër i lënë në harresën e kohës, filloi të përhapet dhe të përdoret gjerësisht qysh në shekullin XVII. Një meritë të veçantë për këta emra ka edhe historiani kroat Dr. Milan Shuflai (1879-1931). (Milan Shuflaj, "Srbi i arbansi"(njihova simbioza u srednjim vjekovima), Beograd 1925, f. 142 (në faqet 11 dhe 25 të origjinalit në serbokroatisht) ose "Serbët dhe shqiptarët (bashkëjetesa e tyre në Mesjetë)", përkthimi në shqip nga Zef Fekeçi dhe Karl Gurakuqi, Tiranë 1926, f. 197 dhe në Prishtinë në vitin 1968).

3. DRISHT ËSHTË EMËR ME PREJARDHJE ILIRE

Gjuhëtari i mirënjohur, Prof. Shaban Demiraj, në botimet e tij ka theksuar: "... Edhe toponimet e vjetra Drivast (Drisht) dhe Aulon (Vlonë-Vlorë) kanë pësuar ndryshime të tilla fonetike që mund të shpjegohen vetëm me anë të rregullave të evolucionit fonetik të elementit të trashëguar të gjuhës shqipe. Kështu te Drisht nga Drivast-rrrokja e patheksuar "va" ka rënë prej kohësh dhe grupi bashkëtingëllor "st" ka dhënë rregullisht "sht", ashtu si edhe raste të tjera të elementit të trashëguar të gjuhës shqipe. Nga emrat e lashtë ilirë këtu vijnë në vështrim në rradhë të parë disa emra vendesh (toponime) dhe njerëzish (antroponime), si dhe emrat e disa fiseve ilire. Të tillë janë ndër të tjera toponimet "Scodra", "Durrak", "Aulon", "Drivast" etj. (Shaban Demiraj: "Eqrem Çabej një jetë kushtuar shkencës". Tiranë, 1990, f. 57 dhe "Zëri i Popullit", "Vendi dhe koha e formimit të gjuhës shqipe", Tiranë. Nr. 121(11, 804), 21 maj 1986, f. 3 dhe 4). Prof. Kolë Kamsi, për emrin e Drishtit, shkruan se: "...Emri i qytetit Drivastum, Drivestum, Drivast siç thirrej motit, del i moçëm fort. Mbaresat "asto", "estë", janë ilire... Influenca romake ndihet në ndonjë emër vendi të dukatit të Drishtit..." (Kolë Kamsi, Vepër e përmendur, Shkodër, 1964, f. 163-166). Duke e mbështetur këtë mendim, studiuesi Vili Kamsi, shkruan: "...Mendimi ynë ka qenë dhe është se, duke qëndruar brenda rregullave të zhvillimit të shqipes, emri i sotëm Drisht rrjedh nga një Drivastum..." (Vili Kamsi "Gjurmime e toponime mesjetare të Shqipërisë", më 12 qershor 1986, në 2 fq. Të daktilografuara (i pabotuar)).

4. DRISHTI NË FUSHËN E ARSIMIT

Siç del nga dokumentat e Raguzës, një mësues nga qyteti i Drishtit hapi shkollën e Stanjit në Dalmaci. Ai quhej Teodor Nikolla. Në dokumentin e datës 19 dhjetor 1388, thuhet se ky mësues mbahej dhe paguhej për shkollën e Stanjit në Dalmaci. Tërthorazi del se arsimit në qytetin e Drishtit duhet të ketë qenë në një nivel të lartë përderisa dërgonte mësues në Dalmaci. Kjo provohet edhe nga figurat e ndritura që ai nxori..." (L.Thallosy, Jirecek, M.Sufflay "Acta et diplomata res Albaniae mediae actatis illustrantia"q vëll. I-II, Vien, 1913-1916 (Akte dhe diploma që ilustronë çështjen e Shqipërisë mesjetare), Vjenë 1913-1916).

8. KTHIMI I DRISHTIT NGA NJË QYTET I LULËZUAR NË NJË FSHAT (SHEK. XV-XX)

Drishti, vërtetë e humbi rëndësinë si qytet, por ai mundi të mbijetojë si fshat, 10 km në verilindje të Shkodrës. Fshati i sotëm i Drishtit përbën një rast të rrallë për studiuesin dhe vizitorin (vendas ose të huaj), sepse nga 4 lagjet e tij, lagjja Kala, është e banueshme deri në ditët tona. Procesi i islamizimit të banorëve të Drishtit dhe të fshatrave që përfshihen në trevën etnografike të Postribës ka përfunduar në vitin 1702. Prof. Aleks Buda kur punohej për hapjen e Muzeumit Kombëtar të Armëve, në Kalanë e Gjirokastrës tha se: "... **Albanologu dhe historiani gjerman Franc Babinger (Franz Babinger 1891-1967), sapo zbriti në aeroportin e Rinasit, në vitin 1967, më kërkoi që të përfshihej në programin e vizitave të tij edhe kalaja e Drishtit**". Kjo tregon se Kalaja e Drishtit kishte një rëndësi të madhe për studiuesit e huaj. Kësaj Kalaje dhe banorëve të Drishtit, Babinger i kishte kushtuar një pjesë të studimeve të veta që në moshë të re. Për këtë ish qytet mesjetar ai kishte përgatitur dhe dorëzuar për botim një libër të veçantë. Ai priste të dilte nga shtypi...Ky botim meriton të gjurmohet nga studiuesit tanë të rinj.

RRETH PREJARDHJES SË EMRIT DRISHT

Sipas etimologut Eqerem Çabej, emri i Drishtit është ndeshur: "Në dokumentet mesjetare latine "Drivastum", në italianët "Drivasto", në grekët "Drivastov", në raguzianët "Drivest", në mesjetarët serbë

“Drivost”. Ndonëse i dëshmuar dokumentarisht vetëm qysh prej shekullit IX e këtej, **Drishti duhet të ketë qenë një themelim që në kohën antike. Për këtë dëshmojnë arkeologjikisht gërmadhat dhe kalaja e moçme e gjuhësisht formimi i emrit, me sufiks-st-sht, formant karaktereistik për ilirishten e më vonë për shqipen**”.(Eqerem Çabej, “Studime etimologjike në fushën e shqipes”, vëll. III, f. 321) Përsa i përket raportit historik Drivastum: Drisht, i pari Skoku, duke u nisur nga format shq. Drisht, skr. Drivest, Drivost, konstatoi që forma e dokumentuar lashtësisht ka qenë Drivastum, me theksim mbi rrokjen nistore të temës. Ky mendim i drejtë do vështruar ndërkaq në mbarë sistemin e toponomastikës së vjetër shqiptare, me zbatim të konstatimit të Krahës (edhe të Skokut) që ilirishtja ka pasur një theksim nistor (inicial), ashtu si edhe disa të tjera gjuhë indoeuropiane (gjermanishtja, keltishtja, italishtja), theksim që ruhet në disa toponime shqiptare të sotme. Prandaj “Drivastum”: Drisht, Dyrhachium: Durrës, Polatum: Pult, etj. Kështu edhe emri i **Drishtit është një ndër dëshmitë e autoktonisë, të kontinuitetit të elementit shqiptar në vendbanimet e sotme të paktën që prej kohës antike.**(Po aty).

NJOHJA E FISEVE DHE BAJRAKËVE SIPAS DOKUMENTACIONIT (KOHA)

POSTRIBA VENDET E TJERA

Viti 743 Drivasto-Drishti Viti 527-565 Dushmani ?
Viti 1332 ? Suma Viti 1108 Arbanum-Arbëri
Viti 1416-1417 Suma Viti 1333 Mazarak-Mazërreku
Viti 1696 ? Suma Viti 1335 ? Kuçi
Viti 1840 Bardhaj Viti 1335 ? Tuzi
Viti 1881 Boksi, Dragoçi Viti 1343 ? Kastrati
Viti 1348 Lohja
Viti 1398 Kopliku
Viti 1414 Hoti
Viti 1416-1417 Grizha, Gruemira.
Viti 1450-Shllaku, Toplana.
Viti 1454-Shala, Shoshi
Viti 1550-Qerreti, Reçi
Viti 1703-Shllaku.

FISET E SHKODRËS ME ORIGJINË NGA POSTRIBA

Studiuesi Hamdi Bushati, në librin e tij voluminoz “Shkodra dhe Motet” ka bërë një punë të madhe shkencore që përfshin shumë fusha. Ajo që paraqet interes këtu është studimi i fiseve që janë me origjinë nga Postriba. Këto fise meqë janë me origjinë nga Postriba, meritojnë pak vend në këtë libër që do t’u paraqes lexuesve, pasi janë pjesë organike e këtij trualli. Ngado që të shkojnë, në çdo vend të botës të jetojnë, ata mbeten me origjinë nga Postriba dhe si të tillë kanë nderin e madh që kanë pasur fatin të jenë të tillë. Njëkohësisht edhe Postriba, si një nënë që ka rritur dhe edukuar bij dhe bija që kanë trashëguar vlerat më të mira të saj, është krenare që përfaqësohet në komunitete të tjera me pasardhës që lënë gjurmë të ndritura të historisë së lashtë të saj. Fiset me origjinë nga Postriba që jetojnë sot në Shkodër, i kanë dhënë Shkodrës një dimension të ri kulturor. Ato e kanë pajisur qytetin me dije, me kulturë, art, me virtytet më të larta të një shoqërie të emancipuar. Bashkë me fise të tjera të zbritura nga fiset më fisnike të Malësisë së Madhe, të Dukagjinit, të Shllakut etj, ata i kanë sjellë Shkodrës civilizimin, qytetërimin, kulturën, artin, shkencën, progresin njerëzor. Dihet historikisht që Shkodra në vitin 1479 u pushtua nga turqit dhe po këtë vit ajo pothuajse u boshatis, pasi qyteti i Drishtit dhe ai i Shkodrës, pas pushtimit turk, mbetën pothuajse pa banorë fare. Shumica e popullsisë të këtyre qyteteve iku drejt brigjeve të Italisë, me qëllimin që të ruanin besimin e tyre katolik, ndërsa një pjesë e vogël e popullsisë që mbeti në vend pranoi konvertimin në mysliman dhe iu nënshtrua pushtimit. Gjatë kësaj periudhe dhe më pas, pati vërshime të mëdha nga Postriba, Malësia e Madhe, Dukagjini, Shllaku, Puka, Mirdita etj, të cilat siç e përmenda më

lart i bënë rigjenerimin qytetit të Shkodrës, i sollën tradita, zakone, doke, gjak të ri, që për një periudhë jo shumë të gjatë Shkodra do të shquhej në të gjitha qytetet e Shqipërisë, si një qytet me diapazon të gjerë qytetërimi, dije, arti, kulture. Shkodra ishte një qytet evropian. Janë pikërisht këto fise që sollën progres në të gjitha fushat e qytetërimit shkodran. (Studimi im, R. S) Përsëri sipas studiuesit Hamdi Bushati, duke studiuar gjenealogjinë e disa familjeve të lagjes “Ndocaj” vihet re se shumica e banorëve janë të shpërngulur nga rrethinat e Shkodrës e të vendosur aty si bujq e kopshtarë, banorë të ulur nga Kraja, nga malet e Mbishkodrës, ose nga rrethet fusharake...Familjet e Boksorëve janë me origjinë nga Postriba... lagjja “Ndocej” kurdoherë ka nxjerrë burra trima e luftëtarë, fytyra legjendare. (Hamdi Bushati, “Shkodra dhe motet” f. 201). Nga shtëpitë e vjetra është edhe ajo e Drishtejve, për të cilën do të shkruajmë në apitull të veçantë me rastin e Luftës së Miletit...Nga toponimet e lagjes “Rus-Maxharr” është për t’u numëruar edhe “Vorri i Fratit” ose “Guri i Fratit”, sikur jemi të informuar nga persona, të cilët ia kanë arrit me e pa dhe me e kujtue atë gur në rrugën në mes të shtëpisë së Karinëve dhe të Molla Ahmet Domnit. Guri ka ekzistuar, sipas tyre, deri në daljen e turkut nga Shkodra. Sipas Hamdi Bushatit, Shkodra në shekullin VII ra në dorë të serbëve. Me vendosjen e këtij shteti, një zotëri me emrin Balshaj zaptoi Zetën, Shkodrën e Drishtin e disa vende të tjera të afërta...(Hamdi Bushati, “Shkodra dhe motet” f. 224).

FISI HOXHA

Me mbiemrin Hoxha, në Shkodër ka disa familje. Këtu është fjala për familjen tregtare të Ibrahim Idriz Hoxhës, banues në lagjen Rus i Vogël, kufi me Rus-Maxharrin. Sipas traditës gojore të familjes origjina duhet kërkuar në Postribë. Islamizimi i familjes duhet të jetë bërë para shekullit XVIII, sepse një nga të parët që kujtohet, është Idrizi, fillimet e shekullit XIX, me profesionin e hoxhës, çka të sugjeron një farë tradite të mëparshme qytetare e shkollimi, duke nënkuptuar dhe një gjendje stabiliteti ekonomikoshoqëror, përforcuar edhe nga një fakt domethënës siç është prania e Ibrahim Idriz Hoxhës në Komitetin Drejtues të Lidhjes së Prizrenit për Shkodrën. Ibrahim kishte arritur të afirmohej në skenën politiko-shoqërore të qytetit që në vitin 1869 për mosbindje ndaj arbitraritetit të valiut osmanllit. Nga fundi i shekullit ai qe emëruar kryetar bashkie (beledije-reiz), por mjerisht...nuk kemi të dhëna konkrete mbi vitet. Familja Hoxha i qe kushtuar tregtisë, kryesisht grumbullimit të leshit dhe eksportit të tij. Ishte i biri i Ibrahimit, Osmani, ai që u shqua në këtë drejtim dhe arriti të krijojë lidhje të ngushta me firma italiane. Me iniciativën e Osmanit u ngrit punishtja e brezave për të kaluar më vonë me ngritjen e fabrikës së tisazhit, e para e llojit në Shqipëri dhe që prodhonte kryesisht bezen, një nga artikujt kryesorë për nevojat e fshatarësisë së kohës. Më vonë u vendosën bazat e fabrikës së Tisazhit dhe të asaj të mëndafshit, në bashkëpunim me Muzhanët... Tregu i brendshëm i kësaj fabrike u shtri në tërë vendin duke përfshirë edhe Korçën. Me jashtë lidhjet u bënë me firmën Prendushi të Triestes. Familja Hoxha u bë e njohur në qytet edhe për faktin se ajo nxori mjeshtrin e këngëve popullore, Sait Hoxhën, rreth të cilit ka edhe shënime të tjera. (Hamdi Bushati “Shkodra dhe motet”, f. 186-187).

DRISHTEJT

Me këtë mbiemër në Shkodër janë dy palë familje të vjetra jo të një fisi: Drishtejt e lagjes Dudas dhe Drishtejt e lagjes Fushë Çelë. Këtu është fjala për Drishtejt e Dudasit. Banesa e këtyre si ndërtesë është një ndër më të vjetrat e kësaj lagjeje, sikurse edhe familja është e vjetër përkatësisht në moshën e ndërtesës. Kjo ndërtesë gjithnjë ka mbajtur lashtësinë e saj dyqindveçare...Të parët e kësaj dere janë ulur prej Drishtit, bajraku i parë i Postribës dhe qyteti i lashtë i Drivastit. Ata erdhën në qytet në fillimet e shekullit të XVIII. Në një dokument të kohës përmendet Sadullah aga Drishti si anëtar i Komisionit Tregtar të vitit 1845. Nga kjo familje u bë i përmendur Haxhi Hysejri, të cilin populli e quajti Haxhag Drishti (mbiemri i vërtetë i drishtejve ka qenë Rada). Në lagjen Dudas Haxhinaga ka pasur një farë ndikimi në mes të banorëve; ashtu edhe pasardhësit e tij deri vonë e mbajtën parinë në atë lagje. Haxhinag Drishti meriton të përmendet si një nga eksponentët e Luftës së Miletit dhe një nga aktivistët e asaj periudhe. Në shtëpinë e Haxhinagës u pat provokuar mbledhja e komisionit të Degës së Lidhjes së Prizrenit, kur Turqia kishte vendosur në vitin 1880 dorëzimin e Ulqinit, Malit të Zi. Në këtë banesë u pat vendosur të luftohej për mosdorëzimin e Ulqinit. Haxhinag Drishti ishte dhe anëtar i Komitetit për organizimin e mbrojtjes së atdheut, sikurse shkruan edhe libri “Lidhja e Prizrenit” e autorit Xh. Belegu: “Hysejag Drishti qe anëtar tepër aktiv i Degës”. Haxhinag Drishti i lindur në vitin 1810, vdiq në vitin 1880.(Hamdi Bushati “Shkodra dhe motet”, f. 159 - 160).

JUKEJT

Në radhën e familjeve me tradita historike është edhe familja e Jukejve. Sipas të dhënave tradicionale të pasardhëve të tyre është një ndër familjet më të vjetra të lagjes Parrucë. Pasardhësit e këtij fisi tregojnë se të parët e tyre janë me origjinë nga Krasniqja të shpërngulur prej andej për çështje gjaku që me miljarët e Bekteshëve kanë ardhur në Shalë të Dukagjinit, mandej prej Shale janë ulur në Rrash të Postribës. Me kohë një nga vëllezërit e tyre ndahet e shkon e zë vend në Trush të rrethit të Shkodrës, kurse pjesa tjetër zë vend në Shkodër në lagjen Parrucë, e cila thuhet se 250 vjet më parë ishte fushë e pabanueshme. Sipas "Hylli i Dritës" të vitit 1942, "Toponomastika e Gelasius", f. 426- 432, rezulton si më poshtë: "Jukajt (vëllazëri myslimane-Rrash-Postribë-Shkodër).Sipas gojëdhënave janë me fis prej Turqie e jo shqiptarë. Ardhur në Shqipëri ndoshta rreth 200 vjet më parë (nga viti kur është botuar ky shkrim nga autori Gelasius). Në "Hylli i Dritës" të vitit 1931, f. 21 përmendet njëfarë Tahir Agë Juka që bëri kryengritje kundër Mehmed Pashë çaushtit." Familja e Jukejve doli në skenë nga çereku i fundit i shekullit XVIII, në periudhën e Karamahmut Pashës. Prej Jukejsh Tahirag Jukaj, i mbiquajtur edhe Tahir aga i Vogël... Historiografia shqiptare Tahirag Jukën e cilëson si udhëheqës i grupit të Tabakëve. Është burrë i zgjuar e trim, por edhe dinak në veprimet e tij politike...Megjithatë Karamahmut Pasha theu me vendosmëri grupin e Tabakëve që udhëhiqej prej Tahirag Jukës dhe ekzekutoi disa nga udhëheqësit e atij grupi, midis të cilëve edhe Tahirag Jukën... Në popullin e Shkodrës ai kishte një ndikim të konsiderueshëm, për këtë populli i pat thurur edhe një këngë trimërie, prej së cilës kemi mundur të gjejmë vetëm këto vargje:

"...Tahirnaga i Vogel
I sillet rrotull Shkodrës..."

Vrasjen e Tahirag Jukës, Oso Juka e tregonte në një variant diçka të ndryshëm prej atyre që kemi treguar më parë. Përsëri sipas plakut Osman Juka, nga fisi i Tahirag Jukës përmenden edhe vëllezërit Myrto e Ahmet Juka, me rastin e komplotit të udhëhequr prej Xheladin Beg Bushatliut, në vitin 1810 kundër Mustafa Beg Bushatliut (më vonë Mustafa Pashës), komplot që dështoi me disfatën e kryengritësve në favor të Mustafa Pashës. Nga çereku i fundit i shekullit XIX e deri në mbarim të okupacionit osman, u bë i njohur Sait Juka, nipi i Myrto Jukës, të përmendur më sipër. Saiti me vëllezër banonte në lagjen Rus i Vogël, aty ku edhe sot banojnë djemtë e nipat e tyre. Ka qenë një nga parësia e kësaj lagjeje...Kurdoherë ka prirë ndër luftëra me çetën e tij kundër agresorëve malazezë, ka marrë pjesë ndër protesta, është vënë në krye të masave popullore kundër pashallarëve turq, kur këta përpiqeshin të zbatonin reforma me të cilat çënoheshin zakonet shqiptare. Në fund të shekullit XIX përmendet Haxhi Ibrahim Juka në mes të tregtarëve të Shkodrës, në vitin 1893. Haxhi Ibrahim qe anëtar i vakëfeve të Shkodrës. Musa Juka ishte nipi i Haxhi Ibrahim Jukës dhe i biri i Zyber Jukës. Në rininë e tij merrej me profesionin "kazaz" (mëndafshdredhës). Musa Juka filloi të dalë në skenë në vitin 1914: më parë si pjesëtar i grupit të "Seda i Milet" (Gazetë turqishte që nisi të botohej këtu nën administrimin e vetë grupit xhonturkofil, H. B.) Qe kryetar bashkë nga viti 1916-1924. Gëzonte besimin e përkrahjen e austriakëve e të francezëve që qeverisnin Shkodrën në ato vite... Me rastin e Luftës së Koplikut qe treguar mjaft aktiv, veçanërisht përsa i përket furnizimit të ushtrisë vullnetare me nxitjen e popullit për furnizimin e frontit. Me ardhjen e Zogut në fuqi, Musa Juka qe bërë krahu i djathtë i tij. Për besnikërinë e tij arriti të bëhej Ministër i Punëve të Brendshme. Me pushtimin e Shqipërisë më 1939, doli në emigracion dhe vdiq në Aleksandri të Egjiptit. Shejnaze Juka u bë heroinë e popullit, e cila vinte nga fisi i Jukeve. Për nder të saj i vunë emrin "Shejnaze Juka "shkollës pedagogjike në Shkodër.(Hamdi Bushati "Shkodra dhe motet", f. 191 - 197).

FISI ÇEKA (SUMA)

Fshati Sumë i Postribës mbahet tradicionalisht si vend i prejardhjes së fiseve shkodrane Suma (katolikë e myslimanë). Tradita e familjes çeka (Suma) transmeton gojarisht këto hollësi në lidhje me prejardhjen e saj. Njëri nga të dy vëllezërit e lagjes Bojaj të Sumës, Kola, u bë mysliman duke u quajtur Sokol (i pari i fisit të Sokolejve të Shkodrës (?!)), ndërsa i vëllai, Pjetri, nuk ndërroi fe dhe u armiqësua me të vëllanë, bile nga frika se Sokoli (Kola) mund të hakmerrej, u largua nga fshati dhe, pas një arratisjeje të gjatë disa

vjeçare, zbriti në Shkodër dhe u strehua tek njëfarë Haxhi çeka, një ish katolik i islamizuar dhe shumë i pasur, me aq influencë sa e mori nën mbrojtje të arraturin. Pjetër Suma i shërbeu me aq besnikëri mirëbërësit të vet, sa arriti t'i shpëtonte inatit të të vëllait dhe njëherazi të ndërtonte dhe shtëpinë. Miqësia me familjen çeka dhe Suma u trash aq shumë sa Pjetri filloi të quhej jo më Suma por çeka, mbiemër që do ta trashëgonin pasardhësit e tij. Për të zhdukur çdo keqkuptim duke pasur parasysh një fakt shumë të rëndësishëm se familja e vjetër tregtare çeka, vetëm në marrëdhëniet e përditshme me bashkëqytetarët njihej me këtë mbiemër, ndërsa në të gjitha dokumentet e shkruara të shekullit XIX figuron me mbiemrin Suma. Edhe anëtari i njohur Filip çeka nënshkruante Filip Suma ndër dokumentet e Lidhjes së Prizrenit. Kështu Pjetri, i pari i fisit çeka-Suma, jetoi dhe punoi në Shkodër duke lënë pesë djem (Preçi, Hila, Ejlli, Kola e Simoni), të cilët u morën me rrobaqepsi. Nga këta Ejlli kreu studimet në Romë dhe shëbeu si prift në Shkodër dhe Shirq. Nga kjo familje, Mikel Suma (çeka), që në vitin 1856 e deri në vitin 1895 ushtroi detyrën e ndihmës dragomanit pranë konsullatës franceze. Ndër brezini të mëvonshme Filip Mikel çeka, pasi kreu të mesmen tregtare, në Shkodër, në administratën shqiptare shërbeu si drejtor finance dhe si nënprefekt në shumë krahina të vendit. (Hamdi Bushati "Shkodra dhe motet", f. 147 - 149).

DERVISHEJT

Janë një familje shkodrane me tradita historike. Pasardhësit e fundit të kësaj familjeje ndryshuan mbiemrin e tyre në "Sokoli". Ky ndryshim i mbiemrit është një çështje familjare, por në pikëpamje gjenealogjike duhet të themi se Dervishejt me Sokolejt, pothuajse nuk kanë të bëjnë aspak. Sokolejt mbahen një fis krejt më vete, ndonëse të ulur nga mali. Sado që historia shqiptare e ka pranuar mbiemrin Sokolejt për Dervishejt, e vërteta nuk mund të mohohet. Familja Dervishejt, me origjinë shqiptare, është e ardhur në Shkodër nga Suma e Postribës kryesisht prej lagjes Bojaj të Sumës. Thuhet se Dervishejt kanë lidhje gjaku me Manejt, Sokolejt e Bacul Hysejt e Golemit dhe Sumejt. Saktësisht nuk dihet se kur kanë ardhur në Shkodër por dihet se Dervishejt që në kohë të Vezirëve Bushatlinj ndodhen të instaluar në lagjen Dërgut ku edhe sot pasardhësit e tyre banojnë ndër troje të vjetra të baballarëve të tyre. Sa duket banesat e vjetra të Dervishejve ishin diku rreth shkollës "Xheladin Fishta". Sipas dokumenteve kadastrale rezultojnë se më i pari i tyre, si mysliman, njihet i quajtur Hysejn Spahia. Këtë titull Hysejini e pat fituar nga timari që i kishte akorduar prej qeverisë turke kundrejt shërbimeve të meritueshme.. I biri i këtij, Dervishi, nuk u quajt më Spahia, ai mori titullin "aga", këndej i mbeti mbiemri familjes "Dervishi". Në periudhën e sundimit të Bushatlinjve bëhen të përmendur sidomos me Abdullahag Dervishin. Historia e Shkodrës nga Dervishejt më të përmendur njih këta persona: Abdullahag Dervishi, i cili ka qenë arkëtar i Ibahim Pashë Bushatliut dhe përfaqësues besnik i tij në çështje të rëndësishme shoqërore e politike.. I dyti është Mahmut Begu, babai i Hodo Pashës. Ai qe sekretar i valiut dhe me këtë Dervishejt fituan titullin "bej" qysh në vitin 1836 kur ishte vali Osman Nuri Pasha I treti vjen Hodo Begu, i cili në fund arriti të gradohej Pashë. Hodoja doli në skenë në vitet 1878-79-80 dhe me vetmohimin që tregoi në periudhën e Lidhjes së Prizrenit dhe të Luftës së Miletit pat fituar simpatinë e masave popullore. Hodo Pasha fitoi të drejtën të quhej një nga figurat më të ndritura të Rilindjes shqiptare. Nga Dervishejt është për t'u përmendur edhe Hafiz Durro Begu, i cili disa vjet me rradhë qe kadi i vilajetit të Shkodrës që në vitin 1908. Hafiz Durro Begu, me rastin e shpalljes së Hyrietit lexoi fermanin mbretëror për aprovimin e kushtetutës së re para popullit të Shkodrës. Ka qenë personalitet me kulturë fetare dhe i specializuar në jurisprudencë islamike. Djali i madh i tij, Fadil Dervishi, ka qenë kapiten aviacioni osman, një ndër pilotët më të zotë të Turqisë. Mbetet për t'u shënuar edhe vëllai i Hodo Pashës, Ibrahim Begu, i cili kishte kryer "Mejtepin ruzhdie". Ibrahim Begu në vitin 1894 ishte kryetar i Xhibalit. Nga fisi i Dervishejve është edhe i quajtur Ago Beg Dervishi (Hamdi Bushati "Shkodra dhe motet", f. 153 - 157).

KAMSI (KAMBËSEJ)

Shkodra, sikurse ka familje të vjetra myslimane me tradita të njohura, ashtu ka edhe familje katolike...Sipas studimeve të një relacioni të botuar, të parët e kësaj familjeje rrjedhin prej Engjëllorëve të Drishtit nga breznia e Dukë Angjelit, veçanërisht nga barku i të birit të dukës së përmendur, të quajtur Denk apo Dhimitër. Nga dialogu i plakut Mark Pema të vitit 1709 me disa prej fisit të Kamsejve, kuptohet se këta paskan qenë zotërinjtë e Kalasë së Drishtit dhe paskan pasur pallate në qytet deri me invazionin e Drishtit. Sipas këtij materiali mbiemri "Kambësi" gjoja paska rrjedhur prej se këta në luftë me turqit qenkan treguar shumë të shpejtë në këmbësori, prandaj qenkan quajtur "Kambsej". Sipas këtij dokumenti me

kohë Denku, i pari i Kamsajve paska rënë në marrëveshje me Sulltanin, i cili iu paska lënë në zotërim pronat e tyre, që i kishin prej Vrake deri në mal të Cukalit. Këto pasuri Kambësajt i gëzuan deri në vitin 1700... Në relacion shkruhet se fisi i Kamsajve formonte një grup rreth 27 shtëpish në afërsi të Shkodrës dhe të Drishtit.

Në disa burime kishtarë e të historiografisë, gjejmë që i quajturi Pepë Kamsi, në vitin 1730, ndër më të vjetrit, ishte dragoman i konsullatës së Republikës së Venedikut në Shkodër. Në vitin 1737 përmendet mzot Pal Kamsi, atëherë meshtar e famullitar i Shkodrës. Në vitin 1741 përmendet edhe një Pal Kamsi, tregtar, eksportues leshi e të tjerë. Ndër pasardhësit e fundit është edhe Gjon Kamsi, dhe një tjetër pinjoll i familjes është edhe profesor Kolë Kamsi, i dalluar në zhvillimin e arsimit kombëtar. Gjoni ishte vëllai i Kolë Kamsit, i cili kishte aftësi të larta profesionale, etj. (Hamdi Bushati "Shkodra dhe motet", f. 197 - 199).

SOKOLEJT

Në vargun e shtëpive me tradita ndikimi, fisnikërie e trimërie, bën pjesë edhe fisi i Sokoleve të Shkodrës. Të parët e kësaj shtëpie janë të ulur nga mali Sumë i Postribës, prej lagjes Bojaj. Deri tani nuk kemi asnjë datë konkrete rreth instalimit të të parëve të tyre në qytet, as nuk dihet se kur u kthyen në islamizëm. Nga folklori e tradita popullore, duke u nisur nga çereku i parë i shekullit XIX, ndër të parët njihet Haxhi Myftarag Sokoli. Në periudhën e sundimit të Mustafa Pashë Bushatliut ka qenë një nga oborrtarët e rixhalët e tij. Me rastin e Luftës Ruso-Turke në vitin 1829 u pat ftuar prej portës së lartë Veziri i Shkodrës, për të marrë pjesë me forcat shqiptare në luftë. Mirëpo Pasha i Shkodrës, para se të vendoste, mbledhi këshillin e ngushtë të tij. Në mes të rixhalëve bënte pjesë edhe Haxhi Myftari. Në bisedime e sipër Haxhi Myftari u deklarua në favor të vajtjes në ndihmë të ushtrisë osmane. Mendimin e Haxhi Myftarit shumica e kundërshtoi, bile, Hysejneg Shllaku iu kërcënua me shpatë në dorë. Mbledhja vendosi që të mos i jepej ndihma ushtrisë turke. Përveç kësaj, Haxhi Myftar Sokoli që ndër përfaqësuesit e Mustafa Pashës për marrëveshjen e dorëzimit të tij te komanda turke, pas tre muajsh qëndrimi e qëndrese në Kala të Shkodrës në vitin 1831. Një dokument i datës 5 janar 1877 konfirmon se Haxhi Myftari, nga familjet e para të Shkodrës, që i pari që bëri pjesë në suitën e Mehmet Reshit Pashës, Kryeministër e komandant i ushtrisë turke, që para 36 vjetësh (referim i asaj periudhe) rrëzoi Mustafa Pashën nga sundimi i Shkodrës. Një fragment i një këngë të vjetër na vë në dukje se Haxhi Myftari që luftëtar e prijës i përmendur kundër forcave malazeze, që sulmonin herë pas here, kufinj të Shqipërisë nga ana e Shkodrës. Fragmenti i këngës është ky:

"...Del moj Shkodër, se ra kaurri
Na ka pri Haxhi Myftari
Ra kaurri malazi
Del, moj, Shkodër, ka nji për shpi.
Del, moj, Shkodër, në daç me dalë
Se na rrethoi Kuçi Kalanë!..."

Haxhi Myftari ka bërë pjesë edhe në këshillin e administratës së guvernaturës edhe pas kapitullimit të Vezirit... Nga shtëpia e Sokolejve një vend të veçantë në historinë e Rilindjes dhe të Luftës së Miletit për veprimtari politike zë Jusuf Agë Sokoli... Fisi i Sokolejve është i përbërë prej shumë barqeve e përveç dy prijësve të përmendur më sipër, më vonë ka pasur edhe njerëz të pajisur me një shkollë mesatare për kohën që qenë vëllezërit Rexhep, Zenel e Elez Sokoli Njihen gjithashtu dhe të tjerë burra të urtë e të nderuar prej popullit, sikurse ka qenë Maliq Agë Sokoli, më parë bylykbash në Këlmend. Gjithashtu njihet Harap Isufi, i cili u vra në përpjekje me Zek Jakinin, i rrethuar në banesën e tij në fshatin Trush. Hysenag Sokoli, i biri i Jusuf Agë Sokolit, heroit të Luftës së Miletit, në vitin 1896 ishte bylykbash i Rrjollit. Duhet përmendur edhe Asllan Bisho Sokoli, i cili shërbeu në gardën sulltanore të Abdyl Hamitit.

Fisi i Sokolejve përbëhet prej shumë familjeve e breznieve. Mbiemri "Sokoli" rrjedh nga i pari i tyre i quajtur Sokol, emër që u bë mbiemër i tërë fisit. Ndër breznitë e vona të Sokoleve u dalluan djemtë e Elez Sokolit: Asimi, Xheladini e Zyhdia. Veçanërisht duhet përmendur Asimi, i cili u dallua si student shumë i talentuar, ai...Përfundoi me rezultate të shkëlqyera Fakultetin e Inxhinierisë në Torino. (Hamdi Bushati "Shkodra dhe motet", f. 241 - 244).

SUMEJT

Me mbiemrin Suma në Shkodër kemi familje myslimane dhe katolike. Të parët nuk janë të një fisi e jaku, kurse Sumejt katolikë, që ekzistojnë këtu, rezultojnë të jenë të gjithë të një fisi, por të ndarë ndër breznitë. Si myslimanët ashtu edhe katolikët janë me origjinë nga zona malore Sumë e Postribës (Studiuesi Hamdi Bushati, në disa vende në libër, Sumën e trajton si zonë e Dukagjinit, gjë që nuk e di se ku mund t'i ketë marrë të dhënat, por Suma me të gjitha lagjet e saj myslimane dhe katolike përfshihet si bajrak me Postribën. Pra Suma ka qenë vazhdimisht bajraku i tretë i Postribës, pas bajrakut të Drishtit dhe atij të Boksit. Bajraktarin Suma e ka në Shakotë. Gjithashtu e di në mënyrë të saktë se në lagjet Gurra dhe Dajcë myslimanë e katolikë janë kushërinj dhe çdo herë kanë bërë morte dhe dasma së bashku si fis. Familja e Brahim Kasemit të Dajcës janë kushërinj me familjen e Ndoc Stakës së Gurrave, dy familje të njohura për traditat më të mira të mikpritjes, të trimërisë, të burrërisë dhe të zgjuarsisë. Lagjet Gurra e Dajcë rrjedhin nga një i parë i tyre, i quajtur Dol Kuçi, i ardhur nga Kuçi i Malit të Zi, me origjinë shqiptare, shënim im, R. S). Sumejt myslimanë kanë qenë një familje me tradita të njohura nga populli i Shkodrës. Pas ardhjes në fuqi të Mustafa Bushtaliut dolën në skenë me kryetarin e tyre Mustafag Sumën, i quajtur nga populli Cafo Suma, i cili në oborrin e vezirit arriti të fitonte një simpati të veçantë dhe të konsiderohej ndër më besnikët e vezirit. Cafo Suma, jo vetëm që administronte të gjitha pronat e Vezirit, ai ishte edhe këshilltar sekret i Bushatliut, kishte edhe të drejtën e firmës ndër akte të shitblerjes. Cafo Suma e tregoi besnikërinë e tij ndaj Mustafa Pashës kur pranoi të ekzekutohej në vend të tij në bazë të dënimit të dekretuar nga Sulltan Mahmuti II me rastin e kapitullimit të Oxhakut të Bushatlinjve në vitin 1831. Cafo Suma i parë e kishte shtëpinë në Tabakë. Ai pat edhe një vëlla që quhej Ali Sumë Tabaku... Cafo Suma i dytë, kur i erdhi koha, bëri krushqi me shtëpinë e Bushatlinjve. (Hamdi Bushati "Shkodra dhe motet", f. 244 - 247).

SUMEJT - KATOLIKË

Autori Hamdi Bushati në librin e tij "Shkodra dhe motet" në mes të tjerave thotë: "...Pikësëpari, autori, duke dashur që të verifikonte personalisht vjetërsinë e kësaj familjeje, vizitoi varrezat katolike në Rëmaj, ku gjeti një gur të asaj familjeje mbi të cilin, në fund të gurit, ishin të gdhendura këto fjalë në gjuhën italishte (këtu të përkthyer shqip): "Këtu pushojnë eshtrat e Zotëri Ndrek Ndoc Sumës, vdekur më 22 qershor 1322". ("Shkodra dhe motet", f. 247...).

FISI META

Përveç familjes Meta të ardhur nga Kruja, me të njëjtin mbiemër kemi edhe familjen e Abdyl Metës të ardhur nga Domni i Postribës. Abdyl qe dalluar në luftën e Rrzhanicës (vëll. I f. 42). Nipat e tij qenë të shkolluar. Kjo familje qe persekutuar nga diktatura: Të gjashtë pjesëtarët e kësaj familjeje pësuan këto dëmtime: Isaja burgim të përjetshëm. Ragipi me burgim të përjetshëm.. Shaqiri, Xhevati, Danishi, Agimi, të gjithë së bashku 37 vjet burg. (Hamdi Bushati "Shkodra dhe motet", f. 220 - 221).

FISI SHIROKA

Ky është një fis shumë i vjetër, një pinjoll i këtij fisi, z. Emil Engjëll Shiroka ka mbledhur të dhëna mbi gjenealogjinë e fisit dhe në vitin 1974 ka hartuar edhe tringun familjar, të cilin na e dha. Më poshtë po japim një përmbledhje të tyre: Prejardhja e fisit Shiroka duhet kërkuar te fisi i Ejllorëve (Engjëllorëve), të cilët sipas Anonimit Tivaras dhe Dhimitër Frangut ishin ndër shtëpitë princore më të vjetra të Shqipërisë. Engjëllorët patën ardhur nga Kostantinopoli në vitin 1200, përzunë serbët dhe pushtuan Drishtin dhe Tivarin.(Shih F. S. Noli "Historia e Skënderbeut", 1949, f. 14) Njëri nga këta princa qe Ndrekë Ejllori (Kont Andrea Angelo Flavio Komneni) i njohur si fisnik e luftëtar trim dhe si autor i veprës në latinisht "Gjenealogjia e shtëpisë së Engjëllorëve të Drishtit", 1855, ku mbrohet mendimi se Engjëllorët janë me prejardhje bizantine nga shtëpia perandorake e Komnenëve. Të bijtë e Andreas qenë Pali dhe Pjetri. Pal Ejlli (Engjëllori, Radovani) qe ipeshkv i Tivarit dhe Arqipeshkv i Durrësit, delegat apostolik i Papës, gati si ministër i jashtëm i Skënderbeut...i njohur si autor i së famshmes "Formula e Pagëzimit", viti 1462, dokument i parë i shqipes së shkruar. Ka të ngjarë që nën pseudonimin Tivarasi të fshihet vetë Pal Engjëlli... Pjetër Engjëlli, vëllai i Palit, qe një nga bashkëluftëtarët e Skënderbeut, një nga anëtarët e gardës, një nga këshilltarët ushtarakë.. Pas pushtimit të Drishtit nga turqit në vitin 1478...Engjëllorët e

braktisën vendin dhe emigruan në Itali. Pasardhës të Engjëllorëve, të ardhur këtu me ekspeditat e pasardhëve të Skënderbeut, mbetën në Shqipëri dhe u vendosën në një zonë në mes Shkodrës dhe Shirokës, matanë Urës së Bunës, afër Kishës së Shën Mërisë. Prej këtij mbiemri të ri familja mori mbiemrin Shiroka. Për këtë shkruan edhe Gjergj Merula, bashkëkohës me Engjëllorët, dhe venedikasi Koriolano Kopione. Sidoqoftë, që në gjysmën e parë të shekullit XIX, familja Shiroka figuron në radhën e familjeve tregtare më të njohura të Pazarit (Ditari i M. Boriçit-1844). Kjo përforcohet nga fakti tjetër se Ndrekë Shiroka është ndër anëtarët e Komitetit Drejtues të Lidhjes së Prizrenit. Është Filip Engjëll Shiroka, vjershëtari gojë ëmbël, “poeti i mërgimit” ai që lartësoi edhe një herë emrin e fisit. Nuk është rastësi që poeti Filip Shiroka, në veprën e tij vuri pseudonimit: “Gegë Postriba”, pasi ky e dinte mirë se ishte me origjinë nga Postriba, nga fisi i Engjëllorëve, (shënimi im, R. S). Ejl Shiroka bëri pjesë më 1913 në Klubin “Lidhja Kombëtare”. I vëllai i tij, Frederiku, u bë i njohur jo vetëm brenda vendit si kirurg, por edhe jashtë tij. (Hamdi Bushati “Shkodra dhe motet”, f. 256 - 258).

FISI URA

Fisi Ura, sipas burimeve gojore, e ka prejardhjen nga fshati malor i Postribës, Ura e Shtrejtë. Për arsye gjaku, njëri nga pjesëtarët u largua nga fshati Ura e Shtrejtë dhe u vendos në Bushat, dhe pasi u konvertua në islamizëm, u vendos në qytetin e Shkodrës, në lagjen Tabakë, sikur e dokumenton një dokument i kohës ku përmendet njëfarë Isuf Ura, banues i asaj lagjeje (Shih vëll I. f. 63 - 64). Familja Ura disponon një korespondencë të pasur tregtare me qytetet e Italisë. Dokumenti më i vjetër përmban datën 19 gusht 1843. Ky dokument është një letër që i erdhi Ali Urës, i pari i familjes, nga Venediku... Ashtu si Ali Ura i brezit të parë edhe Ali Ura i mëvonshëm u shqua në tregtinë e lëkurëve, ku tregtia e tyre arriti nivelin më të lartë... Me vdekjen e Ali Urës tregtia e lëkurëve u ndërpre, por ndërkaq vëllezërit Ura ishin të stabilizuar në lagjen Rus i Vogël. (Hamdi Bushati “Shkodra dhe motet”, f. 265 - 266).

TRASHËGIMIA GOJORE

MBETUR NË RRETHIMIN E SHKODRËS (1912 - 1913)

Postriba ka marrë pjesë në “Rrethimin e Shkodrës” të vitit 1912-1913, duke u dislokuar në frontin e Myselimit dhe në Bardhanjel. Lufta më e përgjakshme në këtë rrethim është bërë në këto dy fronte ku ka marrë pjesë dhe Postriba. Sipas dëshmisë së veteranit të luftës Ramadan Vuli nga fshati Ura e Shtrejtë, në Rrethimin e Shkodrës kanë marrë pjesë nga e gjithë Postriba, nga një trim për tym, siç thonin të moçmit, kështu në fshatin Ura e Shtrejtë kanë marrë pjesë edhe burrat si më poshtë: Selman Isufi, baba I Fasli Selmanit, Tahir Isufi, baba i Duk Tahirit e të tjerë. Humbjet më të mëdha të luftëtarëve të Postribës si edhe të forcave të armikut janë bërë natën e 29 dhjetorit të vitit 1912, kur brenda një nate kanë mbetur të vrarë 60 luftëtarë dhe plagosur 70, të gjithë postribas. Në luftën për mbrojtjen e Shkodrës fuqia mbrojtëse ishte 15.000 ushtarë, nga të cilët 5.000 ushtarë aktivë dhe 10.000 rezervistë nga popullsia civile e qarkut të Shkodrës me rrethina e malësi si dhe nga rrethe të tjera të Shqipërisë. Nga forcat sulmuese kishte 20.000 ushtarë malazezë dhe së bashku me serbët bëheshin 55.000 ushtarë. Në fund të luftës bilanci ishte i tillë: malazezë të vrarë 3.500 ushtarë, serbë të vrarë 600 ushtarë, ndërsa nga ushtria osmano-shqiptare 4.000 dëshmorë dhe të plagosur. Lufta për mbrojtjen e Shkodrës ishte nga më të përgjakshmet, duke luftuar trup më trup e bajonetë më bajonetë. Nga Postriba mbetën të vrarë në luftën e Bardhanjelit dhe në Fusha të Myselimit, në Ulqin, në Deçiq etj., luftëtarët si më poshtë:

1. Dan Zyber Repaj... nga fshati Boks
2. Brahim Beqir Shabaj... nga fshati Boks
3. Halil Isuf Dushaj... nga fshati Drisht
4. Zeqir Isuf Dushaj... nga fshati Drisht
5. Zeqo Smajl Bushaj... nga fshati Kullaj - Boks
6. Idriz Bajram Bajraktari... nga fshati Kullaj-Boks (dëshmor)
7. Haxhi Isen Kurti... nga fshati Domën
8. Isen Kurti... nga fshati Domën
9. Selim Bajram Vulaj... nga fshati Ura Shtrejtë

- 10.Haxhi Ali Kodra... nga fshati Domën
- 11.Kurt Mustaf Jeremija... nga fshati Domën
12. Haxhi Cen Uruçi... nga fshati Domën
13. Caf Cen Uruçi... nga fshati Domën
14. Selim Ram Vulaj... nga fshati Ura Shtrejtë (dëshmor)
15. Januz Met Ahmetaj... nga fshati Ura Shtrejtë
16. Hasan Zenel Bibaj... nga fshati Ura Shtrejtë.
- 17.Bajram Isen Uruçi... nga fshati Domën
- 18.Haxhi Isen Uruçi... nga fshati Domën (dëshmor)
19. Imer Zeneli Hykaj... nga fshti Rrash - Vorfë
20. Lil Nuz Halilaj... nga fshati Dragoç (dëshmor)
21. Avdyl Mustafa... nga Rrash - Vorfa
22. Avdi Hysen Hysaj... nga fshati Myselim (dëshmor)
23. Selim Zenel Bibaj... nga fshati Ura Shtrejtë (dëshmor)
24. Hasan Ahmeti... nga fshati Drisht (Amarej)
25. Lic Hasani... nga Drishti (lagjja Kala)
26. Selim Mehmeti... nga fshati Mes
- 27.Hysen Avdija... nga fshati Myselim
- 29 Myrto Dan Bahçja... nga fshati Drisht (dëshmor)
- 30.Nuh Ahmet çela... nga fshati Drisht (dëshmor)
- 31.Selim Mehmet Dani... nga fshati Myselim (dëshmor)
- 32.Selim Bajram Ulikaj... nga fshati Drisht (dëshmor)
- 33.Isuf Shaban Dushaj... nga fshati Drisht (dëshmor)
- 34.Bajram Osman Muhaj... nga fshati Drisht (dëshmor)
- 35.Mdok Mehmet Metaj... nga fshati Vilzë (dëshmor)
- 36.Shaban Bajram Fisha... nga fshati Vilzë (dëshmor)
- 37.Sait Ramadan Legati... nga fshati Vilzë (dëshmor)
- 38.Reshit Beqir Babaj... nga fshati Drisht (dëshmor)
- 40.Haxhi Adem Ulikaj... nga fshati Drisht (dëshmor)
- 41.Mustaf Hysen çela... nga fshati Drisht (dëshmor)
- 42.Haxhi Dosh çela... nga fshati Drisht (dëshmor)
- 43.Halil Mehmet çela... nga fshati Drisht (dëshmor)
- 44.Beqir Mustaf Bushaj... nga fshati Kullaj (dëshmor)
- 45.Sulo Ndok Papaj... nga fshati Vilzë (dëshmor)
- 46.Liç Murat Bushaj... nga fshati Drisht (dëshmor)
- 47.Cen Ymer Frexhaj... nga fshati Vilzë (dëshmor)
- 48.Avdi Hysen Hyseni... nga fshati Drisht (dëshmor)
- 49.Arif Hysen Kutureli... nga fshati Domën (dëshmor)
50. Avdi Hysen Hyseni... nga fshati Drisht
51. Nuh Ahmert çelaj... nga fshati Drisht
52. Reshit Beqir Bahçja... nga fshati Drisht
- 53.Zeqir Bejto Repaj... nga fshati Boks, mbetur në Deçiq, viti 1911.
54. Bejto Isuf Repaj... nga fshati Boks, mbetur në Ulqin, në vitin 1880.

Shënim: të gjithë burrat e mësipërm kanë rënë në përpjekje me pushtuesit serbomalazezë në periudhën e rrethimit të Shkodrës në vitet 1912-1913, të cilët kanë qenë të dislokuar në frontin e Myselimit dhe në atë të Bardhanjelit, vend në të cilin është zhvilluar lufta më e ashpër, trup më trup dhe bajonetë më bajonetë. Të gjithë luftëtarët e Postribës kanë qenë nën komandën e Komandantit popullor Adem Haxhi Spahija, i cili u shqua në drejtimin dhe organizimin e luftës si një strateg i vërtetë lufte. Mjafton të saktësojmë për sa thamë më sipër, me dekorimin: ***Për merita të shquara patriotike Adem Haxhija dekorohet nga Kuvendi Popullor me urdhrin: “Për veprimtari patriotike të klasit të parë” me motivacionin “Si luftëtar i shquar e komandant popullor ka treguar***

trimëri të rrallë në mbrojtjen e Shkodrës 1912-1913 kundër shovinistëve serbo-malazezë dhe për mbrojtjen e tërësisë tokësore e pavarësisë kombëtare.

Patriotët, të cilëve u është shënuar përbri mbishkrimi “dëshmor” janë marrë nga lista e dëshmorëve të atdheut me vendim të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të rrethit Shkodër nr. 7, datë 12 janar 1987.

Një listë e 12 burrave që kanë rënë në luftë kundër serbo-malazezëve nga fshati Drisht, dorëzuar nga bajraktari i Drishtit, Ymer Myrtja u verifikua dhe rezultoi se emrat e 9 burrave janë pasqyruar në listën e mësipërme, ndërsa tre të tjerë, të quajturit Nuh Ahmet Çelaj, Avdi Hysen Hyseni dhe Reshit Beqir Bahçja, iu shtuan listës së mësipërme, duke e rritur numrin nga 51 veta në 54 veta. Materiali i mësipërm është marrë nga tre burime: nga burra të vjetër në të gjitha fshatrat e Postribës, një burim, nga Komiteti i Veteranëve të rrethit Shkodër, burimi i dytë dhe nga lista e dorëzuar nga bajraktari i Drishtit, burimi i tretë.

DISA LUFTËTARË QË ADEM HAXHIJA KA MBAJTUR AFËR GJATË LUFTËS

Këto të dhëna i kam marrë, disa nga vetë luftëtarët që kanë luftuar gjithmonë pranë Adem Haxhisë, ndërsa disa mi ka treguar, vëllai i Adem Haxhisë, Osman Haxhija shumë vjet më parë, kur ai jetonte. Adem Haxhija nuk ka pasur preferenca miqësie, gjaku apo diçka tjetër, por në mbajtjen e këtyre burrave është përpjekur të afrojë nga të gjitha fiset për të bërë një lidhje më të fortë të luftëtarëve të Postribës. Ai ka pasur parimin në afrimin e këtyre luftëtarëve: të jenë besnikë, të vendosur kurdoherë për të dhënë jetën po të jetë nevoja dhe të mos tërhiqen në çfarëdo rrethanash e vështirësish që mund të ndodhen në front. Burrat që kanë luftuar pranë Adem Haxhisë kanë qenë: Imer Beqir Shabaj nga fshati Boks, Man Alush Gruda nga fshati Dragoç, Kasem Hysen Hysaj nga fshati Myselim, Brahim Zenel Plangaj nga fshati Boks, Halil Ahmet Cekaj nga fshati Kullaj, Ahmet Cuf Celufaj nga fshati Dragoç, Etëhem Beqir Bracaj nga fshati Dragoç, Sadri Ali Isaj nga fshati Shakotë, çel Shaban Repaj nga fshati Boks e të tjerë. Këtu poshtë do të paraqes këta luftëtarë, duke treguar shkurtimisht pak nga jeta e tyre:

IMER BEQIR SHABAJ

Meqenëse ketë luftëtar e kam pasqyruar në kapitullin XXVII “Burrat më në zë të Postribës”, këtu nuk do të ndalem më shumë.

MAN ALUSH GRUDA

Meqenëse ketë luftëtar e kam pasqyruar në kapitullin XXVII “Burrat më në zë të Postribës”, këtu nuk do të ndalem më shumë.

KASEM HYSEN HYSAJ

Sipas bisedës që kam bërë me Kasem Hysenin, kur ai ishte gjallë (shënimi im R. S.), ai më tha se Adem Haxhija e mbante gjithmonë pranë vetes në çdo luftë. Këtë e kam pasqyruar edhe në materialin “Populli për Adem Haxhinë” të kapitullit “Periudha e pushtimeve”, ndaj dhe nuk do të zgjatem më shumë. Gjithashtu këtë të dhënë e sjell edhe Gani Sait Hysaj në materialin për familjen e Kurt Hysen Hysajt.

BRAHIM ZENEL PLANGAJ

Meqenëse ketë luftëtar e kam pasqyruar në kapitullin XXVII “Burrat më në zë të Postribës”, këtu nuk do të ndalem më shumë.

HALIL AHMET CEKAJ

Meqenëse ketë luftëtar e kam pasqyruar në kapitullin XXVII “Burrat më në zë të Postribës”, këtu nuk do të ndalem më shumë.

ETËHEM BEQIR BRACAJ

Një nga luftëtarët që ka mbajtur pranë vetes Adem Haxhija ka qenë edhe Etëhem Beqir Bracaj, i cili, siç thonin, ishte shumë trim, i besës dhe i vendosur për të flijuar edhe jetën po ta kërkonte nevoja e atdheut. Etëhem Beqir Bracaj ka lindur në Dragoç në vitin 1888 dhe ka vdekur në vendlindjen e tij në vitin 1973, në

moshën 85 vjeçare. Në Rrethimin e Shkodrës ai merr pjesë në këtë luftë megjithëse ishte një djalë i ri në moshën 24 vjeçare dhe lufton heroikisht, pa kursyer asgjë në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe të integritetit tokësor. Ai merr pjesë në të gjitha luftërat që zhvillohen në mbrojtje të lirisë dhe pavarësisë së atdheut. Etëhem Beqir Bracaj merr pjesë në kryengritjen e vitit 1916 kundër pushtimit austro-hungarez, që u zhvillua në afërsi të Urës së Mesit. Në vitin 1920 merr pjesë në Luftën e Koplikut, në Suka të Moksetit, së bashku dhe nën komandën e Adem Haxhisë dhe lufton heroikisht në mbrojtje të vatanit. Etëhem Beqir Bracaj merr pjesë në rezistencën që organizohet nga Postriba kundër pushtimit fashist të 7 prillit të vitit 1939, bashkë me forcat e tjera të Postribës. Gjithmonë ai gjendet pranë Adem Haxhisë si një nga besnikët e tij.

SADRI ALI ISAJ

Sadri Alija ishte një nga luftëtarët më besnikë që mbante Adem Haxhija pranë vetes. Ai ka lindur në fshatin Shakotë të Postribës në vitin 1918 dhe ka vdekur në vendlindjen e tij në vitin 1987, në moshën 69 vjeçare. Sadri Ali Isaj ka qenë një nga burrat më në zë të Postribës, por në pamundësi për të marrë të dhëna mbi jetën e tij, megjithë këmbnguljen time, për ta pasqyruar tek kapitulli XXVII “Burrat më në zë të Postribës” u detyrova të shkruaj dy fjalë për këtë burrë. Sadri Ali Isaj ishte planifikuar nga hamnesha e krajlit të Malit Zi për ta vrarë duke paguar lekë pasi i kishte sjellë shumë shqetësime ushtrisë malazeze, bashkë me Adem Haxhinë e Brahim Zenelin. Populli e ngriti në këngë veprën e tyre, ku në mes të tjerave thuhet:

“... Hamnesha e krajlit çka ka thanë:
Treqind lira i kam dhanë
Treqind lira i jap në dorë
Kush t’mi mbysin tre boksorë
Adem Haxhinë vetë të tretin
Sadri Alinë, Brahim Zenelin...”

AHMET CUF CELUFAJ

Ahmet Cuf Celufaj ka lindur në fshatin Dragoç në vitin 1890 dhe ka vdekur në vendlindjen e tij në vitin 1975, në moshën 85 vjeçare. Ahmet Cufi ka qenë një luftëtar besnik i Adem Haxhisë dhe i vendosur për të sakrifikuar edhe jetën e tij në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe të integritetit tokësor. Ai nuk dinte kthim mbrapa në çfarëdo rrethanash apo situatash të paraqitej lufta. Burrë i vendosur për të vdekur bashkë me Adem Haxhinë në çdo situatë që të paraqiteshin rrethanat. Në Rrethimin e Shkodrës ai merr pjesë në këtë luftë megjithëse ishte një djalë i ri në moshën 22 vjeçare dhe lufton heroikisht, pa kursyer asgjë në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe të integritetit tokësor. Ai merr pjesë në të gjitha luftërat që zhvillohen në mbrojtje të lirisë dhe pavarësisë së atdheut. Ahmet Cuf Celufaj merr pjesë në kryengritjen e vitit 1916 undër pushtimit austro-hungarez, që u zhvillua në afërsi të Urës së Mesit. Në vitin 1920 merr pjesë në Luftën e Koplikut, në Suka të Moksetit, së bashku dhe nën komandën e Adem Haxhisë dhe lufton heroikisht në mbrojtje të vatanit. Ahmet Cufi merr pjesë në rezistencën që organizohet nga Postriba kundër pushtimit fashist të 7 prillit të vitit 1939, bashkë me forcat e tjera të Postribës. Gjithmonë ai gjendet pranë Adem Haxhisë si një nga besnikët e tij.

ÇELË SHABAN REPAJ

Çelë Shabani ishte nip i Adem Haxhisë, djali i Zile Haxhisë. Ai kishte trashëguar në gjenin e tij tiparet e trimërisë së dajës, Adem Haxhisë. Çelë Shabani ishte shumë trim dhe besnik, që nuk dinte kthim mbrapa në betejat që bënte me armikun. I vendosur deri në flim, ai tregoi trimëri të rrallë në betejat që u zhvilluan kundër ushtrisë pushtuese serbo-malazeze, për të cilat nuk do të pasqyroj gjë këtu, pasi i kam paraqitur në këtë kapitull në temën “Marrë pjesë në Luftën e Koplikut”. Ka lindur në fshatin Boks në vitin 1883 dhe ka vdekur në vendlindjen e tij më 6 mars të vitit 1981, në moshëm 98 vjeçare. Në Rrethimin e Shkodrës ai merr pjesë në këtë luftë megjithëse i ri në moshë dhe lufton heroikisht, pa kursyer asgjë në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe të integritetit tokësor. Ai merr pjesë në të gjitha luftërat që zhvillohen në mbrojtje të lirisë dhe pavarësisë së atdheut. Merr pjesë në kryengritjen e vitit 1916 kundër pushtimit austro-hungarez, që u zhvillua në afërsi të Urës së Mesit. Në vitin 1920 merr pjesë në Luftën e Koplikut,

në Suka të Moksetit, së bashku dhe nën komandën e Adem Haxhisë dhe lufton heroikisht në mbrojtje të vatanit. Çelë Shaban Repaj merr pjesë në rezistencën që organizohet nga Postriba kundër pushtimit fashist të 7 prillit të vitit 1939, bashkë me forcat e tjera të Postribës. Çelë Shaban Repaj ka ndihmuar Luftën Nacional-çlirimtare me bukë, strehim, pritje e percjellje. Shtëpia e tij ka qenë bazë e Luftës Nacional-çlirimtare.

MBETUR NË LUFTËN E ULQINIT (1880)

Në luftën për mbrojtjen e Ulqinit kanë marrë pjesë bajraktarë dhe prijës të Postribës bashkë me luftëtarët trima të zonës. Në këtë luftë mbetën të vrarë Bejto Isuf Repaj, Tahir Haxhi Bajraktari e të tjerë. Materiali për Bejto Isuf Repaj që ka marrë pjesë në Luftën për mbrojtjen e Ulqinit në vitin 1880 dhe ka mbetur heroikisht në këtë luftë, në frontin e Muriqanit, është marrë nga Hamit Brahim Repaj nga fshati Boks, i moshuar, njeri i drejtë dhe i ndershëm. Gjithashtu materiali për Tahir Haxhi Bajraktarin, që ka marrë pjesë në Luftën e Ulqinit dhe ka mbetur atje heroikisht është marrë nga veterani Fadil Emin çelaj, nga fshati Dragoç. Përveç kësaj, Tahir Haxhi Bajraktari është përjetësuar nga populli në këngën e titulluar: “Kënga e Tahir Haxhisë”, të cilën e kam paraqitur në kapitullin “Periudha e Pushtimeve”.

MBETUR NË MALIN RUMIJE (1800-1850)

Sipas dëshmisë së kryetarit të veteranëve të luftës për fshatin Ura e Shtrejtë, Ramadan Vulit, baba i Isuf Sylo Gashit, i quajtur i Sylejman Taf Alija, ka mbetur në luftë në përpjekje me ushtrinë malazeze, në malin e Rumisë. Aty është varrosur bashkë me ushtarë të tjerë që kanë mbetur në përpjekje me ushtrinë serbo-malazeze. Për heroizmin e tij populli e ka përjetësuar me një këngë, prej të së cilës do të shkëpusim tre vargje:

“... Sylejmani i Taf Alisë
Preu kryet e llisë
Nën shpatë të Malcisë...”

MBETUR NË LUFTËN E PARË BOTËRORE

Mund të kenë mbetur edhe të tjerë rreth viteve 1909-1910, por ajo që dihet dhe që është legalizuar është përcaktuar si më poshtë: çelë Isen çelaj ka mbetur bashkë me Haxhi Ali Kodrën, të dy nga fshati Domën. Këta të dy kanë mbetur duke luftuar kundër ushtrisë serbo - malazeze. Vendi që kanë mbetur quhet “Rrasat e Fikut” të Hotit. Kjo vërteton se Postriba edhe në Luftën e Parë Botërore ka marrë pjesë dhe ka luftuar në mbrojtje të integritetit tokësor të vendit tonë. Shënim: Ky material është marrë nga Manush çela, stërnipi i çelë Isen çelës, që në linjë gjenealogjike është si më poshtë: Maunsh - Haxhi - Sadik - Ali - çelë - Isen - çelaj. Materiali është saktësuar edhe nga burra të tjerë nga Domni.

MBROJTJA E DEÇIQIT (1911)

Luftën e Deçiqit e kam paraqitur në kapitullin “Periudha e Pushtimeve”, ndërsa këtu do të paraqes pjesëmarrjen në këtë luftë të Zeqir Bejto Isufit (Repaj), nga fshati Boks, i cili ka mbetur heroikisht në këtë luftë. Të dhënat për këtë i kam marrë nga nipi i tij, Hamit Brahim Repaj (në linjë gjenealogjike: Hamit-Brahim-Zeqir-Bejto-Isuf...). Për Zeqir Bejto Isuf Repaj ka dy versione: I Pari është ky që paraqitem më lart, se ai ka mbetur në Luftën për mbrojtjen e Deçiqit, ndërsa versioni i dytë është se ai ka mbetur në Luftën e Koplikut të vitit 1920, në Suka të Moksetit. Versioni i parë është paraqitur nga vetë nipi i tij, ndaj dhe them se do të jetë versioni më i saktë pasi askush më mirë se njerëzit e tij nuk mund ta dinë këtë ngjarje.

INTERNUAR NË PODGORICË

Si shenjë hakmarrjeje për dështimin e luftës për pushtimin e Shkodrës, malazeztë dogjën dhe persekutuan në zonën e Postribës, vranë e prenë deri edhe gra shtatzëna i shpuan me bajoneta duke u nxjerrë fëmijët e vdekur nga barku, dogjën ullinj e pemë të ndryshme, të mbjella etj. dhe internuan në Podgoricë gra, pleq, fëmijë të pafajshëm. Këtu poshtë po pasqyroj disa emra të internuar në Fushën e Piprit të Podgoricës, të cilët janë:

1. Caf Mehmet Kodra... nga fshati Domën
2. Mac Shaban Jeremija... nga fshati Domën
3. Tafë Rexh Lugu... nga fshati Domën
4. Rruk Ibrahim Mastaj... nga fshati Domën
5. Man Ali Kodra... nga fshati Domën

Shënim: Caf Mehmeti e Mac Shabani kanë vdekur nga torturat çnjerëzore të malazezëve. Të internuarit nga Postriba, pasi i vendosën në Fushë të Piprit të Podgoricës, i urdhëruan të bënin varret e veta, pasi do të dënoheshin me vdekje. Para se të ekzekutoheshin vjen vajza e Krajlit të Malit të Zi, e porositur nga Krajli, dhe i pyet: “A po mërztiteni që po hapni varret tuaja dhe cila do të ishte fjala e fundit para se të ekzekutoheni!?” Man Ali Kodra apo Tafë Rexhë Lugu, njëri nga këta të dy thotë: “Ne nuk po mërztitemi sepse jemi në besë të Zotit dhe të Krajlit. Ata mund të marrin vendim për ne si të duan. Ne u jemi dorëzuar atyre.” E bija e Krajlit shkon menjëherë tek i ati dhe i thotë mendimin që kishin paraqitur të internuarit para se t’i ekzekutonin. Krajli urdhëron menjëherë të ndalohet ekzekutimi i tyre pasi kishin rënë në besë të Zotit dhe të Krajlit. Në këtë mënyrë u shpëtoi jeta. Më lart thashë se Man Ali Kodra apo Tafë Rexhë Lugu, pasi ka pasur mendime të ndryshme nga pleqtë e fshatit Domën, ndaj dhe e lashë fakultative pasi nuk dihet e vërteta se cili prej tyre e ka thënë një fjalë të tillë. Gjithsesi njëri nga këta të dy e ka thënë një mendim të tillë para se t’i ekzekutonin. Varianti i dytë është ky: Kur u pyetën të internuarit se çfarë kishin për të thënë para se t’u këputnin kokat, Man Ali Kodra foli në emër të të gjithë të internuarve: “ Fjala e fundit e imja dhe e të gjithë të internuarve është lënë në dorë të Zotit dhe të Krajlit të Malit të Zi. Si të jetë thënë prej Zotit dhe si ta mendojë Krajli do të vendoset për jetën tonë.” Ata që do të kryenin ekzekutimin e vendimit e çuan fjalën tek Krajli dhe ai duke u mbështetur në fjalët e fundit të të internuarve vendosi dhe urdhëroi “ T’u falet jeta dhe të mos u këputet koka pasi ata më kanë vënë mua pas Zotit. Pra e meritojnë ta jetojnë jetën!” Shënim: Burimet e këtij materiali janë pleqtë e Domnit, si Ymer Kuptrija, Islam Uruçi, e të tjerë.

MARRË PJESË NË LUFTËN E KOPLIKUT

Po të nisemi për të shënuar emrat e luftëtarëve që kanë marrë pjesë në Luftën e Koplikut, del një listë shumë e gjatë, pasi nga çdo shtëpi ka marrë pjesë një luftëtar dhe nganjëherë edhe dy, ndaj nuk po i araqes të gjithë ata emra që e kalojnë shifrën e 300 luftëtarëve. Në krye të të gjithë luftëtarëve ishte komandanti popullor, Adem Haxhija (Spahija), i mbiquajtur “Luani i Luftës”. Në ndihmë të tij ishin edhe paria, krerët dhe bajraktarët e Postribës. Kjo luftë është pasqyruar në një kapitull tjetër, ndaj dhe nuk po e trajtoj më këtu.. Në Luftën e Koplikut, magazinier kaushe (armatimi) për fshatin Domën ka qenë Qerim Hasan Uruçi. Ai ka furnizuar vullnetarët në këtë luftë, me fishekë, duke ua ndarë ato me shumë ekonomi dhe i porosiste që të mos u shkonte asnjë plumb kot, por çdo plumb të ishte një armik i vrarë. Në këtë luftë kanë marrë pjesë edhe Shaban Imer Plori, Isen Mehmet Kurti (gjyshi i Ragip Sejdi Hagrepi), Rruk Brahimi, Caf Halil Kuptrija e të tjerë. Sipas Imer Selim Sykajt nga Ura e Shtrejtë, kanë marrë pjesë në Luftën e Koplikut të vitit 1920, paria e fshatit Haxhi Lic Canaj, Dervish Can Canaj, Ahmet Lic Canaj, Isuf Sylo Velija (Fikaj), Bel Ahmet Fikaj, Bajram Avdyl Ndrejaj, Haxhi Avdyl Ndrejaj, Ahmet Smajl Mehaj, Duk Tahir Mehaj, Selman Isuf Mehaj, Veli Mehmet Rammetaj, Ram Met Haspepaj, Sejdi Idriz Bibaj si dhe nga një trim për tim në të gjithë Urën e Shtrejtë. Gjithashtu, sipas plakut rreth 100 vjeçar, Riza Veli Repaj, në këtë luftë çelë Shaban Repaj tregon një trimëri të rrallë kur mbetën luftëtarët pa ujë. Ai u mbledh të gjithëve paguret e ujit dhe detyrohet të shkojë për të mbushur ujin në një zonë shumë të vështirë ku ishte dislokuar armiku. Ai nuk merr asgjë parasys, as jetën e tij vetëm që të furnizonte luftëtarët postribas me ujë. Dhe këtë e realizoi pa u dëmtuar. Sipas Caf Dervish Hykës, në vitin 1920, në Luftën e Koplikut, kanë marrë pjesë shumë burra nga fshati Vorfë i zonës së Postribës. Lufta u zhvillua në Suka të Moksetit. Lufta u drejtua nga kapiten Adem Haxhija (Spahija), komandant popullor i Postribës. Burrat e Vorfës drejtoheshin nga Idriz Tahir Hykaj, sipas Caf Hykës, por gjithnjë nën drejtimin e Adem Haxhisë si komandant i gjithë Postribës. Pjesëmarrës në këtë luftë ishin Idriz Tahiri, Jaho Sadiku, Ali Tahiri, Dac Sadiku, Smajl Delija, Selim Hysa, Ibrahim Elezi e të tjerë. Burrat e Postribës sipas Caf Hykës kanë luftuar heroikisht në këtë luftë. Përsëri sipas Caf Hykës, pas mbarimit të luftës Mbreti Zog ka thirrur për analizën e luftës të kësaj zone Adem Haxhi Spahinë, komandantin e Postribës, Idriz Tahir Hykën e Vorfës dhe

Gjelosh Gjokën e Kastratit. Postriba, sipas Caf Hykës dhe pleqve të Vorfës, ka marrë pjesë edhe në “Luftën e Deçiqit”, deri sa është ngritur flamuri shqiptar në majën e Deçiqit së bashku me hotjanë, grudjanë etj.

RËNË NË LUFTËN E KOPLIKUT

Në Luftën e Koplikut të vitit 1920, kanë mbetur të vrarë luftëtarët si më poshtë:

- 1.Selim Bajram Ulikaj... nga fshati Ura Shtrejtë
- 2.Adem Bajram Ulikaj... nga fshati Ura Shtrejtë
- 3.Haxhi Adem Ulikaj... nga fshati Ura Shtrejtë
- 4.Can Osman Cekaj... nga fshati Ura Shtrejtë
- 5.Zeqir Bejto Fikaj... nga fshati Ura Shtrejtë
- 6.Ali Meta ose Brahim Meta... nga fshati Ura Shtrejtë
- 7.Selim Rama... nga fshati Ura Shtrejtë

Sipas Hamit Brahim Repaj, nipi i Zeqir Bejto Repajt, rezulton, se gjyshi i tij, Zeqir Bejto Repaj nuk ka mbetur në Luftën e Koplikut por në Luftën për marrjen e Deçiqit në vitin 1911, i cili në luftë e sipër nën komandën e Adem Haxhisë (Spahija), vdes bashkë me shumë trima të tjerë nga Hoti, Malësia, Postriba e tjerë. E pasqyrova këtë dëshmi pasi gjithsesi askush më mirë se të afërmit e tij nuk e di gjendjen, ndaj dhe nuk e pasqyrova siç është dëshmuar se ai ka rënë në luftën e Koplikut.

PLAGOSUR NË LUFTËN E KOPLIKUT

Në këtë luftë, përveç të vrarëve, u plagosën në përpjekje e sipër shumë luftëtarë, ndër të cilët po paraqes disa:

- 1.Shaban Elez Meaj... nga fshati Ura Shtrejtë
- 2.Bejto Veli Fikaj... nga fshati Ura Shtrejtë
- 3.Zeqir Bejto Fikaj... nga fshati Ura Shtrejtë
- 4.Hasan Ahmet Sykaj... nga fshati Ura Shtrejtë
- 5.Zeqir Ahmet Sykaj... nga fshati Ura Shtrejtë
- 6.Brahim Mustaf Ahmetaj... nga fshati Ura Shtrejtë
- 7.Mehmet Osman Ahmetaj... nga fshati Ura Shtrejtë
- 8.Hysni Idriz Bibaj... nga fshati Ura Shtrejtë
- 9.Selim Ram Vulaj... nga fshati Ura Shtrejtë
10. Elez Shaban Ujka... nga fshati Domën
- 11.Isen Imer Mataj... nga fshati Shakotë
12. Adem Haxhi Spahija (dy plagë)... nga fshati Boks
- 13.Sait Hasan Ahmetaj (Sykaj)... nga fshati Ura Shtrejtë
14. Dyl Ahmet Sykaj... nga fshati Ura Shtrejtë
- 15.Asllan Bajram Ndrejaj... nga fshati Ura Shtrejtë
16. Nuro Sylaj... nga fshati Ura Shtrejtë
17. Zekë Beqiri... nga fshati Ura Shtrejtë
- 18 Halil Hasan Gjuraj... nga fshati Ura Shtrejtë

...

Shënim: Në Luftën e Koplikut të vitit 1920, në përpjekje me forcat e armikut në Suka të Moksetit, Can Osman Sykaj nga fshati Ura Shtrejtë, i kërkoi bajraktarit të Hotit, Deli Metës, që t'i printe përpara për tek mitralozi i armikut, i cili ishte vendosur në majë të Sukave të Moksetit. Në sulm e sipër, djali i bajraktarit të Hotit mbet i vrarë duke shkuar tek mitralozi, në gjysmë të shpatit, ndërsa Can Osman Sykaj mbërriti deri tek mitralozi por edhe ky mbeti i vrarë aty. Shënim: Selim Zenel Sykaj ka qenë prijësi i Urës së Shtrejtë në kohën e Adem Haxhisë, ndaj dhe drejtonin së bashku me Adem Haxhinë e prijës të tjerë të Postribës.

LUFTA PËR MBROJTJEN E PLAVËS E GUCISË

Menjëherë pasi u ngrit Shkodra për mbrojtjen e trojeve tona në Plavë e Guci të prirë (udhëhequr) nga Isuf Sokoli, pa i bërë thirrje Shkodra, u ngrit edhe Postriba në mbrojtje të trojeve të prirë (udhëhequr) nga Ali Haxhi Bajraktari dhe Adem Haxhija, të cilët u gjenden në frontin e luftës menjëherë së bashku me gjithë trimat e Postribës. Ata luftuan krah njëri-tjetrit me një trimëri të rrallë dhe mbetën të vrarë e të

plagosur disa trima nga Postriba. Një nga këta, mbeti i vrarë Zeqir Bejto Repaj i fshatit Boks. Gjithashtu mbetën të vrarë edhe nga fshati Ura e Shtrejtë, nga Domni etj., emrat e të cilëve nuk më kujtohen, thotë Fadil Emin Çelaj. Të vrarët mbetën në Deçiq pasi u çlirua Plava e Gucia nga forcat tona në mbrojtje të trojeve shqiptare.

MBROJTJA E ULQINIT DHE TIVARIT

Pasi u mor vesh se po luftohej për mbrojtjen e trojeve të Ulqinit e Tivarit, u ngrit menjëherë Postriba e udhëhequr nga bajraktari i Boksit, Ali Haxhi Bajraktari, vëllai i të cilit i quajtur Tahir Haxhi Bajraktari lufton heroikisht në mbrojtje të Ulqinit derisa vritet në luftë e sipër kundër forcave serbo - malazeze. Në këtë luftë pati disa të plagosur nga Postriba. Heroizmin e Tahir Haxhisë, populli e përjetësoi në këngën si më poshtë:

“... O Tahir, Tahir Haxhija!
A po të dhimbet bukuria?
Nuk po më dhimbet bukuria
Por po më dhimbet Shqipëria
O Tahir, o trimi i trimit!
Ç’i bane armët e florinit ?
I kam vjerrë në gem t’ullinit
Me i ba rreze gjithë Ulqinit...”

LUFTA PËR MBROJTJEN E HOTIT DHE GRUDËS

Menjëherë sapo sulmuan forcat serbo-malazeze Hotin e Grudën, thotë Fadil Emin Çelaj, këta u betuan se nuk do të lëshonin trojet pa vdekur të gjithë. Duke e parë se nuk mund ta mbanin frontin vetëm, rdhën e i kërkuan ndihmë Shkodrës. Menjëherë sapo u ngrit Shkodra, u ngrit edhe Postriba nën thirrjen dhe udhëheqjen e bajraktarëve të Drishtit, të Boksit, të Sumës dhe të komandantit popullor Adem Haxhija. Ata u gjendën menjëherë në frontin e luftës. Në fund bilanci i luftës u kurorëzua me fitoren e forcave tona, por edhe duke e paguar me gjakun e derdhur të luftëtarëve shqiptarë në përgjithësi dhe atë të Postribës në veçanti. Nga forcat e Postribës pati disa të plagosur dhe mbeti i vrarë trimi Adem Lamush Uraj, i fisit Uraj të fshatit Mes. Për këtë betejë të përgjakshme populli ngriti këngën e mrekullueshme të cilën e kemi paraqitur në kapitullin “Periudha e pushtimeve”.

RRETHIMI I SHKODRËS 1912-1913

Postriba në vitin 1912-1913 u detyrua të lëshojë shtëpi e pasuri dhe të strehohet në qytetin e Shkodrës, në rrethim me popullsinë e qytetit. Burrat rrokën armët, ato që i kishin nëpër shtëpitë e tyre dhe u nkuadruan në mbrojtje të vendit nga pushtuesit serbo-malazezë, nën drejtimin e komandantit popullor Adem Haxhija dhe të parisë së vendit. Forcat pushtuese kishin ardhur nga Mali i Zi e Serbia për të pushtuar Shkodrën. Postriba ishte e vendosur në frontin e Fushave të Myselimit dhe në Bardhanjel. Rrethimi i Shkodrës zgjati rreth shtatë muaj. Lufta u zhvillua shumë e përgjakshme mes forcave tona dhe atyre turke në njërin anë dhe të forcave serbo-malazeze në anën tjetër. Lufta arriti deri aty sa të zhvillohej bajonetë më bajonetë dhe trup më trup. Pas shumë përpjekjeve dhe gjakut të derdhur në mbrojtje të Shkodrës dhe në mungesë të bukës dhe ushqimit, thotë Fadil Emin Çelaj, Shkodra u dorëzua urre.

LUFTA E KOPLIKUT TË VITIT 1920

Posa u mor vesh se forcat serbo-malazeze kishin hyrë në Kastrat, vazhdon Fadil Emin Çelaj, u çua në këmbë e gjithë Shkodra dhe mbarë Postriba në mbrojtje të trojeve shqiptare. Trimat e Postribës të udhëhequr nga Komandanti popullor Adem Haxhija dhe bajraktarët e Drishtit, Boksit e Sumës arritën menjëherë në vijën e frontit. Postribës iu besua vendi më i vështirë, më strategjik dhe më vendimtar për fitoren e luftës. Në këtë betejë të përgjakshme pati shumë të plagosur dhe të vrarë. Këtu u plagosën Adem Haxhija, mori dy plagë, një në krah dhe një në kokë, Beqir Dan Çelaj nga fshati Dragoç mori një plagë. Gjithashtu u plagosën Shaban Elez Mehaj, Zeqir Bejto Velija (Fikaj), Zeqir Ahmeti, i cili u plagos në sy, sipas Imer Selim Sykajt. Këta ishin nga fshati Ura e Shtrejtë. Mbeti i vrarë Can Osman Cekaj nga fshati

Ura e Shtrejtë. Sipas Imer Selim Sykajt, Deli Meta i Hotit pyet se cili ishte djali nga Ura e Shtrejtë që desh të kthente Deli Metën me hotjanë kur ata ishin thyer. Can Osmani nga Ura e Shtrejtë është çuar në këmbë dhe ka thënë: “Unë jam.” Atëherë Deli Meta i ka thënë në mes të të gjitha forcave të Hotit dhe të Postribës: “çohu e hyn në luftë i pari!” Atëherë Can Osmani i është përgjigjur Deli Metës kështu: “Po të hy në luftë unë para teje, atëherë nuk i mbet më parija Hotit por i kalon Postribës, prandaj për të mos e thyer njeri-tjetrin, më qit një ortak nga ana e jote dhe prijmë së bashku”. Atëherë Deli Meta i ka dhënë ortak Pjetër Kolën e Hotit. Të dy së bashku u kanë prirë luftëtarëve të Hotit dhe të Postribës dhe kanë arritur në majë të kodrës në Përrua të Thatë, afër llogoreve dhe kanë filluar luftën. Can Osmani dhe Pjetër Kola u vranë aty nga forcat serbo-malazeze. Në Luftën e Koplikut morën pjesë edhe dy burra nga Gjirokastra, të quajtur Bajo e Çerçiz Topulli, të cilët në luftë e sipër u vranë të dy bashkë me Zeqir Bejton, Ali ose Brahim Metën dhe Selim Ramën, të tre nga Ura e Shtrejtë. Këto të dhëna janë marrë nga Imer Selim Sykaj, Ura e Shtrejtë. Lufta u kurorëzua me sukses, pasi forcat armike u nxorën nga trojet tona. Forcat e Shkodrës, të Postribës dhe të Malësisë së Madhe e detyruan pushtuesin të terhiqej përtej kufinjve tanë.

PUSHTIMI FASHIST 7 PRILL 1939

Me shtatë prill të vitit 1939, Italia Fashiste pushtoi vendin tonë. Populli i Postribës, thotë Fadil Emin Çelaj, me të marrë vesh lajmin se Italia do të sulmonte Shqipërinë, u organizua për të bërë rezistencë kundër këtij pushtimi. Krerët e Postribës posa morën vesh lajmin se vendi ishte objekt i pushtimit fashist, shkuan në bashkinë e Shkodrës për të kërkuar armë dhe municion në mbrojtje të vendit. Luftëtarët e Postribës të udhëhequr nga komandanti popullor, kapiten Adem Haxhija dhe nga krerët e tre bajrakëve, pasi morën armët pas shumë protestash zunë pozicionet e rezistencës në Kodra të Tepes, në Urën e Bahçallëkut dhe në Kodrat e Bërdicës. Forcat e ushtrisë së asaj kohe ishin të përqëndruara në Kalanë e Shkodrës dhe në Kodrat e Tepes. Aty iu bë thirrje Postribës që të bashkohej me forcat e ushtrisë dhe ashtu u bë. Rezistenca kundër forcave fashiste filloi në Bushat nga popullsia e asaj zone. Me të arritur ushtria italiane tek Ura e Bahçallëkut, filloi lufta kundër tyre nga forcat e Postribës bashkë me ato të ushtrisë. Ura e Bahçallëkut iu besua Postribës. Pushka e parë u nis nga Cen Ademi i Boksit, i cili mbante mitraloz. Këtu u vranë një oficer dhe disa ushtarë italianë. Ushtria dhe Postriba rezistoi deri sa erdhi urdhri nga Tirana për tërheqje sepse Shqipëria ishte pushtuar. Në bisedën që kam bërë shumë vite më parë me Osman Haxhinë, vëllain e Adem Haxhisë, ai tregonte se ushtria e udhëhequr nga kapiten Ndrec Prela, jo vetëm që nuk ka zbratur asnjë pushkë, por ai gati sa nuk u vra me Adem Haxhinë sepse kërkonte të lirohen pozicionet e luftës, pasi kishte përfunduar çdo gjë sipas tij. Këtë ma ka thënë edhe Ymer Muho Spahija (baba im), të cilit ia kishte treguar ngjarjen vetë Adem Haxhija, pas pushtimit fashist, (shënimi është i imi, R. S). Pasi Italia pushtoi Shqipërinë, arrestoi dhe internoi Adem Haxhinë dhe Imer Beqirin në Kolfiorito të Italisë, ndërsa Manush Caf Uraj u internua në Lushnje. Këta u internuan për rezistencën që i bënë pushtimit fashist, si oficerë rezervë të mbretit Zog.

KRYENGRITJA ANTIKOMUNISTE

E 9 SHTATORIT TË VITIT 1946

Pasi u çlirua vendi nga pushtuesit e huaj në vitin 1944, forcat nacionaliste të ndershme që morën pjesë në çlirimin e vendit, e panë se ishin zhgënjyer dhe se në Shqipëri po vinte një regjim i egër komunist. Kjo shihej nga reformat drastike që ata përdornin. Duke qenë të revoltuar nga një zhgënjim i tillë, forcat nacionaliste me drejtuesit e tyre në krye filluan të organizoheshin për përmbysjen e regjimit komunist. Në Postribë si drejtues kryesor të kësaj kryengritje të armatosur antikomuniste ishin Osman Haxhi Spahija nga fshati Boks, Emin Zyber çelaj, Selim Rac çelaj dhe Smajl Dul Halilaj nga fshati Dragoç, Avdullah Sahit Bushaj dhe Jakup Dan Bajraktari nga fshati Kullaj, etj. Disa ditë para se të organizohej kryengritja antikomuniste u bë një mbledhje në qytetin e Shkodrës, në shtëpinë e Qaziim Rrojit me pjesëmarrjen e krerëve të Postribës të lartpërmendur dhe të disa krerëve nga qyteti i Shkodrës. Në përfundim të mbledhjes u vendos që kryengritja të kryhej në një kohë të përshtatshme, pa përcaktuar datë. Pas kësaj mbledhjeje filloi veprimtaria e organizimit duke ia besuar familjeve me influencë në Postribë. Pas kësaj u ra dakord me krerët e çdo fshati të Postribës që të organizohej një mbledhje në fshatin Boks, në vendin e

quajtur “Shegat e Ibre”. Në këtë mbledhje në “Shegat e Ibre” morën pjesë krerët e çdo fshati. Kështu nga Drishti morën pjesë Myrto Dan Muhaj dhe Ali Brahim Muhaj, nga fshati Mes-Myselim Myrto Manush Hysaj dhe Muho Dyl Alijaj, nga fshati Domën Imer Adem Milani, nga Boksi Osman Haxhi Spahija, Beshir Brahim Shabaj, Bajram Cuf Bibaj e Beqir Rexhep Repaj, nga fshati Kullaj Jakup Dan Bajraktari e Avdullah Sahit Bushaj, nga fshati Rrash-Vorfë Idriz Tahir Hykaj dhe Haxhi Tahir Jukaj, nga Dragoçi Emin Zyber Çelaj, Hajdar Taf Halilaj, Selim Rac Çelaj, Dervish Nuz Halilaj, Smajl Dul Halilaj e Musa Muho Spahija. Në këtë mbledhje u vendos data e kryengritjes, pikërisht më 9 shtator 1946 dhe u caktuan korierët: për në Gur të Zi korier Hysen Velush çelaj, për në zonën e Koplikut korier Kasem Ragip Shkreli, për në qytet korier Bajram Cuf Bibaj, për të çuar vendimin tek Abdullah Kazazi dhe për të çuar vendimin tek Qazim Rroji korier Zejnun Rac Çelaj. Korierët u nisën që në mëngjes për të lajmëruar datën e kryengritjes, që do të organizohej që atë natë. Kurse në drekë nga ora 15, 00 kanë çuar Fadil Emin çelën tek Qazim Rroji për të marrë fjalën nëse ishin në dijeni për kryengritjen dhe a ishte gati qyteti për të filluar kryengritjen. Ai solli konfirmimin se qyteti ishte në dijeni dhe ishte gati të fillonte kryengritjen në orën e caktuar. Vendi i grumbullimit të të gjitha forcave kryengritëse u la në Fushën e Shtojit në ora 12, 00 të natës. Për kryengritjen u lajmëruan edhe disa persona nga Hoti i Ri, si Pjetër Gjokë Luli, Zef Leka, Gjelosh Vata, etj. Rreth orës 12, 00 të natës së 9 shtatorit 1946 të gjitha forcat kryengritëse u gjenden në Fushën e Shtojit, ku u caktuan edhe detyrat përkatëse të çdo grupi, si thyerja e burgut, prishja e linjave telefonike dhe pjesa kryesore në drejtim të kazermave të ushtrisë. Duhet të themi se burrat e Hotit të Ri që u përmendën më lart morën pjesë krahe për krahe me burrat e Postribës. Në luftim e sipër u vra Elez Baz Bajraktari nga Kullajt, Nuz Salo Shkreli nga Boksi, u plagos rëndë Osman Hysen Hasaj nga Boksi që u kap i gjallë nga forcat e ushtrisë, të cilët e lidhën pas makine rrëshqanë, dhe kur e sollën tek Ura e Mesit, e pushkatuan. Po në këtë ditë u kapën të gjallë nga forcat e ushtrisë dhe u pushkatuan Ymer Zenel Bajraktari nga Kullajt, Qazim Rroji nga Shkodra, Metush Ali Cekaj nga Kullajt, Bajram Daut Bushaj nga Kullajt, Rexhep Idriz Bushaj nga Kullajt, Reshit Beqir Bushaj nga Kullajt, vëllai i Musli Gjetos nga Myselimi etj. Po atë ditë forcat e ushtrisë në mësymje e sipër kaluan në fshatrat e Postribës duke djegur shtëpi dhe duke pushkatuar. Kështu pushkatuan Hysen Velush çelaj nga Dragoçi, Sahit Dul Bushaj nga Kullajt, i cili hapi zjarr kundër tyre dhe pasi u plagos, e kapën të gjallë dhe e pushkatuan. Me urdhër të Zoi Themelit u dogjën shtëpitë si më poshtë: në Dragoç shtëpia e Hajdar Tafë Halilaj, Smajl Dul Halilaj dhe e Dervish Nuz Halilaj. Prishën një pjesë të shtëpisë së Emin Zyber çelajt për ta djegur, por nuk e dogjën pasi rrezikoheshin të digjeshin edhe disa shtëpi të tjera bashkë me të. Dëshën të digjin edhe shtëpinë e Selim Rac çelës por nuk arritën ta digjin sepse erdhi urdhri për të ndaluar djegien e shtëpive të tjera. Në Kullaj dogjën shtëpinë e Fetah çelë Bushajt, të Isa Nuz Bushajt dhe të Jakup Dan Bajraktarit. Në Boks dogjën shtëpinë e Zyber Caf Bajraktarit, të Baz Sylejman Shabajt, një pjesë të shtëpisë së Osman Haxhi Spahisë dhe të Halit Met Hasajt. Po atë ditë u pushkatuan Ymer Beqir Shabaj nga Fshati Boks, Idriz Ibro Cekaj, Halit Met Hasaj dhe Ymer Zeqir Repaj, i cili u la si i pushkatuar, por ashtu i plagosur me 15-20 plumba shkoi në shtëpi natën dhe familja e dërgoi në spital dhe jetoi edhe disa vjet pas kryengritjes. E shoqja e Osman Hysenit, Rruka dhe e bija, Zyka shkuan për ta marrë kufomën për ta varrosur, por nuk i lejuan, dhe po aty sikur ishte, e varrosën në vend. Pjesëtarët e familjes vendosën shenjat e varrimit dhe në vitin 1995 u krye zhvarrosja nga pjesëtarët e familjes dhe kockat e tij i çuan në varreza të fshatit Boks. Sipas Caf Dervish Hykës, Vorfa, si të gjitha fshatrat e Postribës, të zonës fushore dhe pjesërisht të asaj kodrinore, mori pjesë në Kryengritjen Antikomuniste të 9 shtatorit të vitit 1946, nën drejtimin e Idriz Tahir Hykës. Postriba nën drejtimin e Osman Haxhi Spahisë i bën thirrje ashtu si fshatrave të tjera edhe fshatit Rrash-Vorfë për të marrë pjesë në kryengritje dhe kësaj thirrje i përgjigjet pozitivisht Idriz Tahiri me burrat e Rrash-Vorfës. Në këtë kryengritje morën pjesë burrat nga Rrash-Vorfa: Idriz Tahir Hyka, Dervish Idrizi, Dul Idrizi, Malo Mustava, Haxhi Tahir Jukaj, Elez Haxhija, Dac Sadiku, e të tjerë, të cilët u torturuan barbarisht nga Zoi Themeli me oficerë të tjerë të sigurimit të asaj kohe. Gjithashtu, këta burra u dënuan edhe me heqje lirie, duke vuajtur dënimin nëpër burgje të terrorit komunist. Pjesëmarrësve iu dogjën shtëpitë, iu konfiskua pasuria dhe për rreth 50 vjet të regjimit komunist, burrat e Rrash-Vorfës ashtu si edhe ata të Postribës në përgjithësi u trajtuan si të dekluar, si armiq të Partisë e të popullit duke zhvilluar një luftë të egër klasore ndaj tyre. Ata e vuajtën bashkë me familjet e tyre duke i nëpërkëmbur, duke i denatyalizur, duke i demaskuar, internuar etj. Sipas të dhënave që na vinë nga Gëzim Bejto Guri dhe të miratuara edhe nga kryeplaku i fshatit Domën, Bajram Milani, Sylo Turk Guri ka marrë pjesë në Kryengritjen Antikomuniste të 9 shtatorit të vitit 1946 dhe është dënuar me 20 vjet burg nga regjimi komunist, si dhe i është djegur shtëpia dhe

gjëja e gjallë. Po kush ishte Sylo Turku?! Sylo Turku është nga fshati Domën i Postribës. Ai rrjedh nga një familje me tradita të mira patriotike të fisit Guraj, një nga fiset e mira të fshatit Domën. Ai u lind në vitin 1909 në fshatin Domën dhe vdiq në vitin 1985 po në fshatin Domën. Ai ishte një besimtar i mirë dhe si i tillë ai ishte një antikomunist i vendosur, ndaj dhe në vitin 1946 mori pjesë me armë në dorë në përmbyshjen e regjimit komunist, për të cilën pjesëmarrje dhe u dënua si më lart. Ai u rreshtua në front me shumë domnorë të tjerë si Rexhep Hajdar Milani, Imer Zenel Guri, Bel Shabani e të tjerë. Sylo Turk Guri njihet nga të gjithë domnorët si një burrë me vlera, mikpritës, i besës, fisnik, i respektuar në jetë e shoqëri, ndaj dhe e meritonte të thuheshin dy fjalë për këtë burrë nacionalist dhe antikomunist, për këtë burrë që nderohet nga të gjithë ata burra që e kanë njohur.

OFICERËT E POSTRIBËS TË GRADUAR NË PERIUdhËN E MBRETËRISË, NJË ENIGMË

Problemi i gradimit të oficerëve të mbretërisë në Postribë është problemi më delikat që do të trajtohet në këtë material. Them që në fillim se është problemi më delikat, pasi asnjëri nga burrat e Postribës që më sollën emrat e njerëzve të tyre të graduar nga Mbreti Zog, nuk flisnin të bazuar në dokumente shtetërore për gradimin e tyre. Unë jam i sigurt se jo të gjithë janë graduar me gradën “kapiten” nga mbreti Zog, por sipas aktivitetit patriotik që kanë kryer, sipas shkallës së trimërisë, sipas aftësisë drejtuese dhe organizuese, kanë marrë edhe gradën “kapiten”, “toger”, “nëntoger” dhe “aspirant”. Kam përpara një listë të shënuar me emrat e oficerëve që janë graduar nga mbreti në periudhën e mbretërisë, të cilën po e paraqes si më poshtë:

1. Adem Haxhi Spahija fshati Boks
2. Avdi Halil Dushaj fshati Drisht
3. Hajdar Dan Curraj fshati Drisht
4. Imer Beqir Shabaj fshati Boks
5. Jakup Dan Bajraktari fshati Kullaj
6. Manush Caf Uraj fshati Mes
7. Mehmet Isen Bracaj fshati Domën
8. Met Manush Hysaj fshati Myselim
9. Osman Haxhi Spahija fshati Boks
10. Rexhep Hajdar Milani fshati Domën
11. Sait Isen Hysaj fshati Myselim
12. Çelë Murat Shabaj fshati Boks.

(Të më falin postribasit në qoftë se ka qenë edhe ndonjë oficer tjetër që unë nuk kam informacion, dhe për këtë arsye ka mbetur pa u përfshirë në këtë listë, shënimi im R. S.). Këtë listë ia paraqita Oborrit bretëror para katër vjetësh, nëpërmjet një personi shumë të sigurt, i cili do të më kthente përgjigjen me listën e plotë të personave të mësipërm si dhe me gradën që ka dhënë mbreti Zog për secilin prej tyre dhe mundësisht të shoqëruar edhe me një motivacion ku do të shënohej grada, motivacioni dhe data kur është dhënë. Pas disa kohësh e mora përgjigjen si më poshtë: “Arkivi i mbretit Zog ndodhet i bllokuar në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe, ndaj dhe nuk mund të merret asnjë e dhënë deri me çbllokimin e këtij arkivi nga mbretëria”. Ne sot nuk mund të dimë me të dhëna të sakta se kush ka qenë i graduar me gradën e kapitenit, kush me gradën e togerit, nëntogerit apo aspirantit. Nga përshkrimi i jetës dhe i veprimtarisë patriotike të Adem Haxhisë rezulton si më poshtë:

“Në vitin 1928 për merita të shquara drejtuese dhe organizative si komandant popullor i luftëtarëve të lirisë në mbrojtje të tërësisë tokësore dhe të pavarësisë kombëtare, Naltmadhnia Zogu i Parë, e gradon Adem Haxhinë me gradën ushtarake “Kapiten” në rezervë, i pajisur me të gjitha atributet e kapitenit të karrierës.” Sigurisht që në këtë periudhë u gradua edhe Imer Beqiri bashkë me Adem Haxhinë, ndoshta edhe burra të tjerë nga Postriba, por unë nuk kam informacion të saktë shtetëror për gradimin e tyre. Unë nuk kam të dhëna se në cilin vit u graduan burrat e tjerë të Postribës, për cilin aktivitet ushtarak apo për cilën trimëri ata morën gradën e oficerit. Unë i nderoj dhe i respektoj të gjithë ata burra të Postribës që udhëhoqën luftëtarët e saj në të gjitha luftërat që u zhvilluan në mbrojtje të atdheut. Nuk ka rëndësi se me çfarë grade u graduan nga mbreti Zog. Por rëndësi ka se këta burra nacionalistë të vendosur dhe patriotë të shquar, lindën nga fiset më të mira të Postribës dhe luftuan me trimëri të rrallë duke flijuar

edhe jetën për këto troje, për këtë vend. Unë mendoj se mbreti Zog ka graduar oficerë burrat e Postribës në mbështetje të disa kriterëve bazë, si për veprimtari partiotike të secilit luftëtar, për aftësi drejtuese dhe organizative, për guxim dhe trimëri në mbrojtje të trojeve, në mbrojtje të lirisë dhe të pavarësisë së atdheut. Në bisedën që kam bërë me Beqir Haxhi Spahinë, në lidhje me gjyshin e tij Adem Haxhija, ai më tregoi një episod kur Mbreti Zog kishte mbledhur të gjithë krerët, parinë dhe komandantët e vendit për të vendosur se çfarë duhet të bëhet në lidhje me sigurinë kombëtare. Adem Haxhija shkon pak me vonesë dhe kur e sheh Mbreti e thërret duke i liruuar një vend aty pranë tij: “ Hajde Adem Aga se e ke vendin këtu!” dhe e ul pranë vetes. Pra Mbreti Zog e ka dashur dhe e ka respektuar Adem Haxhinë. Për këtë më kanë folur shumë të moshuar si Osman Haxhija, Man Alush Gruda, Shaban Adem Spahija, Adem Ibro Cekaj, Selim Rac çelaj, e të tjerë. Gjithsesi unë mendoj se të gjithë këta burra fisnikë të fiseve më të mira në Postribë kanë pasur lidhje dhe miqësi me Mbretin Zog pasi në gjakun e tyre vlonte ndjenja kombëtare, vlonte nacionalizmi dhe patriotizmi i flaktë.

Adem Haxhija mori 9 plagë në luftë, në mbrojtje të lirisë dhe pavarësisë së atdheut dhe plaga e dhjetë ishte helmimi fashist në Kolfiorito të Italisë në vitet 1939- 1940. Dy plagë njëheri i mori në “Luftën e Koplikut”, gjë e vërtetuar kjo nga historiani Xhevat Repishti si më poshtë: “Adem Haxhija mori dy plagë, por nuk e ndali luftën as udhëheqjen e luftëtarëve në vijën e frontit. “Bashkëkohësit dhe bashkëluftëtarët e cilësuan “Luani i Luftës”. Në dokumentacionin e kohës lexojmë se gratë shkodrane zgjodhën një përfaqësi për ta vizituar Adem Haxhinë e plagosur në shenjë nderimi për trimërinë e tij.” (Xhevat Repishti; “Me plagë në trup nga lufta në luftë”, Jeta e Re, 24 gusht 1985). Nga këto që shtrova më sipër del qartë si rrezja e diellit se Adem Haxhija me dhjetë plagë në trup nga lufta në luftë u vlerësua nga koha dhe regjimet si një nacionalist i madh dhe komandant popullor me aftësi të larta drejtuese dhe organizative. Adem Haxhija dhe Imer Beqiri u internuan në Kolfiorito të Italisë për veprimtari patriotike, për kundërshtimin që i bënë pushtimit fashist më 7 prill të vitit 1939. Por duhet ta dimë se nuk u internuan të tjerë në Itali përveç këtyre dy patriotëve dhe nacionalistëve më të mëdhenj të Postribës. Si mund të dalë dikush tjetër sot e të thotë se në pushtimin fashist më 7 prill 1939 ishim më të rëndësishëm se Adem Haxhija apo Imer Beqiri? Po të ishin të tillë do të ishin ata që do të ishin internuar atje dhe jo këta dy burra nacionalistë të vërtetë dhe patriotë të shquar. Trimëria pas luftës nuk ka vlera. Trimëria ka kohën e vet, ndaj atëherë trimi duhet ta thotë fjalën e vet, jo pas kohe, atëherë kur lufta ka mbaruar. Ka pasur edhe burra të tjerë që janë internuar për rezistencën që i kanë bërë pushtimit fashist, por sipas shkallës së rezistencës dhe emrit të tyre është bërë edhe internimi. Kështu, për shembull, Manush Caf Uraj nga fshati Mes u internua në Lushnje. Postriba e di mirë se kush është internuar, se kush është dënua me heqje lirie, kush është flijuar në mbrojtje të trojeve. Vërtetë Adem Haxhija dhe Imer Beqiri u internuan në Kolfiorito të Perixhias në Itali, por helmimi iu bë vetëm Adem Haxhisë e jo Imer Beqirit, sepse ky ishte shumë i rrezikshëm për pushtuesit italianë. Ai nuk pranoi që të nënshkruante për të qenë në shërbim të fashizmit. Me këtë nuk dua të akuzoj Imer Beqirin pasi ai ishte një nacionalist i madh si Adem Haxhija, por dua të them se **Adem Haxhija ishte simboli i Postribës dhe si simbol që ishte, duhej zhdukur nga pushtuesi për të mos qenë pengesë për të. Halil Isuf Dushaj si nacionalist çfarë mund të bënte më tepër për atdheun, vetëm se të flijonte jetën e tij, të derdhte gjakun për vatan në luftën e Bardhanjelit në vitin 1912 ?! çfarë mund të bënte tjetër Sait Dul Bushaj kundër komunizmit vetëm se të luftonte kundër regjimit deri sa t'i bllokohej pushka dhe të flijonte jetën në mbrojtje të popullit të tij?! çfarë mund të bënte tjetër Imer Beqir Shabaj kur e arrestojnë në Kodër Boks dhe kur i kërkojnë fjalën e fundit, para se të pushkatohej nga skuadra e pushkatimit, veç të thoshte: “Më lejoni të marr abdes që të vdes i pastër si mysliman”!? çfarë mund të bënte tjetër Adem Haxhija veç të kundërshtonte fashizmin edhe atje në tokën e tij, në Itali, deri sa të flijonte jetën e tij me helmim fashist!? Ishin këta nacionalistë dhe patriotë të shquar, oficerë ose jo oficerë, të cilët shkruan me gjakun e tyre faqe të lavdishme të historisë së popullit tonë, ndaj dhe Postriba u nderua nga Presidenti i Republikës me urdhrin më të lartë: “Nderi i Kombit”. Për merita të shquara patriotike Adem Haxhija dekorohet nga Kuvendi Popullor me urdhrin: “Për veprimtari patriotike të klasit të parë” me motivacionin: “Si luftëtar i shquar e komandant popullor ka treguar trimëri të rrallë në mbrojtjen e Shkodrës 1912-1913 kundër shovinistëve serbo-malazezë dhe për mbrojtjen e tërësisë tokësore e pavarësisë kombëtare.”**

Meqenëse ishte simboli i Postribës, Adem Haxhija dekorohet nga Kuvendi Popullor, por duhet të dini se ai u dekorua në periudhën e regjimit komunist, në atë kohë kur regjimi ishte duke u degraduar. Ishte

një periudhë kur kërkohet nga Partia e Punës të zbuloheshin nacionalistët e vërtetë, sepse kështu e kërkonte koha atëherë që udhëheqja e Partisë së Punës kishte shpallë armiq jo vetëm Jugosllavinë, por edhe Bashkimin Sovjetik e Traktatin e Varshavës. Në këtë periudhë Partia u dha udhëzim historianëve që të zbulonin të gjithë ata patriotë dhe luftëtarë që kishin luftuar dhe sakrifikuar edhe jetën në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe të ruajtjes së integritetit tokësor. Historianë të njohur si Xhevat Repishti, Ahmet Bushati, Uran Butka, Hamdi Bushati e të tjerë i hynë punës për të studiuar historinë e vërtetë të popullit tonë dhe si rezultat i një studimi disa vjeçar arritën të pasqyrojnë vlerat e vërteta të nacionalistëve, të komandantëve të tyre, të burrave të përmendur të kohës dhe të luftëtarëve në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe të kombit. Në këtë mënyrë dolën vlerat e vërteta të Adem Haxhisë dhe të luftëtarëve të tjerë posttribas nga Ura e Shtretjtë, Drishti, Boksi, Dragoçi, Domni, Mesi, Myselimi e të tjerë. Adem Haxhija dhe fisi i tij në regjimin komunist luftoheshin si të deklasuar. Komunistët në Postribë i cilësonin njerëzit e fisit të Adem Haxhisë si nipat ose bijtë e kapidanit. Adem Haxhija në regjimin komunist luftohej si kapiten i Zogut, si një përfaqësues i atij regjimi, i cili më 7 prill të vitit 1939 kishte ikur nga atdheu. Adem Haxhija urrehej aq shumë nga komunistët në Postribë sa që me rastin e një ballafaqimi të karakteristikës së autorit të këtij libri në organizatën e partisë së fshatit Dragoç, kishin shpifur në karakteristikë ndaj Adem Haxhisë, që megjithëse i vdekur në vitin 1940, ata e kishin ngjallur nga varri dhe e kishin futur në Kryengritjen Antikomuniste të 9 shtatorit dhe e kishin dënuar me burgim të përjetshëm. Ky veprim i organizatës dhe i komunistëve ishte i qëllimshëm për të zhvlerësuar figurën e Adem Haxhisë si një patriot i madh. Kjo ishte urrejtja komuniste ndaj nacionalistëve të vërtetë. Deri këtu arrinte urrejtja komuniste ndaj një nacionalisti të tillë, siç ishte Adem Haxhija. Regjimi i Enver Hoxhës ia kishte ndaluar me ligj kthimin e Ahmet Zogut në atdhe vetëm për të garantuar jetëgjatësinë e tij si një mbret diktatorial. Adem Haxhija, pra ishte kapiten i atij regjimi dhe si i tillë duhej denigruar edhe ky dhe fisi i tij. Në të gjithë fisin Spahijaj nuk kishte asnjë komunist, sepse artia në pushtet nuk lejonte pranime në parti nga ky fis i madh me pikëpamje zogiste Fisi trajtohej si fisi i lasuar, si armiq të partisë dhe të shtetit në fuqi. Partia nuk lejonte që nga fiset e mëdha dhe me tradita nacionaliste të futeshin në parti. Kështu nuk lejoi as nga fisi Shabaj, që ishin një fis i madh dhe nacionalist me përjashtim të shtëpisë së Baz Sylejmanit, të cilët u futën në parti, bile me shumë shkathtësi arritën të merrnin edhe vendet kryesore në parti, deri edhe anëtarë byroje në komitetin e partisë së rrethit Shkodër.

Është interesant fakti se shtëpia e Baz Sylejmanit kishte marrë pjesë në kryengritjen antikomuniste të 9 shtatorit, bile Baz Sylejmanit iu dogj shtëpia për pjesëmarrje në këtë kryengritje. Në këtë shtëpi u dënuan me burg Daut Bazi dhe Baz Sylejmani. Këtu poshtë po jap një material nga historia e kësaj kryengritje: “Në pasditen e 8 shtatorit 1946 në Kodër Boks, pranë fushës së vjetër të aeroplanëve te Kratuli i Bajram Rexhepit-krerët e Postribës Osman Haxhija, Abaz Sulejmani, Zyber Cafi, Kasem Ragipi nga Boksi,... “ Me një fjalë morën pjesë në këtë kryengritje Baz Sylejmani, kryefamiljari i kësaj shtëpie si dhe Kasem Ragipi, të dy nga Boksi. Format që ndoqën për t’u bërë njerëz besnikë të partisë dhe për të aderuar më vonë në rradhët e saj mund t’i dinë vetëm ata që u pranuan në parti nga kjo familje. Një veprim i tillë mund të jetë aftësi e rrallë e njerëzve që dinë për t’iu përshtatur çdo regjimi dhe kjo është zotësi, sepse është bijtesë njerëzore.

PERIUDHA E PUSHTIMEVE PUSHTIMI TURK 1389

Pas pushtimit të Kosovës më 1389, Turku shkoi duke e zgjeruar sundimin e vet në Shqipëri. Balshajt humbën Kosturin, Beratin, Drishtin e Shkodrën, por dy qytetet e fundit (Drishti e Shkodra), u qenë kthyer Balshajve nëpër ndërmjetësinë e një gruaje, gjakut e gjinisë së tyre, e cila gjendej në harem të Sulltanit (Gelcich, v.e ç.). Para një rreziku të tillë, princat shqiptarë duke mos ditur se kujt duhet t’i mbështeteshin, për të mos mbaruar me të egër e të butë, njëri pas tjetrit, u bënë tributarë të Sulltanit... Në dhjetor 1395 doktori në teologji fra. Nikollë de Samaxiis prej Shkodre paraqitet si legat vetë i treti tek Senati i Venedikut duke i dhuruar prej anës së Gjergjit II Strashimirov Balsha, Shkodrën e Drishtin me rrethe (është fjala edhe për Postribën, shënimi im, R.S), të cilat s’kishte shumë kohë që i kishin shpëtuar kthetrave të turkut. Këtë hap e bënte Gjergji për të pasur shpinën të nxehtë prej Turkut e për të sulmuar rivalin e vet Radoç Crnoeviç, zotin e Zetës. Traktativat vijuan dhe më 14 prill 1396 Venediku pranoi dorëzimin e Drishtit e të Shkodrës me rrethe, duke u zotëruar për t’i dhënë shpërbllim Gjergjit II Strashimirov Balshës, nga njëmijë

dukate në vit (Gelicich, v. c. f. 185). Por megjithëkëtë, Turku nuk i pushoi kurshimet e veta. Nga mbarimi i vitit 1400 e në fillim të vitit 1401, shtëpitë në rrethe të Shkodrës e të Drishtit ishin bërë fare hi e pluhur prej urdive turke.. Kjo ngjarje kishte qitë në mendim Senatit e Republikës së Venedikut, sidomos pse dihej se Kolë Zaharija, zot i Shatit e i Dejës, jo veç se kishte lënë rrugën çelë me ardhë e me i ra Shkodrës e Drishtit, por se edhe kishte pasë marrë pjesë ai vetë... Elena, vejusha e Gjergjit II Strashimirov Balsha, bijë e Lazrit, mbretit të Serbisë, duke mos mundur të bëjë askënd për vete, lypi ndihmën e Turkut për t'i marrë Shkodrën e Drishtin Venedikut. Populli i këtyre dy qyteteve që kishte bjerrë simpatinë për Balshaj u mbajti me Venedik, por megjithëkëtë ushtria tepër e madhe armike i vuri përpara, e pas fillimit të janarit 1405 qyteti i Shkodrës e fusha e Drishtit ishin në dorë të tyre.. Ushtria veneto- shqiptare e ngujuar për qendresë në Kështjellën Rozafat lypte ndihmë. Republika e Venedikut bëri çmos për t'i shpëtuar ato dy qytete. Qyteti i Shkodrës nga mbarimi i të njëjtit vit u mor rishtazi prej ushtrive ngadhënjese të Venedikut...Senati i Venedikut i jepte urdhër Kontit të Shkodrës të merrte me të mirë popullin e atij krahu (krahine), e françeskanin (fra. Françesku prej Shkodrës), që qe shkaku të merrej rishtazi Shkodra i qe propozuar Papës për ipeshkv të Drishtit. (Thallosy, f. 240, n.776 e n. 781-782)... Kryepeshkvi i Tivarit së bashku me Pal Engjëllin, ipeshkvin e Drishtit e me Arjanitin, pajtuan më 25 shtator 1452, Skënderbeun me Princat e Dukagjinit (Fan Noli, "Historia e Skënderbeut", Boston, 1921, f. 194). Në verë të vitit 1478, pas pushtimit të Krujës nga Turku, u pushtuan edhe Lezha, Zhabjaku e Drishti. Shkodra e rrethuar për pesëmbëdhjetë muaj, më 25 janar 1479, pas një mbrojtjeje kreshnike, kapitulloi me konditë të dalë lirisht me armë e plaçka. Sulltan Mehmeti II nuk mundi t'i prente në besë si krutanët pse komandanti venecian Antonio de Lezze, mori disa vetë peng besnikët e Sulltanit, e mandej liroi Rozafatin. Pasi ranë në dorë të Turkut edhe këto qytete, Turku e shtroi Shqipërinë, por jo shqiptarët, pse princat e bujarët shqiptarë u prinë mijëra familjeve që s'donin zgjedhën turke, ndër vende të huaja, e populli tjetër u shpërnda maleve të vendit të vet. Prej këtyre të mërguarve u përbënë koloni shqiptare në Kalabri e Siçili. ("Hylli i Dritës", viti 1940, "Pushtimi Turk 1389", f. 580-587).

POSTRIBA NË KRYENGRITJET ANTITURKE TË SHEKULLIT XIX

Në studimin "Shkodra dhe kryengritjet e tjera shqiptare në vitet '30 të shekullit XIX", të shkruar nga Prof. Dr. PetrikaThengjilli dhe të paraqitura në "Shkodra në Shekuj", vëll. I, në mes të tjerave thuhet: "...Në vitet 1833-1835 Shkodra u bë vatra kryesore kryengritëse që për dy vjet nuk lejoi zbatimin e reformave centralizuese... Popullsia e armatosur me armë zjarri, (nga qyteti i Shkodrës, nga Postriba, Malësia e Madhe, Dukagjini etj., shënimi është i imi, R. S), thotë prof. Petrika Thengjilli, u bë mbështetja kryesore dhe bërthama e njësisve dhe e reparteve luftarake. Në krye të çetave u vunë komandantë me aftësi ushtarake të sprovuara si Haxhi Idriz Boksi, Dasho Shkreli etj. Kryengritësit pretendonin për pavarësi të plotë ose për formimin e një shteti të formës së Serbisë. Ata synonin për një vetëqeverisje..Si rezultat i presionit të vazhdueshëm, Sanxhaku i Shkodrës, si një krahinë tjetër shqiptare, u përjashtua nga zbatimi i reformave të Tanzimatit deri në vitet '50. Kjo krahinë duke përfshirë edhe Postribën, qeverisej sipas sistemit të vjetër administrativ, ku popullata nuk jepte nizamë dhe nuk shlyente taksat në vendet ku ishte zbatuar Tanzimatit". (Prof. Petrika Thengjilli, "Shkodra në Shekuj", vëll. I, f. 27-29). Nga këto fshatra është edhe Rrashi i Postribës, i cili shtrihet në veri të rrugës që shkon për Podgoricë dhe vërtetohet se është rebeluar ndaj Sulltanit. Kjo vërtetohet se Postriba qysh në shekullin XVII (viti 1614) fillon pakënaqësitë ndaj sundimit turk dhe në këtë mënyrë ajo fillon të organizohet në kryengritje antiosmane (shënimi im, R. S.). Në mbarim të shekullit XIX, A. Degrand (konsull francez në Shkodër) shkruan: "Shkodra me rrethe (këtu përfshihet edhe Postriba, shënimi im, R. S) ka 40.000 myslimanë të armatosur, ndër ta nuk kalojnë numrin 12.000 katolikët". Shkodra me rrethina ka kaluar disa vështirësi në vitet 1800-1900. Kështu...në vitin 1819 pllakosi sëmundja e murtajës, e cila solli vdekje masive të popullsisë. Gjithashtu edhe sëmundja e malarjes e vitit 1860 i kushtoi shumë Shkodrës me rrethina, duke përfshirë këtu edhe zonën e Postribës. Pleqtë e Postribës i kanë sjellë të freskëta deri tek ne këto ngjarje të hidhura të asaj periudhe të paharruar. Në vitin 1905 ndodhi një ngjarje tjetër e hidhur për Postribën dhe Shkodrën. Tërmeti i këtij viti shkatërroi shumicën e banesave të lagjeve përreth kështjellës (gjithashtu rrënoi edhe shumë shtëpi në fshatrat e Postribës, shënimi im, R. S.). Këtë shkatërrim na e sollën pleqtë e Postribës nëpërmjet kujtimeve të tyre të atyre viteve të tmerrshme. ("Shkodra dhe motet" f. 44) Në studimin:"Toleranca fetare në Shkodër në

kryengritje të viteve '30 të shekullit XIX", Prof. Dr. Petrika Thengjilli thotë: "Mehmet Pashë Plaku, me të ardhur në pushtet, zbatoi politikën e tolerances fetare për katolikët, duke marrë nën mbrojtje klerin dhe veprimtarinë e tij... Ai nënshkroi një marrëveshje me malësorët...Ai u njohu malësive privilegjin e vetëqeverisjes, duke marrë në shërbim ushtarak sa më shumë malësorë, që u bënë forca ushake më e rëndësishme e sanxhakut të Shkodrës. Toleranca fetare u çelikos edhe më shumë gjatë qeverisjes së Karamahmut Pashës..." (Prof. dr. Petrika Thengjilli, "Shkodra në Shekuj", seminari tretë, vëllimi parë, f. 89). Në këto kryengritje merrnin pjesë përveç Shkodrës edhe malësitë e saj, si Postriba, Malësia e Madhe, Dukagjini, Shllaku, Puka, Mirdita etj.. Kryengritja shtrihej nga Shkodra dhe përfundonte në çamëri, gjë që tregonte se ndasia fetare nuk ishte pengesë në lëvizjen kryengritëse të kohës. Përpara qëndresës së kryengritësve, Sulltani pranoi kërkesën e kryengritësve shkodranë (qytetarë dhe malësorë të sanxhakut të Shkodrës, duke përfshirë, sigurisht edhe malësorët e Postribës, shënimi im, R. S), për largimin e Ali Namik Pashës, pezullimin e përkohshëm të reformave dhe shpërbllimin për dëmet gjatë luftës. Largimi i vezirit ishte frut i bashkimit të shkodranëve pa dallim feje...(Prof. dr. Petrika Thengjilli, "Shkodra ne Shekuj", sem. tretë, vëll. parë). ***Bashkëpunimi mysliman-kristian u ngrit në një shkallë të lartë në kryengritjen e vitit 1835.*** Qeveritari i ri, Hafëz Pasha kishte marrë urdhër për rekrutimin e 40.000 ushtarëve nizamë, të krishterë e myslimanë, të vilte taksën e Xhizjes, pavarësisht nga besimi fetar, të zbatonte reformën gjyqësore, e cila detyronte kadijtë të gjykonin në bazë të kodeve civile. ***Në kryengritjen e vitit 1835 u përfshinë qyteti i Shkodrës me krahinat përreth (Postribë, Malësi e Madhe, etj., shënimi im R. S),*** popullsia e kazave të Lezhës, Mirditës, Matit, e deri në Podgoricë e Kosovë.(Prof. dr. Petrika Thengjilli, "Shkodra ne Shekuj", sem.tretë, vëll. parë, f 93). ***Kryengritjen antiturke të vitit 1835 e ka trajtuar edhe Hamdi Bushati në librin e tij "Shkodra dhe motet". Nga eksponentët kryesorë të kësaj kryengritjeje janë dy përfaqësues kryesorë shkodranë, por që janë me origjinë nga Postriba. Kështu Haxhi Idriz Boksi është me origjinë nga Boksi i Postribës, ndërsa Ahmet efendi Kalaja është me origjinë nga Drishtit, Kalaja e Drishtit.***

Haxhi Idriz Boksi, një nga eksponentët kryesorë të kësaj kryengritjeje (1835), nuk u dorëzua, as nuk u pajtua me qeverinë, por u arratis në malësi. (Hamdi Bushati, "Shkodra dhe motet", f. 408-409). Ardhja e ekspeditës prej 10 mijë vetash ushtarë nën komandën e Mustafa Teofik Pashës e tronditi popullin e Shkodrës. Ai arrestoi disa persona si nismëtarë të kësaj kryengritjeje. Nga të arrestuarit, ai internoi Ahmet efendi Kalanë, Hamz Kazazin, etj. Pas dhjetë muajsh internim, këta u kthyen përsëri në vendin e tyre. Gjatë kryengritjeve popullore kundër qeverisë osmane të viteve 1832-1871 duhen kujtuar disa patriotë, të cilët sakrifikan edhe jetën e tyre, si Hysejn Begu, Hamz Kazazi, Ahmet Kalaja dhe Haxhi Idriz Boksi i lagjes Ndocaj. Këta dy të fundit me origjinë nga Postriba. Të dy hoxhë. Ahmet Kalaja i internuar dy herë si kundërshtar i reformave të Tanzimatit, por dhe prijësi i vullnetarëve shqiptarë përballë malazezëve shovinistë, sidomos me rastin e Luftës së Shpuzës, ku qe dalluar për trimërinë e tij, qe persekutuar nga turqit. Në agoninë e vdekjes pat thënë: "Kam pasë uzdajë se kam me dekë para dushmanit të vatanit!". I dyti Haxhi Idriz Boksi, i cili pat dhënë fetva në luftën kundër ushtarëve osmanllinj, në epokën e Hafiz Pashës, qe një nga udhëheqësit kryesorë të asaj lëvizjeje. U internua, u burgos dhe u dënua me vdekje në Stamboll. Ky mollah sympatrembur u premtonte xhennetin atyre që do të vdisnin për mbrojtjen e atdheut të kërcënuar. (Hamdi Bushati, "Shkodra dhe motet", f. 413-414). Shkodranët, myslimanë e të krishterë, luftuan përkrah njëri-tjetrit. Në një betejë, e zhvilluar më 20 maj 1835 përpara mullinjve të qytetit, pas një lufte të ashpër, sjellja e të vrarëve dhe të plagosurve solli një çast dekurajimin e popullsisë së paarmatosur, por ai u kapërcye shumë shpejt ***me ndërhyrjen vendimtare të Haxhi Idriz Boksit, me fjalët se: "është nata me vdekë, sepse kush vdes për vatan, shpirti i shkon në parajsë."*** Kjo thirrje pati një rëndësi aq të madhe sa një artileri e rëndë. Madje, kur pjesa më e madhe e kryengritësve pranoi të lërë armët, Haxhi Idriz Boksi e Lokja, përfaqësues të krahut më të vendosur në Këshillin e Përkohshëm, e vazhduan luftën deri në fund, sa ranë rob dhe u internuan. (Prof. dr. Petrika Thengjilli, "Shkodra ne Shekuj", sem. tretë, vëll. parë). (Haxhi Idriz Boksi ishte nga Postriba, nga fshati Boks, nga ka marrë edhe mbiemrin, për të ruajtur origjinën e tij, shënimi im, R. S). Pas përfundimit të kryengritjes së vitit 1835, katolikët vazhdonin të paguanin Xhizjen, por në formën e një takse për të qenë të përjashtuar nga thirrja nën armë në rast lufte...Popullsia katolike vazhdonte të mos kishte të drejtë të hapte kisha. Për këtë, banorët katolikë të krahinës së Shkodrës u ngritën kundër kësaj gjendjeje. Pasi hartuan kërkesat e veta, ata ia paraqitën Portës së Lartë nëpërmjet një delegacioni të përbërë nga Anton Mida e Mark Curani...(Prof. dr. Petrika Thengjilli, "Shkodra në Shekuj", sem. tretë, vëll.parë, f. 93). Në vitet

1750, 1768, 1790 dhe 1796 janë bërë shumë luftëra të përgjakshme nga ana e forcave turko-shqiptare me malazezët. Gjatë kësaj periudhe u bë një luftë e përgjakshme në qytetin e Shpuzës, rreth 14 kilometra në veri-perëndim të Podgoricës..., Lufta e Shpuzës u nda në tri faza. Në fazën e dytë më 1860 forcat turko-shqiptare kundër malazezëve ishin rreth 20.000 vetë bashkë me malësorët e Mbishkodrës. Hamdi Bushati nuk sqaron këtu se cilët ishin këta malësorë të Mbishkodrës, por unë dua të sqaroj se ***bashkë me forcat e tjera të Mbishkodrës ishin pa diskutim edhe malësorët e Postribës, pasi siç do ta përmend edhe më poshtë, gjatë kësaj periudhe Mustaf Brahim (Spahija) nga Boksi i Postribës, bëri duel me shkjaun malazias, pasi ky i fundit kërkoi duel për tre ditë me rradhë. Mustaf Brahim i këputi kokën shkjaut të Malit të Zi, sepse kushtet e duelit ishin të tilla, që fituesi t'i këpuste kokën kundërshtarit*** (shënimi im. R. S). Në kohën kur nisi lufta dhe bombardimi me topa prej anës së armikut, në luftëtarët u vu re një farë tronditjeje. Në këtë moment ***Ahmet efendi Kalaja, myderrizi shkodran i përmendur e i njohur për nisma trimërie e burrërie, me zërin e tij kumbues, iu drejtua atyre me thirrjen: “ Kush të dojë me hy në xhenet, sot i ka dyert të hapura!”...Kjo luftë u kushtoi malazezëve mbi 500 krerë të prerë, përveç të plagosurve... Lufta në fjalë përfundoi me fitoren e turqve e të shqiptarëve.*** (Hamdi Bushati, “Shkodra dhe motet” f. 421-423). Thamë më lart se Lufta e Shpuzës u nda në tri faza. Faza e tretë e Luftës së Shpuzës u zhvillua në vitet 1876-1877. Faza e tretë e luftimeve turko-shqiptare kundër malazezëve nisi me Luftën e Podgoricës në tetor të vitit 1877. Lufta drejtohej nga Komandanti Hodo beg Sokoli. Në këtë betejë mori pjesë edhe Ahmet efendi Kalaja, me origjinë nga Drishti i Postribës. (Hamdi Bushati, “Shkodra dhe motet”, f. 424-425). Gjatë kësaj periudhe, në kryengritjet që organizoheshin kundër pushtimit pesëqind vjeçar të Perandorisë Turke, si zgjim i kombit, për çlirimin e trojeve nga pushtuesit, si dhe për ruajtjen e integritetit tokësor nga çdo pushtues, ***Postriba nuk ka pasur asnjëherë dallim në besim, por krah për krah me katolikët në veçanti dhe të krishterët në përgjithësi, kanë luftuar si vëllezër kundër një armiku të përbashkët.***

Postribasit, edhe në mbrojtjen e trojeve kundër pushtuesve serbë e malazezë kanë luftuar krah për krah me katolikët e Shkodrës dhe të malësive pa asnjëfarë dallimi feje, por si vëllezër të një gjaku. Në një betejë të kësaj periudhe, në mbrojtje të trojeve, të sovranitetit dhe të ruajtjes së integritetit tokësor nga pushtuesit serbë e malazezë ndodh një ngjarje, të cilën e tregonin pleqtë vazhdimisht, dhe kjo është kështu: Pas disa përpjekjeve mes dy fronteve, mbrojtësve të vendit, postribasve dhe pushtuesve serbo-malazezë, u vendos një armëpushim i shkurtër. Gjatë kësaj kohe del një shkja në fushë të bejlegut (duelit) dhe hap bejleg duke luajtur shpatën, si ftesë për dyluftim. Kjo gjë vazhdoi për dy-tre ditë rresht duke ftuar për bejleg nga pala kundërshtarë. Ditën e tretë del Mustaf Brahim i fisit Spahijaj të bajrakut të Boksit. Mustaf Brahim ishte një burrë mesatar nga trupi, i thamët në trup, me fytyrë të zeshkët, serioz dhe shumë zemrak. Luftëtarët postribas, duke parë shkjanë një burrë trupmadh dhe sa dukej i fuqishëm dhe Mustaf Brahimin që nuk i përshtatej trupit të tij, i thonë: - Ku shkon baca Mustafë!? - Në pastë ba Zoti emër o me i hjekë kryet shkjaut o me ma hjek ai. Nuk e la ma shkjaun me më hjek bejleg në tokë teme! Hipur mbi kalë, me hutën e gjatë dhe me shpatë në dorë del në fushë të bejlegut. Kur i afrohet shkjaut ai i thotë Mustafës: - Qit Postribë! - Jo nuk i takon Postribës me qitë e para sepse nuk të kam kërkuar unë bejleg por ti, prandaj qit ti i pari! Shkjaun ndez hutën dhe shtie mbi Mustaf Brahimin për ta vrarë. Në këtë kohë Mustaf Brahim, i regjur me bejlegje e me beteja kundër shkjeve serbo-malazezë, rrëzohet nga kali gjoja se e kapi plumbi i shkaut dhe ndërkohë ndez hutën e tij për të shtier mbi shkjaun që i kishte kërkuar bejleg. Kur rrëzohet Mustaf Brahim, shkjaun afrohet për t'i këputur qafën me shpatë e për t'i marrë kokën, siç e kishte rregulli i bejlegut. Në këtë kohë kur shkjaun ngre shpatën për t'i prerë qafën, Mustaf Brahim shtie me hutë mbi të dhe e vret. Shkjaun rrëzohet nga kali dhe Mustaf Brahim shkon e i pret qafën atij dhe i merr kokën dhe ua dorëzon luftëtarëve postribas. Me këtë akt trimërie, Mustaf Brahim la zërin e tij për shekujt që do të vinin pas deri në ditët e sotme. Fisit të tij iu ofrua vendi i bajraktarit por nuk e pranoi një gjë të tillë duke ia lënë nderin Postribës dhe fisit të bajraktarit. Ai mbajti përsëri vendin e tij si vojvodë ose fis pas bajraktarit. Emri i Mustaf Brahimit nuk do të vdesë kurrë sepse nuk vdes vepra e trimërisë që ai bëri duke mos e lejuar shkjaun që të heqë bejleg në trojet tona. ***Postriba e ka shkruar me gjak historinë e saj sepse gjatë shekujve ajo i ka mbrojtur me gjak trojet e vendit të ilirëve, trojet e kombit të saj.***

SYNIMET MALAZEZE PËR PUSHTIMIN E SHKODRËS

Mali i Zi, gjatë gjithë historisë së zhvillimit të tij, ka synuar për zgjerimin e tij në dëm të trojeve të popullit shqiptar. Shumë herë këto synime janë paguar me gjakun e derdhur të luftëtarëve të Shkodrës dhe të malësive përreth, si Postribës, Malësisë së Madhe, Dukagjinit, etj. Por një gjë është e sigurt, se ëndrra malazeze për ta bërë Shkodrën e rrethinat e saj pronë të Malit të Zi, nuk u realizua kurrë. Në studimin e mr.Riza Rexhës nën titullin “Shkodra në projektet e zgjerimit tokësor të Malit të Zi gjatë sundimit të Mbretit Nikollë” dhe të paraqitura në “Shkodra në Shekuj,” sem. tretë, vëll. parë, në mes të tjerave thuhet: “Orvatjet për të pushtuar Shkodrën u zhvilluan nëpër disa etapa: Gjatë krizës Lindore (1875-1878), gjatë Luftës parë Ballkanike (1912-1913), gjatë Luftës parë Botërore (1914-1918) dhe gjatë viteve 1919, 1920, 1921.” (Mr. Riza Rexha, “Shkodra në Shekuj”, sem. tretë, vëll. parë, f. 129). Gjatë krizës Lindore, para se të fillonte lufta e Malit të Zi kundër Turqisë më 1876, princ Nikolla i paraqitej Portës së Lartë si një mik i sinqertë e se ishte kundër çdo konflikti me të. Mirëpo, sipas tij, ajo kishte për të luajtur një rol pozitiv, nëqoftëse do t’i bënte Malit të Zi disa koncesione: një skelë në Detin Adriatik, lundrim të lirë nëpër Liqenin e Shkodrës dhe në lumin Buna si dhe kthim të ishujve të Vraninës dhe Lesendrës. (po aty f. 129). Për realizimin e këtyre aspiratave, Princi Nikolla përpiloi planin, sipas të cilit duhej më parë të pushtohej Tivari, Ulqini dhe të vazhdohej në drejtim të Shkodrës. Tivari përbëhej prej Tivarit poshtë me rreth 5000 banorë dhe Tivarit lart me rreth 3000 banorë. Tivari poshtë ra në duar të malazezve, më 14 nëntor 1877. Pas kësaj ngjarjeje, Nikolla caktoi 8 batalione për të siguruar rrugën për në Shkodër...Më 19 nëntor 1877, u zhvillua një betejë në Anën e Malit, ku ushtria malazeze e humbi luftën... Më 10 janar 1878, ushtria malazeze e okupoi edhe Tivarin lart...Për pushtimin e Ulqinit dhe të Shkodrës ai caktoi 14 batalione...Ulqini u pushtua më 18 janar 1878. (Mr.Riza Rexha, “Shkodra në Shekuj”, sem. tretë, vëll. parë, f. 130)

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT

Programi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878) ishte që në rradhë të parë të organizohej kombi për të kundërshtuar me armë në dorë Perandorinë Turke dhe për të shpallur pavarësinë. U organizuan kryengritje të armatosura të popullit si ajo për Plavë e Guci, ajo për pushtimin e Hotit, Grudës e Triepshit ndër malësorët e Mbishkodrës (duke përfshirë këtu edhe Postribën, shënimi im, R. S.)... ***Lidhja e Prizrenit është shprehja më e qartë e një ndërgjegjeje kombëtare shqiptare të pjekur.*** (“Hylli i Dritës”, viti 1941, “Karakteretë natyrshme e historike.”, f. 238-239).

LUFTA PËR MBROJTJEN E ULQINIT ME 1880

Studiuesi Xhevat Repishti, në studimin e tij “Lufta për mbrojtjen e Ulqinit me 1880”, të paraqitur tek “Kumtari” nr.5, f. 236-242, në mes të tjerave thotë: “... Në qershor të vitit 1880, në kabinetet e Fuqive të Mëdha po rrihej problemi për t’i dhënë Malit të Zi toka në perëndim të liqenit të Shkodrës: Kazanë e Ulqinit bashkë me qytetin... Komiteti i Lidhjes për Shkodrën së bashku me përfaqësuesit e degës së Ulqinit, që erdhën për të kërkuar ndihmë, hartuan planin e përqëndrimit të ngutshëm të forcave vullnetare në Ulqin. Dega e Shkodrës menjëherë iu vu punës për të mbledhur e dërguar vullnetarë shkodranë e, nga ana tjetër, hyri në kontakt me krahinat e tjera të vendit, pasi lufta për mbrojtjen e Ulqinit duhej të ishte luftë e gjithë popullit shqiptar Dega telegrafoi më 25 qershor në Tiranë, Durrës, Kavajë, kurse në Pukë, Pult, Postribë etj., shkuan lajmëtarë të posaçëm, me porositë përkatëse.. Vullnetarët shqiptarë nuk u larguan nga pozicionet që kishin në Hot e Grudë... Bërthamë e trupës vullnetare për mbrojtjen e Ulqinit shërbeu reparti i gardës së degës së Shkodrës, që komandohej nga patrioti i shquar Isuf Sokoli... Sipas Hamdi Bushatit në veprën e tij “Shkodra dhe motet” thuhet se “populli i Shkodrës më 27 qershor, e mori vesh ndërrimin e tokave shqiptare dhe u pezmatua tepër. U mor vendimi që me çdo kusht të mbrohej tërësia e atdheut. Dega e Shkodrës dërgoi në Ulqin Mehmet Becin

që të këshillonte popullsinë e atij vendi që ta kundërshtonte dorëzimin e qytetit dhe të qëndronin me armë në dorë..." Po përsëri sipas Hamdi Bushatit në veprën e tij, "u organizua një mbledhje në shtëpinë e Haxhi Nag Drishtit" (me origjinë nga Drishti i Postribës, shënimi im, R. S) në lagjen "Dudas." Në këtë mbledhje vendosej përsëritja e besës së dhënë. Dega zgjodhi Jusuf agë Sokolin si komandant të forcave vullnetare të Ulqinit, në vend të Hodo Begut, pasi nuk e lejua turqit të ishte ky komandant... Dorëzimi i Ulqinit u bë nga presioni që ushtruan Fuqitë e Mëdha e Rusia mbi Turqinë. **Në këtë luftë shqiptarët lanë 50 të vdekur e shumë të plagosur. Këtu mbeti edhe Tahir Haxhija i bajrakut të Boksit, vëllai i bajraktarit, për të cilin është ngritur një këngë.** Kjo këngë është paraqitur në kapitullin XV "Trashëgimia gojore". (Hamdi Bushati "Shkodra dhe motet", f. 434-442). Në protestën e parë që Ulqini i drejtoi Fuqive të Mëdha thuhej: " Populli i Ulqinit preferon më mirë të zhduket duke u flijuar se sa t'i nënshtrohet administratës barbare të Malit të Zi." (Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912, përgatitur nga St. Pollo e S. Pulaha, Tiranë 1878, f. 113)... Gjithsej për marrjen e Ulqinit u angazhuan 30 mijë forca armike me 200 grykë zjarri. Përballë një vullnetari shqiptar kishte 10 armiq. Lufta ka zgjatur 7 orë pa da.. (Dh. Andoni e K. Luka, Burime vendase mbi periudhën e Lidhjes së Prizrenit në "Studime historike" nr. III, 1963, f.13). Shqiptarët i mbrojtën me trimëri pozitat e tyre, por kishin armatim të dobët dhe të pamjaftueshëm. Humbjet turke në luftën e Ulqinit kanë qenë të mëdha. Heroizmi i vullnetarëve shqiptarë ishte i madh dhe këtë u detyruan ta njihnin edhe vetë turqit. "Nxitoj t'ju njoftoj - deklaronte kryeministri Osman Asim Pasha, - se lëshimi i Ulqinit është kryer pas një të ndeshuri mjaft serioz në mes ushtarëve tanë dhe shqiptarëve." (HHStA, PA, Raport i ambasadorit austro-hungarez në Stamboll dërguar Ministrisë së Punëve të Jatshme në Vjenë më 29 nëntor 1880.). (Xhevat Repishti, "Lufta për mbrojtjen e Ulqinit me 1880", "Kumtari" nr. 5, 236-242). **Në luftën për mbrojtjen e Ulqinit e të Tivarit morën pjesë luftëtarë nga Shkodra, nga Postriba, Malësia e Madhe etj.** Burime gojore nga pleq dhe luftëtarë që kanë marrë pjesë në mbrojtje të këtyre qyteteve shqiptare thonë kështu; **"Pasi u mor vesh se po luftohej për mbrojtjen e trojeve të Ulqinit e të Tivarit, u ngrit menjëherë Postriba e udhëhequr nga bajraktarët e Drishtit, të Boksit e të Sumës.** Ata iu përgjigjën Shkodrës dhe u gjendën menjëherë përkrah luftëtarëve shkodranë, në luftë kundër forcave serbo-malazeze. Në luftë e sipër pati disa të plagosur dhe **mbeti i vrarë Tahir Haxhija, vëllai i bajraktarit të Boksit, për të cilin u fol më lartë.** Në të gjitha luftërat që u zhvilluan kundër pushtuesve serbo-malazezë, **Postriba është gjendur e para në front, ndaj dhe vlerat e saj duhet ruajtur brez pas brezi, si një relike e çmuar kombëtare.** Luftëtarët e Postribës, të Hotit, Grudës, etj. gjatë gjithë kësaj periudhe luftuan me vetëmohim e heroizëm kundër pushtuesve serbo-malazezë, sepse ata e kuptuan mirë që me largimin gradual të Turqisë ata hartonin plane shoviniste për pushtimin e Shkodrës dhe të rrethinave të saj, e kryesisht pjesën lindore të Liqenit të Shkodrës, duke u futur në pjesën më të madhe të rrjedhjes së lumit Kir. Pra, këtu përfshihej edhe Postriba. Mali i Zi, fillimisht u fut në Malësinë e Madhe, në trojet e Hotit e të Grudës me synimin gjoja, për të nxjerrë Turqinë nga trojet tona, por u hetua shumë shpejt, sepse aty nga kalonin malazetë nuk silleshin më si aleatë por si pushtues, duke vendosur flamurin malazez në trojet tona dhe jo flamurin shqiptar. Hoti dhe Gruda kërkoi ndihmë në Shkodër, në Postribë, në Dukagjin, në Malësinë e Madhe, etj **Luftëtarët e Postribës me në krye komandantin trim Adem Haxhija, i shkuan në ndihmë Hotit fill sapo u ngrit Shkodra, dhe krah për krah luftuan Hot, Shkodër e Postribë duke mbrojtur trojet shqiptare.** Në fund, bilanci i luftës që me fitoren e forcave tona, duke e paguar me gjakun e derdhur. Në këtë luftë pati disa të plagosur, ndërsa **nga forcat e Postribës mbeti i vrarë Adem Lamush Ura, nga fshati Mes i Postribës.** Populli për këtë betejë të përgjakshme ngriti këngën e mrekullueshme si më poshtë:

Iptida do ditë përpara
Duel haberi në Stamboll
Hot e Grudë i ka dalë fjala
Ia ka falë mbreti Nikollës
Hot e Grudë na janë betue
Vijnë në Shkodër me qa dert
Pa gjak malet mos me i lëshue
Janë nisë me u ba milet..
Dy sahat pa dalun drita

Ja mbërriti Postriba
Postriba vjen si motit
Më yryç u këcejnë te topi.

Në shkurt të vitit 1911, mbreti Nikolla i propozoi Serbisë që Peja Shkodra dhe Lezha të njiheshin si zonat që duhej t'i përkisnin Malit të Zi. Me fillimin e Luftës Ballkanike (1912- 1913) në Shqipëri krijohet një gjendje mjaft e ndërlikuar: në sa vazhdonte lufta kundër Turqisë, në të njëjtën kohë bëheshin plane për copëtimin e Shqipërisë. Në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (dhjetor 1912-korrik 1913), delegacioni serbo-malazez kërkonte që Shqipëria të ngushtohej sa më tepër. Delegacioni malazez kërkonte Shkodrën. Mbreti Nikolla shpresonte se Shkodra do të dorëzohej shpejt. Për pushtimin e saj angazhoi 8 brigada me 36 batalione dhe 74 topa (me forca ndihmëse prej 17 batalione me 32 topa), mirëpo nuk ndodhi ashtu. Shkodra qëndroi heroikisht. Gjatë dhjetorit 1912- janarit 1913 në malin e Taraboshit, Kodrat e Beltojës, Bërdicës e Baradhanjorëve u zhvilluan beteja të përgjakshme. Ushtria malazeze e komanduar nga Mbreti Nikolla pësoi disfatë. (Mr. Riza Rexha, "Shkodra në Shekuj", sem. tretë, vëll. parë, f. 130-131). Në këto beteja të përgjakshme u shquan luftëtarët e Postribës, të cilët kishin zënë dy fronte: atë të "Fushave të Myselimit" dhe atë të "Badhanjelit" siç e quan populli, ose të Bardhanjorëve, siç e kanë përshkruar historianët. Para se të shkonin në këto dy fronte, Adem Haxhija me luftëtarët e Postribës, morën abdes si myslimanë, për të rënë në fushën e betejës të pastër, pasi ata shkuan në front me synimin për të mos u kthyer më. Luftëtarët morën hallallin tek njerëzit e shtëpisë, se ndoshta nuk do të shiheshin më në këtë jetë dhe shkuan në luftë për të rënë shehit në mbrojtje të trojeve, kundër pushtuesve malazezë. Ishte një nga betejat më të përgjakshme, sa që luftëtarët e forcave shqiptare u ndeshën me ato malazeze trup më trup dhe bajonetë më bajonetë. ***Nga kronikanë të kohës në Shkodër mësojmë se natën e 29 dhjetorit 1912 mbetën të vrarë nga Postriba 60 luftëtarë dhe u plagosën 70 të tjerë, po postribas.*** ("Kumtari" nr. 6-Ditari i një kronikani për Rrethimin e Shkodrës 1912-1913). Në këtë betejë, më 29 dhjetor 1912 ranë heroikisht Dan Zyber Repaj nga fshati Boks, Brahim Beqir Shabaj nga fshati Boks, Zeqir Isuf Dushaj nga fshati Drisht, Halil Isuf Dushaj nga fshati Drisht, Zeqo Smajl Bushaj nga fshati Kullaj, Idriz Bajram Bajraktari nga fshati Kullaj, Haxhi Isen Kurti nga fshati Domën, bashkë me të vëllanë e tij, e sa e sa të tjerë që nuk po i përmendim të gjithë. Edhe në fillim të shkurtit 1913, ushtritë serbo-malazeze e shtuan presionin kundër Shkodrës, por në pozitat e kodrave të Bardhanjorëve dhe të malit Tarabosh pësuan disfatë duke lënë shumë të vrarë. Mbreti Nikolla e vazhdoi luftën me parullën: "Ose Shkodrën, ose Vdekjen"...Në Konferencën e Ambasadorëve në Londër...u vendos që Shkodra me rrethinë t'i mbetej Shqipërisë. Në temën e dr. Romeo Gurakuqit të titulluar: "çështja e Shkodrës në Konferencën e Ambasadorëve (1912-1913) deri në momentin e dorëzimit Malit të Zi," të paraqitura në "Shkodra në Shekuj", sem. tretë, vëll. parë, në mes tjerash thuhet: "Në Konferencën e Ambasadorëve në Londër u ra dakord që Serbia nuk duhej të shtrihej drejt bregut të Adriatikut dhe se duhej të krijohet një Shqipëri Autonome...Fundi i muajit janar shënon një pikë kthese në qëndrimin e Rosisë në lidhje me Shkodrën. Ajo la të kuptohet se mund të hiqte dorë nga qyteti me kusht që të mernte kompensime të përshtatshme si në rajonin përfaqëues Shkodrës (pjesën më të madhe të Liqenit të Shkodrës, rrjedhjen e plotë të Bunës në jug të qytetit, si dhe territorin lindor të liqenit, përfshirë një pjesë të madhe të lumit të Kirit), ashtu dhe pjesën lindore për Serbinë.(Dr. Romeo Gurakuqi, "Shkodra në Shekuj", sem. tretë, vëll. parë, f. 153-158). Siç shihet nga Konferenca e Ambasadorëve, në koordinim edhe me Rusinë e Malin e Zi, ishte menduar që Postriba të përfshihej në territorin e Malit të Zi dhe t'i përkiste kombit sllav. Populli i dinte shumë mirë synimet serbo-malazeze dhe nuk do të lejonte kurrë që trualli i tij të bëhej truall malazez. ***Postriba koordinoi planin e mbrojtjes në bashkëpunim me Shkodrën dhe Malësinë e Madhe dhe në veçanti me Hot e Grudë, duke qenë kurdoherë në vijën e parë të frontit, krah për krah me Hot e Grudë. Populli e përjetësoi këtë me vargjet e këngës si më poshtë:***

***"...Tre sahat pa dalë drita
Ja mbërrini Postriba..."***

Fuqitë e Mëdha kërkuan që Mali i Zi dhe Serbia të tërhiqnin trupat e tyre të orientuar në drejtim të Shkodrës. Këta nuk pranuan... Më 15 prill 1913, në Forin Ofis, përfaqësuesi malazez në mënyrë kategorike

deklaroi: “Mali i Zi nuk do t’i nënshtrohet dëshirës së Fuqive të Mëdha dhe nuk do të pranojë as kompensimin territorial, as financiar, por do të vazhdojë luftën për Shkodrën.” Në shenjë përkrahjeje, në Rusi u zhvilluan manifestime në hedhjen e parullave: “Shkodra, Malit të Zi.”

BETEJA E DEÇIQIT (1911)

Në këtë luftë mori pjesë edhe Postriba. Luftëtarët e Postribës të udhëhequr nga komandanti popullor Adem Haxhija (Spahija), luftuan me heroizëm për marrjen e Deçiqit dhe kjo betejë pasqyrohet edhe nga studiuesja Edith Durham në librin e saj “Brenga e Ballkanit”, ku ndër të tjera ajo shkruan: “...dy shqiptarë nga Gruda, të plagosur lehtë, më thanë se Gruda ishte ndër të parat në luftën e Deçiqit, kishte pasur 52 të vrarë dhe të plagosur dhe maja e Deçiqit ishte mbuluar plot me turq të vrarë. Kaq i shpejtë kishte qenë sulmi i fundit mbi fortesë, sa që turqit ikën me vrap pa i vënë në veprim topat e tyre dhe nizamët që tërhiqeshin u qëlluan nga artileria e tyre. Midis malësorëve dhe malazezëve pati një zili të rëndë se kush do të hynte i pari në Deçiq. Të dy shqiptarët gëzoheshin si fëmijë, sepse njëri kishte zënë dhjetë mauzerë turke, ndërsa tjetri gjashtë. Nëpunësi i censurës së shtypit malazias megjithatë nuk do të lejonte të përmendeshin malësorët dhe pretendonte se Deçiqin e kishin marrë vetëm malazezët. Në të njëjtën kohë ata shanin me të madhe sepse malësorët kishin kapur dhe marrë nga Deçiqi të gjitha mushkat e artilerisë dhe kuajt e ngarkuar, një provë kjo shumë e mirë që tregonte se ata kishin qenë të parët...” Pavarësisht se Miss Durham nuk i specifikon se cilët ishin këta malësorë, por shprehet shkurt “...midis malësorëve dhe malazezëve pati një zili të rëndë se kush do të hynte i pari në Deçiq...”, është fakt se bashkë me malësorët e Hotit, Grudës etj., morën pjesë në këtë luftë edhe malësorët e Postribës me në krye komandantin popullor Adem Haxhija, të cilët dolën të parët bashkë me Hot e Grudë dhe ngritën flamurin në Deçiq.

Sipas bisedave që kam bërë edhe me pleq që kanë marrë pjesë në këtë luftë, bashkëkohës të komandantit popullor Adem Haxhija, vërtetojnë se Postriba bashkë me Hot e Grudë janë ata që vendosën flamurin në majë të Deçiqit.(R. S). Në këtë luftë mbeti i vrarë heroikisht Zeqir Bejto Isuf Repaj nga fshati Boks i Postribës, për të cilin tregon nipi i tij, Hamit Brahim Repaj nga fshati Boks. (shënimi im R. S)

KRYENGRITJA E VITIT 1912

Ndodhitë e atyre ditëve po rridhnin me shpejtësi të rrufeshme. Fati i Perandorisë Osmane do të ndahej nga ai i kombit shqiptar. Stambolli kishte rënë në erë të besëlidhjes ballkanike e po përgatitej të mbrohej. Esad Pashë Toptani ishte emëruar nga kamanda turke komandant i rezervistëve që do të mblihdeshin në Shqipërinë e Mesme për mbrojtjen e Shkodrës kundër Karadakut (Austro-hungarisë, shënimi im. R.S)..Kryengritja shqiptare kishte marrë fund kudo me 14 pikat e Shkupit. Këto 14 pika na jepnin shumë më pak të drejta politike e administrative dhe arsimore. Ishte një hidhërim i fortë për të gjithë nacionalistët shqiptarë, por **më shumë se të gjithë ishin pezmatuar malësorët e Mbishkodrës (Postribë, Malësi e Madhe, Dukagjin, etj) që një vit më parë e kishin derdhur gjakun rrëke për autonominë e Shqipërisë.** (“Hylli i Dritës”, viti 1939, “Kryengritja e vitit 1912”, f. 116-117). Në “Shkodra në Shekuj”, sem. tretë, vëll. parë, në mes tjerash thotë: “ Mbrojtja e Shkodrës përbën një nga faqet më të lavdishme të luftërave të popullit tonë në mbrojtje të tërësisë së trojeve amtare..” (Prof. dr. Gazmend Shpuza, “Shkodra në Shekuj,” sem. tretë, vëll, parë f. 165). Akuzat që ngrijnë disa “analistë” se drejtuesit shqiptarë, duke pasur frymë orientale, e lanë Shqipërinë jashtë luftërave ballkanike dhe jashtë luftës kundër pushtuesit turk, nuk qëndron. Sipas tyre “të ndodhur midis “kryqit” dhe “gjysëmshënës” shqiptarët na paskan mbetur besnikë të së dytës”. Këto janë këndvështrime antishkencore dhe ahistorike...(Prof. dr.Gazmend Shpuza “Shkodra në Shekuj” sem. tretë, vëll. parë, f. 165). Për hir të së vërtetës historike duhet thënë, që **shqiptarët, në shumicë myslimanë, larg frymës orientale për të cilën bëhet aq shumë zhurmë sot, me goditjet që i dhanë sundimit osman në Ballkan gjatë kryengritjeve të tyre të mëdha më 1909-1912 shpejtuan luftërat ballkanike dhe i hapën rrugë fitores së aleatëve...**(Po aty f. 165). Për këtë autori Italian dhe dëshmitar i ngjarjeve, A.Baldacci, ka theksuar: “Një tregim sado i pjesshëm i ngjarjeve mund të provojë qartë se betejat e përgjakshme për liri të shqiptarëve kundër Turqisë së xhonturqëve më 1910-1912, janë arsyeja e vërtetë e përparimeve të shpejta të aleatëve ballkanikë në luftë. Popujt e Ballkanit, pra, duhet të kuptojnë gjithnjë me mirënjohje se qenë shqiptarët ata që punuan për fatin e mirë të të tjerëve.” (Prof. dr. Gazmend Shpuza, “Shkodra në Shekuj”, sem. tretë, vëll. parë, f. 165-166).

Studiuesi Hamdi Bushati, në librin e tij “Shkodra dhe motet”, në lidhje me “Rrethimin e Shkodrës” të vitit 1912, thotë: “Që më 1911 komanda ushtarake turke parashihte një fortifikim për kundër Malit të Zi. Kur plasi Lufta Ballkanike Shkodra kishte tri fortesa kryesore, siç ishin: “Taraboshi”, “Kodrat e Bërdicës” dhe “Fusha e Shtojit”. Në vigjiljen e luftës, komandanti e valiu i Shkodrës Hasan Riza Pasha, nxitoi të fortifikonte pozicionet strategjike të “Dervish-Tepes” dhe të “Bardhanjorëve”... Fuqia mbrojtëse e Shkodrës formohej prej 15.000 ushtarësh: 5.000 ushtarë aktivë dhe 10.000 rezervistë, shqiptarë të ardhur nga krahina të ndryshme të Shqipërisë. Ushtria sulmuese serbo-malazeze përbëhej prej 25.000 trupash, kurse bashkë me serbë bëheshin 55.000 veta... Shkodra e rrethime luftoi me një trimëri jashtëzakonisht të madhe gjatë gjashtë muajve...**Hasan Riza Pasha fitoi një vend nderi në historinë ushtarake botërore...** Shkodra ra prej urisë pas shtatë muajsh rrethim. Hasan Riza Pasha, në kohën e rrethimit ishte vendosur në zonën ushtarake të Kirit. Ai hyri në bisedime me arqipeshkvin e Shkodrës për të çuar popullin katolik kundër serbo-malazezëve. Në kështjellë do të ngrihej flamuri shqiptar nën atë turk, gjë që tregonte se komanda osmane punonte për llogari të Shqipërisë, ndaj dhe malësorët do të rrokniin armët kundër serbo-malazezëve... Më 24 prill 1913 malazezët hynë në qytetin e thyer nga uria...Më 25 prill ushtria osmane e linte Shkodrën përgjithmonë...(Hamdi Bushati, “Shkodra dhe motet” f. 446-464). Studiuesi Paulin Perja në temën e tij “Qëndresa e popullit të Shkodrës gjatë rrethimit serbo-malazez (tetor 1912-prill 1913) sipas burimeve të reja vendëse” të paraqitur në “Kumtari nr. 5 i Muzeut Popullor të Shkodrës” në mes të tjerave thotë: “... Në një front prej 30 kilometrash, mbrojtësit e qytetit, shumica shqiptarë, përballuan trimërisht sulmet e ushtrive armike. Duke filluar nga 22 tetori i 1912 (A. Nazif, Kiramentin: Ishkodra Mudafaasi, vol. I, f. 9 Stamboll, 1933), filloi bombardimin e qytetit me artileri deri 210 mm, duke shkaktuar, përveç rrënimëve të shumta, edhe viktima në popullsinë civile. Në fund të tetorit 1912 në spitalet e shtëpitë e qytetarëve kishte 5000 të plagosur (C. Villavicenza: “Im Belagerten Scutari Nach dem Aufzeichnungen der Scutarinen I. “ Vjenë, 1913, f.11). (Paulin Perja, “Kumtari nr. 5 Muzeu Popullor i Shkodrës”). **Mijëra banorë të fshatrave të Krajës, Anës së Malit, të Postribës dhe të Rranzave të Malësisë, qenë të parët që u ndeshën me pushtuesit, u detyruan të linin vatrat e tyre dhe të futeshin në qytet.** (Paulin Perja, “Kumtari” nr 5, Muzeu Popullor i Shkodrës”). Rrethimi i gjatë dhe i ashpër i 1912-1913 rëndoi kryesisht masat popullore, që jo vetëm nuk kishin mundësi për të vendosur rezerva, por as të bënin shpenzime ditore. Në rrethim mungoi edhe lënda djegëse...Gjatë rrethimit u ndje shumë edhe mungesa e lëndëve djegëse të ndriçimit...Por problemi kryesor mbeti ai i bukës...**Kënga e pasqyron kështu këtë gjendje:**

**“...Po ban Shkodra tak e tuk
Ka mbetë Shkodra pa buk...”**

Filluan vdekjet e para nga uria. Filloi të përdorej si ushqim mishi i kalit, të cilët u therën në numër të madh. Këtë gjendje e përjetëson kënga popullore kështu:

“...Adem Haxhija thotë një fjalë,
Se lëshojmë Shkodrën për të gjallë,
Der’ t’ mos mbesin asnjë kalë
Der’ ta hanë i vëllai të vëllanë...”

Vuajtjet e popullit të Shkodrës (dhe të fshatrave në rrethim, si Postriba, Kraja, Ana e Malit, etj., shënimi im, R. S) gjatë këtij rrethimi qenë nga më të rrallat në histori, megjithatë ajo qëndroi heroikisht nga dita e parë deri tek e fundit. Qyteti ushtonte nga këngët patriotike...” (Paulin Perja, “Kumtari nr. 5 Muzeu Popullor i Shkodrës”). Shkodra qëndroi heroikisht. Gjatë dhjetorit 1912-janar 1913 në malin e Taraboshit, Kodrat e Beltojës, Bërdicës e Bardhanjorëve u zhvilluan beteja të përgjakshme. Ushtria malazeze e omanduar nga Mbreti Nikollë pësoi disfatë. **Kudo në këto beteja të përgjakshme, edhe në qoftë se nuk del emri i Postribës, duhet pasur parasysh se nuk u zhvillua asnjë betejë pa pjesëmarrjen e Postribës, ndaj dhe këto beteja i quaj si pjesë të historisë së Postribës, (autori).** Edith Durham, nga ana e saj thekson: “Mali i Zi dështoi. Fitimet e habitshme të ditëve të para i detyroheshin më tepër lëvizjeve të malësorëve shqiptarë, (kryesisht pjesa katolike e Malësisë së Madhe, shënimi im, R. S), të cilët me luftë i hapën rrugë ushtrisë malazeze. **Por kur malazezët filluan**

menjëherë të përdorin tokën shqiptare si të tyre (“!”, shënimi im, R. S), ta shkretojnë (kur toka shikohet si e vetja nuk shkretohet, përkundrazi ruhet, shënimi im, R. S), ta grabisin...(toka dhe pasuria, kur është jotja nuk grabitet, shënimi im, R. S), armiqësia në mes tyre dhe malësorëve u rrit pa masë...” (Prof. dr. Gazmend Shpuza, “Shkodra në Shekuj”, sem. tretë, vëll. parë, f. 167).

Malësorët e kuptuan shpejt se synimi i Nikollës ishte pushtimi i tokave shqiptare, kur panë që në vend të flamurit shqiptar në trojet e tyre, u ngrit flamuri malazez. (ashtu si në Deçiq, në Tuz etj.).(Prof. dr. Gazmend Shpuza, “Shkodra në Shekuj”, sem. tretë, vëll. parë, f. 167). Shkodra tremijëvjeçare është kryeqyteti i parë i shtetit ilirian të sunduar prej Mbretit Bardhyl dhe Mbretëreshës Teuta. Shkodra me 30.000 banorë, 20.000 myslimanë dhe të tjerët katolikë që flasin një gjuhë, gjuhën shqipe, dhe kanë tradita të përbashkëta, nuk ka pse të pretendohet nga Mali i Zi për ta bërë tokë të tijën, kur s’ka asgjë të përbashkët me Shkodrën dhe banorët e saj. Udhëpërshkruesi turk Evlija çelebi që kishte vizituar Shkodrën në vitin 1662 (2 shkurt-28 prill) thoshte: “Banorët e Shkodrës krejtësisht janë shqiptarë, tjetër komb s’ka në Shkodër, që të gjithë flasin shqip me një dialekt që nuk i përngjan asnjë gjuhe tjetër “ (Prof. Nexhip Alban, Turqi, “Shkodra në Shekuj”, sem. tretë, vëll. parë, f. 173-174). Gjithashtu edhe Sami Frashëri (Enciklopedia Historiko-Gjeografike, Stamboll, -1890, vëll. II, f. 977-982) shënon se tre e katërta e popullit shkodran është mysliman dhe një e katërta është katolike, ka edhe pak ortodoksë shqiptarë. As. Prof. dr. Mahir Hoti, në temën “Trajtimi i temës së Shkodrës në studimet gjeografike”, të paraqitur në “Shkodra në Shekuj”, sem. II, vëll. II, në mes të tjerave thotë: “ Në veprat e shkruara nga Miss Edith Durham, në çerekun e parë të shekullit XX, si “Shqipëria e Epërme”, “Lufta për Shkodrën” etj., pavarësisht se nga përmbajtja janë të karakterit politik, historik, etnografik publistik, **gjen mjaft pasazhe e trajtesa të karakterit përshkruar fiziko-gjeografik e antro-pgjeografik për fshatrat, banorët e mënyrën e jetesës si për Drishtin e kryesisht Kalanë e Drishtit, ku ajo kaloi një pjesë të jetës së saj në kohën e Rrethimit të Shkodrës. (Ajo jetoi për shumë kohë në shtëpinë e bajraktarit të Drishtit të asaj kohe, Halil Isufit, ku ka bërë fotografi në shkallën e kësaj shtëpie dykatëshe, shënimi im, R.S).**

Vlen të përmendet këtu teksti i gjeografisë për shkollat e mesme me autor Ahmet Gashin (1937), në të cilin flitet për këtë zonë. Kështu, në emërtimin “Fushat dhe luginat”, ai përcakton fushën e Shtojit, sikur përfaqëson krejt Ultësirën e Mbishkodrës... Mali i Zi i vogël 250.000 banorësh, duke marrë guxim nga Serbia dhe Rusia, ishte i pari që i hapi luftë Perandorisë Osmane dhe filloi Luftën Ballkanike: Krajl Nikolla, që lakmonte aq shumë të pushtonte Shkodrën, më 8 tetor 1912, sulmoi. Armata malazeze përbëhej prej 40.000 ushtarësh të rregullt dhe bashibuzukë; kishte rekrutuar burrat deri në moshën 62 vjeç. Shkodra, kur filloi rrethimi malazez, mbrohej me një ushtri mikse (shqiptaroosmane) me ushtarë të rregullt dhe vullnetarë. (Vullnetarët ishin nga luftëtarët e Postribës nën udhëheqjen e komandantit popullor Adem Haxhisë, luftëtarët e Malësisë së Madhe dhe kryesisht Hotit e Grudës të udhëhequr nga Ded Gjolluli, nga Kastrati, Gruemira etj., shënimi im, R.S). Kjo korparmatë osmano-shqiptare komandohej nga gjenerali turk Hasan Riza Pashë Tosjalliu dhe Esat (Pashë) Toptani, i ashtuquajtur “Gjeneral bashibuzuk” shqiptar. Kodrat strategjike të Shkodrës qenë fortifikuar vetëm me 60 artileri të rënda, me afro 100 mitrolozë dhe municione të bollshme. Ushtarët shqiptaro-turq ishin pak, por Shkodrën e mbronin edhe kodrat strategjike, si: të Taraboshit, fortifikatat e Krajës, Shirokës, Oblikës, Gorricës, Bërdicës, Bardhanjolit, Golemit, Boksit...etj. **Thirrjes së mikro-mbretit Nikolla për t’u dorëzuar, komandanti turk Hasan Riza Pasha i jep këtë përgjigje: “I zoti i kësaj kështjelle jam unë! Deri sa të jetoj unë, Shkodra nuk do të dorëzohet!”**

Bombardimet reciproke vazhduan deri më 27 tetor, kur malësorët çliruan Boksit. Këtu dha një kontribut shumë të madh Postriba bashkë me luftëtarët e tjerë malësorë si dhe me ushtrinë e rregullt turke. Qeveria e Stambollit më 3 nëntor 1912 propozoi armëpushim. Ky armëpushim u pranua nga Konferenca e Paqes dhe u nënshkrua një marrëveshje (Marrëveshja e Paqes Ballkanike), e cila nuk u pranua nga shqiptarët dhe disa komandantë patriotë që drejtonin Armatën Osmane...Në marrëveshje, veç tjerave, Kosova dhe një pjesë e Shqipërisë veriore i kalonin Serbisë... (Prof. Nexhip Alban, “Shkodra në Shekuj”, sem. tretë, vëll. parë, f. 174 - 176). Në një kohë kur po goditeshin mirë trupat malazeze (nga forcat turko-shqiptare, shënimi im, R. S), ndodhi një fatkeqësi e papritur; **komandanti i parë i garnizonit të Shkodrës Hasan Riza Pasha, më 30 janar pas muzgut, u vra në një atentat.** Para një dite Konferenca e Paqes në Londër ishte ndërprerë. Malazetë e shfrytëzuan këtë situatë. Trupat

serbe 15.000 vetshe, të komanduar nga koloneli Popoviç qenë afruar 7 milje afër Shkodrës. Të nesërmen Popoviç bombardoi Taraboshin. Gjithashtu 30.000 ushtarë bashibozukë malazezë të komanduar nga gjenerali Vukoviç bombardonin me artileri Bardhanjolin e Madh. Por nuk depërtonin dot, sepse fronti turko-shqiptar qe pajisur me torba rëre dhe me pengesa teli. Pala malazezo-serbe u zbraps. Shpërthyen sulme reciproke të përgjakshme. Betejat vazhduan dy ditë e netë me bajoneta; të dy repartet dhanë viktima të mëdha. (Në këtë betejë Postriba la shumë të vrarë, pasi lufta u zhvillua trup më trup dhe bajonetë më bajonetë, shënimi im, R. S). (Prof. Nexhip Alpan, "Shkodra në Shekuj, sem. tretë, vëll. parë, f. 177). Sulmi i armatës turko-shqiptare vazhdoi deri më 8 shkurt. Malazezët që lanë shumë të vrarë, u detyruan të zbrapsen. Bilanci: nga malazezët qenë vrarë 3500 ushtarë, nga serbët 600, ndërsa ushtria osmano-shqiptare kishte dhënë 4000 dëshmorë dhe të plagosur. Këtu u vranë edhe vëllai i mbretëreshës malazeze me dy kushërinjtë e saj. Një të vrarë ekzistonin 1260 oficerë. Lufta në fortifikatë të Bardhanjolit, malazezëve u kushtoi shtrenjtë. Thuhej se Cetina me 5000 banorë ishte bërë një spital i mbushur me 2000 të plagosur. Dhjetë përqind e meshkujve malazezë, kockat i kishin lënë në Shkodër. Nikolla me gjithë disfatat vazhdonte sulmet e ndihmuar nga Serbia. Bashkarisht me serbët më 16 mars 1913 rrahën Taraboshin. Predhat e topave të mëdhenj binin mbi qytet.(Prof. Nexhip Alpan, "Shkodra në Shekuj",sem. tretë, vëll. parë f. 177).

29 dhjetor 1912:

"...Sonte prej orës 3 mbas mesnatës e deri në 4 të mëngjesit është bërë luftë e rreptë nga Bardhajt edhe gjyle kanë rënë shumë. Sonte kanë mbetë 60 luftëtarë dhe janë plagosur 70 luftëtarë, që të gjithë postribas..." Në këtë natë luftëtarët e Postribës nën udhëheqjen e komandantit popullor, Adem Haxhija, kanë bërë betimin që të mos e lëshojnë frontin e luftës edhe sikur të vdesin të gjithë. Para se të niseshin në frontin e Myselimit dhe atë të Bardhajve, luftëtarët morën abdes në shtëpitë e tyre, u kërkuan hallallin pjesëtarëve të familjes, nënës, babës, vëllezërve, motrave, grave e fëmijëve dhe u futën në luftë për të rënë shehit (dëshmor për mbrojtjen e trojeve).Lufta ishte shumë e rreptë dhe luftimi u zhvillua trup më trup e bajonetë më bajonetë. Vetëm në këtë natë ranë shehit 60 luftëtarë postribas dhe u plagosën 70 te tjerë. Komandanti popullor Adem Haxhija mori plagë por nuk vdiq megjithëse luftonte në këmbë pa iu trembur syri.

KRYENGRITJA KUNDËR SUNDIMIT AUSTRO-HUNGAREZ

Në vitet e Luftës së Parë Botërore, pjesa më e madhe e territorit të Shqipërisë, Brenda kufinjve të vitit 1913, përfshirë Shkodrën, u pushtua nga ushtritë e Austro-Hungarisë. Më 23 janar 1916 ushtritë Austro-Hungareze hyn në Shkodër. Populli në përgjithësi mbajti qëndrim pritës për të parë se ç'do të ngjiste më pas. Ky qëndrim kushtëzohet gjithashtu nga qëllimi i afërt i popullit për të larguar nga Shkodra ushtritë e Malit të Zi...Vjena prej kohësh bënte bujë me propagandën e saj si mbrojtëse e tokave shqiptare nga copëtimi serbo-malazez, veçanërisht si mbrojtëse e qytetit të Shkodrës në Konferencën e Ambasadorëve të Londrës (1912-1913). (Xhevat Repishti, Kumtari nr. 6). Por, me të vënë këmbë në tokat shqiptare, pushtuesit austro-hungarezë treguan fytyrën e vërtetë të një shteti pushtues. Ata vendosën regjimin ushtarak të pushtimit. Kudo nëpër qytetin e Shkodrës ata vendosën shpallje me këcënimet më të rrepta të ligjeve ushtarake. (Po aty, "Kumtari nr. 6). Pasojat e pushtimit të ri i ndjeu menjëherë populli ynë, gjë që solli një revoltë të fuqishme në Shkodër e rrethinat e saj, në pranverën e vitit 1916, të cilën pushtuesit austro-hungarezë e shtypën me ashpërsinë më të madhe, duke arrestuar vetëm Brenda një dite, d.m.th. më 16 prill 1916 rreth 1.000 shkodranë. (Po aty,"Kumtari nr. 6). Shfrytëzimi ekonomik sa vinte e bëhej përherë e më barbar. Gjobitjet e populates nën pretekstet nga më të ndryshmet, në çdo kohë kur arka e bashkisë Shkodër ngelte pa të holla, i pinte gjakun popullit dhe ia bënte jetën më të mjerë. Qëndresa e popullit vazhdoi edhe pas shtypjes së Revoltës së Prillit. Refuzimi i të rinjve shqiptarë për të vajtur ushtarë, mbeti problem i përhershëm tensioni e provokoi ndeshje e konflikte të vazhdueshme e të ashpra në mes populates së Shkodrës dhe pushtuesve. Shkodra dhe shumë krahina të vendit përshkohen nga flaka e kryengritjes së armatosur. Pushtuesit austro-hungarezë e kuptuan keqësimin e shpejtë të situatës dhe më 28 shtator gjenerali Schneken u dha urdhër të gjitha detashmenteve ushtarake të xhandarmërisë që të tërhiqeshin në Shkodër, edhe ai vetë u nis për Shkodër nën mbrojtjen e një detashmenti shumë të fortë.

Me datën 30 shtator arriti në Shkodër. (po aty, "Kumtari nr. 6). Më 28 shtator u ngritën bajrakët e Malësisë së Shkodrës, kështu rrokën armët: Shala, Postriba, Hoti, Gruda, Kastrati, Këlmendi. Sulmi mbi forcat pushtuese qe tepër i shpejtë. Kjo solli asgjësimin e një pjese të konsiderueshme të forcave armike, mbeturinat u tërhoqën dhe u strehuan në Shkodër e në Podgoricë. (po aty, "Kumtari nr. 6). Fillimi i kryengritjes në Shqipërinë e Veriut kundër pushtuesve austro-hungarezë e përmendin edhe historianë të huaj. Këtu ata vërejnë: "Vazhdimin e lëvizjeve të mëparshme dhe të pakënaqësive." Kjo pakënaqësi kishte rrënjë të thella. Masat e gjera shqiptare të udhëhequra nga bajraktarët dhe komandantët popullorë tani e kishin shumë të qartë, se austro-hungarezët ishin armiqtë e vendit. Kryengritësit shqiptarë nuk pushonin presionet e sulmet. Ndeshjet e ashpra me kryengritësit i imponuan kryekomandës marrjen e masave të jashtëzakonshme. Veç që dërgoi posaçërisht një fuqi të madhe për të shtypur kryengritësit e fshatrave në fjalë, po gjithashtu dërgoi edhe një detashment ushtarësh, të pajisur me dy topa e gjashtë mitroloza në fshatin Drisht, të Postribës, që ishte qendra e saj, me qëllim që të shpërndante kryengritësit, që ishin grumbulluar aty. Detashmenti që qe dërguar në Drisht, pasi zbrazi disa topa e mitroloza, me të mësuar se po rrethohej prej kryengritësve, "u kthye me ngutësi në Shkodër." Vetëm afër Urës së Mesit la tre të vrarë e dy boshnjakë robër. Këta dy robër, meqenëse kishin rënë në besë të Murat Ymerit (Shabaj) nga fshati Boks, u përcollën në Shkodër nga vetë fshatarët, pa u ndodhur asgjë nga kryengritësit.

Kryekomandanti i ushtrive austro-hungareze, që kishte kuptuar se nuk ishte e mundur t'i shtronte forcërisht këta kryengritës "që po shtoheshin dita-ditës", në letër qarkore, të cilën ia shkruante kryemyftinisë së përgjithshme, si dhe gjithë krahinave (komunave), me datën 21 tetor 1918, i porosiste që t'i merrnin masat e duhura dhe të përdornin ndihmën e tyre për t'i qetësuar kryengritësit. Nga ana tjetër thirri dy personalitete të Shkodrës: Sylço Begun (Bushatin) dhe Muharrem Kazazin, të cilët i ngarkoi me detyrën e ndërmjetësit tek kryengritësit. (Xhevat Repishti, "Kumtari nr. 6). Më 22 tetor dy përfaqësuesit e parisë së Shkodrës u takuan me kryengritësit, të cilët i ishin afruar tepër Shkodrës. Këta kishin për t'iu thënë se komanda austro-hungareze ishte zotuar t'i tërhiqte të gjitha forcat ushtarake brenda një jave. Kryengritësit pranuan t'i jepnin pesë ditë afat që ushtritë në fjalë ta linin Shkodrën dhe të tërhiqeshin përtej kufinjve të Shqipërisë. Mirëpo austriakët nuk u tërhoqën brenda kësaj kohe dhe nuk e lëshuan Shkodrën. Përkundrazi, pasi përfunduan tërheqjen nga Lezha, thirrën divizionin ushtarak që ishte në Mjedë, nën komandën e kapitenit Nagreb dhe mbasi vendosën në Bërdicë 400 ushtarë, detashmentin e Bardhajve e forcuan me 200 veta. Kryengritësit kur panë se Shkodra nuk u lirua brenda afatit të caktuar, me 28 tetor, natën përsëritën sulmet. Së pari duke iu rënë befaz një nga një postave të prapavijave i detyruan këta të dorëzoheshin e pastaj iu vërsulën edhe formacioneve rreth qytetit. Me 29 tetor, një orë pas mesnate, i ranë qendrës së një batalioni, që e rastisën. U vranë dy oficerë dhe u plaçkit materialit luftarak. Tani filloi lufta në krejt qytetin. Austriakët në fillim e përballuan me armë e me zjarr mitrolozi. Pasi lindi dielli e u kuptua gjendja, nisën t'i bombardonin me top kryengritësit. Ndërkaq kryengritësit shqiptarë vazhduan pa pushim sulmet e tyre kundër fuqive austriake, që kishin zënë vend si në Bardhaj ashtu dhe nga Dobraçi e nga Arra e Madhe (lagje në periferi të qytetit). Fuqia e Bardhajve si e kuptoi se nuk ishte e mundur të qëndronte, filloi të tërhiqej nëpër kodrat e Shkodrës në drejtim të Pazarit. (Xhevat Repishti, "Kumtari nr. 6). Atë ditë një fuqi serbe, më shumë në formë çetash, u dukën para Shkodrës. Kryengritësit duke vështruar rrobat që kishin veshur, pandehën se këta ishin ushtarë francezë ose italianë. Serbët u thanë kryengritësve shqiptarë se ishin fuqia e shteteve të mëdha të Antantës, se nuk kishin asnjë qëllim kundër shqiptarëve, përkundrazi kishin ardhur për t'i ndihmuar shqiptarët e për të luftuar kundër austriakëve bashkë me kryengritësit shqiptarë e se do t'i ndiqnin ata dhe nuk do të qëndronin në asnjë vend të Shqipërisë, e kështu patën fituar besimin e shqiptarëve. Kryengritësit po futeshin deri në skajet e shtëpive të qytetit. Pas darke në qytet u dukën shenjat e një revolucioni shoqëror me panik të madh. Qytetarët nuk donin t'i linin kryengritësit të futeshin në qytet, që të mos bëheshin luftime brenda qytetit. Ata i kërkuan komandantit të divizionit ta lironte Shkodrën. Ai ra dakord që ta largonte ushtrinë para se të ngrysej dhe nisi përgatitjet e nevojshme. Austriakët nën presionin e kryengritësve dhe insistimit të qytetarëve nisën të tërhiqen. Kryengritësit nëpër Dobraç hynë në rrugë të madhe. Në këtë kohë filluan të shtien pushkë nga çdo anë të qytetit. Në orën pesë austriakët kaluan Urën e Bunës dhe minuan dy urat, të Bunës dhe të Bahçallëkut. Tashmë kishin hyrë në qytet kryengritësit, pa dëmtuar asgjë. Në kohën e largimit të trupave austro-hungareze, Shkodrës mund t'i kanosej një rrezik tjetër, pushtuesit serbo-malazeze mund të sulmonin nga çasti në çast dhe të hynin në qytet, prandaj Komiteti "**Mbrojtja Kombëtare e Kosovës**" e ftonte **Hysni Currin të kthehej për të organizuar**

Shalen, Shoshin dhe Postribën në mbrojtje të trojeve nga pushtuesit serbo-malazeze. Bajram Curri e njoftonte Hysniun se nga gjysma e dytë e shtatorit kishte qenë në Durrës, por do të nisej për Shkodër për të organizuar mbrojtjen e qytetit kur të largoheshin trupat e huaja. Nga burra të vjetër ka dëshmi se **në këtë periudhë Bajram Curri është takuar me Adem Haxhinë e Postribës** dhe kanë lidhur një akt-bese dhe konkretisht ngjarja tregohet kështu: Bajram Musa Spahija nga fshati Dragoç dëshmon: “Sipas një bisede që kam bërë me një burrë të vjetër të shtëpisë së Halil Belit nga fshati Ura e Shtrejtë, i quajtur Avdi Kasemi, rezulton se Bajram Curri ka fjetur në shtëpinë e Halil Belit tre ditë e netë. Ka qenë në vitin 1916, në muajin prill-maj. Mbaj mend- thotë -Avdi Kasemi-që Bajram Curri gjuajti manin me pushkë dhe u këput dega e manit me gjethe e ra në tokë. Bajram Curri ishte në shtëpinë tonë (Halil Belit, shënimi im, R. S) me nipin e tij të quajtur Hysni Curri dhe Hasan Ago Batushën. Para se me ardhë në Ura Shtrejtë **Bajram Curri me shoqëruesit u takua me Adem Haxhinë dhe bënë besëlidhjen në shtëpinë e Ymer Beqirit në Rrased të fshatit Boks të Postribës, që Shqipëria të sundoje veten e të mos lënë kambë armiku që të pushtojë vatanin.**” Të dhënat historike përputhen me ato të treguara nga dëshmitarë të asaj kohe dhe me të vërtetë është nënshkruar një besëlidhje e tillë në shtëpinë e Ymer Beqirit, në Rrased në mes Adem Haxhisë dhe Bajram Currit dhe këtë e dëshmojnë shumë burra bashkëkohës të Adem Haxhisë dhe Bajram Currit..

LUFTA E KOPLIKUT E VITIT 1920

Trojet tona u kanë ngjallë gjithmonë lakmi fqinjve tanë e në mënyrë të veçantë atyre të veriut. Të pakënaqur nga trofetë e Luftës Ballkanike, ata u përpoqën të përfitonin nga kaosi që krijoi Lufta e I Botërore. Kur po konstatohej disfata e ushtrisë austrohungareze në vitin 1918, serbo-malazeztë u përpoqën me shti në dorë Shkodrën. (Hamdi Bushati, “Shkodra në Shekuj” vëll. parë, f. 107). Serbo-malazeztë u përpoqën me të gjitha mënyrat, deri edhe me agjencura brenda dhe jashtë Shqipërisë si dhe me provokime në kufi duke vlarë 80 malësorë nga Hoti e Gruda për të krijuar tension dhe justifikim sulmi mbi trojet tona. **Drejtuesit e Prefekturës, Sylço beg Bushati dhe Shuk Serreqi mblodhen këshillin e administratës që përbëhej nga: Shaqir Gjylbegu, Maliq Sokoli, Ndrek Kici e Shan Deda, u lajmërua edhe Tirana dhe u mblodh paria e qytetit. Ndërkohë ia mbërritën në Prefekturë tre krenë me të vërtetë patriotë: Adem Haxhija (komandanti popullor i Postribës, shënimi im, R. S), Bajram Hyseni (nga Linajt e Gruemirës, {shënimi im R. S}.e Dul Grizha. Ata shprehen sigurinë se Malësia s’do të rrinte duarkryq, sikur në ballë të luftës të dilnin Sylço Begu me shokë... (Hamdi Bushati, “Shkodra në Shekuj” f. 476).**

Në këto çaste kritike pushteti lokal dërgoi në Tiranë z. z. Xhemal Bushati e Shuk Gurakuqi për të informuar qeverinë mbi situatën e krijuar. Me të shpejtë në Shkodër arritën Imzot Luigj Bumçi, pjesëtar i Këshillit të Naltë dhe Ahmet Zogu, ministër i brendshëm, i ngarkuar me drejtimin e përgjithshëm të operacioneve ushtarake, duke e emruar si komandant të focave vullnetare Sylço B. Bushatin (që nga zv. prefekt, pak muaj më parë Zogu e kishte emruar prefekt) si dhe Rexhep Shalën, komandant i veprimeve ushtarake të krenjtë frontit. Me 30 korrik në qytet u dha kushtrimi, vetë Sylço Begu doli lagje më lagje me rekrutue vullnetarë: “Një pushkë për shtëpi!” U mbyll Pazari. Si në qytet dhe në fshat, në bazë lagjesh, filloi organizimi i formacioneve vullnetare dhe gatishmëria e vullnetarëve, qe e plotë dhe e menjëhershme. (Hamdi Bushati, “Shkodra në Shekuj” vëll. parë, f. 108-109). Në “Agimi” (periodike letrare e përmuajshme), të vitit 1920-1921 në artikullin “Edhe Shkodra në rrezik”, në mes tjerash thuhet: “...Serbët ia behën në Koplik! Ky kushtrim ishte si një rrufe në vesh të shkodranëve, të postribasve, të kelmendasve, të Dukagjinit, Hotit, Grudës. Ishte gushti i vitit 1920...**në kushtrim të Shkodrës dynden edhe Malcija, Hoti e Gruda, Shkreli e Kelmendi, të pesë bajrakët e Postrbës si dhe ata të pesë të Dukagjinit zhdrypën në teposhtë për një herë...**” “Agimi”, 1920-1921, gusht - “Edhe Shkodra në rrezik” Po në “Agimi” (periodike letrare e përmuajshme), 1919-1920, për të bashkuar popullin në këtë periudhë që i kërcënohej një rrezik i madh, botohet një artikull i titulluar “Lavdrim Kombëtar”, në të cilin në mes tjerash thuhet: “...Në të gjitha viset e Shqipërisë lakmohet një bashkim, që të na mbledhin në një popull pa ndërlikim fisesh, e këtu na duhet me shtue edhe pa ngatrrim besimesh. Për të mos rënë në kthetra të të huajve është e nevojshme dhe e domosdoshme me jetue si një popull që e nje dhe e nderon fisin e vet, që ka të njejtin gjak e gjuhë e që do të ketë edhe të njejtat zakone e doke, në mënyrë

që të dallohemi nga kombi tjetër. Marrëveshja mes besimesh është një lavdërim i mençur që nuk e ka asnjë komb në botë.

Detyra e shenjtë për të gjithë shqiptarët është që të rrisin dashurinë me njeritjetrin e respektin e ndërsjellët, të respektojnë besimet e njeri-tjetrit, pasi të gjitha fetë janë të Zotit dhe të gjithë njerëzit kanë një Zot të përbashkët..." ("Agimi", 1919-1920 (periodike letrare e përmuajshme). Ky material në formë kushtrimi në këto çaste kritike për kombin bëri që populli të jetë akoma më i lidhur me njëri-tjetrin dhe është pikërisht kjo lidhje gjaku që i bashkoi të gjithë shqiptarët, që bashkoi Postribën me Hotin në istikamet e luftës për liri e mbrojtje të integritetit tokësor. Që në kohë të hershme, kur nuk ekzistonin ligje e shtet, popujt gjetën mënyra për të komunikuar me njëri-tjetrin, për t'i dhënë fjalën njëri-tjetrit, për të lidhur besë midis tyre etj. Besa ka qenë kurdoherë një institucion mes popujve dhe ka përfaqësuar dy anë të lidhura: një virtut moral dhe një institut të së drejtës dokësore të trashëguar. Besa si virtut moral e ka zanafillën nga lashtësia, si nevojë për solidaritetin në bashkësinë fisnore. Besa mbështetej në kultin e fjalës së thënë, e cila sipas mendësisë primitive ishte akt hyjnor i pathyeshëm.. Ruajtja e tipareve morale dhe juridike të besës gjatë mesjetës e deri në shekullin e XX është e lidhur me kushte të veçanta historike të zhvillimit të shoqërisë shqiptare. Besa ishte mjet për të vënë rregulla në marrëdhëniet vetjake, familjare, fisnore, krahinore dhe ndërkrainore në rrethanat e bashkësive patriarkale të fshatarësisë ndër male, zakonisht atëherë kur mungonte ligji. Fjala e dhënë ose besa ka qenë mbështetja e marrëveshjeve për veprime të përbashkëta. Historia e popullit njih shumë besëlidhje, krahinore e ndërkrainore, që u kanë shërbyer kryengritjeve për çlirim kombëtar. **Postriba dhe Dukagjini kanë qenë gjithmonë fqinj mes njëri-tjetrit dhe kanë ndarë së bashku gjithmonë gëzimet dhe hidhërimet.** Gjatë historisë së tyre kanë realizuar disa herë akt-lidhje bese mes njëri-tjetrit, në mënyrë që t'i koordinonin veprimet mbrojtëse kundër një armiku të përbashkët. **Në Postribë, Adem Haxhija me pari doli në çdo fshat duke kërkuar nga "një pushkë për shtëpi!". Ai i drejtoi Postribës një kushtrim: "Kush të duan me luftue për atdhe e fe të vijnë mbas meje!"** Por duhet të sqarojmë diçka të brishtë që shpesh ekstremistët e religjioneve fetare të besimeve të ndryshme e kanë shfrytëzuar në drejtim të keq thirrjen: "Kush të duan me luftue për atdhe e fe të vijnë mbas meje!" Kjo thirrje nuk përjashton asnjë besim dhe asnjë besimtar. Ajo thirrje është si për besimin mysliman, ashtu edhe për besimin katolik, dhe për atë ortodoks, pra është e njëjtë për të gjithë. Besimtari mysliman nuk është asnjëherë kundër një besimtari katolik, pasi secili beson në një Zot që e kanë të përbashkët të gjithë besimtarët. Besimtarët respektojnë besimet e njëri-tjetrit, ndaj dhe thirrja për atdhe e fe ka qenë unike për secilën fe (Shënimi është i imi, R. S). Agjuntura serbe, bëri ç'bëri, për të hapur panik e mosbesim në masën e qytetarëve, por zërat e elementëve të gënjyer u mbytën nga vendosmëria e përgjithshme popullore. Vetë Sylço Begu iu kërcënua me varje një kushëri të tij, që shfaq shenja hezitimi e përpjekje justifikim.(Hamdi Bushati, "Shkodra në Shekuj" vëll.parë, f. 109). Në Postribë nuk pati asnjë njeri që të hezitojë apo të qëndrojë në një rrugë të mesme. Ata të gjithë iu përgjigjën pozitivisht thirrjes së Adem Haxhisë me pari për të mbrojtur trojet e të parëve dhe të gjithë nga një "trim për shtëpi" me armë në dorë u nisën drejt Hotit për të mbrojtur atdheun dhe në ndihmë të vëllezërve të vet hotjanë e grudjanë. Kështu, më 1 gusht, para dreke, u nis formacioni i parë me 500 vullnetarë nga qyteti. Me ta u bashkuan edhe malësorët e Mbishkodrës, si Postribë, rrethina etj., si dhe emigrantët podgoricanë. Ushtria zuri vend përkohësisht në Vrakë. Edhe shtabi zuri vend në Vrakë. Përveç Sylço Begut e Rexhep Shalës në shtab ishin të pranishëm edhe Maliq Bushati, Muharrem Kazazi, Shuk Gurakuqi, Oso B. Kopluku, Can Mema...(Hamdi Bushati, "Shkodra ne Shekuj," vëll. parë, f. 109). Shtabi do të ndihmohej më vonë me punën e tij edhe nga prania e A. Zogut, B. Currit, M. Krujës dhe e korrierëve. Në qytet mblidheshin edhe të holla, armë e municione. Edhe gratë dhanë ndihmën e tyre: u organizuan në një shoqëri bamirëse me iniciativën e farmacistit Ndoc Ashiku dhe sillnin në front veshmbathje, cigare etj. (Hamdi Bushati, po aty). Ndhimë të madhe dha edhe prapavija: Musa Juka si kryetar bashkie u dallua për organizimin e mirë e serioz të furnizimit të frontit me ushqime e ujë nga qyteti (me karroca). Shtabi kishte dy sekretarë: Sait Bilalin dhe të dytë Hamdi Bushatin (i mbajtur me ndërhyrjen e Hamid Gjylbegut, për arsye shëndetësore). Pranë shtabit u mbajt edhe Zyhdi Baja, Elez Drishti (me origjinë nga Drishti, Postribë, shënimi im, R. S) dhe një roje, xhandari Mehmet. (Hamdi Bushati, po aty). Që në Vrakë rojet u ndanë në tri kolona: Krahu forcës kryesore vullnetare që ishte në qendër, njeri krah iu drejtua bregut të liqenit, tjetri iu mbështet rranxave Gruemirë- Grizhë. Në krye të kolonave të krahëve ishin caktuar dy oficerë me përvojë, Sulejman Shkodra dhe Hamid Gjylbegu. Ato të qendrës i drejtonte oficeri Taip Shkodra... Në krahun e djathtë luajtën rol të

ndjeshëm vullnetarët nga Rrjollë e Gruemira me Bajram Hysenin dhe ata të Postribës me në krye komandantin popullor, kapiten Adem Haxhinë. (Hamdi Bushati, po aty).

Në "Agimi"-1920-1921 (Periodike letrare e përmuajshme), në lajmet e gushtit, në mes tjerash thuhet: **"...Rremit të djathtë u printe Deli Meta me hotjanë dhe Adem Haxhija me Postribë, dy fise këta më të fortat e Gegnisë sonë e që, si ndër kohë të lashta ashtu të vona janë kenë mburoja e palëkundshme e Shkodrës kundra sulmeve malazeze."** ("Agimi", 1920-1921 "Lajme vendi", faqe 79). Pasi kreu një aksion, duke vrarë në Vrakë tre malazezë që bënë punën e informatorëve, kolona e mezit arriti po në mbrëmjen e datës një, në çezme të Koplikut. Në javën e parë të gushtit erdhen në Shkodër 300 vullnetarë nga Kruja e Kavaja nën udhëheqjen e Mustafa Krujës dhe të Abaz Kupit. Me ta u bashkuan edhe emigrantë kosovarë, nën drejtimin e Bajram Currit. (Hamdi Bushati, po aty). Një ndihmë të madhe jepnin aksionet e shpejta të çetave shqiptare në prapavija. Në këtë veprimtari u shquan vullnetarët e Hotit me në krye Deli Meten, si dhe postribasit (nën udhëheqjen e komandantit popullor, kapitenit Adem Haxhija, shënimi im, R. S) dhe kosovarët (nën udhëheqjen e Bajram Currit, shënimi im, R. S), të cilët arritën nga data 10 gusht deri te Kodra e Bajrakut. (Hamdi Bushati, "Shkodra në Shekuj", vëll. parë, f. 109-110). Luftimet më të mëdha u zhvilluen me datën 2 dhe 9 gusht. Gjithashtu duhet të shënohet edhe 5 shtatori, kur vranë shumë armiçë dhe u zu rob një komandant me më se 100 robër. (po aty, f. 110). Gjatë këtyre luftimeve u shkruan faqe heroizmi e trimërie si nga qytetarët si dhe vullnetarët matjanë, postribas, kosovarë e podgoricanë. **U shqua oficeri Hamid Gjylbegaj, që në maje të kalit e pa iu trembur syri, vraponte në vijat e para të sulmit për të inkurajuar trupat. U shqua, gjithashtu komandanti popullor, kapiteni Adem Haxhija, i cili në krye të luftëtarëve postribas, qëndronte dhe luftonte në këmbë, pa hyrë asnjëherë në istikame-llogore, pa iu trembur syri edhe atëherë kur mori dy plagë. (Xhevat Repishti, "Faqe heroizmi në historinë e popullit tonë", Zëri i Popullit, datë 8 tetor 1980). Adem Haxhija qëndronte në këmbë dhe u jepte zemër luftëtarëve postribas me thirrjet: "Forcani burra mbi anmikun, bini mbi ta!", "Përpara për mbrojtjen e trojeve tona por ruani kryet!", "Të mbrojmë nderin tonë, gjakun e baballarëve që derdhen për këtë tokë!" Adem Haxhija mbante gjithmonë afër vetes trimat Man Alush Gruda nga Dragoçi, Etëhem Beqir Bracaj, po nga Dragoçi, Kasem Hysenin nga Myselimi, etj...Kur në vijën e frontit, në këtë luftë nxori kryet nga llogoret Kasem Hyseni nga Myselimi, për të parë ushtrinë armike, Adem Haxhija, i bie me pëllëmbë kokës duke i thënë: "Ule kryet kopuk se po të kap ndonjë plumb!" Kasemi i kthehet kapitenit: "Po ty a nuk të vrasin që lufton gjithmonë në këmbë!?" Ademi i përgjigjet: "Hajt lufto, me mue asht tjetër gjal!" **Adem Haxhija mori dy plagë, por nuk e ndali luftën as udhëheqjen e luftëtarëve në vijën e frontit. "Bashkëkohësit dhe bashkëluftëtarët e cilësuan "Luani i Luftës". Në dokumentacionin e kohës lexojmë se gratë shkodrane zgjodhën një përfaqësi për ta vizituar Adem Haxhinë e plagosur në shenjë nderimi për trimërinë e tij." (Xhevat Repishti; "Me plagë në trup nga lufta në luftë", Jeta e Re, 24 gusht 1985).****

Kjo luftë heroike në mbrojtje të pavarësisë dhe sovranitetit u kurorëzua me fitore, por si çdo luftë pati edhe heronjtë e vet, të cilët dhanë jetën për të ruajtur integritetin tokësor. Të tillë qenë hotjanët Luc Nishi e Zef Prelë Martini e të tjerë që vdiqën heroikisht. Nga qyteti ranë heroikisht Ali Rexhep Spahija e Mustaf Alivodi dhe u plagosën Nut Bala, Rustem Bërdica, Rasim Gjyrezi, Mustaf Shpuza e Sheh Alja, i cili u plagos në vetull dhe humbi syrin nga një cifël predhe. Nga Postriba u plagosën Adem Haxhija (dy plagë, një në krah e një në kokë), Can Osmani nga Ura e Shtrejtë, Postribë, Zeqir Zeqja e Islam Hajdari nga Lepuroshi, Oso Met Beqiraj nga Egç-Rrjollë, Bish Abdyl Sulej nga Gruemira, Sulejman Bajrami nga Kopliku. (Hamdi Bushati, "Shkodra në Shekuj", vëll. parë, f. 110). Lufta mori fund më 14 shkurt 1921, por të tërheq vëmendjen ky fakt se midis ushtarëve serbë kishte edhe mjaft ushtarë të rekrutuar si mish për top, nga viset e aneksuara prej serbëve si nga Maqedonia, Bosnja etj.. Pas luftës, në Malësi u përhap paniku sepse forcat rebele të A. Lohës, Lul Lukës, Mëhill Spasit etj., së bashku me ushtarë dhe oficerë serbë, duke përfutur nga epërsia numerike dhe armatimi, kishin vënë para xhandarët e shpërndarë që tërhiqeshin pa rregull. Xhemal Bushati e Maliq Sokoli sollën lajmin në Shkodër se armiku ndodhej në çezme-Koplik, shtëpitë e kundërshtarëve po digjeshin dhe përgatitej sulmi mbi Shkodër. (Hamdi Bushati, "Shkodra në Sekuj" vëll. parë, f. 111-113). Drejtuesit e prefekturës Sylço B. Bushati dhe Shuk Serreqi mblodhën këshillin e administratës që përbëhej nga Shaqir Gjylbegu, Maliq Sokoli, Ndrek Kiçi e Shan Deda, u lajmërua edhe Tirana dhe u mblodhë paria e vendit. **Ndërkohë ia mbërriten në Prefekturë tre krenë me të vërtetë patriotë: Bajram Hyseni, Adem Haxhija e Dul Grizhja.** Ata shprehen sigurinë se

Malëcia s’do të rrinte duarkryq, sikur në ballë të luftës të dilnin Sylço Begu me shokë. Sylço Begu iu dha fjalën dhe çeshtja u bisedua gjatë e gjërë në mbledhjen e madhe që u zhvillua në sallonin e Prefekturës me përfaqësuesit e dy besimeve...(Hamdi Bushati, “Shkodra në Shekuj”, vëll. parë, f. 112). Në Suka të Moksetit ishin postribasit (ata që luftuan me heroizëm, shënimi im, R. S): këtu mbet i vranë i nipi i H. Ahmet Dervishit nga Ura e Shtrejtë, Postribë, u plagosën Asllan Bajrami nga Ura e Shtrejtë, Postribë, Adem Haxhija (Me dy plagë, një në krah e një në kokë) dhe Ymer Beqiri nga fshati Boks, Postribë, Hasan Ahmeti vetë i treti prej një shtëpie (palgosur apo vdekur!?). Sipas ish oficerit Asim Kopluku, një postribasit i kishte mbetur djali i vranë në front dhe nuk e çoi djalin e vranë në shtëpi vetëm për të mos u shkëputur nga shokët gjatë luftimit. (Hamdi Bushati, “Shkodra në Shekuj”, vëll. parë f. 112-113). Në shtypin periodik “Agimi”, të vitit 1919, në poezinë e titulluar “Mbi varre të Koplikut” (Tingllim), po shkëpusim dy strofa të kësaj poezie, e cila bën fjalë për varret e burrave që dhanë jetën në vitin 1920, në Luftën e Koplikut, në mbrojtje të trojeve dhe të pavarësisë së vendit:

MBI VORRE TË KOPLIKUT

(tingllim)

Atje, bri rruge, n’atë fushë të Koplikut

Do vorre rishtas ngrehun tek diftojnë:

Se djelmt e shqypes vdesin, por anmikut,

Të shëjtin vend, pa gjak kurr nuk j’ a lshojmë!

Atje ran’vdekun burrat t’onë, qi nana,

Qysh t’vogël n’djepi mësoi n’fushë t’trimnisë:

Me Din e Fe t’bashkuemun t’gjithë si zana,

Me gjak themel të fortë me i vu vllaznisë...”

(Malo Krimshi “Agimi”, viti 1919 “Mbi vorre të Koplikut”, f. 64).

POSTRIBA DHE ADEM HAXHIJA

Vendi ynë rriti luftëtarë dhe nga gjiri i tyre nxori komandantë të shquar popullorë, të cilët me aftësi e me trimëri u prinë masave të luftëtarëve ndër beteja. I tillë qe edhe Adem Haxhi Spahija, (i fisit Spahijaj, shënimi im, R. S), nga fshati Boks i Postribës. Ai lindi në vitin 1867, në prag të ngjarjeve të rëndësishme politike, krijimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. (Xhevat Repishti, gazeta “Jeta e Re, 24 gusht 1985). Adem Haxhija u rrit në një mjedis të shëndetshëm patriotik. Haxhi Idriz Boksi, nga krahina e tij, i vendosur në Shkodër, kishte udhëhequr shpirtërisht kryengritjen e masave popullore shkodrane me 1835 kundër sundimit osman. Ai qëndroi deri në fund të kryengritjes, konsekuent për të vazhuar luftën e armatosur. Haxhi Idrizi, Dasho Shkreli, Oso Kuka, Jakup Ferri e dhjetëra të tjerë qenë udhëheqës të shquar të luftërave popullore, që lanë gjurmë të thella në mendjen dhe zemrën e Adem Haxhisë. Ai u shqua si komandant popullor i talentuar, i pajisur me guxim e burrëri, me bujari e aftësi organizative. Mbi të gjitha qëndronte vetë në ballë, atje ku rreziku ishte më i madh. Me 1912-1913 kur Shkodra qëndroi heroikisht për 7 muaj përballë ushtrive të zgjedhura të Malit të Zi e të Serbisë, Adem Haxhija shquhet në frontin e Myselimit. Ky ishte një nga sektorët ku lufta u zhvillua më e rreptë. **Adem Haxhija ka meritën e veçantë, që armiku, me gjithë sulmet e përsëritura disa herësh, nuk mundi të çajë frontin në këtë zonë.** Një vajzë e Adem Haxhisë (Sibja, shënimi im, R. S), humbi këmbën nga gjylet e artilerisë armike. Më 1920 populli ynë u detyrua të bëjë një tjetër luftë, të shpartallojë intervencionin ushtarak serbo-malazez në krahinën e Shkodrës. Forca të shumta armike, në muajin korrik 1920, sulmojnë me artileri kufirin shqiptar në zonën e Kastratit, nga i drejtohen qytetit të Shkodrës. Adem Haxhinë e kemi që në ditët e para të luftës në krye të luftëtarëve vullnetarë të Postribës. Në kundërgoditjen e forcave shqiptare, që nis me një gusht Adem Haxhija komandon forcat vullnetare luftarake të krahut të djathtë, që ecën rrëzë maleve duke ndjekur armikun. Frocat e krahut të majtë ecën buzë Liqenit të Shkodrës, kurse ato të qendrës ndoqën rrugën automobilistike Shkodër-Hani i Hotit. **Adem Haxhija mori disa plagë në këtë luftë. Ai u quajt nga bashkëluftëtarët “Luani i Luftës”. Në dokumentacionin e kohës lexojmë se gratë shkodrane zgjodhen një përfaqësi për ta vizituar Adem Haxhinë e plagosur, në shenjë nderimi për trimërinë e tij. Më vonë Adem Haxhija do të jetë një nga prijësit e kryengritjes së armatosur të qershorit të vitit 1924. Kryengritësit shkodranë luajtën një rol të veçantë në**

përmbysjen e pushtetit të Ahmet Zogut. Sa u tha më lart, është marrë nga studimet e historianit Xhevat Repishti. Unë, autori i këtij libri (R. S) dua të deklaroj se për aq sa kam të dhëna në lidhje me ngjarjen që u tha më lart, Adem Haxhija nuk ka qenë asnjëherë kundër regjimit të Zogut, pasi ai ka qenë oficer i graduar nga ky regjim, me gradën e kapitenit dhe besnik i tij deri në fund të jetës. Ai nuk ka bërë asnjëherë opozitën ndaj regjimit Zogist dhe po të shikohet në kompleksitet figura e tij do të vërtetohet në këtë libër, se Adem Haxhi Spahija ka qenë luftëtar dhe nacionalist në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe të integritetit tokësor gjatë gjithë jetës së tij. (Shënimet janë të mijat, R. S). Pas rrëzimit të qeverisë së Fan Nolit me ndërhyrjen e reaksionit të jashtëm e të brendshëm, Adem Haxhija kthehet e qëndron të shtëpinë e tij në fshatin Boks, me shumë plagë të marra në luftërat për mbrojtjen e Atdheut. Ndonëse 72 vjeçar, në javën e parë të prillit 1939, ai përsëri e ngjeshi pushkën e u përgatit për të pritur me plumba ushtarët e fashizmit që vinin të pushtonin Shqipërinë. Tradhëtia e Ahmet Zogut dhe e klasave sunduese (gjithnjë sipas Xhevat Repishtit, shënimi im, R. S) solli 7 prillin e vitit 1939. Në dokumentat e armikut (Italisë Fashiste), Adem Haxhija konsiderohej shumë i rrezikshëm. E arrestojnë dhe, pasi e mbajnë disa ditë në burgun e Shkodrës, e internojnë në Itali, (në Kolfiorito). E mbajnë atje një vit, pastaj, të sëmurë për vdekje e lirojnë... Të gjitha mundësitë janë që e kanë helmuar. Sapo erdhi në Shkodër (në vendlindjen e tij, në fshatin Boks), në maj të vitit 1940, vdiq. (Rreth një javë apo dhjetë ditë pasi arriti në shtëpi, ai tregonte se e kishin helmuar me një gotë të ëmbëlsuar me sheqer dhe pasi e ka hetuar helmin e ka gjuajtur me gotë shërbyesen që i ka dhënë gotën, shënimi im, R.S). (Xhevat Repishti, gazeta "Jeta e Re", 24 gusht 1985). Vepra e Adem Haxhisë për atdheun dhe popullin është e madhe. Kuvendi Popullor, me rastin e 70 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, e ka dekoruar Adem Haxhinë me urdhrin: "Për veprimtari patriotike të klasit të parë" me motivacionin "Si luftëtar i shquar e komandant popullor ka treguar trimëri të rrallë në mbrojtjen e Shkodrës 1912-1913 kundër shovinistëve serbo-malazezë dhe për mbrojtjen e tërësisë tokësore e të pavarësisë kombëtare."

INTERNIMI NË KOLFIORITO

Ne kemi arritur të disponojmë dokumenta shtetërorë të kohës, kur Adem Haxhija dhe Ymer Beqiri nga fshati Boks i Postribës, për rezistencë që i bënë fashizmit italian më 7 prill të vitit 1939 me të gjithë nacionalistët e Postribës, u internuan në Kolfiorito, Perugia të Italisë bashkë me nacionalistë të tjerë shqiptarë, të cilët së bashku janë 21 burra të vlefshëm shqiptarë. Këtu poshtë po paraqes fotografinë e të internuarve në Kolfiorito të Perugias: Adem Haxhija dhe Imer Beqiri me 19 burra të tjerë të internuar në Kolfiorito, Perugia të Italisë për rezistencën që i bënë pushtimit fashist më 7 prill 1939. Këtu poshtë po paraqes edhe listën origjinale me 21 emra të të internuarve: Lista emërore e të internuarve në Kolfiorito –

Perugia - Itali:

- 1.Ymer Ramadani...Shkodër
- 2.Hysni Jareci...Dibër
- 3.Hysni Dema... Dibër
- 4.Vasil Palaj...Pogradec
- 5.Ymer Beqiri (Shaba)...Postribë
- 6.Sait Bilali...Shkodër
- 7.Faik Bregu...Libohovë
- 8.Teofik Hysa...Dibër
- 9.Tahir Dizdari...Shkodër
10. Haxhi Lani...Mat
- 11.Salih Lufa...Mat
12. Profesor Kostaq Cipo... Elbasan
13. Adem Haxhija (Spahija)...Postribë
- 14.Xhemal Ferra...Krujë
- 15.Haki Luzati...Tepelenë
- 16.Emin Oriza...Berat
- 17.Hajdar Shahu...Kavajë

18. Teofik Gjyli...Shkodër
 19. Zija Kodra...Dibër
 20. Skënder Frashëri...Libohovë
 21. Xhelo Dibra...?

Dokumenti është i "General" i Divizionit të Karabinjerëve Mbretëror." Komandant: -C. Agostinucci - dërguar: "Ministrisë së P. të Mbrendëshme" Tiranë, motivacioni: "Dërgohen tre lista emërore të personave të goditur me masa policie." Confinati albanesi a Colfiorito 19 / XII / 1939 Emrat e 21 të internuarve.

Internimi i Adem Haxhisë dhe Imer Beqirit në Kolfiorito. I pari në krahun e djathtë tonin është Adem Haxhija Faksimile e listës së Simit Fashist e riprodhuar si më lart: Shkresë zyrtare italiane: "Direzione Generale della Pubblica Sicurezza, 443 /76762 urgente...Sudditi albalesi assegnati al confino di polizia oggetto (Colfiorito). Colfiorito Lista emërore e të internuarve në Itali gjatë okupacionit Italian prej 7 prill 1939 deri më 14 shtator 1943.. Kjo listë përmban 40 emra, shumica e të cilëve janë nga Shkodra. Këtu është edhe një profesor imi, i shkollës së mesme "Kristo Isak" në Berat, zoti Galip Juka, shkodoran, me origjinë nga Postriba (Rrash-Vorfë). Si postribas dhe si profesor imi mendova se e meriton të pasqyrohet emri i tij në këtë libër sepse në fund të fundit ai internohet në Itali si nacionalist shqiptar dhe si kundërshtar i devotshëm i pushtimit fashist. Respekt përjetë për profesorin tim, të nderuarin zoti Galip Juka. Në dokumentat që disponoj është edhe një Proces verbal i datës 23 korrik të vitit 1939. Në këtë proces verbal paraqitet lista me 24 emra të internuar, shumica në Itali. Në këtë listë është edhe Ymer Ramadani, i cili është internuar me Adem Haxhinë dhe Ymer Beqirin. Nuk po e paraqes këtë listë me të gjithë emrat pasi emrat e personave nuk i përkasin Postribës. Gjithashtu disponoj edhe një "Shkresë zyrtarë: "Presidenza del Consiglio dei Ministri", Tiranë, 5 / I / 1942 XX, që i drejtohet drejtorit të përgjithshëm të Policisë Tiranë. (Al Direttore Generale di Polizia - Tirana). Është edhe një shkresë zyrtare e "Komanda Superiore e Karabinerisë Mbretërore, drejtuar zyrës politike, e cila bën fjalë mbi internimin politik të Z. Can Osmanit.

POPULLI PËR ADEM HAXHINË

Në këtë material do të sjellim para lexuesit se si e kanë njohur bashkëkohësit Adem Haxhinë si dhe të dhëna të tjera të trashëguara nga baballarët apo paraardhësit dhe si material gojor të kaluara nga brezi në brez deri në ditët tona.

Ymer Muho Spahija (baba im, R. S) deklaroi:

Adem Haxhija mbante gjithmonë dy qemerë me fishekë, njerin e mbante të mbështjellur për brez dhe tjetrin krah e qafë. Adem Haxhija kur shkonte për të marrë pjesë në luftë, vinte me 4-5 veta nga shtëpia e jonë dhe na tregonte se po nisej për luftë. Kur jepte kushtrimin për luftë ai kurrë nuk thonte: "Nisuni për luftë!", por "Hajdeni të shkojmë në luftë kush të jetë për atdhe e fe!", dhe printe vetë i pari. Shpesh thonte vetëm një shprehje: " Shkova!" dhe nisej në frontin e luftës. Mbaj mend një rast-tregon ai-që në luftë mori dy plagë njëkohësisht, njerën në krah dhe tjetrën në ballë lart. Nga fronti i luftës e kishin çuar në Shkodër, në shtëpinë e Isuf Sokolit, në lagjen Dërgut. Aty do ta mjekonin mjekët më të mirë të qytetit. Ne ishim fëmijë atëherë. Baba më mori mua e vëllain, Zeqirin, për të shkuar për ta parë axhë Ademin të plagosur. Unë isha 7-8 vjeç, ndërsa vëllai dy vjet më i vogël. E gjetëm në shtëpi të Isuf Sokolit. U përqaftuam me shumë mall. Ai dukej i fortë moralisht, si të mos kishte ndodhur asgjë. Kishte pamjen e nje heroit të pamposhtur. Ai na pa që u mërzitëm dhe na tha: - Keni ardhur për të parë axhen, ju lumtë! Unë nuk kam asgjë. Mos u bëni merak! Jam shumë mirë.

Bashkëluftëtari i tij, Man Alush Gruda nga fshati Dragoç na tregon për rastrin kur Adem Haxhija mori dy plagët njëkohësisht. Ai thotë kështu: - Plagën e parë e mori në krah. I përshkoi plumbi krahun dhe nuk bërtiti aspak, por nxori një shami nga xhepi dhe lidhi plagën. Ai nuk e ndërpreu luftën për asnje çast, por vazhdoi drejtimin dhe organizimin e saj sikur të mos i kishte ndodhur asgjë. Ai luftonte gjithmonë në këmbë pa u futur kurrë në istikame (llogore), ndërsa ne nuk na linte për të dalë nga pozicionet e luftës, në llogoret ku ishim vendosur. Plumbi i dytë e goditi në kreun e ballit. Plumbi krisi sikur të binte mbi një shkëmb. Në këtë kohë Adem Haxhija u rrëzua. Unë isha afër tij-thotë ai-sepse gjithmonë ai më mbante afër. Ademi më donte shumë. Ai ishte një prijnjës i shkëlqyeshëm dhe i dashur.

Në luftë ai jepte gjithmonë kurajo: “Bini bre burra se do të fitojmë! Ta shtyjmë dushmanin përtej trojeve tona! Ta mbrojmë vatanin!” Kur e këshillonin që të ruante kokën dhe të futej në llogore, ai nuk pranonte të futej në llogore dhe na drejtohej: “Mos ta keni merakun tim, ruani krenat tuaja! Mos dilni nga istikamet! Ruani fishekët të mos u shkonjë kot! çdo fishek një dushman i vvarë!” Ai, jo vetëm që merrej me drejtimin dhe organizimin e luftës, por edhe luftonte vetë si një luftëtar i mirë. Ram Nuro Halilaj nga fshati Dragoç na tregoi një herë: “Ishim në front. Qeveria na kishte sjellë disa armë të tipit të ri. Ne kishim huta. Unë kisha dëshirë për të marrë një armë të re dhe me u futë në vijat e para të frontit. Luftëtarët e Drishtit ishin duke marrë armë të reja dhe nga aty kalonin në vijën e parë të frontit. Ademi nuk më la të merrja armë të tipit të ri. Ai më tha: “ - Shko tek shokët, mos merr armë të re! “ - Pse ? - e pyeta unë. - Atë punë e di unë - tha Ademi. Mbas një kohe morëm vesh që Drishti u thye në vijën e parë të frontit dhe na çuan fjalë për t’u shkuar në ndihmë. Ne shkuam menjëherë në frontin ku ishte Drishti dhe së bashku e mundëm dushmanin. Adem Haxhija, kur ishte në front dhe e shikonte që dushmani po përparonte, ai çonte fjalë me korier në Postribë duke bërë thirrje: “Hiq kush të jesh se Adem Haxhija me trimat e Postribës janë në rrezik!” Me këtë thirrje postribasit niseshin në vijën e frontit me ato armë që kishin. Adem Haxhija, para se të nisej për front dërgonte tellallin nëpër katunde të Postribës duke bërë thirrje: “Kush të duan me vdekë për atdhe e fe, hiq kush të jesh!” Më këtë thirrje dilnin trimat e Postribës në frontin e luftës duke menduar se mund të mos ktheheshin më në shtëpitë e tyre.

Kasem Hysen Hysaj nga fshati Myselim na tregon: “Adem Haxhija ka qenë trim, I urtë dhe me ikballë (fat, shënimi im, R. S). Gjithmonë drejtimi i luftës i ka shkuar mbarë. Ishim duke luftuar në Suka të Moksetit. Ne ishim të gjithë nëpër istikame (llogore), ndërsa Adem Haxhija qëndronte në këmbë jashtë istikamit. Mua më donte shumë. Isha shumë i ri atëherë. Ai kishte hapë këmbët në dy anët e istikamit. Unë isha në llogore mes dy këmbëve të tija. çova kokën për të parë përpara, andej nga ishte armiku. Ai më ra kokës dhe më tha: Ule kryet morë kopuk se po të kap ndonjë plumb!” “ - Po ty - i them - a nuk të kap pushka ? “ “ - Mos ta kesh hallin tim more shejtan!” - tha dhe më ra shuplakë kokës për t’u ulur. Adem Haxhija ka qenë njeri shumë i dashur dhe i thjeshtë me njerëzit. Ai mbante vazhdimisht një thupër në dorë kur shëtiste dhe cilindo që takonte në rrugë prej të rinjve i binte me thupër kokës, krahëve ose në çdo pjesë të trupit. Këtë e bënte në formë shakaje ose në formë afrimi e dashurie. Të gjithë e prisnin me respekt e dashuri shakanë e tij. Adem Haxhija ishte një burrë shpatullgjerë dhe nga që ishte shumë i shëndoshë nuk dukej i gjatë shumë. Ai ishte rreth 130 kilogram. Krahët i kishte të shkurtër dhe të trashë. Gjithashtu edhe shuplakën e dorës e kishte të gjerë, të mbushur plot tule dhe ishte e vështirë që ta përzente me dorë, dorën e tij, ndonjë burrë. Ai kishte mustaqe të zeza, të mbushur mirë dhe të lëshuar poshtë në dy anët e gojës deri afër gushës. Sytë i kishte të mëdhenj ngjyrë gështenjë, vetulla të trasha dhe ballin të gjerë dhe të lartë. Man Alush Gruda nga Dragoçi dëftonte: “Kur Adem Haxhija mori dy plagë në Kodrat e Moksetit, e lamë dy ditë pa e nisë për Shkodër, duke e mjekuar në një çadër aty në front. Bajraktari i Hotit, Deli Meta na tha në një mbledhje që u bë me parinë e maleve: “Kena “Orën” të shtruar, nuk kena orë pa te në luftë. Nuk kena çfarë bëjmë as në mbledhje pa te” Ai i jepte Adem Haxhisë një rol hyjnor, duke e quajtur “Orë” që të mbron nga çdo e keqe. Fasli Salo çelaj nga fshati Dragoç dëfton: “U rrethuam në Kodrat e Moksetit nga dushmani. Adem Haxhija kur e pa se gjendja ishte e rëndë më tha: “Merre gyberen time dhe çoje në Kishë të Madhe, vare brenda në kishë!” Unë e mora gyberen e tij dhe e çova në Kishë të Madhe. E vara brenda në kishë siç më porositë dhe u ktheva në frontin e luftës. Sapo arrita unë ja mbërrini edhe Shkodra në ndihmë të Adem Haxhisë. Nga luftëtarët e mora vesh se varja e gyberes së Adem Haxhisë në Kishën e Madhe ishte shenji: “Adem Haxhija me trimat e Postribës është në rrezik me e çartë dushmani.” Gyberen e Adem Haxhisë e njihnin mirë paria e Shkodrës. Man Alush Gruda nga Dragoçi tregon: “Ishim në rrezik në Kodra të Moksetit. Në front drejtonte Adem Haxhija nga Postriba dhe Xhemal Beg Bushati nga Shkodra. Xhemali i tha Adem Haxhisë: “Mbaje deri nesër frontin se nesër do të çoj Shkodrën në këmbë.” Të nesërmen ja mbërrini Shkodra dhe forca të tjera nga Postriba dhe e shtynë dushmanin përtej kufirit.

Ymer Muho Spahija (baba im, R.S) nga Dragoçi tregon: “Kur sulmoi Italia me 7 prill 1939, Adem Haxhija me luftëtarët e Postribës i doli para Italisë në kodrat e Bërdicës për t’i bërë rezistencë. Kapiten Ndrec Prenga me ushtrinë e tij kishte dalë mbrapa forcave popullore të Postribës, në mënyrë që posa të fillonte lufta, ai t’i binte pas shpine Postribës (luftëtarëve të saj). Kur i thanë kapiten Ndrec Prengës: “

Pse na ke vënë mbrapa shpine ushtrinë ?”, ai u përgjigj: “Unë kam menduar për mirë për t’u garantuar ju, por ju mund të rini ku të doni. “ Forcat e Postribës u tërhoqën dhe dolën në Kodra të Tepes e në Kala të Shkodrës. Aty u hap zjarr kundër forcave ushtarake italiane dhe u vranë disa italianë. Në ballë të Urës së Bahçallekut luftoi heroikisht Cen Adem Hasaj nga fshati Boks, i cili, i pajisur me një mitroloz s’e pushoi zjarrin duke bllokuar një ushtri të madhe siç ishte ushtria fashiste italiane. Vetëm atëherë kur i dha urdhër Adem Haxhija që të lëshonte frontin, ai u largua duke lënë të vranë disa ushtarë e oficerë italianë. Për ndalimin e zjarrit u bënë shkak pasanikët e Shkodrës si Sylço Begu e të tjerë. Nga ana tjetër kapiten Ndrec Prenga i tha Adem Haxhisë kur ishin në Kodra të Tepes: “ Adem Aga, nuk është gjë kjo punë, po e shkrehim luftën. Italia është forcë e madhe e nuk luftohet me te. “ - Jo-i tha Adem Haxhija-këtu do të luftojmë për mbrojtjen e vatanit! Këtu do të vdesim!” Por pronarët e Shkodrës u dorëzuan. U dorëzua edhe kapiten Ndrec Prenga me ushtri dhe mbetën vetëm në front forcat e Postribës. Kur e pa këtë Adem Haxhija urdhëroi luftëtarët e Postribës që të ndalonin luftën dhe të kthehen në Postribë. Pas kësaj Adem Haxhinë e lajmëruan miqtë e dashamirët se do ta arrestonin për rezistencën që i ka bërë Italisë. Ai u largua në Jugosllavinë e asaj kohe së bashku me nipin e tij, Mustaf Can Spahija, po atë ditë, me 7 prill 1939. Atje ndejti 2-3 javë. Paria e Shkodrës i çoi fjalë që të kthehej në At dhe pasi ata do ta merrnin në besë se Italia nuk do t’i bënte gjë. Posa u kthye nga ish Jugosllavia, qeveria italiane e arreston dhe e burgos në burgun e Shkodrës. Nga burgu i Shkodrës, ku kishin arrestuar edhe Ymer Beqir Shabaj, po nga Boksi, i internojnë të dy në Kolfiorito të Italisë. Kjo u muar vesh pas rreth 10 ditësh se ai ishte internuar me shumë shqiptarë të tjerë, për rezistencë që i bënë pushtimit fashist. Me te u internuan edhe Abdyl Këllezi, Naim Gjylbegu e të tjerë, gjithsej 22 burra nacionalistë të devotshëm. Në inetrnim u mbajt rreth një vit e pak. Pas një viti Qeveria e Tiranës lajmëroi familjen që të shkonin në Itali për ta marrë Adem Haxhinë. Siç rezultoi më vonë Qeveria Shqiptare duhej të ishte në dijeni nga Qeveria Itaiane se Adem Haxhinë e kishin helmuar me një helm veprues toksik me afat të caktuar. Nga familja e Adem Haxhisë u nisën për Itali Osman Haxhi Spahija dhe Ali Can Spahija. Udhëtimin e bënë me anije nga Durrësi drejt Barit të Italisë. Udhëtimi zgjati 9 orë. Nga Bari deri në Kolfiorito udhëtuan me tren. Adem Haxhinë e gjetën pak të sëmurë. Osman Haxhija tregon: “ Kur erdhëm në Tiranë, Ademi kishte dëshirë për të shetitë çdo vend të Tiranës, sikur donte të merrte mall. Ne i thamë-tregon Osmani-që të kemi marrë për të sëmurë e kur të shohin do të kapin prap.” - Nuk kanë ç’ka më bëjnë-tha Ademi-Në qoftëse nuk më kanë bërë deri tash, as tash e mbrapa nuk më bëjnë gjë më.” Dhe me të vërtetë italianët e kishin kryer misionin e tyre: Nga dita që erdhi në shtëpi Adem Haxhija nuk jetoi më, vetëm 10 ditë. Ditën e dhjetë të kthimit të tij nga Italia, ai mbylli sytë përgjithmonë. “ - Një grua ma dha helmin-tha Ademi pak ditë para se të vdiste, - Unë i kërkova ujë dhe ajo ma sollti gotën me “ujë.” Kur e piva e hetova se ishte i helmuar dhe atëherë e gjuajta atë bushtrën me gotë dhe i thashë: “Më helmove moj bushtrë!” Në Itali kishin bërë përpjekje që ta bënin të nënshkruante se ishte dakord të punonte për fashizmin gjithë jetën në Shqipëri. Adem Haxhija nuk pranoi kurrë të nënshkruante dhe për të ruajtur konspiracionin ata vendosën ta helmonin, dhe kështu bënë. Bajram Musa Spahija dëshmon: “...Sipas një bisede që kam bërë me një burrë të vjetër të shtëpisë së Halil Belit nga fshati Ura e Shtrejtë, i quajtur Avdi Kasemi, rezulton se Bajram Curri ka fjetur në shtëpinë e Halil Belit tre ditë e netë. Ai thonte: “.. Kanë qenë vitet 1919-1920 në muajt prill-maj. Mbaj mend që Bajram Curri gjuajti manin me pushkë dhe u këput dega e manit me gjethe e ra në tokë. Bajram Curri ishte në shtëpinë tonë me nipat e tij, Hysni Curri dhe Hasan Ago Batusha-thotë Halil Beli-Para se me ardhë në Ura Shtrejtë, Bajram Curri me shoqëruesit u takua me Adem Haxhinë në shtëpinë e Ymer Beqirit, në Rrasek të fshtatit Boks dhe bënë besëlidhjen që: “Shqipëria të sundojë vëdin dhe të mos lamë kambë anmiku që të na shklasë vatanin.” Ky material gojor përputhet saktësisht me dokumenta historikë të të njëjtës periudhë dhe konkretisht: Akademia e Shkencave në librin “Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar” -1918-1920 në “Përmbledhje dokumentash I “ në Udhëzimin nr.264-Udhëzime dhe mendime politike të Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” për mënjanimin e pushtimit të Korçës nga ana e forcave ushtarake greke (Udhëzim 264), pika VIII, thuhet: - Duhet me të shpejtë Hysni Bej Currin ta dërgoni kënde...Sepse, në rast që Konferenca do të japë një vendim të kundërt duhet që të nxiten Shala, Shoshi, Postriba, me një fjalë gjithë malësitë e Shkodrës, dhe kështu të formohet një fuqi kombëtare për të mbrojtur Shkodrën kundra fuqive sllave. E për ta përgatitur këtë fuqi duhet medoemos Hysni Beu. Prandaj ai të kthehet pa vonesë në Shkodër...” Ky dokument e vërteton

plotësisht se Hysni Bej Curri ka ardhur në Shkodër dhe ka marrë kontakt me krerët e Shkodrës e të malësive, pra edhe me Adem Haxhinë si komandant popullor i Postribës për të bërë një besëlidhje në mbrojtje të trojeve tona. Në vendimin nr. 330-Vendimi i Komitetit "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" mbi pjesëmarrjen në Kongresin e Krujës, dhe emrat e delegatëve që u zgjodhën." (Vendim nr. 330). Shkodër, 28 dhjetor 1919:

"1

2. Mbas lajmit që kena me marrë prej Hysni Beut kena me i lajmue malet e Postribës se kur me ra në Lesh.

3 Ditën e parë të mbledhjes ka me u vendue që të formohet qeveria e re edhe delegacioni ka me u ndërrue e telegrafi ka me u çue në Shkodër menjëherë për me iu dhanë Parisit.

4. Bedriu ka me u pa me kryeparin e Përlimtares për me u zgjedhë delegatët e Shkodrës..."(E nënshkruajnë H.Kadriu, B. Pejani, S. Nivica, H. Curri etj.) (Akademia e Shkencave, Përmbledhje dokumentash I, f. 404 - 406, 512). AQSH i RPSH. F. K. "MK e KOSOVËS" D.nr. 23. Origj.

Hamdi Bushatit, në "Shkodra dhe motet" vëllimi i parë ka një vlerësim që Hasan Riza Pasha i ka bërë Adem Haxhisë së Postribës dhe konkretisht studiuesi Hamdi Bushati thotë: "Hasan Riza Pasha i deronte shumë guximtarët, madje mund të thuash se i admironte. Tue qenë në banesën e shtabit të tij në zonën e Kirit, i shkoi për një vizitë i quejtuni Adem Haxhija, një nga krerët e Postribës, shi (tamam) në momentin e një dueli të artillerisë me anmikun (të shkoje ditën në shtabin e këtij komandanti ishte rrezik i madh jete). Hasan Rizaja vuni re se Adem it nuk iu tut syni aspak në momentin kur copat e gurëve binin si breshni prej plasjes së predhave të malazezve, kështu Ademin me shokë i deshi shumë." (marrë nga autori turk Nazif A. Kiramettin v. c. f. 362). Hamdi Bushati, "Shkodra dhe motet" vëll. Parë f. 451.

Këtu poshtë do të jap disa vlerësime të prof. dr. Ahmet Osja, mbi personalitetin e Adem Haxhisë, të cilat i ka nxjerrë nga studime të ndryshme tek autorë vendas apo të huaj. Këto vlerësime janë si më poshtë: "...Adem Haxhija rrjedh nga një familje me tradita të shquara patriotike dhe e fisme...Ai merr pjesë në mbrojtje të Shkodrës me 1912-1913.

Princ Danjeli, për rezistencën që i bën pushuesit në Rrethimin e Shkodrës, bashkë me trimat e Postribës, mbasi bie Shkodra, ai urdhëron për djegien e shtëpisë së Adem Haxhisë dhe i merr të gjitha bagëtitë. Po për rezistencë me urdhër të Princit Danjel në Postribë digjen 63 shtëpi, si shenjë hakmarrjeje për Rrethimin e Shkodrës. Adem Haxhija lufton kundër malazezëve në qershor-gusht të vitit 1915. Në vitin 1916-1917 burgoset nga austro-hungarezët për drejtimin e ktyengritjes që organizon kundër tyre. Ai merr pjesë në Luftën e Koplikut me 1920 ku merr disa plagë. Plaga në kokë i mbetet edhe pas vdekjes dhe kjo hetohet kur i bëhet lëvizja e trupit të tij nga varrezat e vjetra në lagjen Sekaj për në Kodër Boks, aty ku janë sot varrezat e Boksit. Pasi plagoset në Luftën e Koplikut, Adem Haxhija dërgohet për t'u kuruar në Shkodër, në shtëpinë e Sokolëve. Atë e vendosin në një dhomë në katin e dytë dhe kur i vijnë mjekët për ta vizituar dhe kuruar, i thonë të zotit të shtëpisë që ta ulnin poshtë pasi lëvizja e dyshemes mund t'i shkaktojnë dëm të madh. I zoti i shtëpisë nuk pranon ta ulnin poshtë sepse Adem Haxhija nuk ishte për ta lënë në dhomat poshtë sepse ishte fyerje për të zotin e shtëpisë po ta gjenin Adem Haxhinë vizitorët e shumë që vinin për ta parë për respekt të trimërive të tij. Ai mori masa të menjëhershme dhe bëri këmbë tullash nga kati i parë deri në të dytin për të mos lejuar asnjë tronditje të dyshemes ku ishte i shtruar Adem Haxhija... Adem Haxhija gradohet nga Mbreti Zog me 1928 me graden kapiten rezervë me të gjitha të drejtat e kapitenit të karrierës... Adem Haxhija organizon qëndresën kundër pushtimit fashist më 7 prill 1939 tek Ura e Bahçallëkut, në Kodra të Tepes dhe në Kodra të Bërdicës. Për këtë rezistencë ai internohet në ishujt e Italisë në vitin 1939. Ai vdes në vitin 1940 në Shqipëri, në shtëpinë e tij, dhjetë ditë pas kthimit nga Italia, dhe i helmuar. Adem Haxhija ka fotografi në fototekën e Marubit, gjithashtu gjenden fotografi të tij si pjesëmarrës në Kuvendet e Xhibalit e të tjera. Për veprën e Adem Haxhisë shkruajnë dy autorë turq, veprat e të cilëve gjenden në bibliotekën "Marin Barleti" në Shkodër.. Për veprën e tij kanë shkruar edhe autorë vendas si Hashim Kopliku, Xhevat Repishti e të tjerë, përfundon vlerësimet për Adem Haxhinë Prof. Dr. Ahmet Osja.---

REVOLUCIONI I QERSHORIT 1924

Ambicja për pushtet dhe përpjekjet për të zëvendësuar politikën kombëtare të Kongresit të Lushnjës me një politikë proitaliane të pjesës tjetër të opozitës (proteksionistët), përbëjnë zanafillën dhe shkakun kryesor të gjendjes destabilizuese edhe konfrontimeve politike të kësaj periudhe. Shkodra ka qenë mbështetja kryesore e revolucionit të qershorit 1924 (pasi kishte më shumë opozitarë se sa nacionalistë, krahu kombëtar). Nga 13 asamblistë që nxori prefektura e Shkodrës, 12 ishin me opozitën. Nga këta, shumicën e përbënte grupi i klerit katolik "Ora e Maleve" (8 asamblistë), ndërsa pjesa myslimane e opozitës kishte në krye Xhemal Bushatin. Shumica e krerëve politikë të Shkodrës kanë qenë në opozicion me kohë...Shumica myslimane në Shkodër e përkrahu këtë politikë. Pjesa më e vogël (myslimanë e katolikë), e lidhur me Zogun ka qenë kundër tyre dhe ishte më e disiplinuar dhe më e vendosur. Pas zgjedhjeve të 27 dhjetorit për Asamblenë Kushtetuese dhe dorëheqjes së qeverisë së Zogut më 25 shkurt 1924, u formua qeveria e re e kryesuar nga Shefqet Bej Verlaci. Si lëshim ndaj kërkesave të opozitës, ai nuk përfshin Zogun në qeveri. Por opozita vazhdoi të jetë përsëri agresive. Për ta qetësuar atë, kryeministri Shefqet Verlaci i dha dy vende në kabinetin e tij, duke e paraqitur atë si qeveri koalicioni. (Dr. Bajram Xhafa, Shkodra në Shekuj, sem. tretë, vëll. parë, f. 195-197). Në varrimin e Avni Rustemit në Vlorë u bë një manifestim politik dhe kryengritës. Mbi varrin e të vdekurit u bë betimi: "Ja ne në fuqi...ja Shqipëria gur e hi." Po aty u krijua "Lidhja ushtarake" prej 4 oficerëve në emër të grup-komandave të ushtrisë dhe të shkollës së xhandarmërisë e cila vendosi: "anullimin e Asamblesë dhe formimin e një qeverie ushtarake" duke patur dhe tre civila brenda saj (ministrin e Arsimit, të Financave e të Drejtësisë). Kjo mënyrë qeverisjeje do të vazhdonte deri sa këta të bënëin zgjedhjet duke patur si komandant të përgjithshëm nënkolonel Rexhep Shalën...(po aty, f. 197). Tek "Hylli i Dritës" i vitit 1924, e përkohshme, periodike, në temën e titulluar "Trazimet e qershorit 1924", del qartë se "Hylli i Dritës" është në opozitë me Ahmet Zogun dhe qeverinë e tij dhe konkretisht ndër të tjera thuhet: "...Ahmet Zogu donte me ia dhanë koncesionin e vajgurit Anglisë, pse shpresonte se Anglia do ta ndihmonte me u ba Princ a Kryetar Republike në Shqipëri...prandaj ishte më mirë me e heqë Ahmet Zogun prej Kryeministrit... ..Jo thonte fronti i zogollistëve, Ahmet Begu asht i meçëm, energjik e oksidental e se prandaj do të bëhet Mbret, Princ, Diktator e gjithshka në Shqipëri... Porsa u mbyll parlamenti, Ahmet Zogu lëshoi zagarët elektoral të vet në katër qoshet e Shqipërisë...rrah, gjobit, burgos malcorë e katundarë të partisë kundërshtare, për me krijue panik, frikë për ditë të zgjedhjeve... ..Por asht fort ma i naltë mendimi i krishtenë: "un punoj për lumni të Zotit, bashkëveproj në mbretni të Zotit, derdhi mund e djersë e shpërblimin më të çmueshëm e pres prej Zotit. Siç shihet "Hylli i Dritës" është periodike e përkposhme katolike që ka qenë në opozitë me partinë e Legalitetit dhe nuk e kanë dashur qeverisjen e Zogut, pasi kanë qenë, siç e thotë vetë artikulli në këtë periodike, opozitarë në përkrahje të Fan Nolit, i cili përbënte krahun e majtë të demokracisë, në atë kohë.(shënimi im, R. S).("Hylli i Dritës, 1924, "Trazimet e qershorit 1924", f. 186-227). Më 2 maj deputetët e opozitës organizuan në Vlorë një kuvend ku morën pjesë 300 vetë. Kuvendi vendosi të mos njihej qeveria e Tiranës. Më 5 maj doli thirrja për kryengritje të armatosur kundër qeverisë nga shoqëria "Bashkimi". Më 6 maj Bajram Curri sulmoi Krumën por u zbraps nga forcat qeveritare të komanduara nga Muharrem Bajraktari. Pas Vlorës dhe Krasniqen edhe Shkodra nuk e njohu qeverinë e Tiranës. Grupi i deputetëve të Opozitës "Ora e Maleve" të Shkodrës bashkë me ministrin Luigj Gurakuqi, që nga Vlora u nisën për Shkodër për të organizuar kryengritjen. (po aty, f. 197-198). Përgatitjet për kryengritje bëheshin si në Vlorë edhe në Shkodër. Më 19 maj Rexhep Shala kishte një fuqi ushtarake në Lezhë, por ishte ndaluar nga autoritetet e vendit në Kakarriq. ***Në Shkodër, Postriba ka qenë me Zogun. Me forcat antiqeveritare u bashkua Bajram Hyseni nga Rrjollli me 300 vetë, për hatër të Sylço Beg Bushatit, me të cilin kishte lidhje.*** Gjithashtu morën pjesë toger Ndok Gjeloshi me 180 shaljanë dhe Dom Loro Caka me 100 malësorë prej Shllakut... Më 27 maj Shefqet Verrlaci dha dorëheqjen. (Dr. Bajram Xhafa, "Shkodra në Shekuj", sem. tretë, vëll. parë, f. 198-199). Hoxhallarët e Shkodrës ishin të ndarë në dy grupe: me opozitën dhe me Zogun.

Më 30 maj, Rexhep Shala dha urdhrin për sulm kundër ndërtesës së prefekturës. Fuqia qeveritare e përbërë prej 125 xhandarësh mbeti me 32 xhandarë, kryesisht nga jugu dhe forcat e Ndrec Prengës prej 15-20 vetësh, xhandarë të paorganizuar.Nga paria e Shkodrës dhe e maleve që morën pjesë në qendresën në prefekturë kanë qenë Sulejman e Hasan Hoti, Selo Drishti, Abdyl e Taip Lluja, Rexhep Suma, etj.

Nga Paria e maleve: Adem Haxhija nga Postriba vetë i shtatë, Vat Mirashi, bajraktar i Shkrelit, Kanto Marashi, Sadri Zeka (Shkreli), Gjon Gjoni prej Grude dhe Ismail Delia,

gjithsej 42 vetë. (Adem Haxhija, si nacionalist dhe mbrojtës i traditave të vjetra patriotike bashkë me burrat e Postribës luftojnë gjatë gjithë natës me vetëmohim e vendosmëri, por kur vritet komandanti i xhandarmërisë ai e sheh se tani ka ardhur momenti për ta ndërprerë luftën dhe për të dorëzuar prefekturën). Dhe vërtetë pas vrasjes së komandantit të xhandarmërisë prefektura u dorëzua. (shënimi im, R. S)

Lufta në prefekturë vazhdoi gjithë natën deri afër mëngjesit. Gjatë luftimeve vritet në dritaren e anës tjetër të fasadës së godinës së prefekturës komandanti i xhandarmërisë Ferit Frashëri. Pas vrasjes së tij, prefektura u dorëzua në bazë të një protokolli dhe si prefekti edhe kryetari i bashkisë Musa Juka u lanë të lirë të shkojnë në Tiranë. (Musa Juka ishte me origjinë nga Postriba, nga Rrashi, i cili kishte dhënë ndihmesën e tij për t'u lidhur Postriba me Zogun dhe "Legalitetin, si forca politike, (shënimi im, R. S)). Forcat opozitare pasi marrin Kalanë e Lezhës nisen për në Tiranë për të marrë pushtetin. Këtu ishin Xhemal Bushati me 300 forca të Rrjollit dhe me dy batalione nën komandën e kapiten Hysni Pejës dhe kapiten M. Rakës, si dhe 180 shaljanë nën komandën e Ndok Gjeloshit. (dr. Bajram Xhafa, "Shkodra në Shekuj", sem. tretë, vëll. parë f. 200-201).

Tek "Hylli i Dritës i vitit 1924, në materialin "Kleri katolik i Shqipërisë e bashkimi i kombit" paraqitet një luftë mes shkollës së Salih çekajve dhe shkollës së Klerit Katolik, të cilat ekzistonin në Shqipëri para Luftës Ballkanike. Artikulli bën fjalë për "Fletoren e Tiranës" e cila shkruante kundër shkollës së klerit katolik dhe gjithashtu kleri katolik i përgjigjej se nuk qëndronte ashtu siç thuhej nga Shkolla e Salih çekajve. Në vitin 1920, thuhet në artikull, serbë e malazezë sulmojnë Shqipërinë në kufijtë veriorë për të pushtuar Shkodrën, dhe arritën deri në Koplik. Lëshohet kushtrimi dhe dalin në vijën e frontit myslimanë e të krishterë dhe nuk lejojnë pushtimin e Shkodrës. Pavarësisht nga shkollat dhe disa drejtues fetarë ekstremistë, në Shkodër ka ekzistuar gjithmonë dashuria dhe respekti i ndërsjelltë mes besimtarëve të tre besimeve. ("Hylli i Dritës", viti 1924, f. 377-381).

DËSHMORËT E ATDHEUT (PATRIOTË) NË RRETHIMIN E SHKODRËS 1912 - 1913

Materiali që do të paraqes më poshtë është marrë në Komitetin e Veteranëve të rrethit Shkodër, në arkivin e këtij komiteti, të cilët janë shpallë me vendim të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të rrethit Shkodër nr. 7 datë 12 janar 1987. Lista e dëshmorëve paraqitet si më poshtë:

1. Myrto Dan Baçja datëlindja 1882, fshati Drisht, rënë në vitin 1913
2. Selim Ram Vulaj datëlindja 1882, fshati Ura Shtrejtë, rënë më 1913
3. Nuh Ahmet çela datëlindja 1865, fshati Drisht, rënë në vitin 1913
4. Abdi Hysen Hysaj datëlindja 1886, fshati Myselim, rënë më 1913
5. Selim Mehmet Dani datëlindja 1890, fshati Myselim, rënë më 1913
6. Selim Bajram Ulikaj datëlindja 1870, fshati Drisht, rënë më 1913
7. Selim Zenel Bibaj datëlindja 1890, fshati Ura Shtrejtë, rënë më 1913
8. Isuf Shaban Dushaj datëlindja 1875, fshati Drisht, rënë në vitin 1913
9. Idriz Bajram Bajraktari datëlindja 1882, fshati Kullaj rënë më 1913
10. Bajram Osman Buhaj datëlindja 1864, fshati Drisht, rënë më 1913
11. Haxhi Hysen Uruçi datëlindja 1870, fshati Domën, rënë më 1913
12. Mdok Mehmet Metaj datëlindja 1892, fshati Vilzë, rënë më 1913
13. Shaban Bajram Fisha datëlindja 1887, fshati Vilzë, rënë më 1913
14. Sait Ramadan Legati datëlindja 1872, fshati Vilzë, rënë më 1913
15. Reshit Beqir Babaj datëlindja 1878, fshati Drisht, rënë në vitin 1913
16. Haxhi Adem Ulikaj datëlindja 1884, fshati Drisht, rënë në vitin 1913
17. Mustaf Hysen çela datëlindja 1882, fshati Drisht, rënë në vitin 1913
18. Haxhi Dosh çela datëlindja 1887, fshati Drisht, rënë në vitin 1913
19. Halil Mehmet çela datëlindja 1867, fshati Drisht, rënë në vitin 1913
20. Lil Nuz Halili datëlindja 1872, fshati Dragoç, rënë në vitin 1913
21. Beqir Mustaf Bushaj datëlindja 1865, fshati Kullaj, rënë më 1913
22. Sulo Ndok Papaj datëlindja 1870, fshati Vilzë, rënë në vitin 1913
23. Liçe Murat Bushaj datëlindja 1875, fshati Drisht, rënë më 1913

- 24.Cen Ymer Frexhaj datëlindja 1882, fshati Vilzë, rënë më 1913
- 25.Abdi Hysen Hyseni datëlindja 1880, fshati Drisht, rënë më 1913
- 26.Halil Mehmet çela datëlindja 1887, fshati Drisht, rënë më 1913
- 27.Selim Bajram Ulikaj datëlindja 1880, fshati Drisht, rënë më 1913
- 28.Arif Hysen Kutureli datëlindja 1885, fshati Domën, rënë më 1913

Shënim: Të gjithë burrat e mësipërm kanë rënë në përpjekje me pushtuesit serbomalazezë në periudhën e rrethimit të Shkodrës në vitet 1912-1913, të cilët kanë qenë të dislokuar në frontin e Myselimit dhe në atë të Bardhanjelit, vend në të cilin është zhvilluar lufta më e ashpër trup më trup dhe bajonetë më bajonetë. Të gjithë luftëtarët e Postribës kanë qenë nën komandën e Komandantit popullor Adem Haxhi Spahija, i cili u shqua në drejtimin dhe organizimin e luftës si një strateg i vërtetë.

DËSHMORË TË ATDHEUT RËNË NË LUFTEN E KOPLIKUT VITET 1919 - 1920

Materiali që po paraqes më poshtë është marrë në Komitetin e Veteranëve, në arkivin e këtij komiteti, të cilët janë shpallë me vendin të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit Shkodër nr. 159, datë 9 dhjetor 1985. Lista është si më poshtë:

- 1.Jonuz Met Xhaferi datëlindja 1882, fshati Ura Shtrejtë, rënë më 1920
- 2.Zeqir Bejto Fiku datëlindja 1897, fshati Ura Shtrejtë, rënë më 1920
- 3.Oso Met Beqiri datëlindja 1892, fshati Drisht, rënë në vitet 1919 - 1920
- 4.Met Isen Bajraktari datëlindja 1891, fshati Grudë, rënë në vitin 1920
- 5.Martin Gjekë Marku datëlindja 1894, fshati Hot i Ri, rënë më 1920
- 6.Lek Keq Luli datëlindja 1894, fshati Hot i Ri, rënë në vitet 1919 - 1920
- 7.Ali Ramadan Hajdari datëlindja 1899, fshati Drisht, rënë në vitin 1920.

Shënim: të gjithë deshmorët e rënë më sipër kanë rënë në përpjekje me forcat pushtuese serbomalazeze në "Luftën e Koplikut" të vitit 1920, të cilët kanë qenë të inkuadruar në frontin e luftës nën komandën e komandantit popullor të Postribës Adem Haxhija (Spahija). Të dy materialet e mësipërme janë nxjerrë nga veteranët Sami Bushati dhe Burhan Bushati, i cili material është arkivuar në arkivin tim personal që gjendet në bibliotekën time. Materiali është firmosur dhe vulosur nga Kryetari i organizatës së familjeve të deshmorëve të atdheut për Shkodrën, zoti Burhan Bushati.

ADEM HAXHIJA DHE BURRAT NË ZË NË KËNGËT E POPULLIT

BARDHANJEL TË RAFTË PIKA!

Ç'ka po thotë ky krajl Nikolla
Për tri ditë nuk merret Shkodra
Për tri ditë Shkodra s'u muar
U muar unit për shtatë muaj
Për shtatë muaj unit asht marrë
Të shtatë krajlrat kanë çue fjalë
Te shtatë krajlrat vajt haberi
Ç'a po thotë Sulltan Mehmeti:
Se në Shkodër u ba gezepi
U ba gezepi e u ba kërdia
Luftë po ban Adem Haxhija
Kërset pushkë, theren sinija
Sjellen shpatat për dekika
Bardhanjel të raftë pika!

Si s'le djalë pa shti ndër thika!?
 Nishanxhia duel Postriba
 Nishanxhia trim i rrallë
“Lamtumirë o nanë e babë
Se unë po nisëm për mos me ardhë!?”
 Ç po thonë nanat e vetë:
 “Se për ju s’po kena dert
 Veç t’na rrojë ky memleqet “
 I biri i knjazit të Malit të Zi
 Fol nji herë ti Adem Haxhi
 “Nuk jam Plavë, nuk jam Guci
 Jam Postriba me djelm të mi!”
 Adem Haxhija me nand varrë
 Dhetë peticat na i ka marrë
 Taraboshi gropa, gropa
 Seç p’e rrahë kaurri me topa
 Se me topa me petica
 Çfarë aletit ka Postriba!?
 Ka mauzerre, ka petica
 Për gjithë shteg gjindet ndër prita
 Kush po i ngjitet njasajë brinjë
 Adem Haxhija me urdi
 Kush po i ngjitet brinjës përpjetë
 Adem Haxhija me treqind vetë
 Krajl Nikolla në Bardhanjel
 Në Bardhaanjel paska qëllue
 Dymbdhjetmijë krajlit sharrue
 Kam ndie krajlit asht idhnue
 Te shtatë krajlit paska shkue
 Po thotë Nemsja ma lësho mue
 Kam ndie buka asht mbarue
 Të shtatë krajlit këtu ça bajnë!?
 Rrethojnë Shkodrën me dënamë
 Me dënamë Shkodra rrethue
 Adem Haxhija i ka diktue
 Adem Haxhija flet një fjalë:
 “Der’ të mos mbesin kurrnji kalë
 Der’ ta hanë i vëllai të vëllanë
 S’e lëshojmë Shkodrën për të gjallë! “

Sqarim Fjalësh:

1. sinija = heshta, shpata
2. dekika = minuta
3. Unit = urie
4. haberi = lajmi
5. nishanxhia = repart vullnetar i vdekjes në luftë
6. memleqet = populli, vendi
7. petica = lloj arme
8. mauzerre = lloj arme
9. alet = vegël, mjet lufte
10. urdi = ushtri
11. dert = gajle, nuk mërzhitet
12. sharrue = vra, gri, mbarue

13.Nemsja = Austria

14.denamë = grup anijësh luftimi

15.diktue = hetue, parë

LUFTA E TARABOSHIT

Adem Haxhija pikë ma i parë

Kah po çon Postribën mbarë

Në Bardhanjel po due me dalë

Sharapnjelat për hava

Rusi i Vogël ikë me gra

Gratë e Shkodrës bajnë kuku!

Na ka ardhë gjaku der' në gju

Bini trima, bini burra!

Mund ta çojmë gjakun te ura

Bini trima pashallarë!

Mund ta çojmë gjakun në Pazar

Nji postribas vjen tue këndue

Lufta e Serbit ka mbarue

Tarabosh t'laça mallkue

Shumë asqerin ma ke farue

Me kalem nuk muj me shkruë

Kush po i ngjitet njasaj brinjë!?

Adem Haxhija me urdi

Kush po i ngjitet brinjës përpjetë

Adem Haxhija me treqind vetë

Hajt e hajt Adem Haxhija

Sa bukur po t'ndjek urdija!

Sqarime fjalësh:

1.Sharapnjela = predha topi

2.Hava = qiell

3.Farue = mbaruar

4.Muj = mundem

TEK SHQIPONJA MBI FLAMUR

Rrugë e gjatë shekuj më shekuj

Pak të gjallë e shumë të vdekur

Në çdo pëllambë gurë e valë deti

Vjen i gjallë amaneti

Ndero trimat e lirisë!

Ndero emrin e Adem Haxhisë!

Për flamurin e Kastriotit

Për flamurin e shqiptarisë

Kanë lidhë besë me burra t' Hotit

Trimat e rrallë të Adem Haxhisë

Porsi bora mbi Cukal

Rrin qeleshja përmbi ball

Rrezja e diellit kur shkrin borën

Me valët e Kirit sjell jehonën

E mos harroni amanetin

Trimat rrojnë e kurrë nuk vdesin

Kalojnë brezat nëpër urë

Gjithë së bashku shkojnë e vijnë

Si shqiponja mbi flamur

Gjallë e gjejnë Adem Haxhinë.

MOJ POSTRIBË...

Moj Postribë vatani jonë
Lufta ty ta ba zakon
Me luftëtar Adem Haxhinë
Ke derdh gjakun për lirinë.
Nandë shtator katërdhetegjashtë
Treqid trima janë mbledhë bashkë
Kanë lidhë besë e janë betue
Komunizmin me e luftue
Brahim Selimi e Metush Alija
Nuk e njohin ku asht frika
Axe e nip janë pushkatue
Dorë për dorë lidhun vargue
Vdesin trimat dorë për dorë
Me plagë në trup e në krahnor
Nuk ndigjojnë me u rrëzue për dhe
Pa kqyrë vendin ku kanë le.
Gjaku i trimave ka skuq tokën
Asht një lajm për gjithë Europën
Komunizmin me e braktisë
Me mbjellë pemën e lirisë..."

KËNGA E ADEM HAXHISË

T'tanë Postriba tre bajrakë
Istikame shkrumb e flakë
Mal me borë kësulen mbi vetull
Djep legjendash në çdo shekull
Trima rriten Drisht e Boks
Që i kanë pritë gjylet me gjoks
S'ta shkruan penda historinë
Pa përmendë Adem Haxhinë
Letër krejt me u ba ky vend
T'tanë atë emën nuk e xen
Emni i tij porsin nishan
Tre bajrakë njat kapidan
Kjoftë për jetë e pahueme
Kur pat nejt Shkodra e rrethue
N'istikame nëpër prita
Nishanxhi ka shkue Postriba
N'Bardhanjel luften me nisë
Nën komandë t'Adem Haxhisë
N'Bardhanjel deri n'Deçiq
Muer nandë plumba por nuk vdiq
Krah për krah me Dedë Gjon Lulin
Përmbi shkamb kanë vu flamurin
Porsi shqipe për hava
Po i çuditë Malet e Mëdha
Kërset pushka në Mokset
Tokë e t'parëve prap e thërret
Qet kushtrim po thërret malësia

Hej ku je Adem Haxhija!
Djalë për derë merre Postribën!
Hasmit bashkë me ja xanë priten.
Vijnë balona, vijnë gjemi
Vjen Italja me ushtri
Del Postriba me shkodranë
Urën hasmit me ja xanë
Si gjithmonë tuj pri në ballë
Komandanti legjendarë
Tek një varr diku n'atë kodër
Porsi shqipe përmbi Shkodër
Rrin ai trim, ai burrë me za
Ku i bajnë malet temena
T' tanë Postriba djalë mbas djalit
S'e harron këtë shqipe malit.
Shkruar nga Kadri Fikaj

KËNGA E ADEM HAXHISË

Male e fusha po thërrasin
Kiri shtrydhet nga mërzia
Kockat në varr token plasin
Hej ku je Adem Haxhija!
Istikamet shkruajnë kujtimet
Vallë ku gjendet "Nishanxhija" ?
Që derdhi gjakun për agimet
Hej ku je Adem Haxhija!
Tahir Haxhija prej Ulqinit
Ku varros gëzimet e tija
Me armët që vari n'gem t' ullinit
Thërret: Ku je Adem Haxhija!?
Thërrasin shpitërat e flijuara
Thërrasin pleqtë, të rinjtë e fëmija
Thërrasin ëndërrat e pa jetuara
Hej ku je Adem Haxhija!
Të nëntë plagët ndër beteja
Plaga e helmit nga Italija
Kërkojnë trimin si rrufeja
Hej ku je Adem Haxhija!
Nuk qe mal ta gërryente koha
Nuk qe ujë ta tretë nxehtësia
Nuk qe burrë ta kalbëte toka
Ti je gjallë Adem Haxhija!

KANGA E YMER BEQIRIT

Nandë shtator dyzetegjashtë
Postriba u dogj flakë
Në mes të natës, në dritë të hanës
Dridhet fëmija në bark të nanës
Kërcet pushka u dha kushtrimi
çohet Mesi e Myselimi
Boks, Dragoç, Kullaj, Rrasek
Nisen burrat si ortek

Komunizmit me i dalë para
Mbi këtë tokë të mos i mbijë fara
Kanë lidhë besen si me le
Gjallë me te s'jetojmë mbi dhe
Flet xhelati Zoi Themeli:
"Del Isen, t' rrinë Ymeri!"
Zot i madh të qofshim lfalë!
Para plumbit babë e djalë.

**Flet xhelati një fytyrë majmunit:
"Thuaje Ymer fjalën e fundit!"**

"- Se drue vdekjen se po vdes
Pritni pak sa të marr abdes!"
"Zjarr!" thot skuadra pushkatimit
Vritet baba në sy të birit
N' shesh të xhamisë para katundit
Pa i pasë frikë kokrrat e plumbit.
O Ymer, biri Postribës!
Trim i rrallë në krahët e shqipes
Trimat kurrë me lot s'janë qa
Se me ta kemë marrë kala.
Rrokullisen gurë e shkrepa
Për këtë trim që u nda nga jeta
Zantë e malit lëshojnë kushtrimin:
" Kush e vrau Ymer Beqirin ?"
Historia për këtë burrë
Është si shqipja mbi flamur
Ky trim zemrat fort na i theri
Bishat vranë ish kapitenin
Kur u vra ky trim i rrallë
Pak pa vdekë foli një fjalë
Zani i tij ushtoi në Kir
Tuj thanë: "Rroftë Shqipnia e lirë!"

KËNGA E ADEM HAXHISË

Adem Haxhija o ka urdhnue
Shpejtni burra o me u bashkue
N'Bardhanjel o më kanë kërkue
O me dekë o me fitue
Nadje heret pa dalë drita
N'kambë asht çue mbarë Postriba
Derdhet gjaku skuqen luginat
N'fushë t'mejdanit o kanë dalë trimat
Adem trimi shumë ka luftue
Hutë as shpatë s'mujten me rrëzue
Me Postribë ai asht betue:
"Tokë pa vdekë kurrë mos me lëshue!"

LUFTA E KOPLIKUT

Doli fjala n'për katunde
Kush të det' me dekë për atdhe
Kapni hutë e xheberhanë!
Po shkojnë lundrat me vaporre
Ra kaçaku në Semebore

Ti kaçak o qofsh i zi!
Sot në Tuz s'po len me shkue
Kaurri Tuzin e ka zaptue
Nuk po njuh trimat shkodranë
Flakë të kuqe e tym të zi
***Kjo Postriba në maje t'Helmit
Në borë e shi si zog gabelit***

Der't'i qesin namin vedit
Ka po mban ti Dan Alija ?
Der' në Tuz më thërret valia
Merr peticat Adem Haxhija
Adem Haxhija djal' prej djalit
Dhetë petica i ka marrë Krajlit
Hamnesha e Krajlit ça ka thanë:
"Treqind lira i kam dhanë
Treqind lira i jap në dorë
Kush t'mi mbysin tre boksorë
Adem Haxhinë vetë të tretin
Sadri Alinë, Brahim Zenelin."
Adem Haxhija burrë i hollë
Ja ka marrë kaçakut n' llogorë
Ty kaçak të raftë pika!
Kurrnji trimit s'ju dha ika
Gjashtë sahat tu' ther me thika
Tanë shehit kanë mbetë te prita.
Sqarime fjalësh:

- 1.xheberhane = arka municioni
2. gabel = arixhinj
- 3.kush të det' = kush të duan
4. hutë = lloj arme e vjetër
- 5.Kaurri = shkjav i Malit të Zi
- 6.Qesin = nxjerrin
- 7.Der = deri
- 8.Petica = lloj arme
- 9.Hamnesha = titull, ofiq i mbretreshës
- 10.Shehit = Deshomë

KËNGË PËR KRYENGRITJEN ANTIKOMUNISTE TË 9 SHTATORIT DHE PËR ISMAIL DULIN

Tanë Postriba tre bajrakë
Nëpër prita nëpër flake
Djal mbas djalit për këtë dhe'
N'luftë me kraja vra e pre'.
N'Baradhnel deri n'Mokset
Toka e t'parëve sa herë thërret
Del Postriba me djelmëni
Si nishan me nishanli
Shkelë fashizmi në Shqipni
Në Dragoç një djalë i ri
Krah për krah ky djal shqiptar
U rreshtu si vullnetar.
Këtij Ismail Duli i thonë n'emer
Atdhetar me shpirt e zemër.

Pritë n'pritë gjithkund po gjindet
Në flakë me ra vetja s'po'i dhimbet
Komunistët kanë maraz
Se Postriba me Kazaz
Me malësorë e me zotni
Tanë për i'fjalë kanë ra n'ujdi.
Me nis pushka në Postribë
Me i ra Shkodrës për një ditë
Se s'durojnë malet robëni
Se do Shkodra këtë parti.
N'shega t'lbros mbi një kodër
Prej ku i sheh kullat n'Shkodër
Paska marrë vendim Postriba
Më hy n'Shkodër pa dalë drita.
Gjithkund pritat kekan xanë
Shenj për zjarr presin me dhanë
Me ça gardh me ça rrethim
Por janë ba planet gabim.
Tuj luftu n'Shkodër atë natë
çeta e vogël me i brigadë
Kërcet pushka dridhet toka
Mitroloza bomba e topa.
Natën Shkodrës ja bajnë ditë
Gjumin idhun ja kanë qitë
Për Ismail Dulin me shokë t'vet
Pushka e tjetrit plumb nuk qet.
Krah për krah me Jonuz Shkrelin
E ka shkri Ismaili qemerin
Njeni qit e tjetri prit
Njeni mbush e tjetri qit.
Ndhimojnë shokët me u tërhekë
Si t'kish prita tridhjetë vetë
Ka marrë vendi ballakam
Jonuz Shkreli mbet i vramë.
Fjalët vonojnë ka marrë vendimin
N'atë dekik me ça rrethimin
Në Golem tuj ça ndër vija
Partizanëve u thot i vija.
Fillë prej tij tu ba me gisht
A e shihni këtë ballist ?
Që po vjen rrugës përpjetë
Asht Ismail Duli dora vetë.
Atëherë Ismaili pa pikë shpresë
Pa ditë kujt me i kërku besë
Tuj pa veten pa rrugëdalje
I lutet Zotit me i ba çajre
Nxjerr kutinë me ba duhan
Bujrum, u thotë, ju partizanë
Si granadë ju a' lëshon ndërmjet
Ata prit se po pëlçet.
Dhe përmbys kanë ra të tanë
Ai shkoi për tjetrës anë
Ka kalu Vrakë e Banush

Pa ja pre rrugën kërkush.
Me gjetë strehë me gjetë konak
Për me dalë malit koçak
Me qitë pushkë me vra partinë
Me ra n'gjak me qeverinë.
Qysh atë ditë me nandë shtator
Nëpër male n'shi e n'borë
Komunistat ku s'kërkojnë
Me gjetë strehen ku jetojnë.
Kur e panë se s'kanë me i xanë
Kanë qit falje për të tanë
Me i pre n'besë me i vu n'pranga
Me i provu vuajtjet e randa.
Fillojnë burgjet e torturat
Kot s'thonë," burgu asht për burrat"
Ma mirë mortja me t'marë shpejt
Kur gjithë vendi burg asht krejtë.
Gjithë ka t'shkosh punën e ke
Me t'pa fytyrë e me t'pa fe
Këmisha n'shtat bahet spiun
E gjithë jeta tmerrë pa fund.
Ku me i shku mendja Ismail Dulit
Se i sheh sherrin Mao Ce Dunit
Se vjen buka gjysmë rracionit
Për ditëlindje t'diktatorit.
Edhe yje, hanë e diell
Edhe zogjtë që shkojnë për qiell
Me t'shku mendja me'i permendë
T'pret burgu e kalbesh mbrendë.
Gjithë ai burg n'diktaturë
Asht një shekull për këtë burrë
Komunizmin kurrë se desht
Kurrë s'i tha shpirtit hesht!
Dhe pse i thanë që je armik
Ai gjithmonë mbeti besnik:
Me flamur me i pri Postribës
N'ballë të frontit kryengritës.

KUSHTUAR ISMAIL DULIT NË KRYENGRITJEN ANTIKOMUNISTE

Asht hapë lajmi anë e mbanë
Tanë Postriba asht çu n'kambë
Treqind burra vullnetarë
N'fushë Shtojit shpejt kanë dale
ç'asht ai trim që rri në ballë
Osman Haxhija trim luftëtar
Ja ka hek dera edhe shtëpia
Thonë asht ngjallë Adem Haxhija.
Po ai trim që rri përbri
Ismail Duli një djal i ri
Fort gjerdanin e ka shtërngu
Thonë se nana ka lind dragu
Janë nis trimat me luftu

Komunizmin për me rrëzu
Mirë e dinë si asht lirija
Me pasë Kisha dhe Xhamija
Ismail Duli me pesëdhjetë
I bjen Shkodrës drejt për drejt
N'Golem t'Shkodrës kur kanë ra
Kanë ra n'pritë e janë rrethu
A me vdekë a me shpëtu
Municioni asht mbaru
Hek kutinë dhe i ka gju
Prita shtri ratë përdhe
Ismail Duli sërish ka le
Iku nata shpejt u gdhi
"Ismail Duli" shkru n'kuti
Trim luftar e burrë me kokë
Shpëtoi veten me gjithë shokë
Ismail Duli trm si zana
S'ka vonu e ka ra mbramja
S'ka nevojë për dëshmitarë
N'kuti emni i ka dalë
Fort torturat ja kanë shtu
Kambë e duer ja kanë coptu
Kur ka dalë nga burgu i shkretë
Se ka njoftë as nana e vet
Pa ju shëndoshë plagët n'trup
Për së dyti ka ra n'burg
Komunizmin s'ja pat anda
Duart e tij janë mësu n'pranga
Historia s'ka mbarim
Janë rrahë tjerë e pushkatu
Për Ismail Dulin kush më pvetë
Burgu shtëpi ja ba përjetë.

KUSHTUAR NANDË SHTATORIT

Zot i madh, në at mengjes heret
Ditë e qetë si ditë pranveret,
Mitrolozi kur kërciti,
Rozafati veç buçiti.
Taraboshi me Rumi
E ndigjuen krismen e tij.
Edhe maja e Maranajt
Lëshoi gjamë si kushtrim vaj't
Gjithçka din me ba shqiptari
Me shue etjen prej barbari
Nuk mbet fis nuk mbet shtëpi
Pa marr pjesë n' ket tragjedi.
Nuk kje grue që mbet pa kja
Kush për burrë e kush për vëlla,
Ulërasin fëmijë e gra
Gjithë atë tmerr kah rrinë tuj pa
Gjithë Postriba fshat për fshat
Që i takoi ky kob për fat,
Në çdo fis, në çdo katund

Ku më pak e ku më shumë.

Burgje, vuajtje, internimit

Të ndamë me gisht prej tanë njerëzimit,

Midis t' gjallëve si t' vdekun

N'ball' e shpinë t' shkrueme " i prekun!"

Mjer ky popull çka ka hjekun!?

"ZANA POPULLORE"

Këtu poshtë do të paraqes disa këngë të mbledhura nga autori Kasem Taipi në librin e tij "Zana Popullore", të cilat kanë lidhje me Postribën dhe trimëritë e saj në mbrojtje të trojeve.

KËNGA E MUSTAF PASHË QORRIT

Kjo këngë i kushtohet të vëllait të Karamahmut Pashës (Veziri i Shkodrës). Mustaf Pashë Qorri ishte shumë trim dhe këte e tregon kënga që i është kushtuar kësaj trimërie: Ajo që meriton të nënvizohet në këtë këngë është në strofën e tretë të saj ku thuhet:

"...Kishte kenë kjo Postriba
Përmbi t' gjithë malet e Malcis
Kryet xuer Selmani
Mori shpaten e llis..."

Vetë kjo strofë e ngre Postribën mbi të gjitha malet e Malësisë, e cila lufton me heroizëm të madh mbi bjeshkët e Grivadolit.

KËNGA E HAXHI ALISË

Kjo këngë i kushtohet Haxhi Alisë, komandant i flotës Turke, i cili luftoi me Flotën Greke kundrejt Sazanit e pas një luftimi të rreptë ai mbetet i vrarë heroikisht. Unë mendoj (shënimi im, R. S) se Haxhi Alija ka qenë me origjinë nga Postriba, nga fisi i Bajraktarit të Boksit, i cili siç dihet edhe nga populli i Postribës, ka kryer Akademinë Ushtarake të Stambollit dhe këtu Komanda Ushtarake Turke e bën Komandant të Flotës Turke.. Në një rën nga shtatë strofat e kësaj kënge thuhet:

"... Ju të shkretë more ulqinakë
Haxhi Alinë ju ç'e batë
Tu shtatë zanat ikët e e latë
Haxhi Alija, shehidi i detit
Shpata e yte lule xhenetit..."

Ai bie heroikisht në përpjekje e sipër me Flotën Greke, ku dhe mbetet i vrarë si hero. (Kasem Taipi "Zana Popullore" f. 48-281)

KËNGA E HAMZ KAZAZIT

Kjo këngë i kushtohet Hamz Kazazit dhe Haxhi Idriz Boksit nga Postriba ky i fundit. Lufta ishte si formë revolte kundër Turqisë, për të fituar disa të drejta prej Portës së Lartë të Stambollit, në kohën e Sulltan Mahmudit. Haxhi Idrizi në atë kohë ishte imam në xhaminë e Ndocajve. Hamz Kazazi dhe Haxhi Idrizi qenë udhëheqësit kryesorë të luftës që ngritën në këmbë gjithë Shkodrën, kundër turqve për mos me hy nizamë (ushtarë).. Grindja zgjati 3 muaj e 10 ditë duke qëndruar edhe Pazari i mbyllur. Në këngë thuhet:

"...Shkodra të venë (të veten) e bani
I erdh hakut osmanllis..."
"...Të shtunen dy fermana
Nji haraç do ta qesin
Aty ndodhne dy asllana

Nuk e lajmë por do të desim(vdesim)..."

Dy asllanat janë Hamz Kazazi dhe Haxhi Idriz Boksi. Istikamet turke ishin të vendosura në breg të Kirit:

"...Duel nizami në breg të Kirit
Se ç'u ndeshen flakë për flakë..."
"...Hafiz Pasha duel në kodra
Shiqon hallkun (njerëzit) me dyrbi:
A s'e shihni ku erdh Shkodra
N' istiqame na paska hi..."

Nën komandën e Hamz Kazazit dhe Haxhi Idriz Boksit lufetarët shkodranë kishin hyrë brenda endrrethimit të ushtrisë turke në breg të Kirit. Më poshtë kënga tregon se Shkodra nuk ishte vetëm në luftë pasi në ndihmë të saj vjen Postriba në ato momente kur asqeri turk i grin batare pushkësh:

"...Në fund të kodrës, në rrugë të madhe
Vijnë shkodranët tuj hallakatë
Asqeri i grinë batare
Postriba i shkon n'imdad
Një sahat pa dalun drita
Ja mërrijni Potriba
Postrriba porsi motit
Me yryç shkuen te topi
Dhanë e dhanë por s'mund t'a murrn.
Haxhi Idrizi kishte thanë:
Do t'i vijë galib halldupit
Nën klyç i preu të tanë
Si në vakt të Kara Mahmudit..."

Shkodrës i shkojnë në ndihmë edhe krahinat e tjera në fushë e malësi:

"...Hot e Krajë, Shalë e Shosh

Postriba me Shkodranë
Yryç bajnë në Tarabosh
Marrin krena e nishanë..."

Hamza Kazazi e Haxhi Idrizi luftojnë aq heroikisht sa që krahasohen me Dasho Shkrelin:

Hafiz Pasha si iblizi
Trim qenka Haxhi Idrizi
Trim qenka he gjetët balanë
Lufton Dashja me të vllanë..."

Dhe në fund kënga mbyllet duke e ngritur Postribën në majat më të larta të trimërisë:

Në Postribë trima pashë
Bashkë me male kahremana
Nizamin e banë helaqë
Morrën rob edhe nishana..."

Kasem Taipi "Zana Popullore" f. 48-281)

Kjo këngë që po paraqesim më poshtë, tregon urdhrin e Smajl Pashës për rrethimin e qytetit. Është koha kur malësorët e Malësisë së Madhe, Postriba, Dukagjini, e të tjerë ngrihen në kryengritje të

armatosur kundër regjimit osman. Smajl Pasha duke parë se kryengritja do të bëhej patjetër, urdhëron ushtrinë të rrethojë qytetin natën, në mënyrë që të mos kenë mundësi për t'i ardhur në ndihmë malësorëve që kishin organizuar kryengritjen. Kryengritësit ranë në përpjekje me ushtri në Vrakë. Kënga e jep këtë betejë kështu:

“...ç’ka kanë malet që shungllojnë ?
Të shkretat Rranxa po luftojnë
Tri taborre po i mbarojnë
Vija e Vrakës u mbush me gjak...”

NË QAFË TË MALIT

“...
Ke un i mjeri jam tue pa,
Se ne shkja na paska vra:
Na kanë vra njat Tahir Gjelin,
Isuf Pulen, Kot Kaçelin,
Qi ma t’mirë djelmt s’ke pse i lypë
Q’m’Qafë të Diellit del n’Postribë
Me ra pre’, e gjanë me rryme,
Turr me u lshue, kalatë me i thye,
Hasmit n’ luftë me i lanë pa krye,
...”

(“Hylli i Dritës, 1030 “Lahuta e Malcisë” f. 286-331).

LUFTA NACIONAL-ÇLIRIMTARE

Populli i Postribës, duke qenë nacionalist në shekuj, dhe gjithashtu duke vazhduar gjatë gjithë historisë së tij luftën për liri, pavarësi dhe sovranitet kombëtar, nuk ngurroi t’i përgjigjej pozitivisht thirrjes për të marrë pjesë në luftë për çlirimin e vendit nga pushtuesit. Nga shpallja e pavarësisë kombëtare në vitin 1912, pas një lufte të gjatë dhe të përgjakshme populli i Postribës u gjend disi i qetë. Por nuk zgjati shumë kjo gjendje sepse në vitin 1916 u pushtua nga Austro-Hungaria. Populli i Postribës nuk e priti mirë këtë regjim ushtarak të pushtimit nga austro-hungarezët dhe menjëherë filloi organizimin për një kryengritje të armatosur, për të cilën nuk do të flas këtu, pasi këtë periudhë e kam trajtuar tek kapitulli “Periudha e Pushtimeve”. Në vitin 1920 në Lushnje u mbajt “Kongresi i Lushnjes”, në të cilin kongres u vendos “Qeveria e Parë Demokratike”. Këtu u mor vendimi që Tirana të shpallej në të njëjtën kohë qytet dhe kryeqyteti i vendit. Nga viti 1920 dhe deri në vitin 1939 pothuajse nuk pati trazime të mëdha, me përjashtim të vitit 1924 me të ashtuquajturin “Revolucioni Demokratiko-Borgjez” që bëri Fan Noli, i cili nuk qe në gjendje ta mbante qeverinë vetëm gjashtë muaj. Pas kësaj periudhe Shqipëria u bë mbretëri me mbret Ahmet Zogun dhe për 15 vjet rresht, deri në vitin 1939, Shqipëria ishte jo vetëm mbretëri por edhe shteti i parë me një demokraci të sistemit perëndimor. Në periudhën mes viteve 1939 dhe 1944, me pushtimin fashist italian dhe me përfshirjen në Luftën e Dytë Botërore, Postriba u tregua e gatshme për t’u vënë në dispozicion të luftës, qoftë me pjesëmarrjen aktive në çetat partizane e më vonë në inkuadrimin në batalione e brigada, qoftë në krijimin e bazave të luftës për strehim, ushqim, pritje e përcjellje e shërbime të tjera në dispozicion të luftës.

Në arteriet dhe venat e Postribës qarkullonte nacionalizmi, lufta për mbrojtjen e identitetit kombëtar, për ruajtjen e pacënuar të besimit, për mbrojtjen e nderit. Vërtetë, populli i Postribës ishte i varfër ekonomikisht, por ishte i pasur në virtyte njerëzore, ishte i pasur në jetën shpirtërore të tij, ishte besnik, mikpritës, dashamirës, i respektueshëm ndaj religjioneve të tjera dhe për çdo njeri të çdo besimi. Ideali kryesor i burrave të Postribës ishte ruajtja e identitetit kombëtar, e besimit dhe e nderit. Në të njëjtën kohë postribasit, duke qenë të lidhur në miqësi dhe dashamirësi me zotërinjtë e Shkodrës, kishin edhe pikëpamjet e tyre nacionaliste për partitë që i shërbenin nacionalizmit dhe kombit të tyre. Partia e Legalitetit dhe e Ballit Kombëtar kishte kohë që ishin formuar dhe kishin influencë të madhe në Postribë, pasi një pjesë e mirë e burrave të Postribës i kishin përqaftuar idetë dhe pikëpamjet e këtyre partive. Fise,

si Fisi i Spahijajve, i Shabajve në Boks, i Muhajve në Kala të Drishtit, i Urajve në Mes, pjesërisht i Mehajve në Ura Shtrejtë, pjesërisht i Hykajve dhe Jukajve në Rrash-Vorfë, pjesërisht i Tyrbetarëve në Drisht, etj. kishin aderuar në Partinë e Legalitetit. Gjithashtu fisi i Celufajve në Dragoç e të tjerë kishin aderuar në Partinë e Ballit Kombëtar. Gjatë viteve 1942-1943 filluan të futen edhe idetë e Partisë Komuniste, e cila ishte themeluar në Tiranë në vitin 1941. Në këtë periudhë bëhej një propagandë e madhe antikomuniste nga dy partitë nacionaliste, ajo e Legalitetit dhe ajo e Ballit, për t'u ruajtur shumë nga ndikimi negativ i kësaj partie, e cila do të rrezikonte pikëpamjet nacionaliste të popullit të Postribës, do të rrezikonte besimin, nderin, familjen në Postribë. Populli i Postribës kishte dëgjuar me kohë për rrezikun që i kanosej mbarë Europës, sepse komunizmi ishte një ideologji me pikëpamje materialiste, antifetare, antikombëtare, antifamilje. Duke qenë e tillë, në antagonizëm të hapur me besimtarët postribas, me popullin, kjo parti shikohej me shumë rezerva dhe me mos besim në të ardhmen e tij.

Gjatë gjithë historisë qindra vjeçare, Postriba u shqua për rezistencën që bëri kundër pushtimit romak, turk, venedikas, serbo-malazezë, italian e gjerman. Ajo asnjëherë nuk u përkul por luftoi me heroizëm në mbrojtje të lirisë, pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit tokësor. Djalëria e Postribës dhe luftëtarët e saj të udhëhequr nga paria e vendit, nga bajraktarët dhe vojvodët, nga komandantët popullorë, nuk e pushuan asnjëherë luftën në mbrojtje të trojeve të veta, në mbrojtje të nderit, të atdheut dhe të kombit shqiptar.

Lufta Nacional-çlirimtare ishte një provë e gjallë e traditave patriotike që kishte trashëguar Postriba në shekuj. Qindra jetë njerëzish u flijuan ndër vite për liri, atdhe e fe. Populli i Postribës u tregua kurdoherë i gatshëm, kur i bëhej thirrje që ekzistenca e kombit dhe e atdheut ishte në rrezik nga pushtuesit e huaj. Lufta Nacional-çlirimtare do të bëhej e besueshme sikur në frontin e luftës të merrnin pjesë të gjitha partitë dhe i gjithë populli pa dallim feje, krahine dhe ideje, ashtu siç ishte vendosur në Konferencën e Pezës. Por Partia Komuniste që gjatë luftës nuk pranoi që të bashkëpunonte me Partinë e Legalitetit dhe atë të Ballit, gjë që linte për të dyshuar shumë. Mjafton të kujtojmë Mbledhjen e Mukjes për ta vërtetuar këtë. Kjo ishte arsyeja kryesore që besimtarët në Postribë dhe të gjithë ata që kishin aderuar në dy partitë nacionaliste, punuan me shumë kujdes në bashkëpunim ose jo me këtë parti. Pati mjaft familje në Postribë që u bënë baza të luftës, e sidomos në zonën fushore ku rreziku ishte më i madh. Familje të tilla ishin në Mes shtëpia e Rustem Haxhisë, në Boks shtëpia e çelë Muratit, e çelë Shabanit, në Dragoç shtëpia e Ram Nuros, e Musa Muhos me vëllezër, e Man Beqirit, e Haxhi Ramos, e shumë shtëpi të tjera në këto fshatra e në fshatra të tjerë, të cilat do të dalin më vonë në material të veçantë. Pati nga ata burra që i pranuan partizanët në shtëpi, i pritën dhe i përcollën, por asnjëherë nuk u bashkuan me pikëpamjet komuniste dhe as nuk pranuan të bashkëpunonin me komunistët. Di një rast kur Qazim Kapisyzi i ka dhuruar Osman Haxhi Spahisë revolver "A. Zog", në shenjë respekti që kishte ndaj tij dhe i ka kërkuar bashkëpunim, por Osman Haxhija i ka kthyer këtë përgjigje: "Të dua dhe të respektoj shumë, të pres në shtëpi dhe të përcjelli si mik, por kurrë nuk do të bëhem me ty sepse je komunist. Unë jam besimtar, besoj në një Zot si besimtar mysliman, ndërsa komunizmi dhe komunistët nuk kanë fe as atdhe, nuk besojnë në Zot, ndaj dhe nuk na bashkon asgjë në pikëpamje. Ne na ndan çdo gjë bashkë dhe nuk na bashkon asgjë".

Një nga fshatrat që iu përgjigj pozitivisht thirrjes së Konferencës së Pezës që populli të merrte pjesë në Luftën Nacional-çlirimtare pa dallim feje, krahine dhe ideje, ishte fshati Ura e Shtrejtë. Në fshatin Ura htrejtë erdhën Isuf Bajraktari, Fahri Ramadani etj. dhe u strehuan në shtëpinë e Ram Metës, Bajram Dukut, Hajdar Lamit.

Ura e Shtrejtë u bë çerdhe e partizanëve. Më vonë erdhën në Ura Shtrejtë shokë të tjerë si çiril Pistoli, Qamil Gavoçi, Reshit Rusi, Gjon Jaku, Ramiz Xhabia, Fahri Ceni, Naim Gjylbegu, Ahmet Haxhia, Ndoc Mazi, Masar Dervishi, Shyqyri Hafizi, Nazmi Dibra, Bahri Xhabia, Faik Metushi, Shaban Arra, Nuro Beqiri etj. Kështu më 10 qershor 1942 u formua çeta e Parë Partizane e qarkut të Shkodrës me komandant Qamil Gavoçin. çeta u formua në Bjeshkë të Bregut. Shembullin e fshatit Ura Shtrejtë ndoqën edhe fshatrat e zonës malore si Domni, Shakota, Vilza etj. Në këto fshatra pati mjaft postribas që morën pjesë aktive me armë në dorë në çetat partizane për çlirimin e vendit, ndërsa në zonën fushore të saj, meqenëse ishin më afër rrezikut dhe nën ndikimin e partive nacionaliste në zonë, numri i pjesëmarrësve në luftë qe mjaft i kufizuar, por këtu u krijuan mjaft baza luftime si traditë e mikpritjes dhe e besës që kishte zona. Këto baza ndihmuan partizanët për të kryer më mirë aktivitetin e tyre patriotik. Partizanët ishin nacionalistë të devotshëm. Ata nuk kishin dalë në mal për të sjellë në pushtet partinë komuniste, as për të sjellë komunizmin, por për çlirimin e vendit nga pushtuesit.

Më poshtë do të paraqes burrat postribas që kanë marrë pjesë në Luftën Nacional-çlirimtare, që kanë qenë aktivistë në favor të kësaj lufte dhe që kanë qenë baza të Luftës Nacional-çlirimtare.

Në librin e Vehbi Fishtës “Portrete dëshmorësh të LANÇ të Shkodrës”, vëllimi II, bëhet fjalë në mes të jerave: për dy luftëtarë postribas që morën pjesë në Luftën Nacional-çlirimtare me armë në dorë deri sa dhanë jetën e tyre duke rënë heroikisht në mbrojtje të lirisë dhe të pavarësisë së vendit. Të tillë ishin dëshmorët e Luftës Nacionalçlirimtare, Rrustem Tahir Quka dhe Sejdin Idriz Dushaj, për të cilët do të flas më poshtë. Por duhet të sqaroj se nuk ishin vetëm këta dy luftëtarë që morën pjesë në këtë luftë. Pati shumë postribas nga zona malore dhe pjesërisht edhe nga fusha që morën pjesë me armë në dorë deri në çlirimin e plotë të atdheut.

Pjesëmarrjen në Luftën Nacional-çlirimtare të burrave të Postribës si dhe kontributin që dhanë në formimin e bazave të luftës, pritjen e përcjelljen, mikpritjen, besën, etj. Postriba e bëri për çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj, për liri dhe pavarësi, për sovranitet kombëtar, për atdhe e fe dhe jo për të sjellë në Shqipëri komunizmin dhe partinë komuniste në pushtet, siç propagandonin komunistët në atë kohë si dhe pas marrjes së pushtetit nga diktatura komuniste. Populli i Postribës është shquar në shekuj si një popull që beson në një Zot, që di të respektojë fenë e vet dhe fetë e besimeve të tjera. Ai nuk e ka ndarë asnjëherë luftën për mbrojtjen e atdheut me luftën për mbrojtjen e fesë. Por kjo nuk do të thotë se Postriba duke qenë në shumicë në besimin islam do të dilte kundër besimit katolik apo atij ortodoks. Për burrat e Postribës ka ekzistuar vetëm një ndarje: besimtarë dhe jo besimtarë. Të gjithë besimtarët, qofshin këta myslimanë, katolikë apo ortodoksë për postribasit ishin të gjithë të njëjtë, besimtarë dhe si të tillë kishin një lidhje të përbashkët. Ndaj e them me përgjegjësi se në Postribë nuk ka patur asnjë besimtar apo besimtare që ka luftuar për të sjellë komunizmin në Shqipëri. Kjo është aq e vërtetë sa që në vitin 1946 u kurorëzua dhe u vërtetua ajo për të cilën aspironte Postriba.____

PARTIZANË TË LUFTËS NACIONALÇLIRIMTARE TË POSTRIBËS, GJATË PERIUDHËS 1942-1945

Këtu poshtë do të paraqes listën e emrave të të gjithë partizanëve të Postribës që kanë marrë pjesë në Luftën N.ç. Lista është marrë në arkivin e veteranëve të Luftës Nacional-çlirimtare nga kryetari i veteranëve, zoti Qemal Llazani. Sipas bisedës që kam bërë me kryetarin e veteranëve të rrethit Shkodër, zotin Qemal Llazani, lista mund të ketë edhe ndonjë pasaktësi apo ndonjë gabim që mund të jetë bërë gjatë punës në arkiva. Gjithashtu mund të ketë edhe partizanë që kanë marrë pjesë në luftë por nuk janë pasqyruar në këtë listë. Për këtë arsye menduam me kryetarin që lista të saktësohet me burra të vjetër të çdo fshati për të nxjerrë të vërtetën. Partizanët e Postribës sipas kësaj liste janë si më poshtë:

1. Ahmet Gjeto Guri, datëlindja 1920, fshati Domën
2. Avdyl çel Boksi, datëlindja 1921, zona Postribë
3. Avdyl Hys Mataj, datëlindja 1921, fshati Shakotë
4. Beshir Met Namja (Jeremija), datëlindja, 1917, fshati Domën
5. Bajram Duk Mehaj, datëlindja 1920, fshati Ura e Shtrejtë.
6. Dan Mehmet Kurtaj, datëlindja 1918, fshati Ura e Shtrejtë.
7. Faik Isa Metushi, datëlindja 1923, fshati Myselim (Shkodër).
8. Haxhi Ali Osmani, datëlindja 1904, fshati Ura e Shtrejtë.
9. Hysen Zenel Mehaj, datëlindja 1917, fshati Ura e Shtrejtë.
10. Hajdar Lan Lumaj, datëlindja 1907, fshati Ura e Shtrejtë.
11. Halil Ibrahim Hetaj, datëlindja 1924, fshati Vilzë.
12. Halil Shaban Mehaj, datëlindja 1918, fshati Ura e Shtrejtë.
13. Hysen Imer Mataj, datëlindja 1913, fshati Shakotë.
14. Hajdar Zenel Mehaj, datëlindja 1904, fshati Ura e Shtrejtë.
15. Hazir Idriz Bibaj, datëlindja 1904, fshati Ura e Shtrejtë.
16. Halil Zeqiri, datëlindja 1910, fshati Ura e Shtrejtë.
17. Hamdi Reshiti, datëlindja 1919, fshati Drisht
18. Ismajl Met Mataj, datëlindja 1918, fshati Shakotë.
19. Jaho Ibrahim çujaj, datëlindja 1910, fshati Ura e Shtrejtë.

20. Kasem Imer çujaj, datëlindja 1927, fshati Ura e Shtrejtë.
21. Myrto Caf Quka, datëlindja 1920, fshati Domën.
22. Mustaf Adem Rrëmolla, datëlindja 1914, fshati Ura e Shtrejtë.
23. Murat Muho Buhaj, datëlindja 1907, fshati Drisht.
24. Nuro Beqir Beshaj, datëlindja 1890, fshati Drisht.
25. Nel Haxhi Mataj, datëlindja 1920, fshati Shakotë.
26. Nikoll Pal Vathmrija, datëlindja 1918, fshati Vilzë
27. Nikë Lulash Preka, datëlindja 1923, fshati Sumë.
28. Ramadan Brahim Vuli, datëlindja 1922, fshati Ura e Shtrejtë.
29. Rexhep Brahim Buhaj, datëlindja 1922, fshati Drisht.
30. Rrustem Tahir Quka, datëlindja 1910, fshati Domën.
31. Ramadan Fasli Alija, datëlindja 1928, fshati Myselim.
32. Rexhep Met Mataj, datëlindja 1918, fshati Shakotë.
33. Rasim Rac çelaj, datëlindja 1922, fshati Dragoç.
34. Selman Dul çela, datëlindja 1893, zona Postrribë.(Shkodër)
35. Sadik Haxhi Ndrejaj, datëlindja 1925, fshati Ura e Shtrejtë.
36. Sadik Zenel Hysaj, datëlindja 1923, fshati Myselim.
37. Selim Dul çela, datëlindja 1898, zona Postrribë.(Shkodër)
38. Ismajl Met Mataj, datëlindja 1922, fshati Shakotë.
39. Taip Kasem Hysaj, datëlindja 1921, fshati Myselim.
40. Tomë Ndok Dema, datëlindja 1926, fshati Sumë.
41. Tahir Shaban Luma, datëlindja 1920, fshati Ura e Shtrejtë.
42. Veli Reshit Buhaj, datëlindja 1923, fshati Drisht.
43. Xhemal (Xhem) Idriz Bibaj, datëlindja 1916, fshati Ura e Shtrejtë.
44. Zekë Bajrami, datëlindja 1921, fshati Derraj.
45. Haxhi Ali Logja, dalë nga verifikimi fshati Ura e Shtrejtë
46. Tahir Shaban Mesi, dalë nga verifikimi fshati Ura e Shtrejtë.
47. Adem Sadik Pepaj, dalë nga verifikimi fshati Shakotë.
48. Can Met Mehaj, dalë nga verifikimi fshati Ura e Shtrejtë.

AKTIVISTË NË FAVOR TË LANÇ

Në zërin aktivistë në favor të Luftës Antifashiste Nacional-çlirimtare futen shtëpitë që kanë qenë baza të luftës N.ç.L. aktivistë dhe aktiviste të luftës, si korrierë, strehues, shoqërues të partizanëve etj. Ashtu si partizanët, edhe aktivistët në favor të luftës N. ç.L. janë nxjerrë në arkivin e Komitetit të Veteranëve të rrethit Shkodër, nga kryetari i veteranëve, zoti Qemal Llazani. Lista edhe këtu mund të ketë gabime gjatë regjistrimit në arkiv ose gjatë nxjerrjes nga arkivi, ndaj është lënë me kryetarin e veteranëve që lista të saktësohet nëpërmjet pleqve të secilit fshat, të cilët e dinë më saktë gjendjen. Aktivistët sipas kësaj liste janë si më poshtë:

1. Adem Sadik Pepa fshati Shakotë
2. Ahmet Bajram Shullani fshati Domën
3. Arif Lut Braci fshati Domën
4. Ali Met Nemja fshati Domën
5. Ali Reshit Muhaj fshati Drisht
6. Ali Adem Tusha fshati Domën
7. Ali Fasli Ligata fshati Vilzë
8. Avdyl Hasan Mataj fshati Shakotë
9. Avdi Cul Bregu Bruçaj Sumë
10. Ahmet Kasem Elezi fshati Bruçaj Sumë
11. Bisho Dul Duli fshati Shakotë
12. Baftë Ymer Bracaj fshati Kullaj
13. Brahim Haxhi çallaj fshati Mes
14. Bajram Avdyl Ndrejaj fshati Ura e Shtrejtë.

15. Brahim Haxhi Selimi fshati Ura e Shtrejtë
16. Cuf Nut Fikaj, fshati Ura e Shtrejtë
17. çelë Shaban Repaj fshati Boks
18. çelë Zenel Hysaj fshati Myselim
19. çelë Halil Përroni, fshati Drisht
20. Dyl Hasan Malaj fshati Ura e Shtrejtë
21. Dervish Dul Alija fshati Shakotë
22. Dervish Haxhi Rrëmolla fshati Ura e Shtrejtë
23. Dervish Pepa fshati Shakotë
24. Elez Brahim Dushaj fshati Drisht
25. Fasli Selman Mehaj fshati Ura e Shtrejtë
26. Fasli Rrusto Alija fshati Myselim
27. Fahrije Hajdar Arra fshati Ura e Shtrejtë
28. Fate Halil Metushi fshati Myselim
29. Fatime çel Rrëmolla fshati Ura e Shtrejtë
30. Gjylje Dul Haxhija fshati Drisht
31. Gjyze Sal Curri fshati Boks
32. Gjyze Ram Selimi fshati Ura e Shtrejtë
33. Hajrije Lan Frezaj fshati Vilzë
34. Halil Brahim Lisaj fshati Vilzë
35. Hake Zenel Rrëmolla fshati Ura e Shtrejtë
36. Halil Cen Papaj fshati Vilzë
37. Haxhi Kasem Buhaj fshati Drisht
38. Hane Met Mehej fshati Ura e Shtrejtë
39. Haxhi Ali Osmani fshati Ura e Shtrejtë
40. Hajdar Isuf Lisi fshati Vilzë
41. Hasan (Can) Met Mehaj fshati Ura e Shtrejtë.
42. Hajdar Zenel Mehja fshati Ura e Shtrejtë
43. Isuf Muhamet Shaba fshati Vilzë ? (Nuk kam arritë ta verifikoj).
44. Isuf Hasan Frezaj fshati Vilzë
45. Jonuz Bisho Tusha fshati Domën
46. Jaho Brahim Kasemi fshati Ura e Shtrejtë
47. Kasem Manush Mehaj fshati Ura e Shtrejtë
48. Laje Haxhi Lumaj fshati Ura e Shtrejtë
49. Lan Deli Pepaj fshati Shakotë
50. Mus Zenel Shullani fshati Domën
53. Mem Ram Mehaj fshati Ura e Shtrejtë
54. Mehmet Ram Halaj fshati Dragoç
55. Mat Lic Mataj fshati Shakotë
56. Mejreme Fasli Bajraktari fshati Boks
57. Maje Rexhep Guri fshati Domën
58. Met Hasan Mehja fshati Ura e Shtrejtë
59. Met Zeqir Hysa fshati Drisht
60. Murat Muho Buhaj fshati Drisht
61. Mehmet Ali Sykaj fshati Ura e Shtrejtë
62. Manush Can Dushaj fshati Drisht
63. Nuriye Cuf Sykaj fshati Ura e Shtrejtë
64. Qerim Hajdar Kutureli fshati Domën
65. Qerim Rrustem Frezaj fshati Vilzë
66. Ram Fasli Curri fshati Drisht
67. Rexhep Salo Pepaj fshati Shakotë
68. Ram Met Mehaj fshati Ura e Shtrejtë
69. Rabije Shaqir Koprati zona Postribë

70. Rexhep Has Guri fshati Domën
71. Ramadan Ferhati fshati Domën
72. Ruzhe Caf Dushaj zona Postrisë
73. Riza Fasli Mehaj fshati Ura e Shtrejtë
74. Ragip Sejdi Agrepi fshati Domën
75. Ram Selim Ulikaj fshati Ura e Shtrejtë
76. Rexhep Met Mehaj fshati Ura e Shtrejtë
77. Ramadan Fasli Alija fshati Myselim
78. Ram Mustaf Dusha fshati Drisht
79. Rustem Ismajl Curri fshati Drisht
80. Rrukë Caf Pepa fshati Shakotë.
81. Rrukije Cani fshati Ura e Shtrejtë
82. Rasim Rac çelaj fshati Dragoç
83. Rustem Tahir Quku fshati Domën
84. Sibe Caf çallaj fshati Drisht
85. Sutë Mustaf Cuja fshati Ura e Shtrejtë
86. Sutë Adem Rrëmolla fshati Ura e Shtrejtë
87. Sutë Osman Reka fshati Domën
88. Sejdi Idriz Dushaj fshati Drisht
89. Sutë Haxhi Mataj fshati Ura e Shtrejtë ? (Nuk kam arritur ta verifikoj).
90. Sadik Haxhi Avdyli fshati Ura e Shtrejtë
91. Sutë Sait Dushi fshati Dragoç
92. Selim Kurt Burgaj fshati Drisht ? (Nuk kam arritur ta verifikoj).
93. Shaban Halil Tyrbetari fshati Drisht
94. Shaqir Met Namja fshati Domën
95. Fatime Cen Ulikaj fshati Ura e Shtrejtë
96. Fahri Met çallaj fshati Mes
97. Tahir Shaban Meti fshati Ura e Shtrejtë
98. Naçe Dervish Shullani fshati Ura e Shtrejtë
99. Veli Mehmet Mesi fshati Ura e Shtrejtë
100. Xhemal Idriz Bibaj fshati Ura e Shtrejtë
101. Zade Can Mehaj fshati Ura e Shtrejtë
102. Zek Bajram Shullani fshati Mes
103. Zykë Can Lacaj fshati Drisht
104. Zenel Brahim Hasaj fshati Dragoç
105. Zade Reshit Buhaj fshati Drisht
106. Zuke Mustaf çujaj fshati Ura e Shtrejtë
107. Gjyze Salo Avdyli, dalë nga verifikimi fshati Ura e Shtrejtë
108. Mine Ram Mehaj, dalë nga verifikimi fshati Ura e Shtrejtë
109. Putë Zenel Rrëmolla, dalë nga verifikimi fshati Ura e Shtrejtë
110. Kasem Manush Rrëmolla, dalë nga verifikimi fshati Ura e Shtrejtë.
111. Bicel Haxhi Rrëmolla, dalë nga verifikimi fshati ura e Shtrejtë.
112. Fatime Haxhi Avdyli, dalë nga verifikimi fshati Ura e Shtrejtë.
113. Bushe Ahmet Lumaj, dalë nga verifikimi fshati Ura e Shtrejtë.
114. Zade Cen Mehaj, dalë nga verifikimi fshati Ura e Shtrejtë.
115. Musa Muho Spohija, marrë të dhënat nga Dega Usht. Shkodër
116. Rexhep Sadik Hasaj, marrë të dhënat nga Dega Ushtarake Shkodër
117. Zeqir Muho Spahija, marrë të dhënat nga Dega Ushtarake Shkodër
118. Bedrije Cen Spahija, marrë të dhënat nga librezat e veteranit të luftës.

BAZAT E LUFTËS ANÇ

MIRATUAR ME VENDIM TË KOM. EKZ. TË RRETHIT SHKODËR

Shënim: Bazat e Luftës Antifashiste Nacional-çlirimtare janë miratuar me vendimet e Komiteti Ekzekutiv të rrethit Shkodër si më poshtë: Vendim i Komitetit Ekzekutiv nr. 19 datë 24 shkurt 1976, miratuar pllaka, aza të luftës etj. si më poshtë:

1. Zek Bajrami fshati Derraj
2. Ali Meta fshati Domën
3. Ahmet Gjetja fshati Domën
4. Caf Salihi fshati Shakotë
5. Din Mustafa fshati Vukaj (Muri Turkut)
6. çel Shabani fshati Boks
7. Isuf Hasani fshati Vilzë

Vendim i Komitetit Ekzekutiv nr. 86 datë 6 prill 1978, miratuar pllaka, baza të luftës etj. si më poshtë:

8. Arif Lut Bracaj fshati Domën
9. Lic Hysen Kutureli fshati Domën
10. Ali Fasli Legata fshati Vilzë
11. Halil Shabani fshati Ura e Shtrejtë
12. Bajram Avdyli fshati Ura e Shtrejtë

Vendim i Komitetit Ekzekutiv nr. 19 datë 26 dhjetor 1980, miratuar pllaka, baza të luftës etj si më poshtë:

13. Haxhi Ali Logja fshati Ura e Shtrejtë
14. Veli Osman Kulla fshati Domën
15. Rrustem Tahir Quku fshati Domën
16. Hajdar Lami fshati Ura e Shtrejtë
17. Can Meti fshati Ura e Shtrejtë
18. Mustaf Ademi fshati Ura e Shtrejtë
19. Hajdar Mehja fshati Ura e Shtrejtë
20. Bajram Mehja fshati Ura e Shtrejtë
21. Dervish Rrëmollaj fshati Ura e Shtrejtë
22. Kasem Imeri fshati Ura e Shtrejtë
23. Cuf Fikaj fshati Ura e Shtrejtë ?
24. Ram Selimi fshati Ura e Shtrejtë
25. Islam Mataj fshati Shakotë
26. Avdyl Mataj fshati Shakotë
27. Taip Haxhija fshati Drisht
28. Murat Muhja fshati Drisht
29. Veli Buhaj fshati Drisht
30. Dervish Pepaj fshati Shakotë
31. Zenel Mataj fshati Shakotë
32. Ramadan Mataj fshati Shakotë
33. Hasan Frexhaj fshati Vilzë
34. Halil Cen Papaj fshati Vilzë
35. Tahir Muhaj fshati Drisht
36. Elez Dushaj fshati Drisht
37. Kasem Imer Curri fshati Drisht
38. Ram Curri fshati Drisht
39. Zade Bushaj fshati Drisht
40. Met Tyrbetari fshati Drisht
41. Ramush Dushaj fshati Drisht
42. Hysen Dushaj fshati Drisht
43. Ismajl Kulla fshati Drisht
44. Demir Pepaj fshati Shakotë
45. Ismajl Isaj fshati Shakotë

- 46. Muho Pepaj fshati Shakotë.
- 47. Ali Brahimi fshati Vilzë
- 48. Hysni Dushaj fshati Drisht
- 49. Kasem Imeri fshati Drisht
- 50. Nasuf Nuro Halilaj fshati Dragoç

TË BURGOSUR POLITIKË NDIHMUAR LUFTEN N.ÇL.

Të burgosurit politik, të cilët kanë qenë aktivistë në ndihmë të Luftës Nacionalçlirimtare janë marrë në Komitetin e Veteranëve, të cilët janë nxjerrë nga arkivat prej kryetarit të këtij komiteti, zotit Qemal Llazani. Lista paraqitet si më poshtë:

1. Ali Selman Braci, fshati Domën, dënuar nga 7 / 9 - 10 / 11 / 1943
2. Ahmet Gjeto Burgaj fshati Domën, dënuar nga 7 / 9 / - 10 / 11 / 1943
3. Ali Adem Tusha fshati Mes, dënuar nga 25 / 3 - 10 / 5 / 1943 ?
4. Reshit Met Namja fshati Mes, dënuar nga 4 / 9 - 10 / 11 / 1943 ?
5. Bel Shaban Jeremia fshati Domën, dënuar nga 7 / 9 / - 10 / 10 / 1943
6. Beshir Met Namja, fshati Domën, dënuar nga 10 / 11 / - 20 / 12 / 1943
7. Fatime Col Rrëmolla fshati Ura e Shtrejtë, dënuar qershor 1943
8. Mehmet Hysen Braci, fshati Domën, dënuar nga 10 / 11 - 30 / 12 / 1943
9. Irvan Rexhep Medeli fshati Domën, dënuar nga 10 / 11 - 30 / 12 / 1943
10. Muho Turk Guri fshati Domën, dënuar nga 7 / 9 - 10 / 11 / 1943
11. Ram Met Mehaj fshati Ura e Shtrejtë, dënuar më 13 / 10 / 1940.

KRYENGRITJA ANTIKOMUNISTE E POSTRIBËS

Studiuesi Ahmet Bushati, duke folur për Kryengritjen e 9 shtatorit të Postribës në librin e tij “Në gjurmë të një ditari”, në mes të tjerave thotë: “ **Postriba e lidhur me Shkodrën gjithë jetën, kishte qenë e pranishme në të gjitha ngjarjet e saj të rëndësishme.** Duke mos u thelluar në histori, gjatë së cilës postribasit dëshmojnë se shquhen për besë, trimëri e atdhe, mjafton të kujtojmë vetëm disa prej momenteve nga historia e vonë e saj, për të provuar sa më sipër. **Kanë qenë postribasit ata që më 1835, të udhëhequr nga Hamza Kazazi, patën mbështetur kryengritjen kundër turqve, për të cilën flasin vargjet e një kënge:**

**“Dy sahat pa dalë drita
la mbërrijti Postriba
Postriba si gjamë moti
Me yryç po shkon te topi...”**

Vargje këto që tingëllojnë si një refren i përhershëm i saj, sepse sa herë që Shkodra do të ishte përfshirë në ngjarje me rëndësi, Postriba do t’iu gjindte pranë. Kështu me 1913, kur Shkodra ishte e rrethuar nga të gjitha anët për gjashtë muaj rresht prej forcave serbo-malazeze, që e sulmonin pa pushim ditën e natën, **postribasit nën udhëheqjen e trimit të tyre Adem Haxhija, do të zhvillonin beteja të vërteta, midis të cilave ajo e Bardhajve, aq shumë e përgjakshme kishte qenë, sa që lufta do të zhvillohej trup më trup dhe bajonetë më bajonetë.. Po ashtu, përsëri me në krye Adem Haxhinë, në vitin 1920, në luftën e Koplikut e pikërisht në atë te Moksetit, postribasit do të kryenin akte të rralla trimërie.** Kishin qenë postribasit ata, që në ndonjë rast, me praninë e tyre në Shkodër, kishin shmangur ndoshta plaçkitjen e saj. Edhe në javën e parë të prillit 1939-ës, në atë vigjilje të zezë të pushtimit të Shqipërisë prej Italisë, **Adem Haxhija me 300 postribas, do të zinte pritë në kodrat e Bërdicës, (edhe në Tepe e te Ura e Bahçallëkut, shënimi im, R. S). (Ahmet Bushati, “Në gjurmë të një ditari” f. 114).**

Për kryengritjen antikomuniste të Postribës, të 9 shtatorit, të vitit 1946 kanë shkruar mjaft autorë, por më të rëndësishmit, për aq sa kam njohje unë janë profesor Uran Butka në librin “Ringjallja” nën titullin

“Kryengritja e Postribës” dhe Ahmet Bushati në librin “Në gjurmë të një ditari” nën titullin “Kryengritja e Postribës”.

Postriba është një zonë etnikisht e pastër dhe autoktone në trojet e veta. Ajo përbëhet në shumicën e popullsisë të besimit mysliman, duke përfshirë edhe disa pakica të besimit katolik, pjesa më e madhe e tyre kushërinj me myslimanë. Të gjithë banorët janë autoktonë vendas, qoftë ata të zonës malore, qoftë ata të zonës fushore. Pothuajse të gjithë banorët myslimanë e katolikë janë besimtarë sepse besojnë në një Zot dhe kanë gjak të përbashkët.

Përveç dy autorëve që përmenda më sipër, për Kryengritjen antikomuniste të 9 shtatorit ka shkruar edhe Caf Jonuzi në librin e tij “Krushqit e Lirisë”, i cili ndër të tjera thotë: “...Shumë postribas u bashkuan me Luftën Antifashiste, bile çeta e Parë u krijua këtu më 10 qershor 1942, që është e para në Shqipërinë e Veriut. Luftëtarë të rrymave të ndryshme politike luftuan deri në çlirimin e Shqipërisë të bindur se po i bënin shërbimin e duhur kombit. Mirëpo shpejt u pa se sa “popullor” qe ky regjim. Në rrethin e Shkodrës (Koplik e Këlmend) ushtria Nacional-çlirimtare shtypi egërsisht dy lëvizje popullore. Meqë kufiri qe i mbyllur, shumë malësorë e të tjerë, endeshin maleve, në pritje të një organizimi tjetër antikomunist. Kjo u realizua më 9 shtator 1946 në zonën e Postribës. Këtu ishin bërë disa përgatitje paraprake dhe gjithashtu ishte marrë fjala edhe e disa fiseve të tjera të Veriut.”

Në mbrëmjen e 8 shtatorit 1946, në fshatin Mes (këtu me sa duket Caf Jonuzi nuk e ka të qartë se ku u bë mbledhja, pasi ajo u bë në Boks të Postribës në vendin e quajtur “Shegat e Ibros”, shënimi im R. S) të Postribës organizohet një mbledhje me pjesëmarrjen e parisë së vendit dhe të ilegalëve nga Shkodra. U mor në diskutim situata e vendit që sa vinte e rëndohej, terrori që ushtrohej mbi popullin e pafajshëm dhe mbi të gjitha për planin e qeverisë për mobilizimin e përgjithshëm të popullatës, çka nënkuptonte se forcat kryengritëse do të ishin të pakta. (Siç duket qeveria ishte në dijeni të këtyre planeve). Kjo edhe ishte arsyeja që lëvizja shpërtheu para kohe. (Menjëherë qenë dërguar korrierë për të njoftuar Malësinë e Madhe, Dukagjinin, Zadrimën e vetë qytetin).

(Unë e kam thënë edhe në një vend tjetër se Kryengritja e 9 shtatorit 1946 ishte e parashikuar të bëhej më vonë, por jam me atë që thotë edhe Caf Jonuzi, se qeveria ishte në dijeni të organizimit të kësaj kryengritjeje, ndaj dhe mori masa që ta provokonte më parë dhe të parandalonte rrezikun e madh që mund të ndodhte më vonë me kryengritjen e përgjithshme që do të bëhej në shkallë vendi. Është pikërisht plani i qeverisë për mobilizimin e përgjithshëm të popullatës, që do të detyronte Postribën të binte në kurthin e bishës komuniste, për ta shpejtuar datën e kryengritjes, në mënyrë që të mos binte pjesëmarrja në këtë kryengritje. çdo gjë këtu duket qartë si rrezja e diellit mbi planin djallëzor të mobilizimit të përgjithshëm të popullatës që do të organizonte Partia Komuniste. Nuk përjashtohet mundësia që forcat e sigurimit të shtetit komunist të kenë futur agentët e tyre në pjesëmarrjen e kësaj kryengritje. Pritja në heshtje e qeverisë, ashtu si ujku që rri në qetësi në pritje duke ruajtur prenë e tij, duke bërë të paditurën si dhe plani për mobilizimin e përgjithshëm janë dy argumente të forta që dëshmojnë se qeveria ishte në dijeni se çfarë do të ndodhte. Pra, qeveria dhe Partia Komuniste i kishin ndërtuar mirë planet e tyre për të parandaluar përmbysjen e pushtetit terrorist të tyre, shënimi im, R.S.).

Enver Hoxha në Kongresin e Parë të Partisë Komuniste Shqiptare do të deklaronte: “Lëvizja e 9 shtatorit ishte një nxitje e drejtpërdrejtë e anglo-amerikanëve, ku merrte pjesë aktivisht edhe grupi i deputetëve radhtarë, nëpërmjet deputetit tradhtar Riza Dani, në lidhje me të arratisurit si Jup Kazazi etj. Më 9 shtator 1946, mbi 450 vetë të armatosur e të paarmatosur, godasin qytetin e Shkodrës në tre drejtime. Qëllimi i sulmit ishte propaganduar si pikënisje e ndërhyrjes ushtarake anglo-amerikane në Shqipëri. U vranë 33 pjesëmarrës, u pushkatuan 8 vetë dhe 200 të tjerë u dënuan me burg”. (Caf Jonuzi “Krushqit e Lirisë”).

Në materialin që do të paraqes për Kryengritjen antikomuniste të Postribës do të mbështetem ryesisht tek Uran Butka dhe Ahmet Bushati, të cilët janë përpjekur për të bërë një punë serioze në paraqitjen me saktësi të kësaj kryengritje, e cila pati një rëndësi shumë të madhe për kohën që u krye.

Postriba me dhjetë fshatrat e saj, shtrihet në verilindje të Shkodrës, në një fushë të begatë, rrëzë bjeshkëve dhe maleve Maranaj dhe Cukal. Ajo përfshin edhe një pjesë të zonës malore si Vilzën, Drishtin, Urën e Shtrejtë, Domnin, Sumën dhe Shakotën. Me kështjellën e vjetër të Drishtit në krye dhe me varganin e tumave -si vargan malesh-, me vendndodhjet historike e dëshmitë e shumta të ngjarjeve e të luftërave për liri, me Urën e famshme të Mesit, mbi 200 vjeçare, me njerëzit e saj të besës dhe të trimërisë, të punës dhe të mikpritjes, të cilët i kanë të shkruara në ballë këto virtyte dhe i kanë të ruajtura në kujtesë dhe në shpirt dramat, tragjeditë dhe përmbysjet e këtij shekulli, **Postriba dëshmon dhe**

përcjell historinë e saj të lashtë si dhe shndërrimet e vrullshme demokratike në këtë prag shekulli të ri, shekullit XXI.(Uran Butka, "Kryengritja e Postribës", Ringjallja f. 129).

Kryengritja e Postribës i ka trupin dhe gjymtyrët pikërisht në këto treva dhe kokën e ka në qytetin e Shkodrës. (Uran Butka, po aty).

Popujlli i Shkodrës, i Postribës dhe i gjithë krahinave të Shkodrës u zhgënje plotësisht me marrjen e pushtetit nga komunistët menjëherë pas përfudimit të Luftës Nacional-çlirimtare pa bërë zgjedhje demokratike ashtu siç ishte vendosur në Kongresin e Permetit dhe në Konferencën e Pezës dhe të revoltuar, filluan menjëherë reagimin dhe organizimin e rezistencës antikomuniste. Intelektualët e Shkodrës nisën të mendojnë dhe të punojnë për krijimin e një opozite demokratike si dhe të organizimit të një rezistence aktive, që mund të paralizonte terrorin e dhunës. Sidomos **pas manipulimit të zgjedhjeve të 2 dhjetorit 1945 nga komunistët dhe luftës së tyre të egër për të shuar çdo përpjekje për demokraci, për pluralizëm politik, për opozitë në parlament dhe jashtë tij, edhe ata intelektualë demokratë që ndihmuan me të gjitha mënyrat Frontin Nacionalçlirimtar dhe shpresuan për vendosjen e një demokracie pluraliste në Shqipëri, u zhgënjyen dhe ngritën zërin e protestës e të reagimit opozitar.**

Edhe shtypi perëndimor në atë kohë shkruan: "Ne nuk mund ta njohim qeverinë e sotme Shqiptare, nëqoftëse nuk do të ketë parti të tjera dhe zgjedhje të lira nën kontrollin e një komisioni aleat". Kurse Radio Londra thoshte: " Në një vend ku nuk ka shumë parti, nuk mund të ketë demokraci dhe në një vend ku nuk ka demokraci, si në Shqipërinë e sotme, nuk ka zgjedhje të lira."

Në këto kushte, kur mundësitë e luftës me mjete demokratike nuk ekzistonin më, e vetmja alternativë mbetej organizimi i rezistencës antikomuniste - deri në kryengritje për të përmbysur regjimin totalitar. Me këto shpjegohet edhe veprimtaria e rezistencës së grupeve të armatosura, që pushteti komunist i quante "banda".

Sipas raporteve të Degës së Punëve të Brendshme të qarkut Shkodër, gjatë viteve 1945-1946 në këtë qark kanë vepruar aktivisht e në mënyrë të organizuar 20 "banda" të armatosura me një efektiv nga 15-173 vetë secila, si edhe një sasi tjetër njësisht të armatosura me nga 5-15 vetë, nga të cilët mund të përmendim: Banda e Mark Malajt me 173 vetë në Dukagjin, ajo e Nik Sokolit me 143 vetë në Dukagjin, e Gjergj Vatës me 137 vetë në Shllak, e Preng Calit me 43 vetë në Këlmend, e Llesh Marashit me 46 vetë në Kopluk, e Hasan Isufit me 56 vetë në Oblikë, e Jup Kazazit me 23 vetë në Postribë, e Ded Shabanit me 5 vetë në Velipojë etj.

Përveç 738 të arratisurve të organizuar në njësi të mëdha, ishin përfshirë në njësi më të vogla malësorë e qytetarë nga Shkodra, Dukagjini, Berdica, Kastrati, Shkreli, Kelmendi, Postriba, Guri i Zi, Bushati etj., të angazhuar në kryengritjet e vitit 1945-1946. (Uran Butka, "Ringjallja", f. 131).

Në Gazetën Zyrtare të vitit 1946, nr. 88 faqe 3, në listën e të burgosurve kriminelë lufte dhe armiq të popullit, Dekret nr.173 datë 12 shtator 1946-Falje dënimesh, Presidiumi i Kuvendit Popullor, në mbështetje të artikullit 54 të Statutit të Republikës Popullore të Shqipërisë, pasi u aprovua nga Kuvendi Popullor, mbi propozimin e Qeverisë, me rastin e festës kombëtare: Përvjetori i Konferencës së Pezës 16 shtator 1946, dekreton:Faljen e dënimeve kundër lirisë personale, që mbetet për të vuajtur personave të shënuar në listën bashkëlidhur (Lista përmban 65 emra, por këtu do të përfshijmë vetëm ata persona që mendojmë se janë nga zona e Postribës):

Burgu i Shkodrës:

1. Osman Drishti
2. Rifat Uruçi
3. Zade Beqiri
4. Ymer Ademi
5. Ymer Sadiku
6. Zeqir Ujka

Për personat që janë shënuar më sipër, unë jam konsultuar me burra të vjetër të disa fshatrave dhe konkluzioni është se vetëm Ymer Ademi (Milan) është i saktësuar, të tjerët nuk identifikohen se janë postribas.

Nga raportet dhe relacionet e kësaj kohe, që gjenden në Arkivin e Ministrisë së Rendit, mësojmë se intelektualët demokratë të qytetit të Shkodrës kishin filluar punën për organizimin e rezistencës antikomuniste. Paulin Pali ishte në krye të një grupi intelektualësh opozitarë pro perëndimorë ku bënëin

pjesë Myzafer Pipa, Rakip Meta, Adem Bazhdari, Riza Dani, Jup Hoxha, Dan Dibra, Xhevat Dani, Asim Ulqinaku, Kolë Prela, etj., grup që nëpërmjet Kolë Prelës e Riza Danit, deputetë në Kuvendin Popullor, kishin lidhje me alternativën opozitare të Shefqet Bejës, Gjergj Kokoshit, Abdyl Kokoshit etj., në Tiranë.

Ish deputeti "tradhtar" Riza Dani, thuhet në një dokument-u bë përfaqësues dhe mbrojtës i interesave të borgjezisë dhe të tregtarëve të mëdhenj dhe u hodh në luftë të hapur kundër pushtetit popullor. Ai, pasi është në dijeni të rezistencës në Tiranë të një Komiteti Qëndror që po përgatiste një kryengritje në Shqipëri, filloi organizimin e elementëve të inteligjencës reaksionare dhe të borgjezisë tregtare. Në korrik të vitit 1946 organizoi një mbledhje në shtëpinë e Cin Serreqit, në të cilën morën pjesë Riza Dani, Dulo Kali, Caf Dragusha, Rasim Gjyrezi, Pjetër Shan Deda, Kolë Deda, Guiliem Suma, Gjon e Cin Serreqi dhe Dom Nikollë Deda. Në këtë mbledhje morën pjesë edhe paritë e fshatrave: Guri i Zi, Zadrimë, Postribë, Ana e Malit. Pjesëmarrësit folën për gjendjen e keqe të popullit, në mundësitë e shpërthimit të kryengritjes, aprovuan Këshillin Drejtues të saj dhe ndanë zonat e veprimit të tyre-sipas influencës. (Uran Butka, "Ringjallja," f.132)

Arkivi i rendit, kumtesë për Luftën e Organeve të Punëve të Brendshme Shkodër për likuidimin e reaksionit brenda rrethit).

Kjo mbledhje që u tubua më 7 korrik 1946, ishte edhe më e rëndësishmja, sepse vendosi shpërthimin e kryengritjes kundër regjimit komunist brenda datës 16 shtator, sepse formuloi qëllimin, platformën dhe organizimin e saj, sepse formoi një komitet drejtues të kryengritjes për Shkodrën me këtë përbërje pluraliste: Dom Tom Laca, Dom Nikoll Deda, Pjetër Shan Deda, Kolec Deda, Cin Serreqi e Guiliem Suma për demokristianen dhe Riza Dani, Rasim Gjyrezi, Dulo Kali dhe Paulin Pali për nacionalistët. Sipas mendimit të Shefit të Seksionit të sigurimit të Shtetit për Shkodrën, Zoi Themeli, një pjesë e anëtarëve të Komitetit kish lidhje me Jup Kazazin. (Nga Arkivi i rendit, relacion mbi veprimtarinë e reaksionit në Shkodër, 20. 2. 1947).

"Programi i këtij Komiteti-thuhet në dokumentat e asaj kohe-kishte për qëllim bashkimin e të gjithë organizatave opozitare të Shkodrës në një komitet të vetëm, i cili varej nga Komiteti Qëndror i Tiranës, që të ketë një vijë të përbashkët në organizimin e një revolucioni në të gjithë Shqipërinë".

Nga dëshmitë e Cin Serreqit në hetuesi, mësojmë se ***fjalën kryesore në mbledhje e mbajti Riza Dani, i cili foli për gjendjen e vështirë të popullit që po vuan nga padrejtësitë. "Po u merret toka atyre që e kanë patur, tregtarët po eliminohen nga tatimet e mëdha, bile edhe tregtarët e vegjël po zhduken nga taksat e rënda. Industrialistëve po u merren në përgjithësi fabrikat pa asnjë shpërblim dhe po pësojnë fatin e tregtarëve. Dëshpërimi në popull ka arritur kulmin në të gjitha anët e Shqipërisë. Ne nuk e kemi patur kështu..." Pastaj foli për liritë e ndaluara të fjalës dhe të shtypit, "... nuk lejohet të bësh as edhe kritikën më të vogël. Liria e veprimit është krejtësisht e ndaluar.*** Për më të voglën kritikë që guxon të bësh, arrestohesh si reaksionar. Në lidhje me këtë, solli shembull fjalën që kishte mbajtur në Kuvendin Popullor dhe e kishin quajtur reaksionar. Foli për organizimin e një kryengritjeje të përgjithshme për të ngritur një Qeveri Demokratike që do të ketë mbështetje nga çdo pikëpamje...Qëllimi i kësaj mbledhjeje është që edhe Shkodra të ngrihet në këtë revolucion në koordinim me qarqet (rrethet) e tjerë..." (Nga deponimet e Cin Serreqit në hetuesi, arkivi i rendit, dosja 1297).

Sipas Cin Serreqit dhe mjaft dëshmitëve të të dënuarve të tjerë, në këtë Komitet bënë pjesë edhe klerikë, përfaqësues të klerit katolik, të cilët luajtën një rol të rëndësishëm në organizimin e rezistencës antikomuniste në Shkodër. "Unë flas në emër të shokëve të mi klerikë-u shpreh Dom Nikoll Deda në mbledhjen e Komitetit-dhe tregoi se si persekutoheshin klerikët, vuri në dukje mbylljen e kuvendeve fetare, qitjen e klerikëve përjashta, pengesat që nxirren në predikimin e meshtarëve, duke i interpretuar si propagandë reaksionare. Pastaj tha që, më në fund, ne jemi gati me dhënë kontributin tonë nga pikëpamja morale, me anë predikimesh dhe këshillash për besimtarët tanë". (Arkivi i rendit, dosja Rakip Meta nr. 1297).

Pavarësisht nga shkalla e saktësisë së këtij dokumenti, një gjë është plotësisht e vërtetuar në atë kohë: Kuvendi Françeskan ishte mbyllur nga regjimi qysh në marsin e vitit 1946 dhe në shtator të atij viti ky kuvend i njohur fetar ishte kthyer në burg! Në zonën e Postribës u ngarkua të punonte Dulo Kali dhe Qazim Rroji, në zonën e Oblikës-Rasim Gjyrezi, në Muriqan e Vidhgar-Kadri Meta e Abaz Hysi, në zonën e Gurit të Zi, Juban e Reç - Pjetër Deda, Zyber Hyseni, Martin Sheldia e Gjergj Vata. Për qytetin e Shkodrës e Nënshkodrën u caktua Abdullah Kazazi. Gjithashtu në qytet do të vepronin Gjon Serreqi, Guiliem Suma, Cin Serreqi, Caf Dragusha, Sabri Kazazi etj. Pas kontakteve me krerët e krahinave e të bajrakëve u caktua

nga një Komandant e Zv/komandant për çdo fshat e zonë. Gjithashtu u vendos të lidheshin e të bashkëvepronin me kryengritësit e Dukagjinit, të Malësisë së Madhe, të Pukës, të Mirditës, të Krujës etj. "Pas kësaj mbledhje-shënohet në kumtesën e Arkivit të Rendit për luftën e organeve të punëve të brendshme të Shkodrës - **Riza Dani, i cili nuk ishte demaskuar akoma si armik i popullit, thërret në shtëpinë e tij Pjetër Dedën, Rasim Gjyrezin e Cin Serreqin dhe në fund të muajit korrik 1946, disa ditë para se të shkonte në mbledhjen e Kuvendit Popullor, ua bëri atyre të qartë situatën dhe, duke parë se Konferenca e Paqes në Paris po vazhdonte akoma punimet, vendosi që të fillonin kryengritjen e armatosur në 16 shtator, në mënyrë që t'i tregonin botës dhe Konferencës së Paqes që populli nuk e donte këtë pushtet dhe me këtë rast fuqitë e huaja do të ndërhyjnë me anë të tokës, detit e ajrit.** Duke vazhduar këto përpjekje Riza Dani, ra në lidhje me Jup Kazazin dhe një sërë intelektualësh reaksionarë si Paulin Pali, Myzafer Pipa, Kol Prela, Elez Troshani, Rakip Meta, Sami Repishti e Qamil Draçini ".(Po aty). Ndërkohë vjen nga Tirana në Shkodër Abdyl Kokoshi, i cili u dënua më vonë në gjyqin e deputetëve me pushkatim, edhe qëndroi 6 ditë në Shkodër, ku ra në lidhje me bashkëpunëtorët e Riza Danit: Paulin Palin, Rakip Meten e Kol çoben e nëpërmjet tyre, edhe me Jup Kazazin, i cili qëndronte ilegal. Abdyl Kokoshi u premtoi atyre se do të përkraheshin edhe nga perëndimi-siq kishin marrë premtime, nëse do të sulmonin e do të çlirojnë Shkodrën për disa ditë.

Sami Repishti punonte në mënyrë të veçantë më të rinjtë e Shkodrës. Ishin siguruar të gjitha premiset që kryengritja të fillonte me 16 shtator, mirëpo nga fundi i muajit gusht 1946 në zonën e Postribës u thirrën shumë të rinj për shërbimin e detyruar ushtarak. Kjo situatë e detyroi parinë e Postribës të kërkonte shpejtimin e fillimit të kryengritjes, me qëllim që të pengohej mobilizimi ushtarak, si dhe të mos pakësoheshin forcat kryengritëse duke u marrë ushtarë të rinjtë e tyre. **Menjëherë u mblodhën krerët kryesorë të Postribës në ograjën e Abdullah Saitit në fshatin Kullaj, më 7 shtator 1946, ku u vendos që të nesërmen me datë 8 shtator 1946 të mblidheshin në kuvend e gjithë paria dhe luftëtarët e Postribës. Po kështu, me datën 7 shtator Qazim Rroi, organizon një mbledhje në Kullën e Han Hotit, ku njofton për mbledhjen e popullit në datën 8 në Boks.** "Të dielën datë 8 shtator 1946 - thotë Muho Dyl Osja në hetuesi-mblodha Këshillin Popullor dhe Këshillin e Frontit të fshatit tim Myselim dhe pas shumë diskutimesh vendosëm me marrë pjesë në sulmin e Shkodrës bashkë me katundet e tjera të Postribës."

Në pasditen e 8 shtatorit 1946 në Kodër Boks, pranë fushës së vjetër të aeroplanëve te **Kratuli i Bajram Rexhepit-krerët e Postribës Osman Haxhija, Abaz Sulejmani, Zyber Cafi, Kasem Ragipi nga Boksi, Jemin Zyberi, Selim Raci, Dervish Nuzi dhe Ismajl Duli nga Dragoçi, Abdullah Saiti, Jakup Dani, Muho Fetahi nga Kullaj, Myrto Dani, Ali Brahimi, Metush Halili, Ram Fazi nga Drishtit, Muho Dyl Osja nga Myselimi, Haxhi Tahiri dhe Idriz Tahiri nga Vorfa e Rrashi si dhe 150 kryengritës u mblodhën dhe, pas një kuvendimi të gjatë të drejtuar nga (Uran Butka thotë të drejtuar nga bajraktari Osman Haxhija, por ai ishte vojqodë dhe jo bajraktar, shënimi im, R. S) Osman Haxhija, vendosën që sulmi të bëhej të nesërmen, në agim të 9 shtatorit, me pjesëmarrjen e të gjithë burrave të krahinës.**

Kështu në ditën e caktuar, pra më 8 shtator, mbledhja e tre bajrakëve të Postribës u mbajt në "Kodër Boks" e pikërisht në vendin e quajtur "Shegat e Ibros". Mbledhjen e kryesonte Osman Haxhija, vëllai i Adem Haxhisë së vdekur gjashtë vjet më parë. Në të morën pjesë përfaqësuesit e tre bajrakëve, si Abdullah Seiti, Selim Raci, Smajl Duli, Muho Dyli, Emin Zyberi, si dhe me fjalën e marrë prej Myrto Danit, bajraktarit të Drishtit, që atë ditë mungonte. (Në materialin e Uran Butkës: " Myrto Dani vjen me vonesë."). (Ahmet Bushati "Në gjurmë të një ditari", f. 115-116).

Kam mbi tridhjetë vjet që unë studioj dhe mbledh material për Postribën. Në këtë mënyrë jam interesuar edhe për Kryengritjen e Postribës të 9 shtatorit dhe në bisedë me Osman Haxhinë, pasi kam pasur fatin ta kem axha i babës tim, më ka thënë se mbledhja është bërë në "Shega të Ibros" gjë që Uran Butka nuk e cilëson, ndërsa Ahmet Bushat e cilëson këtë. Sipas mendimit tim, versioni i Ahmet Bushatit, në këtë pikë është më i saktë, (shënimi im R. S).

Në këtë tubim foli Osman Haxhija për situatën e nderë dhe për domosdoshmërinë e marrjes së Shkodrës: " Unë i kërkoja Dulo Kalit tri pika - thotë Osman Haxhija: - 1. Na siguroni kufinin, 2. Armë për popullin, 3. Të dalë një nga të parët e Shkodrës me na pri." (Uran Butka, "Ringjallja", f. 135).

Myrto Dani, bajraktari i Drishtit, i cili erdhi nga fundi i mbledhjes, tha: “Ne nuk kemi qenë asnjeherë të ndarë dhe pasi ka vendosur bajraku i Boksit edhe unë bashkohem me mendimin tuaj dhe do të dal vetë në ballë, se populli i Drishtit është pa armë.”

Nuk ishte bërë ende ditë kur 300 burra ishin mbledhur në vendin e caktuar qysh një ditë më parë. Shumica e tyre kishin armë, e një pjesë e vogël ishte pajisur me mjete rrethanore, që gjithsesi shprehte vendosmërinë e madhe të Postribës për luftë. Si këputën lidhjen telefonike me Shkodrën, u nisën drejt saj me besimin se pushkës së tyre Shkodra do t’iu përgjigje me pushkë. Familjarë të shumtë të Fushës së Shtojit (këtu me sa duket autori Ahmet Bushati e ka fjalën për Hotin e Ri, sepse në Fushë të Shtojit nuk ka pasur banorë të tjerë përveç atyre të Hotit të Ri, shënimi, im R. S) kishin dalë para shtëpive të tyre e shihnin me kureshtje e emocion ata luftëtarë që përshkonin me shpejtësi fushën e tyre e me atë rast edhe prej tyre u bashkuan me ta. Nisur nga qëllimi e serioziteti i misionit në prag të luftës, gjendja e veçantë shpirtërore e atyre luftëtarëve duhet të kishte krijuar atë atmosferë, që sa më shumë i afroreshin Shkodrës, aq më solemne t’u bënte ajo. Sidoqoftë, ne dimë se kur ata patën arritur në periferi të Shkodrës e pikërisht te Kazermat në hyrje të saj, dielli ishte ende pa lindur, nën sinjalin “Bini, bre, burra!”, ata kaluan me shpejtësi në rrethimin e kazermave e shtëpive rrotull tyre e nisën pushkën nga shumë anë. Ushtria nga ana e saj e ngritur në këmbë qysh në pushkët e para, por e befasuar prej sulmit të papritur, kërkonte vetëm për t’u mbrojtur. Banorë të zonës për rreth do të na tregonin qysh atë ditë se si postribasit kishin kaluar muret me armë ndër duar e duke thirrur: “He, ju klyshët e Stalinit!” Ndërsa në drejtim të kazermave vlonte pushka, kudo nëpër lagje të Shkodrës kishin dalë njerëzit para shtëpive të tyre duke pyetur njëri-tjetrin me zë: “A dini gjë çka janë këto pushkë!?” (Ahmet Bushati, “Në gjurmë të një ditari”, f. 116).

Nëpërmjet Dulo Kalit u njoftua Shkodra dhe Komiteti njoftoi zonat e tjera. Filluan menjëherë të grumbulloheshin forca në zonën e Postribës, rreth 200 veta, nga të cilët 60 të armatosur, në Gur të Zi 170 veta, ndërsa në zonën e Oblikës 70 veta. Aksionit i parapriu prerja e linjave telefonike nga Hamza Trieshi me shokë për të paralizuar ndërlidhjen. Në orën 2 të mëngjesit, në të gdhirë të datës 9 shtator 1946, filloi sulmi drejt qytetit të Shkodrës në tre drejtime: Nga Postriba në drejtim të kazermave ku ishte komanda e Korpusit III. Nga Guri i Zi në drejtim të postës së Urës së Kirit dhe drejtimi i tretë mësymja drejt Kodrave të Tepes. (Uran Butka, “Ringjallja”, f. 136).

Forcat e Oblikës nuk ishin në kohën e duhur në sulm për mungesë organizimi dhe u bllokuan në Urën e Kirit, ku u zhvillua një përpjekje me forcat qeveritare. Sipas dëshmimeve në hetuesi të Zyber Hasanit, përfaqësues i rajonit të Gurit të Zi, si dhe të Shaban Abdullahit, 9 fshatrat e Gurit të Zi ishin përgatitur për sulmin mbi Shkodër. Martin Sheldia që u priu kryengritësve, u tha: “Nëqoftëse mbetet njeri në luftë, mos i leni në duar të komunistëve dhe mos u dëshpëroni nëqoftëse vdesim për fe e për atdhe.” (po aty).

Forcat e Gurit të Zi u ndanë në dy pjesë: Njëra mori drejtim për tek Ura e Kirit, ku u përleshën me forca të shumta të qarkut dhe të Postës që kishin bllokuar urën, ndërsa rragamasit me Shaban Abdullahin në krye u drejtuan për në Tepe pa arritur dot objektivin. Nuk arritën në kohë as forcat e Anës së Malit, të drejtuar nga Rasim Gjyzezi për arsye të njoftimit me vonesë. Vetëm forcat kryengritëse të Postribës, të ardhura nga fshatrat Boks, Dragoç, Rrash, Kullaj, Vorfë, Myselim, Domën, Hot, Hot i Ri, Trepsh, Koç (!) i Ri (Nuk e dimë se për cilin fshat e ka fjalën autori, ndoshta për Kuçin, ndaj dhe e shënova me pikë çuditëse, shënimi im, R. S), Kastrat, Grudë e Re dhe Shtoj, rreth 200 burra, u sulën në formacion luftimi drejt qytetit, nga ana verilindore e tij. “Në orën 6 e tridhjetë alla turka-dëshmon Abdullah Saiti, i dënuar me burg të përjetshëm-jemi nisur e kemi ardhur tek vorri i Smajl Osmanit dhe në orën 7 ne qitëm tri pushkë dhe na u përgjigjën me tri. U nisëm drejt gazermave, ndërkohë u dëgjuan pushkët e rajonit të Gurit të Zi dhe të Urës së Kirit.” (Arkivi i rendit, dosja 1134).

Luftimet, të cilat u zhvilluan në afërsi mes palëve kundërshtarë, qenë të rrepta për aq kohë sa patën zgjatur, por meqenëse ushtria e Sigurimi nga çasti në çast shtoheshin në numër e armatim, kryengritësit nuk po i përballonin më kundërsulmet e tyre e meqë edhe Shkodra nuk po çohet për të marrë pjesë, siç kishin besuar kryengritësit, udhëheqësit e tyre u detyruan që të lëshonin kushtimin për tërheqje. Plani i kryengritësve...kishte dështuar, ata ishin zhgënjyer. (Ahmet Bushati, “Në gjurmë të një ditari”, f. 116-117).

Postriba, me jo më shumë se 300 trima, kishte guxuar të sulmonte me armë e pa armë një pushtet të fortë e mizor, ashtu si 300 spartanë dikur Persinë e Madhe, duke konfirmuar edhe një herë patriotizmin e saj tradicional e duke gdhendur në kujtesën historike një tjetër faqe nderi e lavdie për vete, Shkodrën e mbarë vendin.

Edhe tërheqja e detyruar e kryengritësve do të pasqyronte vlera të mëdha organizative e morale, si e mbështetur në dispozitat e tyre më të mira. Kështu, ndërsa një pjesë e tyre me rezistencë të vendosur në qendër, do të mbante në vend sulmin e fuqishëm të ushtrisë e Sigurimit, të tjerët ndër krahë, po me aq vendosmëri e shpirt përgjegjësie, nuk do të lejonin që forcat qeveritare të realizonin rrethimin e kryengritësve, përkundrazi, do të mundësonin që këta të fundit të përshkonin fushën e të kapnin malin pa rreziqe.

Në fillim të tërheqjes, kryengritësit do të linin të vlarë Elez Bazin (Bajraktari) prej fshatit Kullaj, për të qenë ai dëshmori i parë i asaj kryengritjeje. Në vazhdim, te vendi i quajtur: "Llomat e Rusit", do të mbetej i vlarë Jonuz Salja (Shkreli) prej fshatit Boks dhe më sipër, te Ura e Mesit, dëshmori i tretë, po prej Boksit, Osman Hyseni (Hasaj). Prej Boksit do të ishte edhe Ymer Zeqiri, të cilin e kishin pasë marrë plumbat rastësisht dhe partizanët që e kishin kujtuar për të vlarë e kishin pasë mbuluar me gurë për së gjalli.

Në hyrje të fshatit Kullaj, plaku e trimi i rrallë, Sait Duli (Bushaj), pasi kishte zënë një pozicion të favorshëm luftimi, i vetëm, do të bllokonte në vend disa forca qeveritare, duke u dhënë kështu edhe një mundësi më tepër djemve të Postribës që të vazhdonin ngjitjen e tyre në mal. Pas njëfarë kohe Sait Dulit do t'i bllokohej pushka e përfundimisht të kapej i gjallë prej forcave të Sigurimit, të cilët, pasi ta torturonin barbarisht, gjysmë të vdekur do ta venin para për në Shkodër, ku ai s'do të mbërrinte kurrë, sepse në hyrje të saj, ai do të jepte shpirt e partizanët për të mos e zgjatur më do ta pushkatonin në vend. (Ahmet Bushati, "Në gjurmë të një ditari", f. 117).

Sulmi kishte dy objektiva: Kundër Kazermave të ushtrisë në lagjen e sipërme periferike të qytetit si edhe kundër forcave ruajtëse të burgut të madh të prefekturës në qendër të qytetit, për të çliruar të burgosurit. Në krye të forcave kryengritëse ishte vojvoda (bajraktari, thotë Uran Butka, i cili nuk kishte dijeni se kush e mbante titullin e bajraktarit, shënimi im, R. S) Osman Haxhija, i cili ishte bërë i njohur qysh më 1920 në Luftën e Koplikut, dhe më 1939 kur u priu postribasve liridashës në pritën që Shkodra u bëri trupave pushtuese fashiste. (Uran Butka, sa duket nuk e ka të qartë se nuk ishte Osman Haxhija, por vëllai i tij Adem Haxhija, komandanti që mori pjesë në Luftën e Koplikut të vitit 1920 si udhëheqës i Postribës, gjithashtu edhe kur bëri rezistencë në krye të burrave të Postribës kundër pushtimit fashist, me 7 prill 1939, për të cilën rezistencë ai u internua në Kolfiorito të Italisë bashkë me Ymer Beqirin e Boksit dhe i helmuar për arsyen e mospranimit të tij për t'i shërbyer fashizmit. Dhjetë ditë nga data e helmimit në Kolfiorito e largojnë nga Italia dhe vdes i helmuar në vendlindjen e tij, në Boks, shënimi im, R. S). Ndër prijësit e tjerë të shquar, qenë edhe Ymer Beqiri, Manush Cafi, Myrto Dani, bajraktar i Drishtit, Jakup Dani, bajraktar i Boksit. Me vetëmohim luftuan Selim Raci, Abdullah Saiti, Jonuz Zyberi (Sa duket është fjala për Jemin Zyberin, pasi nuk del emri i tij, i cili ishte ndër kryesorët në Postribë dhe më kryesori në fshatin Dragoç, pasi ishte kryeplaku i këtij fshati, shënimi im, R. S), Malo Mustafa, Brahim Alija, Smajl Duli, Myrto Manushi, Gjeto Zyberi, Hajdar Tafa, Beshir Brahimi, Seit Hyseni, Idriz Tahiri, Haxhi Tahiri, Baz Sulejmani e Harap Fetahu. Me forcat e Postribës u bashkuan e luftuan krah për krah edhe Zyber Hyseni, Tom Gjini e Tish Pashuku nga Rragami i Gurit të Zi si dhe Pjetër Luli nga Hoti. Ndërsa nga Shkodra ishin bashkuar me ta Murat Haxhija, Dulo Kali, Mustafa Jakupi e Gjon Leka. Në kazemat e ushtrisë përpjekja që e ashpër dhe zgjati mbi një orë. Një lagjet e qytetit dëgjoheshin të shtëna sporadike. Qazim Rroji me të tjerë përpiqeshin të sensibilizonin qytetin në mbështetje të sulmit. Mirëpo forcat e Korpusit III organizuan bllokimin e udhëkryqeve për të mos lejuar depërtimin e kryengritësve në brendësi të qytetit dhe për të paralizuar mbështetjen e mundshme të qytetarëve shkodranë. Nga ana tjetër, në drejtim të Shkodrës u nisën kontigjente të tjera të armatosura qeveritare nga Mbishkodra e rrethet e tjera, që mbërritën atje në mënyrë të rufeshme. Ato arritën të bllokojnë Urën e Kirit, duke u ndeshur me forcat kryengritëse të Gurit të Zi, që u detyruan të ktheheshin mbrapa. Po kështu u bllokuan edhe arteriet e tjera të qytetit. Komandanti i veprimit ushtarak të qarkut të Shkodrës, Musa Daci njofton urgjentisht Tiranën:

"Me datën e sotme 9 shtator 1946, në orën 2 e pesëmbëdhjetë minuta të mëngjezit disa forca kriminelësh të ardhur nga ana e Shllakut, goditën rojën e regjimentit të kazermave. Një rresht tjetër goditën Postbllokun në rrugën Shkodër-Pukë. Nga ana jonë një aspirant i rojës u vra dhe dy veta të regjimentit të plagosur. Nga ana e tyre mbetën dy...Sonte natën janë prerë edhe linjat telefonike. "Musa Daci-Komandant i veprimit të qarkut Shkodër 9 shtator 1946".

Po në datën 9 shtator 1946 pas përfundimit të përpjekjes, Musa Daci raporton më me hollësi: "Në lidhje me telin tonë nr. 77 / 255 datë 9 / 9 / 1946, gjatë ditës së sotme janë vlarë edhe 6 të tjerë të armatosur, u kapën edhe 11 ilegalë të tjerë. Të vlarë gjithsej 12 dhe të kapur 20 veta...Gjatë ditës së sotme nga ana

jonë kemi patur vetëm 2 të plagosur të regjimentit autonom. Ndjekjet tona vazhdojnë... Në bashkëpunim me organet e këtushme janë bërë edhe disa djegie shtëpish nga të të parëve.” Musa Daci. Një grup kryengritësish, rreth 70 veta, arriti të depërtojë deri në lagjen Rus, në afërsi të “Dugajëve të Reja”. Kryengritësit Hajdar Taf Hajdari deponon më pas në hetuesi: “Kryetar kemi patur Osman Haxhinë, Idriz Tahirin e Jakup Danin. Parullën e kemi pasur “Topi” si dhënës e marrës. Deri tek rruga e Rusit kemi ardhur së bashku, aty filloi lufta...” (Arkivi i Rendit, dosja 1193).

Pak më tej, në afërsi të spitalit, mbeti i vrarë trimi Elez Bazi nga fshati Kullaj. Forcave qeveritare mbrojtëse, të drejtuara prej aspirantit të Sigurimit të Shtetit, Shyqyri Rrjollit, u erdhën përforcime të tjera. Duke përfutuar nga epërsia numerike dhe armatimi që dispononin, arritën t’u pritnin hovin kryengritësve dhe të hidheshin në kundërsulm. Kryengritësit u tërhoqën në mënyrë të organizuar, duke synuar të kapin malet mbi fshatrat e tyre. Në tërheqje e sipër ra trimërisht Nuz Salja (Nuz Salo Shkreli, shënimi im, R. S) nga Boksi, në afërsi të stacionit të fermentimit të duhanit. Në fillim të tërheqjes, kryengritësit do të linin të vrarë Elez Bazin (Bajraktari) prej fshatit Kullaj, për të qenë ai dëshmori i parë i asaj kryengritjeje. Në vazhdim, te vendi i quajtur “Lomat e Rusit”, do të mbetej i vrarë Jonuz Salja (Shkreli) prej fshatit Boks dhe më sipër, te Ura e Mesit, dëshmori i tretë, po prej Boksit, Osman Hyseni (Hasaj). Prej Boksit do të ishte edhe Ymer Zeqiri, të cilin e kishin pasë marrë plumbat rastësisht dhe partizanët që e kishin kujtuar për të vrarë e kishin pasë mbuluar me gurë për së gjalli. Sait Duli (emri i Sait Dullit shkruhet nga autori në tre forma: Seit, Sait dhe Sahit, ndërsa në Kullaj njihet me emrin e fundit Sahit, shënimi im, R. S) arriti të kthehej deri në fshatin e tij, Kullaj. Në një shpellë, që u bë istikami i tij i fundit, ai mbrojtësi tërheqjen e shokëve të tij që ngjithnin malin. E, kur ata kaluan, ai vazhdoi luftën i vetëm deri sa i pushoi pushka. E gjetën të ngrirë nga plumbat, në mes të gjakut, po me pushkë në duart e ngrira. Kurse luftëtari Osman Hyseni (Osman Hysen Hasaj nga Rraseku, shënimi im, R. S), i plagosur rëndë, u kap dhe pasi e lidhën pas një makine e tërhoqën zvarrë deri në qendër të Postribës, ku i vdekur lihet disa kohë pa u varrosur për të ngjallur panic në popull. Gjithnjë në tërheqje të rregullt, një pjesë e kryengritësve u shpërnda nëpër fshatra. Murat Haxhija dhe Rasim Boksi, dy atdhetarë shkodranë dhe antikomunistë të vendosur, pas një rezistence me armë që u bënë forcave të Sigurimit të Shtetit, u zunë të gjallë. Pjetër Shan Deda me të shoqen, Marijen, të rrethuar mbetën të vrarë. Në fshatin Krebej të Bregut të Bunës rrethohen dhe vdesin më pas si pasojë e torturave Can Haliti e Mustafa Jakupi, ndërsa bie me pushkë në dorë trimi Rasim Gjyrezi.

Për të dokumentuar çka u shkrua më lart dhe për të përgënjeshtuar shpifjet e denigrimit që i bëjnë edhe sot Kryengritjes së Postribës, do të ishte e nevojshme të jepej raporti i plotë i major Zoi Themelit për Kryengritjen e Postribës, që gjendet në Arkivin e Rendit. Kryengritja u shtyp.

Pas shpërndarjes së kryengritësve, hakmarrja komuniste ishte e paimagjinueshme. Ajo do të përfshinte jo vetëm pjesëmarrësit, por gjithë gjindjen (njerëzit) e Postribës, të Shkodrës dhe të rrethinave të saj. Po atë ditë, më 9 shtator 1946, forcat e diktaturës, të komanduara nga shefi i Sigurimit për Shkodrën, Zoi Themeli, pushkatuan publikisht grupin e parë prej 12 kryengritësish. Ashtu të lidhur këmbë e duar me hekura e konop (litar), pasi i rrahën e i torturuan mizorisht, i grinë me automatik përbri një grope të përbashkët: Hajdar Dani, Metush Alija, Ymer Beqiri (!), Halit Dauti, Reshit Beqiri, Rexhep Idrizi, Ibrahim Selimi, Avdi Zeqiri, Idriz Ibra, Halit Hoti (?), Hysen Velushi. Bashkë me ta edhe Qazim Rroji nga Shkodra. Ky i fundit, me kurajo burrërore u shpëtoi nga duart xhelatëve të kuq që po e torturonin në ish-ndërtesën e Fashios, por u kap prej oficerit të Sigurimit Him Kastrati, u vu përpara skuadrës së pushkatimit dhe u asgjësua. Përsëri 12 të pushkatuar, pra një dyzinë, si në Malësi të Madhe një vit më parë. Koicidencë apo përsëri trill i diktatorit?! (Emrin që e kam lënë me pikë pyetje, Halil Hoti, nuk kam dijeni se për cilin është fjala, gjithashtu edhe Ymer Beqiri, që e kam shënuar me pikëçuditëse, është pushkatuar më vonë në Kodër Boks. Ymer Beqiri ndoshta është ngatërruar me emrin e Ymer Zeqirit, shënimi im, R. S). (Uran Butka, “Ringjallja”, f, 139 - 140).

Ende nuk kishte mbaruar krejt pushka e mitralozi, kur qytetarë të shumtë shkodranë, me sy të mbërthyer nga mali mbi Postribë, do të dallonin me pikëllim shllunga të dendura tymi të zi, që si simbole të pamëshirshme të hakmarrjes komuniste, ngriheshin mbi qiellin e Postribës që digej për ndëshkim.(Ahmet Bushati, “Në gjurmë të një ditari”, f. 118).

Ndërkohë, kudo ndër fshatra të Postribës, prej frikës së raprezaljeve, familjarë të shumtë do të nxirrnin me nxitim e në panik të madh prej shtëpive ç’të mundnin për të shpëtuar e me gjë të gjallë të vendosur përpara, do të merrnin malin me synim mikun, pyllin a shpellën.

Në muzgun e asaj mbrëmje, Sigurimi do të ngrinte për çdo fshat të Postribës nga një shtab operacioni, si edhe nga një qendër hetuesie, në krye të të cilëve do të vendosej vetë famëkeqi e xhalati i Shkodrës, Zoi Themeli. Ai vërsulet si bishë e unshme ndaj presë që i ka dalë para, ashtu si qenë lëshuar me atë rast mbi Postribë e Shkodër me rrethe kriminelët e pushtetit komunist të asaj kohe. Rasti që ata të shfrynin dufin e shpirtit të tyre të egërsuar shumë, u kishte ardhë në derë. Kudo nëpër Postribë filluan arrestime, në përfundim të diellit, për terror, pushkatuan disa burra para popullit të mbledhur me dhunë e në sy të vetë familjarëve të tyre. Kështu në Dragoç, atë pasdreke, pushkatuan Hysë Velushin (çelaj), në Kullaj, vëllezërit Ymer e Ahmet Zeneli, ndërkohë që për më shumë trishtim e tmerr, në Boks, Rrash, Kullaj, Dragoç e deri lart në Vorfë, - ku partizanët e pabesë deri para dy vjetësh kishin pasur çerdhet e tyre më të sigurta - disa shtëpi do të merrnin zjarr njëherit. Më në fund, pas një dite të tejzgatur e ferri të vërtetë edhe mbi Postribë, do të binte nata si nata e varrit, me shtëpi të mbyllura pa asnjë shenjë jete përbrenda, ndërkohë që sipër në qiell, kolona të trasha tymërash të zezë përzier me flakë, vazhdonin të tregonin me trishtim deri larg e larg se ç'po ngjiste me Postribën tashmë të nënshtruar.(Ahmet Bushati po aty).

Të nesërmen, me 10 shtator, forcat e Sigurimit, sipas listave të hartuara qysh gjatë natës, ose edhe më përpara, do të arrestonin shumë prej atyre që kishin qenë përfshirë në kryengritje e të pushkatonin disa prej tyre, si Reshit Beqirin (Bushaj), Halil Dautin, Rexhep Idrizin (Bajraktari), Metush Alinë (Cekaj) e Ibrahim Selimin (Cekaj), të gjithë prej katundit Kullaj. Prej Myselimit me atë rast do të pushkatonin Sylo Gjeten, si dhe trimin shkodran, Qazim Rrojin, i cili për aq orë sa ishte i lidhur me postribasit e mësipërm e deri sa u rrëzua për tokë prej plumbave, asnjëherë nuk do të pushonte së fryeri pushtetarët e komunistët në përgjithësi, duke i quajtur me sa zë kishte: "kriminelë", "të poshtër", "hora" e "vagabonda" dhe pa u kursyer emrat e Enverit, Titos e të Stalinit të tyre. Me qëllim terrorizimi, kufomat e të pushkatuarve do t'i linin për dy ditë rresht të ekspozuar që t'i shikonte populli, pa lejuar që familjarët t'i tërhiqnin...(Ahmet Bushati, "Në gjurmë të një ditari" f. 118-119).

Të nesërmen, me 10 shtator e mandej çdo ditë, çdo javë e çdo muaj të atij viti tragjik por edhe të vitit 1947 nuk pushuan terrori, vrasja, burgosjet, internimet, djegiet e përndjekjet në krahinën e Postribës. Komandanti i operacionit, Zoi Themeli, vendosi në çdo fshat të krahinës nga një qendër hetuesie e torture. Të gjithë kalonin nëpërmes kësaj qendre, duke iu nënshtruar drurit, torturave çnjerëzore e presioneve dhe në përfundim të tyre, dikush pushkatohej përpara familjarëve, dikush nisej i lidhur në burgjet e qytetit, dikush internohej me gjithë familje. Kështu u pushkatuan Sylo Gjetja nga Myselimi dhe Hysë Velushi (ky është edhe një herë i pushkatuar ?!, shënimi im, R. S), Jonuz Shkreli, Elez Bajrami, Muho Fetahu, Ymer Zeneli etj. Ymer Zeqiri u pushkatua bashkë me të birin, por me trupin shoshë nga plumbat, sfidon vdekjen dhe në terrin e natës, largohet nga kasaphana, duke mbetur dëshmitar i asaj hataje deri në ditët tona. Kështu numri i të pushkatuarve u rrit edhe me dhjetra të tjerë. ***Në të gjithë fshatrat e Postribës dridhej foshnja në bark të nënës dhe fëmija në djepin e drunjtë. Rreth 35 shtëpive iu vu flaka, u grabitën mijëra bagëti, u rrëmbye bereqeti, bulmeti e deri bari i mullarëve të sanës. Lista e fshatarëve të arrestuar lidhur me ngjarjen e datës 9 / 9 /1946, është tepër e gjatë. Nga të gjithë fshatrat që morën pjesë në kryengritje, gjejmë një listë me 69 persona të arrestuar, sidomos në fshatrat Boks, Vorfë, Dragoç, Myselim, Rragam, Kullaj, Rrencë, Drisht, Mes etj., si dhe listën me 68 fshatarë të dorëzuar nën kërcënimet e djegieve të shtëpive, të vrasjeve, të burgimeve dhe të premtimeve për falje në rast të dorëzimit të armëve, premtime që nuk u mbajtën, sepse të gjithë ata që u dorëzuan, u torturuan çnjerëzisht dhe u dënuan me vdekje apo me burgime të ndryshme.(Uran Butka, "Ringjallja", f. 140 - 141).***

Atje lart në Domën, forcat e ndjekjes kishin zënë e pushkatuar Idriz Ibron, Halil Metin e Avdi Zeqirin (! sa duket, Avdi Zeqiri është kosovar, shënimi im, R. S), të tre prej fshatit Boks. Ndër tortura kishin mbytur Muho Fetahun. Të urtin e patriotin Ymer Beqirin, pasi e kishin torturuar për vdekje, - duke marrë pjesë edhe vetë Zoi Themeli - e kishin hedhur nga dritarja e katit të sipërm të një shtëpie fshatari e mbrapa pushkatuar. Këtë Ymer Beqir edhe italianët e kishin pasë burgosur e internuar dikur bashkë me Adem Haxhinë, si patriot që kishin qenë. (Ahmet Bushati, "Në gjurmë të një ditari", f. 119).

Pas shumë përpjekjesh, Sigurimi kishte arritur që një ditë të zbulonte edhe shpellën ku ndodhej i fshehur trimi Murat Haxhija, frymëzuesi dhe organizatori kryesor i kryengritjes. I rrethuar nga të gjitha anët prej forcave të shumta të Sigurimit e pas një luftimi prej disa orësh, ai pasi kishte vlarë dy ushtarakë e mbetur më në fund pa municion për të vazhduar qendresën, ishte kapur i gjallë, për t'u pushkatuar pas

disa kohësh. Ishte pushkatuar edhe Hajdar Dani i shtëpisë së bajraktarit të Drishtit (Ahmet Bushati, “Në gjurmë të një ditari”, f. 119).(Sipas verifikimeve që kam bërë Hajdar Dani nuk ka qenë i shtëpisë së bajraktarit të Drishtit por ka qenë i biri i Dan Cenit të fisit Curri, i cili është pushkatuar për pjesëmarrje në Kryengritjen Antikomuniste të 9 shtatorit 1946., shënimi im, R. S).

Në Shkodër po ashtu, Shkodra “reaktionare” ra në kthetrat e pamëshirshme të hakmarrjes komuniste. Kontrolllet, spiunimet, arrestimet s’pushojnë as natë e as ditë. Jup Kazazit dhe të vëllait, Seitit, u kërkohen kokat me ferman. Por ata nuk dorëzohen të gjallë dhe vetëflijohen për të mos rënë në duart e tyre. ***I gjithë fisi i Kazazëve, u shkua në plumb, u burgos apo u internua. (Uran Butka, “Ringjallja”, f. 141). Kështu Abdullah Kazazi një nga figurat më aktive të rezistencës antikomuniste në Shkodër dhe Sabri Kazazi, i biri i tij, i dënuar me burgim të përjetshëm; Besnik Kazazi i dënuar me 30 vjet burg, Bexhet Kazazi i dënuar me 20 vjet burg, si edhe Ramadan Kazazi, Osman Kazazi... Edhe një grua nga kjo familje, Sadie Kazazi, u dënua me 10 vjet burg.***

Ndjekjet dhe dënimet vazhdojnë me intensitet të madh, jo vetëm në lidhje me Kryengritjen e Postrribës, por edhe për motive të tjera. Të arrestuarit nga qyteti i Shkodrës arrinin në qindra vetë. Ata janë kryesisht intelektualë që kanë organizuar Kryengritjen e 9 shtatorit 1946.

Qëllimi është i qartë: të eliminohet përfundimisht rezistenca antikomuniste e Shkodrës, të eliminoheshin intelektualët demokratë, brenda saj dhe luftëtarët e panënshtuar të krahinave të saj. Zalli i Kirit u kthye në një varrmal të vërtetë skeletesh, ku natën mblidheshin qentë e ditën sorrat, aty i hodhën edhe eshtrat e poetit të madh të Shkodrës e të gjithë Shqipërisë, At Gjergj Fishtës. Pushkatohen me gjyqe të inskenuar të viteve 1946-1947-1948, ndonëse ishin arrestuar qysh në shtator 1946 dhe ishin torturuar çnjerëzisht në hetuesinë e Sigurimit të Shtetit: ***Mon Sinjor Gjergj Volaj, i cili para pushkatimit ia fjalën e fundit: “Të m’i thoni shtëpisë se meshët që kam lënë pa thënë, të m’i thonë, Rroftë e përparoftë Shqipëria!”***, Murat Haxhija, Abdullah Kazazi, Caf Dragusha, Cin Serreqi, Nuh Oroshi, Paulin Pali, Gaspër Simoni, Dulo Kali, Rifat Kopliku, Xhevat Hardolli, Kol Shan Deda, Kol Prel Gjoka, Pjetër Prendush Pali, Bilbil Hajni, etj. u dënuan. Ndërkohë, ***u dënuan me burgim të përjetshëm: Osman Haxhija, prijësi i postribasve me shami të kuqe në kokë, Rakip Meta, një nga organizatorët e kryengritjes së Postrribës, të cilit iu fal jeta, vetëm me lutjet e së shoqes Hajrije – bija e Bajram Currit, po u dënua me burgim të përjetshëm, Kol çoba jurist i aktivizuar në organizimin e kryengritjes së Postrribës, Shaban Abdullahi nga Guri i Zi, luftëtar i vendosur, Jakup Dani nga Boksi (Jakup Dani është nga fshati Kullaj-Boks dhe ishte bajraktari i Boksit, shënimi im, R. S) - pjesëmarrës me armë në dorë në kryengritjen e Postrribës, Isa Meta nga Shkodra, Padër Karl Serreqi, Sabri Abdullah Kazazi, Mustafa Jakupi, Muharrem Seit Beqja, Zef Ndoc Darragjati, Abdullah Seit Duli etj.*** U burgosën shumë intelektualë shkodranë që ndihmuan kryengritjen, shumë pjesëmarrës direkt ose indirekt në kryengritje, shumë simpatizantë e mbështetës por edhe mjaft të tjerë që s’kishin lidhje fare me kryengritjen, por që donin t’i eliminonin me këtë rast.(Uran Butka, “Ringjallja”, f. 141-142).

U dënuan me burgime të rënda, ***Sami Repishti, Ahmet Kopliku, Jakup Dani, Surja Anamali, Hamza Trepshi, Mark Malaj, Kol Ndue Prela, Mark Prela, Gjon Serreqi, Abaz Mehmeti, Jakup Alija, Myrto Dan Isufi, Dionish Miçaço, Mehmet Daiu, Mustafa Vela, Hajdar Rusi, Rrok Gjok Luli, Gjelosh Maçi, Hajdar Taf Hajdari, Beb Gaspër Negri, Abdyl Riza Rusi, Nuh Dul Cufi, Hafiz Musa Dërguti, Sulo Kurti, Tom Lec Marku, Hysen Oso Dragusha, Qamil Fakja, Mustafa Shaban Vela e qindra të tjerë, më të shumtët intelektualë të shquar me formim e kulturë perëndimore.***

Në dhënien e këtyre dënimeve kanë treguar një zell të veçantë duke shkelur edhe ligjet e kohës, hetuesit, prokurorët, gjykatësit që ishin njëherësh edhe oficerë të Sigurimit të Shtetit si Abdyl Hakiu, Fadi Kapisyzi, Lefter Lakrori, Dul Rjollji, Misto Bllaci, Namik Qemali, Anastas Korovesi, Niko Ceta, Nesti Kopali, Zoi Shkurti, Aleksandër Shunti, Idriz çoba, Bilo Bregu, Hysni Ndoja, Xhemal Selimaj, Musa Daci dhe mbi të gjithë, dora e hekurt e Sigurimit të Shtetit për Shkodrën, Zoi Themeli, i cili u mor me të gjithë, por në mënyrë të veçantë me hetuesinë dhe torturimin e dy intelektualëve të shquar, Paulin Palit që ishte në krye të grupit intelektual opozitar të Shkodrës, i laureuar për drejtësi në Firence, avokat në Kosovë dhe më pas në Shkodër, anëtar i komitetit kryengritës në qarkun e Shkodrës, i dënuar me vdekje, me pushkatim, dhe Kolë Prelë Gjokës, i lauruar për letërsi në Torino, ish drejtor i normales në Elbasan, profesor i liceut të Shkodrës, deputet i Dukagjinit në Kuvendin Popullor, pjesëmarrës aktiv i opozitës të

intelektualëve të Shkodrës së bashku me Riza Danin dhe i lëvizjes antikomuniste në Dukagjin e në Postribë, i dënuar me vdekje me pushkatim. (Uran Butka, "Ringjallja", f. 142-143).

Pas këtij shkrimi të përgjakshëm e të kësaj kasaphane masive për të zhdukur burrat dhe djemtë e Shkodrës, gjë që vazhdoi disa vjet me radhë, erdhi nata e gjatë e vdekjes së ngadalhtë të këtij qyteti e të kësaj krahine, natë e cila mori fund vetëm me agimin e demokracisë me 22 mars të vitit 1992, që e ringjalli Shkodrën dhe Postribën.

MARRË ME INTERNET NGA FORUMI SHQIPTAR

Me rastin e 62 vjetorit të "Kryengritjes së Parë Antikomuniste në Shqipëri", Forumi Shqiptar, në temën "Shtypi dhe politika", pasqyron në temën e shtypit të ditës dhënien e urdhrit "Nderi i Kombit" komunës së Postribës nga presidenti i Republikës, zoti Bamir Topi.

Ky material është shkruar nga Pëllumb Sulo në "Zëri i Amerikës" me datën 9 shtator 2008. Në mes të tjerave ai thotë: " Presidenti i Shqipërisë, Bamir Topi, dekoroi sot me urdhrin "Nderi i Kombit" komunën e Postribës së rrethit Shkodër, në 62 vjetorin e Kryengritjes së Parë antikomuniste në Shqipëri.

Presidenti Topi shprehu mbështetjen për viktimat e krimeve të komunizmit, të cilat, tha ai, ende nuk janë dëmshpërblyer, rehabilituar e integruar, siç e meritojnë në shoqërinë demokratike."

Kryetarja e Parlamentit, Jozefina Topalli, tha se përmes miratimit të "ligjit të pastërtisë së figurave", Parlamenti do të dënojë krimet e komunizmit, ndërsa ish të përndjekurit politikë shpallën një lëvizje, pikërisht për të nxitur dënimin e këtyre krimeve. "VOA", shpreh respekt për të gjithë ata shqiptarë që patën guximin t'i kthejnë pushkën regjimit komunist të Enver Hoxhës. Kryengritja e armatosur e 9 shtatorit të vitit 1946 në Postribë është cilësuar si e para kryengritje antikomuniste në të gjithë vendet e Europës Lindore

Kryengritja e Postribës kujtohet në Shkodër si një nga ngjarjet më të dhimbshme, pasi diktatura komuniste vrau gjatë përlëshjes 21 burra, si dhe pushkatoi më pas pa gjyq 19 të tjerë, ndërsa 13 persona u dënuan me burg të përjetshëm, 123 të tjerë u dënuan me vite të ndryshme burgimi, si dhe u dogjën 18 shtëpi.

Qëllimi i kryengritjes ishte të sulmonin pikat kryesore të pushtetit lokal të asaj kohe në Shkodër dhe më pas të rrisnin pjesëmarrjen për të marshuar drejt Tiranës, deri në çlirimin e plotë të vendit nga forcat komuniste. Por Kryengritja e Postribës dështoi për shkak të mungesës së organizimit. (marrë nga gazeta "Shqip").

Këtu më poshtë do jap material të shkurtuar, të shkruar nga Anila Dushi. Ajo jep në mënyrë të përmbledhur 21 të vrarë, 19 të pushkatuar me dhe pa gjyq, 13 të dënuar me burgim të përjetshëm dhe 143 të dënuar me burgime të rënda e internime. Të gjitha këto, pas sulmit me armë të 9 shtatorit të vitit 1946.

Janë plot 21 pjesëtarë të kësaj kryengritje nga zona e Postribës, që u vranë e u pushkatuan nga regjimi komunist. Shtypja e kryengritjes ishte fillimi i vuajtjes së atyre që menduan të thyenin ngritjen e një regjimi diktatorial. Shtypja e kryengritjes u pasua me hakmarrjen masive të regjimit ndaj krahinës që guxoi ta kundërshtonte e t'i kundërvihej me armë. Kontrollat e ushtrisë dhe të sigurimsave nisën në çdo shtëpi të Postribës. Dhjetra prej tyre përfunduan të djegur, ndërkohë që u sekuestruan shumë bagëti. Operacioni ndëshkimor mbi fshatrat e krahinës "rebele" drejtohej nga Zoi Themeli. Në fshatin Kullaj, të dhënat e kohës flasin për katër shtëpi të djegur, ato të Jakup Danit, Fetah çelës, Isa Nuzit e Halil Ahmetit.

Kështu me radhë në shumë fshatra të tjerë të zonës. Raprezaljet vazhduan në çdo fshat. Në fshatin Dragoç u kap Hys Velushi, që u pushkatua para bashkëfshatarëve të tij, ndërsa një orë më pas të njëjtin fat pati edhe 30 vjeçari, Ahmet Zeneli.

Seria e pushkatimeve në sy të njerëzve, për t'u bërë shembull vijoi edhe në fshatin Drisht, me Hajdar Danin, që më pas i dogjën edhe shtëpinë. Në ditët që pasuan shumë banorë të Postribës u arrestuan, u burgosën dhe u internuan.

Në burg vdes nga torturat pa u provuar fajësia e tij, Muho Fetahu, për të cilin nuk u mbajt as një proces verbal i thjeshtë. Sipas historianëve, atë e hodhën në një gropë, ku nuk i dihet as vendi.

Ndëshkimi vazhdoi edhe mbi ata që ishin organizatorë të kësaj kryengritjeje dhe që jetonin në qytetin e Shkodrës, apo në fshatra të tjerë. Elez Mërturin nga fshati Myselim e morën ushtar me datën 11 shtator. I

plagosur nga plagët që kishte marrë në kryengritje dhe nga frika se mos identifikohet, gjë që do të sillte pasoja për familjen e tij, ai vret veten.

Postriba që kishte luftuar kundër austro-hungarezëve, serbo-malazezëve, pushtuesve italianë e gjermanë, tani po ndëshkohen nga bashkëkombasit e vet.

Populli i Postribës, historikisht përmendet për trimëri, besë, bujari e si punëdashës. Ura e Mesit, që ndodhet në qendër të Postribës, është një monument i gjallë i kulturës, ndërtuar në kohë të Bushatllinjve. Kalaja e Drishtit e ndërtuar në mesjetën e hershme, para sundimit të Venedikut, është një monument kulture me vlera kombëtare dhe e njohur nga kancelaritë e Europës.

Populli i Postribës zë një vend të rëndësishëm në historinë e luftërave të Shkodrës me rrethinat e saj dhe të Shqipërisë. **Nuk mund të ketë luftë që të ketë marrë pjesë Shkodra dhe të mos ketë marrë pjesë Postriba.**

Qendrat e hershme të banimit, si Kështjella Ilire në Kratulin e Boksit, Kalaja e Drishtit, Drishti, Balezo rrëzë Maranajt, Vorfa e hershme sa Shkodra, Domni, Kanioni i Urës së Shtrejtë, Kisha e Shëngjinit në Rrash, Kisha e Shën Todrit në Myselim, aty ku është sot Shtodri, rezervuari i madh prej 11 milion metra kub uje për ujitje e të tjera dëshmojnë se Postriba është qendër e lashtë qytetërimi.

Në këto 60 vjet, Postriba u kthye në një simbol, për shkak të qëndresës dhe persekutimit të pashembullt që i bëri kësaj zone për rreth 40 vjet diktatura komuniste. Banorët e Postribës janë pjesëmarrës aktivë në luftërat kundër serbo-malazezëve në Hot, Grudë, Ulqin, Tivar, në Suka të Moksetit në Kastrat, në Tarabosh, Shtoj, Bardhanjel gjatë rrethimit të Shkodrës, në Kodrat e Tepes, në Kodrat e Bërdicës, në Urën e Bahçallëkut në rezistencën kundër pushtimit fashist të vitit 1939, etj.

Gjithashtu gjatë Luftës së Dytë Botërore Postriba mori pjesë aktive duke u bërë bazë e fuqishme e luftës. Në Postribë, në fshatin Ura e Shtrejtë u ngrit çeta e Parë partizane. **Shumë familje të Postribës u bënë baza të luftës dhe shumë postribas morën pjesë me armë në dorë për çlirimin e vendit nga pushtuesit italo-gjermanë.**

Këtu poshtë po paraqes listën e të vvarëve e të pushkatuarve në kryengritjen e Postribës:

1. Elez Bazi (Bajraktari)...fshati Kullaj
2. Januz Salja (Shkreli)...fshati Boks
3. Osman Hyseni (Hasaj)...fshati Boks (Rrasek).
4. Sahit Duli (Bushaj)...fshati Kullaj
5. Rexhep Idrizi (Bushaj)...fshati Kullaj
6. Metush Alija (Cekaj)...fshati Kullaj
7. Reshit Beqiri (Bushaj)...fshati Kullaj
8. Halil Dauti...fshati Kullaj
9. Sylo Gjetja... fshati Myselim
10. Ymer Zeneli...fshati Kullaj
11. Ahmet Zeneli...fshati Kullaj
12. Brahim Selimi...fshati Kullaj
13. Ymer Beqiri...fshati Boks
14. Idriz Ibra (Cekaj)...fshati Boks
15. Hysen Velushi (Celufi)...fshati Dragoç
16. Hajdar Dani...fshati Drisht.
17. Muho Fetahu (Bushaj)...fshati Kullaj
(vdes në burg nga torturat).
18. Halit Meti...fshati Boks.
19. Mustaf Elez Mërturi... fshati Myselim
20. Avdi Zeqiri...Kosovë
(ka jetuar në Boks gjatë kësaj kohe).
21. Imer Zeqiri (Repaj)...fshati Boks (Groposet për së gjalli pas shumë plumbash)

Nga Shkodra, të pushkatuar me dhe pa gjyq:

1. Murat Haxhija... nga Shkodra
2. Abdullah Kazazi...nga Shkodra.

3. Caf Dragusha...nga Shkodra
4. Cin Serreqi...nga Shkodra
5. Dulo Kali...nga Shkodra
6. Nuh Oroshi...nga Shkodra
7. Rasim Gjyzezi...nga Shkodra
8. Kol Ashiku...nga Shkodra
9. Rifat Koplaku...nga Shkodra
10. Bilbil Hajni...nga Shkodra
11. Paulin Pali...nga Shkodra

Nga Guri i Zi, të pushkatuar:

1. Pjetër Shan Deda...nga Guri i Zi
2. Marije Deda (e shoqja e Shan Dedës)...nga Guri i Zi
- 3 Tish Pushuku...nga Guri i Zi
4. Tom Markgjini...nga Guri i Zi
5. Zef Lazër Matija...nga Guri i Zi
6. Luigj Pashuku...nga Guri i Zi

Nga Krebaj të Bregut të Bunës, të pushkatuar:

1. Can Haliti...nga Krebaj
2. Mustafa Jakupi...nga Krebaj

Nga Postriba, dënohen me burgim të përjetshëm:

- 1. Osman Haxhija (Spahija)...nga Postriba***
- 2. Abdullah Sahiti (Bushaj)...nga Postriba***
- 3. Jakup Dani (Bajraktari)...nga Postriba***
- 4. Selim Raci (çelaj)...nga Postriba***
- 5. Myrto Dani (Muhaj)...nga Postriba***
- 6. Imer Ademi (Milani)...nga Postriba***

Nga Shkodra, dënohen me burgim të përjetshëm:

1. Kel Çoba...nga Shkodra
2. Karl Serreqi... nga Shkodra
3. Sabri Kazazi...nga Shkodra
4. Muharrem Beqja...nga Shkodra

Nga Rragami, dënohen me burgim të përjetshëm:

1. Zyber Hyseni...nga Rragami
2. Shaban Abdullahi...nga Rragami
3. Zef Darragjati...nga Rragami

Me dënime të tjera të rënda, dënohen nga Postriba:

1. Isuf Hasani...nga Ura e Shtrejtë
2. Hasan Isuf Mehaj...nga Ura e Shtrejtë
3. Isa Isuf Mehaj...nga Ura e Shtrejtë
4. Imer Selim Myrtja...nga Ura e Shtrejtë
5. Brahim Selim Myrtja...nga Ura e Shtrejtë
6. Jakup Vulaj...nga Ura e Shtrejtë
7. Ahmet Lici (burg + internim)...nga Ura e Shtrejtë
8. Isen Ahmet Rekaj (burg + internim)...nga Ura e Shtrejtë
9. Hasan Ahmet Rekaj (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
10. Sulejman Ahmet Rekaj (Internim)... nga Ura e Shtrejtë
11. Lic Ahmet Rekaj (Internim)...nga Ura e Shtrejtë

12. Hava Rekaj (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
13. Hajrije Hasan Rekaj (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
14. Sait Isen Rekaj (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
15. Rrustem Isen Rekaj (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
16. Mine Isen Rekaj (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
17. Laje Ahmet Rekaj (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
18. Haxhi Ahmet Rekaj (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
19. Fahrije Lic Rekaj (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
20. Shkurte Haxhi Rekaj (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
21. Abaz Sulejman Rekaj (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
22. Osman Haxhi Rekaj (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
23. Brahim Isuf Vulaj (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
24. Laje Bel Vulaj (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
25. Aishe Bajram Vulaj (vdes në internim)...nga Ura e Shtrejtë
26. Njome Mehmet Vulaj...nga Ura e Shtrejtë
27. Ahmet Smajl Kurtaj (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
28. Sibe Lic Kurtaj (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
29. Bajram Ahmet Kurtaj (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
30. Kurt Ahmet Kurtaj (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
31. Lan Ahmet Kurtaj (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
32. Isen Ahmet Kurtaj (internim)...nga Ura e Shtrejtë
33. Feride Bajram Kurtaj (Internim)... nga Ura e Shtrejtë
34. Adem Isuf Hasani (Internim)... nga Ura e Shtrejtë
35. Rabiye Reshit Meaj (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
36. Nuse Mul Meaj (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
37. Sulltane Isa Meaj (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
38. Selim Zenel Myrtja (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
39. Shkurte Halili (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
40. Fatime Isufi (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
41. Aishe Selimi (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
42. Ramadan Isufi (Internim)...nga Ura e Shtrejtë
43. Rexhep Milani...nga Domni
44. Isen Elezi...nga Domni
45. Imer Adem Milani... nga Domni
46. Ymer Zenel Guri...nga Domni
47. Brahim Shabani...nga Domni
48. Sylo Turk Guri...nga Domni
49. Ram Isuf Uruçi...nga Domni
50. Beqir Caf Koprija...nga Domni
51. Bujar Salo Milani...nga Domni
52. Sadik Murat Stena...nga Domni
53. Bisho Osman Tusha...nga Domni
54. Januz Bisho Tusha...nga Domni
55. Avdi Bisho Tusha...nga Domni
56. Osman Bisho Tusha...nga Domni
57. Manush Caf Uraj...nga Mesi
58. Rrustem Haxhija...nga Mesi
59. Sadik Rama...nga Mesi
60. Kasem Rama...nga Mesi
61. Mehmet Islam Uraj...nga Mesi
62. Muho Dyli...nga Myselimi
63. Mehmet Dyli...nga Myselimi
64. Sait Iseni...nga Myselimi

65. Myrto Manushi...nga Myselimi
66. Abdullah Saiti...nga Kullajt
67. Mehmet Salja...nga Kullajt
68. Haxhi Salja...nga Kullajt
69. Jup Rrustja...nga Kullajt
70. Imer Myrtja...nga Kullajt
71. Jakup Dani...nga Kullajt
72. Hajdar Dani...nga Kullajt
73. Dervish Tafi...nga Kullajt
74. Taip Isaja...nga Kullajt
75. Veli Rrustja...nga Kullajt
76. Hamza Zejnuni...nga Kullajt
77. Osman Haxhija (Spahija)...nga Boksi
78. çel Murati (Shabaj)...nga Boksi
79. Sadik Imeri (Shabaj)...nga Boksi
80. Beshir Brahimi (Shabaj)...nga Boksi
81. Shaban Ademi (Spahija)...nga Boksi
82. Bajram Cufi (Bibaj)...nga Boksi
83. Haxhi Adem Shabaj...nga Boksi
84. Beqir Haxhija (Spahija)...nga Boksi
85. Daut Baz Shabaj...nga Boksi
86. Elez Rexhep Plangaj...nga Boksi
87. Baz Sylejman Shabaj...nga Boksi
88. Haxhi Adem Spahija...nga Boksi
89. Jakup Ibrahim Shabaj...nga Boksi
90. Ram Isuf Plangaj... nga Boksi
91. Selim Rac çelaj...nga Dragoçi
92. Jemin Zyber çelaj...nga Dragoçi
93. Hajdar Taf Halilaj...nga Dragoçi
94. Taf Hajdar Halilaj...nga Dragoçi
95. Muho Kup Halilaj...nga Dragoçi
96. Zejnun Rac çelaj...nga Dragoçi
97. Smajl Dul Halilaj...nga Dragoçi
98. Hasan Idriz Gruda...nga Dragoçi
99. Bajram Rexhep Halilaj...nga Dragoçi
100. Qazim Haxhi çelaj...nga Dragoçi
101. Sanije Ahmet Paskali (Internim 5 vjet)...nga Dragoçi
102. Bajram Halim Paskali.(internim 5 vjet)...nga Dragoçi
103. Shpresa Halim Paskali (Internim 5 vjet)...nga Dragoçi
104. Haxhi Halim Paskali (Internim 5 vjet)...nga Dragoçi
105. Hajrush Halim Paskali (Internim 5 vjet)... nga Dragoçi
106. Myrto Dani (Muhaj)...nga Drishti
107. Zyber Dervish Muhaj...nga Drishti
108. Nuz Halil Bushi...nga Drishti
109. Jakup Brahimi...nga Drishti
110. Ali Brahimi...nga Drishti
111. Gjeto Zyberi (Shmarqe)...nga Drishti
112. Dan Cen Curri...nga Drishti
113. Avdi Halil Dushaj... nga Drishti
114. Idriz Tahiri...nga Rrash - Vorfa
115. Dervish Idrizi...nga Rrash - Vorfa
116. Malo Mustafa...nga Rrash - Vorfa
117. Haxhi Rrashi...nga Rrash - Vorfa

118. Elez Haxhija...nga Rrash – Vorfa

Me dënime të tjera të rënda, dënohen nga Shkodra:

1. Bilbil Hajni...nga Shkodra
2. Rifat Kopluku...nga Shkodra
3. Xhevat Hardolli...nga Shkodra
4. Kol Ashiku...nga Shkodra
5. Smajl Halili...nga Shkodra
6. Kel çoba...nga Shkodra
7. Karl Serreqi...nga Shkodra
8. Sabri Kazazi...nga Shkodra
9. Muharrem Beqja...nga Shkodra

Shënim: Ka një kontradiktë në zërin “Nga Shkodra dënohet me burgim të përjetshëm” dhe në zërin “Me dënime të tjera të rënda, dënohen nga Shkodra”.

Zotërinjtë Kel çoba, Karl Serreqi, Sabri Kazazi dhe Muharrem Beqja janë të përfshirë në të dy listat. Cila duhet marrë për bazë, e para apo e dyta?! (Shënimi është i imi, R. S.).

Me dënime të tjera të rënda, dënohen nga Rragam e Guri i Zi:

1. Zyber Iseni...nga Rragami e Guri i Zi
2. Shaban Abdullahi...nga Rragami e Guri i Zi
3. Tish Pashuku...nga Rragami e Guri i Zi
4. Pjetër Shandeda...nga Rragami e Guri i Zi
5. Marije Deda...nga Rragami e Guri i Zi
6. Tom Markgjini...nga Rragami e Guri i Zi
7. Zef Lazër Matija...nga Rragami e Guri i Zi

Me dënime të tjera të rënda, dënohen nga Oblika:

1. Can Haliti...nga Oblika
2. Mustafa Jakupi...nga Oblika
3. Muharrem Saiti...nga Oblika

Me dënime të tjera të rënda, dënohen nga Hoti i Ri:

1. Haxhi Rrashi...nga Hoti i Ri
2. Elez Haxhija... nga Hoti i Ri
3. Pjetër Luli...nga Hoti i Ri
4. Zef Leka...nga Hoti i Ri
5. Gjelo Vata...nga Hoti i Ri

BURRAT MË NË ZË TË POSTRIBËS

Për të mos krijuar asnjë keqkuptim në rradhën e vendosjes së burrave të Postribës, vendosa që rradhitja të jetë sipas alfabetit. Kjo mënyrë vendosjeje zhdok çdo pakënaqësi në njerëzit dhe të afërmit e këtyre burrave, të cilët po të jetonin kohën tonë, asnjëri nuk do të kërkonte të ishte para ose mbi të tjerët. Secili do të kërkonte të ishte i barabartë në mes të barabartëve, duke manifestuar thjeshtësi, fisnikëri, burrëri, modesti dhe çdo virtut njerëzor që e karakterizonte njeriun e asaj periudhe me të vërtetë të artë.

Postriba është krenuar gjithmonë me këta burra e me të tjerë, të cilët nuk mund të futen të gjithë në këtë kapitull. Të gjithë së bashku, të udhëhequr nga krerët e fiseve më të mira të Postribës, të udhëhequr nga paria, bajraktarët e vojvodët, i kanë dhënë Postribës vendin e nderit të kombit gjatë gjithë historisë që nga lashtësia e deri në ditët e sotme.

ADEM HAXHIJA (SPAHIJA) - BOKS

Adem Haxhija u lind në vitin 1867 nga një familje e fisme e derës së Spahijave në fshatin Boks të Postribës, me tradita të shquara patriotike brez pas brezi. Baba i gjyshit të tij, i quajtur Mustaf Brahimi i preu kokën ushtarakut malazez që kërkonte duel me një shqiptar, përpara se të binin në përpjekje me forcat tona mbrojtëse.

Adem Haxhija dhe çel Murati janë nipër të fisit Uraj të fshatit Ura e Shtrejtë. Ata i kanë nënat motra dhe si djem tezesh që ishin, kanë shkuar shumë mirë me njëri - tjetrin.

Lindja e Adem Haxhisë përkon me atë periudhë historike kur populli i Postribës përballej me gjendjen e rëndë ekonomike që solli pushtimi turk. Postriba ziente nga revolta, organizonte kryengritje kundër pushtuesit, por makina ushtarake moderne e Perandorisë së madhe Turke ishte e fuqishme. Por si çdo pushtues që ka një fund, edhe pushtimit turk në Ballkan po i vinte fundi.

Revolucioni Xhonturk i vitit 1908 që filloi me periudhën e përtëritjes së Turqisë mbi baza "moderne europiane" nuk qe në gjendje të shuante aspiratat dhe lëvizjet e popullsive të Gadishullit Ballkanik. Përkundrazi, politika e centralizimit dhe e osmanizimit e rëndoi gjendjen dhe i ndezi më shumë ndjenjat kombëtare.

Ndjesia patriotike, me të cilën u rrit Adem Haxhija, e brumosi atë me ideale të larta kombëtare. Trimëritë e Haxhi Idriz Boksit me origjinë nga fshati Boks i Postribës, të Dasho Shkrelit, të Oso Kukës, të Jakup Ferrit, të Dedë Gjolulit, e të dhjetëra trimave të tjerë, lanë mbresa të pashlyera në shpirtin e Adem Haxhisë.

Duke u pajisur me virtytet më të larta të fisnikërisë, të trimërisë, të guximit, të vendosmërisë e të burrërisë dhe me idealet më të shquara të patriotizmit, Adem Haxhija merr mbi shpatullat e tij drejtimin dhe udhëheqjen e djalërisë së Postribës për të luftuar me vendosmëri kundër pushtuesve të vendit deri në fund të jetës së tij.

Në drejtimin dhe organizimin e luftërave dhe të kryengritjeve, Adem Haxhija, shquhet si komandant popullor, i pajisur me guxim, burrëri, trimëri e aftësi ushtarake drejtuese dhe organizative. Në çdo betejë ai qëndron në ballë të luftës, atje ku rreziku ishte më i madh.

Si një komandant i shquar i djalërisë së Postribës merr pjesë dhe drejton kryengritjen në marrjen e Deçiqit bashkë me kryengritësit e Malësisë së Madhe. Në prill të vitit 1911 thyhet armiku dhe ngrihet flamuri kombëtar në majën e Bratilës në Deçiq nga kryengritësit e Malësisë së Madhe e të Postribës të udhëhequr nga Dedë Gjoluli e Adem Haxhija.

Në luftën për marrjen e Ulqinit, qenë luftëtarët e Postribës të udhëhequr nga krerët dhe bajraktarët e bajrakëve të Postribës, që luftuan heroikisht pa kursyer as gjakun e tyre. Në këtë luftë ra heroikisht trimi i Postribës, Tahir Haxhija. Populli e përjetëson këtë luftë me këngën që i kushtohet këtij heroi:

"...- O Tahir, Tahir Haxhija
A po të dhimbet bukurija?
- Nuk po më dhimbet bukurija
Por po më dhimbet Shqipënia.
O Tahir , o trimi i trimit
ç'i bane armët e florinit?
- I kam vjerrë në gem t'Ulqinit,
Me i ba rreze gjithë Ulqinit..."

Në pranverën e vitit 1912 organizohet një kryengritje e madhe kundër pushtimit turk në të gjithë trevat e Shqipërisë, brenda dhe jashtë kufinjve shtetërorë. Adem Haxhija gjendet në krye të kryengritësve postribas. Turqit të mundur nga kryengritësit shqiptarë kërkuan armëpushim dhe premtuan të njihnin katër vilajete si provinca autonome shqiptare, (atë të Janinës, të Shkodrës, të Kosovës dhe një pjesë të Manastirit).

Më 1912-1913 në Rrethimin e Shkodrës, Adem Haxhija shquhet si strateg lufte në frontin e Myselimit. Lufta në Bardhanjel, ku përrojet dhe mali u mbushen me gjak, ishte lufta më e përgjakshme dhe më e rreptë në Rrethimin e Shkodrës. Adem Haxhija si komandant i shquar popullor ka meritën e tij të veçantë, që armiku nuk mundi të çajë frontin në këtë zonë, me gjithë sulmet e përsëritura disa herësh. Lufta u zhvillua trup më trup, e bajonetë më bajonetë. Adem Haxhija me djalërinë e Postribës krijon këtu

batalionin e vdekjes. Kjo trimëri e rrallë përjetësohet në këngën që ngriti populli për këtë akt sublim, të cilën e kam paraqitur në kapitullin XVI “ Periudha e pushtimeve”, ndaj dhe nuk po e pasqyroj këtu.

Hamdi Bushati në veprën e tij “Shkodra dhe motet” shkruan për këtë luftë: “ Hasan Riza Pasha i nderonte shumë guximtarët, madje i admironte. Tue qenë në banesën e shtabit të tij në zonën e Kirit i shkoi për një vizitë i quejtuni Adem Haxhija, një nga krerët e Postribës, shi (tamam) në momentin e një dueli të artillerisë me anmikun (të shkoje ditën në shtabin e këtij komandanti ishte rrezik i madh jetel!).” Hasan Rizaja vuri re se Ademit nuk iu tut syri aspak në momentin kur copat e gurëve binin si breshëri prej plasjes së predhave të malazezëve. Kështu ai, Ademin me shokë i deshi shumë! “ (Hamdi Bushati “Shkodra dhe motet”, vëll. I f. 451 (65)). (Nazif A. Kiramettin v. c. f. 362).

Postriba nuk gjendet vetëm në frontin e Myselimit. Ajo në Rrethimin e Shkodrës u gjend kudo në mbrojtje të saj.

Pas rënies së Shkodrës, e mundur nga uria, autoritetet malazeze me urdhër të princit Danjel të Malit të Zi, organizojnë djegien e shtëpisë së Adem Haxhisë si dhe i marrin të gjitha bagëtitë. Gjithashtu, po me urdhër të princit Danjel, digjen 63 shtëpi në Postribë si shenjë hakmarrjeje për dështimin në Bardhanjel.

Adem Haxhija nuk e pushon asnjëherë luftën në mbrojtje të trojeve shqiptare. Ai merr pjesë në luftën kundër malazezëve në qershor-gusht të vitit 1915. Për rezistencën që i bëri Austro-Hungarisë, në krye të kryengritësve postribas, ai arrestohet nga autoritetet austro-hungareze dhe burgoset në burgun e Shkodrës në vitet 1916-1917.

Lufta vazhdon. Ajo si një jehonë e gjatë ushton nëpër shekuj. Në luftën që u zhvillua në Kodrat e Moksetit dhe që ka marrë emrin “Lufta e Koplikut” e vitit 1920, është përsëri Adem Haxhija, ai që qëndron në krye të luftëtarëve postribas, dhe që nisat i pari në front:

“...Tre sahat pa dalë drita
Ja mërrini Postriba...”

Sipas historianit Xhevat Repishti, në muajin korrik të vitit 1920 forca të shumta armike serbo-malazeze sulmojnë me artileri kufirin shqiptar në zonën e Kastriotit, nga do t’i drejtoheshin qytetit të Shkodrës. Adem Haxhinë e kemi që në ditët e para të luftës në krye të luftëtarëve vullnetarë të Postribës. Në kryengritjen e forcave shqiptare që nisi me 1 gusht, Adem Haxhija komandon forcat vullnetare të krahut të djathtë, që ecën rrëzë maleve duke e ndjekur armikun. Adem Haxhija në këtë betejë mori disa plagë. Për merita në drejtimin, organizimin dhe trimëritë e tij në udhëheqjen e këtij operacioni, bashkëluftëtarët e tij e cilësuan atë “Luani i Luftës”.

Në dokumentacionin e kohës lexojmë se gratë shkodrane zgjodhën një përfaqësi nga ana e tyre për ta vizituar Adem Haxhinë e plagosur në luftë, në shenjë nderimi për trimëritë e tij.

Në vitin 1928 për merita të shquara drejtuese dhe organizative si komandant popullor i luftëtarëve të lirisë në mbrojtje të tërësisë tokësore dhe të pavarësisë kombëtare, Naltmadhnia Zogu i Parë, e gradon Adem Haxhinë me gradën ushtarake “Kapiten” në rezervë, i pajisur me të gjitha atributet e kapitenit të karrierës.

Në pushtimin fashist më 7 prill 1939, Adem Haxhija organizon qëndresë kundër këtij pushtimi në Kodrat e Tepes, te Ura e Baçallekut dhe në Kodrat e Bërdicës. Aty u hap zjarr kundër pushtuesit. Në Urën e Bahçallekut u bë rezistencë e fortë nga forcat e Postribës, nën udhëheqjen e Adem Haxhisë, duke vrarë disa oficerë dhe ushtarë pushtues. Këtu duhet të theksojmë se Cen Adem Hasaj nga fshati Boks shquhet si një luftëtar trim dhe i vedosur në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe të ruajtjes së integritetit tokësor. Ai nuk largohet nga pozicioni i luftimit në ballë të Urës së Bahçallekut, por me mitralozin e tij vazhdon me breshëri mbi armikun deri sa merret konfirmimi zyrtar nga Tirana se vendi ishte pushtuar nga Italia fashiste. Sapo merr njoftimin Adem Haxhija tërheq forcat e rezistencës nga vendi i dislokimit.

Pas pushtimit fashist, Adem Haxhija i shoqëruar nga tre luftëtarë postribas largohet nga atdheu dhe vendoset në trojet e Malit të Zi, tek disa miq shqiptarë për t’i shpëtuar arresimitit të tij nga gestapoja fashiste..

Tre javë pas largimit nga Shqipëria i kërkuar që të kthehet në atdhe me premtimin se do të lihet i lirë, ai kthehet pranë familjes. I prerë në besë, tre ditë pas kthimit autoritetet fashiste e arrestojnë dhe e urgjosin në burgun e Shkodrës. Pas tij arrestojnë edhe Ymer Beqirin dhe i dërgojnë në burgun e Tiranës. Nga këtu Adem Haxhinë, Ymer Beqirin dhe shumë të tjerë i internojnë në Itali, në Kolfiorito. Në Itali Adem Haxhinë

e helmojnë me helm me efekt të ngadalshëm dhe pas helmimit lejojnë kthimin e tij në atdhe. Vdes dhjetë ditë pas kthimit, më 22 maj 1940.

Të nëntë plagët që mori nga beteja në betejë dhe mbyllja e jetës së tij me plagën e helmimit fashist, do të jenë gjithmonë dëshmi e gjallë për luftën dhe heroizmin e jashtëzakonshëm të Adem Haxhisë, “Luanit të Luftës” dhe të luftëtarëve të Postribës, në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe të integritetit tokësor.

Për merita të shquara patriotike, Adem Haxhija dekorohet nga Kuvendi Popullor me urdhërin: “Për veprimtari patriotike të klasit të parë” me motivacionin “Si luftëtar i shquar e komandant popullor ka treguar trimëri të rrallë në mbrojtjen e Shkodrës 1912-1913 kundër shovinistëve serbo-malazezë dhe për mbrojtjen e tërësisë tokësore e pavarësisë kombëtare.”

Adem Haxhi Spahija do të ruhet në kujtesën e brezave pasardhës si një komandant i shquar i luftës për mbrojtjen e lirisë, integritetit tokësor dhe pavarësisë kombëtare, në kufinj të veriorë të Shqipërisë.

ADEM IBRO CEKAJ - BOKS

Adem Ibro Cekaj ka lindur në lagjen Kodër Boks të fshatit Boks të Postribës, në vitin 1920 dhe ka vdekur në fshatin Boks në vitin 2005.

Adem Ibro Cekaj rrjedh nga një familje me tradita të mira nacionaliste të fisit Cekaj, të vendosur kryesisht në fshatin Kullaj-Boks dhe të ardhur nga fisi Kolçekaj i Hotit me origjinë shqiptar, jashtë kufinjve shtetëror, që sot i përket Malit të Zi.

Adem Ibro Cekaj provoi disa regjime gjatë jetës së tij dhe e mbylli jetën me një regjim që nuk e desh kurrë me regjimin komunist.

Familja e Adem Ibro Cekës e drejtuar nga baba i tij Ibro Adem Cekaj dhe çelë Haxhi Cekaj ka trashëguar brez pas brezi tradita nacionaliste. Ibro Adem Cekaj dhe Çelë Haxhi Cekaj kanë marrë pjesë në Rrethimin e Shkodrës në vitin 1912-1913 në frontin e Fushave të Myselimit dhe në atë të Bardhanjelit bashkë me të gjithë luftëtarët e Postribës nën udhëheqjen e komandantit popullor Adem Haxhija duke treguar një heroizëm të rrallë në këtë betejë të përgjakshme. Ata kanë marrë pjesë në të gjitha luftërat në mbrojtje të lirisë, të pavarësisë dhe të integritetit tokësor.

Familja e Adem Ibro Cekës, gjatë periudhës para vitit 1944, ka qenë e aktivizuar më shumë me Ballin Kombëtar. Të gjithë pjesëtarët e familjes së tij kanë qenë të përkushtuar ndaj fesë Islame dhe kanë falë namazin në pesë kohët e tij. Si besimtarë ata kanë qenë kundër regjimit komunist, i cili nuk kishte asgjë të përbashkët me besimin në një Zot.

Çelë Haxhi Cekaj ka marrë pjesë në Kryengritjen Antikomuniste të 9 shtatorit të vitit 1946, ndërsa Adem Ibro Cekaj në këtë periudhë ishte ushtar në Korçë. Vëllai i tij, Idriz Ibro Cekaj, pushkatohet si pjesëmarrës në kryengritjen e 9 shtatorit të vitit 1946. Adem Ibro Cekaj ka qenë besimtar i devotshëm gjatë gjithë jetës së tij. Ai ka falë pesë kohët e namazit jo vetëm pas periudhës së proceseve demokratike por edhe në kohën e regjimit komunist. Ai është përpjekur të kryente me përpikmëri pesë shtyllat e Islamit.

Adem Ibro Cekaj ka qenë njeri me temperament sanguin, tip i gjallë, i fortë, i ekuilibruar dhe mjaft i shpejtë. Ai ka qenë burrë me karakter të fortë, i drejtë, i ndershëm, burrë i besës, i vendosur për t'i çuar deri në fund idetë dhe vendimet e tij. Ai ka qenë shumë i sjellshëm në familje dhe shoqëri. Në familje ai ka qenë shumë kërkues dhe gjithashtu dhe në punët që i janë ngarkuar nga shoqëria ka qenë i vendosur për t'i çuar deri në fund. Ai ka qenë i pajisur me virtyte njerëzore duke manifestuar edhe virtyte hyjnore, si lidhja me Zotin e tij, në zbatim të urdhrave të tij, e të tjera.

Adem Ibro Cekaj i ka pëlqyer këngët e epikës legjendare si ato të Mujit, të Halilit, të Gjergj Elez Alisë, por ka pëlqyer shumë edhe këngët e epikës historike, si këngët e luftërave për liri e pavarësi të popullit tonë në shekuj, këngët e trimërisë, të besës etj. Në shoqëri Adem Ibro Cekaj ka qenë njeri i ekuilibruar dhe mjaft tolerant. Ai është përpjekur për t'iu shmangur konflikteve me njerëzit, duke qenë më shumë falës se sa kërkues dhe këtë e mbështeste në besimin Islam.

Adem Ibro Cekaj gjatë jetës së tij ka qenë i aktivizuar për matjen e reshjeve të shiut dhe të borës, matjen e temperaturave, shtypjen atmosferike etj. Ai e ka vazhduar këtë punë për 22 vjet rresht, nga viti 1955 dhe deri në fund të vitit 1976. Këto të dhëna më kanë shërbyer mua si specialist për të kryer një studim për zonën e Postribës dhe atë të Kishë-Arrës. Pra, Adem Ibro Cekaj i ka hërbyer shoqërisë me aq sa ka pasur mundësi, pa kursyer asgjë.

Më poshtë do të tregoj dy - tre episode nga jeta e tij, të cilat tregojnë për karakterin e fortë që ka pasur dhe për ndershmërinë e vendosshmërinë e tij për të qenë ai që ishte, ashtu siç porositi feja Islame. Në vitet pas çlirimit në Shqipëri u vendos sistemi komunist, sistemi që do të mbante nën survejim e frikë çdo shtetas shqiptar. Kështu në Postribë sollën një operativ nga Vlora, të quajturin Spiro Gjoka. Ai kishte ardhur bashkë me gruan e tij dhe kërkonte një vend strehimi në një familje të mirë në Postribë. Kryetari i Lokalitetit i asaj kohe i thotë se ne mund të çojmë në një familje të mirë në Kodër Boks, por është me përbërje politike jo të mirë. Ai pranoi të shkonte, pavarësisht përbërjes politike. Kështu Spiro Gjokën, operativin e zonës, e dërguan në familjen e Adem Ibro Cekës. Në këtë familje ai ndenji për shtatë muaj duke e kaluar shumë mirë.

Një ditë Adem Ibro Cekaj ishte nisur të shkonte tek motrat në lagjen Milan të Domnit. Spiroja e pyet se ku do të shkonte. Ademi i tregon se do të shkonte tek motrat në Milan. Spiroja i thotë që nuk do të shkonte tek të motrat, pasi janë me përbërje politike jo të mirë.

-“Unë do të shkoj se i kam motra ato, nuk po shkoj për politikë.” - i thotë Ademi. Spiroja i thotë Ademit: “Po të shkosh do t’ia shohësh sherrin kësaj pune.” Ademi i përgjigjet përsëri: “Unë do të shkoj e ti bëj punën tënde pasi je në shtëpinë time.” Spiroja i thotë përsëri: “Ti do të më thyesh mua, kur unë të urdhëroj që të mos shkosh.” Ademi i thotë: “Unë nuk kam mendim as për të thyer as për të fyer, por unë jam nisur me shku atje se jam mërzitë dhe në qoftë se nuk do të pyesje ti, unë do të shkoja dhe ti nuk do të dije gjë.”

Adem Ibro Cekaj shkoi tek motrat. Kur u kthye të nesërmen Ademi, Spiroja e thirri në dhomën e tij, në shtëpi të Ademit. Ai i tha të shoqes që t’i piqte një kafe Ademit dhe pastaj e pyeti: “Ti shkove tek motrat në Milan apo jo?” Ademi i thotë: “Po, shkova.” Spiroja i rrahu shpatullat Ademit duke i thënë: “Të lumtë! Kështu i duam ne njerëzit, të ndershëm dhe të vendosur.”

Pavarësisht se Spiroja ishte nga jugu, zbatoi një zakon të malësorit verior.

Episodi i dytë është në kohën që po ngriheshin kooperativat bujqësore në zonën e Postribës. Kjo ndodhi në vitin 1956. Në shtëpinë e tij kishin shkuar për agjitacion e propagandë një ekip që përbëhej nga Ramadan Reçi, Sadik Bekteshi e të tjerë vendas përfaqësues partie, përfaqësues të frontit etj. Gjatë gjithë natës ata u përpoqën për t’i bindur pjesëtarët e familjes së tij që të hynin në kooperativë por nuk arritën asgjë. Duke e parë që dështuan, ata iu drejtuan Adem Ibro Cekës kur po dilnin nga shtëpia: “Na vjen keq për ju se do ta paguani shtrenjtë, pasi ju e dini mirë se jeni me përbërje të keqe politike. Kooperativa do të ngrihet por ju do të bëheni kulakë.” Atëherë Ademi kthehet dhe u tregon pleqve fjalët që i thanë përfaqësuesit e ekipit. Kështu Ademi mori “pëlqimin” e pleqve për të hyrë në kooperativë.

Episodi i tretë është në vitin 1946, kur Adem Ibra ishte ushtar në Korçë dhe në Postribë kishte plasur kryengritja. Ai nuk dinte gjë se çfarë kishte ndodhur në Postribë. Në këtë kohë ai ishte ushtar në kufi me Greqinë. Shkruante letra në familje por nuk i vinin asnjë. Letrat mbaheshin në komandën e repartit në Korçë dhe nuk ia dërgonin sepse vëllai i tij ishte pushkatuar në kryengritjen e Postribës. Një ditë Ademi e merr vesh rastësisht pasi takon postierin e letrave dhe i thotë se nuk kishte marrë prej shumë kohësh letra nga familja. Postieri i thotë se nga familja i kishin çuar vazhdimisht letra, bile i thotë ai, se edhe sot keni një letër. Ai e sheh letrën dhe ia merr nga dora postierit dhe menjëherë e hap. Por ç’të shohë, nga kjo letër ai merr vesh se ishte pushkatuar i vëllai. Kuptohet se e merr vesh menjëherë komanda dhe tepër urgjent urdhërojnë që Adem Ibro Cekaj të transferohej në qytetin e Korçës dhe deri sa i erdhi koha e lirimtë i lënë një ushtar shoqëruar që të mos i ndodhte gjë Adem Ibro Cekës deri sa ai të lirohej nga ushtria.

I tregova këto episode, të cilat i mora nga djali i tij Ali Adem Cekaj, për të plotësuar më mirë portretin dhe figurën e Adem Ibro Cekës, i cili do të mbetet në kujtesën e brezave të ardhshëm si një burrë në zë i Postribës, si një burrë i besës, i drejtë, i ndershëm dhe besimtar i mirë.

AHMET EFENDI KALAJA – SHKODËR

Ahmet Efendi Kalaja është me origjinë nga fshati Drisht i Postribës, lagjja Kala. Ai më parë banonte në lagjen “Ndocaj” të qytetit të Shkodrës. Mësimet e para teologjike i ka kryer në Stamboll. Personaliteti i tij ka mbetur legjendar në Shkodër, sidomos si hoxhë, ndër më të përmendurit përsa i përket patriotizmit dhe guximit të tij. Ahmet Kalaja u bë i njohur pas vitit 1850.

Molla Ahmet Kalaja u internua dy herë nga qeveria Turke. Internimi i parë i Ahmet Kalasë u bë kur ai i kërkoi pushimin e Vezirit Osman Mashar Pashës, pasi ky nuk zbatoi kërkesat e popullit që të mos eksportohej bereqeti e artikuj të tjerë ushqimorë. Molla Ahmet Kalaja del për të parën herë në skenë dhe nis të emërohet nga populli. Me datën 2 tetor 1856 Mustafa Teufik Pasha, guvernator dhe komandant i ushtrisë urdhëroi arrestimin e nismëtarëve dhe udhëheqësve popullorë, ndër të cilët kujtojmë: Hamza Kazazin, Hysejn beg Podgoricën, Ahmet ef. Kalanë ... Këta persona i internoi në Stamboll, duke i përcjellë me kalorës e duke i torturuar barbarisht. Me datën 7 dhjetor 1859, Ahmet Kalaja u lirua me disa nga shokët dhe erdhi në Shkodër.

Ahmet Kalaja merr pjesë në luftën e Katundit të Ri në Mal të Zi. Më 1860 qeveria Turke detyrohet të çojë forca kundër bandave malazeze që kishin kaluar kufirin, me këtë rast edhe një formacion vullnetarësh hkodranë, duke pasur prijës Molla Ahmet Kalanë. Merr pjesë në Luftën e Dytë të Shpuzës, e cila përfundoi në favor të shqiptarëve. Këtu poshtë po paraqesim një pjesë të këngës për këtë luftë:

“... Molla Ahmet Efendia
Gajret bani me shkodranë.
Ulqinaku e hasbia.
I kcyen tabes anë për anë. ...”

Internimi i dytë i Ahmet Kalasë ka lidhje me ashpërsimin e kontradiktave që krijoheshin në mes të valiut dhe popullatës së qytetit, shkaktuar nga urdhrat e reja të administratës turke në zbatim të reformave të Tanzimatit. Peticioni që bërë gati, për largimin e Esat Pashës nga Shkodra, dhe që nënshkruar...Ndër firmëtarët ishte edhe Ahmet Kalaja. Dihet se ky peticion pat një fund të pakënaqshëm. Firmëtarët u arrestuan, u futën në burgun e Kalasë, mandej nga orët e mbrëmjes, u nisën me vaporin “Sytrat” për internim më 16 maj 1869. Pas 10 muajsh internimi zotërinjtë e lartpërmendur më datën 10 mars 1870 qenë liruuar.

Molla Ahmet Kalaja, myfti i Shkodrës, vdiq me datën 15 rebiul-evvel 1294 (viti Hixhri) (1878). Ai ka dy djem: Myrtezanë dhe Saitin. Ky i fundit disa vjet me rradhë ka qenë drejtor i burgut të Shkodrës, kurse në periudhën e shtetit shqiptar që zgjedhur deputet i Shkodrës.

AVDI CULI (BREGAJ) - BOJAJ SUMË

Avdi Culi u lind në Bojaj të Sumës më 7 mars të vitit 1902 dhe vdiq më 22 shkurt të vitit 1985. Avdi Culi rrjedh nga një familje me tradita të mira nacionaliste të fisit Bregaj. Fisi i Bojajve të Sumës njihet si një nga fiset më të mira të rrethit Shkodër. Për këtë ka një vlerësim si më poshtë:

“Begajt e Bushatit
Alijajt e Kastratit
Bojajt e Bëshkasit
Gegajt e Shllakut”

Avdi Culi është një nga burrat e njohur të Bojajve të Bëshkasit për besë, për trimëri, për mikëpritje, për fisnikëri, për të gjitha ato virtyte njerëzore që mund të ketë një burrë në trevat e veriut. Ai ka qenë derë e njohur jo vetëm në Bojaj por edhe në të gjithë Sumën.

Shtëpia e Avdi Cullit ka qenë bazë e Luftës Nacional-çlirimtare dhe kjo është e vërtetuar edhe në dokumente të Komitetit të Veteranëve në listën si më poshtë: “Aktivistë në favor të Luftës Nacional-çlirimtare”, numri 9 i kësaj liste. (Shih kapitulli VII “Aktivistë në favor të Luftës Nacional-Çlirimtare”, numri 9 i kësaj liste. (Shih kapitulli VII “Lufta Nacional-Çlirimtare”)

Avdi Culi është kushri me Man Sadri Drijaj dhe në linjë gjenealogjike është poshtë :

Adem – Cul – Zenel – Isen – Brahim - Bregaj
Adem – Man – Sadri – Murat – Brahim – Bregaj

Axha i Avdi Cullit, i qatur Halil Zeneli ka marrë pjesë në “Rrethimin e Shkodrës vitin 1912–1913 bashkë me burra të tjerë të Postribës, në mbrojtje të lirisë, pavarësisë të ruajtjes së integritetit tokësor nga pushtuesit e huaj. Shtëpia e Avdi Cullit do të kujtohet me respekt nga brezat pasardhës të Postribës.

Burimi i këtij materiali është marrë nga Bejto Zenel Bregaj nga Bojajt.

BAJRAM AVDYL NDREJAJ–URA E SHTREJTË

Bajram Avdyl Ndrejaj rrjedh nga një familje nacionaliste e fisit Ndrejaj me origjinë nga Ndrejajt e Shoshit. I pari i tyre quhej Palë Preçi, i ardhur në fshatin Ura Shtrejtë djemët e tij Pepë Preçi, Gjekë Preçi, Ndre Preçi dhe Syk Preçi. Këtu ai gjeti fisin vjetër të këtij fshati të quajtur “Kurtaj” si dhe fiset e vjetra Fikaj dhe Vulaj. të mbas fisit Kurtaj.

Bajram Avdyl Ndrejaj lindi në fshatin Ura e Shtrejtë në vitin 1890 dhe vdiq fshat në vitin 1963, në moshën 73 vjeçare.

Gjyshi i Bajram Avdyli, i quajtur Hasan Velija ka qenë kundërshtar i regjimit turkut në lidhje me pagesën e të dhjetave dhe xhelepit. Në këtë kohë ai duke qenë burrat kryesor të fshatit Ura e Shtrejtë kundërshtoi pagesën e të dhjetave dhe xhelepit gjithë fshatin. Për këtë qeveria turke e arrestoi Hasan Velinë dhe i preu kryet kundërshtar i saj.

Bajram Avdyli ka marrë pjesë në të gjitha luftërat që janë zhvilluar nga Postriba mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe të sovranitetit tokësor të vendit tonë.

Në “Rrethimin e Shkodrës” në vitin 1912–1913 ai merr pjesë së bashku me luftëtarë të Postribës në mbrojtje të Shkodrës nga pushtimi serbo–malazëz të dislokuar frontin e Myselimit dhe atë të Bardhanjelit nën udhëheqjen e komandantit popullor Adem Haxhi Spahija. Postriba shquhet në këtë luftë duke mos lënë depërtimin e forcave armike drejt Shkodrës.

Në rezistencën që organizon Postriba kundër pushtimit austro-hungarez duke u ngritur në kryengritje të armatosur, merr pjesë edhe Bajram Avdyli bashkë me burra të tjerë të fshatit Ura Shtrejtë. Përpjekja me forcat armike u realizua afër Urës së Mesit, ku mbetën të vrarë tre ushtarë austro-hungarezë dhe dy boshnjakë u dorëzuan në besë tek Murat Imeri i Boksit, i cili i dorëzoi në Shkodër shëndosh.

Bajram Avdyli merr pjesë në Luftën e Koplikut në vitin 1920 bashkë me burra të tjerë të Postribës nën komandën e Adem Haxhisë .

Në vitin 1939 me pushtimin fashist, Postriba organizon rezistencë ndaj pushtimit Italian në Kodra të Tepes, në Bahçallek dhe në Kodra të Bërdicës. Në këtë rezistencë merr pjesë edhe Bajram Avdyli bashkë me trimat e Postribës në përgjithësi dhe të Urës së Shtrejtë në veçanti.

Bajram Avdyli ishte një burrë i gjatë, me flokë të bardhë, me fytyrë tipike të një malësori verior, që në pamje ravijëzoheshin tiparet e një burri fisnik me karakteristikat e një burri trim e të vendosur në mbrojtje të trojeve. Ai ishte një burrë i drejtë, i besës, mikpritës, besimtar në besimin islam. Ai kishte tiparet e një burri me karakter të fortë, i matur në marrjen e vendimeve, i durueshëm.

Bajram Avdyli kishte temperament flegmatik. Ai ishte tip i qetë, i fortë, i ekuilibruar. Ai ishte njeri i matur, këmbëngulës në marrjen e vendimeve dhe i durueshëm në vështirësi e fatkeqësi. Ai ishte gjakftohtë, nuk mbante inat, nuk gëzohej as nuk hidhërohej shumë.

Në marrëdhënie me të tjerët ai paraqitej i matur, nuk i pëlqenin fjalët e shumta, as llafet e kota. Ai ishte njeri me ndjenja të thella e të qëndrueshme.

Shtëpia e Bajram Avdyliit njihej nga shtëpitë e pasura të fshatit Ura e Shtrejtë. Ai kishte dhi, dhenë, lopë, kalë ngarkese e shale, qe pune për plugimin e tokës etj.

Shtëpia e Bajram Avdyliit ka qenë bazë e Luftës Nacional-çlirimtare. Ai ka ndihmuar partizanët me strehim, bukë, ushqim, pritje e përcjellje gjatë luftës. Gjithashtu nipi i tij Sadik Haxhi Ndrejaj ka qenë partizan gjatë luftës në një periudhë të gjatë prej vitit 1941 deri në vitin 1946.

Bajram Avdyli, në vitin 1931, pas vrasjes që ndodhi në xhaminë e Urës së Shtrejtë, fshati i dorëzoi detyrën e kryeplakut, të cilën deri atëherë e kishte Isuf Hasan Rrëmmolla (sot Mehaj). Këtë detyrë e mbajti deri në vitin 1939, kur Shqipëria u pushtua nga Italia Fashiste. Pas tij u bë kryeplak Halil Bel Fikaj.

Bajram Avdyli, duke qenë burrë i zgjuar dhe i njohur në fshatin Ura e Shtrejtë, ka marrë pjesë në pleqni jo vetëm brenda Postribës por edhe jashtë saj, bashkë me burra të tjerë të Postribës dhe me pleq të tjerë të Malësisë së Madhe, të Dukagjinit, të Shllakut, të Dushmanit etj.

Bajram Avdyli ka pëlqyer këngët e epikës legjendare si dhe ato të epikës historike. Ai ka pëlqyer këngët e Mujos e Halilit, të Gjergj Elez Alisë, të Dasho Shkrelit, të Oso Kukës, të Adem Haxhisë, të trimave që kanë

qitë pushkë për nder etj. Ai ka përdorur Lahutën dhe bashkë me të vëllanë, Haxhi Avdyli, kanë kënduar me lahutë këngë trimërie, këngët që u këndohen burrave.

Bajram Avdyli do të kujtohet nga brezat si një burrë në zë në fshatin Ura e Shtrejtë dhe në Postribë.

BAJRAM REXHEPI (HALILAJ) - DRAGOÇ

Jo shumë larg në kohë, piktori i njohur shkodran, Kolë Idromeno, realizoi portretin “Plaku shekullor i Postribës.” Ky portret pavarësisht se është i paidentifikuar, i përket burrit Lekë Bici, i konvertuar në mysliman me emrin Sylejman Turku, i pari i fisit Karmaj të lagjes Rraskë të fshatit Boks të Postribës.

Si për ironi të fatit, plaku i sotëm mbi njëqind vjeçar, i fisit të Halilajve të fshatit Dragoç, është pothuajse identik me këtë tablo. Kjo na shtyn ta njohim lexuesin me Bajram Rexhepin.

Cilido që qëndron përballë këtij plaku të brishtë, e ndien se gjendet përpara veprimtarisë mbi njëqind vjeçare të një burri që i la brezave shumë përvojë jete. Njeriu ndihet ngushtë kur dëshira e tij për të hyrë në shpirtin e Bajram Rexhepit, mbetet vetëm mundësi por jo realitet i prekshëm. Ndodh kështu, pasi brenda personalitetit të Bajram Rexhepit është akumuluar ndër vite urtësia, vuajtja, durimi, sakrificat e mbijetesës njerëzore. Vështrimi i tij i mjegulluar në dritë-hije e këtij shekulli, të fton për të mos shkelur në “dërrasë të kalbur”, të këshillon ta duash e ta nderosh punën e bujkut. Madje të rrëfen se nga duhet drejtuar “shënjestra” e mirëqënies dhe begatisë së familjeve fshatare.

Bajram Rexhepi ka ç’të tregojë nga jeta e tij. Një thesar fshihet në brendësi të portretit të tij. Duhet të jesh tepër i vëmendshëm për të depërtuar brenda këtij thesari. Rastis që ndodhitë e ngjarjeve t’i ketë mbuluar pluhuri i harresës, por, me takt mund të arrish atje ku e ke vënë piketën e shkërmoqur të episodeve. Ndodh ajo që ti e dëshiron. Kujtesa e plakut riciklohet. Ndodhitë dhe ngjarjet afrohen në kohë.

Fisi i tij ka zbritur në Dragoç nga malësitë e Shkrelit. Në kohën e Muhaseres (Austro-Hungarisë), nga 12 shtëpitë që popullonin Dragoçin, vetëm tri shtëpi ishin të fisit Halilaj të Bajram Rexhepit. Ky plak i urtë ka shkelur me këmbë pothuajse mbarë viset e Shqipërisë, Kosovës e Malit të Zi, kudo ku jetonin shqiptarë, dhe kudo ku shëtiti mori e dha mesazhe mirëkuptimi e paqeje. Nga ky shtegtim, plaku ruan në kujtesë bujtjen tek Hasan Begu i Vranjës. Miku e njohu me burra të fshatit, e këta biseduan ndër vedi, Postriba ku ka hyrë nuk ka dalë e bjerrur.

Bajram Rexhepi kujton me respekt bajraktarin e Boksit, Zenel Alinë, vojvodën Adem Haxhija si dhe pleqtë Nuz Halili, Haxhi Brahimi, Rac Bajrami, Ramo Salihi, të gjithë nga Dragoçi. Ai kujton Haxhi Ahmetin nga Mesi, Tafil Haxhinë nga Myselimi etj. Dikur këta trima të Postribës e qindra të tjerë, nën drejtimin e komandantit trim Adem Haxhija, luftuan dhe mbrojtën trojet nga pushtuesit serbë e malazezë.

Plaku shekullor nuk u mor as me politikë, as me pleqërim kuvendesh, as me filozofi. Jeta mbi njëqindvjeçare ia futi në shenjë të gjitha këto. Ai gjithë jetën ia kushtoi bujqësisë, këtij sektori jetik e të rëndësishëm për njerëzimin.

“Baba më la zanatin e bujkut dhe unë u përpoqa për ta mbajtur amanetin e tij gjithë jetën- thotë ai, - “kuvendova” me tokën dhe ia kuptuam gjuhën njëri-tjetrit.

Kulturat kryesore që ia siguruan vazhdimësinë e jetës janë duhani dhe perimet. Gjithashtu gjatë jetës ai kultivoi edhe drithërat e bukës si misër, grurë etj. Si bujk i dalluar ai u njoh jo vetëm në rrethin e Shkodrës por pothuajse në të gjithë Shqipërinë duke dhënë e marrë përvojë bujqësie.

Ai disa herë u nderua me medalje të ndryshme si dhe u dekorua si bujk përparimtar. Bajrami tregon për huanë shtetërore në kohën e regjimit monist:

“Ne u futëm në garë me Vido Jovon nga Omarajt e Vrakës dhe Zenel Muhon e Kastratit. Pastaj këtë garë e përhapëm në të gjithë Shqipërinë”. Dhe kur e pyet plakun se si e vlerëson jetën në këtë botë materiale, ai të përgjigjet: “kësaj jete as nuk mund t’i thuash e mirë dhe as e keqe. Të dyja pjesët brenda l ka. As e ëmbël, as e hidhur, por të dyja së bashku. Kur më pyeti një komunist në kohën e Enverit për besimin fetar, unë i thashë: “Ne kemi një Komandant (e kisha fjalën për Zotin) dhe asnjë nuk mund të dalë mbi të”

“Kush është njëshi?” - më tha.

Unë i thashë se është Enver Hoxha.

“Më duket se ma ke dredhë, - më tha.

Unë vërtetë ia drodha, mbasi nuk ma mbante të them ndryshe”.

Deri para pak muajsh Bajram Rexhepin e kemi parë në të gjitha familjet e Postribës për gëzime e për morte, duke shërbyer në këmbë si një djalë i ri. Plaku shekullor di t'i respektojë të tjerët. Ai sillet mirë me çdo njeri, i do ata, i vlerëson, i respekton dhe u shërben në ditë të mira e të vështira. Gjithë jetën e tij ai e kaloi në shërbim, në përkujdesje dhe në dashuri e respekt ndaj njerëzve.

Kur e pyet në se e vizitojnë njerëzit tani që ai nuk është në gjendje t'u shërbejë e t'i vizitojë të tjerët, ai me humor të përgjigjet:

“Tashti më shumë rri me të vdekurit se me të gjallët. Kam nevojë të kaloj kohën me njerëz, të rri me ta, të bisedoj për jetën, të çmallem...”

Çdo njeri në Postribë e njej kush ishte dhe kush është Bajram Rexhepi. Ai e meriton plotësisht këtë shkrim mbi portretizimin e personalitetit të tij. Do të kalojë edhe një shekull i ri e Bajram Rexhepi do të mbetet i gjallë në zemrat e njerëzve. Kujtimet e këtij burri patriot e fisnik, të rrallë në këtë kohë, do të jetojnë në çdo familje postribase, në çdo vatër të kësaj krahine, në çdo kuvend, në çdo pjesë të këtij komuniteti.

Ai është njeriu-shekull i Postribës. Dhe shekulli është pjesë e historisë dhe e kulturës njerëzore.

BEJTO ISUF REPAJ - BOKS

Bejto Isuf Repaj ka lindur në fshatin Boks (në lagjen Kodër Boks) të Postribës rreth viteve 1852, në një familje me tradita nacionaliste dhe besimtare. Sipas dëshmisë së Hamit Ibrahim Repaj dhe gjithashtu edhe të dëshmisë së Isuf Abdyl Repaj, Bejto Isuf Repaj ka rënë heroikisht në Luftën e Ulqinit në vitin 1880, në moshën 28 vjeçare. Ka pasur dëshmi të tjera se ai ka mbetur në luftën e Rrethimit të Shkodrës në vitin 1912, por unë mora për bazë atë që dëshmuar njerëzit e tij, pasi ata e dijnë më mirë kohën kur ka mbetur në luftë. Gjithsesi, është fakt se ai ka rënë heroikisht në luftë për mbrojtjen e sovranitetit të Kombit, në luftën për liri, pavarësi dhe integritet tokësor.

Sipas pasardhësit të Bejto Isuf Repaj dhe Zeqir Bejto Repaj, Isuf Abdyl Repaj, rezultojnë se Zeqir Bejto Repaj ka lindur rreth viteve 1873 në fshatin Boks të Postribës, në një familje nacionaliste dhe ka vdekur në luftën për pavarësinë e Tuzit. Kjo dëshmi nuk qëndron pasi nuk e lejon moshën femërore e tij, prandaj dëshmia më e saktë është ajo e Hamit Ibrahim Repaj që Zeqir Bejto Repaj ka rënë heroikisht në luftën për mbrojtjen e Deçiqit, në vitin 1911.

Bejto Isuf Repaj ka qenë një burrë rreth dy metra i gjatë e më shumë, ka qenë burrë i shëndetshëm, shumë fizik, besimtar, atdhetar dhe i zgjuar. Ai ka qenë burrë i besës, mikpritës, trim, i vendosur në çdo veprimtari fetare dhe nacionaliste.

Sipas dëshmisë që ka lënë Jaho Salo Repaj (në linjë gjenealogjike kemi Jaho - Salo - Bejto - Isuf - Repaj), pra nipi i Bejto Isuf Repaj, ai ka qenë nacionalist i vendosur, besimtar dhe burrë i zgjuar. Ai, përsëri sipas Jaho Salo Repaj, ka marrë pjesë në Lidhjen e Prizrenit në vitin 1878, si përfaqësues i zonës së Postribës. Këtë e dëshmon edhe Isuf Abdyl Repaj, një pasardhës i tij.

Jaho Salo Repaj ka lënë dëshmi se në vitin 1939, kur Adem Haxhija kthehet nga internimi i helmuar në Kolfiorito të Italisë, e takon Adem Haxhinë dhe i puth dorën në shenjë respekti e malli të këtij burri të madh të Postribës. Adem Haxhija i thotë Jaho Salo Repajt, se axha i tij Zeqir Bejto Repaj dhe gjyshi i tij Bejto Isuf Repaj kanë qenë burra të nderuar në Postribë, të besës, besimtarë dhe nacionalistë të vendosur në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe integritetit tokësor të kombit tonë.

Familja e Bejto Isuf Repajt ka qenë familje e madhe, me disa kurorë, me pasuri, duke përfshirë këtu tokë, blegtori si lopë, qe pune, kafshë ngarkese e transporti, dhenë, dhi, bletë etj.

Bejto Isuf Repaj do të kujtohet nga brezat pasardhës si një burrë në zë të Postribës, si burrë fisnik, trim, i besës, luftëtar në mbrojtje të trojeve shqiptare, bujar, i matur dhe i ekuilibruar në marrjen e vendimeve, besimtar dhe i zgjuar.

BRAHIM VELI BRACAJ - DOMËN

Brahim Veli Bracaj rrjedh nga një familje nacionaliste e fisit të njohur “Bracaj” të fshatit Domën. Ai u lind rreth viteve 1853 në fshatin Domën dhe vdiq në vitin 1933, po në këtë fshat.

Brahim Veli Bracaj ia kushtoi jetën e tij familjes, shoqërisë dhe mbrojtjes së trojeve nga pushtuesit serbo-malazezë.

Sipas bisedave që kam bërë me pleq të urtë të fshatit Domën, rezulton se Isen Mehmet Isen Bracaj, është plaku më i vjetër i fisit Bracaj, i cili rrjedh nga Ali Nehani, prej të cilit është krijuar fisi Bracaj. I pari i fisit që zuri vend në fshatin Domën quhej Nehan Alija, i cili la tre djem të quajtur Ram, Uruç dhe Ali Nehani. Nga djali i madh Ram Nehani u krijua fisi Mastaj (Halilaj) ose Jeremia. Ky fis mban vendin e parë në fise të Domnit. Djali i dytë ishte Uruç Nehani, nga i cili u krijua fisi Uruçi. Djali i tretë ishte Ali Nehani.

Në Domën thuhet se Brahim Veli Bracaj ka qenë plak për pleqni, i cili bashkë me shumë pleq të tjerë, si Hasë Veli Uruçin, Osman Haxhi Spahinë, Met Rexhen etj., pleqnuan jo vetëm në Postribë, por edhe në malësi të tjera si në Dukagjin, Shllak, Malësi të Madhe e deri në Gjakovë. Ai ka qenë burrë i drejtë, i ndershëm, bujar, i besës, fisnik, tolerues, njeri i ekuilibruar, i matur në marrje vendimesh.

Pleqimin në kuvende ai e ka trashëguar nga baba i tij, Veli Bracaj. Tregohet një ngjarje: Veli Braci bie në gjak me Shalën dhe shaljanët i vrasin djalin e tij të quajtur Hasë Veli Bracaj. Kur Shaljanët i shkojnë Veli Bracit për ngushëllim, bisedojnë me njëri-tjetrin dhe thonë se Veli Bracaj nuk paska lënë djalë hajri si trashëgimtar. Kur u rrit vëllai i të vrarit, Brahim Veli Bracaj, merr pjesë në një pleqni për vendosje kufinjsh që organizohet në mes Sumës së Postribës dhe Xhanit të Dukagjinit. Në përfundim të pleqnisë u vendos ashtu siç tha Brahim Veli Bracaj. Brahim Veli Bracaj i tha njërit prej pleqve të Dukagjinit që kishte marrë pjesë në pleqni dhe që dikur kishte qenë për ngushëllim në shtëpinë e tij për vrasjen e vëllait: “Në shtëpinë time kur keni qenë për ngushëllimin e vëllait tim të vrarë nga Dukagjini keni thënë se Veli Bracaj nuk paska lënë djalë hajri si trashëgimtar. Unë jam djali i Veli Bracajt”. Ata e përgëzuan dhe e pranuan se vërtetë kishin thënë ashtu, por e pranuan se kishin gabuar, pasi Veli Bracaj vërtetë kishte lënë një trashëgimtar të mirë për pleqni.

Brahim Veli Bracaj ka pleqnuar edhe në Shkodër e më gjerë. Ai mori pjesë edhe në pleqimin e kufinjve në mes Drishtit (lagjes Amarej) dhe Domnit, por kjo pleqni mbeti e papërfunduar, pasi ky vdiq. Pas vdekjes së tij kjo pleqni u krye nga Isen Mehmet Bracaj, Sadri Muç Mastaj, etj.

Brahim Veli Bracaj ishte jo vetëm burrë pleqnie, por edhe një prej burrave të fortë në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe të integritetit tokësor. Në vitin 1912-1913, në Rrethimin e Shkodrës ai merr pjesë së bashku me gjithë Postribën në frontin e Myselimit dhe atë të Bardhanjelit, nën komandën e komandantit popullor Adem Haxhija, ku shquhen në këtë front për trimëri, guxim dhe organizimin e luftës.

Brahim Veli Bracaj merr pjesë në kryengritjen kundër Austro-Hungarisë në vitin 1916 dhe në afërsi të Urës së Mesit e thyejnë ushtrinë austro-hungareze.

Në vitin 1920, në Luftën e Koplikut Brahim Veli Bracaj merr pjesë me të gjithë burrat e Domnit e të Postribës në këtë front dhe me guxim e trimëri e mundin armikun, duke e detyruar të kalojnë jashtë kufinjve tokësorë të territorit të atdheut.

Fisi Bracaj, për arsye gjaku detyrohet të largohet nga Domni dhe Postriba dhe vendoset në Krujë për një periudhë prej mbi 30 vjetësh. Pasi bëhet pajtimi nga pleqnia e Postribës dhe e Maleve, në mes fisit të Bracajve dhe fisit me të cilin kishin ndërruar meshkujt, Bracajt kthehen përsëri në Postribë, në fshatin e tyre, në Domën, duke lënë një vëlla në Krujë dhe një vëlla tjetër në fshatin Myselim të Postribës. Në Myselim janë familjet e Hysen Brahimit, Dan Imerit etj. të cilët janë kushërinj me Bracajt e Domnit.

Brezat e rinj do ta kujtojnë me respekt e mirënjohje Brahim Veli Bracin, si një burrë i urtë, i drejtë, trim, mikpritës, i besës, fisnik dhe një nacionalist i vendosur në mbrojtje të pavarësisë kombëtare dhe të integritetit tokësor.

BRAHIM ZENELI (PLANGAJ) - BOKS

Brahim Zeneli u lind në fshatin Boks të zonës së Postribës rreth vitit 1885 në një familje me tradita të mira nacionaliste. Baba i tij Zenel Brahim Plangaj pati dy djem, Brahimin dhe Nuzin. Që i ri Brahimi kishte prirje nacionaliste. Ai pëlqente të rrinte me burra që luftonin për mbrojtjen e trojeve nga të huajt. I pëlqenin burrat që kishin guxim, që ishin të besës, të bujarisë, të burrërisë. Ai merrte pjesë në çdo luftë që bëhej për mbrojtjen e vendit të tij, nuk i shmangej asnjë beteje sado e rrezikshme të ishte për pjesëmarrësit.

Duke manifestuar të gjitha virtytet e trimërisë, të burrërisë, të besës, të guximit, të fisnikërisë, komandanti i luftëtarëve të Postribës, Adem Haxhija (Spahija) e afroi afër vetes, duke e mbajtur si një nga luftëtarët më trima dhe më besnikë të tij. Aty ku ishte Adem Haxhija ishte edhe Brahim Zeneli.

Duke pasur shumë besim në komandantin e tij, Adem Haxhinë, ai i qe shprehur: “Adem Aga, aty ku të vesh këmbën ti, unë do të vë kryet. Mua më ke me vete sa të marr frymë!”

Brahim Zeneli ishte një burrë me trup të madh dhe të zhdërvjelltë, i pashëm, me mustaqe deri te veshët, i bëshëm, me vullnet të pathyeshëm, besimtar dhe fisnik. Ai mbante pothuajse gjithmonë çakçirë me spik, xhamadan ari, gjurdie, qeleshe të bardhë, gjerdan fishekësh dhe armë të kohës.

Brahim Zenelit nuk i erdhi një vdekje siç i takon një trimi. Ai u vra pabesisht, megjithëse deshi të merrte në besë një dukagjinas. Dhe ngjarja u zhvillua kështu: Një grup prej dy-tre vetash dukagjinas duke zbritur nga Dukagjini për në Shkodër, në lagjen Milan të Domnit vrasin burrin milanase të quajtur Adem Sela. Vrasja u krye në Milan. Arsyeja ishte për të marrë pushkën e tij. Në këtë moment, çelë Murati (Shabaj) qiti kushtrimin se Dukagjini kishte vranë Adem Selën e Milanit prandaj të ziheshin pritat dhe të merrej gjaku!

Në këtë kohë, burrat e fisit Plangaj ishin duke prashitur në arën e quajtur “Vreshtë”, buzë Kirit. Rruga për Shkodër kalonte nën Vreshtë. Brahim Zeneli i del para vrasësit dhe i thotë: “Po të kesh vra njeri bjer në dorë teme se nuk të vret njeri. Je në besë të burrit!” Brahim Zeneli nuk kishte armë me vete por ashtu siç qe duke punuar i doli para pa armë. Dukagjinasi kishte armën e mbushur dhe ishte nën Brahimin. Meqenëse kishte frikë për t’u dorëzuar, vret Brahim Zenelin dhe ikën. Por nuk do të kalonte shumë rrugë dhe e vrasin njerëzit e fisit të Brahimit. Dukagjinasi tjetër që kishte me vete merr iken drejt Drishtit për t’u strehuar aty por nuk e pranojnë drishtjanët për ta strehuar dhe në ndjekje e sipër e vrasin në ograja të Drishtit.

Kjo përpjekje për të marrë një armë u kurorëzua me vrasjen e katër burrave, dy dukagjinas dhe dy postribas.

Në këtë mënyrë i erdhi vdekja trimit Brahim Zeneli, i cili gjithë jetën e tij ia kushtoi mbrojtjes së trojeve të veta dhe jetës së ndershme në familjen e tij. Brahim Zeneli para se të vritej ishte burrë i martuar, por nuk arriti të linte trashëgimtar, pasi atë vit ishte martuar me një grua nga një shtëpi e fisme.

Më shumë se sa kam thënë deri tani e tregon kënga se kush ishte Brahim Zeneli, ndaj dhe do të citoj një fragment të kësaj kënge që populli nxorri për të gjallë të tij:

“... Hamnesha e krajlit çka ka thanë:

Treqind lira i kam dhanë
Treqind lira i jap në dorë
Kush t’mi mbysin tre boksorë
Adem Haxhinë vetë të tretin
Sadri Alinë, Brahim Zenelin ...”

Pra siç shihet nga kënga, Brahim Zeneli njihej aq shumë sa ishte bërë objekt bisede edhe në Pallatin mbretëror të Krajl Nikollës, si një nga burrat postribas më të rrezikshëm, sa që hamnesha (e shoqja e Krajl Nikollës) e krajlit kishte vënë pare në dispozicion për atë njeri që do të vriste tre boksorë, një prej të cilëve ishte Brahim Zeneli i fisit Plangaj.

Brahim Zeneli do të kujtohet si një burrë trim i Postribës për shumë breza me rradhë.

ÇELË MURAT SHABAJ - BOKS

Çelë Murat Shabaj u lind në fshatin Boks më 10 korrik të vitit 1874 në një familje të mëkamun ekonomikisht dhe me tradita të shquara patriotike, bir i një burri të njohur, të quajtur Murat Imer Shabaj, nga i cili trashëgoi cilësitë më të virtytshme duke qenë edhe ky po aq me emër të mirë sa dhe i ati i tij.

Ky, veç cilësive të tij morale e intelektit, shquhej për paraqitjen e tij fizike, i dalluar për shtatllartësi dhe pamje të hijshme. Në kompleks, këto vlera e bënin çelën mjaft befasues kudo që ndodhej në mjedise shoqërore.

Në vazhdim të babait të tij, ai, që në moshë të re ishte i lidhur me parinë e Shkodrës dhe atë të krahinave malore duke u angazhuar kështu në aktivitete shoqërore.

Në materialin që më ka paraqitur nipi i tij, Faz Shabaj, thuhet se çelë Murati ishte pritësi i parë në konakun e tij, të intelektualit të shquar e antikomunistit, Rasim Boksi nga qyteti i Shkodrës, i cili në vatrën e Çelë Muratit ndezi shkëndijën fillestare të organizimit të kryengritjes antikomuniste të 9 shtatorit...

Për Kryengritjen Antikomuniste të 9 shtatorit unë kam shfrytëzuar tre materiale të autorëve kryesorë, atë të Uran Butkës (Ringjallja), të Ahmet Bushatit (Në gjurmë të një ditari) dhe të Caf Jonuzit (Krushqit e Lirisë). Te "Ringjallja" të autorit Uran Butka ka për Rasim Boksin si më poshtë: "...Murat Haxhija dhe Rasim Boksi, dy atdhetarë shkodranë dhe antikomunistë të vendosur, pas një rezistence me armë që u bënë forcave të Sigurimit të Shtetit, u zunë të gjallë."

Për kryerjen e aktivitetit kundër shtetit të diktaturës komuniste, çelë Murati bashkë me disa pasues të tjerë, shokë e miq të tij nga Postriba, të survejuar nga sigurimi i shtetit përfunduan në prangat e diktaturës komuniste, e cila i dënoi me heqje lirie deri në vitin 1953 që dolën nga burgu.

I brumosur që në moshë të re me ndjenja nacionaliste, çelë Murati bashkë me shumë burra të tjerë nga Postriba qenë përkrahës të flaktë të mbretit Zog. Këtë e treguan më së miri kur çelë Murati së bashku me burra të tjerë nga Postriba ndihmuan në rikthimin e mbretit Zog në Shqipëri pas arratisjes së tij në Jugosllavi në qershor të vitit 1924.

Sipas nipit të tij, Faz Shabaj, për vlerat dhe kontributin e tij, çelë Murati bëhet mik i afërt i mbretit Zog dhe për rrjedhojë mbreti i jep gradën e kapitenit çelës, por ky, sipas nipit, nuk e pranon këtë ofiq pa e marrë më parë kushëriri i tij Imer Beqiri dhe kushëriri i tij nga nëna, Adem Haxhija. Këtë, sipas nipit të tij, e bëri sepse këta ishin më të mëdhenj në moshë. Mbreti aprovon vërejtjen e çelës me plot respekt dhe dërgon gradën "kapiten" për dy burrat e mësipërm, shumë të nderuar, dhe gradën toger për Çelë Muratin (kjo, gjithnjë, sipas nipit të tij, z. Faz Shabaj).

Çelë Murat Shabaj njihet nga bashkëkohësit e tij si një burrë fisnik, i shkathët, i guximshëm e trim, burrë i besës e mikpritës. Ai do të kujtohet nga brezat si një burrë i matur e serioz, si një burrë i besës dhe nationalist i vendosur në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe integritetit tokësor.

DYL OSO VELIJA (ALIJAJ) - MYSELIM

Dyl Oso Velija rrjedh nga një familje me tradita të mira nacionaliste të fisit Alijaj nga fshati Myselim i Postribës. Duhet të sqarohet se fisi i Dyl Osos vërtetë kanë ardhur nga Alijajt e Kastratit, por nuk mbahen kushërinj me fisin Alijaj, të cilët e mbajnë këtë mbiemër edhe sot. Me këtë fis, thuhet se janë mbështetur fisi i Dyl Osos dhe shtëpia e Fasli Rrustos, që mbajnë të njëjtin mbiemër dhe janë të ardhur edhe këta nga Alijajt e Kastratit, siç thonë, por nuk kanë lidhje gjaku me ta. Sot të gjithë këta, siç thonë disa pleq, funksionojnë si një fis i përbashkët. Mbiemri Velija s' është asgjë tjetër vetëm se emri i gjyshit të Dyl Osos.

Fisi Alijaj, sipas studiuesit Hashim Kopliku, është ndër fise të vjetra të fshatit Myselim. Janë të ardhur prej Alijajve të Kastratit. I pari i këtij fisi thuhet se ishte Gjetoja, i cili pasi erdhi këtu u bë mysliman. I biri i tij, Alija, emrin e të cilit e mbajtën si mbiemër pasardhësit, u bë i parë, ose kryepari mbi Myselim, e brez pas brezi e mbajtën parinë deri vonë (1937).

Thuhet se parinë mbi Myselim ia pati dhënë Alisë, njëri nga vezirët e Shkodrës. Këtë pari ia dha për trimërinë që tregoi në luftën e Moresë, kundër grekëve. (Hashim Kopliku, "Cirka", 1937, f. 129).

Dyl Osja ka lindur në fshatin Myselim rreth vitit 1882 dhe ka vdekur në Myselim në vitin 1957, në moshën 75 vjeçare.

Shtëpia e Dyl Osos ka qenë shtëpi e madhe dhe e njohur në Myselim. Ajo ka pasë rreth 50 veta në familje, në 5-6 kurorë dhe tre deri në katër breza njerëzorë në familje.

Shtëpia e Dyl Osos ka pasur rreth 300 dynym tokë arë, kullosë e livadhe. Ka pasur gjithashtu mbi 150 krerë dhenë, 10 krerë lopë, dy pendë qe për punimin e tokës, kale shale, kalë samari për ngarkesë, gomerë, qerre, karrocë për transport etj.

Dyl Osja me meshkuj të vet ka marrë pjesë në të gjitha luftërat për mbrojtjen e trojeve nga pushtuesit, për mbrojtjen e lirisë, pavarësisë dhe sovranitetit.

Dyl Osja ka marrë pjesë në Rrethimin e Shkodrës në vitin 1912-1913 në frontin e Myselimit dhe atë të Bardhanjelit bashkë me burrat e tjerë të Postribës, nën komandën e komandantit popullor Adem Haxhija.

Ai ka marrë pjesë në kryengritjen kundër pushtimit austro-hungarez në vitin 1916 në afërsi të Urës së Mesit, ku u vranë disa ushtarë dhe u dorëzuan në besë të Murat Imerit dy ushtarë boshnjakë të cilët u dorëzuan shëndosh në Shkodër. Dyl Osja ka marrë pjesë në Luftën e Koplikut në vitin 1920 bashkë me burra të tjerë të Postribës nën drejtimin e Adem Haxhisë. Këtu u vranë dhe u plagosën disa luftëtarë nga Postriba.

Dyl Osja merr pjesë në rezistencën antifashiste më 7 prill 1939 i inkuadruar nën komandën e Adem Haxhisë të dislokuar në Kodra të Tepes, tek Ura e Bahçallekut dhe në Kodra të Bërdicës.

Gjatë luftës Nacional-çlirimtare shtëpia e Dyl Osos bëhet një nga bazat e kësaj lufte duke strehuar partizanët, duke i ushqyer dhe duke i përcjellë.

Djemtë e Dyl Osos, Islam Dyli dhe Beqir Dyli, marrin pjesë në Luftën Nacionalçlirimtare duke qenë partizanë në vitet 1945-1947 në kufi me Greqinë

Në Kryengritjen Antikomuniste të 9 shtatorit 1946 marrin pjesë bashkë me postribas të tjerë edhe dy djemtë e Dyl Osos, Muho Dyli dhe Mehmet Dyli, të cilët u denuan për pjesëmarrjen në këtë kryengritje. Muho Dyli dënohet me 5 vjet heqje lirie dhe Mehmet Dyli me tre vjet heqje lirie.

Dyl Osja ka qenë një njeri me temperament të qetë, burrë i matur dhe i ekuilibruar. Ai ka qenë burrë i besës, mikpritës, i dashur me njerëzit, i respektueshëm dhe i respektuar në shoqëri. Dyl Osja ka qenë njeri fisnik, ka qenë shumë falës ndaj shoqërisë. Ai ka qenë burrë me karakter të fortë dhe i vendosur në kryerjen e punëve dhe projekteve që ka synuar.

Dyl Osja dhe djemtë e tij e kanë dashur shumë këngën e sidomos këngët e epikës legjendare si ato të Mujit e Halilit, të Gjergj Elez Alisë etj. Gjithashtu ata i kanë dashur këngët e epikës historike si këngët e dëshmorëve të luftës, të heronjve, të trimave, të udhëheqësve të luftës si këngët e Dedë Gjo Lulit, të Adem Haxhisë, të Dasho Shkrelit, të Oso Kukës etj. Beqir Dyli jo vetëm që i ka dashur këngët por ka qenë edhe një instrumentist i mirë. Ai ka përdorur fyellin shumë mirë.

Dyl Osja ka qenë një besimtar i mirë. Ka zbatuar shtyllat e Islamit, ka falë pesë kohët e namazit, ka agjëruar Ramazanin, ka falë zeqatin. Ai ka qenë kujdestar i xhamisë së Mes-Myselimit bashkë me burra të tjerë besimtarë.

Dyl Osja nuk ka pasur komplekse fetare. Ai nuk ka bërë dallim mes myslimanëve e katolikëve. Ai ka pasur kumbari me katolikë, si me fisin e Gjysh Shanajve nga Bardhajt. Djali i Dylit, Islami ka pasur shoqëri të ngushtë me Gastil Gjergjin nga Bërdica, si dhe me Dan Malushin e Lohes së Malësisë së Madhe.

Në shtëpinë e Dyl Osos janë marrë me blegtori kryesisht Beqir Dyli, Tahir Osja, Bajram Velija, ndërsa Rexhep Osja është marrë me plugimin e tokës me pendët e qeve, të cilët i donte shumë dhe u shërbente me kënaqësi.

Shtëpia e Dyl Osos do të mbetet në kujtesën e brezave si një ndër shtëpitë e njohura të Postribës për nacionalizëm, për pasuri, për sjellje njerëzore në shoqëri, për besim, për ndershmëri e të tjera virtyte njerëzore. (Shënim: të dhënat u siguruan nga Smajl Islami në bashkëpunim me autorin e këtij libri, si dhe me të dhëna nga historia, shënimi im R. S).

EMIN ZYBER ÇELAJ - DRAGOÇ

Emin Zyberi rrjedh nga një familje me tradita shumë të mira patriotike të fisit çelaj, të ardhur nga fshati Dragosh i Prizrenit.

Emin Zyberi ka lindur në fshatin Dragoç të zonës Postribë, me datën 10 gusht 1889 dhe ka vdekur më 16 shtator të vitit 1962.

Ai ka jetuar që në periudhën e pushtimit turk dhe pastaj ka kaluar periudhën e pavarësisë, regjimin e Zogut, të pushtimit italian e gjerman dhe në fund atë të regjimit komunist, duke kaluar disa regjime. Ai pëlqeu të merrej me politikë, duke i qarkulluar në gjak idetë nacionaliste.

Emin Zyberi ka marrë pjesë në të gjitha luftërat që janë zhvilluar në mbrojtje të pavarësisë kombëtare, të lirisë dhe të integritetit tokësor.

Ai ka marrë pjesë në Rrethimin e Shkodrës të vitit 1912-1913, në frontin e Fushave të Myselimit dhe të Bardhanjelit, megjithëse në moshë të re 22-23 vjeçare, i inkuadruar nën komandën e Adem Haxhisë, si komandant popullor që ishte.

Emin Zyberi ka marrë pjesë në kryengritjen kundër Austro-Hungarisë në vitin 1916, që u zhvillua në shkallë Postribe në afërsi të Urës së Mesit, duke i detyruar forcat austro-hungareze të ikin me ngut për në Shkodër.

Në vitin 1920 Emin Zyberi merr pjesë me të gjithë Postribën në "Luftën e Koplikut" nën udhëheqjen e komandantit popullor Adem Haxhija dhe shquhen në përpjekjet me ushtrinë malazeze në Kodra të Moksetit.

Gjithashtu Emin Zyberi merr pjesë në rezistencën që i bën Postriba pushtimit fashist më 7 prill 1939. Rezistenca organizohet në Kodrat e Tepes, tek Ura e Bahçallekut dhe në Kodra të Bërdicës, nën drejtimin e Adem Haxhisë. Ai luftoi përkrah me Selim Racin dhe Cen Ademin e Boksit. Cen Ademi tregoi heroizëm duke grirë me mitroloz pararojën e forcave fashiste italiane.

Emin Zyberi merr pjesë në "Kryengritjen Antikomuniste të 9 shtatorit të vitit 1946, dhe ishte një nga organizatorët kryesorë të fshatit Dragoç dhe të gjithë Postribës, nën drejtimin e Osman Haxhisë. Sipas djalit të tij, Qamil Emini, u dënua me 101 vjet burg Osman Haxhija dhe Avdullah Sahiti, ndërsa të tjerët u dënua me 20 vjet burg. Pra edhe Emin Zyberi u dënua me 20 vjet burg.

Gjatë torturave në burgun komunist, kur ata po e rrihnin në trup e në këmbë, ai u thotë: "Mos më bini as në trup as në këmbë por në krye, sepse ky i ka sjellë ato këtu." Kur organi i akuzës e akuzoi si tradhtar Emin Zyberin, ai u tha: "E keni gabim, unë nuk jam tradhtar sepse nuk e kam tradhëtuar atdheun, por jam kundërshtar i juaji, prandaj jam këtu."

Kur e pyeti Fadil Kapisyzi, si hetues: "Emin pse na re ne, pse na sulmove? " Emini tha: "Kur erdhi mësuesi e na tha se me urdhër të qeverisë do të mbyllen mejtepet, kam thanë: a do të ketë ndonjë gabel që të dalë kundër jush? Prandaj ju kemi ra sepse jena nacionalistë dhe besimtarë."

Në lidhje me çështjen e grave ai thoshte: "Ne gratë s'i marrim vesh, por si thonë ato bajmë".

Në vitin 1937 Emin Zyberi ishte kryeplak i fshatit Dragoç. Ai bëri kërkesë zyrtare bashkë me pleqtë e fshatit Dragoç si Hajdar Tafa, Selim Raci e të tjerë, për hapjen e shkollës së parë në Dragoç në vitin 1937. Shkolla u hap në shtator të vitit 1938. Mësuesi i parë i kësaj shkolle ishte Sheuqet Golemi, i cili punoi në këtë shkollë deri në vitin 1940. Pas tij erdhi mësues Nazmi Bekteshi.

Në vitin 1940 regjimi fashist kërkoi në Postribë për të regjistruar të rinj në shkolla milicie e fashiste. "Pak më parë se të thirrshim për këtë punë- thotë Emini – pleqësia e Postribës të gjithë së bashku vendosëm që të mos lejonin të rinj për t'u regjistruar as për milicë dhe as për fashistë". Në këtë periudhë Emin Zyberi ishte kryeplak, ndërsa pleq ishin në Dragoç Cuf Ademi, Dervish Nuzi, Dul Braci e Hajdar Tafa. Emin Zyberi u thotë pleqve të fshatit Dragoç: "Kena vendosë si Postribë mos me shkrua as milicë as fashistë. Unë si Emin me fis tem nuk shkruaj as milicë as fashistë." Cuf Ademi i drejtohet Eminit: "As fisi im nuk guxon me shkrua asnjë. Ne kena hallin tand se mos të fusin në burg". Emini u thotë pleqve: "Mos kini gajle për mue se unë ja baj hallin".

Fashistët e futën Eminin në burg për 24 orë, sa për ta frikësuar, por me ndërhyrjen e Selim Racit me miqësi u detyruan ta lëshonin.

Emin Zyberi ka qenë tip i qetë, i ekuilibruar, i gjallë dhe me karakter të fortë. Ai ka qenë njeri i besës, bujar, trim, i sjellshëm në shoqëri, i duruar dhe i drejtë e i ndershëm. Ai ka qenë i sjellshëm edhe në familje.

Emin Zyberi ka pëlqyer këngët patriotike dhe ato të kreshnikëve. Emin Zyberi ka qenë një besimtar i mirë. Ai ka falë pesë kohët e namazit jo vetëm kur ishte i lirë në shtëpinë e tij, por edhe atëherë kur ishte i dënuar në burg.

Emin Zyberi do të kujtohet nga brezat pasardhës si një burrë i besës, i drejtë, i urtë dhe i zgjuar, trim e patriot i devotshëm në mbrojtje të lirisë, të sovranitetit kombëtar dhe të integritetit tokësor.

EMIN GANI SPAHIJA - BOKS

Emin Spahija u lind në fshatin Boks të komunës Postribë, në vitin 1963. Ai rrjedh nga një familje patriotike e fisit Spahijaj. Në damarët e fisit ka qarkulluar brez pas brezi nacionalizmi i pastër. Emin Spahija u rrit nën edukimin nacionalist të baballarëve, gjyshërve e stërgjyshërve të fisit, me thjeshtësinë, besnikërinë, krenarinë, fisnikërinë, trimëritë dhe heroizmat e fisit.

Emin Spahija mori mbi shpatullat e tij një nga detyrat më të vështira, më fisnike, më humane dhe më nacionaliste, mbrojtjen e jetës së qytetarit shqiptar nga gjakmarrja e hakmarrja. Detyra e tij si kryetar i Lidhjes së Misionarëve të Paqes, është puna më e vështirë që merr mbi vete dhe detyra më e shenjtë. Nuk është e lehtë të merret një përgjegjësi e tillë mbi vete kur akoma nuk ka shtet, kur korrupsioni ka prekur majat e piramidës shtetërore, kur vepron krimi i organizuar dhe kur jeta e njeriut në çdo moment është në rrezik. Ai e mori këtë detyrë sepse kishte një zemër të madhe dhe shpirt njerëzor. Ai e mori këtë detyrë sepse e kishte të edukuar nga familja, fisi e religjioni, dashurinë për njeriun, mbrojtjen e jetës së tij. Jetën ta jep Zoti, thoshte ai, dhe askush nuk ka të drejtë ta marrë atë, përveç Krijuesit.

Askush nuk vjen në këtë jetë me dëshirën e tij dhe askush nuk largohet nga kjo jetë me dëshirën e tij. Emin Spahija e kishte një besim të tillë tek Zoti, ndaj dhe punonte me qëllimin e lartë Hyjnor e njerëzor, ditën dhe natën, pa u ruajtur nga askush, pa patur frikë nga asnjë njeri. Ai punonte me një qëllim të shenjtë: “ Të mbrojmë jetë njerëzore!”. Por do të vinte një moment që çdo gjë do ta kërkonte në mes këtë akt Hyjnor: “...Të hënën, më 9 gusht 2004, në orët e para të ditës, jeta e Emin Spahisë ndërpritet nga një dorë kriminale, në mënyrën më të pabesë dhe në mënyrën më të mistershme. Vepra e tij nuk e vlente një shpërblim të tillë mizor”.

Të hënën në mbrëmje, më 9 gusht 2004, pas një varrimi madhështor nga familja, fisi, Postriba, Shkodra, Shqipëria dhe organizatat e misionarëve të paqes e të pajtimit të gjaqeve, brenda dhe jashtë kufijve shtetërorë, Emin Spahija u nda nga ne, duke u bashkuar me të shumtit. Ai na la duke na ngarkuar me amanetin e vazhdimit të veprës së tij. Shokët, miqtë, të afërmit, të gjithë ata që ai i ndihmoi të dilnin nga ngujimi, ata që ai pajtoi, të gjithë dashamirësit e tij nga Shqipëria dhe jashtë kufijve shtetërorë, i dhanë lamtumirën e fundit. Ai që deri dje shpëtonte jetë njerëzish, që i ndihmonte ata me punën e tij fisnike, nuk mund të ndihmohej më nga askush. Shiriti i jetës ishte këputur. Siç thotë Armand Maho i gazetës “55”: “Prej Emin Spahisë, tashmë ka mbetur vetëm kujtimi i tij, por edhe mesazhi i paqes, si dhe inkurajimi për të luftuar kundër gjakmarrjes”.

Emin Spahija e fillon punën si kronikan pranë zyrës së pajtimit të gjaqeve në rrethin e Shkodrës në vitin 1992. Me kamerën e tij ai filmoi me dhjetra pajtime gjaqesh, në rrethe të ndryshme të veriut të Shqipërisë. Në vitin 1997 Emin Spahija krijon organizatën “Lidhja e Misionarëve të Paqes” duke qenë në krye të këtij misioni. Me punën e tij plot pasion, dashuri e këmbëngulje në frenimin e fenomenit të gjakmarrjes, ai arriti të pajtojë me qindra familje, jo vetëm brenda kufijve, por edhe në Kosovë e Maqedoni. Si kryemisionar i paqes ai diti të krijojë lidhje të ndërsjellta me vartësit e tij dhe me komunitetin që ishte në nevojë për zgjidhje konfliktesh. Ai ishte shumë komunikues, i dashur, i thjeshtë, i respektueshëm. Ai dinte të hynte në botën e brendshme të çdo njeriu, duke imponuar natyrshëm respekt, dashuri e mirësjellje. Ai ishte jo vetëm njeri i vlerave por edhe i aksionit, duke qenë i gatshëm për të shkelur me këmbë dhjetëra fshatra të Shqipërisë e më gjerë dhe së bashku me misionarët e tjerë të ndalojë me qindra konflikte të ndryshme.

Emin Spahija, si kryemisionar i paqes, u bë i njohur jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë kufinjve shtetërorë, si në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, pasi ishte kryetar i “Lidhjes së Misionarëve të Paqes” mbarë kombëtar. Por njohja e tij nuk u kufizua vetëm në vendet e Ballkanit ku kishte shqiptarë, ajo i kaloi këta kufinj. Emin Spahija u njoh me një mjek dhe studiues japonez, të quajturin Kazuhiko Yamamoto, i cili ishte i apasionuar pas studimit të Kanunit të Lekë Dukagjinit. Ai mbajti lidhje miqësore me Emin Spahinë aq sa në një letër që i dërgon më 5 janar 2006 (dy vjet pas vdekjes së tij, Yamamoto nuk dinte gjë për vrasjen e Eminit), duke i nisur me këtë letër edhe artikujt lidhur me librin e tij, ndër të tjera i thotë: “...Ju dërgoj artikujt lidhur me librin tim. Do të jetë kënaqësia ime nëse ju i lexoni ata...Kazuhiko Yamamoto”.

Emin Spahija u bë i njohur pas vdekjes së tij edhe në Këshillin e Europës. Këshilltari i posaçëm i Këshillit të Europës në Shqipëri, Fyu-Michel Brandtner, shpreh shqetësimin e Këshillit të Europës lidhur me vrasjen në Shkodër me 9 gusht 2004, të misionarit të paqes, Emin Spahija. Ai thekson se “vrasja e Emin Spahisë është një goditje serioze ndaj luftës kundër hakmarrjes dhe pajtimit të gjaqeve...Këshilli i Europës...është thellësisht i shqetësuar nga kjo vrasje dhe u bën thirrje autoriteteve shqiptare, të përdorin të gjitha mjetet për të dorëzuar vrasësin, përpara drejtësisë...”

Në qendrën e qytetit të Shkodrës ishte vendosur zyra e tij, Zyra e Misionarëve të Paqes, ku çdo ditë shkonin me dhjetëra njerëz, që kërkonin ndihmë tek kryemisionari, i cili me punën e tij, me fjalët e ëmbla që vetëm ai dinte t'i nxirrte, ka arritur që gjatë shtatë viteve në krye të misionit, të pajtojë rreth 1100 familje, që ishin të ngujuara nga fenomeni i gjakmarrjes. Në ish zyrën e tij gjendej një arkiv shumë i pasur gjatë viteve, i pajtur me dokumenta, fotografi, kaseta filmike të familjeve që kanë përjetuar plagët e gjakmarrjes, gjen hasmëri që janë pajtuar, gjen edhe të dhëna statistikore për përmasat e kësaj plage në shumë rrethe të vendit, fenomen që vitet e fundit, ka ardhur duke u minimizuar. Ai arriti që, së bashku me misionarët e tjerë të paqes, të ulë masën e dhimbjes që fenomeni i gjakmarrjes krijonte, duke mundësuar uljen e tij nga viti në vit. Vitin e fundit të jetës së tij, në rrethin e Shkodrës, ka ndodhur vetëm një vrasje nga fenomeni i gjakmarrjes, duke treguar edhe një herë se misioni i paqes që ai drejtonte po e kryente mjaft mirë këtë detyrë.

Emin Spahija ishte jo vetëm nderi i Postribës, por i gjithë veriut të vendit, i gjithë Shqipërisë. Si i tillë ai do të kujtohet gjithmonë si Kryemisionari i Paqes i gjithë shqiptarëve.

FAZ TAHIR SHABAJ - BOKS

Faz Tahir Shabaj rrjedh nga një familje e fisit Shabaj të fshatit Boks të Postribës, me tradita shumë të mira nacionaliste brez pas brezi. Faz Shabaj u lind në fshatin Boks, më 3 shkurt të vitit 1949. Ai mbaroi shkollën e mesme të përgjithshme “Jordan Misja” Shkodër në vitin 1967. Gjithashtu mbaroi shërbimin ushtarak në vitet 1968-1971.

Pas mbarimit të shërbimit ushtarak emërohet mësues në zonën e Temal-Dushmanit në vitin 1972 dhe vazhdon deri në vitin 1974. Në këtë vit e largojnë nga arsimi për motive politike, i cilësuar “familje kulakësh” dhe pjesëmarrje e gjyshit të tij në Kryengritjen Antikomuniste të Postribës.

Pasi e largojnë nga puna ai shkon për të punuar në veprën energjitike “Hidrocentrali i Fierzës”, më vonë në veprën energjitike të Komanit dhe së fundi në veprën energjitike të Banjës deri në vitin 1985.

Në vitin 1981 mbaron shkollën e mesme “dega elektrike” në Shkodër. Në vitet 1985-1991 punon me detyrën e elektriciut në fabrikën e gëlqeres në Mes të Postribës.

Në vitet 1990 e mbrapa është përfshirë në lëvizjet demokratike dhe për merita është zgjedhur sekretar i grup-seksionit të Partisë Demokratike si dhe kryetar i seksionit të Partisë Demokratike të fshatit Boks.

Si rezultat i zgjedhjeve politike të vitit 1991 është emëruar kryetar i këshillit pluralist të Postribës.

Në vitin 1992 ka hedhur kandidaturën për kryetar komune në zgjedhjet e para lokale dhe ka fituar mandatin si kryetar komune i Postribës. Gjithashtu edhe në mandatin e dytë 1996-2000, në mandatin e tretë 2000-2003, në mandatin e katërt 2003-2007 dhe në mandatin e pestë 2007-2011 është zgjedhur në vazhdimësi kryetar i komunës Postribë.

Gjatë periudhës 1996-2009 është anëtar i kryesisë së Partisë Demokratike dega Shkodër. Që nga krijimi për herë të parë i qarkut është anëtar i kryesisë së qarkut Shkodër.

Gjatë gjithë këtyre viteve të aktivitetit të tij ka punuar me përkushtim për mirëqenien e komunitetit për zhvillimin e Postribës si dhe për zhdukjen e hendekut të ndarjeve partiake të krijuara që nga koha e komunizmit.

Kohët e fundit, Faz Shabaj ka punuar me përkushtim për përmirësimin e infrastrukturës rrugore pothuajse në të gjitha fshatrat e Postribës, por më shumë në zonën fushore si në Mes-Myselim, në Boks, në Dragoç, në Kullaj etj. Gjithashtu me krijimin e një donacioni të huaj u punua për të rregulluar infrastrukturën rrugore të Kalasë së Drishtit, e cila kohët e fundit është asfaltuar me një gjerësi prej 4 m e gjysmë deri në portën e hyrjes së lindjes si dhe po punohet për rregullimin e rrugës brenda kalasë, nga porta në portë.

Faz Shabaj duke qëndruar për një kohë të gjatë si drejtues i komunës Postribë, ka fituar popullaritet dhe reputacion në të gjithë Postribën. Ai nuk ka komplekse ndaj njerëzve por i trajton të gjithë postribasit si të barabartë dhe secilit i jep të drejtën po t’i takojë, qoftë i djathtë, qoftë i majtë. Për Faz Shabën janë të gjithë postribas dhe nuk bën asnjë dallim partiak.

Më 9 shtator të vitit 2008, me rastin e 62 vjetorit të Kryengritjes së parë Antikomuniste të Postribës, presidenti i Republikës z. Bamir Topi vjen në Postribë së bashku me kryetaren e Parlamentit znj. Jozefina Topalli dhe i dorëzon kryetarit të komunës, Faz Shabaj titullin e lartë Postriba “Nderi i Kombit”. Kjo do të mbetet si një ngjarje e madhe historike për Postribën, por do të jetë nder i madh edhe për kryetarin e kësaj komune që pati fatin t’i dorëzohej nga presidenti ky titull i lartë: Postriba “Nderi i Kombit”.

Si përfundim mund të themi se Faz Shabaj, pavarësisht moshës së re që ka në krahasim me burrat e tjerë të Postribës, e meriton të jetë krah tyre, pasi është burrë i besës, fisnik, i respektueshëm, dhe i palodhur në punën e tij. Ai meriton respekt dhe mirënjohje nga të gjithë.

GJETO ZYBER SHMARQE - DRISHT

Gjeto Zyberi (Shmarqe) është me origjinë nga bajraku i Sumës, lagjja Gurra-Dajcë. Ai është në fis me familjen e vjetër të Kasem Imerit, të Ndoc Stakës dhe të Mëhill çotës etj. Në linjë gjenealogjike Gjeto Zyberi del në brezin e pestë katolik dhe konkretisht Gjeto-Zyber-Mustafë-Elez-Prelë-Ali-Dol-Kuçi. Familja e Brahim Kasemit bashkohet me Gjeto Zyberin tek Elezi dhe konkretisht: Brahim-Kasem-Imer-Elez-Prelë-Ali-

Dol-Kuçi. Me familjen e Ndoc Stakës Gjeto Zyberi bashkohet tek brezi i tretë duke filluar nga Dol Kuçi, shqiptar i Malit të Zi. Kështu kemi: Ndoc-Stakë-Dedë-Prelë-Ali-Dol-Kuçi

Gjyshi i Gjeto Zyberit, Mustafë Elezi dhe gjyshi i Brahim Kasemit, Imer Elezi kanë qenë vëllezër dhe janë ndarë nga një zjarr.

Gjeto Zyberi ka lindur më 7 maj 1880 në lagjen Hebibaj të fshatit Drisht, në një familje të varfër, të ardhur, siç e theksuam më lart, nga fshati Sumë. Baba i Gjeto Zyberit, vdiq dhe la dy djem jetimë me nënën dhe gjyshin e tyre Mustafë Elezin, të cilët do të kishin barrën e rëndë për rritjen e jetimëve pa babë. Gjetoja mbeti jetim në moshën katër vjeçare dhe Myrtoja në moshën dy vjeçare.

Gjetoja, si djali më i madh, pa u pjekur në moshë, provoi mbi shpatullat e tij hallet e shtëpisë. Të dhuruar nga Zoti zgjuarsinë, mprehtësinë dhe energjitë, ai punoi pa u lodhur duke menduar për familjen, jetën ekonomike të saj, marrëdhëniet e mira shoqërore në fshatin Drisht, besën, burrërinë, fisnikërinë dhe çdo virtyt njerëzor. Ai u gjend shpejt në familjet më të mira në fshatin Drisht.

Kur arriti moshën e pjekurisë, ai fillon të shquhet si një nga burrat e mirë të fshatit, i zoti, i jetesës, i besës dhe i burrërisë, si një nga familjet e pasura të fshatit. Gjeto Zyberi filloi të blejë tokë në bllokun e arave të quajtura “Shmarqe”. Nuk kaluan shumë vite kur ai arriti që të gjithë bllokun e “Shmarqeve” ta bëjë pronë të tijën, si dhe tokë e ogra të tjera rreth fshatit. Në këtë mënyrë familja e Gjeto Zyberit u rreshtua në familjet e mira të fshatit Drisht.

Gjetoja, duke u provuar vetë më parë vështirësitë e hallet familjare, bëhet një shembull i mirë për zgjidhjen e problemeve familjare të bashkë fshatarëve të tij. Në biseda me njerëz që kanë jetuar në kohën e tij, flasin plot pasion, me respektin më të madh për figurën e tij, duke e quajtur si shpëtimtar në situata të vështira, për plot familje në Drisht në kohën që ai jetoi.

Njerëzit, bashkëkohës të tij dhe ata që e kanë njohur Gjeto Zyberin thonin se ai ishte njeri shumë serioz, korrekt me njerëzit, i ndershëm, i drejtë, i dashur, i respektueshëm dhe i besës e i fjalës. Gjeto Zyberi dallohej si besimtar i devotshëm dhe kujtohet nga të gjithë bashkëkohësit si një njeri i jashtëzakonshëm që gjithë jetën e tij nuk kishte truar kurrë, duke u lidhur fort në Zotin e tij.

Gjeto Zyberi ishte një nacionalist i zellshëm dhe në çdo situatë të vështirë të truallit shqiptar ai ishte i gatshëm të merrte pjesë me armë në dorë për mbrojtjen e integritetit tokësor dhe të pavartësisë së vendit. Për aq kohë sa jetoi, ai mori pjesë në të gjitha betejat në mbrojtje të trojeve kundër pushtuesve të huaj. Vlen të përmendet Rrethimi i Shkodrës, i vitit 1912, kur ai merr pjesë bashkë me të vëllanë në Frontin e Myselimit dhe në Kodrat e Bardhanjelit, duke lënë familjen pa asnjë mashkull të rritur në shtëpi dhe duke menduar se edhe mund të vriteshin të dy në këtë luftë, nga më të përgjakshmet që kishte provuar Shkodra.

Gjeto Zyberi ndihmoi edhe Luftën Nacional-çlirimtare kundër pushtuesve nazifashistë me të gjitha mënyrat dhe mjetet që mundi. Pas çlirimit nuk u pajtua asnjëherë me instalimin e diktaturës komuniste në Shqipëri. Si kundërshtar i komunizmit në vitin 1946, me 9 shtator, ai inkuadrohet si pjesëmarrës në Kryengritjen Antikomuniste të Postribës dhe me raprezaljet që u bënë në Postribë pas dështimit të Kryengritjes Gjeto Zyberi arrestohet bashkë me shumë postribas të tjerë dhe dënohet me burg, ku vuan dënimin për 15 muaj rresht duke provuar torturat më të egra.

Pas lirimit nga burgu ai vazhdon të ndihmojë familjen e tij, megjithëse i thyer në moshë. Thelbësore është se Gjeto Zyberi, me virtytet që e karakterizonin personalitetin e tij, mbeti një figurë që meriton të kujtohet nga brezat, dhe do të mbetet i pashlyer në kujtesën e familjeve dhe të të gjithë shoqërisë që e njohu atë. Gjeto Zyberi mbeti shembulli më i mirë për brezat që la pas, si triumfuesi më i vendosur kundër çdo vështirësie dhe të çdo vesi njerëzor duke pasur besimin e plotë tek Zoti i tij.

Gjeto Zyberi vdiq më 7 tetor të vitit 1967, atë vit kur Enver Hoxha shpalli shtetin shqiptar si shteti i parë ateist në botë.

HAJDAR SMAJL MILANI - DOMËN

Hajdar Smajl Milani rrjedh nga një familje e fisme e fisit Milan të Domnit me tradita të mira patriotike e fetare. Hajdar Smajli ka lindur më 11 qershor të vitit 1883 në fshatin Domën dhe ka vdekur më 4 prill të vitit 1964 në lagjen Milan të fshatit Domën.

Familja e Hajdar Smajlit ka qenë një familje e madhe dhe e njohur në Postribë. Shtëpia e tij ka qenë shtëpi mikpritëse, bujare, e besës me traditat më të mira që mund të ketë pasur një familje në Postribë. Ai

ka pasur marrëdhënie shumë të mira me familje të tjera jo vetëm në fshatin Domën, por edhe me familje të tjera të bajrakut të Drishtit, të bajrakut të Boksit dhe të bajrakut të Sumës.

Hajdar Smajli ishte biri i Smajl Ibrahim Milanit, oficer në kohën e mbretërimit të Ahmet Zogut. Por ai nuk harronte asnjëherë se mbi të gjitha ai ishte një postribas dhe mbi Postribën ai nuk vinte asgjë. Partitë ishin në plan të dytë për të. Familja e Hajdar Smajlit me marrjen e pushtetit nga Partia Komuniste, në vitin 1946 u cilësua "Familje kulaku" pasi kishte pasuri që e kishte fituar me djersën e ballit, por shteti komunist që në fillim të karrierës së tij, vendosi për të luftuar familjet e fisme nacionaliste, pasi këto i sillnin një dëm të madh në qeverisjen e vendit. Djali i tij, Rexhep Hajdar Milani, mori pjesë në Kryengritjen Antikomuniste të 9 shtatorit të vitit 1946. Për këtë lidhën me litar te mani te shtëpia e vjetër në vitin 1946 Hajdar Smajl Milanin bashkë me Imer Adem Milanin, dhe donin t'i pushkatonin, por për fatin e tyre u ndalua ky pushkatim nga Zek Bajrami i Derrajve të Domnit, i cili ishte atëherë me detyra në pushtet.

Familja e Hajdar Smajl Milanit u trajtua si familje e dekluar si shumë familje të tjera në Postribë deri në vitin 1990, kur filluan proceset demokratike.

Në vitin 1916, me pushtimin austro-hungarez, Hajdar Smajl Milani merr pjesë bashkë me të gjithë burrat e tjerë të Postribës në kryengritjen kundër pushtimit Austro - Hungarez të drejtuar nga paria e Postribës dhe komandanti popullor Adem Haxhija.

Hajdar Smajl Milani ishte burrë i drejtë dhe besimtar, ndaj dhe si i tillë ai ka marrë pjesë në kuvende për pajtim gjaqesh e për probleme të tjera të fshatit e më gjerë.

Hajdar Smajl Milani ka marrë pjesë në të gjitha luftërat që janë zhvilluar në mbrojtje të lirisë, sovranitetit dhe integritetit tokësor, si në Luftën e Koplikut në vitin 1920, në rezistencën antifashiste të vitit 1939, në Kodra të Tepes, në Bahçallek e Kodra të Bërdicës nën komandën e Adem Haxhisë.

Hajdar Smajl Milani do të mbetet në kujtesën e brezave pasardhës si një burrë në zë i Postribës, si një besimtar i mirë dhe si një nationalist i devotshëm për mbrojtje të trojeve tona.

HALIL AHMET CEKAJ - KULLAJ

Halil Ahmet Cekaj rrjedh nga një familje me tradita të mira patriotike të fisit Cekaj të fshatit Kullaj-Boks të Postribës. I pari i këtij fisi, i quajtur Gjergj Gjon Kolçekaj, ka ardhur në Postribë nga Hoti i Malësisë së Madhe dhe është vendosur fillimisht në Kodër-Boks, në truallin e Cen Adem Hasajt. Ai rrjedh nga fisi Kolçekaj i Hotit. Ai kur erdhi në Postribë u konvertua në mysliman me emrin Ahmet.

Halil Ahmet Cekaj ka lindur në fshatin Kullaj në janar të vitit 1895 dhe ka vdekur në fshatin Kullaj të Boksit, më 21 mars të vitit 1978, në moshën 83 vjeçare. Halil Ahmeti ka marrë pjesë në të gjitha luftërat që janë zhvilluar në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe integritetit tokësor të vendit. Në moshën 17 vjeçare ai ka marrë pjesë në "Rrethimin e Shkodrës, në frontin e Fushave të Myselimit dhe atë të Bardhanjelit bashkë me burra të tjerë të Postribës dhe nën drejtimin e komandantit popullor Adem Haxhi Spahija.

Ai ka marrë pjesë në kryengritjen e Postribës kundër pushtimit ushtarak austro-hungarez në vitin 1916, që u zhvillua në afërsi të Urës së Mesit, kryengritje e cila i detyroi forcat austro-hungareze të ikin me ngut për në Shkodër të mundur nga forcat e Postribës. Halil Ahmet Cekaj ka marrë pjesë në Luftën e Koplikut të vitit 1920, nën komandën e komandantit popullor Adem Haxhi Spahija, dhe ka qenë pranë Adem Haxhisë kur ai mori dy plagë, një në krah dhe një në kokë. Halil Ahmeti i lidhi Adem Haxhisë plagen që kishte në kokë me këmbësorët e Ademit në mënyrë që të mos i rridhte shumë gjak.

Ai merr pjesë edhe në rezistencën antifashiste të Postribës, që u zhvillua në Kodra të Tepes, në Bahçallek dhe në Kodra të Bërdicës, kundër pushtimit fashist Italian.

Halil Ahmet Cekaj ka qenë i organizuar politikisht me opozitën, me një fjalë ai ishte kundër regjimit të Zogut. Me kërkesën e Xhemal Beg Bushatit ai shkon shoqëruar në mbrojtje të jetës së Luigj Gurakuqit dhe të Xhemal Beg Bushatit, i cili e merr djalë as vetes, duke e vlerësuar si besnik dhe trim. Qeveria e Zogut e ndjek për ta arrestuar. Halili Ahmet Ceken, si kundërshtar politik i tij, por me ndërhyrjen e Imer Beqir Shabajt pushohet ndjekja e tij, duke e falur.

Halil Ahmeti ka qenë burrë me tradita të mira nacionaliste, burrë i besës, bujar, fisnik dhe i dashur me njerëzit.

Familja e Halil Ahmet Cekajt ka qenë ndër familjet e mëdha të Postribës dhe me tradita të mira të trashëguara nga paraardhësit e tij. Familja e tij përbëhej nga mbi 20 veta me tre deri në katër kurorë.

Burimi i të dhënave është nipi i tij, Bajram Avdi Halili, si dhe material nga historia e Postribës.

Halil Ahmet Cekaj do të kujtohet nga brezat pasardhës si një burrë i besës dhe nacionalist i mirë, në mbrojtje të trojeve tona.

HALIL ISUFI (MUHAJ) - DRISHT

Sipas trashëgimisë gojore, fisi Muhaj i lagjes Kala të fshatit Drisht, arrin 12-13 brezni myslimanë, që po të llogaritet me 35 vjet jeta mesatare e një brezi, rezulton që të jetë një periudhë prej 400 vjetësh në vazhdimësi myslimane, pra që nga viti 1600.

Halil Isufi i fisit Muhaj, erdhi në këtë jetë rreth viteve 1844, në lagjen Kala të ish qytetit Drivast (Drishti i sotëm).

Njeriu i parë i këtij fisi quhej Muho, i cili ka pasur edhe dy vëllezër të tjerë. Të tre vëllezërit mendohet të kenë ardhur nga Turqia me detyra ushtarake dhe fetare. Ata fillimisht u vendosën në fshatin Kullaj-Boks të Postribës. Vëllai i vogël, i njohur me emrin "Hoxha i Dheut të Drishtit" u largua nga Postriba dhe u vendos në Shkodër, në vendin e quajtur "çinari i Hoxhës së Dheut", afër stadiumit "Loro Boriçi". Ky emër i zonës u vendos për nder të tij. Ai studioi për fe dhe gjithë jetën ia kushtoi religjionit islam në Shkodër. Muhja, vëllai i dytë u largua nga Kullaj-Boksi dhe u vendos në Kala të Drishtit, ku krijoi degën e tij, që më vonë mori përsipër detyrën e bajraktarit. Vëllai i madh qëndroi në Kullaj-Boks.

Përpara fisit të Halil Isufit, detyrën e bajraktarit e kryente një fis nga Vilza i quajtur Hetaj. Për kalimin e bajrakut nga Vilza në Drisht u bë shkak një ngjarje: "Postriba bie në përpjekje me forcat malazeze, në luftë për mbrojtjen e trojeve, thuhet në vendin e quajtur "Maja e Helmit" Këtu vritet bajraktari i Vilzës që mbante flamurin dhe duke mos pasur luftëtar tjetër të fisit të tij për ta zëvendësuar, e merr flamurin një luftëtar nga fisi Muhaj i Kalasë së Drishtit, dhe nëpërmes plumbash arrin të ngrejë flamurin në Majë të Helmit. Megjithë fisnikërinë e fisit Muhaj për ta lënë bajrakun përsëri në Vilzë, këta, po me fisnikëri nuk pranuan ta mbanin më bajrakun, duke e quajtur trimëri ngritjen e flamurit në Majën e Helmit dhe në këtë mënyrë u bë kalimi i bajrakut nga Vilza në Drisht".

I pari në fisin Muhaj që e mori bajrakun quhej Hasë Bajraktari dhe pas vdekjes së tij e merr detyrën e bajraktarit Halil Isufi, në një moshë të re. Ai ishte 20 vjeç kur e merr këtë detyrë dhe e kryen në mënyrë të shkëlqyer deri ditën që u vra në moshën 76 vjeçare, rreth vitit 1919.

Halil Isufi ishte një nacionalist i devotshëm. Ai gjithë jetën e tij ia kushtoi mbrojtjes së trojeve. Së bashku me nacionalistë të tjerë të shquar në kohë të ndryshme si Tahir Haxhija, Adem Haxhija, Ymer Beqiri e Haxhi Idriz Boksi nga Postriba, Dasho Shkreli e Oso Kuka nga Shkodra, Dedë Gjolluli nga Hoti, morën pjesë në çdo betejë që u zhvillua në mbrojtje të sovranitetit dhe të integritetit tokësor.

Halil Isufi merr pjesë në Rrethimin e Shkodrës më 1912, në luftën për mbrojtjen e saj. Osman Kupi nga Drishti na vë në dispozicion një akt guximi të jashtëzakonshëm të Halil Isufit në Rrethimin e Shkodrës. Ai tregon: "Mali i Zi gjuan me topa primitivë nga Kratuli i Boksit në drejtim të Shkodrës. Predha bie brenda telave të rrethimit, por nuk plas. Në atë çast Halil Isufi e kap predhën me dy duart, e vë atë në sup dhe siç ishte me fitil të ndezur e hedh atë jashtë telave të rrethimit dhe u jep urdhër luftëtarëve të ulen në pozicion barkas deri sa të pëlçasë predha. Kur plasi ajo i mbuloi luftëtarët me dheun që çoi lart".

Halil Isufi merr pjesë në Kryengritjen e Postribës në vitin 1916 kundër regjimit austro-hungarez. Në janar të vitit 1916 ushtritë austro-hungareze hyjnë në Shkodër. Ata porsa hynë, vendosën regjimin ushtarak të pushtimit. Në popull ziente revolta e fuqishme kundër pushtuesit. Forcat popullore të organizuara dhe të udhëhequra nga Halil Isufi, bajraktari i Drishtit, Adem Haxhija, vojvodë dhe komandant popullor, bajraktari i Boksit dhe ai i Sumës, po përgatiteshin për të filluar një kryengritje të armatosur kundër pushtuesve austro-hungarezë. Komanda austro-hungareze e parashikonte rrezikshmërinë që paraqiste kryengritja, ndaj dhe u përgatit për ta penguar atë. Ajo dërgoi posaçërisht një fuqi të madhe ushtarake për të shtypur Kryengritjen e Postribës. Në Drisht ajo dërgoi një detashment ushtarak të pajisur me dy topa e gjashtë mitroloza, pasi Drishti ishte qendra e Postribës. Ajo përpiqet të shpërndajë kryengritësit që ishin organizuar dhe po prisnin urdhrin e fillimit të kryengritjes. Megjithë që ky detashment zbrazti disa topa e mitroloza, nuk ia arriti qëllimit. Kryengritësit, nën komandën e Halil Isufit e Adem Haxhisë me bajraktarin e Boksit nisen egërsisht kryengritjen. Detashmenti në përpjekje për të shpëtuar u nis me ngut drejt Shkodrës, por megjithatë afër Urës së Mesit la të vrrarë tre ushtarë dhe u zunë robër dy boshnjakë.

Halil Isufi ishte një njeri sanguin. Ai ishte i gjallë, i lëvizshëm, gjaknxehtë me mimikë të pasur. Ai ishte jeri shumë i afrueshëm dhe i dashur me njerëzit. Ai ishte me ndjenja të forta por jo të thella e të qëndrueshme. Halil Isufi kishte humor të mirë, por këtë e kishte shumë të lëvizshëm. Ai lehtë, për diçka fare të thjeshtë kalonte në humor të keq. Ai ishte njeri me iniciativë, i guximshëm, i aftë për të gjetur zgjidhje në momente të vështira, siç qe rasti i largimit të predhës nga zona që rrezikonte jetën e luftëtarëve në Rrethimin e Shkodrës.

Halil Isufi ishte njeri me karakter të fortë. Për nga pikëpamjet ai ishte me botëkuptim idealist dhe besimtar. Ai ishte njeri me vullnet të fortë për të përballuar vështirësitë e jetës, për të siguruar mbijetesën.

Halil Isufi ishte, trim, besnik, bujar, i vendosur, nacionalist i devotshëm. Ai ishte i durueshëm dhe deri në njëfarë mase e zotëronte veten duke u përpjekur për të ruajtur gjakftohtësinë në raste konfliktesh, por nuk arrinte ta kontrollonte veten deri në fund. Ai kishte karakter burri, peshonte rëndë në fjalën dhe veprën e tij, ishte zemërbardhë, ishte i zgjuar.

Halil Isufi ka pasur fizionomi burrërore. Ai ishte autoritar. Mustaqet e gjata të kthyer pak sipër dhe me ngjyrë të kuqremtë deri në të verdhë duket sikur i jepnin fisnikëri e burrëri. Sytë e kuq i jepnin ashpërsinë dhe trimërinë. Fytyra e bardhë në të kuqe personifikonte bardhësinë e shpirtit dhe peshën e mençurisë. Ai mbante mbi kokë qeleshe të bardhë të formës dibrane, vishte anteri me spik, xhamadan ari, çakçirë me spik, gybere shajaku. I veshur kështu ai të krijonte përshtypjen sikur ke përpara një plak dymijë vjeçar që shekujt nuk i hoqën gjë por i shtuan dhunti. Ai dukej sikur vinte nga thellësitë e historisë dhe udhëtonte drejt pafundësisë.

Halil Isufi ishte njeri i vendosur në marrjen e vendimeve dhe në zbatimin e tyre. Ai nuk e kthente kurrë mbrapa një vendim të marrë edhe sikur të ishte në dëm të tij. Kjo përbënte, ndoshta, një ves të tij, të cilin nuk mund ta quajmë këmbëngulje, por një kokëfortësi.

Halil Isufi ishte njeri i dashur dhe i sjellshëm në familje e shoqëri. Nuk i dhimbsej asgjë nga pasuria e tij për pjesëtarët e familjes sepse, në fund të fundit, thoshte ai, pasuria është vënë me djersën e tyre, ndaj dhe duhet ta gëzojnë. Në familje jetonte me vëllezërit e tij, Tafë e Dan Isufi, të cilët i donte dhe i respektonte shumë. Ai ishte serioz, megjithatë ai e donte shumë këngën dhe muzikën. Ai pëlqente shumë këngët patriotike që këndoheshin me lahutë e çifteli.

Halil Isufi ka pasur pasuri dy kuaj shale, dy pendë qe, lopë, qindra krerë dhi, dhenë etj. Ai kryente tregun e shtëpisë, merrej kryesisht me kuaj dhe i donte shumë ata. Ai, jo vetëm që merrej me drejtimin dhe organizimin e jetës familjare, por edhe me drejtimin e bajrakut, me pleqërim gjaqesh e konflikte të ndryshme shoqërore. Ai merrej me drejtimin e luftëtarëve në bashkëpunim me bajraktarët e bajrakëve të tjerë të Postribës dhe të zonave fqinje si Dukagjin, Shkodër, Hot etj. Ai bashkëpunonte edhe me vojqodët e komandantët popullorë të Postribës e të zonave të tjera.

Halil Isufi nuk ka qenë njeri hakmarrës. Megjithatë, për çështje nderi, prestigji, integriteti tokësor, etj., ai nuk falte njeri, ishte i rreptë. Gjithashtu ai nuk falte edhe kur vartësit e tij nuk i zbatonin urdhërat që ai u jepte.

Halil Isufi i donte shumë njerëzit dhe nuk kishte komplekse fetare në drejtim të respektit e dashurisë. Ai donte shumë Beqir Velen e fisit Dushaj, Ymer Brahimin e fisit Halilaj në Dragoç dhe djalit e tij, Sadik Ymerin. Ai donte shumë familjen e Tyrbetarëve. Ai donte shumë Kolë Kirin, Kolë Xhuxhen dhe Sylço Begun me vëllezër që ishin prej fiseve të mira të qytetit. Siç thoshte, ai dinte edhe të urrente. Ai urrente shumë njerëzit e pabesë, frikacakët, hajdutët, gënjeshtarët, imoralët, etj. Ai urrente shumë pushtuesit serbë e malazezë, të cilët kishin vrarë e plaçkitur disa herë gratë, fëmijët dhe pleqtë e Postribës. Ata i kishin një borxh të madh Halil Isufit dhe Postribës, gjithë popullit shqiptar.

Halil Isufi ishte njeri besimtar. Përpiquej të kryente të gjitha ritet fetare dhe faljet sipas normave Islame. Halil Isufi ka pasur lidhje respekti e dashurie të ndërsjelltë me bajraktarët e Tophanës në Shkodër, të Shalës, të Shoshit, të Hotit. Ai ka pasur lidhje miqësore me Adem Haxhinë e Boksit, komandantin e shquar popullor, me Elez çelen të fisit të njohur Laçej të Pukës, etj. Halil Isufi ka marrë pjesë në të gjitha betejat që janë zhvilluar në mbrojtje të trojeve të kombit, bashkë me Adem Haxhinë deri sa vdiq në vitin 1921.

Halil Isufin e donin dhe e respektonin shumë bashkëkohësit e tij deri në atë masë sa që kurrë nuk e thërrisnin në emër por me epitetin "Bajraktar".

Ai nuk ka pasur arsim laik por vetëm fetar. Ai ka kryer mejtepe për të mësuar se si duhet të lidhet myslimani me Zotin e tij dhe si duhet të adhurohet, si duhet të kryhen detyrimet ndaj Zotit të Gjithësisë. Duke qenë një besimtar i devotshëm, ai ka falë nga pasuria e tij sipas ligjit Islam të Sheriatit dhe ka ndihmuar familjet e varfra si familjet në Kala të Drishtit dhe në fshatra të tjera.

Halil Isufi ka treguar një kujdes të veçantë ndaj xhamisë si ndërtesë kulturi. Në xhami, që edhe sot ndodhet në qendër të lagjes Kala, ai ka vendosur shtylla anës rrugës me fenerë ndriçues, në drejtim të portës së lindjes dhe asaj të perëndimit poshtë. Gjatë gjithë natës xhamia dhe rruga kryesore e lagjes nga porta në portë ishte nën ndriçimin e fenerëve, që bashkë me gjelbërimin e manave anës rrugës dhe dritën e hënës krijonin një pamje të magjishme. Lagja Kala merrte pamjen e një qytetërimi në antikitet. Në mendjen dhe shpirtin e Halil Isufit reflektohej arti i qytetërimit të Drivastit të lashtësisë.

Halil Isufi i erdhi një vdekje e shpejtë dhe jo e zakonshme, megjithatë fisi i bajraktarit ruajti gjithmonë burrërinë dhe fisnikërinë, siç e kanë pasur rregullat dhe kanuni i maleve. Pas vdekjes së Halil Isufit, detyrën e bajraktarit e mori Myrto Dani, nipi i Halil Isufit, ndërsa sot këtë ofiq e gëzon Ymer Myrto Muhaj, djali i Myrto Danit.

Fisi i bajraktarit të Drishtit është fisi më i nderuar në Drisht. Ai ruan traditat më të mira të fisnikërisë, të bujarisë, të trimërisë, të besës, të respektit dhe të dashurisë njerëzore.

Halil Isufi do të mbetet kujtimi më i bukur dhe njeriu më i nderuar i Postribës në brezat që do të vijnë pas. Ai do të rrezatojë gjithmonë tek ne fisnikëri, paqe, respekt e dashuri njerëzore. Ai do të mbetet gjithmonë mishërim i trimërisë, burrërisë, besës, fisnikërisë dhe paqes mes fiseve e bajrakëve të Postribës.

Burimi i të dhënave është stërnipi i tij, Dyl Maliq Buhaj si dhe materialet arkivore dhe historike.

HALIL ISUF DUSHAJ-DRISHT

Halil Isuf Dushaj rrjedh nga një familje e fisit Dushaj të Drishtit me tradita shumë të mira patriotike. Halil Isuf Dushaj u lind në fshatin Drisht rreth vitit 1855 dhe vdiq heroikisht në frontin e luftës në Bardhanjel, në vitin 1912 kundër forcave pushtuese serbo-malazeze. Lufta ishte shumë e rreptë, e cila u zhvillua trup më trup dhe bajonetë më bajonetë.

Fisi Dushaj është ndër fiset më të mëdha të fshatit Drisht. Prejardhja e këtij fisi është nga Dushi i Mirditës, të cilët kanë ardhur në këtë fshat para rreth 300 vjetësh e ndoshta edhe më shumë. Mbiemri i fisit mbeti nga vendi prej të cilit kishin ardhur “Dush” i Mirditës, pra Dushaj.

Halil Isufi, pjesën më të madhe të jetës e kaloi në regjimin turk. Ai provoi edhe përpjekjet e pushtuesve serbo-malazezë për të marrë atdheun tonë nën pushtimin e tyre, por nuk arriti ta gëzonte pavarësinë e vendit, pasi u flijua në mbrojtje të trojeve tona. Duke qenë një nacionalist i devotshëm, Halil Isufi vihet në mbrojtje të integritetit dhe sovranitetit tokësor, në mbrojtje të lirisë dhe të pavarësisë së atdheut.

Halil Isufi ishte njeri i drejtë, i ndershëm, i vendosur për t’i çuar qëllimet dhe objektivat e tij deri në fund për mbarëvajtjen e punës në familje e shoqëri.

Halil Isufi kishte një familje të madhe, mbi 30 veta, gjithashtu kishte shumë krerë dhi, dhenë, lopë, qe pune, kafshë ngarkese etj. Ai mbante edhe kalë shale me të cilin lëvizte nëpër miq e dashamirë, jo vetëm nëpër fshatra të Postribës por edhe në bajrakë të tjerë ku ai kishte kumbari e dashamirë, si në Shllak, në Dukagjin etj. Ai ishte në gjendje të mirë ekonomike. Familja e tij ka ndërruar katër herë trojet e saj: fillimisht ishte e vendosur si familje në lagjen Kala të Drishtit, më vonë vendoset në Përrue Mos, nga Përrue Mosi shkon në Drisht, në lagjen Hebibaj dhe së fundi përfundon në trojet ku janë edhe sot pasardhësit e tij, në vendin e quajtur “Nën Udhe”.

Halil Isufi duke qenë i drejtë, ishte edhe një besimtar i mirë dhe i devotshëm. Gjithë jetën e tij e kishte vënë në dispozicion të dy parimeve themelore, për të cilat ia vlente që të sakrifikoje edhe jetën e tij: “Për fe e atdhe!” Kjo ishte motoja e jetës së tij. Siç e thamë edhe më lart, në “Rrethimin e Shkodrës” të vitit 1912, Halil Isufi u nda nga jeta dhe familja e tij duke rënë shëhit në frontin e luftës në vendin që mbeti në histori, në Bardhanjel. Ai luftoi nën drejtimin e komandantit patriot të Postribës, Adem Haxhisë dhe duke qenë i vendosur për të mos e lëshuar frontin, ra në këtë front së bashku me 59 burra të tjerë luftëtarë postribas, natën e 29 dhjetorit të vitit 1912, në të cilën betejë u plagosën edhe 70 luftëtarë të tjerë postribas. Në këtë betejë u plagos edhe e reja e tij, nusja e Avdi Halilit, e quajtur Hava Manush Dushaj, e cila mori plagë në gjurin e këmbës së djathtë.

Halil Isuf Dushaj do të kujtohet nga brezat pasardhës, si një luftëtar i vendosur, si një trim i rrallë, si një burrë i besës dhe nacionalist që luftoi me vetëmohim për fe e atdhe në mbrojtje të integritetit dhe sovranitetit tokësor.

Burimi i të dhënave është materiali historik si dhe të dhëna nga stërnipi i tij, Rexhep Dushaj.

HASAN AHMET SYKAJ - URA E SHTREJTË

Hasan Ahmet Sykaj u lind rreth viteve 1872 në fshatin Ura e Shtrejtë dhe vdiq në vitin 1928. Rrjedh nga një familje nacionaliste e fisit të njohur Sykaj të fshatit Ura e Shtrejtë të Postribës.

Sipas materialeve të studiuesit Hashim Kopliku, të parët e fisit Sykaj kanë ardhur nga Boksi i Planit të Gjakovës. I pari i tyre i ardhur nga Boksi i Planit quhej Preç. Ky kishte katër djem të quajtur Pepë Preçi, Gegë Preçi, Ndre Preçi dhe Mark Preçi. Preçi, sipas gojëdhënës, u ul me katër djemtë në fshatin Ura e Shtrejtë me një ferlik dhe u kërkoi leje vendasve që të festonte festën e Shënkollit, sa duket, në një shpellë të fshatit që më vonë mori emrin "Shpella e Palit". Djemtë e Preçit më vonë krijuan katër barqe të një vëllazërie të quajtur Has-Pepaj. Sykajt janë vëllai i madh i Pepë Preçit.

Sipas Imer Selim Sykajt, Palë Preçi ka ardhur nga Ndrejajt e Shoshit dhe ka zënë vend në shpellen që mori emrin "Shpella e Palit", e cila ndodhet mbi rrugë pa shkuar tek Kroni i Hacajve. Sipas tij, Preçi ka pasur katër djem të quajtur: Ndre Preçi, Gjekë Preçi, Sykë Preçi dhe Palë Preçi (Palë Kola i Kolë Preçit. Sa duket këto të dhëna janë më të sakta se të dhënat e para).

Hasan Ahmeti gjithë jetën e tij ia kushtoi mbrojtjes së trojeve nga pushtuesit serbo-malazezë. Ai ishte një burrë i nderuar jo vetëm në fshatin Ura e Shtrejtë por edhe në Postribë e më gjerë. Sipas Imer Selim Sykajt, Hasan Ahmeti ishte anëtar i Prefekturës së Shkodrës gjatë viteve 1913-1921 dhe zëvendës i Bylykbashit (kryetarit të qarkut të Shkodrës), të quajtur Halil Idrizi. Duhet të saktësoj se të dhënat e Imer Selim Sykajt, për Hasan Ahmet Sykajn, që duhet të vertetojnë se ka qenë anëtar i Prefekturës dhe zëvendës i Bylykbashit, nuk i kam gjetur në asnjë studim apo material historik nga studiues apo historianë, ndaj dhe për të qenë në rrugën e drejtë dhe për të mos më paragjykuar lexuesit i shënova këto të dhëna. (shënimi im, R. S)

Hasan Ahmeti merr pjesë në Rrethimin e Shkodrës në vitin 1912-1913, duke organizuar gjithë Urën e Shtrejtë dhe nën drejtimin e komandantit popullor Adem Haxhija me gjithë Postribën dislokohen në Fusha të Myselimit dhe në Bardhanjel, ku shquhen për trimëri dhe vetëmohim në mbrojtje të vatanit. Në këtë luftë ai ishte rreth 40 vjeç.

Hasan Ahmet Sykaj merr pjesë në Kryengritjen e Postribës kundër pushtimit austro-hungarez në vitin 1916 bashkë me burrat e Urës së Shtrejtë e të Postribës dhe në përpjekje e sipër në afërsi të Urës së Mesit writen tre ushtarë austro-hungarezë dhe zihen rob lufte dy boshnjakë, të cilët duke i rënë në besë Murat Imerit të Rosekut shpëtojnë dhe dorëzohen shëndosh e mirë në Shkodër.

Para Luftës së Koplikut, në mars të vitit 1920, forcat serbo-malazeze sulmojnë nga Dukagjini për të marrë Postribën dhe Shkodrën, duke i rënë nga Shtegu i Dhenëve. Forcat e Urës së Shtrejtë me gjithë Postribën zënë pritë prej në Sukë të Veshtëllit, në Curr të çardakut e deri në Shkallë të Logjës. (këto të dhëna janë sipas Imer Selim Sykajt, shënimi im, R. S).

Hasan Ahmeti më 3 prill 1920, të djelën e Pashkëve, sjell armë nga Prefektura, përveç atyre që blen vetë dhe i çon në Ura Shtrejtë për t'ua shpërndarë vullnetarëve të Postribës. Transporti i armëve është ndihmuar nga Dan Ceni i Dristit, Adem Haxhi Spahija dhe Çelë Murat Shabaj të bajrakut të Boksit, nga Brahim Veli Braçaj i Domnit, Met Rexh Mataj i fshatit Shakotë dhe Halil Cen Papaj i fshatit Vilzë. Armët gjatë udhëtimit, Hasan Ahmeti ia ka lënë në mirëruajtje Selim Zenel Myrtos dhe Brahim Mustaf Xuferajt. Armët i shkuan për t'i shpërndarë Isuf Hasan Velisë (Mehaj) dhe Shaban Imerit (Haspepaj), të cilët ishin në front në Shkallë të Logjës.

Lufta në Shkallë të Logjës ka zgjatur, sipas Imer Selimit, prej në mars deri në maj të vitit 1920.

Postriba e mundi ushtrinë serbo-malazeze në frontin e Shkallës së Logjës, duke e detyruar të dalë jashtë kufinjve shtetërorë.

Hasan Ahmeti merr pjesë në Luftën e Koplikut, në gusht të vitit 1920, duke marrë me vete burrat e Urës së Shtrejtë nga mosha 20 - deri në 60 vjeç, ndërsa burrat mbi 60 vjeç i lë për të mbrojtur Shkallën e Logjës nga ndonjë sulm i papritur i armikut. Gjithë burrat e Postribës nën drejtimin e krerëve dhe të Adem Haxhisë shkuan në frontin e luftës në Koplik. Në këtë kohë ushtria serbo-malazeze kishte pushtuar vendin

duke kaluar Përroin e Thatë në drejtim të Shkodrës. Deli Meta ishte në tërheqje, pasi ishte thyer nga forcat serbo-malazeze. Në këtë kohë, sipas Imer Selimit, Can Osmani i fshatit Ura e Shtrejtë, shkëputet nga kolona e Postribës që ishte në mësymje dhe i del përpara Deli Metës që ishte në tërheqje me hotjanë, dhe kërkon ta kthejë Deli Metën, por Hasan Ahmeti i bërtet të birit dhe Selim Zenelit dhe u thotë të ndalonin Can Osmanin që të mos hyjë lufta në mes të Postribës dhe Hotit, të mos vriteshin mes vëllezërish dhe e lë Deli Metën me hotjanë të pushojnë një natë në çezme të Koplikut se kishin vuajtur shumë deri atëherë në frontin e luftës dhe të nesërmen të ktheheshin përsëri në front. Në këtë kohë Postriba në mësymje e sipër arrin në Përrua të Thatë. Në orët e pasdites Postriba fillon luftën në Përrua të Thatë. Gjatë natës, Postriba në mësymje e sipër kalon Përronin e Thatë, duke e detyruar armikun që të tërhiqet.

Në mungesë të ujit dhe të armëve e municionit, Hasan Ahmeti detyrohet të shkojë në Shkodër për të kërkuar ndihmë dhe kthehet përsëri në front. Pas një ore arrin një burrë vetë i katërti, të hypur të gjithë në kuaj. Burri ishte i veshur me rroba kombëtare. Zbresin nga kuajt, takohen me burrat e Postribës dhe burri me rroba kombëtare i pyet se për çfarë kishin nevojë. Postriba i kërkon armë, municion dhe ujë. Burri që ishte i veshur me rroba kombëtare ishte Ahmet Zogu. Brenda 2-3 orësh vjen nga Shkodra furnizimi me bukë, ujë, armë dhe municion. Bajo Topulli që merr pjesë në frontin e luftës e pyet Hasan Ahmetin se kush ishte dhe nga ishte. Ai i thotë se ishte Hasan Ahmeti nga fshati Ura e Shtrejtë e zonës Postribë, anëtar i Prefekturës dhe zëvendës i Bylykbashit (Kryetar i qarkut Shkodër).

Lufta e Koplikut zgjati tre javë. Në këtë luftë Hasan Ahmeti plagoset.

Hasan Ahmet Sykaj do të kujtohet nga brezat pasardhës si një burrë trim, nacionalist, i vendosur në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe të integritetit tokësor, si një nga burrat më në zë të Postribës.

Burimi i të dhënave është nga Imer Selim Sykaj, Beqir Met Sykaj dhe materiale historike. (shënimi im R.S).

HASË VELI URUÇAJ-DOMËN

Hasë Veli Uruçaj ka lindur në fshatin Domën në vitin 1846 dhe ka vdekur në Domën në vitin 1910. Rrjedh nga një familje nacionaliste e fisit Uruçi të ardhur nga Kraja. I pari i fisit, i quajtur Nehan Alia, la mbrapa pasi vdiq tre djem të quajtur: Ram Nehani, Uruç Nehani dhe Ali Nehani. Djali i madh ishte Ram Nehani nga i cili u krijua fisi Mastaj (Halilaj) ose Jeremija. Ky fis mban vendin e parë në fise të Domnit. Djali i dytë i Nehan Alisë ishte Uruç Nehani, nga i cili u krijua fisi Uruçi. Djali i tretë i Nehan Alisë ishte Ali Nehani, nga i cili u krijua fisi Bracaj. Hasë Velija pothuajse gjithë jetën e tij e kaloi në periudhën e pushtimit osman, deri në prag të pavarësisë.

Hasë Velija ka qenë burrë i zgjuar, apo siç i thonin atëherë kur ai jetoi, burrë i urtë. Ai ka marrë pjesë në pleqërimin e gjaqeve, në konflikte të ndryshme mes fiseve brenda bajrakut si dhe mes bajrakëve të ndryshëm, jo vetëm në Postribë por edhe në pleqërimin e maleve, duke përfshirë Malësinë e Madhe, Krajën, Malësitë e Gjakovës etj. Ai ka pleqëruar gjithmonë së bashku me Brahim Veli Bracajn. Këta dy burra kishin një ndryshim për nga pamja e jashtme. Brahim Veli Bracaj ishte një burrë i gjatë, me shëndet mesatar dhe kishte pamjen e një burri tipik verior, ndersa Hasë Veli Uruçi ishte pak më i shkurtër se Brahim Veli Bracaj por ishte shumë i pashëm. Pleqtë e Postribës kanë qenë në zë për pashi, trimëri, zgjuarsi dhe fisnikëri.

Thuhet se në një pleqërim që shkuan dhe bënë në Koplik së bashku me pleqtë e Malësisë së Madhe, në fund u vendos ashtu siç menduan pleqtë e Postribës.

Hasë Veli Uruçi ishte një burrë me temperament sanguin, tip i gjallë, i fortë, i ekuilibruar dhe i shpejtë në gjykim. Ai ka qenë burrë me karakter të fortë, ka pasur tiparet e malësorit verior me burrëri, fisnikëri, bujar, i besës, i matur dhe i ekuilibruar.

Hasë Veli Uruçi ka qenë besimtar. Ky ka marrë pjesë në ndërtimin e dy xhamiave në Domën, në Xhaminë e Madhe që u ndërtua tek Kroni i Domnit dhe në Xhaminë e Vogël që u ndërtua në Kodër të Qershisë. Ai i ka vlerësuar besimet pa asnjëfarë dallimi, pasi siç thoshte ai: “të gjitha besimet të çojnë në një Zot të përbashkët të të gjithë njerëzimit”.

Ai ka qenë pjesëmarrës në nxjerrjen e vadës së Domnit.

Hasë Veli Uruçi ka qenë një instrumentist i mirë. Ai i ka rënë lahutës dhe ka kënduar me lahutë këngë të epikës legjendare, këngët për liri e pavarësi të vendit, këngët e trimërisë etj. Lahuta e Hasë Veli Uruçit

është ruajtur nga nipi i tij Ramadan Qerim Uruçi deri në vitet 1950. Ai i ka dashur këngët dhe i ka vlerësuar ato, pasi ato pasqyronin jetën e popullit shqiptar.

Hasë Veli Uruçi është marrë gjithmonë me bujqësi e blegtori, por më shumë ka pasur pasion blegtorinë.

Hasë Veli Uruçi ka qenë i dashur në familje dhe në shoqëri. Ai ka pasur miqësi me burra të mirë të Postribës dhe më gjerë. Ai ka shkuar mirë me Hajdar Taf Gurin, me Smajl Brahim Milanin dhe me Brahim Veli Bracajn. Ai ka qenë shumë i dashur me të gjithë njerëzit e Domnit në veçanti e të Postribës në përgjithësi.

Hasë Veli Uruçi ka marrë pjesë në një pleqëri që është zhvilluar mes Urës së Shtrejtë dhe Shllakut. Ngjarja ndodhi kështu: Kishte një keqkuptim në vendosjen e kufinjve mes Urës së Shtrejtë dhe Shllakut. Një ditë Shllaku i merr Urës së Shtrejtë 6 krerë dele me pretekstin se ato kishin hyrë në prona të Shllakut. Ura e Shtrejtë shkon në Shllak dhe merr 6 krerë mushka. Me këto mushka është deklaruar se është bajtur gjithë gëlqerja dhe rëra për ndërtimin e xhamisë së Urës së Shtrejtë. Shllaku bie me luftë në Ura Shtrejtë për të marrë me forcë mushkat. Ura Shtrejtë i përgjigjet po me luftë deri sa ndërhyt qeveria e asaj kohe për të vendosur paqe. çështja u la për ta pleqëruar dy palë pleqë, ata të Postribës dhe ata të Shllakut. Ura Shtrejtë mori për pleqërim Hasë Veli Uruçin e Domnit ndërsa Shllaku mori për pleqërim Qorrin e Kastratit. Shllaku i dërgoi fshehtas Hasë Velisë 6 qese me flori për të devijuar pleqërinë, por ai nuk pranoi. U bë pleqëria për kufinj dhe u vendos ashtu siç tha Hasë Veli Uruçi, në ato kufinj që kishin vendosur Ura e Shtrejtë më parë. Pas pleqërimit u shtrua buka në Shllak dhe për hakmarrje dikush e helmoi në ushqim Hasë Veli Uruçin, dhe pas tre ditësh nga ajo drekë Hasë Velia vdiq i helmuar.

Hasë Veli Uruçi do të kujtohet nga pasardhësit si një burrë i urtë në pleqërim kuvendesh.

HAXHI IDRIZ BOKSI - SHKODËR

Haxhi Idriz Boksi ishte i biri i një fshatari nga fshati Boks-Postribë , i të quajturit Idriz, i rënë në qytet. Prindërit e Haxhi Idrizit në fillim u vendosën në lagjen e Xhamisë së Begos. Idrizi , i ati e dërgoi në mejtep. Për një ngatërresë, familja e Haxhisë shkoi në lagjen “Ndocaj”, ku banojnë edhe sot pasardhësit e tij.

Haxhi Idriz Boksi është i njohur si një nga luftëtarët e patriotët e vjetër shkodranë të shekullit të kaluar.

Në vitin 1835 ai ishte imam i xhamisë së Ndocajve. Ai krahasohet me Haxhi Sheh Shaminë.

Haxhi Idriz Boksi del në skenë në vitin 1834-1860 pasi mori pjesë aktive në Kryengritjen e Hamz Kazazit me 1835, kundër Hafiz Pashës. Këtu ai i prin çetës së Ndocajve duke dhënë “fetva” për të luftuar kundër ushtrisë turke të komanduar nga Hafiz Pasha.

Haxhi Idrizi luftoi krahas me Hamz Kazazin e shokët e tij kundër ushtarëve osmanllinj duke bërë kërdrinë. Po paraqesim një pjesë të këngës:

“... Haxhi Idrizi kishte thane.

Do t’i vij galip halldupit.

Nën Këlliç i pret të tanë.

Si në vakt të Karamahmutit.

... Haxhi Idrizi tuj mendue.

Merr pushkën me luftue.

Merr pushkën karajfile

Mos me veshë petka lëtime ...”

Pasi morën fund luftimet, në mes të kryengritësve dhe të qeverisë, u përfundua një marrëveshje. Haxhi Idrizi nuk iu bind vendimit, u arratis e shkoi në Postribë, në fshatin Ura e Shtrejtë, kurse dy motrat e Haxhi Idrizit kishin shkuar të strehoheshin në shtëpinë e të quajturit Beqir Behri, me të cilin Haxhi Idrizi kishte krushqi. Turqit i arrestuan dy motrat dhe për këtë arsye ai ishte i detyruar të dorëzohej. Turqit e dërguan në Stamboll, e burgosën dhe pastaj e dënuan me vdekje, por shpëtoi nga një falje e përgjithshme nga ana e Stambollit. Haxhi Idrizit iu fal jeta dhe pas tri vjetësh u lirua nga burgu.

Pas lirimimit nga burgu, ai merr një dekret mbretëror, me të cilin emërohet imam në Xhaminë Ndocaj.

Haxhi Idriz Boksi kthehet nga internimi e burgu më 26 prill 1840. Ai nuk pranoi asnjëherë kompromis. Haxhi Idriz Boksi vdiq në vitin 1860. Ai la pas pasardhësit e vet.

Dy vargje të këngës që po paraqesim më poshtë flasin shumë, se kush ishte Haxhi Idriz Boksi:

“... Hafiz Pasha si Iblisi (dreqi H.B)
Trim qenka Haxhi Idrizi. ...”

Haxhi Idriz Boksi do të kujtohet nga pasardhësit në Postribë, e aq më tepër në Shkodër, si një burrë patriot i madh dhe një besimtar i devotshëm, që nuk kurseu asgjë në mbrojtje të inegritetit tokësor dhe të pavarësisë kombëtare.

HAXHI MEHMET RRASHI

Haxhi Rrashi, i njohur me këtë mbiemër pasi ka ardhur nga Rrafshi i Dukagjinit, nga Krasniqja. Në të vërtetë ai quhet Haxhi Mehmet Rrashi.

Haxhi Rrashi ka lindur rreth viteve 1832 në fshatin Rrash-Vorfë dhe ka vdekur rreth viteve 1907, duke jetuar 75 vjet.

Haxhi Rrashi rrjedh nga një familje me tradita të mira nacionaliste të fisit të njohur Jukaj. Është njohur si një familje e madhe në Postribë. Shtëpia e tij ka pasur rreth 60-70 frymë që jetonin të gjithë së bashku në një familje të madhe. Shtëpia e Haxhi Rrashit kishte mbi 12 krerë lopë, rreth 200 krerë dhenë, mbi 100 krerë dhi, tre pendë që për punimin e tokës, dy kuaj shale, dy kuaj ngarkese dhe një sipërfaqe të madhe toke.

Haxhi Rrashi lindi, u rrit dhe vdiq në regjimit e pushtimit turk. Meqenëse jetoi në Perandorinë Turke, ai nuk njohu asnjë regjim tjetër vetëm atë turk. Haxhi Rrashi ishte një besimtar i mirë dhe një nationalist i vendosur për mbrojtjen e lirisë, pavarësisë dhe të integritetit tokësor. Ai e rriti trupin e tij nëpër luftëra, gjithmonë në mbrojtje të trojeve nga pushtuesit serbo-malazezë. Ai nuk kurseu asgjë për mbrojtjen e lirisë dhe pavarësisë së atdheut dhe me të gjithë meshkujt e familjes së tij u vu në mbrojtje të integritetit tokësor.

Haxhi Rrashi merr pjesë në Luftën e Shpuzës, në të tri fazat e saj. Në fazën e dytë më 1860, në moshën 28 vjeçare, Haxhi Rrashi merr pjesë me forcat turko-shqiptare kundër malazezëve. Në këtë luftë fronti turko-shqiptar kishte rreth 20,000 luftëtarë trima bashkë me malësorët e Mbishkodrës. Hamdi Bushati nuk sqaron këtu se cilët ishin këta malësorë të Mbishkodrës, por unë dua të sqaroj se bashkë me forcat e tjera të Mbishkodrës ishin pa diskutim edhe malësorët e Postribës, pasi siç do ta përmendi edhe më poshtë, gjatë kësaj periudhe Mustafë Brahimi (Spahija) nga Boksi i Postribës, bëri duel me shkaun malazias dhe i këputi kokën atij. Pas duelit nisi një luftë e rreptë. Në këtë moment Ahmet efendi Kalaja, me origjinë nga Kalaja e Drishtit, myderrizi shkodran i përmendur dhe i njohur për nisma trimërie e burrërie, me zërin e tij kumbues, iu drejtua luftëtarëve me thirrjen: “Kush të duan me hy në xhenet sot i ka dyert e hapura!”

Haxhi Rrashi ishte burrë me karakter të lartë. Ai ishte trim, i vendosur për ta ruajtur nderin, burrërinë dhe atdheun të pacënuar nga asnjë pushtues. Ai ishte burrë i drejtë, i ndershëm, burrë i besës, i zgjuar. Ai ishte burrë fisnik dhe bujar. Haxhi Rrashi i donte shumë njerëzit dhe i vlerësonte ata.

Duke qenë burrë i zgjuar dhe i drejtë, atij i takoi të marrë pjesë në pleqërimin e shumë çështjeve dhe problemeve e deri në pajtim gjaqesh. Ai ka pleqnuar jo vetëm si plak i Postribës por edhe në pleqni malesh si në Malësi të Madhe, në Dukagjin, në Shllak, e deri në Krasniqë. Bashkë me Haxhi Rrashin kanë marrë pjesë në pleqni edhe Tahir Osmani i Hykajve, Elez Brahimi i Shegajve, Avdyll Mustafa i Hoxhajve e të tjerë.

Haxhi Rrashi ka përdorur veshjen e vjetër me dallamë, me çakçirë (tirqe), gybere, xhamadan ari me qestek, qeleshe të bardhë dhe të pështjellë rreth saj shall, identike me veshjen e kosovarëve. Ai pëlqente sportin e gjojes, pëlqente gjuajtjen e shenjave me armë në ditë festash e në dasma. Ai pëlqente, gjithashtu, gara hipizmi me kuaj, lojërat popullore si lojën e unazave, kala dibrançe etj.

Në shtëpinë e Haxhi Rrashit mbanin “Shterë”(Gur për shtypjen e kafes) për bluarjen e kafes, të cilën e kanë ruajtur deri vonë. Haxhi Rrashi pëlqente këngët me lahutë, këngë të epikës legjendare si dhe të epikës historike, të trimave dhe heronjve të luftës në shekuj, këngët e mbrojtjes së nderit, të mbrojtjes së atdheut dhe të fesë.

Haxhi Rrashi i nderonte trimat dhe organizatorët e luftës në mbrojtje të lirisë dhe të pavarësisë kombëtare. Ai i respektonte shumë burrat e fiseve të Postribës dhe pëlqente të bënte miqësi me ta, pasi siç thonte ai, bijat e fisit o të lënë fjalën o djalin.

Haxhi Rrashi do të kujtohet nga brezat pasardhës, si një burrë fisnik, trim, nacionalist dhe i zgjuar. Bashkë me burrat e tjerë në zë të Postribës lanë një emër të mirë, një vepër të mirë dhe një të kaluar të lavdishme të Postribës. Si të tillë, burrat nuk vdesin kurrë.

IDRIZ TAHIR HYKAJ-VORFË

Idriz Tahir Hykaj rrjedh nga një familje nacionaliste e fisit të njohur Hykaj nga fshati Vorfë të zonës së Postribës. Ai u lind më 2 prill 1875 në fshatin Vorfë dhe vdiq në Vorfë me 14 prill 1964. Idriz Tahir Hykaj është mik shtëpie i Adem dhe Osman Haxhi Spahisë të fshatit Boks të Postribës. Ai ishte antikomunist i vendosur, por duke qenë një nacionalist i ndershëm, ndihmoi Luftën Nacional-çlirimtare me qëllimin e mirë për çlirimin e vendit nga pushtuesit, por jo për të sjell komunizmin në Shqipëri.

Në Kryengritjen Antikomuniste të 9 shtatorit të vitit 1946, marrin pjesë dy djemtë e tij, Dervish e Dul Idrizi (Hykaj). Pas dështimit të kryengritjes arrestohen të dy pjesëmarrësit me datën 23 dhjetor 1947, sipas të dhënave që kemi marrë nga Caf Hyka, dhe vuajnë dënimin në burgjet shqiptare bashkë me shumë pjesëmarrës të tjerë.

Gjatë viteve të pushtetit komunist për rreth 50 vjet familja e Idriz Tahir Hykaj trajtohet si një familje e deklasuar.

Në vitin 1950, sipas Caf Hykës, dënohet me 16 vjet heqje lirie nipi i Idriz Tahirit, i quajtur Muho Dul Hykaj në moshën 20 vjeçare dhe pas 8 vjet burgimi dhe torturash, ai vdes në burg dhe sot e kësaj dite nuk i dihet as vendi i varrosjes. Në vitin 1965, pushteti komunist arreston nipin tjetër të Idriz Tahirit, të quajturin Jonuz Hyka, në moshën 27 vjeçare, i cili dënohet me pushkatim dhe përsëri sipas Caf Hykës, me datën 2 nëntor të vitit 1965 pushkatohet. As Jonuz Hykës nuk i dihet varri, sot e kësaj dite.

Në vitin 1984, më 10 gusht, sipas Caf Hykës, partia në pushtet demaskon para popullit të Vorfës Dul Idriz Hykaj, i cili akuzohet si armik i Partisë. Gjithashtu me datën 17 shtator 1988 demaskohet Dervish Idriz Hykaj si armik i Partisë, i cili akuzohet sikur ka folur për bunkerët që ka bërë Partia në atë kohë. Ai akuzohet gjithashtu për tufëzat dhe për kolektivizimin, etj. Demaskimi u bëhet këtyre vëllezërve nga instruktori i komitetit të partisë i asaj kohe si dhe nga organizata e partisë në zonë.

Idriz Tahir Hykaj merr pjesë në Rrethimin e Shkodrës në vitin 1912, në Fusha të Myselimit si dhe në Bardhanjel bashkë me burrat e tjerë të Postribës, nën komandën e Adem Haxhi Spahisë, të cilët shquhen në luftë kundër serbo-malazezëve. Në këtë luftë ai është në moshën 37 vjeçare. Në këtë luftë, në përpjekje e sipër vritet Imer Zenel Hykaj, vëllai nga nëna i Idriz Tahir Hykës.

Idriz Tahiri merr pjesë edhe në Luftën e Koplikut, në vitin 1920, në Suka të Moksetit, bashkë me postribas të tjerë dhe nën komandën e komandantit popullor, Adem Haxhi Spahija. Edhe këtu ata shquhen për sakrificë dhe trimëri në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe të sovranitetit tokësor.

Idriz Tahir Hykaj ka qenë një burrë i njohur jo vetëm në Postribë, por dhe në Malësinë e Madhe, si një burrë trim, i urtë që ka ndihmuar në zgjidhjen e shumë problemeve në zonë e më gjerë si dhe si një shtëpi e madhe, fisnike e mikpritëse. Djali i tij Dervish Idrizi pas viteve 1990 ka kontribuar shumë për paqe bashkë me burra të tjerë të Postribës, ndërsa nipi i Idriz Tahirit, Caf Dervish Hyka ka shërbyer si misionar i paqes bashkë me Emin Gani Spahinë, drejtues i këtij misioni. Caf Hyka e donte dhe e respektonte shumë kryemisionarin e paqes, Emin Spahija dhe e vlerësonte si të njëjtë me punën e Anton çetës në Kosovë.

Idriz Tahiri do të mbetet në kujtesën e atyre që e kanë njohur, si një burrë në zë në Postribë.

IMER ADEM MILANI-DOMËN

Imer Adem Milani rrjedh nga një familje e fisme e fisit Milan të fshatit Domën të zonës Postribë. U lind më 26 shtator të vitit 1914 në fshatin Domën dhe ka vdekur më 1 maj të vitit 1998 në lagjen Milan të fshatit Domën.

Familja e Imer Adem Milanit ka qenë një ndër familjet e mëdha dhe të njohura në Postribë. Shtëpia e tij ka qenë shtëpi mikpritëse, bujare, e besës me traditat më të mira që mund të ketë pasur një familje në Postribë. Ai ka pasur marrëdhënie shumë të mira me familje të tjera jo vetëm në fshatin Domën, por edhe me familje të tjera të bajrakut të Drishtit, të bajrakut të Boksit dhe të bajrakut të Sumës.

Familja e Imer Adem Milanit me marrjen e pushtetit nga Partia Komuniste, u cilësua "Familje kulaku". Imer Adem Milani mori pjesë në Kryengritjen Antikomuniste të 9 shtatorit të vitit 1946. Për këtë u lidhen

me litar për man te shtëpia e vjetër në vitin 1946, bashkë me Hajdar Smajl Milanin, të cilët donin t'i pushkatonin, por për fatin e tyre u ndalua ky pushkatim nga Zek Bajrami i lagjes Derraj të Domnit, i cili ishte atëherë me detyra në pushtet.

Familja e Imer Adem Milanit u trajtua si familje e deklasuar gjatë gjithë regjimit komunist.

Në vitin 1916, me pushtimin austro-hungarez, Imer Adem Milani merr pjesë në kryengritjen kundër pushtimit Austro-Hungarez të drejtuar nga paria e Postribës dhe komandanti popullor Adem Haxhija.

Imer Adem Milani ishte burrë i drejtë dhe besimtar. Ka marrë pjesë në kuvende për pajtim gjaqesh e për probleme të tjera të fshatit e më gjerë.

Në "Gazetën Zyrtare të vitit 1946, nr. 88, faqe 3, me dekret nr. 173, datë 12 shtator 1946, Imer Adem Milanit, pasi kryen një pjesë të dënimit, i dënuar si kriminel lufte dhe armik i popullit, me vendim të Presidiumit të Kuvendit Popullor, të propozuar nga qeveria e asaj kohe dhe të miratuar nga Kuvendi Popullor, i falet dënimi kundër heqjes së lirisë personale.

Sa jam i informuar, ai është dënuar si pjesëmarrës i kryengritjes së Llesh Marashit të vitit 1945, periudhë në të cilën edhe është dënuar. (shënimi im, R. S) Për saktësi mund të shihet kapitulli "Kryengritja Antikomuniste e Postribës".

Imer Adem Milani ka marrë pjesë në të gjitha luftërat që janë zhvilluar në mbrojtje të lirisë, sovranitetit dhe integritetit tokësor, si në Luftën e Koplikut në vitin 1920, në rezistencën antifashiste të vitit 1939, në Kodra të Tepes, në Bahçallek e Kodra të Bërdicës nën komandën e Adem Haxhisë.

Imer Adem Milani do të mbetet në kujtesën e brezave pasardhës, si një burrë në zë i Postribës, si një besimtar i mirë dhe si një nacionalist i devotshëm për mbrojtje të trojeve tona.

IMER BEQIR SHABAJ-BOKS

Imer Beqir Shabaj u lind në Kodër-Boks në vitin 1878 dhe vdiq më 9 shtator 1946. Gjatë jetës së tij ai kaloi regjimin turk, Pavarësinë, Mbretërinë Shqiptare dhe Sistemin Komunist.

Imer Beqiri rrjedh nga një familje me tradita shumë të mira nacionaliste. Ai ka marrë pjesë në të gjitha përpjekjet kundër pushtuesve të huaj të vendit tonë.

Në vitin 1912-1913 në Rrethimin e Shkodrës merr pjesë në frontin e Myselimit dhe atë të Bardhanjelit së bashku dhe nën komandën e Adem Haxhisë dhe lufton me heroizëm në mbrojtje të Shkodrës. Në këtë luftë merr pjesë edhe vëllai i tij, Brahim Beqir Shabaj, i cili vret 8 serbë dhe plagoset vetë, nga e cila plagë vdes. Postribasit para se të nisen në këtë luftë marrin abdes dhe marrin hallallin në familjet e tyre, duke menduar se mund të vriten dhe nuk kthehen më. Populli e quajti "Nishanxhi Taborr" këtë njësi ushtarake të drejtuar nga Adem Haxhija (Spahija).

Në pushtimin Austro-Hungarez të vitit 1916 Imer Beqiri kapet nga regjimi, vetë i treti, bashkë me Nuz Halilin e fisit Halilaj dhe Baz Haxhinë e fisit çelaj dhe varen për krahësh në manin e varrezave të fshatit Dragoç. Këtë veprim, regjimi austriak e bën për të bërë presion në zonë, në mënyrë që të mos realizohet kryengritja kundër regjimit, por megjithatë ata nuk ia arrijnë qëllimit. Kryengritja realizohet dhe detashmenti ushtarak që ishte i vendosur në Drisht, në ikje e sipër bie në përpjekje me forcat kryengritëse në afërsi të Urës së Mesit, lë të vranë tre ushtarë dhe dy boshnjakë bien në besë të Murat Imerit (Shabaj). Në vitin 1920 merr pjesë në Luftën e Koplikut bashkë me Adem Haxhinë dhe trimat e Postribës. Postriba shquhet për qëndruesë dhe nuk e lëshon vijën e frontit deri sa vjen ndihma nga Tirana me në krye Ahmet Zogun. Fronti i Postribës me Adem Haxhinë në krye dhe fronti i Hotit me Deli Metën në krye shquhen për luftën vetëmohuese dhe heroizmin e tyre.

Në shtëpinë e Imer Beqirit në Kaçerdhe është bërë takimi i Bajram Currit me Adem Haxhinë dhe është biseduar që "Shqipëria të qeveriset më vete, e pavarur nga të tjerët". Në vitin 1939, në pushtimin fashist, Imer Beqiri merr pjesë bashkë me Adem Haxhinë dhe Postribën për t'i bërë rezistencë Italisë Fashiste në Kodra të Tepes, në Bahçallek dhe në Kodra të Bërdicës. Ata i hapin zjarr pararojes së ushtrisë italiane tek Ura e Bahçallekut dhe në këtë zjarr bien viktimat e para italiane. Këtu shquhet trimi patriot Cen Adem Hasaj nga Boksi. Pas pushtimit fashist Imer Beqiri dhe Adem Haxhija arrestohen dhe pasi qëndrojnë pak në burgun e Shkodrës dhe në atë të Tiranës, internohen në Kolfiorito të Italisë, ku qëndrojnë për rreth një vit. Adem Haxhija helmohet këtu dhe pas dhjetë ditësh që kthehet në Shqipëri, vdes i helmuar nga fashistët italianë.

Në vitin 1946 Imer Beqiri merr pjesë në Kryengritjen Antikomuniste të 9 shtatorit bashkë me burrat e tjerë të Postribës dhe pas dështimit të kryengritjes fillojnë raprezaljet në Postribë. Kryexhelati Zoi Themeli i çon fjalë Imer Beqirit që të paraqitej tek xhamia në Kodër Boks. Ai e kupton mirë se për çfarë thirret dhe merr abdes që të vdesë l pastër. Sapo shkon në Kodër Boks tek xhamia, atë e arrestojnë dhe e lidhin bashkë me të birin, Hysenin, dorë për dorë dhe i nxjerrin për t'i pushkatuar. Pas dy-tre urdhrash për t'i pushkatuar, lirojnë Hysenin pasi ishte shumë i ri dhe e vendosin para skuadrës së pushkatimit vetëm Imer Beqirin. Para se ta pushkatojnë i thonë për të thënë fjalën e fundit. Imer Beqiri thotë dëshminë se ka vetëm një Zot dhe se Muhamedi është i dërguari i tij. Pas Shehadetit (këtyre thënieve) atë e pushkatojnë.

Imer Beqiri ka qenë njeri me karakter të fortë. Ai ka qenë besimtar i mirë, njeri i besës, mikpritës, bujar, trim, fisnik dhe atdhetar i vendosur për mbrojtjen e trojeve etnike shqiptare. Shtëpia e Imer Beqirit e ka ndihmuar shumë Luftën Nacional-çlirimtare me bukë strehim, pritje e përcjellje, por ka qenë në armiqësi me komunizmin, pasi ishte një besimtar i devotshëm.

Imer Beqir Shabaj do të mbetet në kujtesën e brezave që vijnë pas, si një simbol i nacionalizmit dhe një nga burrat më në zë të Postribës.

ISMAIL DUL HALAJ - DRAGOÇ

Ismail Dul Halaj u lind në një familje të fisme të fisit Halilaj të fshatit Dragoç, në vitin 1917 dhe vdiq në vendlindjen e tij në vitin 1981.

Ismail Dul Halaj që në rininë e tij shquhet si një djalë energjik, i angazhuar në problemet shoqërore dhe i gatshëm për t'u shërbyer njerëzve.

Rreth vitit 1942, në moshën 25 vjeçare, Ismail Dul Halaj angazhohet me rininë antifashiste shqiptare dhe, duke qenë shumë aktiv, zgjidhet përfaqësues i rinisë antifashiste të zonës së Mbishkodrës dhe merr pjesë në një mbledhje të rinisë antifashiste shqiptare në Tiranë, në të cilën mbledhje ai diskuton me patos në lidhje me detyrat që ka rinia për mbrojtjen e atdheut nga rreziku fashist. Më vonë Ismail Dul Halaj angazhohet me Ballin Kombëtar si simpatizant i tij, ku ai jep një kontribut të vlefshëm si i ri që ishte.

Pas çlirimit të vendit, në vitin 1946, i zhgënjyer nga idealet e rinisë antifashiste shqiptare, e cila u bë një vegël besnike e Partisë Komuniste, Ismail Duli është një nga organizatorët kryesorë të Kryengritjes Antikomuniste të 9 shtatorit dhe merr pjesë në mbledhjen që organizohet në Shegat e Ibre, për organizimin e kyengritjes që do të bëhej së shpejti.

Pas dështimit të kryengritjes së 9 shtatorit, Osman Haxhija jep urdhër për tërheqjen e forcave të mësymjes. Në tërheqje e sipër, Ismail Dul Halaj mban frontin me Jonuz Salo Shkrelin, në mënyrë që t'u jepej mundësia forcave të Postribës të tërhiqeshin pa ndonjë dëm të madh. Në afërsi të Fermentimit të Duhanit apo në afërsi të Golemit vritet Jonuz Salo Shkrelej nga forcat e operacionit komunist të udhëhequra nga Zoi Themeli, dhe i zënë në vështirësi Ismail Dul Halaj, heq kutinë e duhanit nga xhepi dhe bën sikur e ndez dhe e hedh në drejtim të forcave operative që kishin marrë përsipër të bënin raprezalie mbi kryengritësit rebelë. Në këtë kohë forcat operative mbrohen duke rënë të gjithë barkas rrafsh me tokën, duke menduar se ishte granatë luftarake, dhe në këtë mënyrë Ismail Duli fiton kohë dhe forcat e tjera të Postribës fitojnë kohë që të largohen. Ismail Dul Halaj largohet në fshehtësi nga fshati Golem dhe prej andej kalon në Vrakë dhe merr drejtimin për në Gruemirë. Duke e hetuar se ai kishte marrë drejtimin për në Gruemirë, forcat operative marrin masa për të kontrolluar zonën. Ismail Dul Halaj shkon në një çezme dhe gjen një grua duke mbushur buljerën me ujë. Ajo e kupton se është kryengritës dhe e informon se i kishin zënë pritë. Ai i thotë ma jep mua buljerën dhe thuaj se jam djali yt, ndërkohë automatikun e fsheh nën pelerinë. Gruaja ecën përpara dhe Ismail Duli pas saj me buljerë në krah. Kur e pyesin plakën ajo u thotë se djali i saj kishte shkuar për ta ndihmuar, pasi ajo nuk ishte në gjendje që ta ngarkonte buljerën. Në këtë mënyrë Ismail Dul Halaj shpëton nga forcat operative të komunizmit dhe del në mal. Udhëton nëpër mal deri sa del në Bukmirë të Sumës. Aty ai shkon në shtëpinë e Halil Zenelit dhe nuk pranon të strehohet në shtëpi, në mënyrë që të mos i sjellë dëm njerëzve të tij. Ai fshihet në një shpellë larg shtëpisë së Halil Zenelit dhe për aq kohë sa rri atje, ata e mbajnë me bukë si postribas që ishte.

Forcat e sigurimit gjejnë kutinë e duhanit të Ismail Dulit, në të cilën ishte shkruar emri i tij dhe lajmërojnë që po të mos dorëzohej, jo vetëm që shtëpia do t'i digjej, por do të pushkatonin edhe vëllezërit e tij. Shtëpia i digjet nga forcat operative dhe Ismailit i shkon fjala se i kishin djegur shtëpinë. Duke menduar se pas djegies së shtëpisë do t'i vriteshin vëllezërit, ai detyrohet të dorëzohet dhe në këtë

mënyrë ai arrestohet nga forcat e sigurimit. Sipas djalit të tij, Ruzhdi Ismail Halaj, ai u dënua në fillim me pushkatim, pastaj i zbret dënimi 25 vjet heqje lirie dhe përfundimisht ai kryen 7 vjet burg, duke dalë i lirë rreth viteve 1953 - 1954.

Në vitin 1969, regjimi komunist i Enver Hoxhës do të organizonte një dënim të dytë në Postribë për të vënë nën diktaturë të plotë gjithë popullsinë tjetër të persekutuar në vazhdimësi që nga viti 1946. Regjimit i duhej të bëhej një kurban. Dhe ai e kishte gjetur se cili do të ishte kurban i rradhës. Njeriu më i përshtatur për këtë qëllim do të ishte Ismail Dul Halaj, i dënuar si pjesëmarrës në kryengritjen antikomuniste të 9 shtatorit. Kësaj rradhe u punua për gjetjen e akuzave dhe për të sajuar se kush do të ishte dëshmitar për akuzat e trilluara. Akuzat ishin fabrikuar nga organet e sigurimit të shtetit si për shembull "Tentativë për arratisje". (Kjo akuzë e kishte bazën sepse Ismail Dul Halaj ishte nip Kraje dhe gjoja do të arratisje nga Shiroka e Zogajt për të shkuar tek dajat e tij). Akuza e dytë ishte për plastmasin, pasi sipas tyre ai kishte thënë "Ky qenka i mirë për qefinin e Mao Ce Dunit" dhe akuza e tretë ishte "Për agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor". Me këto tri akuza Ismail Dul Halaj mori dënimin me heqje lirie dhe kreu edhe 5 vjet të tjera burg.

Këtu poshtë do të japim dy strofa nga kënga për Kryengritjen Antikomuniste të 9 shtatorit të vitit 1946, që populli ka përjetësuar veprimtarinë dhe trimëritë e burrave nacionalistë dhe antikomunistë të Postribës:

"... ç'është ai trim që rri në ballë?
Osman Haxhija trim luftëtar
Ja ka hek dera e shtëpia
Thonë është ngjallur Adem Haxhija
Po ai trim që rri përbri
Ismail Duli një djalë i ri
Fort gjerdanin e ka shterngu
Thonë se nëna e ka lind dragu ..."

Ismail Dul Halaj do të mbetet në kujtesën e brezave që do të vijnë, si një burrë energjik, trim e nacionalist në mbrojtje të lirisë, pavarësisë, integritetit dhe besimit në një Zot të vetëm, si një besimtar i vertetë.

ISUF HASAN MEAJ (MEHAJ-KURTAJ) - URA E SHTREJTË

Isuf Hasani ka lindur në fshatit Ura Shtrejtë të Postribës në vitin 1883 dhe vdiq në Ura Shtrejtë në vitin 1965. Sipas të dhënave të djalit të tij, Isa Isufi, ai vdiq brenda kohës së internimit. Isuf Hasani rrjedh nga një familje me tradita të mira nacionaliste. Fisi i tij Kurtaj, që sot njihet me mbiemrin Meaj dhe Mehaj, kanë ardhur nga Dibra dhe janë vendosur të parët në fshatin Ura Shtrejtë. Ngulimi i tyre është bërë rreth viteve 1450-1500, pra të parët banorë në këtë fshat. Fisi i tyre, sipas gojëdhënave të dëshmuara nga Isa Usuf Meaj, është me origjinë nga Pregazi i Poshtëm i Drenicës, të vendosur më parë në Dibër dhe të ardhur nga Dibra nëpër Cukal dhe pasi kanë zbritur nga Cukali, janë vendosur në lagjen që mori emrin Kurtaj nga fisi Kurtaj i Dibrës.

I pari i fisit Kurtaj quhej Qorri i Kurtajve. Isa Isufi na kujton se duhet përmendur Harapi i Mehajve, i cili në bejleg me një pushtues në breg të liqenit të Shkodrës del fitimtar duke ia prerë kokën kundërshtarit. Gjithashtu, sipas Isa Isufit duhet përmendur Hasan Velija, baba i Isuf Hasanit, i cili u vra me njerëzit e vezirit të Shkodrës për probleme të fshatit Ura Shtrejtë rreth viteve 1895. Ai u largua për 9 vjet në Dibër bashkë me të birin, Isuf Hasanin që ishte rreth 12 vjeç. Veziri dogji dhe shkatërroi çdo gjë të familjes së tij.

Sipas Isa Isufit, veziri mori edhe masa të tjera duke i hequr parinë e fshatit dhe këtë ia kaloi Ahmet Isen Sykajt. Sipas të dhënave të tjera të marra nga burra të Urës së Shtrejtë, të të gjitha fiseve, kalimi i vendit të parë nga Kurtajt tek Sykajt ka ndodhur ndryshe. Është fjala për një gjak që Sykajt nuk mundën ta merrnin, pasi nuk mund t'i zinin Kurtajt në asnjë pritë. Pleqnia ndërhyr për t'i rregulluar dhe si përfundim Sykajt ranë dakord që Kurtajve t'u falej gjaku me kusht që ata të merrnin vendin e parë që kishin Kurtajt dhe Kurtajt të kalonin në vendin e dytë. Pleqëria i pajtoi sipas kushtit që kërkuan Sykajt. Unë i paraqita të dy variantet. Më mirë se askush tjetër, këtë histori e di populli i Urës së Shtrejtë.

Rreth vitit 1905, pas 9-10 vjetësh që ndenjti në Dibër, bashkë me babën e tij, Hasan Velinë, Isuf Hasani kthehet në Ura Shtrejtë. Gjatë kohës që ishte në Dibër, Isufit i kishte vdekur nëna e tij. Baba i tij Hasan Velija martohet me një grua të dytë, me të cilën lind një djalë, Tahir Hasani. Tahir Hasani në provokacionin e 2 gushtit të vitit 1949 ndodhet në frontin e luftës me grekët, dhe për merita patriotike dekorohet me Dekorata trimërie, kjo sipas Isa Isuf Meaj.

Isuf Hasani merr pjesë në Rrethimin e Shkodrës në vitet 1912-1913 bashkë me burrat e tjerë të Postribës dhe inkuadrohet nën komandën e Adem Haxhisë. Si shenjë hakmarrjeje, serbo-malazezët djegin të gjitha fshatrat e Postribës, pasi shtëpitë kishin mbetur shkretë, sepse popullsia ishte zhvendosur në Shkodër.

Isuf Hasani merr pjesë në Luftën e Koplikut në vitin 1920 nën komandën e Adem Haxhisë dhe në këtë betejë, sipas Isa Isufit, Isufi plagoset. Duhet shënuar se në materialet historike për Luftën e Koplikut janë të vrarë pesë vetë nga fshati Ura Shtrejtë dhe të plagosur 12 veta, por emri i Isuf Hasanit nuk del nga këto të dhëna.

Në vitin 1926 Isuf Hasani, sipas Isa Isufit, vret një hasëm të fisit të tij dhe qeveria e Ahmet Zogut e dënon Isufin me vdekje në mungesë. Isuf Hasani rri tre vjet në arrati nëpër miqtë e vet. Pas tre vjetëve, miqtë e tij Isen Beg Selmani, Hasan Hoti dhe Lan Juka i bjen mbretit brenda që t'i falin jetën Isuf Hasanit. Mbreti duke pasur parasysh që në vitin 1924 e gjithë Postriba voton për Ahmet Zogun dhe gjithashtu Isuf Hasani bashkë me krerët e Postribës ishin përkrahësit kryesorë, ia fal jetën dhe burgun, duke e lënë të lirë atë.

Isuf Hasanit i vdes gruaja e parë duke i lënë vetëm një djalë, Hasan Isufin, i cili kishte lindur në vitin 1924. Ai vdiq në moshën 73 vjeç, në vitin 1997. Si kundërshtar i komunizmit, Hasan Isufi bën 9 vjet burg dhe 5 vjet internim.

Pas vdekjes së gruas së parë, Isufi martohet me gruan e dytë, me të cilën i lindin katër fëmijë: Isa, Adem, Hanë dhe Feride Isufi.

Isuf Hasani i bën rezistencë Italisë fashiste më 7 prill 1939 tek Ura e Lezhës, bashkë me forcat e Xhemal Beg Mlikës, (kjo sipas dëshmisë së Isa Isuf Meaj), të cilin e kishte mik për kokë. Këtu i hapin luftë Italisë fashiste. Pas këtij akti Isuf Hasani arrestohet nga pushtuesit italianë. Këtu hyn Sylço Beg Bushati për të mos e internuar dhe mbasi bën disa kohë burg, përsëri ndërhyrjen Sylço Beg Bushati dhe e lirojnë nga burgu.

Në vitin 1941, në luftën Italo-Jugosllave, siç dëshmohet nga Isa Isufi, serbo-malazezët vendosin për të pushkatuar 24 burra nga Prekali, por me ndërhyrjen e Isuf Hasanit bashkë me fiset e fshatit Ura e Shtrejtë, duke e kërcënuar me armë ushtrinë serbo-malazeze, detyrohen të lirojnë 24 burrat prekalorë. Prekalorët ia shpërblejnë Urës së Shtrejtë më vonë këtë ndërhyrje për shpëtimin e jetës së 24 burrave.

Në vitin 1942, në fshatin Ura Shtrejtë krijohet çeta e Parë partizane për çlirimin e vendit nga pushtuesit, por jo për të sjellë në pushtet komunizmin. Çeta krijohet nga nacionalistë të vendosur për mbrojtjen e trojeve nga çdo lloj pushtimi.

Isuf Hasani merr pjesë në Luftën e Reçit me forcat e Sali Myftisë. Ai arrestohet në janar të vitit 1945 me pretekstin se burrat e Postribës donin të bashkoheshin me çetën e Llesh Marashit për të bërë kryengritjen së bashku.

Isuf Hasani merr pjesë në mbledhjen që organizohet në shtëpinë e Hamza Zejnunit në fshatin Kullaj-Boks. Pas mbledhjes, ai arrestohet tek Ura Mesit. Në Rrsek arrestojnë Rexhep Hajdar Milanin. Të arrestuarit i çojnë tek xhamia e Urës së Shtrejtë. Këtu arrestojnë edhe Jakup Met Vulajn, i cili vdiq në hetuesi. Arrestojnë gjithashtu Rasim Asllan Malajn dhe Ram Hasan Ahmetin, të cilin këtë të fundit e arrestojnë për Ram Met Hasanin. Ky del i pafajshëm në gjyq pasi e sqaron se ai nuk ishte Ram Met Hasani, por Ram Hasan Ahmeti. Pas pak lirohet edhe Rasim Asllan Malaj.

Në shtator të vitit 1945, pas 8 muajve në hetuesi në burgun gjerman në Shkodër, Isuf Hasani dënohet me 10 vjet burg, për të cilat vuan dënimin po 10 vjet. Kur i thanë Isuf Hasanit se dënohesh si mik i mbretit, por hiq dorë nga mbreti se të falim dënimin, ai u tha: "Edhe kryet në ma prefshi, ai ashtu i premë thotë emrin e Ahmet Zogut, edhe zemrën në ma çilshi, mbretin e gjeni në zemrën time ndejë aty. Do t'u a lë edhe pasardhësve të mi amanet që të jenë me mbretin, i cili krijoi shtetin e parë shqiptarë".

Pasi mbaroi 10 vjet burg, Isuf Hasanin e arrestojnë familjarisht dhe e internojnë në kënetat e Lushnjes, ku edhe vdes brenda kohës së internimit në vitin 1965.

E gjitha familja e Isuf Hasanit dënohen si më poshtë:

- Isuf Hasani 10 vjet burg dhe 5 vjet internim

- Hasan Isufi 9 vjet burg dhe 5 vjet internim.
- Isa Isufi 20 vjet burg.
- Adem Isufi internim.
- Gruaja e Isasë 5 vjet internim.
- Rabija, gruaja e Isuf Hasanit, arrestuar, torturuar dhe internuar prej vitit 1945 dhe deri në vitin 1990.

Familja e Isuf Hasanit është konfiskuar disa herë, sa herë kanë rënë në burg apo janë internuar pjestarët e familjës.

Isuf Hasani është bërë operacion nga një mjek popullor nga Karma e Mirditës i quajtur Marash Kola, i cili e bëri operacion në vitin 1916. Ai i hoqi një kockë të thyer në këmbë dhe në vend të saj i vuri një kockë qeni. Operacioni i doli me sukses dhe gjatë gjithë jetës së tij, Isuf Hasani nuk u ankua më për këtë ndërhyrje kirurgjikale nga mjeku popullor i Karmës.

Isuf Hasani do të kujtohet nga brezat pasardhës si një burrë nacionalist që diti për t'i dalë çdo herë situatave të vështira me aftësitë e tij prej malësori.

Burimi i këtyre të dhënave është materiali i dhënë nga djali i tij, Isa Isufi, i cili dorëzoi një dorëshkrim tek autori i librit. Materialit nuk iu bë asnjë ndryshim dhe u lexua në prezencën e Isa Isuf Meaj.

ISUF SYLO GASHI (VULAJ) - URA E SHTREJTË

Fisi i Vulajve mendohet të ketë ardhur nga Gashi i Kosovës, rreth viteve 1770 si pasojë e luftërave dhe në kërkim të një jete më të mirë. Isuf Sylo Vulaj, për të ruajtur origjinën nga kanë ardhur të parët e tyre, do të ketë marrë mbiemrin "Gashi", ky është edhe mendimi i trashëgimtarit të tij Ramadan Vulaj, i cili është kryetari i veteranëve për fshatin Ura e Shtrejtë. (E bëra këtë sqarim sa për të shuar kureshtjen e lexuesve në lidhje me mbiemrin).

Isuf Sylo Gashi (Vulaj) rrjedh nga një familje e fisit Vulaj të fshatit Ura e Shtrejtë, me tradita shumë të mira nacionaliste.

Isuf Sylo Gashi (Vulaj) ka lindur në fshatin Ura e Shtrejtë të Postribës rreth vitit 1849 dhe ka vdekur në vitin 1929 në fshatin Ura e Shtrejtë.

Isuf Sylja ka qenë një nacionalist i devotshëm. Ai gjithë jetën e tij ia kushtoi mbrojtjes së lirisë, pavarësisë dhe mbrojtjes së integritetit tokësor. Ai ka marrë pjesë në Rrethimin e Shkodrës në vitin 1912-1913 në frontin e Myselimit dhe atë të Bardhanjelit me luftëtarët e Postribës nën udhëheqjen e parisë së vendit dhe të komandantit popullor Adem Haxhija (Spahija) dhe ka luftuar me heroizëm për mbrojtjen e trojeve nga pushtuesit e huaj.

Isuf Sylja ka marrë pjesë në Kryengritjen kundër pushtimit austro-hungarez në vitin 1916 së bashku me burrat e Postribës, të cilët ranë në përpjekje me forcat pushtuese në afërsi të Urës së Mesit dhe i thyen ato duke u vlarë tre ushtarë dhe duke u zënë robër lufte dy boshnjakë.

Isuf Sylo Gashi (Vulaj) mori pjesë edhe në Luftën e Koplikut të vitit 1920, në Suka të Moksetit, megjithëse ishte i moshuar në këtë kohë dhe nuk kurseu asgjë në mbrojtje të pavarësisë së atdheut. Në lidhje me Luftën e Koplikut tregohet një ngjarje nga të moshuarit e fshatit Ura e Shtrejtë dhe konkretisht thuhet kështu: Sylço Begu del në Shkallë Basleq (në fshatin Boks) dhe u thotë burrave të Postribës që ishin nisur për luftë: "A keni marrë hoxhallarë me vete?!"

Ura e Shtrejtë i përgjigjet: "Ne i kemi marrë hoxhallarët me vete sepse i kemi prej Boksit, Drishtit dhe Dragoçit, kemi marrë edhe qefinët me vete, por ne kemi nevojë dhe duam armë e fishekë me luftue me Mal të Zi për të çliruar vendin".

Ramadan Vuli dëshmon: "Në Luftën e Koplikut të vitit 1920 ka marrë pjesë e para Postriba me luftëtarët e vet dhe e kanë çuar ushtrinë serbo-malazeze duke e ndjekur deri jashtë kufinjëve shtetërorë. Në këtë luftë kanë mbetë të vlarë Can Osmani e Zeqir Bejtja (Fikaj) dhe plagosur janë Hasan Ahmeti, Zeqir Ahmeti, Sait Hasani, i Hasan Ahmetit, Shaban Elezi Kurtaj, Met Hasani Mehaj, baba i Ramë Metës, Mehmet Osmani, Brahim Mustafa e të tjerë". Sipas Ramadan Vullit, është një këngë e vjetër që i kushtohet sa duket babës së Isuf Sylos, Sylejman Tafë Alisë, e cila këndohet si më poshtë:

"...Sylejmani i Tafë Alisë
Preu kryet e llisë
Nën shpatë të Malcisë..."

Sylo ose Sylejman Gashi, i quajtur në këngë “Sylejmani i Tafë Alisë” është varrosur në bjeshkë të Rumisë, sepse gjatë luftës mbeti i vranë aty, ndaj edhe aty u varros. Kjo këngë i përket kohës së hershme., rreth viteve 1800-1850, në luftërat që janë bërë me serbo-malazezët, në mbrojtje të integritetit tokësor. Isuf Sylja ka qenë burrë i gjatë, i pashëm, trim, burrë i besës, fisnik, i drejtë dhe i ndershëm. Ai ka qenë i lidhur me familjen e Sylço Begut, Oso Beg Koplikut, Gjyrezët e Shkodrës, Sykajt e Shkodrës etj.

Isuf Sylja ka qenë gjuetar i mirë dhe shkonte gjithmonë për të gjuajtur me bejlerët e Shkodrës. Isuf Sylja ka pëlqyer shumë këngët e epikës legjendare si ato të Mujos e të Halilit, të Gjergj Elez Alisë si dhe këngët e epikës historike, të heronjëve të luftës në mbrojtje të trojeve, trimave të Postribës që ruajtën nderin, që ruajtën besën, që ranë si burrat në mbrojtje të atdheut. Isuf Sylja ka lënë edhe trashëgimtarë të mirë. Nipat e tij (Djemtë e motrës së tij Kajë Sylja) janë Hasan Ahmet Sykaj, Zeqir Ahmet Sykaj, Dyl Ahmet Sykaj, Halil Ahmet Sykaj dhe Sadik Ahmet Sykaj. Këta pesë burra kanë falë tokën e tyre për të bërë xhaminë e fshatit aty ku është sot xhamia. Sipas Ramadan Vullit, xhamia e parë e fshatit Ura e Shtrejtë është bërë rreth 130 vjet më parë, që i takon aty nga viti 1870. Sipas imanit Shkëlzim Haxhia, xhamia e parë në Ura Shtrejtë është bërë rreth 300 vjet më parë, dëshmi për këtë janë varrezat e vjetra të kësaj xhamie.

Gjithnjë, sipas Ramadan Vullit, i pari që është varrosur në varrezat e Urës së Shtrejtë është Selim Osmani nga fshati Gur i Zi. Ai ka pasur të martuar motrën në fshatin Ura e Shtrejtë, në shtëpinë e Bel Ahmet Fikajt, për Kasem Osman Fikaj. Ai u sëmur tek e motra dhe aty vdiq, ndaj dhe u varros në këtë fshat.

Isuf Sylo Gashi (Vulaj) do të kujtohet me respekt nga pasardhësit, si një burrë trim, fisnik dhe atdhetar, i cili nuk kurseu asgjë në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe sovranitetit tokësor.

Shënim: Të gjitha të dhënat janë marrë nga veterani Ramadan Vuli si dhe janë saktësuar edhe nga burra të tjerë nga Ura e Shtrejtë.

JUSUF SOKOLI - SHKODËR

Jusuf Sokoli rrjedh nga familja “Sokoli” të ardhur nga fshati Sumë-Postribë, që i përket bajrakut të tretë të Postribës. Kjo familje ka zbritur në Shkodër nga lagjja Bojaj të fshatit Sumë. Bojajt janë të përmendur si fis në zë dhe për këtë ka zbritur deri tek ne shprehja e vlerësimit të katër fiseve më të përmendura në rrethin e Shkodrës, si më poshtë:

“Begajt e Bushatit,
Alijajt e Kastratit,
Bojajt e Bëshkasit,
Gegajt e Shllakut.”

Pra, një fis shumë i njohur që në lashtësi. Disa prej këtij fisi zunë vend në qytet dhe disa të tjerë në Golem. Deri vonë pasardhësit e tyre, si në Shkodër edhe në Golem quheshin kushërinj dhe ndihmonin njëri-tjetrin.

Tani trashëgimtarët e Sokolajve janë në gjendje të numërojnë me rradhë deri në tetë brezni burrash. Të gjithë e çojnë trungun gjenealogjik tek një i quajtur Bajram, kështu që, duke u nisur mesatarisht nga 30 vite (që pranohet në histori për një brezni), të paktën shkojnë deri në fillim të shekullit XVIII.

Në letrat e konsujve të Venedikut përmendet për tregti, krahas familjeve të tjera të mëdha, ajo e Sokolëve.

Më 1842 Myftar Sokoli, djali i Ahmetit, ka blerë një të dhjetën e timarit të një qytetari shkodran, i quajtur Sokol Hysejn Bekteshi. Myftari në pleqni është quajtur Haxhi Myftar Sokoli. Emrin Haxhi e merr sepse shkon në Mekë për pelegrinazh. Ky pati katër djem: Smajlin, Rexhepin, Hasanin e Jusufin. Haxhi Myftari ka qenë një nga rixhalë (këshilltarët) e Mustafa Pashë Bushatliut. Kur Turqia hyri në luftë me Rusinë në vitin 1826, Porta e Lartë i kërkoi Vezirit të Shkodrës që të merrte pjesë me forcat e veta në frontin e luftës përkrah me ushtrinë turke. Mirëpo Pasha i Shkodrës, para se të vendoste, provokoi një mbledhje të gjerë, ku ishte i ftuar edhe Haxhi Myftar Sokoli. Kjo mbledhje u bë në pallatin veror të Kosmaçit.

Sipas një dokumentacioni dorëzuar ish-Institutit të shkencave, del rëndësia e tij në atë periudhë si personalitet me influencë në Shkodër.

Me datën 1 gusht 1840 Haxhi Myftari kthehet nga Manastiri (arsyeja e shkuarjes nuk dihet, shënimi im, R. S).

Më 23 nëntor 1863, u emërua anëtar i Këshillit Administrativ, Myftar Agë Sokoli, krahas anëtarëve të tjerë të Këshillit. Nga tregimet gojore mësojmë se Jusuf Sokoli ishte burrë i urtë dhe i shkathët, përdorues i mirë i armëve dhe kalorës i zoti...

Në një letër me datën 21 janar 1865 shkruar në italisht dhe e firmosur nga Jusuf Sokoli me cilësinë "kryetar i maleve", kuptohet se ka arritur të emërohet në këtë detyrë.

Sipas dokumentave, Jusuf Sokoli ka filluar karrierën si zëvendës-krahinor, para se të caktohej i tillë.

Në librin e Kasem Taipit "Zana Popullore" në faqen 88 lexojmë, në hyrjen e këngës: "Në luftë që u bë në kala të Medunit": "Ushtria qe ndarë në dy pjesë:

1.Shkodra me Rranxa nën komandën e Jusuf Sokolit. Ushtria e rregullt e Ali Mashës.(1862)

2.Malësia e Madhe bashkë me Trepshin nën komandën e Sali Pashë Bebeziqit Jusuf Sokoli merr pjesë gjallërisht qysh në fillim të Lidhjes së Prizrenit, më 10 qershor 1878 e mbetet deri në fund nga më besnikët e saj. Ai luftoi kundër serbomalazezëve dhe Turqisë...

Më 20 tetor 1878 Jusuf Sokoli emërohet nënprefekt i Mirditës.

Në Luftën për mbrojtjen e Ulqinit Jusuf Sokoli plagoset rëndë dhe pas dy ditësh që erdhi në Shkodër, vdiq.

Për kontributin e Jusuf Sokolit në dobi të çështjes sonë kombëtare në periudhën e Lidhjes së Prizrenit, për pjesëmarrjen tepër aktive në Luftën e Miletit, Presidenti i Kuvendit Popullor me rastin e 50 vjetorit, e çmon: "Për veprimtari patriotike" Klasi III f. 486-495.

KURT HYSEN HYSAJ - MYSELIM

Kurt Hyseni rrjedh nga një familje me tradita të mira patriotike të fisit të madh Hysaj të fshatit Myselim të zonës Postribë. Kurt Hyseni u lind në fshatin Myselim më 20 mars të vitit 1890 dhe vdiq në vitin 1953, në moshën 63 vjeçare.

Familja e Kurt Hysenit, si të gjitha familjet e fiseve e tjera të Postribës, ka në gjakun e saj ndjenja të forta nacionaliste për mbrojtjen e trojeve nga pushtuesit serbomalazezë dhe gjithmonë agresionit pushtues i është përgjigjur me armë për ruajtjen e identitetit kombëtar. Kurt Hyseni u njoh si figurë dhe si shtëpi pas viteve 1911-1912, kur Shkodra u rrethua nga pushtuesit serbomalazezë për shtatë muaj rresht. Në këtë periudhë, pra në vitin 1911, Kurt Hysenit iu vra në përpjekje me forcat armike në frontin e Myselimit, baba i tij Hysen Avdia si dhe vëllai i tij Avdi Hyseni.

Pas vrasjes së të atit, Kurt Hysenit i bie mbi shpatulla drejtimi i shtëpisë, për rimëkëmbjen e ekonomisë dhe për mbarëvajtjen e punëve në familje. Familja e tij përbëhej nga 17 frymë, pra futej në shtëpitë e mëdha në Myselim, dhe kishte rreth 150 dynym toke , mbi 130 krerë dhenë, 40 krerë dhi, 12 krerë lopë, dy pendë qe pune për punimin e tokës, një kalë shale, që mund të përdorej edhe për ngarkesa të ndryshme për nevojat e shtëpisë etj. Ai kishte një shtëpi dy katëshe, si dhe një odë tavani, siç quhej atëherë, e cila shërbente për pritjen e miqve, për kuvende etj. Shtëpia ishte e pajisur edhe me një çardak, si shumë familje të mëdha në Postribë.

Luftërat e vazhdueshme me serbo-malazezë bënë që Kurt Hyseni të njihej më shumë, ashtu si shumë burra të tjerë në Postribë. Kurt Hyseni ishte burrë i besës, i burrërisë, i bujarisë, i trimërisë. Ai ishte burrë fisnik, i matur, i ekuilibruar dhe i vendosur për t'i çuar deri në fund detyrat kombëtare që i ngarkoheshin nga komanda apo komandanti popullor Adem Haxhija. Duke qenë trim dhe besnik, Adem Haxhija merr afër vetes në të gjitha luftërat vëllain e tij Kasem Hyseni. Vrasja e babës dhe e vëllait të tyre, e shtuan edhe më shumë urrejtjen ndaj pushtuesve serbo-malazezë dhe gjithashtu e bënë më agresiv. Vrasja e dy meshkujve në një familje, bëri që të rritej edhe pjesëmarrja në luftë për mbrojtjen e lirisë, pavarësisë dhe integritetit tokësor. Në vitin 1924, në Suka të Moksetit, në përpjekje me forcat pushtuese plagoset edhe vëllai i Kurt Hysenit, Sait Hyseni, të cilin e përshkon plumbi në gjoks, sipas Gani Sait Hysenit, por duke qenë jetëgjatë shpëton nga vdekja. Në këtë vit Sait Hyseni zgjidhet kryeplak i fshatit Myselim dhe qëndron në këtë detyrë për 15 vjet rresht. Brenda kësaj periudhe, në vitin 1936, Sait Hyseni hap shkollën e parë shqipe.

Sipas Gani Sait Hysajt, në vitin 1911-1912, kur lufta zhvillohej trup më trup mes forcave pushtuese dhe atyre mbrojtëse, u vranë në një betejë 27 luftëtarë postribas, prej të cilëve 6 ishin nga Ura e Shtrejtë, 7 ishin nga Drishti, një prej të cilëve ishte Halil Isuf Dushaj dhe 14 të tjerët ishin nga Boksi e fshatrat e tjerë.

Kurt Hyseni me vëllezërit e tij do të kujtohet gjatë nga brezat e rinj, sepse ata bashkë me burrat e tjerë të Postribës shkruan historinë më të lavdishme, e cila u bë pjesë e historisë kombëtare.

LIC META - DAJCË (SUMË)

Lic Meta është një nga burrat më në zë në Postribë për nga pamja. Thuhej nga bashkëkohësit e tij se nuk ka parë syri burrë më të pashëm se ai. Lic Meta rrjedh nga paraardhësi i hershëm i tij, Dol Kuçi, i pari i fisit të tij i ardhur nga Kuçi i Malit të Zi, me origjinë shqiptare. Ai erdhi nga Kuçi i Malit të Zi bashkë me të vëllanë, Pyl Kuçi dhe u vendosën në fshatin Sumë, Dol Kuçi u vendos në lagjen Gurra- Dajcë dhe Pyl Kuçi në lagjen Bukmirë. Si rrjedhim pasardhësit e Dol Kuçit janë lagjja Gurra-Dajcë dhe pasardhës të Pyl Kuçit janë lagjja Bukmirë. Përveç Lic Metës në lagjen Gurra-Dajcë ishin në zë edhe Kasem Imeri dhe i biri i tij Ibrahim Kasemi, Ndoc Staka etj. Ndërsa në lagjen Bukmirë ishte burrë në zë Halil Zeneli e të tjerë.

Lic Meta ishte burrë në zë jo vetëm për pamje por edhe për trimëri, për besë, për bujari, për fisnikëri, për burrëri etj. Babai i tij Met Alija (Pali) si trim dhe shtëpi e fortë që ishte, grabiti një bijë nga Shala e Dukagjinit, e quajtur Sykë Malja të cilën e mbajti për grua. Lic Meta ishte nip Shale, djali i Sykë Males. Sykë Malja ishte gjyshja e gjyshes sime (shënimi është i im, R.S.).

Me vajzën e grabitur nga Shala e Dukagjinit, lindën një vajzë, të quajtur Hakë Metja (Hakë Sykja), të cilën kur u rrit, Meta e martoi në Blini të Urës së Shtrejtë, me Mehmet Alinë. Vajza e Metës, Haka lindi me Mehmet Alinë dy djem e shtatë vajza, (Sadri, Dan, Azna, Shkurte, Bullë, Gune, Sutë, Goskë dhe Halë Mehmeti). Shkurte Mehmeti ishte gjyshja ime.(R.S.) Mehmet Alia e martoi Shkurten në Ura Shtrejtë për Cen Elezin, burrë në zë në fshatin Ura e Shtrejtë. Gjyshja, Shkurte Mehmeti e martuar me Cen Elezin, lindën dy djem dhe tri vajza. Djemtë nuk jetuan por i vdiqën, ndërsa vajzat ishin Zade Ceni, Mine Ceni dhe nëna ime, Bedrije Ceni.(shënimi im R. S.).

Lic Meta pati dy djem Sadik Licin dhe Mehmet Licin.

Lic Meta në linjë gjenealogjike paraqitet si më poshtë: Lic - Met - Ali (Palë) - Prelë – Ali - Dol - Kuçi. Dol Kuçi ishte shqiptar nga Mali i Zi. Ky është kushëri me Ndoc Staken e Gurrave, i cili në linjë gjenealogjike paraqitet si më poshtë: Ndoc - Stakë - Dedë - Prelë - Ali - Dol - Kuçi. Gjithashtu është kushëri edhe me Gjeto Zyberin e Drishtit, i cili në linjë gjenealogjike paraqitet si më poshtë: Gjeto - Zyber - Mustafë - Elez (Kolë) - Prelë - Ali - Dol - Kuçi.

Duke mos patur të dhëna të tjera për Lic Metën, këtë burrë shumë të pashëm në Postribë, por edhe të pajisur me të gjitha virtytet e tjera njerëzore, i lë mesazh brezit të ri që ta kujtojë këtë burrë në zë në Postribë krahas burrave të tjerë.

MAN ALUSH GRUDA – DRAGOÇ

Man Alush Gruda u lind rreth viteve 1887-1888 dhe vdiq në vitin 1965. Ai lindi dhe vdiq në fshatin Dragoç. Gjatë jetës së tij ai kaloi regjimin e pushtimit turk, periudhën e Pavarësisë, Mbretërinë Shqiptare si dhe Regjimin Komunist.

Man Alush Gruda rrjedh nga një familje e fisit Grudaj me tradita të mira nacionaliste brez pas brezi. Origjina e hershme e fisit të tij është nga Mitrovica. Fisi i tij është zhvendosur nga Mitrovica për arsye gjaku dhe është vendosur fillimisht në Grudë-Fushë të zonë së Gruemirës, ku ka blerë trojet për të qëndruar aty. Por përsëri për arsye gjaku, fisi i tij është zhvendosur nga Grudë-Fusha në fshatin Dragoç të Postribës dhe ka ngulur në trojet e blera në afërsi të çeçojeve, troje të cilat i kanë pronë pasardhësit e tij.

Fisi i Man Alush Grudës ka pasur mbiemrin e hershëm të quajtur Ali-Hakaj, por mbiemrin Grudaj e morën kur u shpërngulën nga Grudë-Fusha, për të ruajtur emrin e vendit nga kanë ardhur. Mendohet të ketë ardhur fillimisht në Dragoç paraardhësi i tij Haxhi Alija me djem, vëllezër e nipër.

Man Alush Gruda ka pasur një temperament të qetë dhe karakter të fortë. Ai ka qenë njeri i vendosur për t'i çuar punët deri në fund. Ai ka qenë njeri me vullnet, trim, i besës, i matur, fisnik, mikpritës, serioz dhe një luftëtar i mirë dhe qitës i shkëlqyer me armë.

Man Alush Gruda ka qenë njeri i shoqërisë. Ai ka pasur shoqëri miqësore me Jemin Zyber çelaj, më Abdullah Sait Bushaj, me Shaban Haxhi Halilaj, më Ymer Muho Spahinë e të tjerë.

Ai ka qenë njeri punëtor dhe mjeshtër i mirë i kosës në kositje livadhesh, ka qenë nje grirës i mirë i duhanit në çark dhe pothuajse ka jetuar me këtë zanat në regjimin e Mbretërisë së bashku me Ymer Muho Spahinë, Dyl Sadri Mataj, etj. Ata grinin rreth 25 kilogram duhan për njeri në ditë, duke e grirë në formën më të mirë, siç quhej atëherë “Kadaif”.

Man Alush Gruda bashkë me Ymer Muho Spahinë e të tjerë kanë ushtruar shumë mirë zanatin e bërjes së vajit të ullirit me këmbë në magjet primitive. Ata oganizoheshin në shoqëri për bërjen e vajit të ullirit, duke vendosur tre deri në katër magje në lokale të caktuara dhe kështu në shoqëri e bënin vajin në sasi nga një deri në tre kuintal për familje.

Man Alush Gruda ka qenë një besimtar i mirë, i drejtë dhe i ndershëm në marrëdhënie me njerëzit. Ai nuk ka pasur komplekse fetare, pasi i ka dashur pa asnjë dallim si myslimanët ashtu edhe katolikët. Man Alushi ka lidhur kumbari dhe ka pirë gjakun me dukagjinas. Kështu ka pasur lidhje të ngushta dashurie të ndërsjelltë dhe kumbari me Ndue Mëhillin nga Gimajt e Shalës, me Kolë Avdinë nga Dukagjini e të tjerë.

Man Alush Gruda ka marrë pjesë në të gjitha betejat në mbrojtje të tërësisë tokësore dhe të integritetit, në mbrojtje të trojeve dhe të lirisë.

Megjithëse i ri në moshën rreth 23-24 vjeçare ai merr pjesë në Rrethimin e Shkodrës në vitin 1912-1913 në frontin e Myselimit, në Bardhanjel e Lodërtunë nën komandën e Adem Haxhisë. Ai merr pjesë me të gjithë postribasit, të cilët shquhen në frontin e Myselimit dhe atë të Bardhanjelit.

Man Alushi ka lënë dy kujtime në pjesëmarrjen në luftë. Njërin kujtim e tregon për luftën në Rrethimin e Shkodrës dhe tjetrin kur ka marrë pjesë në Luftën e Koplikut të vitit 1920. Po i riprodhojmë këto kujtime: “Kur ishim në Rrethimin e Shkodrës, në betejë e sipër vritet Lil Nuz Halilaj, vëllai i Dervish Nuz Halilajt të fshatit Dragoç. Komandanti Adem Haxhija na urdhëron që të vramin ta çonim pranë vend strehimit të familjes së tij në Shkodër, për ta varrosur. E marrim unë dhe Sahit Imer Halilaj për ta çuar pranë familjes. Në Brraka të Rusit pushojmë pak. Në këtë kohë arrin “Nishanxhi Taborr”, i cili vjen nga Taraboshi për të shkuar në frontin e luftës. Sahit Imeri desh të hynte bashkë me ushtarët e “Nishanxhi Taborrit për të shkuar në luftë por Komandanti nuk e la të mernte pjesë. Kur arritën në zall të Kirit, komandanti dha urdhër për formacion luftimi. Të gjithë ushtarët e “Nishanxhi Taborrit” u shpërndanë në formacion luftimi pa marrë parasyshë se ku u takonte të luftonin. Në këtë kohë artileria e armikut që ishte vendosur në fushë të Shtojit hap zjarr kundër “Nishanxhi Taborrit” Deri në këtë kohë ushtarët e “Nishanxhi Taborrit” nuk kishin hapur zjarr. Vazhdonin përpara në formacion luftimi por pa hapur zjarr deri sa arritën në “Kaçina”, në Kodrat e Bardhanjelit. Aty u dha urdhëri nga komandanti dhe të gjithë një zëri thirrën: “Salu-Ala-Resul-Allah-Muhamed!” dhe menjëherë gjëmuan pushkët dhe mbas tyre shtrin bajonetat dhe luftimi u bë aty e mbrapa bajonetë më bajonetë dhe trup më trup dhe mbrenda një kohe shumë të shkurtër ariten fitoren mbi serbo-malazeztë.”

Ngjarjen e dytë Man Alush Gruda e tregon kështu: “ Mbasi ramë në përpjekje me serbo malazeztë në Suka të Moksetit ne i thyem ata dhe i vumë përpara, duke i çuar drejt kufirit shtetëror. U dha një urdhër për armëpushim. Në këtë kohë vjen një ushtar malazez dhe kërkon duel për t’u rrëzuar me një luftëtar të Postribës. Faz Rustem Repaj i thotë malazezit se nuk do të shkoj për të kërkuar më të fortin në frontin tonë por po pranoj unë që të hy në duel me ty. Ranë dakord dhe dolën të dy në fushë për të provuar forcën. U lidhen me duar për brezit të secilit dhe ushtari malazez i tha Fazit që t’i jepte i pari për ta rrëzuar. Fazi nuk pranoi duke i thënë se malazezi kishte kërkuar i pari duel, ndaj i takonte atij t’i jepte i pari. Gjatë kësaj kohe Fazi vazhdonte ta shtërngonte në bel kundërshtarin deri në atë shkallë sa malazezi nuk qe në gjendje për t’i dhënë. Në këtë kohë Fazi e shtërngon edhe më tepër deri sa me një dhënie krejt të lehtë e rrëzon kundërshtarin përdhe. Adem Haxhija menjëherë qet me pistolë përpjetë në shënjë fitoreje. Ushtari malazez shkoi i turpëruar tek ushtarët e tij.”

Man Alush Gruda merr pjesë në kryengritjen kundër ushtrisë austro-hungareze bashkë me kryengritësit e Postribës nën komandën e Adem Haxhisë dhe të parisë së Postribës, në vitin 1916 dhe përpjekja u bë në afërsi të Urës së Mesit, ku ushtria austrohungareze iku me turp drejt Shkodrës. Adem Haxhija e ka mbajtur gjithmonë afër Man Alushin, Sadri Alinë, Etëhem Beqir Bracajn, Brahim Zenel Plangajn, Ahmet Cuf Celufajn, çel Shaban Repajn, Kasem Isen Hysajn e të tjerë. Ai i mbante këta burra si besnikë dhe si trima.

Man Alushi merr pjesë në Luftën e Koplikut të vitit 1920 bashkë me forca të Postribës në Kodra të Moksetit, betejë në të cilën e nxjerrin armikun jashtë kufinjve shtetërorë.

Man Alush Gruda merr pjesë edhe në qëndresën që i bën Postriba pushtimit fashist më 7 prill 1939 në Kodra të Tepes, në Bahçallek dhe në Kodra të Bërdicës.

Man Alush Gruda do të kujtohet nga brezi i ri si një luftëtar dhe nacionalit i vendosur për të mbrojtur trojet e të parëve, për liri dhe pavarësi të atdheut. Ai do të kujtohet si një burrë me karakter të fortë, i matur, i qetë në temperament, fisnik, i besës, bujar dhe i dashur me njerëzit.

MAN SADRIJA (DRIJAJ) - BOJAJ SUMË

Man Sadrija ka lindur në lagjen Bojaj të fshatit Sumë në vitin 1877 dhe ka vdekur më 15 shtator të vitit 1974. Man Sadrija rrjedh nga një familje nacionaliste e fisit të Bojajve, një nga fiset më të mira të të gjithë rrethit Shkodër.

Man Sadrija ishte një burrë i njohur jo vetëm në lagjen Bojaj e në të gjithë Sumën, por edhe në të gjithë bajrakun e Sumës. Ai ishte një burrë me karakter të fortë, i besës, mikpritës me një bujari të theksuar të një malësori verior, burrë i matur, i vlerësuar nga burrat e zonës, zemërbardhë, besimtar i mirë.

Për vlerat që kishte Man Sadrija, populli i Sumës e ka zgjedhur kryeplak për të gjithë Sumën në kohën e regjimit të Zogut dhe ka qëndruar për një periudhë të gjatë në këtë detyrë, deri sa e mori pas tij Elez Imeri i Dajcës.

Në periudhën kur Luma sulmoi për plaçkë zonën e Postribës, shkoi për të plaçkitur edhe Bojajt e Sumës, por Man Sadrija veprroi me shumë zgjuarsuri duke e ndaluar këtë plaçkitje. Komandanti i Lumës që kishte shkuar për të plaçkitur ishte Brahim Gjoçi. Man Sadrija i vë në prehër për ta bërë kumbar, djalin e vëllait, të quajtur Imer Zeqiri, i cili ishte rreth 8-9 vjeç. Brahim Gjoçi nuk pati tjetër rrugë për t'iu shmangur dhe u detyrua që t'i priste flokët djalit dhe të pranonte të bëhej kumbar i shtëpisë së Man Sadrisë. Man Sadrija organizoi një pritje të madhe për kumbarin që desh të grabiste gjithë Bojajt dhe në këtë mënyrë shpëtoi gjithë zonën e Sumës nga grabitjet.

Man Sadrija ishte një burrë fisnik, i ekuilibruar por edhe trim, që dinte të falte por dinte edhe të të vriste po t'i bije në qafë padrejtësisht. Familja e Man Sadrisë ishte një nga familjet më të mira jo vetëm në Bojaj, por edhe në të gjithë Sumën. Ai kishte një grua shumë sejnike, të quajtur Mollë Bajrami, bijë e Egçit të Bregut, derë e fisme dhe me tradita burrërie e trimërie. Ajo ishte mikpritëse, e respektueshme, e dashur, që dinte ta bënte për vete jo vetëm mikun por edhe armikun. Ajo nuk ishte një grua e madhe me trup, por ishte shumë e virtytshme. Buka që gatonte Mollë Bajrami, e shoqja e Man Sadrisë vinte e ëmbël, sikur të hahej edhe thatë pa asgjë. Buka që qitet me zemër është gjithmonë e ëmbël.

Man Sadrija ka marrë pjesë në pajtime gjaqesh në bajrakët e Postribës dhe së bashku me burrat e urtë të Postribës si Zog Mustafën, Osman Haxhinë, Met Rexhën, e të tjerë ka pleqëruar edhe me burrat e Dukagjinit.

Man Sadrija ka qenë bazë e Luftës Nacional-çlirimtare, ndër të parat familje në Sumë, gjithashtu edhe shtëpia e Avdi Culi ishte bazë e Luftës Nacional-çlirimtare pas Man Sadrisë. Man Sadrija ishte kushri me Avdi Culin dhe në linjë gjenealogjike përcaktohet si më poshtë:

Avdi - Cul - Zenel - Isen - Brahim - Ali - Boj - Gjoni

Adem - Man - Sadri - Murat - Brahim - Ali - Boj - Gjoni

Siç shihet më lart, Avdi Cul lidhe Adem Man Sadrija bashkohen tek Brahim - Ali - Boj - Gjoni .

Në linjë gjenealogjike ai lidhet me Zog Mustafën, Dyl Brahimin etj. Ai është i ardhur nga Boj Gjoni, vëllai i dytë. Vëllezërit e tjerë ishin Koc (ose Kol sipas Imer Selimit) Gjoni, vëllai i madh, Per Gjoni, vëllai i tretë dhe Dedë Gjoni, vëllai i katërt. Këta formuan katër lagje të Sumës si më poshtë: Koc Gjoni lagjja Shakotë dhe Bukmirë, Boj Gjoni lagjja Bojaj, Per Gjoni lagjja Pergjon dhe Dedë Gjoni lagjja Delaj.

Man Sadrija do të kujtohet nga brezat pasardhës, jo vetëm në Bojaj por edhe në të gjithë bajrakun e Sumës si një burrë që peshonte shumë, si një burrë fisnik me të gjitha virtytet njerëzore të një burri verior.

Shënim: Ky material është marrë nga Bejto Zenel Bregaj nga Bojajt, si dhe nga djali i Man Sadrisë, Sadri Man Drijaj, me të cilin ka jetuar deri sa ka vdekur në vitin 1974, në moshën 97 vjeç.

METUSH ALI CEKAJ - KULLAJ

Metush Ali Cekaj rrjedh nga fisi Ramaliaj, i ardhur nga Kodër Boksi i fshatit Boks të Postribës. Ky ishte fisi i vogël në numër frymësh, por i përmendur në vlera njerëzore dhe tradita të mira. Fisi përbëhet sot nga 9

familje, të cilat janë: Hasim Metushi vet i treti vëlla, Xhevdet Selimi vet i treti vëlla, Brahim Rifati vet i dyti vëlla dhe Sadik Imeri i Imer Alisë. Fisi Ramaliaj, duke qenë i vogël, iu mbështet fisit Cekaj të fshatit Kullaj, për të cilin thuhet se e ka origjinën nga Hoti i Malësisë së Madhe. Fisi Ramaliaj pas mbështetjes në fisin Cekaj mori mbiemrin e ri Cekaj.

Metush Ali Cekaj u lind në fshatin Kullaj të Boksit në shkurt të vitit 1910 dhe vdiq në Kullaj më 9 shtator të vitit 1946, i pushkatuar nga regjimi i egër komunist për pjesëmarrje në Kryengritjen Antikomuniste të Postribës, më 9 shtator 1946. Në fisin Ramaliaj u pushkatuan dy burra. Përveç Metush Alisë u pushkatua pa gjyq edhe Brahim Selimi, gjyshi i Brahim Rifatit. Në Fushën e Shtojit më 9 shtator u pushkatuan pa gjyq 10 burra nga fshati Kullaj. Nga ky fis u dënua me heqje lirie Selim Alia, i cili bëri disa kohë burg. Gjithë fisi u persekutua nga regjimi i egër komunist për pjesëmarrje në kryengritje.

Metush Alia ishte burrë i besës, trim, me karakter, burrë i ndershëm, bujar, i dashur me njerëzit dhe me pjesëtarët e familjes, me autoritet dhe mjaft fisnik. Ai nuk është marrë me politikë, por ka pasur një përvojë të pasur jete, duke kaluar situata dhe ngjarje të ndryshme gjatë kohës. Kjo përvojë e ndihmoi shumë në njohjen e njerëzve, në dallimin e tyre duke i grupuar në të mirë dhe në të këqinj.

Gjatë jetës Metush Ali Cekaj ka pasur zanatin e bujku dhe të blegtorit. Ai e donte bujqësinë, i donte bimët dhe u shërbente atyre me shumë devocion, sepse në fund të fundit, siç thoshte ai, ata i mbanin shpirtin gjallë. Në mënyrë të veçantë Metush Alia është marrë me blegtori pothuajse gjatë gjithë jetës së tij. Ai e donte blegtorinë e në mënyrë të veçantë dhentë. U kryente çdo shërbim, që nga detyra e blegtorit, duke u kujdesur në kullotë për t'i ushqyer sa më mirë e deri në shërbimet e tjera, si mjelje, grazhdim në vathë, mirërritjen e qingjave etj.

Në periudhën e luftërave dhe të pushtimeve të vendit tonë Metush Ali Cekaj nuk ka marrë pjesë pasi ishte i vogël në atë kohë, por meshkujt e familjes së tij dhe ata të fisit që ishin bërë për të marrë pushkën në dorë, morën pjesë në çdo betejë që u zhvillua në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe të ruajtjes së integritetit tokësor.

Si të gjithë postribasit e tjerë, Metush Alia do të rritej një ditë dhe do t'i takonte të merrte pjesë edhe ai në mbrojtjen e vendit nga regjimi komunist. Bashkë me burrat e tjerë të Postribës më 9 shtator të vitit 1946, Metush Ali Cekaj inkuadrohet nën drejtimin e krerëve të Postribës për të kundërshtuar regjimin komunist në Shqipëri. Ai merr pjesë në kryengritje bashkë me Brahim Selimin dhe me deshtimin e saj Metush Alia dhe Brahim Selimi i të njëjtit fis pushkatohen pa gjyq bashkë me burrat e tjerë.

Metush Alisë iu ndërpre jeta në moshën më të bukur, në moshën 36 vjeçare. Regjimi komunist duke pushkatuar njerëz të pafajshëm, nacionalistë të ndershëm dhe besimtarë të devotshëm, mendonin se do të përligjinin regjimin e tyre totalitar, por u gabuan rëndë, sepse ato ideale të burrave të Postribës do të realizoheshin një ditë.

Metush Ali Cekaj dhe Brahim Selim Cekaj do të kujtohen nga brezat e rinj. Metush Alia do të kujtohet si një burrë që iu ndërpre jeta në moshën më të bukur, nga regjimi komunist, por gjaku i tij nuk shkoi kot. Gjaku i burrave të Postribës, pra edhe i Brahim Selimit e Metush Alisë do të bëhej himn që do t'i këndohej jetës së re, jetës demokratike, jetës së lirë, të ardhmes dhe progresit njerëzor.

METUSH SELMAN SHKRELI - BOKS

Metush Selman Shkreli rrjedh nga një familje patriotike e fisit Shkreli të Boksit të Postribës. I pari i këtij fisit në Boks është Gjon Nik Syku nga Shkreli, ndaj dhe mbajtën si mbiemër fisi emrin e vendit nga erdhën "Shkreli". Gjon Nik Syku, konvertohet në mysliman me emrin Hysen (Gjoni), pra Hysen apo Hys Ali Syku.

I pari i fisit të Shkrelajve i vendosur në Boks të Postribës është Smajl Hysa (Hyseni).

Metush Selman Shkreli ka lindur në fshatin Boks në vitin 1879 dhe ka vdekur në lagjen Draçin të qytetit të Shkodrës në vitin 1952, në moshën 73 vjeçare.

Metush Selman Shkreli që në moshë të re bie në sy si një burrë i zoti dhe për këtë në moshën 25-30 vjeçare zgjidhet kryeplak i fshatit Boks dhe për disa kohë edhe si kryeplak i Postribës, me vulë të tij, kjo sipas nipit të tij, Imer Isuf Shkreli.

Metush Selman Shkreli merr pjesë, sipas nipit të tij, në besëlidhjen e Postribës me Dukagjin në Prekal në vitin 1919, më 25 shtator, por sipas dokumenteve historike nuk rezulton emri i tij. Por unë them (R. S) se ai mund të ketë marrë pjesë, pavarësisht firmosjes së dokumentit, pasi ky dokument është firmosur

nga paria e bajrakut të Boksit si më poshtë: Isuf Sul Velija, Tahir Haxhija, Nuz Halili, Idriz Zhiri (?), Adem Haxhija dhe bajraktari Zenel Alija.

Metush Selmani ka marrë pjesë në të gjitha luftërat që janë bërë nga Postriba kundër pushtimeve të huaja, bashkë me luftëtarët e tjerë të Postribës dhe nën udhëheqjen e komandantit popullor Adem Haxhi Spahija.

Ai ka marrë pjesë në Rrethimin e Shkodrës në vitin 1912-1913, në frontin e Myselimit dhe atë të Bardhanjelit, dy frontet më të rrepta të një lufte të përgjakshme.

Metush Selmani merr pjesë në Kyengritjen e Postribës kundër Austro-Hungarisë në vitin 1916, ku beteja kryesore u zhvillua në afërsi të Urës së Mesit. Kryengritja fitoi dhe ushtria austro-hungareze pasi zbrazi disa armë e mitraloza kundër kryengritësve, u largua me turp në drejtim të Shkodrës.

Metush Selman Shkreli merr pjesë në Luftën e Koplikut nën udhëheqjen e komandantit popullor, Adem Haxhija, bashkë me trimat e tjerë të Postribës, në të cilën luftë vriten disa luftëtarë postribas dhe plagosen disa të tjerë.

Metush Selmani nuk merr pjesë në rezistencën që i bën Postriba pushtimit fashist, pasi në këtë kohë ai ishte me banim në lagjen Draçin të Shkodrës.

Duke qenë një burrë i njohur në Postribë, si dhe duke qenë një burrë i njohur në lagjen Draçin, Sylço Beg Bushati e mbante gjithmonë Metush Selman Shkrelin afër vetes si një burrë me autoritet dhe i fisëm.

Në votimet e vitit 1924, në shtetin e parë demokratik në Shqipëri, Metush Selmani rreshtohet me opozitën, kundër pozitës që ishte në atë kohë qeveria e Zogut. Ai u rreshtua me opozitën pasi kishte mik Xhemal Beg Bushatin, i cili ishte me Fan Nolin.

Në vitin 1926, më 24 tetor, Dukagjini mësyni Postribën, të organizuar edhe nga Mali i Zi për të përmbysur regjimin e Zogut dhe për të sjellë në pushtet Fan Nolin. Përpjekja e forcave kundërshtarë u realizua në Mes, ku forcat e Dukagjinit sulmuan Komunën e Mesit për ta marrë. Metush Selman Shkreli, megjithëse ishte në opozitë, merr pjesë me Muharrem Kazazin që ishte kryetar komune, dhe me shumë postribas të tjerë, kjo sipas Imer Isuf Shkrelit, të cilët luftuan përkrah me Muharrem Kazazin, në mbrojtje të regjimit Zogist. Në këtë luftë plagoset Muharrem Kazazi. Metush Selmani, në këtë kohë ishte planifikuar që të internohej në Elbasan si kundërshtar i Zogut, por Ahmet Zogu nuk e internoi Metush Selmanin sepse ndërhyri Muharrem Kazazi për ta shpëtuar nga internimi pasi ky kishte mbajtur qëndrim pro-Zogist në këtë luftë që u zhvillua në Komunën e Mesit.

Metush Selman Shkreli ka qenë një burrë me temperament të qetë, paqësor, i duruar, i ekuilibruar, i besës, mikpritës dhe i dashur me njerëzit.

Ai ka pasur një karakter të fortë burri dhe i vendosur për t'i çuar punët deri në fund.

Në fshatin Boks Metush Selman Shkreli ka qenë shtëpi shumë e pasur. Ai ka poseduar shumë toka dhe gjithashtu ka qenë pronar i vadës së Boksit që është marrë me shpenzime të gjyshit të tij që kur Metushi ishte fëmijë. Vada është marrë në Rosek, në burimin e tij me shumë shpenzime. Më vonë në vadën e Boksit janë bërë pronarë edhe shumë familje të tjera, pasi ato blinin tokë nga familja e Metush Selmanit bashkë me orët e vaditjes që i takonte tokës që shitej.

Në mes fshatrave Boks dhe Dragoç ka pasur një mosmarrëveshje për tokat që ishin mera. Boksi nuk donte të lejonte Dragoçin që të dilnin në mal, në tokat mera pasi, siç thonin ata, i përkisnin fshatit Boks. Po ashtu edhe Dragoçi ngulte këmbë se as Boksi nuk do të lejohej të dilte në tokat mera që ishin në fushën e Shtojit, pasi këto toka i takonin fshatit Dragoç. Kjo mosmarrëveshje vazhdoi me pleqni por nuk u zgjidh. Më vonë kaloi kjo çështje edhe me gjyq në Shkodër e pastaj në Tiranë por përsëri nuk u zgjidh Protagonistë kryesorë për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje kanë qenë Metush Selman Shkreli për fshatin Boks dhe Emin Zyberi për fshatin Dragoç dhe u ra dakord që meritë e malit dhe të fushës t'i kishin të përbashkëta dy fshatrat Boks dhe Dragoç.

Metush Selman Shkreli do të kujtohet nga brezat pasardhës si një burrë i urtë, i besës, si një burrë me karakter të fortë, i matur, bujar dhe një nacionalist i devotshëm. (Të gjitha këto të dhëna janë marrë nga Imer Isuf Shkreli, me përjashtim të materialit historik, të cilin e kam kombinuar me atë gojor, shënimi im R.S.).

MOLLA RAMO MUSTAFË BUSHAJ - KULLAJ

Ramo Mustafë Bushaj, i quajtur Molla Ramo Mustafa u lind në fshatin Kullaj-Boks të Postribës në vitin 1847 dhe vdiq në Kullaj-Boks të Postribës në vitin 1934.

Ramo Mustafë Bushaj rrjedh nga një familje me tradita të mira nacionaliste, të fisit Bushaj të fshatit Kullaj- Boks të Postribës.

Ramo Mustafa duke qenë një burrë i drejtë, besimtar dhe i zgjuar, i besohet detyra e kryeplakut të fshatit Kullaj-Boks për periudhën 1922-1933.

Ai ka marrë pjesë në shumë pleqni për zgjidhjen e problemeve të fshatit dhe Postribës.

Molla Ramo Mustafa ka qenë një besimtar i devotshëm dhe ka praktikuar besimin islam duke falur pesë kohët e namazit gjatë ditës, duke agjëruar Ramazanin dhe duke zbatuar shtyllat e tjera të besimit Islam. Ai nuk ka kryer ndonjë shkollë për besim dhe nuk ka marrë gradën e Mollahit, por megjithatë i gjithë fshati dhe Postriba e kanë thirrur “Molla” në shenjë respekti për një besimtar të devotshëm në besimin Islam. Ai ka lëshuar mjekrën dhe ka mbajtur çallme duke zbatuar një synet të profetit Muhamed. Ramo Mustafa ka organizuar pjesëmarrjen e luftëtarëve vullnetarë të fshatit Kullaj- Boks në “Rrethimin e Shkodrës” në vitin 1912-1913.

Në familjen e Ramo Mustafës ka marrë pjesë në Rrethimin e Shkodrës të vitit 1912-1913, vëllai i tij, i quajtur Zeqo Mustafa, i cili në përpjekje me forcat serbo-malazeze në frontin e Myselimit dhe në atë të Bardhanjelit ka rënë dëshmor i luftës për mbrojtjen e pavarësisë kombëtare dhe të sovranitetit tokësor.

Më 2 dhjetor 1922 Ahmet Zogu emërohet kryeministër duke mbajtur edhe postin e ministrit të punëve të brendshme. Gjatë kësaj periudhe, qeveria ndjek kundërshtarët, pra veprimtarët e partisë opozitare. Në këtë kuadër, në Postribë arrestohen nga qeveria Rac Bajrami nga Dragoçi, Ramo Mustafa (Bushaj) nga fshati Kullaj-Boks dhe Ramo Salihi (Hasaj) nga fshati Dragoç. Këta internohen në Vlorë.

Me ndërhyrjen e gjeneralit dhe kryeadjutantit Zef Serreqi, tek Zogu, i cili kishte miqësi të fortë me Rac Bajramin, Ahmet Zogu i liron tre burrat e Postribës dhe do t'i shpërblejë me napolona ari për periudhën e dënimit, por këta nuk pranojnë duke e lënë këtë sasi napolonash për nevoja të spitaleve.

Molla Ramo Mustafa do të kujtohet me respekt e mirënjohje nga brezat pasardhës, si një besimtar i mirë dhe nacionalist i devotshëm brez pas brezi, në mbrojtje të trojeve nga pushtuesit e huaj.

MURAT IMER SHABAJ - BOKS

Murat Imer Shabaj është një nga burrat më në zë i fisit Shabaj. Ai u lind në fshatin Boks, lagjen Kodër Boks, ose siç quhet ndryshe Kodra e Lleshit. Ai u lind rreth viteve 1854 dhe vdiq rreth vitit 1925.

Murat Imeri u rrit dhe u edukua nga një familje e fisme e derës së fisit Shabaj, me tradita të shquara patriotike brez pas brezi.

Sipas Hashim Koplikut, banorët më të vjetër të fshatit Boks thuhet se janë Ali-Kukajt e Bajrajt, Ahmetajt, Hasanajt e Bajrajt, atlosh i cilëve është njëfarë Gjoke, të parët e të cilët thuhet se janë të ardhur prej Mirdite, shumë kohë para se të vinin turqit në Shqipëri. Gjoka pati tre djem: Lleshin, Markun dhe Pjetrin, të cilët pas vdekjes së t'atit u ndanë. Lleshi zuri vend në Kodër-Boks, vend i cili edhe sot mban emrin e tij “Kodra e Lleshit”. (Hashim Kopliku, Cirka, 1937, f. 62).

Janë pikërisht Ali-Kukajt, fisi i Shabajve, të cilët bashkë me Plangaj, etj. që kanë qenë banorët e parë të këtij fshati.

Murat Imeri pati tre djem: çelën, Ademin e Bajramin. çelë Murati ishte djali i madh i Muratit. Ai ishte pothuajse moshatar me Adem Haxhi Spahinë, të cilët ishin djem tezesh dhe shkonin shumë mirë me njëri-tjetrin. Të dy ishin nacionalistë të devotshëm dhe të vendosur për të siguruar mbrojtjen e trojeve nga pushtuesit serbo-malazezë.

Murat Imeri gjithë jetën e tij ia kushtoi mbrotjes së integritetit tokësor, mbrojtjes së nderit dhe të fesë.

Murat Imeri ishte burrë i besës, i trimërisë, i burrërisë, i mikpritjes. Ai ishte fisnik në shpirt, ruante traditat e të parëve, duke i pasuruar ato me cilësi gjithnjë më të mira. Ai ka marrë pjesë në të gjitha luftërat që janë zhvilluar në mbrojtje të trojeve shqiptare dhe bashkë me parinë e vendit, ai u ka prirë luftëtarëve të Postribës në çdo front lufte pa kursyer as gjakun, po ta kërkonte nevoja. Ai ka marrë pjesë në “Rrethimin e Shkodrës, megjithëse i madh në moshë dhe bashkë me trimat e tjerë të Postribës luftoi me heroizëm në Fusha e Myselimit, në Bardhanjel e Lodërtunë, ku lufta u zhvillua jo vetëm me petica por edhe trup më trup, me bajoneta, si një nga luftërat më të përgjakshme të Shqipërisë.

Murat Imeri merr pjesë në kryengritjen e Postribës kundër sundimit Austro- Hungarez, në vitin 1916. Kjo luftë u organizua nga krerët e Postribës, bashkë me komandantin popullor, Adem Haxhija. Në këtë periudhë Komanda Austro-Hungareze, duke e ndier rrezikun e kësaj kryengritje dërgoi një detashment ushtarak me dy topa dhe gjashtë mitroloza në Drisht, ndërsa në Dragoç dërgoi kapitenin Gjon Fusha me një njësi ushtarake. Ai, me të ardhur në Dragoç, nis terrorin duke varur për krahësh në manin e varrezave në qendër të fshatit tre burra: Ymer Beqir Shabaj, nipin e Murat Imerit, Nuz Halil Halilaj dhe Baz Haxhi çelaj nga fshati Dragoç.

Megjithatë, komanda ushtarake Austro-Hungareze nuk arriti të shtypte kryengritjen. Ky detashment ushtarak pasi zbrazti disa topa e mitroloza, me të mësuar se po rrethohej prej kryengritësve postribas, u kthye me ngutësi në Shkodër.

Nga burra të vjetër ka dëshmi se në vitin 1916 Bajram Curri është takuar me Adem Haxhinë e Postribës, në shtëpinë e Murat Imerit në Rrask të bajrakut të Boksit dhe kanë lidhur një akt-bese që "Shqipëria të sundojë veten, e të mos lënë këmbë armiku që të pushtojë vatanin".

Të dhënat historike përputhen me ato të treguara nga dëshmitarë të asaj kohe dhe me të vërtetë është nënshkruar një besëlidhje e tillë në shtëpinë e Murat Imerit, në Rrask në mes Adem Haxhisë dhe Bajram Currit dhe këtë e dëshmojnë shumë burra bashkëkohës të Adem Haxhisë dhe Bajram Currit.

Murat Imeri ka qenë njeri shumë i dashur në shoqëri e miqësi si edhe në familje ka qenë i sjellshëm. Ai ka qenë bujk dhe e ka dashur shumë blegtorinë.

Murat Imeri ka pasur shumë miqësi me familjen e Dan Hasanit të Shkodrës, me familjen e Maliq Beg Bushatit, etj. Ai gjithashtu nuk ka bërë dallim fetar mes njerëzve, pra nuk ka pasur komplekse fetare. Ai ka pasur kumbari me familjen e Vuksan Vatës së Shoshit, një nga familjet e njohura të Shoshit.

Murat Imeri ka qenë shumë besimtar dhe si i tillë ka qenë i drejtë, ndaj dhe ka marrë pjesë në pleqni dhe në gjykimin e çështjeve e të konflikteve mes fiseve e më gjerë.

Murat Imeri do të mbetet në kujtesën e brezave për shumë vite si një burrë trim, i dashur, i besës dhe bujar e fisnik.

MUSA JUKA - SHKODËR

Musa Juka është bir i Shkodrës, por me origjinë nga Postriba, nga fshati Rrash i bajrakut të Boksit. Paraardhësit e këtij fisi tregojnë se të parët e tyre janë me origjinë nga Krasniqja, të shpërngulur prej andej për çështje gjaku, dhe bashkë me familjarët e Bekteshëve kanë ardhur në Shalë të Dukagjinit, pastaj nga Shala janë ulur në Rrash të Postribës. Me kohë, një nga vëllezërit e tyre ndahet dhe shkon e zë vend në Trush të rrethit të Shkodrës, një pjesë zë vend në Shkodër në lagjen Parrucë, ndërsa Jukajt e tjerë mbeten sot e kësaj dite në vendin e tyre në Rrash të Postribës.

Familja e Jukejve doli në skenë nga çereku i fundit i shekullit XVIII, në periudhën e Karamahmut Pashës. Prej Jukejsh përmendet njëfarë Tahirag Jukaj, i mbiquajtur edhe Tahiraga i Vogël...

Musa Juka ishte nipi i Haxhi Ibrahim Jukës dhe i biri i Zyber Jukës. Filloi të dalë në skenë që në vitin 1914, më pas si pjesëtar i grupit të "Seda i Miletit" (Gazetë turqishte që nisi të botohej këtu nën administrimin e vetë grupit xhonturkofil - H.B).

Sipas Hamdi Bushatit, Musa Juka u zgjodh kryetar bashkie në vitin 1916. Para se të zgjidhej kryetar bashkie njihej tepër pak nga masat popullore të Shkodrës...Me ardhjen e austriakëve në Shkodër, Musa Juka u pajtua me politikën e tyre... Musa Juka ishte kërkues i rreptë, por edhe hakmarrës ndaj kundërshtarëve politikë. Populli në përgjithësi nuk e simpatizonte, aq më tepër elementi katolik nuk e honeste...Ishte guximtar e me iniciativë. U dallua në ndihmë të prapavijës në Luftën e Koplikut.Musa Juka vazhdoi kryetar i Bashkisë së Shkodrës deri në qershor të vitit 1924. Ai vdiq në emigracion, jashtë atdheut.("Shkodra dhe motet" f. 142.).

Musa Juka ishte kryetar Bashkie nga viti 1916-1924 dhe gëzonte besimin dhe përkrahjen e austriakëve e të francezëve që qeverisnin në Shkodër në ato vite. Ai ishte njeri i detyrës, energjik, nxiste të renë në qeverisje...

Në "Hylli i Dritës" të vitit 1921, në lajmin e Këshillit të Naltë (Shkodër), në mes të tjerave thuhet: Kryetari i Perlimtares, Z. Musa Juka, u përkujdes me mbledhë këshillin municipal edhe të Ndershmit Deputet, që u gjindshin në Shkodër, si përfaqësuesit e vërtetë e të gjithë popullit të Prefekturës së Shkodrës... (Hylli i Dritës, viti 1921, f. 238 - 239)

Me rastin e Luftës së Koplikut u tregua mjaft aktiv, veçanërisht përsa i përkiste furnizimeve të ushtrisë vullnetare dhe nxitjen e popullit për furnizimin e frontit. Porsa u nis ushtria në luftë, Musa Juka formon nën kryesi të vet një komision me emër: “Komisioni përkujdestar i ushtrive vullnetare”, i cili ka për qëllim kujdesin për çka i përket veprimeve ushtarake, duke mbledhur ndihma prej popullit dhe duke gatuar me këto ndihma sende ushqimore për ushtri.

Me ardhjen e Zogut në fuqi, Musa Juka qe bërë krahu i djathtë i tij. Për besnikëri ndaj Zogut ai arriti të bëhej Ministër i Punëve të Brendshme.

Me pushtimin e Shqipërisë më 1939, Musa Juka doli në emigracion dhe vdiq në Aleksandri të Egjiptit.

MUSTAF BRAHIMI (SPAHIJA) - BOKS

Mustaf Brahimi u lind rreth viteve 1780-1790 nga një familje besimtare e patriotike e fisit Spahijaj të fshatit Boks të Postribës. Ai gjithë jetën e tij luftoi për mbrojtjen e trojeve nga pushtuesit serbo-malazezë. Ai ishte burrë trim, i vendosur për të kryer çdo punë që merrte përsipër, i dashur, i rreptë, jo i ngutshëm por shumë gjaknxehtë kur cenohej padrejtësisht, burrë i drejtë dhe i ndershëm. Ai merrte pjesë në të gjitha veprimtaritë që organizoheshin nga bajraktarët, nga paria e vendit, nga drejtuesit dhe organizuesit e djalërisë për mbrojtjen e trojeve.

Postriba i ka koordinuar gjithmonë veprimtaritë patriotike bashkë me të gjithë bajrakët e Shkodrës, Malësisë së Madhe, Dukagjinit, Shllakut, Dushmanit etj. Postribasit, edhe në mbrojtjen e trojeve kundër pushtuesve serbë e malazezë kanë luftuar krah për krah me katolikët e Shkodrës dhe të malësive pa asnjëfarë dallimi feje, por si vëllezër të një gjaku.

Në një betejë të viteve 1835, në mbrojtje të trojeve, të sovranitetit dhe të ruajtjes së integritetit tokësor nga pushtuesit serbë e malazezë ndodh një ngjarje, të cilën e tregonin pleqtë vazhdimisht, dhe kjo është kështu:

Pas disa përpjekjeve mes dy fronteve, mbrojtësve të vendit, postribasve dhe pushtuesve serbo-malazezë, u vendos një armëpushim i shkurtër. Gjatë kësaj kohe del një shkja (ushtarak malazez) në fushë të bejlegut (të duelit) dhe hap bejleg duke luajtur shpatën, si ftesë për dyluftim. Kjo gjë për dy-tre ditë rresht duke ftuar për bejleg nga pala kundërshtarë. Ditën e tretë del Mustaf Brahimi i fisit Spahijaj të bajrakut të Boksit. Mustaf Brahimi ishte një burrë mesatar nga trupi, me një shëndet mesatar, me fytyrë të zeshkët, serioz dhe shumë zemrak. Luftëtarët postribas, duke parë shkjaun një burrë trup madh dhe sa dukej i fuqishëm ndërsa Mustaf Brahimin që nuk i përshtatej trupit të tij, i thonë:

- Ku shkon baca Mustafë!?

- Në pastë ba Zoti emër, o me i hjekë kryet shkjaun, o me ma hjek ai. Nuk e la ma shkjaun me më hjekë bejleg në tokë teme!

Hipur mbi kalë, me hutën e gjatë dhe me shpatë në dorë del në fushë të bejlegut. Kur i afrohet shkjaun, ai i thotë Mustafës:

- Qit Postribë!

- Jo nuk i takon Postribës me qitë, sepse nuk të kam kërkuar unë bejleg por ti, prandaj qit ti i pari!

Shkjaun ndez hutën dhe shtie mbi Mustaf Brahimin për ta vlarë. Në këtë kohë Mustaf Brahimi, i regjur me bejlegje e me beteja kundër shkjeve serbo-malazezë, rrëzohet nga kali gjoja se e kapi plumbi i shkaut dhe ndërkohë ndez hutën e tij për të shtier mbi shkjaun që i kishte kërkuar bejleg. Kur rrëzohet Mustaf Brahimi, shkjaun afrohet për t'i këputur qafën me shpatë e për t'i marrë kokën, siç e kishte rregulli i bejlegut. Në këtë kohë, kur shkjaun ngre shpatën për t'i prerë qafën, Mustaf Brahimi shtie me hutë mbi shkjaun dhe e vret. Shkjaun rrëzohet nga kali dhe Mustaf Brahimi shkon e i pret qafën atij dhe i merr kokën dhe ua dorëzon parisë dhe luftëtarëve postribas.

Me këtë akt trimërie, Mustaf Brahimi la zërin dhe emrin e tij për shekujt që do të vinin pas, deri në ditët e sotme. Fisit të tij iu ofrua vendi i bajraktarit por nuk e pranoi një gjë të tillë duke ia lënë nderin Postribës dhe fisit të bajraktarit. Ai mbajti përsëri vendin e tij si Vojvodë ose fis mbas bajraktarit. Në nderim të trimërisë së tij dhe në pamjen që kishte ngjyrë të remtë, populli e thërriste “Harapi i Boksit”.

Emri i Mustaf Brahimit nuk do të vdesë kurrë sepse nuk vdes vepra e trimërisë që ai bëri. Postriba e ka shkruar me gjak historinë e saj sepse gjatë shekujve ajo i ka mbrojtur me gjak trojet e vendit të ilirëve, trojet e kombit të vet.

Mustafë Brahim Spahija do të mbetet në kujtimin e brezave pasardhës, si një burrë trim, patriot dhe luftëtar në mbrojtje të integritetit tokësor e të pavarësisë kombëtare.

MYRTO DAN ISUFI (MUHAJ) - DRISHT

Myrto Dan Isufi (Muhaj) rrjedh nga një familje e fisit Muhaj të Kalasë së Drishtit, me tradita të shkëlqyera patriotike.

Myrto Dani ka lindur në Kala të Drishtit më 2 dhjetor të vitit 1895 dhe ka vdekur në Kala të Drishtit më 12 janar të vitit 1972.

Njeriu i parë i këtij fisi quhej Muho, i cili ka pasur edhe dy vëllezër të tjerë. Të tre vëllezërit mendohet të kenë ardhur nga Turqia me detyra ushtarake dhe fetare. Ata fillimisht u vendosën në fshatin Kullaj-Boks të Postribës.

Vëllai i vogël, i njohur me emrin Hoxha i Dheut të Drishtit u largua nga Postriba dhe u vendos në Shkodër, në vendin e quajtur çinari i Hoxhës së Dheut, afër stadiumit “Loro Boriçi”. Ky emër i zonës u vendos për nder të tij. Ai studioi për fe dhe gjithë jetën ia kushtoi religjionit islam në Shkodër. Muhja, vëllai i dytë u largua nga Kullaj-Boksi dhe u vendos në Kala të Drishtit, ku krijoi degën e tij, që më vonë morën përsipër detyrën e bajraktarit. Vëllai i madh qëndroi në Kullaj-Boks.

Përpara fisit të Halil Isufit, detyrën e bajraktarit e kryente një fis nga Vilza i quajtur “Hetaj”. Për kalimin e bajrakut nga Vilza në Drisht u bë shkak një ngjarje, të cilën e kam trajtuar tek Halil Isuf Muhaj (Bajraktari), i këtij fisi, ndaj dhe nuk po e përsëris.

I pari në fisin Muhaj që e mori bajrakun quhej Hasë Bajraktari dhe pas vdekjes së tij e merr detyrën e bajraktarit Halil Isufi, në një moshë të re. Ai ishte 20 vjeç kur e merr këtë detyrë dhe e kryen në mënyrë të shkëlqyer deri ditën që u vra në moshën 74 vjeçare, rreth viteve 1919. Pas tij e merr detyrën e bajraktarit Zeqir Tafa, nipi i Halil Isufit, djali i vëllait. Në besëlidhjen në mes Postribës dhe Dukagjinit, që u krye në fshatin Prekal më 25 shtator të vitit 1919, detyrën e bajraktarit e kryente Zeqir Taf Isufi. Për bajrakun e Drishtit kanë nënshkruar burrat si më poshtë:

Paria e Drishtit: Qurk Brahimi, Smajl Dula, Isuf Hasani, Hasan Ahmeti. Bajraktari: Zeqir Tafa. (Zeqir - Taf - Dan - Isuf) Dan Isufi dhe Halil Isufi ishin vëllezër. (shënimi im, R. S).

Pas Zeqir Taf Isufit, detyrën e bajraktarit e merr Myrto Dan Isufi (Muhaj) dhe e kryen këtë detyrë deri ditën që arrestohet, më 14 shtator 1946 për pjesëmarrje në Kryengritjen Antikomuniste të Postribës. Pas tij këtë detyrë e kryen djali i tij, Imer Myrto Muhaj, i cili e gëzon edhe sot këtë detyrë. Ai gëzon respekt nga populli i Drishtit dhe i gjithë Postribës.

Myrto Dani në moshën 17 vjeçare merr pjesë në Rrethimin e Shkodrës, në frontin e Fushave të Myselimit dhe në atë të Bardhanjelit nën komandën e komandantit popullor Adem Haxhi Spahija, në të cilin front Postriba shquhet për trimëri dhe strategji ushtarake. Megjithëse i ri, Myrto Dani që në këtë moshë jep shenjat e një luftëtari guximtar dhe të vendosur në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe të sovranitetit tokësor.

Në Kryengritjen e Postribës që u organizua kundër pushtimit austro-hungarez në vitin 1916, Myrto Dani merr pjesë në kryengritje bashkë me burrat e Postribës dhe në përpjekjen që u realizua në afërsi të Urës së Mesit, Postriba fitoi kundër ushtrisë austro-hungareze, e cila u largua nga Postriba e mundur.

Në Luftën e Koplikut që u bë në vitin 1920, Myrto Dani merr pjesë si bajraktar i Drishtit me të gjitha forcat e Drishtit në veçanti, dhe të Postribës në përgjithësi dhe nën komandën e komandantit popullor Adem Haxhi Spahija organizohet një luftë e rreptë në mbrojtje të pavarësisë dhe të ruajtjes së integritetit tokësor, duke i përzënë pushtuesit serbo-malazezë jashtë kufinjve shtetërorë.

Myrto Dani merr pjesë në rezistencën që u organizua nga Postriba më 7 prill të vitit 1939, në Kodrat e Tepes, në Kodrat e Bërdicës dhe tek Ura e Bahçallekut. Kjo rezistencë organizohet nga paria e Postribës nën komandën e Adem Haxhisë. Në këtë kohë Myrto Dani ishte bajraktar i Drishtit.

Në vitin 1946 Postriba, e zhgënjyer nga Lufta Nacional-çlirimtare dhe Partia Komuniste e cila nuk lejoi zgjedhje të lira dhe demokratike siç kishte premtuar në Konferencën e Pezës, organizoi Kryengritjen Antikomuniste të saj më 9 shtator të këtij viti. Në këtë kryengritje Myrto Dan Muhaj ishte një nga krerët kryesorë së bashku me Osman Haxhi Spahinë, Baz Sylejman Shabaj, Emin Zyber çelaj, Abdullah Sahit Bushaj e të tjerë. Për këtë arsye Myrto Dan Muhaj arrestohet më 14 shtator 1946.

Me vendim nr. 432 / 2 datë 27 prill 1947 nga gjykata ushtarake Shkodër është deklaruar fajtor për krimin: "Ka agjituar dhe propaganduar kundër pushtetit dhe në bazë të nenit 2 dhe 3, pika 1, 2, 4, 7, 14 të ligjit 372 dhe në bazë të nenit 4 të këtij ligji e dënon me privim lirie e punë të detyrueshme për jetë, konfiskim të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, heqje e të drejtës qytetare e politike." Dënimi i ka filluar më 14 shtator 1946.

Në bazë të dekretit të Kuvendit Popullor, të ligjit 335 të Presidiumit të Kuvendit Popullor, i ulet dënimi në 20 vjet burg.

Myrto Dan Muhaj e vuan dënimin deri me 25 nëntor të vitit 1959, kur lirohet nga burgu.

Myrto Dan Muhaj gjatë gjithë jetës së tij ka qenë një burrë me karakter të lartë, trim, burrë i besës, mikpritës, i dashur me njerëzit, i respektueshëm, i drejtë, i ndershëm, besimtar, i durueshëm dhe i ekuilibruar.

Duke qenë bajraktar, ai ka marrë pjesë në shumë pleqni, jo vetëm në Postribë por edhe në male të tjera, si në Dukagjin, në Malësi të Madhe, në Shllak, në Dushman etj. Myrto Dan Muhaj ka pëlqyer këngët e epikës legjendare dhe të asaj historike, si të Ded Gjolulit, të Adem Haxhisë, të trimave që u këndohej trimëria, për nder, për besë, për fe, për atdhe.

Myrto Dani ishte burrë trim dhe i respektonte trimat. Ai ishte fisnik dhe i respektonte burrat fisnikë. Ai respektonte shumë fiset e mira, burrat e këtyre fiseve që nderonin jo vetëm Postribën, por edhe malësitë e veriut dhe Shkodrën. Ai dinte të mbante vendin e vet por edhe dinte të respektonte dhe të nderonte vendet e fiseve të tjera.

Myrto Dan Muhaj kishte vlera si bajraktar, nga i cili mund të mësonin edhe bajraktarët e tjerë, krerët dhe paria e Postribës. Por në të njëjtën kohë Myrto Dani i nderonte dhe i respektonte vlerat e burrave të Postribës, mësonte prej tyre, shkëmbente vlera.

Për të gjitha këto virtyte e vlera Myrto Dan Muhaj do të kujtohet nga brezat pasardhës, si një burrë që peshonte rëndë në fjalën e vet, që kishte karakter burri, që kishte besë e nder gjatë gjithë jetës së tij.

NDOC STAK GURRAJ - (GURRA - DAJCË) SUMË

Ndoc Staka rrjedh nga një familje nacionaliste e lagjes Gurra - Dajcë të fshatit Sumë të Postribës. Ai ka lindur në fshatin Sumë, në Gurra - Dajcë, rreth viteve 1889 dhe ka vdekur në vendlindjen e tij në vitin 1977, në moshën 88 vjeçare.

Rreth 300 vjet më parë, të parët e fisit të Ndoc Stakës, Dol Kuçi e Pyl Kuçi, erdhën nga Kuçi i Malit të Zi, tokë shqiptare në atë kohë, dhe u vendosën në Gurra - Dajcë e Bukmirë të fshatit Sumë. Dol Kuçi u vendos në Gurra - Dajcë ndërsa Pyl Kuçi u vendos në Bukmirë, duke mbajtur edhe emrin e vendit "Bukmirët", nga kishin ardhur. Sot e gjithë lagja Gurra - Dajcë rrjedh nga i pari i tyre, Dol Kuçi.

Familja e Ndoc Stakës ka qenë një familje e madhe, mbi 20 vetë, e pëbërë nga katër kurorë, me nipër e mbesa. Zot shtëpie ka qenë kurdoherë Ndoc Staka, i cili ishte vëllai më i madh ndër katër vëllezër që ishin. Ai kishte shumë toka sa i përket zonës ku banonte, kishte mbi 150 krerë dhi, 85 krerë dele, 3 krerë lopë me viça, 2 mushka për ngarkesë e transport, një pendë që pune për plugimin e tokës, rreth 25 zgjoje bletësh primitive e të tjerë.

Ndoc Staka, duke qenë një familje nacionaliste ka marrë pjesë në të gjitha luftërat për liri, pavarësi e sovranitet kombëtar, në mbrojtje të trojeve të kombit.

Ai ka marrë pjesë në Rrethimin e Shkodrës të vitit 1911-1912, në mbrojtje të Shkodrës kundër ushtrive serbo-malazeze dhe së bashku me gjithë Postribën, nën komandën e komandantit popullor, Adem Haxhija, dhe ka luftuar pa kursyer asgjë për liri, pavarësi e integritet tokësor.

Ndoc Staka ka marrë pjesë në Luftën e Koplikut të vitit 1920, në mbrojtje të trojeve tona, bashkë me bajrakët e Drishtit, të Boksit, të Shllakut dhe të Dushmanit, të cilët treguan heroizëm duke luftuar kundër një ushtrie të madhe të motorizuar e moderne.

Ndoc Staka në regjimin e Zogut ka qenë kryeplak i gjithë fshatit Sumë për një periudhë rreth dhjetëvjeçare. Siç tregon djali i tij, Prela, në kohën që Suma nuk pagoi të dhjetat për një periudhë, Ndoc Staka u arrestua nga qeveria dhe u mbajt në burg për rreth një javë. Për këtë u mblodh i gjithë fshati Sumë dhe pa vonesë mblodhën të gjitha të dhjetat dhe i dorëzuan në qeveri për të siguruar lirimin e Ndoc Stakës. Qeveria e liroi menjëherë kryeplakun e fshatit të Sumës, Ndoc Stakën.

Ndoc Staka ka marrë pjesë në pleqnimin e gjaqeve, duke përfaqësuar fshatin Sumë. Ai ka pleqnuar me Osman Haxhinë, Met Rexhën, Ram Metën e të tjerë, jo vetëm në bajrakun e tij, por edhe në bajrakët e tjerë të Postribës e më gjerë, si në pleqni me Dukagjin, Shllak, Dushman etj.

Ndoc Staka ishte një burrë i gjatë, trup drejtë me pamje tipike të një malësori verior. Ai ishte një burrë i qetë dhe i vendosur. Portreti i tij dukej se vazhdimisht meditonte për fisnikërinë, burrërinë, atdhetarizmin, bujarinë, zemërbardhësinë. Ai ishte burrë i besës, i dashur në familje dhe shoqëri, që dinte të respektonte të tjerët por edhe shoqëria e respektonte atë. Ai ishte burrë i matur, i ekuilibruar, ishte fisnik dhe i respektonte burrat me karakter e të ndershëm.

Në lidhje me besën tregohet një ngjarje, për të cilën këndohet një këngë për besnikërinë e tij ndaj Bejto Lanit të Traboinit, të cilën po e paraqesim të shkurtuar në vargje si më poshtë:

“... Ky Ndoc Staka e Ky Ndre Zefi
S’presin kend mik mbas vedi
S’kanë pre vetë as s’ka pre baba ...”

Ndoc Staka vishej gjithmonë me tirqe, ose çakçirë, xhamadan të kuq e brez, të prodhuara të gjitha në Gjakovë. Ai mbante mbi kokë qeleshe dhe rreth saj mbështillte një shall me lidhjen karakteristike të një kosovari. Në pamje dukej si një legjendar me tiparet e një fisniku.

Shtëpia e Ndoc Stakës ka qenë gjithmonë një shtëpi mikpritëse për çdo udhëtar që i takonte rruga andej pari. Ai i donte dhe i respektonte miqtë dhe kur i shkonin miq thoshte gjithmonë “Shtëpia e Zotit dhe e miqe është”. Një shtëpi që nuk i ha bukë asnjë njeri nuk ka si të ketë bereqet, thoshte Ndoc Staka.

Ndoc Staka do të kujtohet nga brezat pasardhës si një burrë fisnik, trim, nacionalist, i besës, i burrërisë, mikpritës, i dashur dhe i respektueshëm nga gjithë shoqëria. Gjithë materiali u mor nga djali i tij Prelë Ndoci dhe u ballafaqua me material historik.

OSMAN HAXHI SPAHIJA - BOKS

Osman Haxhija rrjedh nga një familje e fisit Spahijaj të fshatit Boks të Postribës me tradita të shquara nacionaliste. Ai ka lindur në fshatin Boks në vitin 1902 dhe ka vdekur në vendlindjen e tij, në fshatin Boks me datën 22 nëntor të vitit 1975.

Osman Haxhija, gjithë jetën e tij 73 vjeçare, që kur arriti në moshën e pjekurisë, që filloi të mendojë për jetën dhe kombin e tij, e kaloi në luftë dhe përpjekje të vazhdueshme për mbrojtjen e identitetit kombëtar, në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe integritetit tokësor. Ai nuk kurseu asgjë në mbrojtje të dy parimeve themelore: “për fe e atdhe!”

Pushtimi austro-hungarez i vitit 1916 e gjen Osman Haxhinë në moshën 14 vjeç. Duke qenë nën moshën e organizimit ushtarak, ai nuk është në gjendje të marrë pjesë në kryengritjen që u organizua nga Postriba nën komandën e Adem Haxhisë, kundër pushtimit austro-hungarez të vitit 1916.

Osman Haxhi Spahija merr pjesë në Luftën e Koplikut të vitit 1920, në moshën 18 vjeçare, bashkë me luftëtarët e Postribës në mbrojtje të trojeve kundër pushtuesve serbomalazezë, luftë që përfundoi me sukses, duke i nxjerrë pushtuesit jashtë kufirit shtetëror.

Në vitin 1939, më 7 prill, Italia pushton vendin tonë. Osman Haxhija merr pjesë në rezistencën që organizohet nga Postriba kundër pushtimit Italian, në Kodra të Tepes, në Bahçallek dhe në Kodra të Bërdicës. Pas pushtimit fashist, arrestohet vëllai i tij, Adem Haxhija bashkë me Imer Beqirin, të cilët i internojnë në Kolforito të Italisë. Pasi e helmojnë në Itali Adem Haxhinë, si një kundërshtar i fashizmit, se nuk pranon të vihet në shërbim të tij, Osman Haxhija shkon në Itali dhe merr vëllain që të vdiste në vendin e vet.

Dy vjet pas çlirimit të vendit, në vitin 1946, më 9 shtator, Osman Haxhija me krerët e Postribës organizon Kryengritjen Antikomuniste për përmbysjen e regjimit. Kryengritja dështoi dhe u shtyp egërsisht nga sigurimi i shtetit dhe terrori komunist, por Postriba doli e fituar sepse i tha komunizmit se nuk e pranonte diktaturën komuniste. Osman Haxhija u dënua fillimisht me pushkatim, pastaj me 101 vjet heqje lirie. Ai kreu 10 vjet burg, duke provuar torturat me të egra të regjimit në burgun komunist. Si një njeri i vendosur, ai nuk iu nënshtrua torturave çnjerëzore dhe mori mbi vete çdo përgjegjësi në lidhje me kryengritjen.

Në librin e autorit me emrin letrar “Veri Jugu” dhe të titulluar “Epos’i Shqipës”, bëhet fjalë për heroizmin e trimave të Postribës në Kryengritjen antikomuniste të saj, që shpërtheu më 9 shtator të vitit 1946.

Këtu poshtë po paraqesim disa vargje për vlerësimin që autori i bën Osman Haxhisë në poemën e tij:

“... E Postripa me burra të saj
Aty në Boks në një ograjë
Janë mbledhë bashkë me bisedue
Gjithë këtë punë me organizue
Nën drejtimin e Osman Haxhisë
Me i vu pushkën qeverisë.

...

Veç Postripa përmbi Shkodër
Asht çue n’kambë i madh e i vogël
Ku u ka pri Osman Haxhija
Nji burrë trim nji plak me thinja
Mos të harrojmë se edhe vëllai i tij
Adem Haxhija burrë dai
Njëzet e gjashtë vjet ma parë
Pat bashkue Postribën mbarë ...”

Osman Haxhi Spahija, gjatë regjimit 50 vjeçar të pushtetit diktatorial komunist u trajtua si armik i pushtetit në fuqi, si një njeri i deklasuar dhe i rrezikshëm i regjimit komunist. Ai meriton respekt së bashku me krerët e tjerë të Postribës, të cilët me veprën e tyre shkruajtën një faqe të lavdishme të historisë moderne të Postribës dhe të Shqipërisë.

Osman Haxhija ishte një burrë i gjatë me tiparet karakteristike të një malësori verior. Në fytyrën e tij spikaste butësia e shpirtit njerëzor, zemërgjerësia, fisnikëria, burrëria, maturia, ekuilibri dinamik i një burri që di të falë, por di edhe të veprojë me guxim dhe trimëri kur i paraqitet nevoja.

Osman Haxhija ishte një burrë i zgjuar, i mençur, që di të veprojë në çdo situatë që t’i paraqitet. Duke qenë në pozicionin e vojvodës, atij i takoi që të merrej me pleqni që në moshën 40 vjeçare. Ai ka marrë pjesë në të gjitha pleqnitë që janë organizuar në Postribë si dhe jashtë saj, në pleqimin dhe kuvendet e maleve si në Malësi të Madhe, në Dukagjin, në Shllak, në Dushman, e deri në Pukë, Has e Gjakovë. Ai ka pasur natyrë që fliste pak, por kur fliste ai, vendosej ashtu siç thoshte, sepse fjala e tij kishte peshë të madhe, siç thoshte plaku i fisit Smajlaj të Gruemirës, Islam Idrizi, në mos gabofsha: “Fjala e Osman Haxhisë peshonte si shkambi dhe nuk kishte burrë ta luaj aty ku binte!”

Islam Idrizi na tregoi mbi një ngjarje pleqërimi, në të cilën kishte marrë pjesë bashkë me Osman Haxhinë. Në këtë pleqim, siç thoshte Islami, Osman Haxhija u shqua në zgjuarsinë e tij. Ai tregon kështu: “U mbledhëm në një pleqni, pleqtë e të gjitha maleve të veriut. Kishim për të marrë një vendim. Folën të gjithë pleqtë me rradhë dhe në fund foli Osman Haxhija. Fjala e tij ishte e rëndë si shkëmbi, peshonte shumë aty ku binte”

Osman Haxhija në shkallë zone ka marrë pjesë në pleqim me burra të njohur të Postribës si me Met Rexhën e Shakotës, me Brahim Kasemin e Dajcës, me Myrto Danin dhe Metush Halilin e Drishtit, me Haxhi Tahirin e Rrashit, me Isuf Hasanin e Ram Metën e Urës së Shtrejtë, me Brahim Veli Bracajn dhe Hasë Veli Uruçaj të Domnit etj.

Osman Haxhija ka kryer dy pleqni të rralla, të cilat do t’i riprodhojmë si më poshtë: në Malësi të Madhe për pleqimin e një vajze që kishin vendosur ta ekzekutonin për fajin që kishte bërë. Ajo kishte gabuar në moral. Osman Haxhija, Met Rexha i Shakotës dhe Isuf Hasani i Urës së Shtrejtë takohen me pleqtë e Malasisë së Madhe, të cilët kishin marrë një vendim për të varur në litar një vajzë që kishte gabuar në moral. Osman Haxhija u drejton një pyetje pleqve të Malasisë së Madhe: “A keni gabuar njëditëherë në jetën tuaj ju që pleqnoni? “Po - i thanë ata - kemi gabuar.” “A ju kanë denuar me varje pleqtë ju, për fajin që keni bërë?” Ata panë njëri - tjetrin dhe pastaj, ai që drejtonte kuvendin u përgjigj: “Ne vërtetë nuk na ka denuar asnjë pleqni, por si duhet të veprojmë për ta shpëtuar këtë vajzë nga dënimi i opinionit të popullit?!” “Këtë punë na e leni ne, thanë njëzëri, Osman Haxhija, Met Rexha dhe Isuf Hasani. Vajzën do ta

marrim ne pleqnia e Postribës dhe këtë thuajani popullit. Atë do ta fejojmë dhe do ta martojmë ne.” Kështu ranë dakord dy palët e pleqnive. Pas dy javësh, pleqtë e Postribës e fejuan dhe e martuan vajzën në rrethin e Mirditës.

Rasti i dytë ishte kështu: Pleqnia e Malësisë së Madhe kishin bërë një pleqni por palët nuk kishin pranuar të pajtoheshin. Për ta shpejtuar procesin e pajtimit i kërkojnë ndihmë pleqve të Postribës. Shkojnë për të bërë këtë pajtim Osman Haxhija, Met Rexha dhe Isuf Hasani. Gjatë rrugës marrin me vete gjaksorin dhe e lidhin me litar për duarsh, duke i thënë që ai duhet të pranonte çdo gjë që t’i thonin pleqtë edhe sikur të vritej nga familja që ai i kishte vlarë djalin. Gjaksori pranoi siç i thanë pleqtë. Litarin që i kishin lidhur duart e lidhin pak gjatë për shalën e kalit të Osman Haxhisë. Njoftojnë shtëpinë e të vrarit se po mbërrinin për të bërë pajtimin pleqtë e Postribës dhe kërkojnë përgjigje se a mund të shkonin për të kryer këtë pajtim apo jo. Plaku i shtëpisë, burrë shumë i urtë, pyet se kush ishte bashkë me pleqtë e Postribës që kishin vendosur për të kryer pajtimin. Ata i thanë se pas tyre ishte një burrë i lidhur me litar që u shkonte mbrapa i lidhur sipas urdhrat të tyre. “Mos bre - tha plaku - më paskan xanë ngushtë dhe duhet me e falë patjetër gjakun se burri i lidhur duarsh nuk vritet sepse është në besë të tre pleqve të Postribës dhe po ta vras hy në gjak me tre fise të forta në Postribë. Pra i qoftë falë gjaku për jetë! - tha plaku i urtë dhe çdo gjë u krye sapo arritën pleqtë e Postribës.

Osman Haxhija ka qenë një njeri i dashur me njerëzit, i thjeshtë, i respektueshëm. Ai i ka vlerësuar njerëzit, është sjellë mirë si me të moshuar ashtu edhe me të rinj. Ai ka qenë i dashur edhe në familje, i ka respektuar pjesëtarët e familjes dhe i ka trajtuar si të barabartë me veten e tij.

Osman Haxhija ka qenë njeri shumë komunikues. Gjatë bisedës, ai ka folur gjithmonë me qetësi e dashuri, i qeshur kurdoherë dhe para se ta nxirrte fjalën, ai e bluante mirë atë. Fjala e tij peshonte shumë dhe kishte vlerë për çdo njeri që e dëgjonte. Secili njeri që e ka dëgjuar Osman Haxhinë të bisedonte, të paktën edhe një herë të vetme, do ta ruante në kujtesën e tij si një rast të rrallë të komunikimit me një njeri të tillë. Ai kishte vlerat që shekulli ia dhuroi vetëm atij.

Imer Muho Spahija, ndjesë pastë, e ka dashur shumë Osman Haxhinë, jo vetëm sepse e ka pasur axhë, por më tepër për këto vlera të rralla që ai kishte.

Osman Haxhi Spahija do të kujtohet nga gjithë ata njerëz që e njohën, si një njeri i drejtë, i ndershëm, besimtar, fisnik me karakter burri dhe i zgjuar deri në mrekulli. Njëherë të tillë, i dhurojnë kohës diçka të veçantë për të lënë gjurmë në histori.

RAC BAJRAMI (ÇELAJ) - DRAGOÇ

historia e popujve u shkrua me lëvizje demografike, me emigrime, me luftëra dhe eksode, me përpjekje forcash materiale dhe njerëzore për një jetë më të mirë.

Në këtë mënyrë, në një ditë të zakonshme një degë e fisit çelaj nga Dragoshi i Prizrenit largohet përgjithmonë nga vendlindja në kërkim të mbijetesës dhe vendoset në zonën e Postribës të rrethit Shkodër, në një vend që mori emrin Dragoç. Ndoshta koha e evoluoi emrin nga Dragosh në Dragoç.

Fisi Çelaj është një nga fiset më të vjetra që formoi fshatin Dragoç të Postribës. Këtë e vërteton historiku i fshatit, vendndodhja e shtëpive të banimit si dhe pronësia mbi oqrajat, ullishtet dhe tokat arë që gjenden në qendër të fshatit.

Njerëzit që lënë emër dhe kujtesë në brezat që vijnë pas janë pothuajse çdo herë njerëz të heshtur, të qetë, të dashur, të thjeshtë e të vendosur për t’i shërbyer shoqërisë dhe njerëzimit në çdo kohë. I tillë ishte edhe plaku i urtë e bujar Rac Bajrami i fisit çelaj të fshatit Dragoç të Postribës. Heshtja e tij e mbyllur mund të dijë më shumë nga ç’kanë treguar bashkëkohësit e tij. Ai mori me vete në varr atë thesar diturie që u ruajt në mendjen dhe zemrën e tij si një pasuri që ruan vlera të paçmuara. çdo njeri që vihet përballë portretit të tij do të krijojë bindjen për origjinën e tij kosovare me qelshen e bardhë që mban në kokë dhe shallin e mbështjellë rreth qelshes e qafës, me xhamadanin dhe gyberen prej shajaku që e pajisin atë me burrëri e fisnikëri, një harmoni portreti që të imponon respekt.

Rac Bajrami të shikon i qetë, drejt e në sy, tamam si burrat e motit, duke të lënë përshtypjen se edhe sot i vdekur ai po të studion karakterin dhe personalitetin, burrërinë dhe besën, bujarinë dhe dashurinë njerëzore me të cilat virtyte ai u ushqye gjatë gjithë jetës së tij.

Rac Bajrami u lind në fshatin Dragoç të Postribës në vitin 1832 dhe pas një shekulli, në vitin 1928, para se të vdiste la në formën e testamentit tre amanete: Amaneti i parë ishte konsultimi i tij me pasardhësit se

cili duhej të mbetej kryetar familjeje pas vdekjes së tij. Amaneti i dytë ishte që pasardhësit të ndiqnin rrugën e tij të drejtimit, të burrërisë, të besës, të bujarisë, të besimit dhe të drejtësisë. Porosia e tretë në formën e testamentit ishte kjo: “Para se të vdes po ju lë dy miq e gjysmë. Miku i parë është familja e Shuk Kolës, miku i dytë është familja e Pistullorëve dhe gjysma e mikut është familja e Rrojëve. Dy familjet e para mbajini se janë të provuara, ndërsa familjen e Rrojëve plotësojeni mik të plotë pasi mua nuk po më mjaftojnë ditët për ta plotësuar.” Të tria familjet janë nga qyteti i Shkodrës. Pra, Rac Bajrami, dy familjet e para i kishte bërë provë se ishin miq të vërtetë, ndërsa familjen e Rrojëve e kishte zënë mik vonë. Ai ecte me parimin se “ari në zjarr provohet, ndërsa miku në ditë të ngushta kuptohet.”

Rac Bajrami drejtonte një familje të madhe. Në familje jetonin e punonin 64 veta, të përfshirë në tre deri në katër breza njerëzorë. Me punën dhe djersën e pjesëtarëve të familjes, ai kishte arritur të akumulonte një pasuri të madhe në familje pa dëmtuar interesat e shoqërisë ku jetonte. Ai kishte shtëpi të madhe që kishte zë në zonë, gërmadhat e së cilës janë edhe sot. Ai kishte ndërtesa ekonomike, stallë blegtorie e tjerë. Ai dispononte tre pendë qe, 27 krerë lopë, 400 krerë dhenë, 40 krerë dhi, 3 mullinj bloje, të cilët dy i mbante për bloje drithi dhe një për të bluar sheqer e kafe për tregtarët e Shkodrës.

Rac Bajrami rrjedh nga një familje me tradita të mira patriotike. Fisi i tij brez pas brezi në bashkëpunim me fiset e tjera patriotike të Postribës, luftonin me heroizëm për mbrojtjen e trojeve nga pushtuesit e huaj.

Në kohën e regjimit turk baba i Rac Bajramit, i quajtur Bajram Haxhija, burrë në zë e trim, ishte kryetar i komisionit të të dhjetave e xhelepit për zonën e Mbishkodrës. Gjatë vlerësimit të të dhjetave në zonën e Jubanit vritet në konflikt e sipër. Pas njëmbëdhjetë vjetësh Rac Bajrami i merr gjakun babës së tij në Pazarin e Shkodrës, duke vrarë vetë dorasin. Për të mos e lënë vetëm në marrjen e gjakut, bashkë me të shkoj Ymer Brahimi i fisit Halilaj të fshatit Dragoç të Postribës, i cili mori vesh rastësisht se Rac Bajrami ishte nisur për Pazar, pasi e kishin njoftuar se gjaksi ndodhej aty. Rac Bajrami e pranoi si shoqërues Ymer Brahimi me kusht që gjaksin ta vriste Raci për t’u qetësuar në shpirt. Ymeri do të shtinte mbi të nëqofëse do t’i shpëtonte Racit. Pajtimin e gjakut në mes këtyre fiseve e realizoi Shuk Kol Serreqi, miku i Rac Bajramit.

Në janar të vitit 1916 ushtritë austro-hungareze hynë në Shkodër. Ato posa hynë, vendosën regjimin ushtarak të pushtimit. Në popull ziente revolta e fuqishme kundër pushtuesit. Forcat popullore të organizuara dhe të udhëhequra nga bajraktarët, vojvodët e komandantët popullorë, po përgatiteshin për një kryengritje të armatosur kundër pushtuesve austro-hungarezë. Duke parë rrezikshmërinë që paraqiste kryengritja e malësorëve të Postribës, komanda austro-hungareze ndërmori masa të jashtëzakonshme për të penguar kryengritjen. Ajo dërgoi një fuqi të madhe ushtarake për të shtypur kryengritjen e Postribës. Kështu vetëm në fshatin Dragoç dërgon një njësi ushtarake nën komandën e kapiten Gjon Fushës. Me të hyrë në Dragoç Gjon Fusha nis terrorin duke varur për krahësh në manin e varrezave në qendër të fshatit tre burra: Ymer Beqir Shabaj të fshatit Boks, Nuz Halilin të fisit Halilaj dhe Baz Haxhinë e fisit çelaj, dy të fundit nga Dragoçi. Qëllimi i terrorit ishte dorëzimi i armëve dhe parandalimi i kryengritjes. Sapo mori vesh për terrorin, Rac Bajrami shkoi dhe u takua me kapiten Gjon Fushën, e ftoi atë bashkë me ushtri, i siguroi strehim e ushqim duke i lëshuar një jerevi të madhe dhe i kërkoi lirim e tre burrave të varur. Ai liron burrat ndërsa vazhdon të qëndrojë në fshat me ushtarë për të ushtruar kontrollin e armëve dhe për të shtypur kryengritjen. Një ditë kapiten Gjon Fusha e pyet Rac Bajramin se ku i merrte bagëtitë që therte për mish. Rac Bajrami i tha se deri sa të mbaronte bagëtitë e veta, ai nuk do të merrte gjë në fshat. Bujaria e plakut të Postribës e mundi armiqësinë e kapitenit. Në kohën kur ushtria austro-hungareze u thye nga kryengritja e Postribës, kapiten Gjon Fusha i thotë Rac Bajramit që n’i paç pushkët një pash në dhe’ futi shtatë pash, pasi po të më pyesin do të them se Rac Bajrami me Postribë nuk ka armë.

Përveç ushtrisë që kishte shpërndarë në zonë, komanda austro-hungareze dërgoi gjithashtu edhe një detashment ushtarak të pajisur me dy topa e gjashtë mitroloza në fshatin Drisht, që ishte qendra e Postribës, me qëllim që të shpërndante kryengritësit, që ishin grumbulluar aty. Ky detashment pasi zbraz disa topa e mitroloza, me të mësuar se po rrethohej prej kryengritësve potribas, u kthye me ngut në Shkodër. Vetëm afër Urës së Mesit la të vrarë tre ushtarë dhe u zunë robër dy boshnjakë.

Kryekomandanti i ushtrive austro-hungareze, që e kishte kuptuar se nuk ishte e mundur t’i shtronte forcërisht kryengritësit “që po shtoheshin dita-ditës”, në letër qarkore, të cilën ia shkruante kryemyftisë së përgjithshme, si dhe gjithë krahinave (komunave), me datën 21 tetor 1918, i porosiste që t’i merrnin masat e duhura dhe të përdornin ndikimin e tyre për t’i qetësuar kryengritësit.

Vitet 1904 e në vazhdim sollën zinë e bukës. Kjo gjendje ia shtoi vështirësitë popullit të zonës por Rac Bajrami si kurdoherë, bujar e zemërbardhë ndihmoi me bukë të gjitha ato familje që ishin në nevojë. Ai gjithashtu ndihmoi fshatin për arsimimin e moshës së re me arsim fetar duke dhënë truall për të ndërtuar aty një institucion arsimor me karakter fetar. Kështu, në Dragoç u hap mejtepi i parë për arsimimin fetar.

Rac Bajrami ishte nacionalist. Duke qenë i tillë, ai bën lidhje miqësore me Adem Haxhinë, patriotin dhe komandantin popullor të Postribës. Këtë miqësi ai e dyfishon duke i marrë vajzën për djalë dhe duke i dhënë vajzën e tij për djalë. Kjo miqësi u reflektua edhe në veprimtarinë patriotike. Në Rrethimin e Shkodrës, komandanti Adem Haxhija me djalërinë e Postribës merr pjesë në mbrojtje të Shkodrës duke zënë frontin e Myselimit dhe atë të Bardhanjelit. Rac Bajrami merr mbi vete prapavijën e forcave të Postribës duke i furnizuar ata me bukë, ushqim, armatim e municion ushtarak. Gjithashtu edhe në Luftën e Koplikut të vitit 1920 Rac Bajrami kryen detyrën e furnizimit të luftëtarëve si komandant i prapavijës.

Rac Bajrami si veprimtar politik ka qenë nacionalist opozitar, ndërsa Adem Haxhija ka qenë nacionalist i pozitës. Kjo ndarje mes dy miqve nuk e dëmtonte miqësinë e tyre. Më 2 dhjetor 1922 Ahmet Zogu emërohet kryeministër duke mbajtur edhe postin e ministrit të punëve të brendshme. Gjatë kësaj periudhe qeveria ndjek kundërshtarët, pra veprimtarët e partisë opozitare. Në këtë kuadër në Postribë arrestohen nga qeveria Rac Bajrami, Ramo Mustafa (Bushaj) nga fshati Kullaj-Boks dhe Ramo Salihi (Hasaj) nga fshati Dragoç. Këta internohen në Vlorë.

Me ndërhyrjen e gjeneralit dhe kryeadjutantit Zef Serreqi, tek Zogu, i cili kishte miqësi të fortë me Rac Bajramin, Ahmet Zogu i liron tre burrat e Postribës dhe do t'i shpërblejë me napolonash ari për periudhën e dënimit, por këta nuk pranojnë duke e lënë këtë sasi napolonash për nevoja të spitaleve.

Rac Bajrami ishte njeri me temperament flegmatik. Ai ishte tip i qetë, i fortë, i ekuilibruar, por i ngadalhtë. Ai ishte njeri i matur, këmbëngulës në marrjen e vendimeve dhe i durueshëm në vështirësi e fatkeqësi. Ai ishte gjakftohtë, nuk mbante inad, nuk gëzohej as nuk hidhërohej shumë. Në marrëdhënie me të tjerët ai paraqitej i matur, nuk i pëlqente fjalët e shumta as llafet e kota. Ai ishte njeri me ndjenja të thella e të qëndrueshme.

Ai ishte njeri me vullnet të fortë për ta çuar deri në fund një punë, një mendim, një pikëpamje, një synim.

Gjatë gjithë jetës së tij, ai nuk përdor asnjë lloj pijeje alkoolike as duhanin. Nga lindja e deri sa mbyllti sytë, ai nuk pati nevojën e mjekësisë. Ai ishte njeri i besimit të fortë islam. Studionte në fe aq sa i mësonte hoxha, falte namazin, mbante Ramazanin dhe falte Zeqatin sipas ligjit Islam. çdo vit ai falte nga blegtoria e imët një krerë nga dyzetë krerë.

Rac Bajrami ka qenë shumë bujar, i mëshirshëm, i dhimbshëm. Një ditë, i hipur mbi kalin e shalës, po shkonte për të bërë tregun e festës së Bajramit tek tregtarët e Shkodrës. Në Shtoj, aty ku është Hoti i Ri sot, ai zë e lë mbrapa dy gra, të cilat ishin nga Kalaja e Drishtit. Ato ishin të varfëra në familjet e tyre. Ato diskutojnë me njëra-tjetrën: “Lum ky burrë që ka pasuri dhe ka me çka i gëzon pjesëtarët e familjes këtë natë Bajrami, po ne të mjerat me çka do t'i gëzojmë fëmijët tonë?” Ai preket thellë në shpirt kur i dëgjon por nuk bën zë dhe sa shkon tek myshteria i tij, Man Hoxha (tregtar me zë në atë kohë) i thotë: “Do të vijmë dy gra nga Kalaja e Drishtit, plotësojua tregun me çdo gjë që të kenë nevojë dhe mos u merr lekë sepse i paguaj unë të gjitha paret.” (Rac Bajrami i jep Man Hoxhës emrat e grave pasi i njihte mirë ato). Në këtë mënyrë, Rac Bajrami pagoi harxhin që morën gratë për Bajram duke e mbyllur këtë fshehtësi në varr. Ai nuk dëshironte t'i tregonte asnjë njeriu për mirësitë që bënte.

Rac Bajrami ka marrë pjesë në pajtime gjaqesh duke u bërë një faktor i rëndësishëm në afrimin dhe pajtimin e familjeve në konflikt. Prania e tij në gjykimin e shkaqeve që kanë sjellë konfliktet apo gjaqet si dhe trajtimi i problemeve me drejtësi dhe paanshmëri i shtonin autoritetin dhe respektin nga të tjerët.

Në familje ishte njeri i dashur dhe i thjeshtë. Ai i donte shumë pjesëtarët e familjes e sidomos fëmijët. Ai ka qenë njeri i dashur në shoqëri. Atë e donin dhe e respektonin shumë si në Postribë ashtu edhe në Shkodër. Në shpirtin e tij zinte vend vetëm dashuria për njerëzit. Ai urrente vetëm pushtuesit, hajdutët dhe mashtruesit. Ai ruante respekt e dashamirësi për njerëzit e çdo religjioni fetar. Ai nuk kishte komplekse fetare dhe nuk kishte asnjëfarë paragjykimi, sepse, siç thote ai, besimtari Islam duhet të njohë dhe të respektojë të gjitha religjionet e profetët e tyre, pasi njerëzit janë krijesa të një Zoti të vetëm.

Ndër miqtë e Shkodrës, më të dashurit kishte Shuk Kolë Serreqin, Pistullorët, që ishin katolikë si dhe familjet myslimane Qukajt, Rrojët e tjerë.

Rac Bajrami nuk zotëronte vetëm artin e punës por edhe atë të qitjes, gjuetisë, të këngëve e valleve. Ai ishte një gjuetar i mirë. Pëlqente sidomos gjuetinë e shpendëve dhe të peshkut. Shepkat i gjuante shumë dhe pothuajse gjatë gjithë jetës së tij ushqej me mishin e tyre. Ai pëlqente garat me kuaj, organizimin e festave popullore në ditë të caktuara gëzimesh si dhe gjuajtjen e shenjave me armë. Ai donte shumë këngët popullore, vallet, artin. Rac Bajrami përdorte lahutën si instrument popullor.

Në dokumentat e kohëve pas vdekjes së Rac Bajramit gjejmë se trashëgimtarët e tij ruajtën emrin dhe prestigjin e derës së madhe të fisit. Ato vazhdojnë të ruajnë traditat nacionaliste të Rac Bajramit. Gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore, kolonel Faik Quku i lidh me misionin anglez që ndodhej në Cukal për të koordinuar punët me aleatët e vet, nacionalistët shqiptarë. Njëri nga misionarët, kapiten Hibberdini sëmuret në Cukal. Kolonel Faik Quku me porosi të major Neel-it, e merr nga Cukali dhe e vendos në familjen e Rac Bajramit bashkë me një doktor italian. Aty i lë rreth tre javë, deri sa u shërua kapiten Hibberdini. Familja e Selim Rac Bajramit nuk kurseu asgjë për miqtë.

Figura e Rac Bajramit lë të shërbejë si mesazh për brezat që jetojnë, për të edukuar tek ata bujarinë, burrërinë dhe nacionalizmin që personifikon personin e tij dhe të gjithë burrat e Postribës të asaj kohe të artë!

RAMADAN HALIL THORJA-MYSELIM

Ramadan Halil Thorja u mendua të rreshtohet me burrat më në zë të Postribës për arsyen se është intelektual i parë që del në zonën e Postribës, në vitin 1962, është mjeku i parë (i specializuar për pediatri) që del nga kjo zonë, i cili i shërbeu popullit të zonës së veriut me përkushtim e devotshmëri për gati një gjysmë shekulli. Ai fitoi shumë popullaritet dhe respekt jo vetëm në Postribë, por edhe në Shkodër, Pukë, Fushë Arrës dhe në Malësinë e Madhe e kudo ku ai punoi. Janë pikërisht këto arsye që më imponuan për ta rradhitur me burrat më në zë të Postribës.

Ramadan Halil Thorja ka lindur në fshatin Myselim, më 22 mars 1935 dhe ka vdekur me 24 janar 2009. Ai rrjedh nga një familje nacionaliste e fisit të madh Hysaj, që përfshin pothuajse të gjithë fshatin Myselim. Gjithë fisi Hysaj mendohet të ketë origjinën nga Mërturi i Gurit-Pukë.. I pari i tyre mendohet të jetë Balë Gjoni, katolik nga Mërturi i Gurit.

Ramadan Halil Thorja kreu shkollën fillore në Bardhaj, ndërsa shkollën Unike (shtatëvjeçare) e kreu në Shkodër në vitin 1950. Gjatë kësaj kohe ka ndihmuar në zhdukjen e analfabetizmit, duke u mësuar brezave të rritur, burrave dhe grave, shkrim e këndim, pas orarit të punës së tyre.

Ramadan Halili kryen shkollën e mesme të ndihmësmjekut në Tiranë dhe sapo kryen shkollën, emërohet infermier në rrethin e Kukësit, në Krumë të Hasit, por nuk punoi fare në këtë vend sepse iu dha e drejta e vazhimit të studimeve të larta në fakultetin e mjekësisë. Këtu ai studioi për mjek i përgjithshëm. Ramadan Halili ishte i pari banor i Postribës që kryen një shkollë të lartë në vitin 1962 dhe mjeku i parë i zones së Postribës. Që nga viti 1962 emërohet mjek në rrethin e Pukës. Në vitet 1965-1966 kryen dy vjet specializim për pediatër. Ai punoi deri në vitin 1978 në rrethin e Pukës me funksione të ndryshme, si mjek, drejtor i spitalit të Pukës e Fushë-Arrësit, shef i seksionit të shëndetësisë të këtij rrethi.

Nga viti 1978 deri në fund të vitit 2006 ka punuar me detyrën e mjekut pediatër në rrethin e Shkodrës dhe të Malësisë së Madhe, duke shërbyer për 44 vjet në mjekësi me përkushtim, seriozitet, profesionalizëm e ndershmëri.

Nga viti 1996 deri në vitin 2006 punoi si mjek në Malësi të Madhe, megjithëse në pension.

Për punë të mirë dhe devotshmëri, në vitin 1989, Presidiumi i Kuvendit Popullor, e dekoron Ramadan Halilin me medaljen: “Për shërbim të mirë të popullit”. Dekret nr. 7323, Tiranë dt.07 09 1989.

Ramadan Halil Thorja do të kujtohet nga brezat e rinj si një mjek i aftë e me përkushtim dhe si një njeri human, i dashur dhe i respektueshëm në shoqëri.

Vëllai i tij i quajtur Adem Halili ka lindur në vitin 1921 dhe vazhdon të bëjë një jetë normale e të qetë. Ai ka qenë dhe është njeri me emër në Postribë, një burrë i njohur dhe i zgjuar. Ai ka ndihmuar shumë në zgjidhjen e mjaft konflikteve, mosmarrëveshjeve, në pajtime gjaqesh e të tjera. Ai ka dhënë mjaft këshilla të urta si: “Mos të mallkoftë nëna jote, pasuria jote, mundi yt!” Adem Halili është një besimtar i mirë. Ai ishte një ndër organizatorët kryesorë, së bashku me Cuf Zejrunin e Hasan Sylon, për hapjen e xhamisë së fshatit Mes-Myselim, në dhjetor të vitit 1990, pak ditë pas hapjes së xhamisë së Plumbit në Shkodër.

Mendova ta trajtoj Adem Halilin shkurtimisht së bashku me vëllain e tij Ramadan Halili, sa për t'ua lënë brezave pasardhës si një kujtim të mirë për këtë burrë me vlera të urtësisë dhe të fisnikërisë të një burri verior.

RAM META (MEAJ) - URA SHTREJTË

Ka lindur në Përrue Mos të Postribës në vitin 1896 dhe ka vdekur në fshatin Hot i Ri, më 9 gusht 1973. Gjatë jetës, nga lindja deri në vdekje, për 77 vjet jetë, ka kaluar disa regjime politike, që nga regjimi turk i pushtimit e deri në regjimin komunist. Ram Meta rrjedh nga një familje me tradita të mira patriotike. Axha i tij Isuf Has Mehmeti, ka qenë kryeplak i fshatit Ura e Shtrejtë për një periudhë dhjetëvjeçare, (1921-1931), deri ditën që hyri pushka në xhaminë e Urës së Shtrejtë, që përfundon me 9 vetë të vdekur e të plagosur. Këtu vritet edhe Isuf Has Mehmeti.

Fisi i Rametajve ka tradita të mira patriotike. I pari i këtij fisi, i quajtur Pepë Preçi, është i ardhur nga Mirdita, sipas dëshmisë së djalit të tij Sabri Ram Meaj, i cili më vonë është islamizuar.

Ram Meta ka qenë nacionalist gjatë gjithë jetës së tij. Me vdekjen e Isuf Has Mehmetit, axhës së tij, Ram Meta mori drejtimin e familjes në moshën 35 vjeçare. Duke qenë nacionalist me pikëpamje dhe me vepra, ai lidhet me Ahmet Zogun nëpërmjet Dan Hasanit të Shkodrës. Ai shërben si një zogist i mirë deri në çlirimin e vendit, në vitin 1944.

Ram Meta ka marrë pjesë në çdo mbledhje që është organizuar në Postribë. Ai mori pjesë në Kaçerdhe dhe tek shegat e Osman Isenit, tek Ura e Rrasekut. Në këto mbledhje, gjatë luftës është vendosur edhe ndarja e rrugëve nga do të lëviznin forcat e djathta (Legaliteti dhe Balli) dhe nga do të lëviznin forcat e majta të drejtuara nga Partia Komuniste. Kjo ndarje u bë me marrëveshje mes postribasve, që të mos kishin konfrontime të forcave të ndryshme politike dhe të mos pritej në besë asnjë njeri që mund të shoqërohej nga postribasit.

Në një mbledhje që u organizua në Kaçerdhe ku morën pjesë përfaqësues të forcave të ndryshme politike, që gati duke hyrë pushka mes burrave për çeshtje të Ram Metës, ku përfaqësuesit e Partisë Komuniste akuzuan se Ram Meta qëndron me këmbë në kapërcyell duke mbajtur lidhje me forcat komuniste si dhe me Legalitetin. Burrat e mençur e ndaluan këtë konfrontim me armë. Sali Efendia dhe Daut Komi kërkuan të bisedonin më vete me Ram Metën, por nuk e lanë përfaqësuesit e forcave partizane që ishin të porositur nga shtabi. Sali Efendia me shumë zgjuarsiri e ndaloi konfrontimin, duke i thënë Ramës që je i lirë të zgjedhësh nga duhet të shkosh, bile po të përcjellim. Ai e kuptoi se Ram Meta nuk donte të dilte haptas se ishte zogist, sepse komunistët edhe mund t'i rrezikonin jetën, ndaj dhe e shmangu konfrontimin me armë. Siç tregonte një veteran që ishte prezent në ngjarjen: “të gjithë kishim mbushur armët dhe ishim gati të nisnim pushkën”.

Ram Meta ka marrë pjesë në të gjitha luftërat që janë organizuar në mbrojtje të integritetit tokësor, të pavarësisë dhe të lirisë. Ai ka marrë pjesë edhe në kryengritjen e organizuar kundër regjimit austro-hungarez në vitin 1916 nga krerët e Postribës, megjithëse në moshën 20 vjeçare. Fshati Ura e Shtrejtë ka bërë besëlidhje brenda fiseve, gjatë luftës. Kjo besëlidhje i lejonte çdo personi ose fisi të Urës së Shtrejtë që të lidhej me parti politike të ndryshme gjatë luftës, për të marrë pjesë në çlirimin e vendit ose edhe për veprimtari të tjera që nuk i sillnin dëm popullit e vendit. Kushdo që mund të hynte në Ura Shtrejtë në besë të një fisi apo të një personi të vetëm nga Ura e Shtrejtë, atij i ruhej jeta nga të gjitha fiset e fshatit. Lidhja e besës ishte një lidhje që bazohej në besën e Zotit.

Ram Meta ka qenë kryetar i pajtimit të gjaqeve për gjithë Postribën për 25 vjet rresht (1931-1956). Këtë e konfirmon djali i tij, Sabri Rama dhe për të cilin konfirmim unë nuk kam ndonjë kundërshtim nga pleq të tjerë deri tani, (shënimi im, R. S).

Ai ka marrë pjesë në matjen e sipërfaqeve të maleve për ndërtimin e hartave, me gjeologë rusë e anglezë, në malet nga Cukali e deri në Theth. Me ekipet e gjeologëve ka vazhduar për 4-5 vjet.

Ram Meta ka qenë një burrë i gjatë, rreth dy metra, me trup të drejtë, i pashëm, me fytyrë karakteristike të një malësori verior, i ashpër por fisnik. Ai ishte burrë me temperament sanguin. Ishte tip i gjallë, i fortë, i ekuilibruar dhe i ngadaltë në marrjen e vendimeve.

Ai nuk ngutej kur fliste, por nuk tërhiqej nga bindjet e tij, kur e gjykonte se ishte në rrugën e drejtë.

Duke qenë kryetar i pajtimit të gjaqeve për gjithë Postribën (kjo sipas djalit të tij, Sabri Rama, shënimi im, R. S), për një periudhë 25 vjeçare, ai kishte përfutur një përvojë të madhe në gjykim e urtësi, ndaj dhe

fjala e tij kishte peshë të madhe në shoqëri. Ai ishte njeri me pak vese dhe shumë virtyte njerëzore. Ram Meta ishte burrë i besës, i matur, i guximshëm, i ekuilibruar, bujar, dashamirës, fisnik e tolerant në falje.

Në familje ruante autoritet, por i donte pjesëtarët e familjes, e veçanërisht nuset e djemëve i respektonte më shumë.

Ram Meta ka punuar pak në bujqësi. Ai ka pasur zanatin e muratorit dhe kryesisht të karpentierit, pasi merrej kryesisht me mbulim shtëpish. Në shoqëri ai sillej mirë, i donte dhe i respektonte të gjithë por më shumë ka dashur Zog Tahirin, Sadri Cagin, Isuf Hasanin nga Ura e Shtrejtë.

Ram Meta ka qenë besimtar i devotshëm. Ai ka mbajtur Ramazanin, ka qenë i drejtë dhe nuk u ka hyrë në hak njerëzve. Ai nuk ka pasur komplekse fetare dhe i ka pëlqyer gjithmonë biseda me priftërinj, pasi, siç thonte ai: “priftërinjtë janë politikanë dhe njerëzit përfitojnë nga ata” .

Si në çdo familje të Postribës, pothuajse, edhe në familjen e Ram Metës, meshkujt ishin të ndarë në parti politike të ndryshme. Kështu Ram Meta ishte zogist (në Partinë e Legalitetit), Can Meti ishte nacionalist, ndërsa Rexhep Meti ishte me Partinë Komuniste. Kjo ndarje ishte bërë nën zgjuarsinë e Ram Metës, në mënyrë që kushdo forcë politike të fitonte luftën, të përfitonte edhe familja e tyre.

Ram Meta ishte politikan në shpirt, dhe aq sa e kuptonte ai politikën. Ai ndiqte gjithmonë parimin e Postribës: “Postriba është gjithmonë me atë që sundon Kalanë e Shkodrës!” Ai diti t’i përshtatej çdo rrethane dhe çdo sistemi që erdhi në fuqi në Shqipëri

Ram Meta do të mbetet gjithmonë në kujtesën e njerëzve në ditë festash, kur merrte pjesë në gëzimet, apo në dasmat që organizoheshin, kur ai bënte kërcimet dyshe së bashku me një grua. Këto kërcime që populli i quante “dyshe” ishin të tilla kur shkriheshin në një të vetme epika me lirikën, trimëria me dashurinë.

Trupi i Ram Metës i gjatë, i drejtë, i zhdërvjelltë, elastik, i lehtë në kërcim, i pashëm dhe azgan, fisnik në paraqitje, do të mbetet në kujtesën e atyre që e panë duke e hedhur këtë valle, si një harmonizim i rrallë i një arti koreografik.

Në vitin 1967, në organizimin tradicional të festës së Reçit në Malësinë e Madhe, Ram Meta takohet me udhëheqësin e Partisë e të Shtetit të asaj kohe, Enver Hoxhën, dhe së bashku me të dhe me Dervish Haxhinë, kushëririn e tij, bën një fotografi. Sistemin komunist nuk e kam dashur kurrë dhe për këtë unë kam paraqitur pikëpamjet e mia në librin që po shkruaj për Postribën. Megjithatë, mendoj se gjërat duhet të shihen me objektivitet, duke pasqyruar anët negative dhe pozitive të çdo sistemi pa as më të voglin paragjykim.

Gjithsesi, në këtë rast unë vlerësoj figurën e Ram Metës, sepse nuk ishte gjë e vogël që një burrë Postribe të dilte në fotografi me një udhëheqës të atij sistemi që ishte në fuqi, të atij sistemi që Postriba e kundërshtoi që në krijimin e tij, në vitin 1946 me Kryengritjen Antikomuniste, e aq më tepër të një sistemi të diktaturës më të egër në Europë.

Ram Meta ishte një burrë postribas i tillë që vlerësohej jo vetëm nga populli i Postribës, por edhe nga udhëheqësi i shtetit shqiptar të asaj kohe. Enver Hoxha nuk pranonte të dilte në fotografi me burra të rëndomtë, por me ata burra që ishin vlerësuar nga koha dhe populli, jo vetëm nga populli i Postribës, por edhe nga populli i maleve të Malësisë së Madhe, të Dukagjinit, të Shllakut e Dushmanit etj.

Figura e Ram Metës do të ruhet në kujtesën e postribasve dhe të të gjithë atyre që e kanë njohur, si një burrë nacionalist, i urtë e i matur, i drejtë e fisnik, me të gjitha vlerat e një malësori që lë gjurmë në histori.

RAM NURO HALILI-DRAGOÇ

Ram Nuro Halili ka lindur në Dragoç më 10 gusht të vitit 1878 dhe ka vdekur në vitin 1951 në fshatin Dragoç.

Ram Nuro Halili rrjedh nga një familje nacionaliste e fisit të njohur Halilaj në Dragoç. Ky fis ka ardhur nga Shkreli i Malësisë së Madhe. Sipas gojëdhënave, fisi Halili ose Halilaj ka ardhur në Dragoç nga një lagje e Shkrelit, e quajtur Dragoç. Ka edhe një mendim tjetër që mund të ketë ardhur nga një fshat i rrethinave të Tuzit me prejardhje nga feja katolike. I pari i këtij fisi i quajtur Tefë (Shtjefën) Tufa, për arsye gjaku është detyruar të emigrojë me gjithë familje në Dragoç. Tefa, pastaj u konvertua në mysliman, i vetëquajtur nga Tefë, Halil, ndaj dhe nga ky emër ka lindur mbiemri “Halili”, më vonë u vetëquajtën

“Halilaj” dhe në fund u reduktua ky mbiemër në “Halaj”. Sot pothuajse të gjitha familjet e këtij fisi gëzojnë mbiemrin “Halili”.

Ram Nurja, djali më i madh i Nuro Brahimit, kishte dy vëllezër Dyl dhe Nasuf Nurja, me të cilët shkonte shumë mirë. Kjo vërtetohet nga dy aspekte që po i paraqes më poshtë:

Aspekti i parë: për hir të vëllait të vogël, Nasufit, ka pranuar të strehojë partizanë në shtëpi.

Aspekti i dytë: për të nderuar partizanët dhe vëllain e tij, në një kontroll nga gjermanët (thuhet se gjermanët ishin të pirë, por kjo nuk dihet saktësisht), në momentin që ata po hynin në shtëpi, Rami hyn në dhomën e partizanëve me nagant në dorë dhe u thotë: “Në qoftë se është e vërtetë që ju keni dalë për liri e vatan sot është dita me luftue. Shtëpinë e kam dy katëshe, çatia le të futet në themele, të gjithë njerëzit e shtëpisë le të vdesin, pushkën do ta filloj unë i pari. Kush të dorëzohet prej jush do ta vras me dorën teme”. Rama vendos një karrigë të vjetër në korridor, para derës së dhomës ku ishin partizanët, në mënyrë që po të hynin gjermanët aty do të hapej zjarri së pari nga Ram Nurja. Ky incident u evitua për fatin e mirë që gjermanët nuk hynë në këtë dhomë.

Në kohën kur mendohej të organizohej kryengritja antikomuniste, Ram Nurja nuk ishte dakord me organizimin e kësaj kryengritjeje, pasi ai e mendonte se kjo kryengritje ishte e tradhtuar nga krerët e qytetit të Shkodrës.

Shtëpia e Ram Nuros ka qenë bazë e Luftës Nacional-çlirimtare bashkë me disa shtëpi të tjera në Dragoç si shtëpia e Musa Muho Spahisë me vëllezër, shtëpia e Man Beqir Hasajt, shtëpia e Cuf Adem Hasajt e të tjera.

Shtëpia e Ram Nuro Halilit dhe shtëpia e Rac Bajram çelajt, dy baza, njëra e partizanëve dhe tjetra e ballistëve, kanë bashkëpunuar vazhdimisht në mbrojtje të fshatit, duke mbajtur një besëlidhje të fuqishme mes njëri-tjetrit. Kjo bëhej që të mos kishte konfrontime mes partive që vepronin në zonë si dhe të mos kishte konfrontime në mes fiseve të Dragoçit dhe të Postribës.

Ram Nuro Halili ka marrë pjesë në të gjitha luftërat që janë organizuar në mbrojtje të lirisë, të pavarësisë dhe të sovranitetit tokësor. Bashkë me burrat e Postribës dhe nën udhëheqjen e parisë së vendit dhe të komandantit popullor, Adem Haxhija, Ram Nurja ka marrë pjesë në Rrethimin e Shkodrës, në fusha të Myselimit dhe në Bardhanjel, megjithëse në moshë të re, rreth 30 vjeç. Gjithashtu ka marrë pjesë edhe në Luftën e Koplikut të vitit 1920, në Suka të Moksetit dhe bashkë me burra të tjerë të Postribës ka luftuar pa kursyer asgjë në mbrojtje të lirisë e të pavarësisë së vendit.

Ai ka qenë kundër pushtimit fashist të vitit 1939, dhe bashkë me trimat e Postribës ai ka marrë pjesë në rezistencën që i është organizuar pushtimit fashist në Kodra të Tepes, në Bahçallek dhe në Kodra të Bërdicës.

Ram Nurja ka qenë njeri i drejtë dhe i ndershëm.

Ai ka pasur një temperament kolorik, ka qenë shumë gjaknxehtë, i papërmbajtur, i fortë dhe i paekuilibruar në paraqitjen e situatave të vështira.

Ai ka qenë me karakter të fortë, ka pasur tiparet e një burri verior, i besës, i vendosur për t’i çuar punët deri në fund, mikpritës, i dashur me njerëzit.

Ram Nurja ka pëlqyer këngët e epikës legjendare, si ato të Mujos e Halilit, të Gjergj Elez Alisë, si dhe këngët e epikës historike, të luftës për liri e pavarësi kombëtare, këngët e trimave etj. Vëllai i Ram Nuros, Nasuf Nurja ka marrë pjesë në Luftën Nacional-çlirimtare që në vitin 1944 dhe deri në çlirimin e vendit. Nasuf Nurja u inkuadrua në Ushtrinë Nacionalçlirimtare me krijimin e Brigadës XXVII Sulmuese të UNÇLSH në qytetin e Shkodrës.

Nasuf Nurja gjatë gjithë jetës së tij mbetet një nationalist i vendosur dhe i devotshëm. Ai nuk bëhet anëtar i Partisë Komuniste, pavarësisht se i ofrohet një kërkesë e tillë. Ai pranoi që djemtë e tij Hasan Nasufi dhe Tahir Nasufi të bëhen anëtarë partie.

Nasuf Nurja është dekoruar disa herë me urdhëra trimërie dhe me medalje për periudhën e Luftës Nacional-çlirimtare si dhe me rastet e përvjetorëve të themelimit të Ushtrisë Nacional-çlirimtare

Në shtëpinë e Ram Nuros janë strehuar partizanët si Qazim e Fadil Kapisyzi, Fiko Canja, Sadik Bekteshi, Bilal Parruca e të tjerë.

Familja e Ram Nuros do të kujtohet si një nga familjet e mira të fshatit Dragoç dhe të Postribës.

RAMO SALIH HASAJ-DRAGOÇ

Ramo Salih Hasaj rrjedh nga një familje me tradita nacionaliste të fisit Hasaj nga fshati Dragoç, të Postribës, të ardhur nga zona e Shkrelit.

Thuhet se i pari i tyre ishte një pinjoll shumë i largët i të birit të Gecit, të atij që zuri vend në Shkrel, i cili duke rënë në varfëri atje, erdhi në Dragoç si rrogëtar dhe zuri vend bri kushërinjve të largët. Prej tij u krijuan dy vëllazëri: Halilajt dhe Hasajt, të cilët më vonë formuan fise më vete. Me këta dy vëllazëri mbahen edhe Bracajt e Dragoçit, të cilët erdhën shumë më vonë Shkrelit.

Ramo Salih Hasaj u lind në Dragoç në vitin 1862 dhe vdiq po në Dragoç në vitin 1949, në moshën 87 vjeçare.

Ramo Salih ka qenë një nga shtëpitë e mëdha në Dragoç. Ai ka pasur të mbledhur në shtëpinë e tij 65 vetë, të përfshirë në katër breza njerëzore dhe 17 kurorë së bashku (Beqir Salih me djem 6 kurorë, Adem Salih 4 kurorë, Haxhi Ramo Salih 5 kurorë dhe Malo Ramo Salih 2 kurorë).

Ramo Salih Hasaj ka poseduar një pasuri të madhe të tundshme dhe të patundshme. Baba i tij Salih Bajrami u la vetëm 3 dynym tokë si trashëgim tre djemve të tij kur vdiq. Me punën e tij dhe të të gjithë pjesëtarëve të familjes ai arriti të ketë 150 dynym tokë arë në Dragoç, 450 dynym tokë arë në Guçi dhe 350 dynym livadhe në Livadhet e Shkodrës. Ai kishte 500 krerë dhenë, 4 pendë që pune për plugimin e tokës, 2 kuaj karroce për transportimin e prodhimeve bujqësore, një kalë shale të cilin e përdorte edhe për kaloshin (pajton) për shëtitje kudo ku kishte miq.

Duke jetuar një periudhë të lavdishme të popullit tonë në luftë të vazhdueshme me pushtuesit e huaj në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe të sovranitetit tokësor, Ramo Salih, i ndikuar nga luftëtarët patriotë të Postribës, merr pjesë që i ri në luftën kundër serbomalazezëve rreth viteve 1875-1880, por bajraktari i Boksit nuk e lë të luftojë në vijën e frontit, por e vë në shërbim të luftëtarëve larg rrezikut të jetës, pasi ishte shumë i ri.

Ramo merr pjesë në të gjitha luftërat në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe të integritetit tokësor së bashku me luftëtarët dhe prijësit e Postribës. Ai merr pjesë në Rrethimin e Shkodrës në vitet 1912-1913 në Bardhanjel dhe në Fusha të Myselimit dhe nën udhëheqjen e bajraktarëve dhe të komandantit të shquar popullor Adem Haxhi Spahija, shquhen për trimëri dhe vendosmëri në mbrojtjen e trojeve tona.

Ramo Salih merr pjesë në Kryengritjen e Postribës kundër pushtimit austrohungarez që organizohet në afërsi të Urës së Mesit nën komandën e komandantit popullor Adem Haxhija dhe të bajraktarëve të Drishtit, të Boksit dhe të Sumës.

Më 2 dhjetor të vitit 1922 Ahmet Zogu emërohet kryeministër duke mbajtur edhe postin e ministrit të punëve të brendshme. Gjatë kësaj periudhe, qeveria ndjek kundërshtarët, pra veprimtarët e partisë opozitare. Në këtë kuadër, në Postribë arrestohen nga qeveria Rac Bajrami, Ramo Mustafa (Bushaj) nga fshati Kullaj-Boks dhe Ramo Salih (Hasaj) nga fshati Dragoç. Këta internohen në Vlorë. Ramo Salih ishte me pikëpamje nolistë dhe si i tillë ndiqet nga qeveria e Zogut bashkë me nolistët e tjerë.

Me ndërhyrjen e gjeneralit dhe kryeadjutantit Zef Serreqi, i cili kishte miqësi të fortë me Rac Bajramin, Ahmet Zogu i liron tre burrat e Postribës.

Ramo Salih ka qenë burrë i besës, besimtar i mirë dhe i devotshëm. Ai ka falë 5 kohët e namazit, ka mësuar në fe në arabisht dhe ka mbajtur mjekër. Për këtë populli e quante me respekt "Molla Ramja". Ai ka falë zeqatin dhe ka pasur parimin që çdo vit nga delet të jepte sadaka një dele në çdo 40 krerë edhe sikur të takonte e katërdhjeta dashi apo delja më e mirë.

Ramo Salih ka qenë i dashur në familje dhe i respektuar në shoqëri. Ai gjithashtu ka shkuar mirë dhe ka pasur miqësi me burra të njohur në Shkodër, si me Muzhanët katolikë, ashtu edhe me Tepelijajt e Bushatllinjët myslimanë. Në Postribë ka shkuar mirë me Rac Bajramin, Nuz Halilin, me Kasem Bracin etj.

Duke qenë mikpritës, ai nuk ka nxjerrë kurrë jashtë shtëpisë udhëtarë të mbetur jashtë gjatë lëvizjes nga Dukagjini për në Shkodër dhe anasjelltas. Ai ka qenë njeri me temperament të qetë dhe me karakter të fortë.

Ramo Salih Hasaj i ka dashur shumë kafshët. Këtë dashuri e ka shprehur me atë që para se të siguronte bukën për familjen e tij, ai siguronte bazën ushqimore për dimërimin e blegtorisë.

Duke qenë një besimtar i mirë, ai nuk ka qenë asnjëherë inatçor apo hakmarrës, ka qenë durimtar i mirë duke ruajtur ekuilibrin islam. Ai përdorte gjithmonë një shprehje: "Zoti në qiell dhe qeveria në tokë".

Ramo Salih Hasaj do të kujtohet nga brezat e rinj si një burrë nacionalist, besimtar i mirë dhe njeri i jetesës, si një kryefamiljar që i dha emër shtëpisë së tij për nga pasuria. (Shënim: të dhënat janë marrë nga Faik Isa Hasaj si dhe nga materiali historik që kam në arkivin tim personal, R. S).

SADIK ZYBER LISAJ - VILZË

Sadik Zyber Lisaj ka lindur në Vilzë me datën 10 mars të vitit 1910 dhe ka vdekur në vendlindjen e tij me datën 25 tetor të vitit 1977, në moshën 67 vjeçare.

Sadik Zyber Lisaj rrjedh nga një familje me tradita patriotike dhe besimtare të fisit të njohur Hetaj të fshatit Vilzë të Postribës. Para se ta merrte bajraktarllëkun e Drishtit fisi Muhaj i Kalasë së Drishtit, e mbante Vilza dhe pikërisht fisi Hetaj.

Sadik Zyberi me të vëllanë, Avdi Zyberi ishin dy burra të njohur dhe të vlefshëm, jo vetëm në Vilzë, por në të gjithë Postribën. Sadik Zyber Lisaj lindi në prag të lëvizjeve të mëdha nacionaliste të vendit tonë, në prag të pavarësisë kombëtare dhe ndoshta koha, në të cilën u lind, ndikoi fuqishëm në edukimin e tij me ndjenja nacionaliste, i cili më vonë kur të bëhej djalë dhe zot i mendjes do të brumosej me idealet nacionaliste të kombit, në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe integritetit tokësor.

Këtu poshtë po jap një vlerësim të studiuesit Hashim Kopliku, i cili në mes të tjerave thotë: ***“Fisi i vjetër që është shuar pothuajse krejtësisht, më tepër prej luftërave, kanë qenë fisi Hetaj, burrat e të cilit krahasoheshin me Mujon e Halilin, për nga fuqia e tyre”***.

Për fuqi të tyre sjellin një gojëdhënë: Thuhet se kur një burrë Hetajsh ishte duke pluguar arën, një i fuqishëm duke ia ndierë zërin këtij fisi erdhi në Vilzë për të bërë bejleg (duel). Ky i tha burrit të Hetajve:

- Ku e ka shtëpinë burri i fortë i Hetajve?

- Njatje (atje) - i tha burri që po plugonte tokën dhe me njerën dorë ngriti parmenden bashkë me pendën e qeve dhe tregoi drejtimin nga e kishte shtëpinë burri i fortë i Hetajve.

Bejlegtarin (njeriun që kërkonte duel) e kapi frika e duke e gjykuar se një njeri, që atij iu duk asgjë kishte aq fuqi sa për të çuar parmenden bashkë me pendën e qeve me njerën dorë, ndaj dhe drodhi e u largua pa bërë bejleg me burrin e Hetajve. ***(Nga fisi i Hetajve, sot kemi shtëpijat e Sadik Zyberit, Avdi Zyberit, Halil Brahimit, e të tjerë, të cilët kanë pasë bajraktarinë para se ta merrte Drishtin,*** (shënim i im, R. S). Shtëpijat e Hetajve sot i trashëgojnë Bracajt. (Hashim Kopliku, “Cirka”, 1938).

E solla këtë shëmbull nga studimet e Hashim Koplikut, të shkruar në “Cirka” në vitin 1938, sa për të dhënë një informacion për ata që dëshirojnë të dinë për fiset e Postribës diçka nga e kaluara e tyre.

Sadik Zyber Lisaj ishte njeri i zgjuar, i matur, i besës, i burrërisë, i trimërisë, fisnik deri në mrekulli, i dashur me njerëzit, i respektueshëm, me të gjitha vlerat që mund të ketë një burrë shqiptar verior.

Unë, autori i këtij libri, e kujtoj me një respekt të veçantë këtë burrë, i cili edhe në shtëpi kishte një disiplinë të natyrshme, që më dukej se rridhte si një ujëvarë harmonishëm duke të lënë mbresa të pashlyera në shpirt. Unë nuk e merrja vesh asnjëherë se si ai kuptohej me njerëzit e shtëpisë së tij, pa folur por vetëm me shenja dhe çdo veprim kryhej sikur të shkelej një buton komandimi.

Shtëpia e tij njihej si një shtëpi e madhe në fshatin Vilzë dhe si një shtëpi shëmbull, nga ku mund të merrte mësim çdo familje tjetër. Ai zotëronte një sipërfaqe të konsiderueshme toke në pronësinë e tij, kishte prozhme gati sa gjysma e fshatit Vilzë, kishte tri krerë lopë, 40 krerë dhenë, 150 krerë dhi, mbi 35 koshere primitive bletë, kafshë ngarkese si mushkë, kalë, etj.

Shtëpia e Sadik Zyber Lisaj ka qenë bazë e Luftës Nacional-çlirimtare dhe siç tregon Isa Avdi Lisaj, nipi i tij, në shtëpinë e Sadik Zyberit ka qenë e vendosur pllakata e luftës. Shtëpia e tij ka strehuar partizanët gjatë luftës, si Sadik Bekteshin e të tjerë.

Sadik Zyber Lisaj ka qenë njeri besimtar dhe si i tillë ai është përpjekur për të realizuar pesë shtyllat e Islamit, duke i shërbyer besimit Islam me devotshmëri.

Sadik Zyber Lisaj do të mbetet në kujtesën e brezave pas tij, si një burrë fisnik, i zgjuar, i matur dhe i dashur me njerëzit, nacionalist, i besës, i burrërisë, një burrë tipik verior më të gjitha cilësitë dhe virtetet njerëzore.

SAIT DUL BUSHAJ-KULLAJ

Sait Dul Bushaj u lind në fshatin Kullaj-Boks më 1 shtator të vitit 1878 dhe vdiq në afërsi të Fermentimit të Duhanit më 9 shtator të vitit 1946, i pushkatuar nga forcat e sigurimit të shtetit për pjesëmarrje në Kryengritjen Antikomuniste të Postribës.

Sait Duli ka marrë pjesë në të gjitha luftërat që janë zhvilluar në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe të integritetit tokësor. Ai mori pjesë në Rrethimin e Shkodrës në vitin 1911-1912 në frontin e Myselimit dhe atë të Bardhanjelit, i organizuar me të gjitha forcat luftëtare të Postribës nën komandën e komandantit popullor, Adem Haxhi Spahija, front që u mbajt me trimëri e heroizëm nga forcat e Postribës, në mbrojtje të qytetit të Shkodrës.

Sait Duli merr pjesë në kryengritjen e vitit 1916 kundër pushtimit ushtarak të forcave austro-hungareze dhe në afërsi të Urës së Mesit bien në përpjekje me forcat ushtarake austro-hungareze, të cilat të mundura nga kryengritësit, tërhiqen me ngutësi për në Shkodër.

Sait Duli merr pjesë në Luftën e Koplikut në vitin 1920 bashkë me axhën e tij, Nuz Imerin dhe me forca të tjera të mbarë Postribës dhe luftojnë me heroizëm kundër forcave pushtuese serbo-malazeze të organizuar nën komandën e Adem Haxhisë dhe të parisë së Postribës.

Sait Duli ishte një burrë i urtë, fisnik, trim, besnik dhe besimtar i devotshëm në fenë islame. Ai kurdoherë ka punuar, pleqnar dhe luftuar në të mirën e Postribës, në të mirën e vendit.

Ai ishte burrë që kishte aftësi dhe urtësi në pleqnim jo vetëm në fis, por edhe në fshat e bajrak. Ai ishte burrë aktiv në marrjen e vendimeve dhe pleqimin e kuvendeve që bënin burrat e urtë të Postribës.

Sait Dul Bushaj bënte pjesë në familjen e madhe të Isa Nuzit të fshatit Kullaj, të njohur për pasuri e burrëri. Në këtë familje përfshiheshin 10-12 kurorë dhe tre deri në katër breza njerëzorë, në të cilën bëheshin rreth 63 frymë. Ata kishin rreth 300 dynym tokë, rreth 300 krerë dhenë, 20 krerë lopë, dy deri në tre pendë qe pune për plugimin e tokës, kalë shale e ngarkese, karrocë e qerre transporti për nevojat e familjes, 30 koshere bletë etj.

Sait Duli merr pjesë në rezistencën që organizohet nga krerët e Postribës dhe komandanti popullor Adem Haxhi Spahija, kundër pushtimit fashist italian, rezistencë që u organizua në Kodra të Tepes, në Bahçallek dhe në Kodra të Bërdicës.

Sait Duli merr pjesë në Kryengritjen Antikomuniste të 9 shtatorit të vitit 1946 dhe për këtë pjesëmarrje dënohet me pushkatim në afërsi të Fermentimit të Duhanit në Shkodër. Në dokumentët historike ka të pasqyruar këto rreshta: “ Në hyrje të fshatit Kullaj, plaku e trimi i rrallë, Sait Duli (Bushaj), mbasi kishte zënë një pozicion të favorshëm luftimi, i vetëm, do të bllokonte në vend disa forca qeveritare, duke u dhënë kështu edhe një mundësi më tepër djemve të Postribës që të vazhdonin ngjitjen e tyre në male. Pas njëfarë kohe, Sahit Dulit do t’i bllokohej pushka e përfundimisht kapet i gjallë prej forcave të Sigurimit, të cilët, pasi ta torturonin barbarisht, gjysmë të vdekur do ta venin para për në Shkodër, ku ai s’do të mbërrinte kurrë, sepse në hyrje të saj, ai do jepte shpirt e partizanët për të mos e zgjatur më, do ta pushkatonin në vend (Ahmet Bushati, “Në gjurmë të një ditari”, fq. 117).

Në librin “Epos’i Shqipeve” të autorit me pseudonim “Veri Jugu”, në mes të tjerave ka këto rreshta:

“ ... Sait Duli shpatë e gjallë
I ka dalë ushtrisë përballë.

.....

Sait Duli burrë i pjekur
Ky plak trim ky zemër hekur
Dalë kadalë për faqe t’bardhë
Kur ka pa ushtrinë tuj ardhë
Kah po mësyjshin me furi
Porsi reja e zezë me shi
Aty trimi zemër nguti
Zemra e tij si qeskë baruti
Maliherin xu me mbushë
Pesë fishekë ia futi në gushë ...”

Sait Dulit vërtetë iu bllokua pushka, por deri në atë moment ai bllokoi forcat e togës së zezë të xhelatit Zoi Themeli dhe u dha mundësi djemve të Postribës që të tërhiqeshin në mal për t'u mbrojtur.

Sait Duli u pushkatua në afërsi të Shkodrës, por nga ajo ditë e zezë e deri më sot nuk u gjet varri i tij.

Sait Dul Bushaj nuk ishte i vetmi në familje që njihet në fshat e bajrak. Ai, me edukimin e mirë të fisnikut, të burrit të besës dhe të trimërisë, të mikpritjes e bujarisë diti të lërë pasardhës të denjë në shërbim të familjes, fisit e shoqërisë. I tillë është djali i tij, Abdullah Sait Bushaj.

Abdullah Sait Bushaj u lind në fshatin Kullaj-Boks më 7 mars të vitit 1915. Ai ishte një nga organizatorët kryesorë në Kryengritjen Antikomuniste të 9 shtatorit të vitit 1946. Ai vërtetë ishte më i ri se burrat e tjerë të Postribës, por edhe në këtë moshë tregoi pjekurinë dhe vendosmërinë e tij kundër ideologjisë komuniste dhe regjimit diktatorial të këtij regjimi. Ai ishte një besimtar i mirë dhe si i tillë nuk mund të pajtohej asnjëherë me një ideologji pa fe, pa atdhe, pa Zot, pa shpirt. Ai do të luftonte me vendosmëri përkrah burrave të tjerë të Postribës në mbrojtje të lirisë, të fesë, të atdheut, të besimit në një Zot. Abdullah Sait Bushaj merr pjesë në të gjitha mbledhjet që organizohen në Postribë për përmbysjen e regjimit komunist në Shqipëri dhe është i vendosur për ta çuar këtë luftë deri në fund.

Gjatë pjesëmarrjes në kryengritje, Abdullah Sait Bushaj kapet nga forcat qeveritare dhe burgoset në burgjet e regjimit të egër komunist ku vuan torturat më çnjerëzore për të treguar se kush ish organizatorët kryesorë të kësaj kryengritje, por ai merr mbi vete çdo faj duke mos ngarkuar asnjë nga burrat e Postribës që kishin qenë rganizatorët kryesorë të kësaj kryengritje.

Abdullah Sait Bushaj do të vuajë dënimin me heqje të lirisë për disa vjet nën torturat më të egra të regjimit komunist dhe pasi del nga burgu, i thyer në moshë nuk do të jetojë gjatë. Ai vdes në fshatin Kullaj-Boks me datën 23 qershor të vitit 1979 duke lënë pas vetes brezin e ri, i cili do ta ketë në kujtesë për shumë vite pas, si një burrë trim, i besës, besimtar i devotshëm, antikomunist i vendosur dhe fisnik e nacionalist i mirë.

Sait Duli dhe djali i tij Abdullah Saiti u sakrifikuan në mbrojtje të lirisë, të besimit, dhe nuk u shkoi munda kot sepse do të vinte një ditë që idealet e tyre do të realizoheshin dhe fantazma komuniste nuk do të endej më në trojet e Postribës. Postriba vërtetë humbi disa jetë burrash, nga më trimat dhe më të vendosurit në mbrojtje të nacionalizmit, të atdheut dhe të fesë kundër një regjimi pa Zot, pa fe e atdhe, por do të realizonte një ditë aspiratat e veta, aq të kërkuara në shekuj.

SYLEJMAN TURKU (KARMAJ)-BOKS

Ngjarja që do të tregoj më poshtë nuk është as trillim, as krijimtari prej shkrimtari, as dëshirë, as ëndërr, por një ngjarje e vërtetë që ndodhi në fillim të vitit 1818:

Ishte vetëm pesëmbëdhjetë vjeç kur doli nga shtëpia e tij, nga Karma e Mirditës. Quhej Lekë Bici. Rugës shoqërohej nga vëllai i madh i tij. Ai do të vendosej në fshatin Rragam të Shkodrës, në familjen e kumbarit së tij të quajtur Murat Osmani, gjyshi i Isen Osmanit. Këtu Leka do të vihej në shërbim të familjes së kumbarit, i cili do ta shpërblente me një sasi patesh që do ta shikonte të arsyeshme. Lekë Bici nuk e mendonte kurrë se largimi nga shtëpia do t'i ndryshonte gjithë jetën e tij.

Në familjen e Murat Osmanit, Lekë Bici nis një jetë të re. Gjëja e parë që i la mbresa në shpirtin e tij, ishte mënyra se si myslimanët lidheshin me Zotin e tyre. Ndryshonte në themel nga ritet e besimit katolik në kishë. Siç i tregonin të rinjtë myslimanë, çdo besimtar komunikonte me Zotin e tij pesë herë në ditë. Ata faleshin edhe në shtëpi, edhe në xhami. Myslimanët para se të faleshin, pastronin trupin, merrnin abdes, pastaj duke u drejtuar nga Qabja kryenin faljen sipas rregullave islame. Leka nuk e kuptonte pse myslimanët binin me fytyrë në tokë, ose siç i thonin ata, me krye në sezhde duke iu lutur Allahut të tyre për jetën e përtejme, për jetën qiellore.

Lekë Bici në kontakt me të rinjtë e familjes dhe të fshatit Rragam, fillon ta pëlqejë besimin islam. Ai nis të shkojë në xhami çdo ditë të premte dhe gradualisht fillon të mësojë mënyrën e faljes. Ai, sa hynte në xhami, ndiente në shpirt një respekt disi të veçantë. Ai mbushej me një ndjesi që i dukej se vinte nga qielli. Ndihej i lumtur në shpirt se diçka po kryente në rrugën e vërtetë, në rrugën e Zotit. Fillon të mësojë sure nga Kur'ani dhe lutje islame, rregullat e faljes...

Ishte natë Bajrami kur Lekë Bici ndihej shumë i sëmurë. Kishte temperaturë. Me gjithë kujdesin e madh të familjes së kumbarit, duke i shërbyer për t'ia ulur temperaturën, ai gjatë gjithë natës edhe në

mëngjesin e ditës së parë të Bajramit ka temperature të lartë. Ai dëshironte me gjithë shpirt që të shkonte për të falur Bajramin, por gjendja e tij e rëndë nuk e la të shkonte në xhami.

Në kohën që myslimanët po falnin Bajramin, do të ndodhte mrekullia me Lekë Bicin. Do të ndodhte ajo mrekulli që do t'i ndryshonte gjithë jetën e tij. Në një gjendje të një temperature të lartë, në një kllapi mes jetës dhe vdekjes, i paraqitet si një vegim, as ëndërr, as zgjuar, as gjallë, as vdekur, silueta e hoxhës i veshur krejtësisht me rroba të verdha prej floriri, dhe me një mjekër të gjatë e të bardhë. Hoxha hyri në dhomë dhe u nis drejt tij tek krevati. Ai ngjasonte në fytyrë me hoxhën e Rragamit. Afrohet ngadalë, ulet pranë tij dhe i vë gishtin tregues në mes të ballit duke e thirrur tre herë me emrin "Sylejman!" Sylejman! Sylejman!" në intervale të njëjta. Në këtë moment ai del nga kllapia dhe habitet kur vëren se nuk ka asnjë farë temperature, pra ndihet krejtësisht i shëruar. çohet shpejt nga krevati dhe shkon në kuzhinë, i thotë zonjës së shtëpisë, që po piqte petullat e Bajramit, t'i jepte disa petulla për ta qerasur hoxhen. E zonja e shtëpisë bashkë me Lekën kërkojnë hoxhën nëpër shtëpi për ta qerasur por nuk e gjejnë.

Lekë Bici mendon me vete: "Tri herë më thirri hoxha me emrin "Sylejman!" dhe mbas tri thirrjeve në personin tim kishte ndodhur mrekullia, isha i shëruar krejtësisht!"

Mbasi kryhet falja e Bajramit, hoxha bashkë me njerëzit e shtëpisë së Murat Osmanit shkon për të uruar Bajramin në familje. Leka bashkë me zonjën e shtëpisë e pyesin hoxhën se nga kishte humbur kur e kërkuar për ta qerasë. Ai u tha se nuk kishte qenë në shtëpi në atë kohë por në xhami. Pastaj ai i pyeti se si qëndronte puna. Leka i tregoi hoxhës se si i qe paraqitur si në ëndërr kur ai ishte me temperaturë të lartë. Hoxha e kuptoi se Lekës i qe paraqitur një nga ëngjëjt e mëdhenj të Zotit, ndaj dhe ishte një shenjë i mirë për të.

Nga ky moment, Lekë Bici vendosi të bëhet mysliman dhe si emër pranoi emrin Sylejman që ëngjëlli ia kishte përsëritur tri herë. Leka i kërkoj hoxhës që ai t'i tregonte kushtin që e lejonte të kthehej mysliman. Hoxha i tha se shtylla e parë e besimit islam ishte dëshmia. I ndihmuar nga hoxha, Leka bëri dëshminë: "Dëshmoj se nuk ka tjetër Zot veç Allahut dhe Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij!" Lekë Bici i vetëquajtur Sylejman Turku (Karma), ra shehadet dhe pranoi Islamin si fe. Nga kjo ditë ai quhet Sylejman Turku.

Një vit nga dita e largimit nga Karma, shkon vëllai i tij në Rragam për ta marrë, por Sylejman Turku, nuk pranon të kthehet më në Karmë, pasi ishte konvertuar vullnetarisht në mysliman. Me këtë rast, krijohet konflikt mes këtij dhe vëllait që kishte shkuar për ta marrë. Gjithashtu, vëllai i tij hyn në konflikt edhe me familjen e Murat Osmanit, e cila, sipas tij, e kishte prerë në besë që e kishte detyruar Leken të konvertohej në mysliman. Por Leka i thotë se familja e Murat Osmanit nuk kishte asnjë faj, pasi ishte zgjedhja e tij për t'u kthyer në fenë islame, në fenë e vërtetë. Në fund vëllai i thotë Lekës se ku do t'i linte prindërit, kush do t'i mbante babë e nënë të moshuar!? Sylejman Turku i thotë të vëllait se prindërit do t'i mbante ai gjithë jetën, me kusht që të konvertohen në myslimanë dhe të shkojnë me të. Në të kundërtën t'i mbante ai me vëllezërit e tjerë pasi të gjithë kishin detyrime të njëjta për prindër.

Meqenëse familja e Murat Osmanit hyn në konflikt me fisin Karmaj të Mirditës, vendos ta largojë Sylejman Turkun duke e çuar tek Bushatllinjët e Shkodrës, tek Shaban Efendia, gjyshi i Sylço Begut. Ky vendim u mor rreth viteve 1820. Në moshën Shaban Efendia, gjyshi i Sylço Begut. Ky vendim u mor rreth viteve 1820. Në moshën shtatëmbëdhjetë vjeçare, Sylejman Turku shkon rrogëtar tek Shaban Efendia në Shkodër dhe punon aty për katër-pesë vjetë. Siç e kujtonte Sylejman Turku, në atë kohë në Shkodër kishte, veç Bedistenit, edhe tre dyqane: një që shiste kripë, një cikërrimtar dhe një dyfekçi (që rregulloheshin armë). Në atë kohë, përsëri sipas tij, Ura e Bunës nuk ekzistonte, pasi Drini derdhej në Lezhë dhe kishte aq pak ujë Buna sa që kalohej me kapërcime mbi gurë të vendosur për këtë qëllim.

Fisi Karmaj vazhdon ta ndjekë këmba-këmbës Lekë Bicin për ta vrarë, pasi ai kishte tradhëtuar fenë e tij duke u konvertuar nga Lekë në Sylejman. Kjo gjë i bie në sy edhe familjes së Shaban Efendisë, ndaj dhe illon të marrë masa që të mos i ndodhë gjë Sylejman Turkut. Gjatë kësaj kohe, ai vë në dijeni drejtuesit e dy besimeve në Shkodër, kryemyftinë dhe ipeshkvin. Këta të dy së bashku thërrasin Sylejman Turkun për të marrë vendimin e tij se cilën fe do të dëshironte për të mbajtur. Sylejman Turku në prezencën e kryemyftisë dhe të ipeshkvit pranon me kënaqësi besimin islam. Kryemyftia e pajisë Sylejmanin me një shkrim të shenjtë në formë hajmalie, duke e pranuar në besimin Islam.

Shaban Efendi Begu bie në kontakt me Haxhi Isen Spahinë si vojvodë i Boksit dhe i kërkon ta mbajë pranë fisit të tij, pasi ndiqej nga fisi Karmaj dhe mund të rrezikohej jeta e tij po të qëndronte aty. Haxhi Isen Spahija e merr Sylejman Turkun dhe e strehon në shtëpinë e tij, duke i lëshuar një tra shtëpie, siç

quhej atëherë hapësira mes dy trerëve (aq sa të shtrosh një dyshek gjërësi), dhe i jep për grua, një nga bijat e fisit të tij. Nga ky moment Sylejman Turku bëhet dhëndërr i fisit të Spahijajve. Në vendin e quajtur "Shegat e Ibre," ai i jep një pjesë të mallit dhe aty ai jeton deri sa vdes në vitin 1928, në moshën 125 vjeçare.

Me bijën e Spahijajve, Sylejman Turku lind dy djem, Dyl dhe Zeqir Sylejmani, të cilët nuk lënë rashëgimtarë, vdesin. Gjithashtu vdes edhe gruaja e tij.

Martesën e dytë, Sylejman Turku e bën me hallën e Bajram Idriz Nehanaj, me të cilën i lindin përsëri dy djem, Dervish dhe Rexhep Sylejmani, të cilët nuk arrijnë të lënë trashëgimtarë, i vdesin. Gjithashtu i vdes edhe gruaja e dytë.

Martesën e tretë, e bën me Sutë Bajram Grudën, hallën e Man Alush Grudës nga Dragoçi, me të cilën i lindin nëntë fëmijë, katër djem dhe pesë vajza. Djemtë quheshin: Musë, Adem, Reshit e Zeqir Sylejmani. Vajzat quheshin: Zyfë, Mine, Hava, Rrukë dhe Zylë Sylejmani, të cilat jetojnë të gjitha. Gjithashtu i jetojnë edhe katër djemtë...

Sot nga Lekë Bici, i konvertuar në Sylejman Turku (Karma) numërohen rreth 500 pasardhës, të gjallë dhe të vdekur, të gjithë myslimanë. Sot ka mbi 25 familje të vendosura në lagjen Rrasek të fshtatit Boks, që rrjedhin prej tij.

Me konvertimin e tij në mysliman, Sylejman Turku bëri qaben pa shkuar në Qabe, duke lënë si pasardhës rreth 500 myslimanë të devotshëm të besimit Islam.

Duke qenë njeri i veçantë Sylejman Turku bëhet objekt i artit figurativ. Piktori i mirënjohur shkodran, Kolë Idromeno, i bën një pikturë në vaj në moshën njëqind vjeçare, duke i vënë dixhidurën "Plaku njëqind vjeçar i Postribës" të cilën po e paraqesim në libër. Sylejman Turku ka marrë pjesë në Rrethimin e Shkodrës në vitin 1912, gjithashtu merr pjesë edhe në Luftën e Koplikut në vitin 1920, por meqenëse ky ishte i vetëm në shtëpi dhe nuk kishte njeri tjetër që të çonte në luftë, i japin leje të largohet nga fronti pasi Postriba kishte një rregull për të marrë pjesë në luftë: "Nga një trim për tim (tym, shtëpi)". Ai kthehet në shtëpi i urdhëruar për të rritur fëmijët.

Sylejman Turku do të mbetet në historinë e Postribës si një rast i rrallë, si një gur i çmuar dhe shembull frymëzimi për besimtarët myslimanë dhe për brezat që do të vijnë.

YMER SHABAN BUSHAJ-KULLAJ

Ymer Shabani ka lindur në fshatin Kullaj në vitin 1907 dhe ka vdekur në vendlindjen e tij në vitin 1984.

Ymer Shabani rrjedh nga një familje nacionaliste e fisit Bushaj të fshatit Kullaj. Fisi i tij Bushaj mendohet të kenë ardhur nga Mirdita, ashtu si shumica e banorëve të fshatit Boks.

Ymer Shabani ishte nip nga qyteti i Shkodrës. E ëma ishte bijë e Mllojajve të Shkodrës, por duke jetuar në fshatin e asaj kohe ku mbisundonte analfabetizmi, ai pati shumë vështirësi për të mësuar shkrim e këndim. Me gjithë këto vështirësi, Ymer Shabani, duke qenë nip Shkodre, bie në kontakt të vazhdueshëm me njerëz të ditur dhe me vullnet shumë të fortë e aftësitë e tij të lindura arrin që në mënyrë autodidakte të mësojë shkrim e lexim shqip si dhe të përvetësojë me të shkruar e me të folur gjuhën arabe.

Duke lexuar literaturë shkencore dhe artistike, me mençurinë që e karakterizonte, ishte në gjendje të diskutonte me mësuesin, mjekun, agronomin e veterinarin, me priftin e hoxhën.

Ymer Shabani ishte një plak i zgjuar, ndaj dhe si i tillë, ai mori pjesë në pleqënimin e shumë gjaqeve, konflikteve e mosmarrëveshjeve midis njerëzve, jo vetëm në zonën e Postribës por edhe në zona të tjera, së bashku me pleqtë e urtë Osman Haxhi Spahija nga Boksi, Met Rexha nga Shakota, Ramë Meta nga Ura e Shtrejtë e të tjerë.

Ai vlerësonte shumë të kaluarën pozitive të fiseve dhe familjeve më të mira, duke i ruajtur këto vlera, si dhe përkrahte me forcë të renë, përparimtarën, progresin njerëzor. Ai jetonte me mendimin që shoqëria njerëzore nuk duhet të mbetet statike, por të jetë vazhdimisht në zhvillim, në ndryshim, në marrjen e vlerave më pozitive, të cilat e drejtonin njeriun drejt virtyteve hyjnore.

Ymer Shabani ishte edhe një njeri me humor të hollë dhe këtë humor e kthente vazhdimisht në shaka. Sa për ilustrim të kësaj që thashë, do të tregoj një rast kur një vajzë jo normale e gjakut të tij e pyet kur ai po milte një dhi, i thotë: "Ymer Aga, a është mashkull a femën ajo që po mjel?!"

Ymeri i përgjigjet: " Nuk e di moj Luti, por unë po e mjeli njëherë e pastaj do ta shikoj nëse është mashkull apo femën." . Një rast tjetër dikush e pyet: "Ymer Aga kur e keni ba atë lopë?!" (ishte fjala për

blerje, pra kur e kishin blerë). Ymeri i përgjigjet: “Nuk e kena ba, por e kena ble.” Ymer Shabani ishte një plak i zgjuar, ndaj dhe si i tillë, ai mori pjesë në pleqërimin e shumë gjaqeve, konflikteve e mosmarrëveshjeve midis njerëzve, jo vetëm në zonën e Postribës por edhe në zona të tjera, së bashku me pleqtë e urtë Osman Haxhi Spahija nga Boksi, Met Rexha nga Shakota, Ramë Meta nga Ura e Shtrejtë e të tjerë.

Ai vlerësonte shumë të kaluarën pozitive të fiseve dhe familjeve më të mira, duke i ruajtur këto vlera, si dhe përkrahte me forcë të renë, përparimtarin, progresin njerëzor. Ai jetonte me mendimin që shoqëria njerëzore nuk duhet të mbetet statike, por të jetë vazhdimisht në zhvillim, në ndryshim, në marrjen e vlerave më pozitive, të cilat e drejtonin njeriun drejt virtyteve hyjnore.

Ymer Shabani ishte në gjendje që kur rrinte me fëmijët, fliste me gjuhën e fëmijëve, kur rrinte me të rinjtë fliste me gjuhën e të rinjve, kur rrinte me bashkëmoshatarët, fliste me gjuhën e tyre, kur rrinte me të moshuarit bisedonte si i moshuar dhe kur rrinte me intelektualë bisedonte si një intelektual, bile u bënte pyetje të tilla, sa i vinte në pozitë të vështirë ata.

Ymer Shabani ishte një burrë i pashëm dhe shumë i mençur. Kushdo që ndodhej para atij burri ndihej në vështirësi, pasi ai dukej sikur i studionte njerëzit sikur u dinte çdo gjë që ata përqeshin për ta fshehur diku në skutat e shpirtit të tyre.

Ai ishte burrë trim por i mençur, fisnik dhe bujar, i besës dhe i zakonit, besimtar dhe i ekuilibruar në kryerjen e çdo veprë që merrte mbi vete.

Ymer Shabani ishte kryetar i këshillit të fshatit Kullaj, kur u bë Kryengritja Antikomuniste e 9 shtatorit të vitit 1946. Në këtë kohë komandanti i operacionit terrorist për shtypjen e kryengritjes, i kërkoi si kryetar këshilli që të jepte tre emra për njerëzit që duheshin pushkatuar, në këmbim të dorëzimit të armëve, Ymeri u shpreh para fshatarëve të tij: “Më kërkoni të dorëzojmë armët ose të jap tre emra për pushkatim. Ju e dini se armë nuk kemi, por edhe emra për pushkatim nuk mund të jap. Kështu që për pushkatim do të dalim unë edhe vëllai im Brahimi, për të tretin të bëjnë çfarë të duan.” Në këtë mënyrë Ymeri shpëtoi fshatin dhe u bë një shëmbull i mirë që duhet vlerësuar. Akti i Ymer Shabanit për të pranuar pushkatimin bashkë me të vëllanë, në mënyrë që të shpëtojnë jetën e bashkëfshatarëve të tij, është shumë burrëror e fisnik, është një akt sublim.

Ymer Shabani ishte një burrë i duruar, i sakrificës dhe me një shpirt të madh. Nuk duhet harruar shëmbullin i jashtëzakonshëm në kohën që i vdiq djali i madh nga një vdekje e papritur. Ishte e vështirë për atë burrë për të provuar vdekjen e djalit të martuar e me fëmijë, por ai bisedonte me njerëzit që kishin ardhur për ngushëllime, sikur të ishte në një gëzim të madh dhe bisedonte me djalin e tij të vdekur sikur ta kishte të gjallë. Një qëndrim i tillë, prej një burri fisnik siç ishte rasti i Ymer Shabanit nuk harrohet lehtë nga ata njerëz që kishin para tyre një burrë legjendar.

Ymer Shabani e donte shumë këngën. Ai ishte mjeshtër në punimin e instrumenteve popullore, si të lahutës, të çiftelisë etj., por ishte edhe një instrumentist i mirë. Ai i binte lahutës dhe këndonte këngë të epikës legjendare, këngë të epikës historike, si këngët për liri, pavarësi e mbrojtje të integritetit tokësor, këngë të trimave etj.

Ai ishte mjeshtër i mirë i drurit dhe i gurit. Ai kishte duar të arta në punime të tilla. Ymer Shabani kishte karakter të fortë, ishte i vendosur dhe i matur në marrje vendimesh dhe kishte zakon që t'i çonte deri në fund detyrat që merrte mbi vete.

Ymer Shabani nuk mund të merrte pjesë në Kryengritjen Antikomuniste të 9 shtatorit, pasi në shtëpinë e tij kishte operativin e asaj kohe, por ai gjithsesi ndihmoi duke ruajtur në konspiracion çdo gjë në mbrojtje të fshatit të tij.

Ymer Shabani do të kujtohet për shumë kohë si një burrë i mençur, i drejtë, i ditur, fisnik, i ekuilibruar dhe shumë i dashur me njerëzit.

ZENEL ALIJA (BAJRAKTARI) KULLAJ - BOKS

Zenel Alija ka lindur në fshatin Boks rreth vitit 1835 dhe ka vdekur në Boks në vitin 1925, në moshën 90 vjeçare.

Ai rrjedh nga një familje me tradita të shkëlqyera nacionaliste të fisit Bajraktari të bajrakut të Boksit. Fisi i tij mendohet të ketë prejardhjen nga Alijajt e Kastratit. Zenel Alija ka qenë bajraktar i bajrakut të Boksit pasi i vdiq i ati, Ali Haxhija, që e kishte këtë detyrë para tij e ka mbajtur bajraktarllëkun deri sa ia

dorëzoi këtë detyrë vëllait të tij Haxhi Alija. Vëllai i gjyshit të Zenel Alisë, i quajhuri Tahir Haxhija, merr pjesë në Luftën e Ulqinit në vitin 1880 dhe në luftë e sipër vdes heroikisht. Populli e ka përjetësuar jetën e tij në këtë luftë me këngën si më poshtë:

“ ... - O Tahir, Tahir Haxhija,
Apo të dhimbet bukuria?!
“ -Nuk po më dhimbet bukuria,
Por po më dhimbet Shqipëria! “
“- O Tahir, o trimi i trimit!
ç’i bane armët e florinit?
“- I kam vjerrë n’gem t’ullinit,
Me i ba rreze gjithë Ulqinit!” ...”.

Zenel Ali Bajraktari ka marrë pjesë në të gjitha luftërat që janë zhvilluar në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe të ruajtjes së integritetit tokësor të vendit, duke drejtuar djalërinë e bajrakut të Boksit dhe së bashku me bajraktarët e tjerë të bajrakëve Drishtë e Sumë, të gjithë luftëtarët e Postribës.

Në Rrethimin e Shkodrës të vitit 1911-1912, Zenel Alija, si bajraktar i bajrakut të Boksit, së bashku me bajraktarët e tjerë të Postribës dhe me komandantin popullor Adem Haxhi Spahija u prin luftëtarëve të Postribës që u vendosën në dy frontet më të vështira të këtij rrethimi, në Fusha të Myselimit dhe në Bardhanjel. Postriba u shqua në këtë luftë për trimëri dhe qëndresë, duke mos e lëshuar frontin për depërtimin e forcave të pushtuesve serbo-malazezë në drejtim të Shkodrës.

Në vitin 1916, me pushtimin ushtarak austro-hungarez, Postriba me krerët e saj si Zeqir Tafa, bajraktar i Drishtit, Zenel Alija, bajraktar i Boksit, Sadri Alija, bajraktar i Sumës dhe komandantin popullor Adem Haxhi Spahija organizojnë një kryengritje me të gjithë luftëtarët e saj kundër këtij pushtimi dhe në përpjekje me forcat pushtuese në afërsi të Urës së Mesit, e detyrojnë ushtrinë austro-hungareze të tërhiqet drejt Shkodrës, të dështuar me turp.

Në vitin 1919, Zenel Alija merr pjesë në organizimin e besëlidhjes që bëhet në mes të Postribës dhe Dukagjinit në Prekal, për koordinimin e përbashkët të luftës kundër pushtuesve serbo-malazezë. Ai firmos në këtë akt besëlidhjeje së bashku me krerët e këtij bajraku, si më poshtë:

Paria: Isuf Sul Velija, Tahir Haxhija, Nuz Halili, Idriz Zhiri, Adem Haxhija. Bajraktari: Zenel Alija.

Në vitin 1920 Zenel Alija merr pjesë në Luftën e Koplikut së bashku me forcat e Postribës dhe me Adem Haxhinë, si komandant popullor, në të cilën luftë Postriba lufton me heroizëm kundër forcave pushtuese serbo-malazeze dhe i detyrojnë pushtusit të dalin jashtë trojeve shqiptare.

Zenel Ali Bajraktari ishte një burrë fisnik në shpirt, me tiparet e një burri verior, që di të falë por di edhe të luftojë në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe të integritetit tokësor. Ai ishte një burrë i besës, të cilën e mbështeste në besën e Zotit, sepse besa e Zotit ishte besë e burrave të kohës. Zenel Alija ishte burrë trim që nuk kursente asgjë në mbrojtje të lirisë dhe pavarësisë së atdheut. Ai ishte me zemër të gjerë, i dashur me njerëzit, por edhe i rreptë me kundërshtarët e tij dhe e të gjithë ata që cënonin interesat e vendit.

Zenel Alija ishte shumë besimtar. Nipi i tij, Elez Brahimi tregon një episod të bukur në lidhje me shkallën e lartë të besimit që kishte ai. Elez Brahimi tregon: “ Ishin vitet e fundit të jetës së tij. Unë isha në atë kohë rreth tre vjeç, në vitin që do t’i vinte vdekja. Këtë ma tregon baba im. Ishte muaji i Ramazanit i vitit 1925. Momenti i vdekjes i vjen kështu: në sabah, pasi fal namazin e sabahut, fillon të këndojë (lexojë) në musaf (libër i besimit islam). Duke kënduar në libër përkulet në një rënë anë dhe në moment i del shpirti, rast i rrallë për një vdekje të tillë”.

Duke qenë besimtar, Zenel Alija edukon tek fëmijët e tij ndjenjën e besimit tek një Zot, tek Kurani dhe librat e shenjtë. Pasardhësit e tij vazhdojnë rrugën e besimit në fenë Islame dhe si të tillë ata janë kundërshtarë të vendosur të ideve komuniste dhe të komunizmit si ideologji. Për këtë, në vitin 1946, djali i tij Imer Zeneli (Bajraktari) pushkatohet si kundërshtar i kësaj ideologjie dhe i regjimit komunist në Shqipëri. Ai pushkatohet me burra të tjerë në fushën e Shtojit, si me Brahim Selimin, Metush Alinë, Qazim Rrojin nga Shkodra, Rexhep Idrizin, Sylo Canin nga Mesi, Reshit Beqirin, Halil Dautin etj.

Vëllai i Zenel Alisë, Muharrem Alija (Bajraktari), me kërkesën e Pashës, dërgohet për studime ushtarake në Stamboll. Për disa vjet kryen akademinë ushtarake dhe merr gradën e oficerit madhor. Gjatë kohës që ishte me studime, vjen dy - tre herë me leje nga Stambolli. Siç tregon Elez Brahimi, nipi i Zenel Alisë, rreth

viteve 1911-1912, Muharrem Ali Bajraktari, vjen me leje nga Stambolli. Nga tre bajrakët e Postribës organizohet një pritje në Ulqin. Për ta pritur, shkojnë në Ulqin 30 burra me kuaj shale nga e gjithë Postriba dhe e presin atje për tre ditë e net. Pasi vjen në Ulqin vijnë me të në Postribë dhe organizojnë tre ditë festë për nder të ardhjes së tij në vendlindje.

Pasi del oficer madhor nuk ka karrierë të gjatë ushtarake. Një ditë në bisedë me një shokun e tij, edhe ai oficer madhor që kishin kryer shkollën së bashku, hapet një debat për Shqipërinë dhe në debat e sipër ai e fyen Muharrem Ali Bajraktarin. Në fyerje e sipër ata vriten të dy dorë për dorë dhe ballë për ballë me njëri - tjetrin.

Fisi i bajraktarit të Boksit e ka marrë bajraktarllëkun e Boksit pas fisit Plangaj, i cili e kishte bajraktarllëkun para fisit të Zenel Ali Bajraktarit.

Zenel Ali Bajraktari dhe të gjithë ata burra që drejtuan këtë bajrak, do të nderohen dhe do të kujtohen nga brezi i ri, si burra fisnikë dhe të besës, si nacionalistë të vendosur në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe të sovranitetit të kombit.

ZOG MUSTAF DEMAJ - BOJAJ SUMË

Zog Mustaf Demaj ka lindur në Bojaj të Sumës në vitin 1880 dhe ka vdekur në vendlindjen e tij në vitin 1960, në moshën 80 vjeçare. Ai rrjedh nga një familje me tradita të mira patriotike dhe është derë e fisme në Bojaj të Bëshkasit. Fisi i tij ka gëzuar vendin e vojvodës.

Zog Mustaf Demaj ka qenë vojvoda i fshatit Sumë dhe ka mbajtur detyrën e kryeplakut deri pas çlirimit të vendit. Ai ka marrë pjesë në të gjitha pleqnitë që janë zhvilluar jo vetëm brenda bajrakut të Sumës por edhe në Postribë e më gjerë duke pleqnuar si plak të gjitha mosmarrëveshjet, konfliktet apo gjakmarrjet brenda dhe jashtë Postribës, duke përfshirë edhe Dukagjinin, Shllakun etj. Ai ka pleqnuar me burrat e nderuar si Kasem Imerin e Dajcës, Vatë Marashin e Vatnikajve, Ali Manin e Bukmirës, me pleq të Dukagjinit etj.

Do të përmendi një shembull pleqnie të Zog Mustafës në lidhje me grabitjen e një arme të një burri nga një burri tjetër. Burri që kishte grabitur armën, i kërkoi Zog Mustafës që ta pleqnonte si për vete. Zog Mustafa i tha se do ta pleqnonte drejtë, e do ta linte mirë, por jo si për vete. Burri nguli këmbë përsëri që ta pleqnonte si për veten e tij. Atëherë Zog Mustafa i tha: po deshe me të pleqnue si për vete, atëherë merr armën dhe shko e vra burrin që i ke grabitur armën, pra poshtëroje dy herë. Këtë Zog Mustafa e bëri për të ushtruar presion tek burri që kërkonte padrejtësisht ta pleqnonte si veten, pasi e dinte se ai nuk kishte të drejtë në kërkesën e tij. Burri i tha se këtë nuk mund ta bënte, pasi e kuptoi se ai e kishte poshtëruar një herë. Atëherë, i tha Zog Mustafa atij që kërkonte të përfitonte padrejtësisht, burrit që i ke grabitur armën duhet t'i kthesh dy armë për një, një për të paguar armën që i ke grabitur dhe të dytën për të paguar poshtërimin që i ke bërë padrejtësisht. Këtë Zog Mustafa e bëri për të evituar gjakmarrjen në mes grabitësit të armës dhe të atij që i ishte grabitur arma.

Në besëlidhjen që u bë në Prekal më 25 shtator të vitit 1919, mes Postribës dhe Dukagjinit, Zog Mustafa firmos aktin e besëlidhjes mes Postribës dhe Dukagjinit bashkë me burrat e bajrakut të Sumës si më poshtë:

Bajraku i Sumës: Paria: Lec Martini, Marash Kola, çot Ujka, Zog Mustafa, Vat Marashi. Bajraktar: Ali Hajdari.

Pra, Zog Mustafa firmos këtu në cilësinë e vojvodës së Sumës bashkë me parinë e vendit dhe bajraktarin Ali Hajdari.

Zog Mustaf Demaj ishte nacionalist me pikëpamje zogiste. Ai ishte përkrahës i Zogut. Pas çlirimit, duke pasur dyshime në personin e tij, regjimi komunist e arreston dhe e mban në hetuesi për 9 muaj rresht, por për mungesë provash dhe faktesh detyrohen ta lirojnë nga burgu.

Regjimi komunist arreston edhe vëllain e tij, Haxhi Mustaf Demaj bashkë me Kolë Bishen nga Dajca dhe pasi i arrestojnë në Sumë, i nisin për në Shkodër të shoqëruar me policë, por diku nga Drishti, afër Kirit hidhen të dy në lumë dhe ikin pa mundur për t'i kapur. Disa kohë më vonë i arrestojnë përsëri dhe i burgosin, por nga torturat e rënda Haxhi Mustafa nuk jeton shumë pasi del nga burgu, ndërsa Kolë Bisha jeton gjatë pas daljes nga burgu.

Ka një shembull të rrallë në lagjen Bojaj që ka mbetur në histori si unikal, që nuk ka ndodhur në asnjë bajrak tjetër. Zog Mustafa me pleq arrijnë të pajtojnë një gjak, kur një shtëpi e fortë në Bojaj fal 7 gjaqe në

një kohë, pra 7 burra të vrarë në shtëpinë e tij dhe për të ndaluar gjakderdhjen mes fisesh shtëpia e fortë e fisit të fortë Bojaj arrin të falin përgjithmonë gjakun e shtatë meshkujve të tij. Me këtë akt heroik të kësaj shtëpie të fortë u ndalua gjaku mes tyre.

Duhet të vlerësoj se nuk është e lehtë që të falësh gjakun e shtatë meshkujve. Falja e gjakut është më e vështirë se marrja e gjakut, prandaj është thënë nga burrat se është më vështirë të falësh se të vrasësh. Por, në të njëjtën kohë është thënë se të falësh është më burrëri se të marrësh gjak.

Zog Mustaf Demaj ka marrë pjesë në të gjitha luftërat që janë zhvilluar në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe të integritetit tokësor. Ai ka marrë pjesë në Rrethimin e Shkodrës në vitin 1912-1913 bashkë me burra të tjerë postribas. Ai merr pjesë edhe në Luftën e Koplikut të vitit 1920 bashkë me luftëtarët e tjerë të Postribës, të udhëhequr nga bajraktarët e vojvodët si dhe nga komandanti popullor Adem Haxhi Spahija.

Zog Mustaf Demaj do të kujtohet nga brezi i ri si një nga burrat më në zë të Postribës, si një burrë që di të flasë pak, por në ato pak fjalë ruhen vlerat e një burri që bëri emër në Postribë e më gjerë.

(Shënim: Të dhënat kryesore për Zog Mustaf Demen u morën nga çelë Ahmet Demaj nga lagjia Bojaj e fshatit Sumë dhe një pjesë nga materiali historik që gjendet në arkivin tim, R. S).

BURRA TË TJERË NË ZË NGA POSTRIBA

Në Postribë ka shumë burra të tjerë në zë, por për arsye të ndryshme subjektive, mbetën pa u pasqyruar në këtë kapitull. Një pjesë e këtyre burrave, me gjithë këmbënguljen time për të komunikuar me njerëzit e familjeve apo të të afërmeve të tyre, për mosvlerësim apo për subjektivizma të tjera kanë mbetur pa pasqyruar aktivitetin dhe jetën e tyre patriotike. Këtë e them me keqardhje, megjithatë unë do të paraqes emrat e një pjese, të cilët kam mundur t'i identifikoj në bashkëpunim edhe me njerëz të afërm apo burra të vjetër në Postribë. Këtu poshtë po i paraqes emrat e tyre me qëllimin e mirë që studiues të tjerë pas meje, të mund të pasqyrojnë jetën dhe aktivitetin patriotik të këtyre burrave në zë:

Në Drisht

Metush Halil Çelaj
Dan Ceni
Osman Met Hamja

Në Domën

Jaho Brahim Guri
Rruk Brahim Mastaj
Sylo Turk Guri

Në Ura Shtrejtë

Isuf Sylo Fikaj
Asallan Bajram Malaj
Selim Zenel Myrtaj
Isuf Brahim Lumaj
Dyl Jaho Lumaj (mjek popullor)

Në Mes - Myselim

1. Rrustem Haxhi Uraj
2. Hajdar Ram Alijaj
3. Tafil Haxhi Hysaj
4. Met Manush Hysaj:

Në Kullaj

Selim Memë Cekaj
Brahim Selim Cekaj

Në Rrash - Vorfë:

1. Dan Hasani në Rrash

Në Sumë

1. Brahim Kasemi në Dajcë
2. Halil Zeneli në Bukmirë
3. Met Rexha në Shakotë
4. Sadri Alija në Shakotë
5. Lic Mehmeti (Kocaj) Pergjon.
6. Kol Maçi në Delaj
7. Vat Marashi në Vatnikaj
8. Tush Pepa në Vatnikaj
9. Ali Mani në Bukmirë
10. Çotë Ujka në Pergjon
11. Voc Gjoni në Dajcë
12. Lic Hasani në Likaj
13. Bush Lika në Likaj
14. Kasem Imeri në Dajcë.

Postriba ka edhe burra të tjerë që i meritojnë së paku pesë rreshta mbi jetën dhe veprimtarinë e tyre patriotike. Atyre u mbetem shumë borxh, por besoj se të tjerë studiues pas meje do të pasqyrojnë të dhëna dhe vlera të tjera për Postribën.

Shkodër, më 15 janar 2013

Autori
Riza Spahija